

VIKTOR HYGO

TË MJERËT

ROMAN

Vëllimi I

E përktheu nga origjinali

MISTO TRESKA



Pjesa e parë

••••••••••••••••••••

FANTINA

Titulli i origjinalit:
LES MISÉRABLES

copyright © BOTA SHQIPTARE, 2012
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Redaktor: Kujtim Gjonaj
Përkujdesja grafike: Studio grafike BJORN

ISBN 978-9928-00-072-9
ISBN 978-9928-00-073-6

Botues: Genti Gjonaj
Shtëpia botuese BOTA SHQIPTARE

Sa kohë që, për shkak të ligjeve dhe të dokeve, do të ketë në botë një mallkim shoqëror, që në palcë të qytetërimit krijon në mënyrë të rreme skëtterra; sa kohë që të tri problemet e shekullit: zvetërimi i burrit të katandisur në proletar, poshtërimi i gruas nga uria, atrofizimi i fëmijës nga errësira, nuk do të jenë zgjidhur; sa kohë që në disa rajone asfiksia shoqërore do të bëjë të sajën; me fjalë të tjera, dhe nga një pikëpamje akoma më të gjerë, sa kohë që do të ketë mbi tokë padije dhe mjerim, libra si ky nuk do të jenë të padobishëm.

Hotëvilë-Hauz, 1 janar 1862

Libri i parë

NJË NJERI I DREJTË

I

Zoti Miriel

Më 1815 zoti Charl-Fransua-Bienvëny Mirieli ishte ipeshkv i Dinjës. Ai ishte një burrë plak, shtatëdhjetë e pesë vjeç; selinë ipeshkvore e mbante që nga viti 1806.

Megjithëse kjo imtësi nuk e prek në asnjëfarë mënyre thelbin e asaj që kemi për të treguar, jemi të mendjes se nuk do të ishte pa dobi, qoftë edhe vetëm sa për të qenë të përpiktë në gjithçka, po të shënonim këtu të gjithë zërat e thashethemet që kishin marrë dhenë lidhur me të në kohën kur pati ardhur në dioqezë. E vërtetë ose e rremë qoftë, ajo që thuhet për njerëzit, zë po aq vend në jetën e tyre e sidomos në fatin e tyre sa edhe punët që bëjnë. Zoti Miriel na ishte biri i një këshilltari në Kuvendin e Drejtësisë së Eksit; derë gjykatësish. Flitej për të se i ati, duke dashur ta bënte trashëgimtar të ofiqit që mbante, e kishte martuar fort herët, në moshën tetëmbëdhjetë-ose-njëzetvjeçare, sipas një zakoni mjaft të përhapur në familjet e këshilltarëve. Charl Mirieli, ndonëse i lidhur me këtë martesë, thuhej se kishte dhënë shkas të hapeshin shumë fjalë rreth tij. Ishte burrë i pashëm, ndonëse pak i vogël nga shtati, sqimatar, i hijshëm dhe fort i mprehtë nga mendja; tërë pjesën e parë të

jetës së tij ai ua kishte kushtuar qejfeve dhe grave. Por, ndërkohë, erdhi Revolucioni, ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi, familjet e këshilltarëve, të dhjetuara, të ndjekura e të përndjekura, u shpërndanë sa andej këtej. Zoti Sharl Mirieli qysh ditët e para të Revolucionit mërgoi në Itali. E shoqja i vdiq atje nga një sëmundje kraharori, nga e cila ishte prekur që prej kohësh. Fëmijë nuk kishin. Çfarë ndodhi më pas me fatin e zotit Miriel? Mos vallë shembja e shoqërisë së vjetër franceze, rënia e familjes së vet, ngjarjet e vitit 93, ndoshta akoma më të frikshme për të mërguarit, që i shikonin këto ngjarje së largu të fryra e të zmadhuara nga tmerrri, i kallën në zemër ndjenjat e largimit nga shoqëria dhe të vetmisë? Apo mos vallë në mes të qejfeve dhe të dashurive që mbushnin jetën e tij, ai pësoi papritmas ndonjë nga ato goditjet e mistershme dhe të tmerrshme, të cilat, duke e qëlluar njeriun mu në zemër, ngandonjëherë vijnë dhe e përmbysin aq keq, sa as katastrofat publike nuk do ta kishin tronditur fare, edhe sikur t'i kishin cënuar jetën dhe pasurinë? Askush nuk mund të thoshte se si qëndronte puna: dihej vetëm se, kur erdhi nga Italia, ai ishte veshur prift.

Më 1804 zoti Miriel ishte famullitar i B. (Brinjolës). Qysh atëherë ai ishte i thyer në moshë dhe jetonte shumë i vetmuar.

Aty nga koha e kurorëzimit të Napoleon Bonapartit, një çështje e vogël e famullisë, nuk dihet fare se çfarë, e shpuri gjer në Paris. Përveç njerëzve të tjerë të fuqishëm, ai vajti e i kërkoi ndihmë për banorët e famullisë së vet edhe zotit kardinal Feshit. Një ditë, kur perandori kishte ardhur t'i bënte vizitë të ungjit, famullitari i denjë, që ishte duke pritur në paradhomë, qëlloi të ndodhej tamam aty ku do të kalonte madhëria e tij. Napoleoni, tek pa që plaku po e vështronte me njëfarë kureshtjeje, u kthye dhe tha befas:

-Ç'është ky njeri i mirë që m'i ka qepur sytë?

-Madhëri, - tha zoti Miriel, - ju po vështroni një njeri të mirë, por unë po vështroj një njeri të madh. Të dy jemi të fituar.

Perandori, po atë mbrëmje, i kërkoi kardinalit emrin e atij famullitari, dhe pas disa kohësh zoti Miriel u çudit shumë kur mori vesh se ishte emëruar ipeshkv i Dinjës.

Por, fundi i fundit, çfarë gjërash të vërteta kishte në tregimet që thureshin mbi pjesën e parë të jetës së zotit Miriel? Askush nuk e dinte. Pak familje e kishin njohur familjen e zotit Miriel përpara Revolucionit. Zoti Miriel duhej t'i nënshtrohej fatit të të gjithë atyre që vijnë rishmë në një qytet të vogël, ku ka shumë gojë që flasin e fort pak kokë që mendojnë. Atij iu desh t'i nënshtrohej këtij fati, ndonëse ishte ipeshkv, por edhe ngaqë ishte ipeshkv. Por, fundi i fundit, thashethemet kur merrej nëpër gojë emri i tij, ndoshta nuk ishin tjetër veçse thashetheme: zhurmë, fjalë, llafe, më keq se llafe, *pallavra*, siç thotë gjuha e gjallë e Jugut.

Sidoqoftë, pas nëntë vjetësh ipeshkvie dhe qëndrimi në Dinjë, të gjitha ato përralla të thëna poshtë e lart, që përbëjnë brumin e bisedave, me të cilat merren në fillim qytetet e vogla dhe njerëzit e vegjël, kishin rënë në një harresë të thellë. Askush nuk kishte guxim t'i zinte ngoje, askush, madje, nuk guxonte as t'i kujtonte.

Zoti Miriel kishte ardhur në Dinjë i shoqëruar nga një lëneshë, zonjusha Baptistinë, që ishte e motra dhe që ishte dhjetë vjet më e re nga ai.

Këta na kishin si shërbëtore të vetme një grua po në moshën e zonjushës Baptistinë, që i thoshin zonja Magluarë, e cila, pasi kishte qenë *shërbyesja e zotit famullitar*, kishte fituar tani titullin e dyfishtë: si shërbyese dhome e zonjushës dhe si ekonomë e imzotit.

Zonjusha Baptistinë ishte një grua e dobët, e zbehtë, e imët, e butë; ajo e meritonte në mënyrë ideale fjalën "e respektueshme"; sepse, mesa duket, u dashka medoemos që një grua të jetë nënë për të qenë e përnderueshme. Ajo s'kishte qenë asnjëherë e bukur; e tërë jeta e saj, e cila kishte qenë vetëm një varg veprash të shenjta, kishte arritur të derdhte mbi të njëfarë bardhësie e drite; dhe, duke u plakur, ajo kishte fituar atë që mund ta quanim bukuria e mirësisë. Kur ishte e re, ishte e dobët; tani, në moshën e pjekur ishte kthyer e bërë e tejpushme. Ajo ishte më shumë një shpirt, sesa një virgjëreshë. Trupi i saj dukej sikur ishte gatuar prej hijesh; aq trup, sa për të bërë bé që ajo ishte një femër: pak materie, që përmbante

një dritëz; sy të mëdhenj, që rrinin gjithmonë të ulur; një arsye, sa për të thënë se gjallonte mbi këtë dhé.

Zonja Magluarë ishte një plakëz bardhoshe, topolake, e ardhangët, përherë e zënë me punë, gjithë gulçime, së pari, se duart e këmbët s'i pushonin kurrë dhe, së dyti, se vuante nga astma.

Kur erdhi në Dinjë, zotin Miriel e vendosën në pallatin e tij ipeshkvor me të gjitha nderimet që kërkonin dekretet perandorake, të cilat e vënë ipeshkvin menjëherë pas gjeneralit të brigadës. Kryetari i bashkisë dhe kryetari i gjykatës i erdhën të parët për vizitë dhe ai, nga ana e vet, të parën vizitë ua bëri gjeneralit dhe prefektit.

Me të zënë vend në shtëpi, qyteti priti ta shihte ipeshkvin e vet në punë.

II

Zoti Miriel bëhet imzot Bienvëny

Pallati ipeshkvor i Dinjës ishte puq me spitalin. Pallati ishte një ndërtesë e madhe dhe e bukur, ndërtuar me gurë, qysh në fillim të shekullit të kaluar nga imzot Hanri Pyzheti, doktor në teologji i Fakultetit të Parisit, abat i Simorës, i cili ishte ipeshkv i Dinjës më 1712. Ky pallat ishte një banesë e vërtetë princore. Gjithçka kishte një pamje madhështie: edhe apartamentet e ipeshkvit, edhe sallonet, edhe dhomat, edhe oborri i nderit, fort i gjerë, me shëtitore dhe arkore, sipas modës së vjetër fiorentine, edhe kopshtet, të mbjella me drurë madhështorë. Në sallën e bukës, një galeri e gjatë dhe e madhërishtme, që ndodhej në katin përdhes dhe që shihte nga ana e kopshteve, imzot Henri Pyzheti u kishte pas shtruar për të ngrënë me ceremoni më 29 të korrikut 1713 imzotërve: Charl Brylar dë Zhanlit, arkipeshkv-princ i Ambrënit, Antuan dë Mesrinjit, kapuçin, ipeshkv i Grasës, Filip dë Vandomës, prior i madh i Francës, abat i Sent-Honoré dë Lerenit, Fransua dë Berton dë Krijonit, ipeshkv-baron i Vansës, Cezar dë Sabran dë

Forkalkierit, ipeshkv-sundimtar i Glandevës, dhe Zhan Soanenit, prift i oratorios, predikues ordinar i mbretit, ipeshkv-sundimtar i Senezit. Portretet e këtyre shtatë personazheve të përndershme zbukuronin atë sallë, dhe ajo datë e paharrueshme, 29 korrik 1714, ishte gdhendur me shkronja ari mbi një tryezë mermeri të bardhë.

Spitali ishte një shtëpi e ngushtë dhe e ulët me një kat të vetëm dhe me një kopsht të vogël.

Tri ditë pas mbërritjes së tij, ipeshkvi vizitoi spitalin. Si mbaroi vizitën, iu lut drejtorit të kishte mirësinë t'i vinte në shtëpi.

-Zoti drejtor, - i tha ai, - sa të sëmure keni tani?

-Njëzet e gjashtë, imzot.

-Edhe unë aq numërova, - tha ipeshkvi.

-Shtretërit, - vazhdoi drejtori, - janë shumë të ngjeshur njëri pas tjetrit.

-Edhe mua më ra në sy kjo gjë.

-Sallat nuk janë salla, por dhoma, dhe ajrosja aty bëhet me vështirësi.

-Edhe mua ashtu më duket.

-Dhe pastaj, kur bie ndonjë rreze dielli, kopshti është shumë i vogël për ata që janë përkëmbur nga sëmundja.

-Edhe unë ashtu po thosha me veten time.

-Palé kur kemi raste epidemish! Ja, p.sh., këtë vit patëm tifon, dy vjet të shkuar patëm ethet e nxehta, ngandonjëherë na bëhen gjer njëqind të sëmure; nuk dimë fare nga t'ia mbajmë.

-Edhe mua më shkoi mendja për këtë.

-Ç'të bësh, imzot, - tha drejtori, - do t'i shtrijmë këmbët sa kemi jorganin.

Kjo bisedë po bëhej në sallën-galeri të bukës në katin përdhes. Ipeshkvi mbeti një hop në heshtje, pastaj u kthye vrik nga drejtori i spitalit.

-Zotëri, - tha ai, - sa shtretër ju thotë mendja se mund të nxërë vetëm kjo sallë?

-Salla e bukës e imzotit? - bërtiti i çuditur drejtori.

Ipeshkvi hidhte vështrimin nëpër sallë dhe dukej sikur po maste e po llogariste me sy.

-Do të nxinte patjetër njëzet shtretër! - tha ai dhe dukej sikur po fliste me vete; pastaj duke ngritur zërin: - Dëgjoni, zoti drejtor, dua t'ju them diçka. Duket sheshit se në këtë mes ka një gabim. Ju jeni njëzet e gjashtë shpirt në pesë a gjashtë dhoma të vogla. Ne këtu jemi tre shpirt dhe kemi vend sa për gjashtëdhjetë. Ja ku po ju them se këtu ka një gabim. Ju do të merrni shtëpinë time dhe unë po marr tuajën. Kthemani shtëpinë që më përket mua. Kjo shtëpia këtu është juaja.

Të nesërmen, të njëzet e gjashtë fatkeqët u vendosën në pallatin e ipeshkvit dhe ipeshkvi në spital.

Zoti Miriel s'kishte asnjë pasuri, sepse familja e tij ishte rrënuar nga Revolucioni. E motra gëzonte një rentë prej pesëqind frangash të ardhura në vit, të cilat, në shtëpinë priftërore, mjaftonin për shpenzimet e saj vetjake. Zoti Miriel merrte nga shteti si ipeshkv një rrogë prej pesëmbëdhjetë mijë frangash. Po atë ditë kur erdhi e u vendos në ndërtesën e spitalit, zoti Miriel përcaktoi një herë e përgjithmonë përdorimin e kësaj shume në mënyrën që vijon. Po sjellim këtu një shënim të shkruar me dorën e tij:

Shënim për të rregulluar shpenzimet e shtëpisë sime

Për seminarin e vogël	<i>një mijë e pesëqind livra</i>
Kongregata e misionit	<i>njëqind livra</i>
Për lazaristët e Montdidierit	<i>njëqind livra</i>
Seminari imisioneve të huaja në Paris	<i>dyqind livra</i>
KongregataeShpirtit të Shenjtë	<i>njëqind e pesëdhjetë livra</i>
Themelatat fetare të Tokës së Shenjtë	<i>njëqind livra</i>
Shoqëritë e mëshirës amësore	<i>treqind livra</i>
Shtojcë për Shoqërinë e Arlës	<i>pesëdhjetë livra</i>
Vepra për përmirësimin e burgjeve.....	<i>katërqind livra</i>
Vepra për lehtësimin dhe çlirimin e të burgosurve	<i>pesëqind livra</i>
Për të liruar etërit e familjeve të burgosur për borxhe	<i>një mijë livra</i>
Shtojcë mbi rrogat e mësuesve të varfër të dioqezës	<i>dy mijë livra</i>

Për depon e rezervave të grurit në Alpet e Epërme
Kongregata e zonjave të Dinjës, të Manoskës e të Sisteronit për arsimin falas të vajzave të varfra
Për të vobektit
Shpenzimet e mia
Shuma.....

njëqind livra

një mijë e pesëqind livra

gjashtë mijë livra

një mijë livra

pesëmbëdhjetë mijë livra

Gjatë gjithë kohës që qëndroi në Dinjë, zoti Miriel nuk i bëri pothuajse asnjë ndryshim këtij rregullimi. Ai e quante këtë, siç e shohim, *të rregulluarit e shpenzimeve të shtëpisë së vet.*

Këtë rregullim e pati pranuar me një përulje të plotë edhe zonjusha Baptistinë. Kjo vajzë e shenjtë e kishte zotin e Dinjës njëkohësisht edhe vëlla, edhe ipeshkv, mik të saj, sipas natyrës, dhe epror, sipas kishës.

Ajo e donte dhe e përnderonte fare thjesht. Kur ai fliste, ajo përkulej; kur ai vepronte, ajo përulej. Vetëm shërbëtorja, zonja Magluarë, sikur murmuriste pakëz nëpër dhëmbë. Zoti ipeshkv, siç mundëm ta vërejmë, kishte ruajtur për vete një mijë livra, të cilat, së bashku me pensionin e zonjushës Baptistinë, bënë një mijë e pesëqind franga në vit. Me këto një mijë e pesëqind frangat rronin dy plakat dhe plaku.

Dhe, kur ndonjë prift fshati vinte në Dinjë, zoti ipeshkv gjente mënyrën dhe e rregullonte për të ngrënë e për të pirë falë kursimeve të rrepta të zonjës Magluarë dhe qeverisjes plot zgjuarsis të zonjushës Baptistinë.

Një ditë - ishin bërë afro tre muaj që kishte ardhur në Dinjë - ipeshkvi tha:

-Kam rënë shumë ngushtë e s'di nga t'ia mbaj!

-Ju zë besë me tërë mend, - bërtiti zonja Magluarë, - ju, imzot, as që jeni kujtuar të kërkoni rentën që ju detyron departamenti për shpenzime karroce në qytet dhe vajtje-ardhjet në dioqezë. Për ipeshkvët e dikurshëm kjo ishte një gjë e rëndomtë.

-Pa shih, - tha ipeshkvi, - keni të drejtë, zonja Magluarë.

Dhe e bëri kërkesën.

Para disa kohësh, Këshilli i Përgjithshëm e mori parasysh këtë kërkesë dhe vendosi për të një shumë vjetore prej tri mijë frangash, nën këtë rubrikë: *Alokacion zotit ipeshkv për shpenzime karroce, shpenzime poste dhe shpenzime udhëtimesh baritore.*

Kjo gjë e bëri borgjezinë lokale të bërtiste me të madhe, dhe, me këtë rast, një senator i perandorisë, ish-anëtar i Këshillit të Pesëqindtëve, përkrahës i 18 brymerit¹⁾ dhe i pajisur pranë qytetit të Dinjës me një shtëpi madhështore senatoriale, i shkroi ministrit të Kulteve Fetare, zotit Bigot të Preamënë, një biletë të vogël sekrete e plot zemërim, nga e cila po nxjerrim këta rreshta autentikë:

“-Shpenzime karroce? Ç’duhen ato në një qytet me më pak se katër mijë banorë? Shpenzime poste e udhëtimi? Një herë, kujt i hyjnë në punë këto udhëtime? Pastaj, si mund të ecë karroca në një vend malor? Aty s’ka rrugë. Njerëzia aty udhëtojnë me kuaj. Dhe vetë ura e Dyansës në Shato-Arnu mezi mban qerret me qé. Kështu janë priftërinjtë, të gjithë njëllor. Të pangopur dhe koprracë. Ky, kur erdhi në krye, na u shit si apostull i shenjtë. Tani edhe ai po bën si gjithë të tjerët. Iu dashka karrocë për në qytet dhe araba për udhëtime. Iu dashkan lukse si ipeshkve të dikurshëm?! Oh, gjithë kjo priftëri e ndytë! Zoti kont, punët do të venë mirë vetëm atëherë kur perandori të na i ketë hequr qafe kamillafët. Poshtë papa! (Punët po ngatërroshin me Romën.) Kurse unë jam vetëm për Cezarin dhe për askënd tjetër. Etj... etj.”

Ndërsa kjo gjë e gëzoi fort zonjën Magluarë.

-Bukur! - i tha ajo zonjushës Baptistinë, - Imzot e ka filluar nga të tjerët, por, më në fund, iu desh medoemos që të mendonte edhe për vete. I ka rregulluar të gjitha veprat e bamirësisë. Tani këto të tri mijë frangat janë për ne. Dësh zoti, më në fund!

Po atë mbrëmje ipeshkvi shkroi dhe i dorëzoi së motrës një shënim të përpiluar në këtë mënyrë:

Shpenzime për karrocë dhe udhëtime

Për t’u dhënë lëng mishi	
të sëmurëve të spitalit	<i>një mijë e pesëqind livra</i>
Për shoqërinë e mëshirës	
amësore të Eksit	<i>dyqind e pesëdhjetë livra</i>
Për shoqërinë e mëshirës	
amësore të Draginjanit	<i>dyqind e pesëdhjetë livra</i>
Për fëmijët e gjetur	<i>pesëqind livra</i>
Për jetimët	<i>pesëqind livra</i>
Gjithsej.....	<i>tri mijë livra</i>

I tillë ishte buxheti i zotit Miriel.

Përsa u përket të ardhurave të rastit, si shpallje martesash, leje të ndryshme, pagëzime, predikime, bekime të kishave dhe të kishëzave, martesat etj. ipeshkvi i mbledhte nga të pasurit po me aq zell sa ua jepte të varfërve.

Mbas pak kohësh, dhuratat në të holla filluan të rridhnin si lumë. Ata që kishin dhe ata që s’kishin, trokisnin te porta e zotit Miriel, njëra palë vinte për të kërkuar lëmoshën që të tjerët vinin dhe e depozitonin. Ipeshkvi, në më pak se një vit, u bë ruajtësi i thesarit të të gjitha bamirësive dhe arkëtari i të gjitha halleve dhe nevojave. Shuma të mëdha i kalonin atij nëpër duar; por asgjë s’e tundoi që të ndryshonte diçka nga mënyra e jetesës dhe të shtonte diçka të tepërt mbi atë që ishte e domosdoshme.

Përkundrazi! Duke qenë se këtu poshtë kishte shumë mjerim, ai jepte gjithçka, si të thuash, përpara se t’i kishte rënë në dorë; ishte njëllor si uji mbi një tokë të thatë; sadoqë merrte, ai kurrë s’kishte të holla. Atëherë, ai hiqte edhe nga qesja e vet.

Duke qenë se zakoni ishte që ipeshkvët të përmendnin emrin e tyre të pagëzimit në krye të urdhëresave dhe të letrave të tyre baritore, njerëzit e vobektë të vendit kishin zgjedhur me njëfarë ndjenje të natyrshme plot dashuri midis emrave dhe mbiemrave të ipeshkvit atë emër që për ta kishte një kuptim, kështu që ata nuk e quanin ndryshe veçse imzot Bienvény²⁾.

¹⁾ Këmbëmbari.

Edhe ne do të bëjmë si ata, dhe, kur të vijë rasti, kështu do ta quajmë. Pastaj, ky emërtim i pëlqente edhe atij vetë.

-Më pëlqen ky emër kështu, - thoshte ai. - Bienvënyi e korrigjon imzotin.

Ne nuk themi se portreti që po bëjmë këtu është i vërtetë; por themi vetëm se është i përngjashëm.

III

Ipeshkvit të mirë ipeshkvi të vështirë

Edhe pse zoti ipeshkv i jepte lëmoshë të hollat që i duheshin për shpenzime karroce, ai nuk rrinte pa i bërë udhëtimet e veta nëpër dioqezë. Dioqeza e Dinjës është një dioqezë e vështirë. Ka fare pak fusha, shumë male, pothuajse asnjë udhë, siç e pamë edhe më përpara, tridhjetë e dy famulli, dyzet e një mëkëmbësi famullish dhe dyqind e tetëdhjetë e pesë degë. T'i vizitosh të gjitha këto, i thonë një punë e madhe. Por zoti ipeshkv ia dilte mbanë. Shkonte më këmbë kur ishte puna aty përreth, me araba në fushë, në samar të mushkës maleve. Atë e shoqëronin edhe të dyja plakat. Kur udha ishte tepër e lodhshme për to, atëherë ai shkonte vetëm.

Një ditë arriti në Senez, një qytet i vjetër ipeshkvor, hipur majë një gomari. Ishte fort ngushtë në atë kohë dhe kështu nuk pati mundësi të merrte tjetër veç gomarit. Kryetari i bashkisë erdhi ta priste te porta e ipeshkvisë dhe po e vështronte me sy të çakërritur tek po i zbriste gomarit. Disa borgjezë po qeshnin rreth tij.

-Zoti kryetar, - tha ipeshkvi, - dhe zotërinj borgjezë, po e shoh edhe vetë përse jeni pataksur kështu; ju e quani si mendjemadhësi për një prift të varfër që t'ia hipë po asaj kafshe që ia pati hipur edhe Jezu Krishti. Por këtë gjë unë e bëra nga nevoja dhe jo për të shitur mend.

Në turnetë e tij, ai ishte mëshirëmadhë e i butë dhe më shumë bënte biseda sesa predikime. I shpjegonte virtytet thjesht e kuptueshëm. Nuk shkonte t'i kërkonte larg arsyetimet

dhe shembujt që paraqiste. Banorëve të një fshati u sillte shembullin e një fshati tjetër fqinjë. Ndër kantonet ku njerëzit silleshin vrazhdësisht me nevojtarët, ai thoshte: "Pa shikoni njëherë banorët e Briansonit. Ata u kanë dhënë të vobektëve, të vejave dhe jetimëve të drejtën që të kositin livadhet e tyre tri ditë përpara të tjerëve. Ata ua rindërtojnë falas shtëpitë kur fillojnë t'u rrënohen. Kështu që Briansonit është një vend që e ka bekuar Zoti. Gjatë një shekulli prej njëqind vjetësh s'ka dalë asnjë vrasës."

Në fshatrat, ku njerëzit ishin të dhënë pas fitimeve dhe nuk ndihmonin njëri-tjetrin në kohë të draprit, ai thoshte: "Pa shihni njëherë ata të Ambrënit. Në qoftë se një kryefamiljar, në kohë të të korrurave, i ka djemtë e vet në shërbim ushtarak, vajzat shërbejnë në qytet, dhe vetë është i sëmurë e i pamundur, famullitari e vë në dukje një gjë të tillë dhe, kur të shikoni ju, të dielën, pasi thuhet mesha, të gjithë njerëzit e fshatit, me burra, me gra e me fëmijë, ngrihen e venë në arë të këtij burri nevojtar dhe i futen të korrurit e ia sjellin me kashtë e me bereqet deri në hambar." Familjeve që kishin hyrë në grindje për punë të hollash e trashëgimesh, ai u thoshte: "Pa shihni njëherë ata malësorët e Develnit, vend aq i egër, sa nuk dëgjon as këngën e bilbilit, qoftë dhe një herë në pesëmbëdhjetë vjet. E pra, kur vdes i zoti i shtëpisë, djemtë marrin nga sytë këmbët e venë në kurbet dhe ua lënë pasurinë vajzave, në mënyrë që ato të gjejnë nga një copë burrë e të martohen." Në krahinat ku njerëzve u pëlqenin gjyqet dhe ku çifçinjët rrënoheshin së bleri pulla taksash për të bërë lutje e ankesa, ai thoshte: "Pa shihni njëherë ata fshatarët e mirë të luginës së Keirasit. Bëhen plot tri mijë shpirt. Po, për besë, aty është si ndonjë republikë e vogël më vete. Aty nuk ia dinë emrin as gjyqtarit, as ftuesit. Gjithçka e rregullon kryetari i bashkisë. Bën ndarjen e taksave dhe ia cakton secilit me drejtësi të madhe, i shqyrton dhe i gjykon zënkat falas, bën ndarjen e pasurive, pa kërkuar asnjë shpërblim dhe jep vendime gjyqësore, pa i ngarkuar me shpenzimet përkatëse; dhe të gjithë e dëgjojnë, sepse ai është njeri i drejtë midis njerëzve të thjeshtë". Fshatrave ku nuk gjente mësues shkolle, u sillte si shembull përsëri banorët e Keirasit: "A e dini

si bëjnë ata? - thoshte ai. - Meqenëse një fshat me dymbëdhjetë a pesëmbëdhjetë shtëpi nuk mund të ushqejë një mësues, ata kanë mësues që i paguan e gjithë lugina dhe që shëtitin fshatrave, duke kaluar e dhënë mësim tetë ditë në këtë fshat, dhjetë ditë në atë tjetrin. Këta mësues venë edhe panairove, ku i kam parë me sytë e mi. Ata njihen nga pendët e shkrimit që mbajnë në tizgë të kapelës. Ata që japin mësim vetëm për të lexuar, kanë vetëm një pendë, ata që japin mësim për lexim e aritmetikë, kanë nga dy pendë, ata që japin mësim për lexim, aritmetikë dhe latinisht, kanë nga tri pendë. Këta të fundit janë dijetarë të mëdhenj. Por sa turp është të jesh i paditur! Bëni edhe ju si ata të Keirasit”.

Ai fliste kësisoj, tërë seriozitet dhe si atë i vërtetë, dhe, kur s'gjente dot ndonjë shembull, atëherë shpikte ndonjë paravoli, duke qëlluar drejt e në shenjë me pak fraza e shumë figura. Ai ishte vetë i bindur për ato që thoshte, prandaj i bindte edhe dëgjuesit e vet.

IV

Si fjalët, punët

Biseda e tij ishte e ëmbël dhe e gëzueshme. Me të kuptoheshin mirë edhe të dy plakat që kalonin jetën me të; kur qeshte, ai kishte një të qeshur të dëlirë si shkollarët.

Zonja Magluarë i thërriste me gjithë qejf *madhëria juaj*. Një ditë ai u ngrit nga kolltuku dhe vajti në bibliotekën e vet të kërkonte një libër. Ky libër ishte në njërën prej raftëve të sipërme. Meqenëse ipeshkvi ishte mjaft i vogël nga shtati, nuk e arriti dot.

-Zonja Magluarë, - tha ai, - sillni këtu një karrige. Madhëria ime s'arrin dot as gjer te kjo dërrasë.

Një nga kushërirat e tij të largëta, zonja konteshë Dë Lo, rrallë linte t'i shpëtonte rasti pa numëruar, në prani të tij, ato që ajo i quante “shpresat” e të tre bijve të saj. Ajo kishte shumë farefis të shtyrë në moshë dhe me një këmbë në varr,

trashëgimtarë të të cilëve ishin natyrisht bijtë e saj. Më i vogli i të treve kishte për të marrë nga një teto-madhe njëqind mijë livra të bekuara si rentë; i dyti do të merrte titullin duk nga i ungi; më i madhi do të trashëgonte titullin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Francës nga stërgjyshi i vet. Ipeshkvi i dëgjonte zakonisht në heshtje këto parashtrime të pamëkata dhe të falshme të asaj nëne. Por, njëherë ai dukej më ëndërrues se zakonisht, teksa zonja Dë Lo ishte duke përsëritur të gjitha hollësitë e këtyre trashëgimeve dhe “shpresave”. Ajo e ndërpreu fjalën me njëfarë padurimi: - “Pash Zotin, o kushëri! Po për çfarë po mendoni kështu?” “Po mendoj, - tha ipeshkvi, - për diçka të pazakontë që ndodhet besoj në veprat e shën Agostinit: “Vari shpresat tek ai të cilit nuk do t'i bëhesh trashëgimtar.”

Njëherë tjetër ai mori një letër lajmërimi për vdekjen e një fisniku të atij rrethi, ku parashtroheshin në një faqe të tërë, përveç dinjitetëve të të ndjerit, të gjitha cilësimet feudale dhe fisnikërore të të gjithë farefisit të tij.

-Shpinë të fortë paska vdekja! - bërtiti ai. - Ç'barrë të admirueshme titujsh i paskan ngarkuar si me shaka, dhe sa mendjehollë duhet të jenë ata njerëz që e përdorin kësisoj vdekjen për të kënaqur kotësinë e tyre.

Ai, në raste të tilla, hidhte ndonjë thumb të lehtë, i cili përmbante pothuajse gjithmonë një kuptim serioz. Gjatë një kreshme, erdhi në Dinjë një vikar i ri dhe predikoi në katedrale. Ishte gojëtar. Thelbi i predikimit të tij ishte dhimbsuria. Ai u bëri thirrje të pasurve që t'u japin të varfërve, me qëllim që të shpëtonin nga ferri, të cilin e përshkroi të llahtarshëm mesa munda, dhe të fitonin paraajsën, të cilën e paraqiti joshëse dhe magjepsëse. Midis dëgjuesve na që edhe një ish-tregtar i pasur, pak si fajdexhi, i quajtur zoti Zheborand, i cili kishte fituar një gjysmëmilion duke fabrikuar stofa të trasha, shajakë, stofa të lehta dhe kësula. Kurrë në jetën e tij zoti Zheborand s'i kishte dhënë lëmoshë ndonjë fatkeqi. Pas atij predikimi, njerëzit vunë re se ai çdo të diel u falte nga një *su*^{*)} plakave që lypnin te porta e katedrales. Ky *su* u takonte ta ndanin gjashtë lypësve. Një

^{*)} Para franceze baras me pesë qindarka.

ditë ipeshkvi e pa tek po jepte lëmoshë dhe i tha së motrës duke buzëqeshur:

-Pa shih, zoti Zheborand po ble një su parajsë.

Kur vinte puna për lëmoshë, atij nuk i vinte rëndë bile edhe kur nuk i jepnin; edhe atëherë ai gjente disa fjalë që të bënin t'i vije gishtin kokës. Njëherë ai po mblidhte lëmoshë për të varfrit në një sallon të qytetit. Aty ndodhej edhe markezi Dë Shamtersje, plak, i pasur, koprrac, i cili ishte marifetçi i madh për t'u hequr njëkohësisht edhe si ultramonarkist, edhe si ultravolterian. Kësi farë njerëzish ka pasur bota gjithmonë. Ipeshkvi, kur arriti tek ai, i preku krahun e i tha:

-Zoti markez, duhet të më jepni edhe ju diçka.

Markezi iu kthye e iu përgjigj thatë:

-Imzot, kam edhe unë të varfrit e mi.

-Nëmini mua, - ia pat ipeshkvi.

Një ditë ai mbajti në katedrale këtë fjalim:

“O shumë të dashurit vëllezërit e mi, o miqtë e mi të mirë, në Francë ka një milion e treqind e njëzet mijë shtëpi fshatarësh që kanë vetëm tri vrima, një milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë që kanë dy vrima, portën dhe një dritare, dhe, më në fund, treqind e dyzet e gjashtë mijë kasolle që s'kanë veçse një vrimë, portën. Dhe kjo ngjet për shkak të njëzë gjëje që i thonë taksë mbi portat e dritaret. Shkoni, ju lutem, e vendosni tani familje të varfra, plaka, fëmijë të vegjël në këto banesa, dhe shikoni pastaj se si do të bëjnë kërdinë ethe dhe sëmundjet! Vajmedet! Zoti u fal njerëzve ajrin, kurse ligji ua shet me parà. Unë nuk e padit ligjin, por bekoj perëndinë. Në krahinat e Izerës, të Varit, të Alpeve të Epërme dhe të Poshtme, fshatarët s'kanë as karroca dore, ata e mbartin plehun në krahë; s'kanë as kandila, dhe ndezin shkopinj me rrëshirë ose bishtira litarësh të lyer me katran. Kështu ngjet në të gjithë pjesën e Sipërme të Dofinesë. Ata e gatujnë bukën njëherësh për gjashtë muaj dhe e pjekin me bajga të thata lope. Dimrit ata e çajnë këtë bukë me sëpatë dhe e zbutin në ujë për njëzet e katër orë rresht, se ndryshe nuk shtihet në gojë. Kini mëshirë, o vëllezërit e mi! Shihni se si vuajnë të tjerët rreth jush.”

Ai kishte lindur provansal dhe ishte familjarizuar lehtë me

të gjitha të folmet e Jugut të Francës. Përdorte shprehje të krahinës së Langëdokut të Poshtëm, të Alpeve të Poshtme dhe të Dofinesë së Sipërme. Këto shprehje i pëlqenin popullit dhe i kishin dhënë dorë ipeshkvit që të ishte i afruar dhe i kuptueshëm për të gjithë llojet e njerëzve. Në kasolle e në mal, ai e ndiente veten si në shtëpi të vet. Dinte të kallëzonte gjërat më të mëdha me të folmet më të thjeshta. Duke folur të gjitha gjuhët, ai u futej të gjithëve në zemër.

Veç kësaj, ai sillej njëlloj me të gjithë, si me ata të dyerve të mëdha, ashtu edhe me njerëzit e thjeshtë të popullit.

Ipeshkvi kurrë nuk ndëshkonte me nxitim dhe pa marrë parasysh rrethanat e ndryshme. Ai thoshte: “Dale të shohim njëherë udhën prej nga ka kaluar gabimi.”

Ai ishte zemërgjerë ndaj grave dhe të varfërve, mbi të cilët rëndon pesha e shoqërisë njerëzore. Ai thoshte: “Për gabimet që bëjnë gratë, fëmijët, shërbëtorët, të dobët, të varfrit dhe të paditurit janë fajtorë burrat, etërit, zotërit, të pasurit dhe dijetarët.”

Thoshte edhe kështu: “Atyre që nuk dinë, mësojuni sa më shumë që të mundni; shoqëria është fajtorë pse nuk u jep arsimin falas; ajo është përgjegjëse për errësirën që mbjell. Kur një shpirt është plot terr, aty bëhet edhe gabimi. Fajtor nuk është ai që bën mëkat, por ai që mbjell terrin në shpirtin e njerëzve.”

Nga sa shihet, ai kishte një mënyrë të çuditshme dhe të tijën në të gjykuarit e gjërave. S'ma ha mendja që t'i kishte marrë të gjitha këto nga ungjilli.

Një ditë ai dëgjoi tek po bisedonin në një sallon rreth një procesi kriminal që po hetohej e që do të gjykohej. Një burrë i mjerë, nga dashuria për një grua dhe për një fëmijë që kishte bërë me të, kishte mbetur në pikë të hallit dhe kësaj kishte bërë monedha false. Falsifikimi i monedhës asokohe dënohej akoma me vdekje. Gruaja u arrestua tek po prishte monedhën e parë false të fabrikuar nga burri. Atë e kishin mbërthyer paq, por prova kishin vetëm kundër saj. Vetëm ajo, po të pohonte, mund ta ngarkonte të dashurin me faj dhe ta merrte më qafë. Por ajo mohoi gjithçka. Gjyqtarët ngulën këmbë. Ajo vazhdoi

të mohonte. Në këto e sipër, prokurorit të mbretit na i ra në mend një ide e bukur. Ai kishte sajuar një pabesi gjoja nga ana e dashnorit dhe kishte arritur me ca copa letrash të paraqitura me marifet t'ia mbushte mendjen fatkeqes se ajo kishte një rivale dhe se ai, i dashuri, e mashtronte. Atëherë, duke plasur nga zilia, ajo e kishte denoncuar të dashurin e vet, kishte pohuar e provuar gjithçka. Burrin e kishte marrë lumi. Së afërmi ai do të gjykohej në Eks tok me bashkëfajtoreshen e tij. Kështu e kallëzonin ngjarjen, dhe secili mbetej i mahnitur dhe i magjepsur me shkathtësinë e prokurorit. Duke e nxitur zilinë, ai kishte bërë që të shpërthente e vërteta me anë të zemërimit, kishte bërë që nga hakmarrja të shpërthente drejtësia. I peshkvi i dëgjonte të gjitha këto në heshtje. Kur gjithçka mbaroi, ai pyeti:

-Ku do t'i gjykojnë burrin e gruan?

-Në gjykatën e qarkut.

Ai vazhdoi:

-Po zotin prokuror të mbretit ku do ta gjykojnë?

V

Sa kohë i rronin veladonët imzot Bienvënyit

Jeta e brendshme e zotit Miriel ishte e ngjeshur me po ato mendime që ai kishte në jetën publike. Për atë që do të kishte mundur ta shihte nga afër këtë jetë, varfëria me dashje në të cilën jetonte zoti ipeshkvi i Dinjës do të ishte një pamje hijerëndë dhe e këndshme.

Si të gjithë pleqtë dhe si shumica e mendimtarëve, ai flinte pak, por bënte gjumë të thellë. Në mëngjes falej e lutej ndonjë orë, pastaj thoshte meshë, qoftë në katedrale, qoftë në oratorion e vet. Si mbaronte meshën, hante mëngjes me një copë bukë të thekërt të ngjyer me qumështin e lopëve të tij. Pastaj i futej punës.

I peshkvi është njeri i zënë me shumë punë; duhet të presë çdo ditë sekretarin e ipeshkvisë, i cili rëndom është një

kanonik, dhe pothuaj çdo ditë vikarët e tij kryesorë. Duhet të kontrollojë kongregatën, të japë privilegje, të shqyrtojë një librari të tërë kishtarë, famullitarë, katekizma dioqeziake, mesharë etj., të shkruajë udhëzime, të lejojë predikime, të pajtojë famullitarë e kryetarë bashkie, të bëjë letërkëmbim priftëror, letërkëmbim administrativ, nga njëra anë, shteti, nga ana tjetër, Selia e Shenjtë, një mijë e njëqind punë.

Kohën që i tepronte nga të një mijë e njëqind punët, shërbesat dhe libri i uratave, ua kushtonte, në radhë të parë, nevojtarëve, të sëmurëve dhe të pikëlluarve; kohën që i tepronte nga të pikëlluarit, të sëmurët dhe nevojtarët, ia kushtonte punës. Herë mihte tokën e kopshtit, herë lexonte e shkruante. Këto dy lloj punësh ai i quante me një fjalë të vetme: punoj kopshtin. "Edhe mendja është një kopsht", - thoshte ai.

Në mesditë hante drekën. Dreka i përngjiste mëngjesit.

Aty nga ora dy, kur koha ishte e mirë, dilte e shëtiste më këmbë fushës ose qytetit, duke hyrë shpesh nëpër kasolle e shtëpi të varfra. E shihnin tek ecte vetëm, i zhytur në mendime, me një bastun të gjatë në dorë, i veshur me dollomanë ngjyrë vjollce e të mbushur përbrenda me pambuk, e cila e mbante shumë ngrohtë. Mbante çorape po ngjyrë vjollcë, këpucë të rënda dhe një kapelë shpatuke, nga të tri bigat e së cilës dilnin tri lende lisi të arta me farëza spinaqi.

Ngazëllim i madh ishte kudo që kalonte ai. Fëmijë e pleq dilnin në prag të dyerve për ipeshkvin njëlloj si për diellin. Bekonte dhe e bekonin. Kur ndokush kishte nevojë për diçka, i tregonin shtëpinë e ipeshkvit.

Aty-këtu ndalej, fliste me çunat e vegjël dhe me vajzat e vogla dhe u buzëqeshte nënave. Sa kishte të holla, u shkonte të varfërve në shtëpi: kur s'kishte më të holla, atëherë u shkonte të pasurve.

Meqenëse veladonët i mbante për një kohë shumë të gjatë dhe nuk donte që t'ia shihnin ashtu të vjetruar, nuk dilte kurrë në qytet veçse me dollomanë e tij ngjyrë vjollce. Kjo e pengonte pak në verë.

Në mbrëmje, në orën tetë e gjysmë, hante darkën bashkë me të motrën, ndërsa zonja Magluarë rrinte në këmbë prapa

tyre dhe u shërbente në tryezë. S'kishte gjë më të thjeshtë se kjo darkë. Por kur ipeshkvi kishte për darkë ndonjë nga famullitarët e vet, zonja Magluarë përfitonte nga ky rast për t'i shtruar imzotit ndonjë peshk të shkëlqyer të liqeneve ose ndonjë gjah të shijshëm të maleve. Çdo famullitar që vinte, bëhej shkak për të përgatitur gjellë të mira; ipeshkvi nuk kishte ndonjë kundërshtim. Me përjashtim të këtyre rasteve, gjellët e tij të rëndomta ishin vetëm zarzavate të ziera me ujë dhe supë me vaj. Kësisoj, në fshat, bota thoshin: Kur ipeshkvi nuk ha darkë famullitari, ha darkë ashkëtiu.

Si hante darkë, rrinte e bisedonte ndonjë gjysmë ore me zonjushën Baptistinë dhe zonjën Magluarë, pastaj hynte në dhomën e vet, dhe fillonte përsëri të shkruante, herë mbi fije letre të shkëputura, herë në qenar të ndonjë in-folioje. Ishte njeri i mësuar dhe pak si dijetar. Ai ka lënë pesë a gjashtë dorëshkrime që të tërheqin mjaft kureshtjen.

Aty nga ora nëntë e mbrëmjes, të dyja gratë tërhiqeshin dhe ngjiteshin në dhomat e tyre në katin e dytë, duke e lënë gjer në mëngjes vetëm në katin përdhes.

Këtu është e domosdoshme që të japim një idé të saktë të banesës së zotit ipeshkv të Dinjës.

VI

Kush ia ruante shtëpinë

Siç e kemi thënë, shtëpia përfshinte një kat përdhes dhe një kat të dytë; tri kthina në katin përdhes, tri dhoma në katin e dytë dhe sipër një papafingo. Prapa shtëpisë, një kopsht rreth një dynymi tokë. Të dy gratë banonin në katin e dytë. Ipeshkvi banonte poshtë. Kthina e parë, që dilte drejt e në rrugë, shërbente si dhomë buke, e dyta si dhomë fjetjeje dhe e treta si oratorio. Nuk mund të dilje nga kjo oratorio pa kaluar përmes dhomës së fjetjes, dhe nga dhoma e fjetjes pa kaluar përmes dhomës së bukës. Në oratorio, aty në fund, kishte një kamare të mbyllur, ku ishte një shtrat kur vinte ndonjë bujtës. Zoti

ipeshkv ua lëshonte për të fjetur famullitarëve që vinin nga fshatrat në Dinjë për punë të ndryshme ose për nevoja të famullive të tyre.

Farmacia e spitalit, një ndërtesë që i ishte shtuar shtëpisë dhe ishte ndërtuar mbi truallin e kopshtit, ishte shndërruar në kuzhinë dhe në qilar.

Veç kësaj, në kopsht kishte edhe një haur, që kishte qenë dikur kuzhinë e spitalit dhe ku ipeshkvi mbante dy lopë. Sado qumësht që të jepnin ato, ai çdo mëngjes, pa përjashtim, ua dërgonte gjysmën të sëmureve të spitalit. "Paguaj xhelepin", - thoshte ai.

Dhoma e tij ishte mjaft e madhe dhe ishte vështirë ta ngrohje në dimër. Meqenëse drutë ishin shumë shtrenjtë në Dinjë, ai kishte menduar dhe ndërtuar në haurin e lopëve një kthinëz të mbyllur me një ndarje çatmaje dërrasash. Aty i kalonte ipeshkvi mbrëmjet, kur të ftohtët ishte i madh. Ai e quante këtë *sallonin e tij të dimrit*.

Në këtë sallon dimri, ashtu si në sallën e bukës, nuk kishte mobilje të tjera përveç një tryeze katrore prej druri mështekne dhe katër karrige kashte. Salla e bukës ishte e zbukuruar, veç të tjerave, me një bufë të vjetër, të lyer me ngjyrë trëndafili të sajuar me ujë, tutkall, gomë e të bardhë veje. Me një bufë tjetër si kjo, të veshur për bukuri me napëza të bardha dhe dantella të rreme, ipeshkvi kishte bërë lterin që zbukuronte oratorion e tij.

Besniket e pasura dhe besimtarët e Dinjës shpeshherë kishin shtëinë parë për të ndërtuar një lter të ri e të bukur për oratorion e imzotit; por ai çdo herë i kishte marrë paratë dhe ua kishte dhënë të varfërve.

Në oratorion e tij kishte dy karrige lutjesh prej kashte; dhe një kolltuk me krahëza, gjithashtu prej kashte, në dhomën e tij të gjumit. Kur qëllonte që të priste shtatë a tetë veta njëherësh, prefektin ose gjeneralin, ose shtatmadhorët e regjimentit në garnizon, ose nxënës të seminarit të vogël, ai dërgonte për të marrë në haur karriget e sallonit të dimrit, në oratorio karriget e lutjeve dhe në dhomën e gjumit kolltukun; në këtë mënyrë mund të bëheshin tok deri njëmbëdhjetë ndenjësë për

vizituesit. Për çdo vizitë të re ata boshatisnin një dhomë.

Herë-herë qëllonte të bëheshin dymbëdhjetë veta; atëherë ipeshkvi, qëndronte vetë në këmbë përpara oxhakut, po të qe dimër, ose i ftonte të bënin një shëtitje në kopsht, po të qe verë.

Vërtet që kishte edhe një karrige në kamaren e mbyllur, por, ajo e kishte kashtën gjysmë të ronitur dhe mbahej vetëm në tri këmbë, kështu që ajo mund të shërbente vetëm duke qenë e mbështetur pas murit. Zonjusha Baptistinë kishte vërtet në dhomën e saj edhe një kolltuk shumë të madh prej druri të praruar dhe të veshur me tafta Pekini me lule, por, për ta ngjitur atë kolltuk në katin e dytë, ata kishin qenë të detyruar ta kalonin përmes dritares, meqenëse shkalla paskësh ndodhur tepër e ngushtë; pra, ai nuk mund të zihej si mobilje e përdorshme për këso rastesh.

Zonjusha Baptistinë ishte e dëshiruar të blinte një mobilje salloni prej mogani të përkulur si qafë mjellmeje dhe të veshur me kadife Utrehti të verdhë plot me trëndafila, së bashku me një kanapé. Por kjo do të kushtonte të paktën pesëqind franga, dhe, pasi kishte parë se në krye të pesë vjetëve kishte mundur të kursente për këtë qëllim vetëm dyzet e dy franga dhe dhjetë *su*, ajo, më në fund, kishte hequr dorë nga kjo ëndërr. Po kush e plotëson dot vallë dëshirën e vet?

Është e lehtë të merret me mend se si mund të ishte dhoma e gjumit e ipeshkvit. Një derë me xhamllëk që shikonte nga kopshti, përballë shtratit, një shtrat spitali prej hekuri me një perde të leshtë jeshile; ngjitur me shtratin, prapa një perdeje, ishin veglat e tualetit, që nxirrnin akoma sheshit zakonet e dikurshme elegante të njeriut të salloneve; dy dyer, njëra, pranë dritares, që të çonte në oratorio; tjetra, pranë bibliotekës, që të çonte në sallën e bukës; biblioteka, një dollap i madh me xhama, plot libra; oxhaku prej druri të pikturuar si mermer, zakonisht pa zjarr; në vatër dy demiroxhakë hekuri, të zbukuruar me dy vazo me kurorëza lulësh dhe ullukthe dikur të lyera me argjend, me ca vijëza të kryqëzuara, gjë që ishte njëfarë luksu ipeshkvor; sipër, në vendin ku zakonisht vihet pasqyra, ishte vendosur një kryq bakri, të cilit i kishte ikur argjendi, mbërthyer mbi një kadife të zezë të fërkuar dhe të vendosur në një kornizë druri,

së cilës i qe fshirë ari. Pranë derës me xhamllëk, një tryezë e madhe me një kallamar, e ngarkuar me letra lesh e li dhe me vëllime të trasha. Përpara shtratit, një karrige lutjesh, marrë nga oratorioja.

Në dritare kishte një perde të mocme stofi të trashë prej leshi, e cila erdh e t'u vjetrua aq keq, sa, për të kursyer shpenzimet që duheshin për një perde të re, zonja Magluarë kishte qenë e detyruar t'i hidhte një arnë të madhe mu në mes. Kjo arnë formonte një kryq të madh. Ipeshkvi e vinte gjithmonë në pah këtë gjë. - "Sa mirë që duket!" - thoshte ai.

Të gjitha dhomat e shtëpisë, si në katin përdhes, ashtu edhe në katin e dytë, pa dallim, ishin të lyera me gëlqere, gjë që është rregull në kazermat ushtarake dhe në spitalet.

Megjithatë, vitet e fundit, zonja Magluarë gjeti, siç do ta shohim më tutje, nën letren e lyer me gëlqere disa piktura që zbukuronin apartamentin e zonjushës Baptistinë. Para se të bëhej spital, kjo shtëpi paskësh qenë sallë mbledhjesh për çështjet bashkiake. Ja pse ishin këto zbukurime. Dhomat ishin shtruar me tulla të kuqe, që i lanin çdo javë, dhe me shkorsa kashte te këmbët e të gjithë shtretërve. Me një fjalë, kjo banesë e mirëmbajtur nga dy gra ishte fund e krye e pastër dritë. Ky ishte i vetmi luks që ipeshkvi lejonte. Ai thoshte: "Kjo s'u heq asgjë të varfërve nga goja."

Megjithatë, duhet pranuar se nga ato që kishte pasur dikur i kishin mbetur gjashtë lugë e pirunë dhe një lugë e madhe supe, të gjitha të argjendta, të cilat zonja Magluarë i vështronte përditë me kënaqësi tek ndritnin mbi napën e trashë prej pëlhure të bardhë. Dhe, meqenëse këtu po përshkruajmë ipeshkvin e Dinjës ashtu siç ishte, na duhet të shtojmë se i kishte ndodhur më se një herë të thoshte: "Vështirë do ta kem të heq dorë nga të ngrënit në takëme argjendi."

U duhen shtuar këtyre argjendeve edhe dy shandanë të mëdhenj prej argjendi masiv, që i kishin mbetur si trashëgim nga një teto e tij. Këta dy shandanë mbanin dy qirinj dylli dhe qëndronin zakonisht mbi oxhakun e ipeshkvit. Kur kishte njeri për darkë, zonja Magluarë i ndizte të dy qirinjtë dhe i vinte shandanët mbi tryezë.

Në dhomën e ipeshkvit, në krye të shtratit, kishte edhe një dollap të vogël, ku zonja Magluarë vendoste çdo mbrëmje të gjashtë takëmet e argjendta dhe lugën e madhe. Duhet thënë se çelësi nuk hiqej kurrë nga dollapi.

Kopshti, pakëz i shëmtuar nga ndërtimet e pahijshme fare, për të cilat kemi folur, përbëhej nga katër rrugëza kryq, që bashkoheshin rreth një lloj pusi, që mblidhte ujërat e panevojshme; një rrugëz tjetër i binte rreth e qark kopshtit dhe shtrihej përgjatë murit të bardhë të avllisë. Këto rrugëza kishin midis tyre katër katrorë, buzë të cilëve ishte mbjellë bush. Në tre katrorë, zonja Magluarë mbillte perime; në të katërtin ipeshkvi kishte vënë lule. Tek-tuk kishte edhe ndonjë pemë.

Njëherë zonja Magluarë ia kishte hedhur fjalën ipeshkvit me njëfarë shpotie të butë: “Imzot, ju që s’lini gjë pa shfrytëzuar, keni lënë, megjithatë, një katror të padobishëm. Do të ishte më mirë të kishim aty sallata, sesa buqeta lulesh.” “Zonja Magluarë, - u përgjigj ipeshkvi, - gaboheni. E bukura është po aq e nevojshme sa edhe e dobishmja”. - Dhe shtoi, pas njëfarë heshtjeje: - “Edhe më shumë ndoshta”.

Në këtë katror, prej tri a katër leshesh, ipeshkvi merrej po aq sa edhe me librat. Kalonte me qejf aty një a dy orë, duke prerë e krasitur dhe duke hapur aty-këtu në tokë ca vrime ku shtinte farëza. Ai nuk ishte edhe aq armik i insekteve sa ç’duhej të ishte një kopshtar i vërtetë. Veç kësaj, atë s’e brente shumë merakun e botanikës; ai nuk i njihnte grupet dhe solidizmin;²⁾ as që bëhej fare merak të mbante anën e Turnëforit³⁾ apo të metodës natyrale; nuk mbante as anën e utrikuleve kundër kotiledoneve, as anën e Zhysjeit⁴⁾ kundër Linesë.⁵⁾ Nuk merrej me studimin e bimëve; ai i donte lulet. Dijetarët i respektonte shumë, por akoma më shumë respektonte të padijshmit, dhe, pa i marrë kurrë nëpër këmbë këto dy respekt, ujiste lehet e veta çdo mbrëmje në verë me një vaditëse teneqeje të lyer me ngjyrë të gjelbër.

Asnjë derë e portë nuk mbyllej me çelës në atë shtëpi. Porta e sallës së bukës, e cila, siç e kemi përmendur, të nxirrte drejt e në sheshin e katedrales, kishte qenë dikur e pajisur me brava e lloze, si ndonjë portë burgu. Ipeshkvi i kishte hequr të gjitha

këto hekurishte, dhe kjo portë, ditë e natë, mbyllej vetëm me një mandallëz. I pari udhëtar që vinte, në çfarëdo orë, mjaft sa ta shtynte, dhe hynte brenda. Në fillim të dyja gratë patën qenë mjaft të shqetësuara nga kjo portë, që nuk mbyllej kurrë; por zoti i Dinjës u kishte thënë: “Vëruni brava e lloze dhomave tuaja, po patët qejf”. Më në fund, edhe ato kishin rënë në një mendje me besimin e ipeshkvit ose të paktën ashtu bënë. Vetëm zonjën Magluarë e kapte herë pas here frika.

VII

Kravati

Këtu natyrisht e shoh të udhës të tregoj një ndodhi që nuk duhet ta lëmë në harresë, sepse është një nga ato ndodhi që nxjerrin më mirë në pah se çfarë njeriu ishte ky imzot ipeshkvi i Dinjës.

Pas shpartallimit të bandës së hajdutëve të Gaspar Besit, që i pati shkretuar grykat e Oliulës, njëri nga ndihmësit e tij, Kravati, u struk në male. Ai u fsheh disa kohë me hajdutët e vet, mbeturinë e bandës së Gaspar Besit, në kontenë e Nicës, pastaj u hodh në Piemont dhe papritmas u duk përsëri në Francë, nga ana e Barcelonetës. E panë së pari në Zhozier, pastaj në Tyilë. U fsheh në shpellat e Zhug-dë-l’Eglit dhe prej andej zbriste në fshatra e katunde përmes përrenjve të Ybejetës. Ai, madje, pati guximin të futej deri në Embrun, hyri një natë në katedrale dhe plaçkiti sakristinë. Hajdutëritë e tij e kishin shtënë në hall vendin. Xhandarët iu qepën, por më kot, se ai gjithmonë kërciste e ikte; disa herë bënte edhe qëndresë të fortë me armë.

Ai na ishte një katil i hazdisur. Pikërisht në mes të këtij terrori arriti ipeshkvi. Ky kishte dalë për turné. Në Shastëlar, kryetari i bashkisë i doli përpara dhe iu lut që të kthente udhë. Kravati ishte zot i malit deri në Arshë e më tej. Ishte rrezik i madh, edhe sikur të kishe një grup shoqëruesish. Do të merreshin më qafë kot së koti tre a katër xhandarë të gjorë.

-Prandaj edhe unë kam ndër mend të shkoj pa shoqërues.
-Me gjithë mend e keni, imzot? - thirri kryetari i bashkisë.
-E kam mbushur mendjen top, aq sa nuk pranoj në asnjë mënyrë xhandarë dhe do të nisem pas një ore.

-Do të niseni?

-Do të nisem.

-Vetëm?

-Vetëm.

-Imzot, nuk duhet ta bëni këtë punë.

-Atje në mal, - ia pat ipeshkvi, - është një komunë varfanjake, një pëllëmbë gjë, të cilën m'u bënë tre vjet që s'e kam parë. Aty kam miqtë e mi të mirë. Janë barinj shpirtmirë e të ndershëm. Ata kanë vetëm njëzë dhi nga tridhjetë që ruajnë. Bëjnë ca tizga fort të bukura prej leshi lloj-lloj ngjyrash dhe u bien ca melodive malësore me ca fyej të vegjël me gjashtë vrima. Kanë edhe ata nevojë që t'u flitet kohë më kohë për perëndinë. Çfarë do të thoshin vallë ata për një ipeshkv që ka frikë? Ç'do të thoshin vallë, po të mos u shkoja?

-Mirë, imzot, por hajdutët! Në u takofshi me hajdutët!

-Pikërisht edhe mua aty më rreh. Keni të drejtë. Mund edhe t'i takoj. Edhe ata duhet të kenë nevojë që t'u flitet për perëndinë.

-Imzot, por ata do t'ju plaçkitin.

-Unë s'kam asgjë.

-Do t'ju vrasin.

-Mua, një prift, një plak njeri, që kalon duke murmuritur urata e lutje? Bah! Por ç'do t'u duhem unë atyre?

-Ah! Zot o Zoti im! Dhëntë Zoti të mos i takonit!

-Do t'u kërkoj lëmoshë për të varfrit e mi.

-Imzot, mos shkoni, pashi Zotin! Po e vini veten në rrezik.

-Zoti kryetar, - tha ipeshkvi, - për këtë keni hall ju? Unë nuk jam në këtë botë për të ruajtur jetën time, por për të ruajtur shpirtat e të tjerëve.

S'qe punë që bëhej, dhe e lanë të nisej. Dhe ai u nis i shoqëruar nga një çunak, i cili kërkoj t'i shërbente si udhërrëfyes. Këmbëngulja e tij bëri bujë atyre anëve dhe u futi datën të tjerëve.

Nuk desh të merrte me vete as të motrën, as zonjën Magluarë. E kaloi malin hipur mbi mushkë, nuk hasi njeri dhe arriti shëndoshë e mirë te "miqtë e tij të mirë", barinjtë. Ndenji aty pesëmbëdhjetë ditë duke predikuar, duke administruar, duke mësuar e duke moralizuar. Kur afroi koha për t'u larguar, ai vendosi të këndonte një "Te Deum" në mënyrë pontifikale. Foli për këtë punë dhe me famullitarin. Por nga ta zinte? Ai s'i kishte fare zbukurimet ipeshkvore. Mund t'i jepnin vetëm një sakristi fshati, që mezi mbahej në këmbë, me disa petrahilë të vjetër prej damasku të fërkuar dhe të zbukuruar me galona të rremë.

-Bah! - tha ipeshkvi. - Zoti famullitar, le t'ua bëjmë besnikëve të ditur "Te Deumin" tonë. Gjithçka do të rregullohet për bukuri.

Kërkuan edhe në kishat rreth e qark. Të gjitha salltanetet e atyre famullive të varfra, edhe sikur t'i bëje tok, nuk do të mjaftonin për të veshur ashtu siç duhej qoftë edhe një psalt katedraleje.

Tek ishin në këtë telash të madh, një goxha arkë u soll dhe u vendos në prezbiter për zotin ipeshkv nga dy kalorës të panjohur, të cilët ishin larguar e kishin ikur aty për aty. E hapën arkën; ajo kishte brenda një manto ipeshkvore prej stofi të qëndisur me ar, një mitër të zbukuruar me diamante, një kryq arqipeshkor, një patericë të madhërishme, të gjitha petkat pontifikale të vjedhura një muaj më parë në thesarin e "Shën-Mërisë" së Embrënit. Brenda në arkë ishte një letër, ku ishin shkruar këto fjalë: *Kravati, për imzot Bienvënyë*.

-Kur thosha unë se gjithçka do të rregullohej për bukuri! - tha ipeshkvi. Pastaj shtoi duke buzëqeshur: - Atij që kënaqet me një petk të thjeshtë famullitari, perëndia i dërgon një mantò arqipeshkvi.

-Imzot, - murmuriti famullitari duke tundur kokën me buzën në gaz, - perëndia ose dreqi.

Ipeshkvi ia nguli sytë famullitarit dhe vazhdoi me autoritet: - Perëndia!

Kur u kthye në Shastëlar dhe gjatë gjithë rrugës, njerëzit vinin dhe e shikonin plot kërsëri. Ai gjeti në qelën e Shastëlarit

zonjushën Baptistinë dhe zonjën Magluarë, që po e prisnin, dhe i tha së motrës:

-Eh, pra! A nuk kisha të drejtë? Prifti i varfër vajti tek ata njerëz të varfër me duar bosh dhe u kthye me duart plot. U nisa duke marrë vetëm besimin tim te Zoti; tani po sjell thesarin e një katedraleje.

Sidoqoftë, ngjarjet e mëdha ishin të rralla në jetën e tij. Ne po tregojmë vetëm ato që dimë, por zakonisht ai e kalonte jetën duke bërë të njëjtat gjëra, gjithmonë po në të njëjtën kohë. Një muaj i vitit të tij i përngjiste një ore të jetës së tij.

Po të na pyeste ndokush se si i vajti filli "thesarit" të katedrales së Embrënit, ai do të na fuste në telashe. Aty kishte gjëra shumë të bukura dhe shumë joshëse, dhe shumë të mira për të vjedhur për fatkeqët. Ato të vjedhura se të vjedhura ishin, një herë. Gjysma e aventurës ishte plotësuar; nuk mbetej veçse të ndërroje drejtimin e gjërave të vjedhura dhe t'i bëje të ecnin pakëz andej nga krahu i të varfërve. Sidoqoftë, ne nuk pohojmë asgjë mbi këtë çështje. Veçse është gjetur nëpër kartat e ipeshkvit një shënim mjaft i errët që ka lidhje ndoshta me këtë çështje dhe që është hartuar si vijon: "Është puna që të vendoset nëse kjo duhet t'i kthehet katedrales apo t'i shkojë spitalit."

VIII

Ç'tregon motra për të vëllanë

Për të dhënë një ide të qartë për qeverisjen e brendshme të zotit ipeshkv të Dinjës dhe për mënyrën se si këto dy gra të shenjta ua nënshtonin veprimet e tyre, mendimet e tyre, madje edhe instinktet e tyre prej grash, që trembeshin për hiçgjë, zakoneve dhe qëllimeve të ipeshkvit, pa qenë as nevoja që ky të merrte mundimin t'i shprehte, gjëja më e mirë që do të bënim do të ishte të transkriptonim këtu një letër të zonjushës Baptistinë dërguar zonjës vikonteshë Dë Buashevron, mikes së vet të fëmijërisë. Kjo letër është në duart tona.

Dinjë, më 16 dhjetor 18...

"Zonjë e dashur, s'ka ditë që të mos ju zëmë në gojë. Na është bërë zakon, por kemi edhe një arsye tjetër. Merreni me mend, duke larë dhe duke u fshirë pluhurin tavaneve dhe mureve, zonja Magluarë bëri disa zbulime; tani ato dy dhomat tona të veshura me letër të vjetër e të lyera me gëlqere nuk do t'ia prishnin aspak bukurinë një kështjelle, që i ngjan asaj suajës. Zonja Magluarë e grisi të gjithë letrën. Nën të kishte disa piktura. Salloni im, ku nuk ka mobilje dhe që ne e përdorim për të nderë rrobat e lara, është pesëmbëdhjetë këmbë i lartë, tetëmbëdhjetë për së gjati e për së gjeri, ka një tavan të pikturuar qëkuri me ar dhe trarë si ata të shtëpisë suaj. Këtë tavan e kishin veshur me pëlhurë, që nga koha kur ishte spitali. Më në fund, ka edhe punime druri që nga koha e gjysheve tona. Por veç ta shohësh një herë, sidomos atë dhomën time. Zonja Magluarë ka zbuluar, nën nja dhjetë shtresa letrash, të ngjitura sipër njëra-tjetrës, ca piktura, të cilat nuk janë edhe aq të mira, por që prapë hahen. Aty sheh Telemakun, që po dorëzohet kalorës nga Minerva,⁶⁾ e sheh edhe ndër kopshtije. Emri i tyre s'më kujtohet tani. Me një fjalë, atje ku zonjat romake vinin vetëm një natë. E ç'tju them më parë? Kam këtu romakë e romake sa të duash (këtu është një fjalë e palexueshme) dhe të gjithë karvanin që u vjen pas. Zonja Magluarë i qëroi e i pastroi të gjitha këto, dhe kësaj vere do të ndreqë disa dëmtime të vogla, do t'u heqë një vernik të ri, dhe kështu dhoma do të jetë një muzé i vërtetë. Ajo gjeti në hatullat e shtëpisë edhe dy konsola prej druri, nga ato të modës së hershme. Na kërkuan dy skude ari dhjetë livrash për t'i bojatisur përsëri me varak të artë, por është akoma më mirë t'ua japësh këto të holla të varfërve, veç asaj janë edhe fort të shëmtuara dhe do të desha më shumë të kisha një tryezë të rrumbullakët prej dru mogani.

Si gjithnjë, jam shumë e lumtur. Im vëlla është shumë i mirë. Ç'ka e ç'nuk ka, ai ua jep të varfërve dhe të sëmurëve. E heqim fare hollë. Vendi është shumë i ashpër në dimër, dhe duhet të bësh patjetër diçka për ata që s'kanë. Zjarr e dritë

kemi sa për të thënë. E shihni, pra, ç'jetë të ëmbël që bëjmë.

Im vëlla ka zakonet e veta. Thotë se një ipeshkv kështu duhet të jetë. Merreni me mend që porta e shtëpisë nuk mbyllet kurrë. Mund të hyjë kush të dojë drejt e brenda në shtëpi të tim vëllai. Ai s'ka frikë nga asgjë, as natën. Kjo është trimëria e tij, siç thotë vetë. Ai nuk do që unë të kem merak për të, as zonja Magluarë të ketë merak. S'i bën lak asnjë rreziku dhe nuk do që ne të dukemi sikur kemi frikë. Duhet të dish ta kuptosh atë njeri.

Del kur bie shi; ecën në ujë, udhëton dimrit. S'ka frikë nga nata, nga udhët e dyshimta, as nga takimet me njerëz të dyshimtë.

Vitin që shkoi, ai vajti filli vetëm në një krahinë hajdutësh. Nuk desh të na merrte me vete. Për pesëmbëdhjetë ditë të tëra, humbi e s'u duk fare. Kur u kthye, s'kishte pësuar asgjë. Të gjithë e kujtonim të vdekur, kurse ai ishte shëndoshë e mirë dhe tha: "Ja, shikoni se si më kanë vjedhur!" Dhe hapi një sënduk plot me të gjitha stolitë e katedrales së Embrënit, që ia kishin dhënë hajdutët.

Atë radhë, kur u kthye, meqë i kisha dalë përpara nja dy lega larg me disa miq të tij, s'durova dot dhe e qortova pakëz, duke pasur kujdes t'i flisja vetëm atëherë kur bëhej zhurmë, që të mos dëgjonte njeri tjetër.

Kohët e para thosha me vete: "S'ka rrezik që ta ndalojë, është njeri i tmerrshëm." Tani u mësova me këso punësh. I bëj me shenjë zonjës Magluarë që të mos ia prishë qejfin. Ai u futet rreziqeve pa menduar më tutje. Unë marr me vete zonjën Magluarë, vete në dhomën time, lutem e falem për të dhe pastaj bie të fle. Jam e qetë, se e di mirë që, po i ngjau gjë e keqe atij, edhe unë do të mbaroj.

Do të vete në duart e perëndisë tok me vëllanë dhe ipeshkvin tim. Zonja Magluarë e ka pasur më të vështirë se unë që të mësohej me pamaturitë e imzotit, siç e quan ajo. Por tani edhe ajo i vete pas avazit. Lutemi e falem të dyja tok; kemi frikë si njëra tjetra dhe të dyja biem e flemë. Edhe sikur goftëlargu të hynte në shtëpi, s'do ta trazonte fare. Po, fundi i fundit, kujt t'ia kemi frikën në këtë shtëpi? Qoftëlargu mund

të kalojë nëpër shtëpi, por këtu banon vetë perëndia, që i paçim uratën.

S'dua gjë tjetër. Im vëlla s'ka nevojë bile as të flasë. E kuptoj ku e ka hallin edhe pa më folur.

Ja se si duhet të sillesh me një njeri që ka diçka të madhe në shpirt.

E pyeta tim vëlla për njoftimet që më kërkonit ju mbi familjen Dë Fo. Ta shikosh se si i di të gjitha dhe çfarë kujtese që ka. Me të vërtetë, ajo është një familje shumë e ujetër normande nga bashkësia e Kaenit. Këtu e pesëqind vjet përpara kanë jetuar një Raul dë Fo, një Tomas dë Fo, një Zhan dë Fo, që ishin fisnikë, njëri prej të cilëve është senjor i Roshëforit. I fundmi ishte Gi-Etien-Aleksandri, i cili ishte komandant i një regjimenti të kavalerisë dhe diçka në kalorinë e lehtë të Bretanjes. E bija, Mari-Luiza, pati marrë për burrë Adrien-Sharlë dë Gramonin, birin e dukës Dë Gramon, par i Francës, kolonel i Gardës Franceze dhe gjeneral-nënkolonel i ushtrive. Emri shkruhet Fo, Fok dhe Fauk.

O zonjës e mirë, lutjuni kushëririt tuaj të shenjtë, zotit kardinal, të na ketë ndër mend në lutjet e tij. Përsa i përket Silvanisë suaj të dashur, ajo bëri mirë që nuk përtoi e më shkroi. Lavdi Zotit që është mirë me shëndet, që punon e të dëgjon dhe mua më do gjithmonë. Kështu ma do zemra edhe mua. Kujtimin që më dërgoi me anën tuaj, e mora. Jam shumë e gëzuar. Nga shëndeti s'jam edhe fort keq, dhe megjithatë po thahem e po mpihem përditë e më shumë. Lamtumirë, po më mbarohet edhe letra dhe duhet t'i jap fund. Ju uroj të gjitha të mirat.

BAPTISTINA

P.S. - Zonja kunata juaj është gjithmonë këtu me familjen e saj të re. Nipi juaj i vogël është shumë i lezetshëm. A e dini se për pak kohë mbush pesë vjet? Dje, tek pa të kalonte një kalë që i kishin vënë gjunjëza tha: "Ç'i kanë gjunjët që i kanë vënë ato?" Ç'fëmijë i dashur që është! Vëllai i tij më i vogël heq zvarrë një fshesë të ujetër nëpër apartament si karrocë dhe bërtet: "Hy! hy!"

Siç e shikoni nga kjo letër, këto dy gra dinin t'i vinin pas ujërave ipeshkvi me atë mjeshtërinë e posaçme të gruas, që e kupton burrin më mirë sesa burri burrin. Ipeshkvi i Dinjës, nën atë pamje të ëmbël e të çiltër, që kurrë nuk ndryshonte, bënte herë pas here gjëra të mëdha, të guximshme e të madhërishtme, pa e bërë veten fare. Ato dridheshin nga frika, por e linin në punë të vet. Ngandonjëherë zonja Magluarë hidhte ndonjë qortim, por gjithmonë përpara dhe kurrë gjatë ose pas veprimit. Ato kurrë nuk e turbullonin, qoftë edhe me ndonjë shenjës, kur fillonte ndonjë veprim. Hera-herës, pa qenë nevoja as të hapte gojën, edhe kur as ai s'e priste, kaq e përsosur ishte thjeshtësia e tij, ato e ndienin se ai vepronte si ipeshkvi; atëherë ato, si dy hije, s'pipëtinin fare në shtëpi. I shërbenin të bindura dhe, kur ishte puna për t'u larguar, ato bindeshin e largoheshin. E merrnin me mend me një finesë të admirueshme instinktive se disa kujdesje mund edhe ta bezdisnin. Kështu, edhe kur kujtonin se ai ishte në rrezik, ato e kuptonin kaq shumë, nuk them mendimin e tij, por natyrën e tij, sa nuk vigjëlonin më mbi të. Ato e kishin lënë në dorë të Zotit.

Madje, Baptistina thoshte, siç e përmendëm pakëz më parë, se fundi i vëllait do të ishte edhe fundi i saj. Zonja Magluarë nuk e thoshte një gjë të tillë, por e dinte.

IX

Ipeshkvi përpara një drite të panjohur

Në një periudhë më të vonshme se data e letrës që treguam në faqet e mëparshme, ipeshkvi bëri një gjë që, po t'i zësh besë gjithë qytetit, ishte akoma më e rrezikshme se udhëtimi përmes maleve të hajdutëve.

Na ishte pranë Dinjës, në fushë, një burrë që jetonte i vetmuar. Ky njeri, le ta themë troç që tani, ishte një konvencionar^{*)} i vjetër. Ai quhej G. Në Dinjë të gjithë flisnin

^{*)} Anëtar i Konventës, dhoma e përfaqësuesve të popullit gjatë Revolucionit Frëng.

për këtë konvencionar me njëfarë llahtare. A e merrni dot me mend se ç'do të thotë konvencionar? Konvencionarë kishte në atë kohë kur njerëzit flisnin me "ti" e me "ty" dhe kur i thoshin njëri-tjetrit qytetar. Ky njeri ishte pothuajse një përbindësh. Ai nuk kishte votuar në Konventë tamam për dënimin me vdekje të mbretit, por aty afër. Ishte gati-gati një mbretvrasës. Ai kishte qenë njeri i tmerrshëm. Si ishte e mundur që, kur u kthyen princërit legjitimë nga mërgimi, nuk e patën nxjerrë përpara gjyqit të paapelueshëm? Kokën nuk do t'ia kishin prerë, në daçi ta dini; shpirtbutësi, mbi të gjitha, s'do mend, por një mërgim të përjetshëm do ta kishte ngrënë patjetër. Fundi, do të ishte bërë një shembull i mirë për të tjerët etj., etj. Veç të tjerave, ai na ishte edhe ateist, si të gjithë njerëzit e atij lloji. Krakaritje laraskash për fajkuan.

A ishte ndonjëfarë fajkoi ky G.? Po, në qoftë se e gjykoje nga ajo që kishte të frikshme në vetminë e tij. Megjithatë nuk kishte votuar për vdekjen e mbretit, ai nuk ishte përfshirë në listat e proskripcionit⁷⁾ dhe kishte mundur të mbetej në Francë.

Banonte tre çerek ore nga qyteti, larg çdo vendi të banuar, larg çdo udhe, s'dihet se në çfarë skute të një gryke shumë të egër. Thuhej se atje ai kishte një si arë, një vrimë, një strofkë. Asnjë fqinjë, as kalimtarë. Që nga koha kur banonte në atë grykë, monopati që të çonte aty qe zhdukur nën barin që kishte mbirë e ishte rritur. Njerëzit flisnin për atë vend si për shtëpinë e xhelatit.

Megjithatë, ipeshkvi vriste mendjen dhe kohë më kohë vështronte horizontin atje tutje, ku një tufë pemësh shënonte grykën e konvencionarit të dikurshëm, dhe thoshte: "Atje tej ka një shpirt që është vetëm."

Dhe thellë në mendjen e vet ai shtonte: "Ja kam për borxh t'i bëj një vizitë."

Por, duhet ta pohojmë, ky mendim, i cili në fillim i dukej i natyrshëm, pasi e kishte tnulluar për një çast, i ngjante i çuditshëm dhe i pamundur, dhe pothuajse i pështirë. Sepse, thellë-thellë, edhe ai bashkohej me përshtypjen e përgjithshme, dhe konvencionari i ngjallte, pa e kuptuar as ai vetë sesi, atë

ndjenjë që është si ai kufiri i urrejtjes dhe që e shpreh aq mirë fjala "largim."

Sidoqoftë, a duhet që zgjebja e deles ta zmbropsë bariun? Jo. Por çfarë deleje ishte ai!

Ipeshkvi i shkretë s'dinte si të bënte. Disa herë shkonte atyre anëve, por pastaj kthehej prapë.

Më së fundi, një ditë, na u hap fjala në qytet se një farë bariu i ri, që i shërbente konvensionarit G. në strofkën e tij, kishte ardhur të gjente një mjek; se ky plaku keqbërës po hiqte shpirt, se e kishte pushtuar paraliza dhe se nuk do ta gdhinte dot atë natë. "Lavdi perëndisë!" - shtonin disa. Ipeshkvi mori shkopin, veshi pallton, meqenëse veladoni i tij, siç e kemi thënë, ishte si tepër i ronitur, si edhe për shkak të erës së mbrëmjes, që nuk do të mënonte të frynte, dhe u nis.

Dielli po perëndonte dhe gati po çikte horizontin, kur ipeshkvi arriti te vendi i mallkuar. I rrahu fort zemra kur pa se ishte afër strofkës. Kërceu një hendek, kapërceu një gardh, ngjiti një shteg, hyri në një si avlli të rrënuar, bëri disa hapa me mjaft guxim dhe, befas, në fund të ugarit, prapa një ferre të madhe, pa strofkën.

Ishte një kasolle fare e ulët, e varfër, e vogël dhe e pastër, me një hardhi të mbërthyer në ballinë.

Përpara portës, në një karrige me rrotëza, kolltuk fshatari, ishte një njeri me flokë të thinjur, që po i buzëqeshte diellit.

Pranë plakut të ulur qëndronte në këmbë një djalosh i ri, bariu i vogël. Ky po i zgjaste plakut një poç me qumësht.

Ndërsa ipeshkvi po vështronte, plaku ngriti zërin: "Faleminderit, s'kam më nevojë për gjë." Dhe buzëqeshja e tij u shkëput nga dielli e qëndroi mbi fëmijën.

Ipeshkvi bëri përpara. Nga zhurma që bëri duke ecur, plaku i ulur ktheu kokën, dhe fytyra e tij shprehu të gjithë atë habinë që mund të ketë njeriu pas një jete të gjatë.

-Që kur jam këtu, - tha ai, - kjo është hera e parë që dikush hyn në shtëpinë time. Kush jeni ju, zotëri?

Ipeshkvi u përgjigj:

-Unë jam Bienvény Mirieli.

-Bienvény Mirieli! E kam dëgjuar këtë emër. A jeni ju ai që populli ju quan imzot Bienvény?

-Unë jam.

Plaku vazhdoi me një gjysmë buzëqeshjeje:

-Atëherë, ju qenkeni ipeshkvi im?

-Pak a shumë.

-Urdhëroni brenda, zotëri.

Konvensionari i shtriu dorën ipeshkvit, por ipeshkvi nuk e çiku. Ipeshkvi tha vetëm kaq:

-Jam i kënaqur tek po shoh se më paskan gënjyer. Ju nuk po më dukeni i sëmurë.

-Zotëri, - tha plaku, - do të shërohem.

Heshti një hop dhe tha:

-Do të vdes pas tri orësh.

Pastaj vazhdoi:

-Jam pak mjek unë; e di se në ç'mënyrë afrohet ora e fundit.

Dje i kisha vetëm këmbët të ftohta, sot të ftohtët më ka marrë edhe gjunjët, tani e ndiej që po më ngjitet gjer në brez, kur të arrijë te zemra, do të mbaroj. Dielli është i bukur, apo jo? Kërkova të më sillnin gjer këtu jashtë për t'u hedhur një sy për të fundit herë gjërave. Mund të më flisni, se kjo nuk më lodh aspak. Bëtë mirë që erdhët të shikoni një njeri që është duke vdekur. Është mirë që në çaste të këtilla të ketë një dëshmitar. Njeriu ka manitë e veta: unë për vete do të dëshiroja të arrija gjer në agim. Por e di se mezi më kanë mbetur akoma edhe tri orë. Edhe pak do të bjerë nata. Por, fundi sa parà bën. Të mbarosh, është një punë fare e thjeshtë. S'është nevoja të presësh mëngjesin për një punë të tillë. Ashtu qoftë! Do të vdes nën dritën e yjeve.

Plaku u kthye nga bariu.

-Ti ec e fli. Mbrëmë ke ndenjur gjithë natën e natës pa gjumë. Je lodhur.

Fëmija hyri në kasolle.

Plaku e ndoqi me sy dhe shtoi sikur po fliste me vete:

-Në kohën kur ai do të jetë duke fjetur, unë do të vdes. Të dy gjumet mund të pluskojnë pranë e pranë.

Ipeshkvi nuk ishte i tronditur, siç mund ta merrnim me

mend se duhej të ishte. Atij nuk i besohej të ndiente praninë e Zotit në këtë lloj vdekjeje. Le t'i themi të gjitha, sepse kontradiktat e vogla të zemrave të mëdha duhet të tregohen ashtu si çdo gjë tjetër; ai që, kur vinte puna, qeshte me gjithë shpirt për madhërinë e tij, ishte pak si i prekur që nuk po i thoshin imzot dhe ishte gati t'i kthente përgjigjen: qytetar. I hipi ashtu vagëll qejfi i një familjariteti gërnjar, diçka mjaft e zakonshme te mjekët dhe te priftërinjtë, por që ai vetë nuk e kishte zakon. Ky njeri, fundi i fundit, ky konvencionar, ky përfaqësues i popullit, dikur kishte qenë një njeri i pushtetshëm mbi këtë dhë; për herë të parë në jetën e tij ndoshta ipeshkvi e ndjeu se po bëhej i ashpër.

Konvencionari, megjithatë, e kundronte me një përzemërsi të thjeshtë, ku mund të dalloje ndoshta përvujtmërinë që e kap njeriun kur është në buzë të varrit.

Ipeshkvi, nga ana e vet, megjithëse i ruhej kërshërisë, e cila, sipas tij, ishte motër me fyerjen, nuk mund të duronte pa e këqyrur konvencionarin me një vëmendje, e cila, duke mos e pasur burimin te simpatia, mund të merrej ndoshta si faj, po të ndodhej ballë për ballë një njeriu krejt tjetër. Një konvencionar i jepte pak përshtypjen e një njeriu të nxjerrë jashtë ligjit, madje edhe jashtë ligjit të mëshirës.

G., i qetë, me bustin gati të drejtë, zërin tingëllues, ishte një nga ata tetëdhjetëvjeçarët që e lënë pa mend fiziologun. Revolucioni ka pasur shumë nga këta burra që i binin përshtat kohës. Njeriu ndiente se ky plak ishte një burrë i rrahur me jetën. Kaq afër mbarimit të tij, ai i kishte ruajtur të gjitha lëvizjet e njeriut plot shëndet. Në atë vështrim të qartë të syrit, në atë theks të patronditur, në atë lëvizje të shëndoshë të supeve të këtij plaku kishte diçka e cila mund ta bënte edhe vdekjen të dyzonte mendjeprishur. Azraeli, engjëlli muhamedan i vdekjes, do të ishte kthyer nga rruga dhe do të kishte kujtuar se kishte gabuar derë. G. dukej se po vdiste ngaqë këtë e dëshironte vetë. Edhe në agoni ndihej vullneti i tij i lirë. Vetëm këmbët i kishte të ngrira. Vdekja e kishte zaptuar nga këmbët. Këmbët ishin të vdekura e të ftohta, kurse koka jetonte me të gjithë fuqinë e jetës dhe kishte një qartësi të plotë. G. në këtë çast të rëndë i

përngjiste atij mbretit të përrallës së Lindjes mish nga brezi e lart, mermer nga brezi e poshtë.

Aty afër ndodhej një gur. Ipeshkvi u ul. Pjesa e parë e predikut u bë *ex abrupto*.^{*)}

-Ju përgëzoj, - tha ai me një zë si qortues. - Sidoqoftë, ju nuk keni votuar për vdekjen e mbretit.

Konvencionari u duk sikur nuk e vuri re nënkuptimin e hidhur e të fshehur në këtë fjalë: "sidoqoftë". Ai u përgjigj. Çdo buzëqeshje i qe zhdukur nga fytyra.

-Mos më përgëzoni edhe aq tepër, zotëri, unë kam votuar për vdekjen e tiranit.

Ky ishte theksi hijerëndë përpara theksit të ashpër.

-Ç'doni të thoni me këtë? - vazhdoi ipeshkvi.

-Dua të them se njeriu ka një tiran, paditurinë. Unë kam votuar për vdekjen e këtij tirani. Ky tiran ka pjellë mbretërinë, që është një pushtet i cili e ka burimin në gënjeshtren, ndërsa shkenca është një autoritet që e ka burimin në të vërtetën. Njeriu duhet të qeveriset vetëm nga shkenca.

-Dhe nga ndërgjegjja, - shtoi ipeshkvi.

-Po ajo gjë është. Ndërgjegjja është sasia e shkencës së ngjizur që kemi në veten tonë.

Imzot Bienvényi e dëgjonte pak i habitur këtë të folme krejt të re për të.

Konvencionari vijoi:

-Sa për Luigjin XVI, unë thashë "jo". Unë s'kam si t'ia ngarkoj vetes të drejtën që të vras një njeri; por e ndiej për detyrë që të shfaros të keqen. Unë votova fundin e tiranit. Domethënë, fundin e kurvërisë për gruan, fundin e skllavërisë për burrin, fundin e errësirës për fëmijën. Duke votuar për republikën, kam votuar për këtë. Kam votuar për vëllazërimin, pajtimin, agimin! Kam ndihmuar në zhdukjen e paragjykimeve dhe të gabimeve. Zhdukja e paragjykimeve dhe e gabimeve, përhap dritën. Ne, ne rrëzuam botën e vjetër, dhe bota e vjetër, llumi i mjerimeve, duke u rrokullisur nga gjinia njerëzore, u bë një burim gëzimi.

^{*)} Eks abrupto (lat.) Në mënyrë të befasishme, pa hyrje.

-Gëzimi të përzier, - tha ipeshkvi.

-Mund të thoshit gëzimi të turbulluar, dhe sot, pas atij kthimi fatal të së kaluarës, që quhet 1814, gëzimi të zhdukur. Për fat të keq, vepra ka qenë e paplotë, dhe unë e pranoj; ne e shkatërruam regjimin në veprat, por nuk mundëm ta zhduknim krejtësisht nga idetë. Të asgjësosh shpërdorimet, edhe kjo nuk mjafton; duhet të ndryshosh edhe zakonet. Mulliri s'është më, por era është akoma.

-Ju keni shkatërruar. Mund të jetë e dobishme të shkatërrosh, por unë nuk i zë besë një shkatërrimi të përzier me zemërimin.

-E drejta ka edhe ajo zemërimin e vet, zoti ipeshkv, dhe zemërimi i së drejtës është një element i përparimit. Por s'ka gjë, dhe sidoqë të thonë, Revolucioni Francez është hapi më i fuqishëm i gjinisë njerëzore. I paplotë, po, por i madhërishtëm. Revolucioni nxori në shesh të gjitha të panjohurat shoqërore. Ai i zbuti shpirtat; ai qetësoi, lëmoi, ndriçoi; ai bëri që të vërshojnë mbi tokë valë të tëra qytetërimi. Ka qenë i mirë. Revolucioni Francez është shenjtërimi i njerëzimit.

Ipeshkvi s'e mbajti dot veten dhe murmuriti:

-Ashtu? Po viti 93!

-Ah! Prapë po ai avaz! Viti 93! Unë e prisja këtë fjalë. Një re u formua gjatë një mijë e pesëqind vjetëve. Pas pesëmbëdhjetë shekujve, kjo re shpërtheu. Ju po gjykoni krismën e bubullimës.

Ipeshkvi ndjeu, ndoshta pa ia mohuar as vetes së vet, se diçka brenda shpirtit të tij ishte goditur. Megjithatë, ai e mbajti veten dhe u përgjigj:

-Gjykatësi flet në emër të drejtësisë; prifti flet në emër të mëshirës. Një krismë bubullime nuk duhet të gabojë.

Dhe shtoi duke vështruar ngultas konvencionarin:

-Po Luigji XVII?

Konvencionari shtriu dorën dhe i kapi krahun ipeshkvit:

-Luigji XVII! Pa të shohim njëherë! Për cilin qani ju? Për fëmijën e pafajshëm? Atëherë, ashtu qoftë. Dhe unë qaj tok me ju. Për fëmijën mbretëror? Atëherë, unë ju them të mendoni. Vëllai i Kartushit,⁹⁾ fëmijë i pafajshëm, i varur për sqetullash

në sheshin "Grevë", derisa i doli shpirti, për të vetmin krim sepse ishte i vëllai i Kartushit, nuk më dhimbset më pak se i nipi i Luigjit XV, fëmijë i pafajshëm, i martirizuar në kullën e "Tamplit" për të vetmin krim sepse ishte i nipi i Luigjit XV.

-Zotëri, - tha ipeshkvi, - mua nuk më pëlqen t'i vëmë pranë këta emra.

-Kartushi? Luigji XV? Kundër cilit nga këta jeni ju?

U bë një hop heshtje.

Ipeshkvi ishte penduar që kishte ardhur aty e, megjithatë, ai e ndiente veten të tronditur në mënyrë të pakuptueshme dhe të çuditshme.

-Unë ngul këmbë, - vijoi konvencionari G. - Ju më zutë ngoje Luigjin XVII. Le të merremi vesh. A do të qajmë për të gjithë të pafajshmit, për të gjithë martirët, për të gjithë fëmijët, për ata që janë poshtë dhe ata që janë lart? Unë për këtë jam. Po atëherë, jua thashë, duhet të ngjitemi më lart se viti 93 dhe lotët tanë duhet të fillojnë më përpara se Luigji XVII. Do të qaj për fëmijët e mbretërve tok me ju, me kusht që edhe ju të qani tok me mua për fëmijët e popullit.

-Unë qaj për të gjithë, - tha ipeshkvi.

-Barabar! - bërtiti G., - dhe në qoftë se balanca duhet të anojë, le të anojë nga ana e popullit. Populli ka më shumë kohë që po vuan.

U bë edhe një heshtje tjetër. Dhe këtë heshtje e prishi konvencionari. U mbështet mbi një bërryl, kapi lehtë faqen me gishtin e madh e me gishtin tregues pakëz të përkulur, ashtu siç bën njeriu padashur kur pyet e gjykon, u kthye nga ipeshkvi dhe i hodhi një vështrim të mbushur plot e përplot me të gjitha energjitë e agonisë. Ishte gati si një shpërthim.

-Po, zotëri, populli ka kohë që po vuan e heq. Pastaj, pa dale, se s'kam mbaruar, pse vini e më pyesni e më flisni për Luigjin XVII? Unë nuk ju njoh. Qëkurse kam ardhur në këtë vend, kam jetuar në këtë avllizë, vetëm, pa bërë asnjë hap përjashta, pa parë njeri tjetër përveç këtij fëmije, që më ndihmon. Është e vërtetë se emrin tuaj ma ka zënë veshi ashtu si nëpër tym, dhe, më duhet ta them, jo për keq; por kjo nuk do të thotë gjë; njerëzit e shkathët kanë kaq e kaq marifete për t'i

hedhur hi syve këtij babaxhan populli. Meqë ra fjala, unë nuk e dëgjova zhurmën e karrocës suaj, do ta keni lënë pa dyshim prapa korijes, atje tutje, te bigëzimi i udhës. Nuk ju njoh, po ju them. Më thatë se ishit ipeshkvi, por kjo nuk më jep asnjë njoftim mbi figurën tuaj morale. Shkurt, po jua përsërit pyetjen time. Kush jeni ju? Jeni një ipeshkv, domethënë një princ i kishës, një nga ata njerëz të larë në ar, në salltanete, që notojnë në mes të të ardhurave nga tokat dhe nga ofiqet kishtarë - ipeshkvia e Dinjës, pesëmbëdhjetë mijë franga të paluajtshme, dhjetë mijë franga të tjera të rastit, të gjitha bëjnë njëzet e pesë mijë franga - që kanë kuzhina, shërbëtorë të veshur akull, që hanë e pinë mirë, që hanë pula e shapkëza të premtëve, që kapardisen me shërbëtorë përpara e shërbëtorë prapa, me karroca festash, dhe që kanë pallate, e që notojnë në luks në emër të Jezu Krishtit, i cili ecte këmbëzbathur. Ju jeni një prelat; të ardhura, pallate, kuaj, shërbëtorë, tryezë me një mijë të mira, të gjitha qejfet e jetës, të gjitha këto i keni edhe ju, si të gjithë të tjerët, dhe, ashtu si të tjerët, i gëzoni, mirëpo kjo do të thotë shumë gjëra ose jo edhe aq; kjo nuk më sqaron lidhur me vlerat tuaja të brendshme dhe themelore, mbi ju që vini këtu duke dashur ndoshta të më shitni urtësi. Me cilin po flas? Kush jeni ju?

Ipeshkvi uli kryet dhe u përgjigj: "*Vermis sum*"^{*)}

Një krimb toke, por me karrocë, ama, - tha nëpër dhëmbë konvensionari.

Tani kishte ardhur radha e konvensionarit të ishte i njerëzishëm dhe e ipeshkvit të ishte i përvuajtur.

Ipeshkvi rifilloi me butësi:

-Zotëri, ashtu qoftë. Por, shpjegomëni se në ç'mënyrë karroca ime, që është aty dy hapa larg prapa pemëve, në ç'mënyrë tryeza ime dhe shapkëzat që ha të premtëve, të njëzet e pesë mijë livrat e të ardhurave, me se pallatet dhe shërbëtorët e mi provojnë se mëshira nuk është një virtyt, se shpirtbutësia nuk është një detyrë dhe se viti 93 nuk ka qenë i pamëshirshëm.

^{*)}Vermis sum (lat.) - Jam një krimb.

Konvensionari e kaloi dorën mbi ballin e vet, si për të përzënë soje një hije.

-Përpara se t'ju përgjigjem, - tha ai, - ju lutem të më falni. Unë kam bërë një gabim, zotëri. Ju jeni në shtëpinë time, jeni mysafiri im. Duhet t'ju bëj nder. Ju diskutoni mendimet e mia, pra është e udhës që unë të kufizohem të luftoj arsyetimet tuaja. Pasuritë dhe të mirat që gëzoni, janë avantazhe për mua në këtë luftë mendimesh, por ma do nderi që të mos i përdor ato.

-Ju faleminderit, - tha ipeshkvi.

G. vijoi:

-Të kthehem te shpjegimi që më kërkuat. Ku e kishim fjalën? Çfarë po më thoshit? Që viti 93 ka qenë i pamëshirshëm?

-I pamëshirshëm, po, - tha ipeshkvi. - Ç'mendoni për Maratin, a nuk e duartrokiste ai gijotinën?

-Ç'mendoni ju për Bosyenë⁹⁾ që këndonte një "*Te Deum*" për dragonadat.⁹⁾

Përgjigjja ishte e ashpër, por binte drejt e në shenjë me papërkulshmërinë e një maje të çeliktë. Ipeshkvit iu drodh shtati, nuk i erdhi asnjë përgjigje në gojë, por u pezmatua nga kjo mënyrë se si zihej në gojë Bosyeja. Edhe mendjet më të mëdha kanë edhe ato hajmalitë e tyre, dhe ngandonjëherë e ndiejnë veten si të plagosura nga mungesa e respektit të logjikës.

Konvensionari po fillonte të gulçonte; astma e hjekës, që përzihet me frymëmarrjen e fundit, ia ndërpriste zërin; megjithatë, një qetësi e plotë shpirtërore shprehej akoma në sytë e tij. Vazhdoi:

-Le të themi edhe ndonjë fjalë aty-këtu, kam shumë qejf. Jashtë Revolucionit, i cili, i marrë në tërësinë e tij, është një pohim i pakufishëm njerëzor, viti 93, fatkeqësisht! është një kthim përgjigjeje. Ju e quani të pamëshirshëm, po e tërë monarkia, zotëri, si ju duket? Zotëri, zotëri, unë i qaj hallin Maria-Antuanetës, arkidukeshë dhe mbretëreshë; por unë i qaj hallin edhe asaj të varfrës grua hugenote, e cila, më 1685, nën Luigjin e Madh, zotëri, kishte një fëmijë në gjë dhe që e lidhën lakuriq gjer në brez, pas një shtylle, duke ia mbajtur fëmijën larg gjirit; gjiri i përfryhej nga qumështi dhe zemra nga

angështia; vogëlushi, i uritur dhe i zverdhur, e shikonte këtë gjë, hiqte shpirt dhe vdiste; dhe xhelati i thoshte gruas, asaj nëne me fëmijë në gjë: “Moho!”, duke e lënë të zgjidhte midis vdekjes së fëmijës dhe vdekjes së ndërgjegjes së saj. Si i thoni ju kësaj sflitjeje prej Tantalit që i kanë punuar një nëne? Zotëri, mbajeni mend mirë këtë. Revolucioni ka pasur arsyet e veta. Inatin e tij do ta shfaqë ajo e ardhmja. Përfundimi i tij është një botë më e mirë. Nga goditjet e tij më të tmerrshme del një përkëdhelje për gjininë njerëzore. Po i bie shkurt. Po e lë me kaq, loja është në favorin tim. Pastaj, unë jam duke vdekur.

Dhe, duke e larguar vështrimin nga ipeshkvi, konvencionari e mbaroi mendimin e vet me këto pak fjalë të qeta:

-Po, dhunat e përparimit quhen revolucione. Njerëzit i njohin dhe i pranojnë, pasi kanë marrë fund ato, se gjinia njerëzore ka qenë përdorur ashpër, porse ka ecur edhe përpara.

Konvencionarit as që i shkonte ndër mend se i kishte pushtuar njërin pas tjetrit të gjitha llogoret e brendshme të ipeshkvit. Por megjithatë, kishte mbetur akoma edhe një, dhe prej kësaj llogoreje, që ishte mbështetja e burimi më i lartë i qëndresës së imzot Mirielit, doli kjo fjalë, ku u shfaq përsëri e gjithë ashpërsia e fillimit:

-Përparimi duhet të besojë në Zotin. Mirësia nuk mund të ketë shërbyes të pabesë. Është udhëheqës i keq i gjinisë njerëzore ai që është ateist.

Përfaqësuesi plak i popullit nuk iu përgjigj. Ai pati një të dridhur. Vështroi qiellin dhe një lot mbuloi ngadalë këtë vështrim. Kur kapaku i syrit u mbush plot, loti u rrokullis përgjatë faqes së tij të rrudhur e të bërë meit. Dhe konvencionari tha gati duke belbëzuar, me një zë të ulët dhe duke folur me vetvete, me sytë të humbur ndër thellësira:

-O ti! O ideal! Vetëm ti je në këtë botë!

Ipeshkvi ndjeu njëfarë tronditjeje që s'mund të shprehej.

Pas një heshtjeje plaku ngriti një gisht drejt qiellit e tha:

-Pafundësia është. Ajo është atje. Në qoftë se pafundësia nuk do të kishte një unë, uni nuk do të ishte kufi e cak; nuk do të ishte e pafundshmja, me fjalë të tjera ajo nuk do të ishte

fare. Por ajo është. Pra, ajo ka një unë. Ky uni i pafundësisë është Zoti.

Kur mbaroi së foluri, sytë e tij u mbyllën. Përpjekja e kishte rraskapitur fare. Dukej sheshit që ai sapo jetoi në një minutë të vetme ato pak orë që i mbeteshin akoma. Çasti suprem po arrinte.

Ipeshkvi e kuptoi, koha nuk priste, ai kishte ardhur aty si prift; nga ftohtësia e tejme, ai kishte arritur në tronditje të tejme; ai i vështroi ata sy të mbyllur, e mori atë dorë të plakur plot rrudha e të ftohtë akull dhe u përkul nga njeriu që po hiqte shpirt:

-Kjo orë është ora e Zotit. A nuk mendoni edhe ju se do të ishte për të ardhur keq që takimi ynë të shkonte kot?

Konvencionari i riçeli sytë. Një hije e rëndë, ku sundonte njëfarë errësire, e damkosi fytyrën e tij.

-Zoti ipeshkv, - tha ai me një ngadalësi, e cila vinte më shumë ndoshta nga dinjiteti i shpirtit, sesa nga rraskapitja e forcave, - unë kam kaluar jetën time duke menduar, duke studiuar e duke vëzhguar. Isha gjashtëdhjetë vjeç atëherë kur atdheu më thirri dhe më urdhëroi të merresha me punët e tij. Unë u binda. Kishte shpërdorime, dhe unë i luftova; kishte tiranira, dhe unë i shkatërrova; kishte të drejta dhe parime, dhe unë i shpalla dhe i nxora në shesh. Atdheu ishte pushtuar, dhe unë e mbrojta; Franca kërcënohej, dhe unë dhurova gjoksin tim. Nuk isha i pasur; jam i varfër. Unë kam qenë njëri prej zotërve të shtetit, depot e thesarit ishin mbushur dënga me sende, aq sa u shtrënguan t'u vinim stengëza mureve, që ishin gati të pëlcisnin nën peshën e arit dhe të argjendit, por haja darkë në rrugën “Arbrë-Sek” me nga njëzet e dy su për kokë. U kam ardhur në ndihmë të shtypurve, u kam dhënë dorën atyre që vuanin. Kam grisur edhe napën e lterit, është e vërtetë; por këtë e kam bërë për të lidhur plagët e atdheut. Kam përkrahur gjithmonë ecjen përpara të gjinisë njerëzore drejt dritës. Unë kam bërë detyrën mesa kam mundur, dhe të mira aq sa më ka ardhur për dore. E pas gjithë këtyre, më përzunë, m'u vunë këmba-këmbës, më ndoqën, më përndoqën, më nxinë, më tallën, më pështynë, më mallkuan e më nxorën fare. Që prej

shumë vjetësh, me gjithë flokët e mi të bardhë, po shoh se shumë njerëz kujtojnë se kanë të drejtë të më përbuzin; për turmën e varfër të padijshme unë kam fytyrën e një të mallkuari, dhe e pranoj vetminë e urrejtjes duke mos urreyer asnjëri. Tani jam tetëdhjetë e gjashtë vjeç; do të vdes. Çfarë keni ardhur të kërkoni prej meje?

-Bekimin tuaj, - tha ipeshkvi.

Dhe ra në gjunjë.

Kur ipeshkvi ngriti kokën, fytyra e konvencionarit ishte bërë e madhërishme. Sapo kishte dhënë frymën e fundit.

Ipeshkvi u kthye në shtëpi, i zhytur thellë nuk e di në çfarë mendimesh. Gjithë natën e kaloi me lutje. Të nesërmen disa kureshtarë si më trima u orvatën t'i flisnin për konvencionarin G.; ai u kufizua vetëm duke treguar qiellin. Që prej atij çasti ai e dyfishoi dashurinë dhe vëllazërinë për të vegjlit dhe të përvuajturit. Kur i zinin ngoje atë "keqbërësin plak G.", ai zhytej në një siklet të pazakontë.

Kjo "vizitë baritore" u dha natyrisht shkak thashethemeve të gojëve të këqija të vendit: "A ishte vallë e udhës për një ipeshkv të shkonte e t'i rrinte mbi shtratin e vdekjes një njeriu si ai? Ishte e qartë se ai keqbërës nuk do të ndërronte udhë. Të gjithë këta revolucionarët janë pa din e pa iman. Atëherë, pse të shkonte atje? Ç'deshi të shikonte atje? Siç duket, do të ketë qenë shumë kureshtar për të parë se si djalli do ta rrëmbente shpirtin e tij."

Një ditë një vejushë që jetonte me të ardhurat e burrit të vet, një grua nga ato më të pacipat, që e hiqte veten fort mendjempërtë, i hodhi këtë thumb: "Imzot, njerëzit duan të dinë se kur do ta vërë madhëria juaj kësulën e kuqe." "Oh! Oh! Kjo është ngjyrë me spec, - u përgjigj ipeshkvi. - Për fat të mirë që ata që e përbuzin këtë ngjyrë në një kësulë, e përnderojnë në një kapelë."

X

Një rezervë

Kishte rrezik të gaboje rëndë, po të nxirrje nga kjo përfundimin se imzot Bienvényi ishte një "ipeshkv filozof" ose "një famullitar patriot". Takimi, të cilin gati-gati mund ta quajmë afrim me konvencionarin G., i la atij njëfarë habie, që e bëri akoma më të butë. Kjo qe e gjitha.

Megjithëse imzot Bienvényi nuk ishte aspak njeri i politikës, ndoshta këtu është vendi të tregojmë shumë shkurt se cili ishte qëndrimi i tij ndaj ngjarjeve të asaj kohe, duke pranuar sikur imzot Bienvényi të kishte menduar të mbante ndonjë qëndrim.

Le të kthehemi, pra, disa vjet prapa.

Disa kohë pas ngritjes së zotit Miriel në ofiqin e ipeshkvit, perandori e kishte bërë baron të Perandorisë, së bashku me shumë ipeshkvë të tjerë. Arrestimi i papës u bë, siç dihet, natën e 5-6 korrikut 1809; me këtë rast, zotin Miriel e thirri Napoleoni në sinodin e ipeshkve të Francës e të Italisë, të mbledhur në Paris. Ky sinod u mbajt në kishën e Shën-Marisë dhe u mbledh për të parën herë më 15 qershor të 1811-tës, nën kryesinë e zotit kardinal Feshit. Zoti Miriel ishte një nga ata të nëntëdhjetë e pestët ipeshkvë që vajtën aty. Por ai nuk mori pjesë veçse në seancë dhe në tri a katër konferenca të posaçme. Si ipeshkv i një dioqeze malore, që jetonte aq afër natyrës, katundarçe dhe fare hollë, duket se sillte midis këtyre burrave me nga një barrë ofiqe idera që e ndërtonin temperaturën e mbledhjes. Pa mënuar shumë, u kthye prapë në Dinjë. E pyetën pse ishte kthyer kaq vrik, dhe ai u përgjigj: "I bezdisja. Ajri nga jashtë u vinte përmes meje. Unë u dukësha atyre sikur të isha ndonjë portë e hapur."

Njëherë tjetër ai tha: "Epo, ç'prisnit ju? Ata zotërinj janë princa, jo shaka. Ndërsa unë s'jam tjetër veçse një ipeshkv i varfër fshati."

Puna është se ky s'para u kishte pëlqyer. Mes shumë gjërash të tjera të çuditshme, i paskësh shpëtuar goja e paskësh

thënë një mbrëmje, kur ndodhej te një prej kolegëve të vet më të lartë: “Ç’sahate të bukura! Ç’qilima të bukur! Ç’veshje të bukura! Këto duhet të jenë bezdi e madhe, besa! Oh, unë s’do të dëshiroja kurrë të kisha gjithë këtë tepri, nga e cila pastaj do të më buçisnin pa pushim veshët: “Ka njerëz që kanë uri! Ka njerëz që kanë ftohtë! Ka njerëz të varfër! Ka njerëz të varfër!”

Le ta themi kalimthi se urrejtja ndaj salltanetit nuk është një urrejtje fort e mençur. Kjo urrejtje do të sillte urrejtjen ndaj arteve. Megjithatë, te njerëzit e kishës, me përjashtim të festimeve dhe ceremonive, salltaneti është një gjë e padrejtë. Salltaneti duket se zbulon zakone që nuk përputhen aspak me mëshirën. Një prift i pasur e barkmadh është një kundërkuptim. Prifti duhet të qëndrojë afër të varfërve. Por a mund të prekësh pa pushim, dhe natën, dhe ditën, të gjitha hallet, të gjitha fatkeqësitë, të gjitha skamjet, pa pasur edhe ti vetë mbi veten tënde pakëz nga ky mjerim i shenjtë, ashtu si merr njeriu pluhur kur punon? A ta merr mendja që të rrijë një njeri pranë zjarrit dhe të mos e ndiejë të nxehët? A ta merr mendja që një punëtor i cili punon pa pushim në një furrë, të mos ketë asnjë qime floku të përcëlluar, asnjë thua të nxirë, asnjë pikë djersë, asnjë kokrrizë hiri në fytyrë? Prova e parë e mëshirës te një prift, sidomos tek ipeshkvi, është varfëria.

Pa dyshim kështu mendonte zoti ipeshkv i Dinjës.

Por edhe nuk duhet besuar që ai, mbi disa pika delikate, të ishte në një mendje me ato që do t’i quanim “idetë e shekullit”.

Pak përzihej në zënkat teologjike të kohës dhe e kyçte gojën për gjërat ku përziheshin kisha dhe shteti; por, po ta ngacmoje shumë, ka të ngjarë që ai të dilte më shumë ultramontan se galikan¹⁰⁾. Meqenëse po bëjmë një portret dhe duam të mos fshehim asgjë, jemi të shtrënguar të shtojmë se ai qëndroi i ftohtë akull kundërshtimit Napoleonit, që kishte marrë tatëpjetën. Nga viti 1813 e tëhu ai mori pjesë ose duartrokiti në të gjitha shfaqjet kundër tij. Ai nuk pranoi t’i dilte përpara e ta priste udhës, kur u kthye nga ishulli i Elbës, dhe nuk dha urdhër në dioqezën e tij që të bëheshin lutje publike për perandorin gjatë të njëqindditëve.¹¹⁾

Veç motrës, zonjushës Baptistinë, ai kishte edhe vëllezër:

njërin gjeneral, tjetrin prefekt. U shkruante shpesh të dyve. Për ca kohë qëndroi i zemëruar me të parin, sepse, duke pasur një komandë në Provansë, në kohën e zbarkimit të Kanës, gjenerali ishte vënë në krye të një mijë e dyqind burrave dhe e kishte ndjekur perandorin tamam si ndonjë njeri që don enkas ta lërë të ikë e t’i shpëtojë. Letërkëmbimi i tij ishte mbushur me më shumë dashuri për vëllanë tjetër, ish-prefektin, burrë sokol dhe i denjë, që jetonte i vetmuar në Paris, në rrugën “Karetë”.

Imzot Bienvényi pati, pra, edhe ai çaste kur u përzie në punë partish, çaste hidhërimesh e turbullirash. Hija e pasioneve të kohës e përshkoi edhe këtë shpirt të butë e të madh, që merrej me gjëra të amshuara.

Po të kishim pranuar se imzot Bienvényi ishte krijuar jo për një funksion politik, ne do të kishim kuptuar dhe admiruar protestën në emër të së drejtës dhe të lirisë, kundërshtinë krenare, qëndresën plot rreziqe dhe të drejtë ndaj Napoleonit të plotfuqishëm. Por ajo që na pëlqen për ata që ngjiten, s’na pëlqen fort për ata që bien. Ne e duam luftimin përderisa ka rrezik; dhe, në të gjitha rastet, luftëtarët e orës së parë janë të vetmit që kanë të drejtë të jenë asgjësuesit e orës së fundit. Ai që nuk ka qenë paditës i vendosur gjatë lulëzimit, duhet ta mbyllë gojën përpara gremisjes. Ai që padit haptazi suksesin, është i vetmi gjykatës i ligjshëm për rënien. Kurse ne, kur Fati hyn në valle e godet, ne e lëmë atë të veprojë. Viti 1812 fillon të na çarmatosë. Më 1813 prishja e poshtër e heshtjes nga ai trup ligjvënës i nemitur, që mori zemër nga katastrofa, s’kishte tjetër veçse gjëra që të indinjonin, dhe ishte e padrejtë të duartrokisje, më 1814, përpara atyre mareshalëve tradhtarë, përpara atij senati, që u zhyt nga njëri lull në tjetrin, që hodhi baltë pasi pati ngritur në qiej, përpara këtij adhurimi servil, i cili pastaj pështyu mbi idhullin, e kishte për detyrë ta ktheje kokën me përbuzje, më 1815, teksa shkatërrimet e mëdha po trokisnin në derë, ndërsa Franca po dridhej nga afrimi i tyre i kobshëm, ndërsa njeriu mund të dallonte Vaterlonë të hapur gojë përpara Napoleonit, në brohoritjen e dhimbshme të ushtrisë dhe të popullit për të dënuarin nga fati nuk kishte asgjë qesharake,

dhe, duke mbajtur çdo rezervë ndaj despotit, një zemër si ipeshkvi i Dinjës ndoshta nuk do të duhej të hidhte poshtë e të mos njihnte çka kishte të madhërishtme e prekëse, buzë greminës, përfaqimi i fortë midis një kombi të madh dhe një njeriu të madh.

Me këtë përjashtim të vetëm, ai ishte dhe qëndroi në çdo gjë i drejtë, i vërtetë, i paanshëm, i zgjuar, i përvuajtur dhe i denjë; mirëbërës dhe dashamirës, gjë që është një bamirësi tjetër. Madje, duhet thënë, edhe në këtë opinion publik, për të cilin ne e qortuam pak më lart dhe që ne jemi gati ta gjykojmë pothuajse ashpër, ai ishte i gjerë dhe jo i ngurtë, ndoshta më shumë se ne që jemi duke folur këtu. Portierin e bashkisë së qytetit e kishte vendosur aty vetë perandori. Ky portier na ishte një nënoficer i moçëm i gardës së vjetër, legjionar i Austerlicit, bonapartist si shqiponja. Kur i vinte rasti, këtij të shkreti të paudhë na i shpëtonin ca nga ato fjalët e papeshuara, të cilat ligji i atëhershëm i cilësonte si *fjalë kryengritëse*. Qëkurse profili perandorak ishte zhdukur nga Urdhri i Legjionit të Nderit, ai nuk vishej kurrë *sipas rregullores*, siç thoshte ai, me qëllim që të mos detyrohej të mbante kryqin. Ai e kishte hequr me dorën e vet plot devocion fytyrën perandorake nga kryqi, të cilin ia kishte dhënë vetë Napoleoni. Kështu, në mes të kryqit kishte mbetur një vrimë, por ai s'pranoi kurrë të vinte gjë tjetër në vend të saj. "Më mirë të vdes, - thoshte ai, - sesa të mbaj mbi zemrën time të tre zhabjakët!"¹² Ai s'ia përtonte fare ta tallte hidhët e me zë të lartë Luigjin XVIII. "Plak, i rrëgjuar me çizme angleze!" - thoshte ai, - le ta këputë qafën në Prusi me gjithë bishtalecin që mban!" I bëhej zemra mal të bashkonte në një të sharë të vetme të dy gjërat që urrente më shumë, Prusinë dhe Anglinë. Bëri e bëri, sa humbi edhe punën. Dhe mbeti udhëve me gruan e me një tufë fëmijë. Ipeshkvi e thirri, e qortoi butë-butë dhe e emëroi portier të katedrales.

Zoti Miriel ishte në dioqezë bariu i vërtetë, miku i të gjithëve.

Në krye të nëntë vjetëve, duke bërë shumë e shumë veprime të mira dhe duke u sjellë butë, imzot Bienvënyi e kishte mbushur të gjithë Dinjën me njëfarë përnderimi të dashur

birnor. Edhe sjellja e tij armiqësore ndaj Napoleonit kishte qenë pranuar dhe falur heshturazi nga ana e popullit, kopë e mirë dhe e dobët, që adhuronte perandorin e vet, por që ushqente dashuri për ipeshkvin e vet.

XI

Vetmia e imzot Bienvënyit

Rreth një ipeshkvi ka pothuajse gjithmonë një çetë abatësh të vegjël, ashtu siç ka rreth një gjenerali një trumbë oficerësh të rinj. Këta ai i këndshmi Sen-Fransua dë Salë na i quan diku "priftërinj aguridhë". Këtyre lakmuesve që rrinë pranë njerëzve me ofiqe, u hapen udhët e ofiqeve. S'ka ofiq që të mos ketë rrethin e vet të sahanlëpirësve; s'ka pasuri që të mos ketë larot e vet përreth. Ata që kërkojnë të ardhmen e tyre, gumëzhijnë rreth së tashmes së shkëlqyer. Çdo mitropoli ka dhe shtatmadhorinë e vet. Çdo ipeshkv me shumë a pak influencë ka rreth vetes edhe çetën e kerubinëve seminaristë, që bën rojë dhe mban rregullin në pallatin ipeshkvor dhe që përgjon buzëqeshjen e imzotit. Po i hyre në zemër një ipeshkvi, e vure këmbën në yzengji për t'u bërë nëndhiak. Duhet medoemos t'i hapësh udhë vetes; parimet apostolike nuk i hedhin poshtë ofiqet në hierarkinë kishtare.

Ashtu si ka gjetkë kësula të mëdha, në kishë ka mitra të mëdha. Këta janë ipeshkvët e favorizuar, të pasur, me të ardhura, të shkathët, të nderuar nga të gjithë, që dinë të luten, por që dinë edhe të kërkojnë e të lajkatojnë, që s'e kanë për gjë ta bëjnë të presë në paradhomën e tij një dioqezë të tërë, vijëzlidhëse, kjo, midis lterit dhe diplomacisë, që janë më tepër abatë se priftërinj, më tepër prelatë se ipeshkvë. Lum ai që arrin t'i afrojë! Si njerëz me besim që janë, ata lëshojnë si shi rreth vetes së tyre, mbi njerëzit e zellshëm dhe të përkrahurit dhe mbi gjithë atë rini që di t'u hyjë në zemër, famullira të majme, të ardhura kishtare, grada kryefamullie lëmosharie dhe shërbesa

kryekishtare, duke pritur ofiqet ipeshkvore. Duke përparuar vetë, ata çojnë përpara edhe satelitët e tyre, rrethin e tyre; është tamam si një sistem i tërë diellor në lëvizje. Shkëlqimi i tyre u jep dritë edhe atyre që u rrinë në bisht. Mbarësia e tyre thërrmohet mbi të gjithë krahinën kishtare në gradime të vogla e të mira. Sa më e madhe dioqeza e padronit, aq më e madhe edhe famullia e të përkraturit. Pastaj, ja ku është Roma. Një ipeshkv që di të bëhet arkishop, një arkishop që di të bëhet kardinal, të merr me vete si konklavist, dhe ja tek hyre si anëtar në gjykatën papnore; more shiritin e bardhë të ofiqeve të larta, ja tek u bëre auditor, ofiqar i dhomës së papës, imzot, dhe nga madhëria te lartësia s'mbetet veçse një hap, dhe midis lartësisë dhe shenjtërisë nuk mbetet veçse tymi i votimit për t'u bërë papë. Çdo kapuç prifti mund të ëndërrojë edhe tiarën e papës. Prifti është sot i vetmi njeri që mund të bëhet rregullisht mbret, dhe çfarë mbreti! mbret mbi mbretërit. Ja pse një seminar është tamam si një farishte ëndrrash lakmuese! Sa e sa fëmijë të turpshëm, ndihmës të priftërinjve në shërbesat fetare, sa e sa abatë të rinj mbajnë kotruven e Peretës mbi kokë!¹³. Sa lehtë ambicia mund të titullohet dhunti dhe, kush e di? ndoshta në mirëbesim ose duke gënjyer vetveten, ashtu e djallëzuar siç është!

Imzot Bienvenyi, i përvuajtur, i varfër, i mënjanuar, nuk hynte në sërën e mitrave të mëdha. Kjo dukej sheshit edhe nga ajo që rreth tij nuk kishte fare priftërinj të rinj. E pamë se si në Paris atij "s'i kishte ecur". Asnjë e ardhme nuk dukej të shartohej mbi këtë plak të vetmuar. Asnjë ambicie nuk guxonte të bulonte në hijen e tij. Kryepriftërinjtë dhe vikarët e tij të mëdhenj ishin pleq babaxhanë, njerëz që mbanin erë popull si ai vetë, të muosur si ai vetë në këtë dioqezë, pa shpresë për të shkuar drejt kardinalisë, dhe që i përngjasin ipeshkvit të tyre, me këtë ndryshim se ata kishin mbaruar, kurse ai ishte përkryer, aq sheshit ndihej pamundësia për t'u ngjitur në ofiqe pranë imzot Bienvenyit, sa, me të dalë nga seminari, të rinjtë që ai i kishte nën urdhrat e tij, si merrnin rekomandime për kryepeshkopët e Eksit ose Oshit, largoheshin së andejmi me të katra. Sepse, fundi i fundit, njeriu do edhe një shtytje përpara.

Një shenjtor që jeton me një vetëmohim të tepruar, është një fqinjë i rrezikshëm; ai fare lehtë mund të të molepsë me një varfëri të pashërueshme, të të bëjë ulok nga këmbët e të mos shkosh dot përpara, të të ngjitë sëmundjen e vetëmohimit më tepër nga sa do ti. Prandaj ti i ikën dhe i largohesh këtij virtyti të zgjebosur. Për këtë shkak imzot Bienvenyi kishte mbetur i vetmuar. Ne jetojmë në një shoqëri të errët. T'ia arrish qëllimit, ja ky është mësimi, i cili bie pikë-pikë nga korrupsioni që na qëndron mbi kokë.

Le ta themi kalimthi se suksesi na qenkësh një gjë mjaft e fëlliqur. Përngjashmëria e tij e rreme me meritën i kobit njerëzit. Për turmën arritja e qëllimit ka gati po atë fytyrë që ka edhe epërsia. Suksesi, ky binjak i talentit, ka besimtarin e vet të verbër: historinë. Vetëm Juvenali dhe Taciti janë ata që e qortojnë nëpër dhembë. Në ditët tona, një filozofi pothuajse zyrtare ka hyrë si shërbyese në shërbim të suksesit, mban veshjet e tij plot stolira dhe i shërben në paradhomë. Ngadhënjëni: kjo është e gjitha. Lulëzimi don të thotë aftësi. Po fitove në llotari, të quajnë njeri të shkathët. Ai që triumfon, përnderohet. Po linde me këmishë, mbaroi puna. Po pate fat, të tjerat vijnë vetë; po që i lumtur, do të kujtojnë se je i madh. Përveç pesë a gjashtë përjashtimeve të mëdha që bëjnë shkëlqimin e një shekulli, admirimi i kohës sonë s'është gjë tjetër veçse dritëshkurtësi. Çdo gjë që ka ngjyrë ari, është ar. Po që se ke fituar në jetë, s'të pyesin se kush je, por të lëshojnë kreun e vendit. Njeriu i pagdhendur është një Narcis plak që adhuron vetveten dhe që duartroket të pagdhendurin. Zotësinë e pakufishme, me anën e së cilës njeriu mund të bëhet Moisi, Eski, Dante, Mikelanxhelo ose Napoleon, turma ia ngjit njëzëri dhe me brohori cilitdo që ia arrin qëllimit të vet në çdo gjë që të jetë. Sikur një noter të shpërfytyrohet në deputet, sikur një Kornej i rremë të bëjë *Tiridatin*,¹⁴ sikur një eunuk të arrijë të shtjerë në dorë një harem të tërë, sikur një Prydom¹⁵ ushtarak të fitojë gand betejën vendimtare të një epoke, sikur një farmacist të shpikë shuajt prej kartoni për armatën e Sambrë-e-Mezës dhe të sigurojë për vete, me këtë karton të shitur për shollë, katërqind mijë livra të ardhura në vit, sikur një tregtar

shëtitës të vërë kurorë me fajdenë dhe ta bëjë këtë të pjellë nja gjashtë a shtatë milionë, për të cilët ky është babai dhe ajo është nëna, sikur një predikues të bëhet ipeshkv duke folur nën hundë, sikur një intendent prej dere të mirë të jetë aq i pasur, kur të dalë nga shërbimi, sa ta bëjnë ministër të Financave, njerëzit këtë gjë e quajnë Gjenerali, ashtu siç quajnë Bukuri fytyrën e Musketonit dhe Madhëri dukjen e rreme të Klaudit. Ata ngatërrojnë me shenjizat e pafundësisë yjet që bëjnë këmbët e rosave në lymën e butë të pellgut.

XII

Cfarë mendonte

Një fjalë të fundit.

Meqenëse këto farë hollësish, veçanërisht për çastin ku jemi dhe, për të përdorur një shprehje që sot është e modës, mund t'i jepnin ipeshkvit të Dinjës njëfarë tipari "panteist" dhe t'i bënin njerëzit të besonin, qoftë për ta qortuar, qoftë për ta lavdëruar atë, se ai kishte një nga ato filozofitë vetjake, që i përkasin shekullit tonë e që disa herë hedhin rrënjë në shpirtitrat e vetmuar, e brumosen e rriten gjer në atë shkallë sa të zëvendësojnë fetë, ne ngulim këmbë mbi këtë, se asnjë nga ata që e kishte njohur imzot Bienvëny në nuk do ta kishte quajtur veten të autorizuar të mendonte një gjë të tillë. Ajo që e ndriçonte këtë njeri, ishte zemra e tij. Urtësia e tij ishte gatuar me dritën që buronte nga zemra.

Ai s'kishte asnjë sistem teorik, por kishte bërë shumë vepra. Spekulumet e errëta ta sjellin mendjen vërdallë; asgjë nuk dëshmon që ai e fuste kuturu shpirtin e tij nëpër apokalipset. Apostulli duhet të jetë i guximshëm, por ipeshkvi duhet të jetë i përmbajtur. Ai ndoshta u druajt që t'i gërmonte si tepër thellë disa probleme që u përkasin mendjeve të mëdha, të tmerrshme. Nën qemeret e enigmës ka një llahtarë të shenjtitë; këto zgavra të errëta qëndrojnë aty, përpara, të hapura si gojë;

por një diçka të thotë ty, kalimtarit të jetës, se këtu nuk hyhet. Mjerë ai që hyn brenda!

Të menduarit njerëzor s'ka asnjë kufi. Pa marrë parasysh as dëme, as rreziqe, mendimi analizon dhe rrëmon shkëlqimin e vet. Mund të themi gati-gati se, me anë të njëfarë kundërveprimi të shkëlqyer, ai lëbyr edhe natyrën; bota e mistershme që na rrethon, kthen prapë atë që merr, dhe ka të ngjarë që soditësit të jenë të soditur. Sidoqoftë, mbi tokë ka njerëz - a janë vallë njerëz? - të cilët dallojnë qartë në fund të horizonteve të ëndrrës lartësitë e absolutes. Imzot Bienvëny nuk ishte nga këta njerëz. Imzot Bienvëny nuk ishte gjenerali. Ai i pati drashtur këto maja të larta, prej nga disa njerëz, madje dhe shumë të mëdhenj, si Svedenborgu e Paskali,¹⁶⁾ ranë në çmenduri. Sigurisht, këto ëndërrime të fuqishme kanë dobinë e tyre morale, dhe përmes këtyre udhëve të vështira njeriu i afrohet përsosmërisë së kulluar. Ai merrte monopatin që shkurtonte udhë: ungjillin.

Ai nuk orvatej që zhguni i tij të bënte palat e mantosë së Eliut,* nuk hidhte asnjë rreze të ardhmeje mbi dallgëzimin e errët të ngjarjeve, nuk kërkonte që dritën e gjërave ta ngjishte e ta bënte flakë, s'kishte asgjë as nga profeti, as nga magjistari. Ky shpirt i përvuajtur donte dhe asgjë më tepër.

Ai përkulej mbi atë që lëngonte dhe mbi atë që hiqte shpirt. Gjithësia i dukej atij si një sëmundje pa anë e pa fund; ai ndiente gjithkund ethe, gjithkund dëgjonte vuajtje dhe, pa kërkuar që të zbulonte enigmën, ai përpiquej që të lidhte plagën. Pamja e frikshme e gjërave të krijuara zhvillonte tek ai shpirtbutësinë; ai nuk merrej me tjetër punë përveçse si të gjente për vete të vet dhe për të tjerët mënyrën më të mirë për t'u qarë hallin të tjerëve dhe për t'i lehtësuar ata. Ajo që ekziston, ishte për këtë prift të mirë dhe të rrallë një shkak i vazhdueshëm trishtimi, të cilin kërkonte ta ngushëllonte.

Ka njerëz që punojnë në gjirin e tokës për të nxjerrë arin; kurse ai punonte për të nxjerrë mëshirën. Miniera e tij ishte

¹⁶⁾ Profet çifut që pengoi për një farë kohe kultin e Baalit në popullin e Izraelit.

mjerimi i përbotshëm. Dhembja s'ishte veçse një rast për të bërë të mirën, gjithkund e gjithmonë: "Duajeni njëri-tjetrin:" ai e shpallte këtë si një gjë të plotë, nuk uronte asgjë më shumë, dhe kjo ishte e tërë doktrina e tij. Një ditë ai farë burri që e pandehte veten "filozof", ai senatori që kemi zënë ngoje përpara, i tha ipeshkvit: "Pa shikoni njëherë se ç'bëhet në botë: luftë e të gjithëve kundër të gjithëve; kush është më i fortë, është edhe më i mençur. Kjo fjala juaj: *duajeni njëri-tjetrin*, është një marrëzi."

-Eh, pra, - u përgjigj imzot Bienvényi, pa hyrë në zënka fjalësh, - në qoftë se është marrëzi, shpirti duhet të mbyllet në të, ashtu si mbyllet margaritari në guaskë. Ai mbyllej, pra, jetonte aty dhe kënaqej plotësisht, duke lënë mënjanë çështjet çudibërëse, që të joshin e të kallin frikën, perspektivat e pamatshme të abstraksionit, parimet e metafizikës, të gjitha ato thellësira që bashkojnë apostullin me Zotin, ateistin me hiçin: fatin, të mirën e të keqen, luftën e qenies kundër qenies, ndërgjegjen e njeriut, somnambulizmin mendues të kafshës, shndërrimin me anë të vdekjes, thelbin, lëndën, *Nilin* dhe *Ensin*,^{*)} shpirtin, natyrën, lirinë, nevojën; probleme të prera thikë, thellësi të kobshme, ku përkulen kryeengjëjt viganë të mendjes njerëzore; hone të pafundme, që Lukreci, Manui, Shën Pavli e Dantja i soditin me atë sy të zjarrtë, i cili, duke vështruar ngultas pafundësinë, duket sikur don që aty të bulojnë e të çelin yjet.

Imzot Bienvényi ishte thjesht një njeri që konstatonte së jashtmi çështjet e mistershme, pa i gërmuar me sy, pa i trazuar dhe pa e turbulluar me to mendjen e tij; ai kishte në shpirt një respekt të rëndë për errësirën.

^{*)} *Nili dhe Ensi (lat.)* – Hiçi dhe Qenia.

Libri i dytë

RËNIA

I

Mbrëmjen e një dite udhëtimi

Në ditët e para të tetorit të vitit 1815, nja një orë përpara perëndimit të diellit, një burrë, që ecte në këmbë, po hynte në qytetin e vogël të Dinjës. Ata banorë të rrallë, që gjendeshin në atë çast në dritaret ose në pragjet e shtëpive të tyre, e vështronin këtë udhëtar me njëfarë shqetësimi. Ishte vështirë të takoje një kalimtar me një pamje më të mjeruar se ai. Ishte një burrë me shtat mesatar, i ngjeshur e i shëndoshë, në lule të moshës. Mund të ishte nja dyzet e gjashtë a dyzet e tetë vjeç. Një kasketë me strehë lëkure, e rrasur gjer poshtë, ia fshihte pjesërisht fytyrën, që e kishte të djegur nga dielli e të rrahur nga era dhe qull në djersë. Këmisha prej pëlhure të trashë ngjyrë të verdhë, e mbërthyer te gryka me një kapëse prej argjendi, linte të dukej kraharorin e tij leshtor; kishte një kravatë të përdredhur si litar, një palë pantallona doku blu, të fërkuara e të arnuara, të bardha në njërin gju, të grisura në tjetrin, një bluzë të vjetër ngjyrë hiri zhele-zhele, të arnuar në njërin bërryl me një copë stof të gjelbër, qepur me spango, në shpinë një çantë ushtari të mbushur cit, të mbërthyer paq e fringo të re, në dorë një shkop të madh gjithë nyja, këmbët pa çorape, futur në një palë këpucë

me gozhdë, kokën të qethur dhe mjekrën të parruar.

Djersa, vapa, udhëtimi në këmbë dhe pluhuri i shtonin nuk di çfarë gjëje të llahtarshme këtij togu zhelesh.

Flokët, megjithëse të prerë rrafsh, i qëndronin përpjetë si gjemba, sepse kishin filluar t'i rriteshin pak, dhe dukeshin që nuk ishin qethur që prej disa kohësh.

Askush nuk e njihte. Dukej qartë që ai do të ishte ndonjë udhëtar që kalonte andej. Nga vinte ai? Nga Jugu. Mbase nga bregu i detit. Sepse ai hyri në Dinjë nga e njëjta rrugë ku shtatë muaj më parë pati kaluar Napoleoni, duke vajtur nga Kana në Paris. Ky burrë duhej të kishte ecur gjithë ditën e ditës. Dukej i lodhur e i këputur. Disa gra të lagjes së vjetër, që gjendet në këmbë të qytetit, e kishin parë tek ishte ndalur nën drurët e bulevardit "Gasenti" dhe tek kishte pirë te çezma që është në skajin tjetër të shëtitorës. Duhej ta kishte djegur etja, sepse disa fëmijë, që i ishin vënë prapa, e panë të ndalej edhe një herë e të pinte, dyqind hapa më tutje, te çezma e sheshit të tregut.

Si arriti te cepi i rrugës "Puashëver", bëri nga e majta dhe u drejtua për nga bashkia. Hyri brenda dhe doli së andejmi pas një çerek oreje. Një xhandar ishte ulur pranë derës mbi sofatin prej guri, ku gjeneral Druoti pati hipur më 4 mars për t'i lexuar turmës së trembur të banorëve të Dinjës shpalljen e gjirit të Zhyanit.¹⁷⁾ Burri hoqi kasketën dhe e përshëndeti përulësisht xhandarin.

Xhandari, pa ia kthyer përshëndetjen, e vështroi me vëmendje, e ndoqi një hop me sy, pastaj hyri në bashki. Kishte asokohe në Dinjë një bujtinë të bukur me një tabelë, ku shkruhej "Kryqi i Kolbasit". Kjo bujtinë kishte për zot një të quajtur Zhaken Labari, njeri i dëgjuar në qytet për shkak të farefisnisë së tij me një tjetër Labar, që mbante në Grënobël bujtinën e "Tre Delfinëve" dhe që kishte shërbyer në repartet e udhërrëfyesve. Kur zbarkoi perandori, shumë thashetheme patën marrë dhenë atyre anëve rreth bujtinës së "Tre Delfinëve". Tregonin se gjeneral Bertrandi, i veshur tebdil si karrocier, paskësh bërë aty udhëtime të shpeshta në janar dhe u paskësh ndarë kryqë nderi ushtarëve dhe grushte me napolona disa

borgjezëve. E vërteta është se, me të hyrë në Grënobël, perandori nuk paskësh pranuar të vendosej në ndërtesën e prefekturës; e paskësh falënderuar kryetarin e bashkisë duke i thënë: "Do të vete te një sokol burrë që e kam të njohur", dhe na paskësh vajtur në "Tre Delfinët". Kjo lavdi e Labarit të "Tre Delfinëve" pasqyrohej njëzet lega larg gjer te Labari i "Kryqit të Kolbasit". Bota flisnin për të në qytet: "Është kushëriri i atij të Grënoblit."

Njeriu u drejtua për nga kjo bujtinë, që ishte më e mira e vendit. Hyri në kuzhinë, e cila ishte rrafsh me rrugën. Të gjitha furrat ishin ndezur; një zjarr i madh digjej flakadan e plot gaz tek oxhakët. Bujtinari, që ishte njëkohësisht edhe kuzhinier, shkante e vinte nga vatra te tenxheret; ishte shumë i zënë me punë, se po kujdesej për një darkë të shkëlqyer, të porositur nga disa karrocierë, që dëgjoheshin tek qeshnin e flisnin me zhurmë të madhe në një sallë aty pranë. Cilido që ka udhëtuar, e di se askush nuk ha e pi më mirë se karrocierët. Një marmotë e majme, me ca thëllëza të bardha e gjela të egër anash, vërtitej shkuar në një hell të gjatë përpara zjarrit; mbi furrat po piqeshin dy krapa të mëdhenj nga të liqenit të Lozetit dhe një troftë e liqenit të Alozit.

Bujtinari, si dëgjoi portën që u hap dhe myshteriu e ri që hyri, tha pa i hequr sytë nga furrat:

-Ç'urdhëroni, zotëri?

-Për të ngrënë e për të fjetur, - tha burri.

-Kollaj fare, - vazhdoi bujtinari. Në këtë çast, ai ktheu kokën, e mati me sy fund e krye udhëtarin dhe shtoi:... - por duke paguar.

Njeriu nxori një qese të madhe lëkure nga xhepi i bluzës dhe u përgjigj:

-Parà, kam.

-Atëherë, mirë se erdhët, - tha i zoti i bujtinës.

Udhëtari e vuri përsëri qesen në xhep, e hoqi çantën, e vendosi përdhé afër portës, shkopin e mbajti në dorë dhe vajti e ndenji mbi një stol të ulët afër zjarrit. Dinja është qytet malor. Mbrëmjet e tetorit atje janë të ftohta.

Ndërkohë, gjithë duke vajtur e ardhur, bujtinari vërente udhëtarin.

-Do të hamë shpejt? - tha burri.

-Në çast, - tha i zoti i bujtinës.

Ndërsa i porsaardhuri me shpinë të kthyer po ngrohej, bujtinari i nderuar Zhaken Labari nxori një laps nga xhepi, pastaj grisi cepin e një gazete të vjetër që ndodhej mbi një tryezë të vogël pranë dritares. Në anën e bardhë shkroi nja dy rreshta, e palosi pa e mbyllur dhe ia dha në dorë këtë copëz letër një djali, i cili dukej se i shërbente njëkohësisht edhe si ndihmës në kuzhinë, edhe si shërbëtor. Bujtinari i tha një fjalë në vesh çunakut, dhe fëmija iku me vrap në drejtim të bashkisë.

Udhëtari s'vuri re asgjë nga këto punë.

Ai pyeti edhe një herë tjetër:

-Do të hamë shpejt?

-Në çast, - tha bujtinari.

Djali u kthye. Solli përsëri letrën. Bujtinari e shpalosi me ngut, si një që pret përgjigje. U duk që po lexonte me vëmendje, pastaj tundi kokën dhe ndenji një copë herë i menduar. Më në fund, bëri një hap drejt udhëtarit, i cili dukej se ishte zhytur në mendime të turbullta.

-Zotëri, - tha ai, - s'mundem t'ju pranoj.

Ai u ngrit përgjysmë nga stoli.

-Si! Mos vallë keni frikë se nuk paguaj? Doni të parapaguaj? Parà kam, ju them.

-Nuk është puna aty.

-Po çfarë, pra?

-Keni parà...

-Po, - tha ai.

-Por unë, - tha hanxhiu, - s'kam dhomë.

Udhëtari vazhdoi me të qetë:

-Bëmëni vend në haur të kuajve.

-S'mundem.

-Pse?

-Kuajt e kanë zënë të tërë vendin.

-Po mirë, - tha ai, - ndonjë skutë në papafingo. Një krah kashtë. E shohim këtë punë pasdarke.

-As darkë s'mund t'ju jap.

Kjo deklaratë, e bërë me një zë të matur, por të vendosur, iu duk e rëndë të huajit. Ai u ngrit në këmbë.

-As, kështu! Por unë po vdes urie. Kam ecur që më të dalë të diellit. Kam bërë dymbëdhjetë lega. Unë paguaj. Dua të ha.

-S'kam asgjë, - tha bujtinari.

Burri ia plasi të qeshurit dhe u kthye nga oxhaku dhe furrat.

-Asgjë! Po këto ç'janë, këto!

-Këto i kam të porositura.

-Nga kush?

-Nga këta, zotërinjtë karrocierë.

-Sa janë?

-Dymbëdhjetë.

-Por aty ka sa të hanë njëzet gojë.

-M'i kanë porositur dhe paguar të gjitha që përpara.

Burri u ul përsëri dhe tha pa e ngritur zërin:

-Këtu unë jam në bujtinë, më hahet bukë, ndaj s'po luaj vendit.

Bujtinari atëherë iu përkul te veshi dhe i tha me një theks që e bëri të dridhej:

-Hiquni së këtejmi.

Udhëtari, që ishte kërrusur në këtë çast dhe po shtynte disa thëngjij në zjarr me majën e hekurt të shkopit të vet, u kthye vrik, dhe, tek po hapte gojën për të kthyer përgjigje, bujtinari ia nguli sytë dhe shtoi po me zë të ulët:

-Na, mjaft, lërinia ato fjalë. Doni t'ju them edhe emrin? Ju ju quajnë Zhan Valzhan. Tani, doni t'ju them edhe se kush jeni? Kur ju pashë që hytë, dyshova për diçka, dërgova në bashki dhe ja se çfarë m'u përgjigjën. Dini të lexoni, apo jo?

Dhe, duke folur kështu, ia zgjaste krejt të shpalosur atë copën e letrës që sapo kishte bërë udhën nga bujtina në bashki dhe nga bashkia në bujtinë. Njeriu i hodhi një sy letrës. Bujtinari vazhdoi pas një heshtjeje:

-E kam zakon të jem i sjellshëm me gjithë botën. Hiquni së këtejmi.

Burri uli kryet, mori çantën që kishte lënë përdhe e u largua.

Mori rrugën e madhe. Ecte përpara në tym, rrëshqitazi mureve të shtëpive, si njeri i përunjur dhe i trishtuar. Asnjëherë nuk e ktheu kokën prapa. Po të qe kthyer, do ta kishte parë bujtinarin e "*Kryqit të Kolbasit*" te pragu i portës, të rrethuar nga të gjithë udhëtarët që ndodheshin në bujtinë dhe nga të gjithë ata që kalonin rrugës, duke folur me gjallëri dhe duke e treguar me gisht, dhe, prej vështrimeve plot mosbesim e llahtarë të grumbullit, do të kishte pikasur se pas pak ardhja e tij do të merrte dhenë e do ta mbante në gojë tërë qyteti.

Ai s'pa asgjë nga këto. Njerëzit që i kanë pllakosur hallet, nuk vështrojnë prapa tyre. Ata e dinë fort mirë se fati i keq i ndjek pas.

Bariti kështu për njëfarë kohe, duke ecur pa pushim, duke shkuar kuturu nëpër rrugë që s'i njihte, duke harruar lodhjen, ashtu siç ngjet kur të pllakos trishtimi. Papritmas ndjeu se po e gërryente uria. Nata po afrohej. Vështroi rreth e rrotull për të parë se mos gjente ndonjë strehë sa për të futur kokën.

Bujtina e bukur ishte mbyllur për të; po kërkonte ndonjë kabare shumë të përvuajtur, ndonjë birucë shumë të varfër.

Pikërisht në fund të rrugës po digjej një dritë; një degë pishe, e varur mbi një direk hekuri, po ravizohej mbi qiellin e bardhë të muzgut. Ia mbajti për atje.

Ajo ishte me të vërtetë një kabare. Kabareja që ndodhet në rrugën "Shafò".

Udhëtari u ndal për një çast dhe vështroi përmes xhamit brenda sallës së ulët të kabaresë, të ndriçuar nga një llambë e vogël mbi një tryezë dhe nga një zjarr i madh në oxhak. Aty brenda ishin disa burra që po pinin. I zoti i kabaresë po ngrohej pranë zjarrit. Flaka po bënte të gurgullonte një kusi hekuri, e varur te çengeli i vatrës.

Në këtë kabare, e cila është gjithashtu njëfarë bujtine, mund të hysh me anë të dy portave. Njëra sheh në rrugë, tjetra hapet para një oborri të vogël, të mbushur me pleh. Udhëtari nuk guxoi të hynte nga porta e rrugës. U fut në oborr, u ndal përsëri, pastaj ngriti me druajtje mandallën dhe shtyu portën.

-Kush është aty? - tha pronari.

-Një që dëshiron të hajë e të flejë.

-Mirë se të vini! Këtu për të ngrënë e për të fjetur kemi sa të doni.

Hyri brenda. Të gjithë ata që po pinin, kthyen kokën. Llamba e ndriçonte nga njëra anë dhe zjarri nga ana tjetër. E vërejtën një copë herë në kohën kur ai po zgjidhte çantën.

Pronari i tha:

-Ja ku e keni zjarrin. Darka po zien në kusi. Ejani të merrni një të ngrohur, shok.

Ai vajti dhe u ul afër vatrës. Zgjati nga zjarri këmbët, që i ishin bërë pleh nga lodhja; një erë e mirë po dilte nga kusia. Gjithë ajo pjesë që mund të dalloje nga fytyra e tij nën kasketën e rrasur, mori një pamje të vagët mirëqenieje, të përzier me atë pamjen tjetër aq prekëse të njeriut që i është bërë zakon vuajtja.

Veç kësaj, ai kishte një profil të prerë, energjik dhe të trishtuar. Kjo fizionomi ishte ngjizur në mënyrë të çuditshme; në fillim dukej si e përvuajtur, po pastaj dukej e ashpër. Syri xixëllonte nën vetullat, si ndonjë prush nën drizë.

Mirëpo, njëri nga burrat e ulur në tryezë, një peshkshites, përpara se të hynte në kabarenë e rrugës "Shafò", kishte vajtur për të vendosur kalin e vet në haurin e Labarit. Fati kishte dashur që atë mëngjes ai ta kishte hasur këtë të huaj me pamje të dyshimtë duke udhëtuar midis Bara d'Asit dhe... (e kam harruar emrin. Më duket se është Eskublioni). Kështu, kur e kishte hasur, njeriu, i cili dukej shumë i lodhur, i paskësh kërkuar që ta merrte në vithe të kalit; kësaj kërkese peshkshitesi i qenkësh përgjigjur duke ngarë akoma më shpejt. Ky peshkshites bënte pjesë gjysmë ore përpara në grupin që ishte mbledhur rreth Zhaken Labarit dhe ai vetë ua kishte rrëfyer takimin e tij të pakëndshëm të mëngjesit njerëzve të "*Kryqit të Kolbasit*". Nga vendi ku ndodhej, i bëri pronarit të kabaresë një shenjë që s'e pikasi njeri. Kabaretieri iu afrua. Ata këmbyen disa fjalë me zë të ulët. Udhëtari ishte zhytur përsëri në mendime.

Kabaretieri u kthye përsëri tek oxhaku, vuri vrik dorën mbi supin e burrit dhe i tha:

-Duhet të hiqesh së këtejmi.

I huaji u kthye dhe u përgjigj me të butë:

-Ah! E ditkeni, hë?...

-Po.

-Edhe nga bujtina tjetër më përzunë.

-Dhe tani po të ndjekin edhe nga kjo këtu.

-Por, ku thoni ju të vete?

-Gjetkë.

Burri mori shkopin dhe çantën dhe u largua.

Tek po dilte, disa fëmijë, të cilët i ishin ngjitur pas që nga "Kryqi i Kolbasit" dhe dukej se po e prisnin, i shtinë me gurë. U kthye prapa plot inat dhe i kërcënoi me shkop; fëmijët u shpërndanë si ndonjë trumbë zogjsh.

Kaloi përpara burgut. Te porta varej një zinxhir hekuri, kapur te një zile. I ra ziles.

U hap një sportel.

-Zoti rojtar, - tha ai duke hequr kasketën plot respekt, - do të kishin vallë mirësinë të më hapnit portën dhe të më strehoni për një natë?

Një zë u përgjigj:

-Ky është burg dhe jo bujtinë. Bëni diçka që t'ju arrestojnë. Atëherë, do t'ju hapet dera.

Sporteli u mbyll përsëri.

Ai hyri në një rrugë të vogël, ku kishte shumë kopshte. Disa syresh ishin të rrethuara vetëm me gjerde, gjë që ta gëzonte syrin. Midis këtyre kopshteve dhe gjerdeve ai pa një banesë të vogël njëkatëshe, dritarja e së cilës kishte dritë. Vështroi përmes këtij xhami, ashtu siç kishte bërë te kabareja. Ishte një dhomë e madhe, e lyer me gëlqere, kishte një shtrat të mbuluar me beze të stampuar dhe një djep në një qoshe, disa karrige druri dhe një çifte të varur në mur. Në mes të dhomës ishte shtruar tryeza. Një llambë bakri ndriçonte napën prej pëlhure të trashë e të bardhë, kanën prej kallaji, që shndriste si argjend e që ishte plot me verë, dhe supierën e murrme, që po avullonte. Te kjo tryezë ishte ulur një burrë nja dyzet vjeç, me një fytyrë të gëzuar dhe të çelur, i cili po e kërcente hopthi mbi gjunjë një fëmijë. Pranë tij, një grua fare e

ré po i jepte gjë një fëmijë tjetër. Babai qeshte, fëmija qeshte, nëna buzëqeshte.

I huaji ndenji për një çast si i menduar përpara kësaj pamjeje të ëmbël e qetësuese. Çfarë po ngjiste në shpirtin e tij? Vetëm ai mund ta dinte. Mund të ketë menduar se kjo shtëpi e gëzuar do të ishte mikpritëse dhe se atje ku shikonte aq lumturi, do të gjente ndoshta pak mëshirë.

Dhe trokiti fare lehtë te xhami.

Nuk e dëgjoji njeri.

Trokiti për së dyti.

Dëgjoji gruan që po thoshte:

-Burrë, më duket se dikush po troket.

-Jo, - u përgjigj i shoqi.

Trokiti për së treti.

Burri u ngrit, mori llambën dhe vajti e hapi portën.

Ishte një burrë shtatgjatë, gjysmëfshatar dhe gjysmëartizan. Mbante një përparëse të madhe lëkure, që i ngjitej gjer te supi i majtë. Në këtë përparëse bënin bark një çekiç, një shami e kuqe, një qeskë baruti, gjithfarë sendesh, të cilat i mbante rripi, sikur të ishte ndonjë xhep. Ai e shtynte kokën prapa; këmisha e hapur ia zbulonte qafën si të demit, të bardhë e të zhveshur. Kishte vetulla të trasha, favorite të mëdha e të zeza, sy të kërcyer, pjesën e poshtme të fytyrës si turi kafshe dhe, mbi të gjitha këto, atë shprehjen që tregonte se ishte zot shtëpie e që është e pamundur të përshkruhet.

-Zotëri, - tha udhëtari, - më falni. Me të paguar, a do të mundeni të më jepni një pjatë supë dhe një skutë për të fjetur në atë strehën që është atje në kopsht? Më thoni, a do të mundeni? Me të paguar.

-Kush jeni ju? - pyeti i zoti i shtëpisë.

Ai u përgjigj:

-Vij nga Pyi-Muasoni. Kam ecur gjithë ditën e ditës. Kam bërë dymbëdhjetë lega udhë. A do të mundeni? Me të paguar?

-Nuk do të kursehesha, - tha fshatari, - të strehoja njerëz të mirë që paguajnë. Por pse nuk shkoni në bujtinë?

-S'ka vend.

-Bah! S'është e mundur. Sot s'është as ditë panairi, as ditë pazari. A vajtët te Labari?

-Po.

-E ç'ju tha?

Udhëtari u përgjigj si i zënë ngushtë:

-Nuk e di, nuk më qasi.

-A vajtët tek ai i rrugës "Shafò"?

I huaji po zihej gjithnjë e më ngushtë. Belbëzoi:

-As ai s'më qasi.

Fytyra e fshatarit mori një shprehje dyshimi, vështroi të porsaardhurin nga koka gjer te këmbët dhe menjëherë bërtiti me njëfarë dridhme:

-Mos jeni ai njeriu që?...

I hodhi të huajit edhe një vështrim tjetër, bëri tre hapa prapa, vendosi llambën mbi tryezë dhe rrëmbeu çiften nga muri.

Ndërkohë, me fjalët e fshatarit: "Mos jeni ai njeriu që?...", gruaja kishte brofur në këmbë, kishte marrë të dy fëmijët në krahë dhe ishte strukur vetëtimthi prapa të shoqit, duke vështruar të huajin me frikë të madhe, ashtu gushëzbuluar e syçakërritur, dhe duke murmuritur me zë të ulët: *Tso-marode*^{*)}.

E gjithë kjo punë ngjau në më pak kohë nga ç'mund ta marrësh me mend. Si këqyri një hop *njeriun*, ashtu siç këqyrin ndonjë nepërkë, i zoti i shtëpisë erdhi te porta dhe tha:

-Qërohu!

-Kini mëshirë, - vijoi njeriu, - një gotë ujë.

-Një plumb ballit! - tha fshatari.

Pastaj e mbylli portën me turr, dhe njeriu e dëgjoi tek po shtynte dy lloze të mëdha. Pas një hopi, edhe kapakët e dritares u mbyllën, dhe zhurma e një shufre hekuri që ngulej arriti gjer jashtë.

Nata vazhdonte të binte. Era e ftohtë e Alpeve po frynte. Në muzgun e ditës që po hiqte shpirt, të huajit i zuri syri në njërin nga kopshtet buzë rrugës një si kasolle, e cila iu duk sikur ishte ndërtuar me plisa. Kapërceu me vendosmëri një parmak

^{*)} Dac kobash – tip hajduti. – Dialekt i Alpeve të Francës.

druri dhe u gjend brenda në kopsht. Iu afrua kolibes; ajo kishte si derë një vrimë të ngushtë shumë të ulët dhe u përngjiste atyre strofkave që punëtorët e rrugës ndërtojnë buzë udhëve. Dhe pa dyshim ai mendoi se kjo do të ishte me gjithë mend banesa e ndonjë prej tyre; po vuante nga të ftohtët dhe nga uria; me urinë ishte pajtuar, por të paktën ajo kolibe ishte një strehë kundër të ftohtit. Këto lloj banesash, zakonisht, nuk janë të zëna natën. U shtri barkazi dhe u hoq rrëshqanthi në kasolle. Aty brenda bënte ngrohtë dhe gjeti edhe një shtrat kashte mjaft të mirë. Qëndroi për një çast i shtrirë mbi këtë shtrat, pa mundur të bënte asnjë lëvizje, aq fort ishte lodhur. Pastaj, meqenëse çanta në shpinë e pengonte dhe, veç asaj, ajo ishte një jastëk krejt i gatshëm, filloi të zgjidhte njërin nga rripat. Në këtë çast, u dëgjua një hungërimë e frikshme. Ai ngriti sytë. Koka e një qeni shumë të madh vizatohej në errësirë te hyrja e kasolles.

Ajo kasolle na qenkësh një stelë qeni.

Edhe ai vetë ishte i fortë si ka e i frikshëm; kapi shkopin, e mbajti çantën si mburojë dhe doli nga kasollja ashtu si mundi, jo pa i zgjeruar të grisurat e zheleve të tij.

Doli gjithashtu edhe nga kopshti, por praptazi, sepse ishte i detyruar, për të mbajtur qenin zap, të përdorte këtë manovër të shkopit, të cilën mjeshtërit e skermës me shkop e quajnë "*trëndafili i mbuluar*".

Si e kaloi, jo pa mundime, parmakun dhe si u gjet përsëri në rrugë, vetëm, pa banesë, pa strehë, pa strofkë, i përzënë, madje, edhe nga ai shtrat me kashtë dhe nga ajo stelë e mjerë, ai u plas si thes, se s'mund të thuash që u ul, mbi një gur. Duket se një kalimtar që po kalonte asaj ane e dëgjoi tek bërtiste: "S'vlekam as sa një qen, s'vlekam!"

Pas një hopi, u çua përsëri dhe përsëri filloi të ecte. Doli nga qyteti, me shpresë që të gjente arave ndonjë pemë a ndonjë mullar ku të fuste kokën.

Bëri kështu një copë udhë, gjithmonë kokëposhtë. Kur e pa veten larg çdo banese njerëzore, ngriti sytë dhe kërkoi rreth e rrotull. Ishte në një arë, para tij shtrihej një nga ato kodërzat

e ulëta të mbuluara e grunjëra të prera rrafsh, të cilat pas të korrurave duken si kokë të qethura.

Horizonti ishte i zi sterrë, jo vetëm nga errësira e natës, por edhe nga rétë e ulëta, që dukeshin sikur mbështeteshin mbi vetë kodrinën dhe ngjiteshin lart duke mbushur gjithë qiellin. Por meqenëse hëna nuk do të mënonte të dilte dhe në zenit përpëlitej akoma një dritëz mugëtire, këto ré formonin në lartësinë e qiellit njëfarë kubeje të zbardhëllyer, nga lëshohej mbi tokë një dritë e vagëlluar.

Toka, pra, ishte më e ndriçuar nga qielli, gjë që krijon një efekt veçanërisht të kobshëm, dhe kodërza, me një përvijim të varfër e të dobët, vizatohej vagët dhe zbehtë mbi horizontin e sterrosur. E gjithë kjo pamje ishte e neveritshme, e vockël, e përzishme dhe e mbyllur. Në arë s'kishte asgjë, kurse mbi kodër vetëm një pemë shtrembaluqe që përdridhej duke fërgëlluar disa hapa larg udhëtarit.

Siç shihet, ky njeri ishte shumë larg mendjemprehtësisë dhe ndjenjave të holla të shpirtit, që e bëjnë njeriun të jetë i ndjeshëm përpara pamjeve misterioze të gjërave; por në atë qiell, në atë kodërz, në atë fushë dhe në atë pemë kishte diçka aq të vrerosur, sa, si ndenji një hop i shtangur dhe i zhytur në ëndërrime, ktheu papritmas udhë. Ka çaste kur edhe vetë natyra duket armiqësore.

U kthye andej nga kishte ardhur. Portat e Dinjës ishin mbyllur. Dinja, e cila ka përballuar sa e sa rrethime gjatë luftërave fetare, gjer më 1815, ishte akoma e rrethuar me mure të vjetra, me kulla katrore, që i kanë rrënuar me kohë. Kaloi nëpër një të çarë dhe hyri në qytet.

Mund të ishte ora tetë e mbrëmjes. Ngaqë nuk i njihte rrugët, e filloi shëtitjen e tij përsëri më tym.

Arriti kështu gjer te prefektura, pastaj te seminari. Duke kaluar përmes sheshit të katedrales, ai i tregoi grushtin kishës.

Në skaj të këtij sheshi ka një shtypshkronjë. Aty qenë shtypur për herë të parë shpalljet e perandorit dhe të Gardës Perandorake drejtuar ushtrisë, shpallje që u prunë nga ishulli i Elbës dhe u diktuan nga vetë Napoleoni.

I rraskapitur nga lodhja dhe pa asnjëfarë shprese, ai u shtri

mbi sofatin prej guri që ndodhet te porta e kësaj shtypshkronje.

Në këtë çast një grua plakë po dilte nga kisha. Ajo e pa këtë njeri të shtrirë në errësirë.

-Ç'po bëni aty, miku im? - tha ajo.

Ai u përgjigj ashpër dhe me inat:

-Siç po e shihni edhe vetë, o grua e mirë, jam shtrirë.

Gruaja e mirë, me të vërtetë e denjë për këtë emër, na ishte zonja markezë Dë R.

-Por mbi këtë sofat, kështu? - vazhdoi ajo.

-Për nëntëmbëdhjetë vjet rresht kam pasur një shtrojë druri, - tha burri, - sot kam një shtrojë guri.

-Mos keni qenë ushtar?

-Po, o grua e mirë. Ushtar.

-Pse nuk shkoni në bujtinë?

-Se s'kam të holla.

-Për fat të keq! - tha zonja Dë R., - edhe mua vetëm katër su më ndodhen në çantë.

-M'i jepni, sa të jenë.

Ai i mori të katër *sutë*. Zonja Dë R. vijoi:

-Këto të holla s'ju dalin për të fjetur në bujtinë. Por, të paktën, a jeni përpjekur diku mos gjenit për të fjetur. Është e pamundur ta kaloni natën kësisoj. Pa dyshim, keni ftohtë dhe uri. Dikush do t'ju kishte strehuar për mëshirë.

-Trokita në të gjitha portat.

-Edhe?

-Kudo më përzunë.

Gruaja i preku krahun të panjohurit dhe i tregoi, në anën tjetër të sheshit, një shtëpi të vogël e të ulët, bri pallatit ipeshkvor.

-Keni trokitur, - vazhdoi ajo, - në të gjitha portat?

-Po.

-Keni trokitur tek ajo atje?

-Jo.

-Epo, trokitni.

Urtësisë i këshillohet maturi

Atë mbrëmje, pas shëtitjes që kishte bërë nëpër qytet, zoti ipeshkv i Dinjës kishte qëndruar deri vonë i mbyllur në dhomën e vet.

Po punonte akoma gjer në orën tetë, duke shkruar pa kurrfarë komoditeti mbi ca kartonë të vegjël katrorë, me një libër të trashë të hapur mbi gjunjë, kur zonja Magluarë hyri, sipas zakonit të vet, për të marrë takëmet e argjendta në dollapin pranë shtratit. Pas një hopi, duke ndier që tryeza e bukës ishte shtruar dhe që e motra ndoshta edhe po e priste, ipeshkvi e mbylli librin, u ngrit nga tryeza e punës dhe hyri në dhomën e bukës.

Dhoma e bukës ishte një kthinë gjatore me oxhak, me derë që hapej drejt e në rrugë dhe me dritare që shikonte nga kopshti.

Me të vërtetë, zonja Magluarë po mbaronte së shtruari tryezën.

Ajo, nga një anë, punonte, nga tjetra, bisedonte me zonjushën Baptistinë.

Mbi tryezë kishte një llambë; tryeza ishte pranë oxhakut. Aty ishte ndezur edhe një zjarr bubulak.

Njeriu nuk e ka edhe fort të lehtë t'i përfytyrojë këto dy gra, që i kishin kaluar, që të dyja, të gjashtëdhjetat: zonja Magluarë, e vogël, topolake, e gjallë, zonjusha Baptistinë, e butë, e hollë, delikate, pakëz më e madhe se i vëllai, e veshur me një fustan mëndafshi ngjyrë kafeje të errët, ngjyrë që ishte e modës më 1806. Atë fustan ajo e kishte blerë asokohe në Paris dhe i qëndronte akoma. Për të përdorur ca shprehje vulgare, që kanë vetinë të shprehin me një fjalë të vetme një idé të cilën edhe një faqe e tërë mezi do ta shprehte, zonja Magluarë kishte pamjen e një *fshatareje* dhe zonjusha Baptistinë pamjen e një *zonje*. Zonja Magluarë kishte një si skufje të bardhë me ca palëza, në qafë varur një kryqth floriri, e vetmja stoli gruaje që ndodhej në shtëpi, një rubë të bardhë dëborë, që i dilte nga

fustani i zi prej leshi, me mëngë të gjera e të shkurtra, një përparëse pëlhere pambuku me katrore të kuqe e të gjelbra, të lidhur në mes me një brez të gjelbër, me gjoksore të së njëjtës plaçkë, të mbërthyer me dy karfica të cepat e sipërm, mbathte një palë këpucë të mëdha dhe çorape të verdha si gratë e Marsejës. Fustani i zonjushës Baptistinë ishte prerë sipas modeleve të vitit 1806, me belin të ngushtë, mëngë me supëza, me pafta e kopsa. Ajo i mbulonte flokët e vet të thinjur me një parukë me kaçurrela që quhej *ala bebé*: Zonja Magluarë dukej e zgjuar, e gjallë, e mirë; ata dy cepat e gojës, të ngritur njëri më shumë se tjetri, dhe ajo buza e sipërme më e trashë se e poshtnja i jepnin asaj një tipar si zemërak e të rrëmbyer. Sa kohë që imzoti heshtte, ajo fliste pa teklif, me respekt dhe liri bashkë; por, sa hapte gojën imzoti, ajo bindej pa gjysmë fjale, ashtu si zonjusha. Zonjusha Baptistinë as fliste fare. Ajo dinte vetëm të bindej e të mos prishte qejf. Edhe kur kishte qenë e ré, ajo s'kishte qenë e bukur; kishte një palë sy të mëdhenj, të kaltër e të kërcyer, dhe një hundë të gjatë e me samar; por tërë fytyra e saj, krejt qenia e saj dihatnin një mirësi të parrëfyer. Ajo kishte qenë gjithmonë shpirtmirë, por besimi, mëshira, shpresa, këto tri virtyte që ngrohën shpirtin, e kishin ngritur këtë shpirtmirësi deri në shenjtëri. Natyra e kishte bërë dele të butë. E shkreta vajzë e shenjtë. Kujtim i ëmbël që ishte zhdukur!

Zonjusha Baptistinë, qysh nga ajo kohë, e ka rrëfyer kaq e kaq herë se çfarë pati ndodhur në shtëpi të ipeshkvit atë mbrëmje, aq sa edhe sot e kësaj dite shumë veta, që jetojnë akoma, i kujtojnë edhe hollësitë më të imëta.

Në çastin kur zoti ipeshkv hyri brenda, zonja Magluarë po fliste me njëfarë gjallërie. Ajo po fliste me *zonjushën* për diçka që e kishte në majë të gjuhës dhe me të cilën ipeshkvi ishte mësuar. Ishte puna e llozit të portës së hyrjes.

Duket se, kur kishte shkuar të blinte diçka për darkë, zonja Magluarë kishte dëgjuar disa gjëra që fliteshin poshtë e lart. Flisnin për një endacak me një fytyrë fort të keqe; thuhej se një vagabond i dyshimtë paskësh ardhur, se ndodhej diku në qytet dhe se mjerë ai që do ta takonte në udhë duke u kthyer natën vonë në shtëpi. Sepse edhe policia vetë s'paskësh qenë në terezi,

për arsye se zoti prefekt dhe zoti kryetar i bashkisë s'para shkonin me njëri-tjetrin dhe përpiqeshin që t'ia hanin kokën shoku-shokut, duke krijuar punë të paqena, se njerëzit me mend në kokë duhej të bëheshin vetë policë e t'i bënin vetë hall kokës së tyre, se duhej të kishin kujdes që t'i mbyllnin, t'i kllaposnin e t'i barrikadonin shtëpitë dhe t'i mbyllnin mirë portat e tyre.

Zonja Magluarë u mëshoi më shumë këtyre fjalëve të fundit por ipeshkvi, që po kthehej nga dhoma e vet, ku ishte tharë së ftohti, ishte ulur përpara oxhakut dhe po ngrohej me mendjen gjetiu. Nuk i kapi dot fjalët që theksoi zonja Magluarë. Ajo i përsëriti edhe një herë. Atëherë, zonjusha Baptistinë duke dashur t'ia plotësonte dëshirën zonjës Magluarë, pa ia prishur qejfin të vëllait, guxoi e tha si me të druajtur:

-O vëlla, a e dëgjoni se ç'po thotë zonja Magluarë?

-Dëgjova diçka si nëpër tym, - u përgjigj ipeshkvi.

Pastaj, duke e kthyer përgjysmë karrigen e vet, duke vënë të dyja duart mbi gjunjë dhe duke ngritur drejt shërbëtores fytyrën e tij të përzemërt dhe buzagaze, të cilën zjarri ia shndriste së poshtmi, tha:

-Pa dale të shohim, Ç'është? Ç'ka ngjarë? Mos na kërcënon ndonjë rrezik i madh?

Atëherë zonja Magluarë ia nisi edhe një herë historisë, duke e zmadhuar nga ca, pa e pikasur as ajo vetë. Me gjasë, një endacak, një zbatharak, njëfarë lypsari i rrezikshëm, na paskësh ardhur asaj dite në qytet. Paskësh vajtur për të fjetur te Zhaken Labari, por ky s'na e paskësh qasur. E paskëshin parë të arrinte nga bulevardi "Gasendi" dhe të sillej rrugëve më të thyer të ditës. Një njeri i hurit e i litarit me një fytyrë të tmerrshme.

-Vërtet? - tha ipeshkvi.

Kjo pyetje i dha zemër zonjës Magluarë, së cilës iu duk se me këtë ipeshkvin do ta pushtonte frika e do të shqetësohej; ajo vazhdoi triumfuese:

-Po, imzot. Ashtu është. Do të na ngjasë ndonjë e pabërë sonte në qytet. Gjithë bota kështu thonë. S'mjafton kjo, por kemi edhe policinë për faqe të zezë. (Përsëritje e dobishme.) Të jetosh në një vend malor, dhe të mos kesh as fenerë, natën

rrugëve! Del njeriu, por, të t'i shtjerë tjetri gishtat në sy, nuk e sheh fare! Dhe ja ku po ju them, imzot, dhe zonjusha këtu është si unë thotë, se...

-Unë, - e ndërpreu motra, - s'po them asgjë. Ç'do gjë që të bëjë im vëlla, për mua e bërë qoftë.

Zonja Magluarë vazhdoi sikur të mos e kishte kundërshtuar njeri fare.

-Ne themi se kjo shtëpi këtu s'është hiç e siguruar; po të më japë leje imzot, unë vete sakaq e i them Paulin Myzëbuasë, çelësabërësit, të vijë e t'i vërë bravat e vjetra, imzot qoftë edhe vetëm sa për sonte; sepse, ja ku po jua them, s'ka gjë më të tmerrshme sesa një portë që hapet nga jashtë me një mandallë, nga i pari udhëtar që vjen; le pastaj, por imzoti ka edhe zakonin të thotë gjithmonë bujrum dhe, veç kësaj, edhe në mes të natës, o Zot o perëndi! Këtu njerëzit s'kanë nevojë as të kërkojnë leje...

Në këtë çast, dikush trokiti në portë me një të goditur mjaft të furishme.

-Hyni, - tha ipeshkvi.

III

Heroizmi i bindjes pasive

Porta u çel.

U çel vrik, kat e kat, sikur dikush ta shtynte me vërtik dhe vendosmëri.

Hyri brenda një burrë.

Këtë burrë e njohim që më parë. Është udhëtar i që sapo e pamë të endej poshtë e lart, duke kërkuar ku të fuste kokën.

Hyri brenda, bëri një hap dhe u ndal, duke lënë portën të hapur prapa tij. Çantën mbi sup, shkopin në dorë, ai kishte në sy një shprehje të ashpër dhe guximtare, të lodhur dhe të dhunshme. Zjarri i vatrës hidhte dritë mbi të. Ai ishte i llahtarshëm. Ishte një fanitje ogurzezë.

Zonja Magluarë nuk pati as fuqi të lëshonte ndonjë britmë. Ajo u drodh e tëra dhe mbeti gojëhapur.

Zonjusha Baptistinë u kthye, e pa burrin që po hynte dhe u çua përgjysmë nga frika, pastaj, duke e sjellë pak nga pak kryet nga oxhaku, filloi të vështronte të vëllanë dhe fytyra e saj u bë thellësisht e qetë dhe e kthjellët.

Ipeshkvi i kishte ngulur burrit një vështrim të qetë.

Tek po hapte gojën, pa dyshim për ta pyetur mysafirin e posaardhur se çfarë dëshironte, burri mbështeti të dyja duart mbi shkopin e vet, i endi sytë me radhë mbi plakun dhe gratë dhe, pa pritur që të fliste ipeshkvi, ai tha me zë të lartë:

-Ja si është puna. Unë quhem Zhan Valzhan. Jam njeri i dënuar me punë të rënda. Kam bërë nëntëmbëdhjetë vjet burg. Ka katër ditë që jam liruar dhe po udhëtoj për në Pontarlier, që është vendqëndrimi im. U bënë katër ditë që po udhëtoj që nga Tuloni. Sot kam bërë dymbëdhjetë lega në këmbë. Sonte, me të ardhur në këtë vend, vajta në një bujtinë, por më përzunë për shkak të pasaportës sime të verdhë që paraqita në bashki. Ashtu duhej. Vajta në një bujtinë tjetër dhe aty më thanë: "Hiq s'këtëjmi!" Vajta te njëri, vajta te tjetri, por asnjeri s'deshi të dinte për mua. Vajta edhe në burg, por portieri s'ma hapi portën. Isha edhe në stelën e një qeni. Edhe qeni më kafshoi e më përzuri, sikur të ishte njeri. A thua se edhe ai e dinte se kush isha unë. Mora e shkova arave për të fjetur jashtë, nën dritën e yjeve. Por as yje nuk kishte. M'u duk se do të binte shi dhe s'do të kishte zot mëshirëmadh që ta ndalonte, kështu që u ktheva përsëri në qytet për të gjetur strehë nën ndonjë portë. Atje, te sheshi, po shtriheshja për të fjetur mbi një pllakë guri. Një grua shpirtmirë më tregoi shtëpinë tuaj dhe më tha: "Trokit atje", dhe trokita. Ç'është këtu? Mos jeni bujtinë? Të holla kam, për të paguar. Njëqind e nëntë franga e pesë su kam fituar në burg me punë gjatë nëntëmbëdhjetë vjetëve. Jam gati të paguaj. S'më ha merak, parà kam. Jam shumë i lodhur, dymbëdhjetë lega në këmbë s'i thonë shaka, pastaj më griu edhe për të ngrënë. A më pranoni të qëndroj?

-Zonja Magluarë, - tha ipeshkvi, - shtroni edhe një pjatë më tepër.

Burri bëri tre hapa dhe iu afrua llambës që ishte mbi tryezë.

-Pa daleni, njëherë, - tha ai, sikur të mos e kishte kuptuar

mirë, - puna qëndron ndryshe. A dëgjuat mirë? Unë jam një i burgosur, njeri i dënuar me punë të rënda. Vij nga burgu.

Nxori nga xhepi një fije letre të madhe ngjyrë të verdhë dhe e shpalosi.

-Ja pasaporta ime. Është e verdhë, siç e shihni. Kjo shërben për të më dëbuar ngado që vete. Doni ta lexoni? Sa për të lexuar, di unë. Kam mësuar në burg. Ka një shkollë atje, për ata që duan. Ja, shikoni se ç'kanë vënë në pasaportë: "Zhan Valzhan, i burgosur i liruar, lindur në..." Kjo aq ju bën juve... "Ka ndenjor nëntëmbëdhjetë vjet në burg. Pesë vjet për vjedhje me dhunë. Katërmbëdhjetë për arsye se është orvatur të arratiset katër herë. Ky njeri është shumë i rrezikshëm". Ja! të gjithë më kanë flakur jashtë. Ju, a dëshironi të më pranoni? Bujtinë është kjo? Doni të më jepni për të ngrënë e për të fjetur? Mos keni ndonjë haur?

-Zonja Magluarë, - tha ipeshkvi, - do të shtroni çarçafë të bardhë në shtratin e kamares.

E kemi shpjeguar që më parë se si i bindeshin të dyja gratë ipeshkvit.

Zonja Magluarë doli për të zbatuar urdhrat.

Ipeshkvi iu kthye burrit:

-Zotëri, uluni dhe ngrohuni. Pas pak do të hamë darkë, dhe shtratin do t'jua përgatitin në kohën që do të hani darkë.

Këtu, burri kuptoi gjithçka. Shprehja e fytyrës së tij, gjer atëherë e zymtë dhe e ashpër, erdh e u çel nga habia, dyshimi dhe gëzimi e u bë e jashtëzakonshme. Filloi të belbëzonte si ndonjë i çmendur:

-Vërtet? Si! Më pranoni? Nuk po më përzini! Unë jam i burgosur! Ju po më quakeni edhe zotëri! Më flitni edhe me ju! Këput qafën, qen i zgjebosur! Ja, kështu më kanë folur gjithmonë. Mua më ishte mbushur mendja top se do të më dëbonit. Ja pse ju thashë që në krye se kush jam. Oh! Ajo gruaja zemërmirë që më mësoi të vija këtu! Do të ha darkë! Pastaj edhe shtrat! Shtrat me dyshek dhe me çarçafë! Si gjithë bota! U bënë nëntëmbëdhjetë vjet që s'kam fjetur në shtrat! A, me gjithë mend e keni që të mos iki? Paskeni qenë njerëz të ndershëm! Veç asaj, unë kam edhe parà. Do të paguaj mirë.

Më falni, zoti bujtinar, por si ju quajnë? Do të paguaj sa të kërkonti. Qenkeni fisnik njeri. Jeni bujtinar, apo jo?

-Unë, - tha ipeshkvi, - jam një prift që banoj këtu.

-Prift! - vazhdoi njeriu. - Oh, një prift për kokën e priftit.

Atëherë, nuk kërkonti parà prej meje? Famullitari jeni ju, apo jo? Famullitari i kësaj kishës së madhe? Pa dale! Vërtet, sa i marrë paskam qenë! S'jua vura ré kapuçin që mbani në kokë.

Gjithë duke folur, ai kishte vendosur çantën dhe shkopin në një qoshe, pastaj kishte vënë pasaportën në xhep dhe ishte ulur. Zonjusha Baptistinë po e vërente me butësi. Ai vazhdoi:

-Qenkeni shpirtnjeriu, zoti famullitar. S'i përbuzkeni të tjerët. Është gjë e madhe kur ke një prift të mirë. Atëherë, nuk paskeni nevojë t'ju paguaj?

-Jo, - tha ipeshkvi, - mbajini të hollat. Sa keni? Mos thatë njëqind e nëntë franga?

-E pesëmbëdhjetë su, - shtoi burri.

-Njëqind e nëntë franga dhe pesëmbëdhjetë su. Dhe sa kohë bëtë për t'i fituar ato?

-Nëntëmbëdhjetë vjet.

-Nëntëmbëdhjetë vjet!

Ipeshkvi psherëtiu thellë.

Burri vazhdoi:

-I kam akoma paratë të pacenuara. Këto katër ditë kam harxhuar vetëm njëzet e pesë su, të cilat i kam fituar duke ndihmuar për shkarkimin e disa karrove në Grasë. Meqenëse qenkeni abat, dua t'ju them se edhe ne kishim një meshtar në burg. E pastaj, një ditë, pashë edhe një ipeshkv. Nga ata që u thonë imzot. Ky na paskësh qenë ipeshkvi i Mazherës, në Marsejë. Është prift mbi priftërinjtë. Që thoni ju, unë s'i tregoj dhe aq mirë këto punë, më falni, por këto gjëra s'i marr vesh edhe aq mirë. Ju e kuptoni, dora jonë kaq di! Mbajti meshë mu në mes të kampit, mbi një altar, kishte edhe një diçka si me majë, e tëra flori, mbi kokë. Ditën për drekë, ajo shkëlqente shumë. Ishim vënë me radhë nga të tre krahët. Përpara kishim topat me fitila të ndezur dhe me grykat drejt nesh. Nuk shikonim dot mirë. Ai foli, por ishte shumë thellë dhe nuk e dëgjonim dot. Ja se ç'është ipeshkvi.

Ndërsa ai fliste, ipeshkvi kishte vajtur të mbyllte portën, që kishte mbetur e hapur kat e kat.

Zonja Magluarë hyri. Ajo solli një pjatë dhe e vuri mbi tryezë.

-Zonja Magluarë, - tha ipeshkvi, - vëreni atë pjatë sa më afër zjarrit. - Dhe, duke u kthyer nga mysafiri i tij, tha:

-Era e natës është acar në Alpet. Duhet të keni ftohtë, zotëri, apo jo?

Sa herë që thoshte atë fjalë *zotëri*, me atë zërin e tij të ëmbël e të thellë dhe me atë çiltërsi, fytyra e burrit merrte dritë. *Zotëri* një të burgosuri, është si një gotë ujë i pijshëm për udhëtarin e "Meduzës", që po mbytet, në mes të detit. Të poshtëruarit kanë etje për kujdes e përfillje.

-Kjo llambë, - tha ipeshkvi, - s'po na ndrit mirë.

Zonja Magluarë i ra në të dhe shkoi e mori mbi oxhakun e dhomës së fjetjes të dy shandanët e argjendtë dhe i vendosi të ndezur mbi tryezë.

-Zoti famullitar, - tha burri, - ju qenkeni njeri i mirë. Ju nuk po më përbuzni. Më pranoni dhe më prisni në shtëpinë tuaj. Ndizkeni edhe llambadhet për mua. Megjithatë, unë s'jua kam fshehur se prej nga vij dhe se jam njeri fatkeq.

Ipeshkvi, ulur pranë tij, i preku lehtazi dorën.

-Mund të mos ma thoshit fare se kush ishit. Kjo derë nuk e pyet atë që hyn nëse ka ose jo emër, por nëse ka ndonjë brengë. Ju vuani, keni uri dhe etje; mirë se të vini. Dhe mos më falënderoni, mos më thoni se ju kam pritur në shtëpinë time. Askush nuk është këtu në shtëpi të vet përveç atij që ka nevojë për strehë. Jua them juve që kaloni këtej, se ju jeni këtu në shtëpinë tuaj më shumë se unë. Gjithçka që është këtu, është juaja. Ç'nevojë kam unë të di emrin tuaj? Sidoqoftë, përpara se të ma thoshit, ju keni një emër që unë e dija.

Burri hapi sytë me çudi.

-Vërtet? E dinit se si quhem?

-Po, - u përgjigj ipeshkvi, - ju quheni vëllai im.

-Pa dale, zoti famullitar, - bërtiti burri, - kur hyra këtu, unë kisha uri të madhe; por ju qenkeni aq i mirë, sa tani nuk e di se ç'kam; më shkoi fare.

Ipeshkvi e vështroi dhe tha:

-Keni vuajtur shumë?

-Oh! Xhaketa e kuqe, gjylja me vargoj në këmbë, një dërrasë për të fjetur, të nxehtë, të ftohtë, puna, galera, dajakët! Dy palë pranga, për asgjë. Qelia, për një fjalë goje. Edhe i sëmure në shtrat, prangat s'të ndaheshin. Edhe qentë, edhe qentë janë më të lumtur! Nëntëmbëdhjetë vjet! U bëra dyzet e gjashtë vjeç. Tani, ja dhe pasaporta e verdhë! Kështu!

Ndërkohë, zonja Magluarë e kishte shtruar darkën. Një supë me ujë, vaj, bukë e kripë, pak lard, një copë mish dashi, pastaj fiq, djathë تازه dhe një copë bukë të madhe thekre. Ajo kishte shtuar vetë, veç gjërave të zakonshme të ipeshkvit, edhe një shishe me verë të vjetër të Movës.

Fytyra e ipeshkvit mori aty për aty atë shprehje të gëzuar që është veti e njerëzve mikpritës.

-Urdhëroni të hamë! - tha ai me gjallëri. Siç e kishte zakon kur një i huaj hante darkë me të, ai e ftoi burrin të ulej në të djathtë të tij. Zonjusha Baptistinë, krejt e qetë dhe në mënyrë të natyrshme, zuri vend në të majtë.

Ipeshkvi tha uratën e bukës *benedicite*, pastaj u shtiu supë vetë, sipas zakonit që kishte. Burri filloi të hante si i babëzitur.

Befas ipeshkvi tha:

-Po më duket se diçka mungon në këtë tryezë.

Zonja Magluarë në të vërtetë kishte vënë vetëm të tri takëmet, që ishin krejt të domosdoshme. Por ishte zakoni i shtëpisë që, kur ipeshkvi kishte dikë për darkë, të shtroheshin mbi napë të gjashtë takëmet prej argjendi, një salltanet ky i pafajshëm. Ky luks i shtirë, i bërë me lezet, ishte njëfarë teke prej fëmije plot hir në këtë shtëpi të ëmbël dhe të rreptë, që e ngrinte varfërinë gjer në shkallën e dinjitetit.

Zonja Magluarë e mori vesh vërejtjen, doli pa thënë asnjë fjalë, dhe pas një hopi të tri takëmet që kërkoi ipeshkvi shndritnin mbi napë, të rregulluara në mënyrë simetrike përpara secilit prej të tre përbujtësve.

IV

Hollësira mbi baxhot e Pontarlierit

Për të dhënë një idë se ç'ndodhi rreth kësaj tryeze, nuk do të bënim punë më të mirë sesa të paraqitnim këtu të shkruar pjesën e një letre të zonjushës Baptistinë dërguar zonjës Dë Buashëvron, ku bisedimi i të burgosurit dhe i ipeshkvit është kallëzuar me një imtësi të padjallëzuar:

.....
"...Ky burri as ua vinte fare veshin të tjerëve. Hante me një grykësi prej të urituri. Por, pas supës, ai tha:

"-Zoti famullitar i perëndisë së uruar, të gjitha këto janë tepër të mira për mua, po s'më rrihet pa thënë se karrocierët, që nuk deshën të më linin të haja me ta, hanë e pinë më mirë se ju.

"Ta themi midis nesh, kjo vërejtje sikur më preku pak. Im vëlla u përgjigj kështu:

"-Ata lodhen më shumë se unë.

"-Jo, - ia pati burri, - ata kanë para më shumë. Ju jeni i varfër. E shoh mirë unë. Ju ndoshta s'jeni as famullitar. A jeni të paktën famullitar? Ah! Për besë, në qoftë se Zoti i bekuar do të ishte i drejtë, ju duhej të ishit medoemos famullitar.

"-Zoti i bekuar është më se i drejtë, - tha im vëlla.

"Pas një çasti, ai shtoi:

"-Zoti Zhan Valzhan, në Pontarlier po shkoni?

"-Me itinerar të detyrueshëm.

"Më duket se kështu u përgjigj njeriu. Pastaj vazhdoi:

"-Nesër, në pikë të mëngjesit, më duhet të nisem për udhë. Sa e rëndë është të udhëtosh! Në qoftë se netët janë të ftohta, ditët janë të nxehta.

"-Por po shkoni në një vend të mirë, - tha im vëlla. - Në kohën e Revolucionit familja ime u rrënua, dhe unë gjeta strehë së pari në Franshë - Konté dhe jetova atje për ca kohë me djersën e ballit. Punës nuk ia përtoja. Dhe punë gjeta. Aty punë

kishte, veç të zgjidhje e të merrje. Ka fabrika letre, lëkurësh, distilerira, fabrika sahatësh, fabrika çeliku, bakri, të paktën njëzet uzina hekuri, prej të cilave katër në Lods, në Shatijon, në Adënkur dhe në Bër, të cilat janë mjaft të mëdha...

“Besoj se nuk gabohem kur them se janë tamam këta emra që zuri në gojë im vëlla, pastaj e ndërpreu fjalën dhe m’u drejtua mua:

“-Motërz e dashur, kemi apo s’kemi farefis ne në atë vend?

“Unë u përgjigja:

“-Kemi pasur, midis të tjerëve, zotin Dë Lysënet, i cili ka genë kapiten i portave të Pontarlierit në regjimin e vjetër.

“-Po, - vazhdoi im vëlla, - por më 93, njeriu s’kishte më farefis, kishte vetëm krahët e tij. Unë punova. Në krahinën e Pontarlierit, atje ku po shkoni ju, zoti Zhan Valzhan, kanë një industri shumë patriarkale dhe shumë të hirshme, o motërza ime. Këto janë baxhot që i quajnë pemëtore.

“Atëherë, im vëlla, nga njëra anë, e nxiste mysafirin të hante, dhe nga ana tjetër, shpjegonte me shumë hollësi se ç’ishin ato pemëtoret e Pontarlierit; - se mund të dalloje dyfarëshe: *hambarët e mëdhenj*, që janë të të pasurve dhe ku ka dyzet a pesëdhjetë lopë, të cilat prodhojnë shtatë a tetë mijë rrota djathi për çdo verë; *pemëtoret e ortakërisë*, që janë të të varfërve; këta janë fshatarët e zonave gjysmëmalore që i bashkojnë lopët dhe mbajnë bulmetin. Pajtojnë një baxhoxhi, që e quajnë në gjuhë të tyre *gryrin*; gryrini merr nga ortakët qumështin tri herë në ditë dhe shënon sasi të një çetele të dyfishtë; puna e baxhove fillon aty më të dalë të prillit, dhe aty nga mesi i qershorit baxhoxhinjtë i çojnë lopët e tyre në bjeshkë.

“Burri filloi të gjallërohej duke ngrënë. Im vëlla i shtinte për të pirë nga ajo vera e uruar e Movës, nga e cila as ai vetë nuk pi, sepse thotë që është verë e shtrenjtë. Im vëlla ia kallëzonte të gjitha këto hollësi me atë gazin e tij të dëlirë që ju ia njihni mirë, duke më hedhur me lezet edhe mua ndonjë fjalë herë pas here. Shumë herë me radhë foli për atë të bekuar mjeshtër të gryrinit, sikur donte që ai burri të kuptonte, pa ia këshilluar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vrazhdë, se kjo punë do të ishte një folezë e mirë për të. Një gjë më ra në sy. Ai burri

ishte ashtu siç ju thashë. Eh, pra! Im vëlla, sa zgjati darka dhe mbrëmja, përveç disa fjalëve mbi Krishtin që kur pati hyrë, nuk tha asnjë fjalë që t’i kujtonte atij burri se kush ishte, as t’i jepte të ditur këtij njeriu se kush që im vëlla. Ishte tamam rasti në dukje që të predikonte pak dhe të hiqej si ipeshkv ndaj të burgosurit, sa për t’i lënë një farë mbrese. Ndonjë tjetri do t’i dukej se ishte tamam rasti, meqë e kishte këtë fatkeq në dorë, që t’i ushqente njëkohësisht edhe shpirtin, edhe trupin dhe t’i bënte disa qortime të kripura me moral dhe këshilla, ose ta prekte pak, sa për ta nxitur që të sillej më mirë në të ardhmen. Im vëlla s’e pyeti as për vendin se nga ishte, as për historinë e tij. Sepse në këtë histori përfshihej edhe gabimi që kishte bërë ai burri; dhe im vëlla dukej se i shmangej gjithçkaje që mund t’ia kujtonte këtë gabim. Kaq sa, në një çast të caktuar, ndërsa im vëlla po fliste për malësorët e Pontarlierit, që kanë *një punë të ëmbël afër qiellit dhe që*, shtonte ai, *janë të lumtur, sepse janë të pamëkatë*, ai u ndal vrik, duke drashtur se mos në këto fjalë që i shpëtuan nga goja kishte ndonjë gjë që mund ta pezmatonte këtë njeri. Pasi e vrava dhe e vrava mendjen, besoj se e kam kuptuar se çfarë ngjiste në zemrën e tim vëllai. Ai pa dyshim mendonte se këtij burri, që quhet Zhan Valzhan, ia brente me të tepër shpirtin e mendjen fatkeqësia e tij dhe e mira e të mirave do të ishte që t’ia largonte mendjen soje dhe ta bënte të besonte, qoftë edhe për një çast të vetëm, se ai ishte një njeri si të gjithë njerëzit e tjerë dhe ishte për të një njeri krejt i zakonshëm. M’u duk se ky duhej të ishte mendimi i brendshëm i tim vëllai. Sidoqoftë, unë mund të them vetëm një gjë: edhe nëse i kishte këto mendime, ai nuk shprehu asnjë syresh, as me mua; ishte, nga kreu gjer në fund, si në të gjitha mbrëmjet e tjera dhe hëngri darkë me atë Zhan Valzhanin me atë shprehje dhe me atë mënyrë siç do të hante darkë po të ishte me zotin Gedeon Lë Prevó ose me zotin famullitar të famullisë.

“Nga fundi, kur ishim te fiqtë, dikush trokiti te porta. Ishte nënë Zherboja me fëmijën e vet në krahë. Im vëlla e puthi fëmijën në ballë dhe më mori pesëmbëdhjetë *su* për t’ia dhënë nënë Zherbosë. Burri gjatë kësaj kohe nuk para vinte vesh. Nuk

fliste më dhe dukej i rraskapitur. Si iku e ngrata nënë Zherbò, im vëlla tha uratën e përhirimeve, pastaj u kthye nga burri dhe i tha: "Duhet të keni shumë, shumë nevojë të pushoni në shtrat". Zonja Magluarë i hoqi pjatat shpejt e shpejt. Unë e mora vesh se duhej të largoheshim për ta lënë të flinte udhëtarin, dhe u ngjitëm lart që të dyja. Por ndërkohë dërgova zonjën Magluarë të çonte mbi shtratin e këtij burri një lëkurë sorkadheje të Pyllit të Zi, që ndodhet në dhomën time. Netët janë akull të ftohta dhe ajo lëkura të mban ngrohtë. Sa keq që ajo lëkurë është e vjetër: po i bie qimja e po rruhet fare. Im vëlla e ka blerë që kur ishte në Gjermani, në Totlingen, pranë burimeve të Danubit, tok me thikën me dorëz fildishi që e përdor në tryezë,

Pas pak, zonja Magluarë u ngjit përsëri lart, pastaj hymë secila në dhomën e vet, pa këmbyer asnjë fjalë".

V

Qetësi

Si i uroi natën e mirë së motrës, imzot Bienvënyi mori mbi tryezë njërin nga të dy shandanët e argjendtë, ia dorëzoi tjetrin mikut dhe i tha:

-Zotëri, do t'ju çoj gjer në dhomën tuaj.

Burri i shkoi pas.

Siç mund ta keni vënë re edhe nga sa është thënë më lart, banesa ishte ndarë në atë mënyrë që, për të kaluar në oratorio, ku ishte shtrati, ose për të dalë që andej, duhej të kaloje përmes dhomës së fjetjes së ipeshkvit.

Në çastin kur po kalonin nëpër këtë dhomë, zonja Magluarë po vendoste enët e argjendta në dollapin që ishte mbi kryet e shtratit. Kjo ishte puna e fundit që bënte ajo përpara se të shkonte për të fjetur.

Ipeshkvi e vendosi mysafirin në kamare. Aty ishte shtruar një shtrat i bardhë dhe i freskët. Burri vendosi shandanin mbi një tryezë të vogël.

-Epo, tani bëfshi natën e mirë! - tha ipeshkvi. - Nesër në mëngjes, përpara se të niseni, do të pini një filxhan qumësht të ngrohtë nga të lopëve tona.

-Ju faleminderit, zoti abat! - tha burri.

Me të shqiptuar këto fjalë paqësore, papritmas ai bëri një lëvizje të çuditshme, e cila do t'i kishte ngrirë nga frika të dy vajzat e bekuara, po të ishin aty dëshmitare të kësaj ngjarjeje. Edhe sot e kësaj dite e kemi të vështirë të kuptojmë se çfarë e shtyu atë në këtë çast. Deshi të bënte ndonjë paralajmërim apo të lëshonte ndonjë kërcënim? Mos vallë i bindej thjesht ndonjë shtytjeje instinktive, që mund të ishte e errët edhe për atë vetë? U kthye vrik nga plaku, kryqëzoi krahët dhe, duke i ngulur bujtësit të vet një vështrim të egër, bërtiti me një zë të ngjirur:

-Dreq o punë! Mendje e bukur dhe kjo! Ju më bëni vend në shtëpi tuaj, pranë jush, kështu si pa gjë të keq!

E preu fjalën dhe shtoi me një të qeshur, ku kishte diçka të përbindshme.

-A i keni peshuar mirë të gjitha? Kush mund t'ju thotë se unë nuk kam vrarë?

Ipeshkvi ngriti sytë nga tavani dhe u përgjigj:

-Kjo është punë e Zotit të bekuar.

Pastaj, rëndë-rëndë dhe duke lëvizur buzët si ndonjë njeri që falet ose që flet me vete, ai ngriti të dy gishtat e dorës së djathtë dhe e bekoi atë burrë, i cili as u përku fare, dhe, pa kthyer kokën e pa vështruar prapa, hyri në dhomën e vet.

Pas një çasti ipeshkvi kishte dalë në kopsht e po ëndërronte duke baritur.

Kurse burri ishte aq i lodhur, sa nuk kishte mundur as të përfitonte nga ata çarçafë të butë dhe të bardhë. I kishte fryrë qiriut me hojëzat e hundës, ashtu siç bëjnë të burgosurit, dhe ishte plasur me gjithë rroba mbi shtrat, ku e kishte mbërthyer menjëherë një gjumë i thellë.

Po binte mesnata kur ipeshkvi po kthehej nga kopshti në apartamentin e vet.

Disa minuta më vonë gjithçka flinte në shtëpinë e vogël.

VI

Zhan Valzhani

Aty nga mesi i natës, Zhan Valzhani u zgjua.

Zhan Valzhani ishte nga një familje e varfër fshatarësh të Brisë. Në fëmijëri ai s'kishte mundur të mësonte as shkrim, as këndim, kur arriti në moshën e pjekurisë, u bë krasitës në Favërolë. E ëma quhej Zhanë Matjë, i ati quhej Zhan Valzhan ose Vlazhan, ndoshta si nofkë dhe shkurtim i fjalëve *Voilà Jean*.^{*)}

Zhan Valzhani, nga karakteri ishte njeri i menduar, por jo i trishtuar, veti, kjo, e njerëzve të dashur. Me një fjalë, ky Zhan Valzhani na ishte një njeri si i fjetur dhe nuk shquhej ndër shokë, të paktën në dukje. Babai dhe nëna i kishin vdekur kur ishte akoma kërthi. E ëma i kishte vdekur nga një palë ethe qumështi, që s'ia kishin mjekuar mirë. I ati, krasitës si ai, ishte rrëzuar nga një pemë e kishte mbetur i vdekur në vend. S'i kishte mbetur më Zhan Valzhanit në këtë botë veç një motre më të madhe nga ai, e ve, me një karvan fëmijë, shtatë djem e vajza. Kjo motër e kishte rritur Zhan Valzhanin dhe, sa kohë që kishte gjallë të shoqin, ajo e mbajti në shtëpi dhe e ushqeu vëllanë e saj të vogël. I shoqi vdiq. Më i madhi i shtatë fëmijëve ishte tetë vjeç, i vogli ishte motak. Zhan Valzhani sapo i kishte mbushur të njëzet e pesë vjetët. Ai zuri këmbën e babait të fëmijëve, dhe kësaj radhe iu bë krah motrës, që e kishte rritur. Këtë punë Zhan Valzhani e bëri fare thjesht, sikur të kryente një detyrë, madje me një mënyrë të prerë. Të ritë e tij ai e harxhonte kështu në punë të rëndë dhe të paguar keq. S'i dinin e s'i kishin parë ndonjë "mikeshë" në fshat. S'kishte pasur kohë e ngë ai të binte në dashuri.

Mbrëmjeve kthehej në shtëpi i dërrmuar dhe hante pak supë, pa nxjerrë fjalë nga goja. Ndërsa ai hante, e motra, nënë Zhana, i merrte nga çanaku pjesën më të mirë të gjellës, copën

^{*)} Vuala Zhan (frëngj.) – Ja Zhani.

e mishit, thelën e lardit, zemrën e lakrës, dhe ia jepte ndonjërit prej fëmijëve të saj; ai vazhdonte të hante, i kërrusur mbi tryezë, me kokën pothuajse në supë, me flokët që i binin rreth çanakut dhe i mbulonin sytë, dhe dukej sikur nuk shihte asgjë, por e linte të motrën të vepronte. Aty në Favërolë, jo larg kasolles me kashtë të Valzhanëve, në anën tjetër të rrugëzës, jetonte një fermere që quhej Mari-Klode; fëmijët Valzhan, zakonisht të uritur, shkonin herë pas here e merrnin hua në emër të nënës së tyre ndonjë litër qumësht te Mari-Klodja dhe e pinin prapa gardhit ose në ndonjë skutë të mbuluar me pemë, duke ia rrëmbyer poçthin njëri-tjetrit, të ngutur si të paparë, aq sa vajzat e vogla e derdhnin ca në përparëse dhe ca në gurmaz. Po ta kishte pikasur këtë hilë, nëna do t'ua kishte ndrequr mirë qejfin këtyre fajtorëve. Zhan Valzhani, i rrëmbyer dhe gërnjar, ia paguante Mari-Klodes litrën e qumështit prapa krahëve të nënës, dhe kështu fëmijët nuk dënoheshin.

Ai fitonte në stinën e krasitjeve njëzet e katër su në ditë, pastaj shkonte e pajtohej me drapër, punëtor krahu, lopar, shërbëtor. Punonte ç'të mundte. Edhe e motra punonte sa shuhej, por si t'ia bënte me shtatë fëmijë të vegjël? Ishte një tufë e trishtuar, të cilën e pllakosi dhe e shtrydhi pak e nga pak mjerimi. Ndodhi që një dimër bëri mot i ashpër. Zhani s'pati punë. Familja s'pati bukë. S'pati bukë. Përnjëmend. Shtatë fëmijë!

Një të diel mbrëma, Mobert Izaboi, furrtar në Sheshin e Kishës, në Favërolë, po bëhej gati të binte për të fjetur, kur dëgjoji një krismë të fortë në xhamllëkun me grila të dyqanit të vet. Arriti në kohë dhe pa një krah njeriu që kishte kaluar përmes një vrime të bërë nga goditja e grushtit në grilë dhe në xham. Krahu kapi një bukë dhe e rrëmbeu. Izaboi doli me nxitim; vjedhësi po ikte me të katra; Izaboi ngau vrap prapa tij; e kapi dhe e ndali në vend. Vjedhësi e kishte flakur bukën. Por e kishte krahun akoma të gjakosur. Ky ishte Zhan Valzhani.

Kjo ndodhi më 1795. Zhan Valzhani doli përpara gjyqit të atëhershëm për "vjedhje me dhunë natën në një shtëpi të banuar". Kishte një pushkë, me të cilën shtinte më mirë se çdo qitës tjetër në botë, se ishte një çikë si gjahtar kaçakçe; kjo e

rëndoi dhe e dëmtoi shumë. Kundër gjahtarëve kaçakë ka një paragjykim të përligjur. Gjahtari kaçak, ashtu si kontrabandisti, i afrohet fort kusarit. Megjithatë, le ta themi kalimthi, ka akoma një humnerë midis kësaj fare njerëzish dhe vrasësit të neveritshëm të qyteteve. Gjahtari kaçak rron në pyje; kontrabandisti rron në mal ose në det. Qytetet nxjerrin njerëz shtazarakë, sepse nxjerrin njerëz të prishur. Mali, deti, pylli nxjerrin njerëz të egër. Ata zhvillojnë anën e egër, por shpesh pa prishur anën njerëzore.

Zhan Valzhani u shpall fajtor. Dispozitat e kodit ishin të prera. Ka në qytetërimin tonë disa çaste që të kallin frikën; janë çastet në të cilat penalteti, ndëshkimi vendos një diçka që është baras me një përmbytje. Eh, ç' minutë e përzishme është ajo kur shoqëria largohet dhe shkon e braktis në mënyrë të pandreqshme një krijesë që mendon! Zhan Valzhani ishte dënuar me pesë vjet burgim me punë të rënda.

Më 22 prill 1796, brohoritën në Paris fitoren e Montenotes që korri kryekomandanti i armatës së Italisë,¹⁸⁾ të cilin mesazhi i Direktoratit drejtuar të pesëqindëve, më 2 të florealit^{*)} të vitit IV, e quan Buona-Parte; po atë ditë, një karvan të burgosurish u mbërthye me pranga në Bisetrë... Zhan Valzhani bënte pjesë në këtë karvan. Një rojtar i vjetër i burgut, i cili sot është nëntëdhjetë vjeç plak, e mban mend akoma fare mirë këtë fatkeq që u lidh me pranga në skajin e vargut të katërt në qoshen veriore të oborrit. Ai ishte ulur përdhé si gjithë të tjerët. Dukej sikur s'merrte vesh gjë se ç'po ndodhte me të, në mos atë që kjo ishte në gjendje e llahtarshme. Ka gjasë që ai të ajgëtonte gjithashtu, përmes ideve të vagëlluara të një njeriu të shkretë që s'di se ç'është bota, diçka si të tepruar. Në kohën kur po ngjitnin me goditje të forta çekani prapa kokës së tij rrëfanën e hallkës së qafores së hekurt, ai po qante, lotët e mbytnin dhe nuk e linin të fliste, vetëm se arrinte të thoshte kohë më kohë: "Unë isha krasitës në Favërolë". Pastaj, duke dënesur, ai ngrinte dorën e djathtë dhe e ulte shkallë-shkallë shtatë herë, sikur të prekte me radhë, njëra pas tjetrës, shtatë kokë të pabarabarta,

^{*)} Muaji i tetë i kalendarit republikan në Francë.

dhe me këtë lëvizje bota kuptonin se atë gjë që kishte bërë, e kishte bërë vetëm e vetëm për të veshur e ushqyer shtatë fëmijë të vegjël.

U nis për në Tulon. Arriti aty pas një udhëtimit prej njëzet e shtatë ditësh, mbi një karro, me pranga në qafë. Në Tulon e veshën me xhaketën e kuqe. Gjithçka u shua nga jeta e tij, deri dhe emri që kishte; ai s'ishte më Zhan Valzhani; ai u bë numri 24601. Ç'u bë e motra? Si u vajti filli të shtatë fëmijëve? E kush merret me këtë punë? E ç'bëhet vallë tufa e gjetheve të pemës së re të sharruar nga rrëza? Gjithmonë po e njëjta histori. Këto të shkreta qenie të gjalla, tanimë pa mbështetje, pa prijës, pa plang e pa shtëpi, morën kuturu nga sytë këmbët, kushedi? secili ndoshta për hesap të vet, dhe u zhytën pak e nga pak në atë mjegullën e ftohtë ku përpihen fatet e vetmuara, në ato terre të zymta ku zhduken njëra pas tjetrës kaq koka fatkeqe në ecjen e sterrosur të gjinisë njerëzore. Ata braktisën vendin. Edhe kambanorja e fshatit të tyre i harroi fare; edhe guri i sinorit të arës së tyre i harroi; pas disa vjetësh qëndrimi në burg edhe vetë Zhan Valzhani i harroi. Në atë zemër ku kishte një plagë erdh e u bë një korez. Dhe vetëm kaq. Gjatë gjithë kohës që kaloi në Tulon mezi dëgjoji një herëz të vetme të flitej për të motrën. Ishte besoj aty nga fundi i vitit të katërt të burgosjes së tij. Tani as unë s'e di se me ç'rrugë i pati ardhur ai lajm. Dikush që i kishte njohur në fshat, ia kishte parë të motrën. Ajo ishte në Paris. Banonte në një rrugë të varfër pranë Sen-Sylpisit, në rrugën "Zhëndrit". Kishte me vete vetëm një fëmijë, një djalë të vogël, atë të fundit fare. Ku ishin vallë gjashtë fëmijët e tjerë? As ajo vetë ndoshta s'e dinte. Çdo mëngjes ajo vente në një shtypshkronjë në rrugën e "Sabotit", Nr. 3, ku punonte si faqosëse e libralidhëse. Duhej të ishte në punë në orën gjashtë të mëngjesit, shumë para se të zbardhte dita në dimër. Në ndërtesën e shtypshkronjës kishte një shkollë dhe ajo e çonte në këtë shkollë djalin e vet të vogël, që ishte shtatë vjeç. Vetëm se, meqë ajo hynte në shtypshkronjë dhe shkolla hapej vetëm në orën shtatë, fëmijës i duhej të priste një orë të tërë në oborr, gjersa të hapej shkolla; dimrit, një orë të tërë qëmenatë, jashtë në thëllim! Nuk donin që fëmija të hynte në shtypshkronjë, se

thoshin që pengonte të tjerët. Punëtorët e shihnin duke kaluar aty pranë; e shihnin atë krijesëz të varfër, të ulur mbi rrasat e gurit, të këputur për gjumë dhe shpesh të përgjumur në errësirë, të kërrusur e të mbledhur shuk mbi shportën e tij. Kur binte shi, një grua plakë, portierja, kishte mëshirë për të; ajo e mblidhte aty në kthinëzën e saj, ku kishte vetëm një shtrat druri, një çikrik dhe dy karrige druri, dhe vogëlushi flinte atje në një qoshe, duke u shtrënguar pas maces, që të ngrohej pak. Në orën shtatë, shkolla hapej dhe ai hynte brenda. Ja, këto i thanë Zhan Valzhanit. I folën kështu një ditë të tërë, dhe ky ishte një çast, një vetëtimë, një si dritarez e hapur befaz mbi fatin e këtyre qenieve, që ai i kishte dashur aq shumë, pastaj gjithçka u mbyll; s'dëgjoi më të flitej për ta, dhe kjo ishte hera e fundit. Asgjë, asnjë lajm nuk arriti më nga ata te ky, kurrë s'i pa me sy dhe kurrë s'i takoi, dhe, në vazhdim të kësaj historie të dhimbshme, as ne nuk do t'i hasim më.

Nga fundi i vitit të katërt, i erdhi radha edhe Zhan Valzhanit për t'u arratisur. Shokët e ndihën, ashtu siç është zakoni në këtë vend të zymtë. Ai u arratis. U end dy ditë i lirë nëpër fusha e ara; i lirë i thënçin, kur të gjëmojnë këmba-këmbës; kur kthen kokën në çdo çast; kur dridhesh edhe nga zhurma më e vogël; kur ke frikë nga gjithçka; nga pullazi që nxjerr tym, nga njeriu që kalon, nga qeni që leh, nga kali që nget kupthi, nga sahati që tingëllon, nga dita, pse të shohin, nga nata, pse nuk sheh, nga udha, nga monopati, nga ferra, nga gjumi. Mbrëmjen e ditës së dytë e kapën përsëri. Për tridhjetë e gjashtë orë s'kishte futur gjë në gojë dhe s'kishte vënë gjumë në sy. Për këtë faj, gjykata detare e dënoi me një zgjatje burgimi prej tre vjetësh dhe kjo ia ngriti burgimin në tetë vjet. Vitin e gjashtë i erdhi edhe një herë radha të arratisëj; edhe këtë rast nuk e la pa shfrytëzuar, por nuk ia doli mbanë. Ai mungonte kur u thirrën emrat. Qitën një herë me top për kushtrim, dhe natën rojat e gjetën të fshehur në skafin e një anijeje që po ndërtohej; rojave që e kapën, u bëri edhe qëndresë. Arratisje dhe rebelim. Kjo vepër e parashikuar nga kodi special u ndëshkua me një rëndim prej pesë vjetësh, dy prej të cilëve me vargonj të dyfishtë. Trembëdhjetë vjet. Vitin e dhjetë i erdhi

përsëri radha, dhe ai përfitoi edhe një herë. Por s'ia doli dot në krye. Tre vjet për këtë orvatje të re. Gjashtëmbëdhjetë vjet. Më në fund, besoj aty nga viti i trembëdhjetë, ai provoi për të fundit herë dhe nuk arriti të bënte tjetër veçse të binte përsëri në dorë pas një mungese prej katër orësh. Tre vjet të tjerë për këto katër orë. Nëntëmbëdhjetë vjet. Në tetor 1815, ai u lirua; kishte hyrë atje më 1796, pse pati thyer një xham e marrë një bukë.

Këtu është vendi për një parantezë të shkurtër. Është e dyta herë që, në hulumtimet e veta mbi çështjen e ndëshkimeve dhe dënimeve me anë të ligjit, autori i këtij libri has vjedhjen e një buke si pikënisje të rrënimt të fatit të një njeriu. Klod Gei¹⁹⁾ kishte vjedhur një bukë; Zhan Valzhani kishte vjedhur një bukë. Një statistikë angleze nxjerr në dritë se në Londër katër vjedhje mbi pesë kanë si shkak imediat urinë.

Zhan Valzhani kishte hyrë në kampin e punëve të rënda duke dënesur e duke u dridhur; doli soje i pandjeshëm ndaj dhembjes. Kishte hyrë i dëshpëruar dhe doli i zymtë.

Ç'kishte ndodhur me këtë shpirt?

VII

Brendësia e dëshpërimit

Le të përpiqemi ta themi.

Shoqëria duhet t'i shikojë medoemos këto gjëra, sepse është ajo vetë që i shkakton.

Siç thamë, ai ishte një njeri i panxënë, por nuk ishte budalla. Drita e mençurisë së natyrshme qëndronte e ndezur brenda tij. Fatkeqësia, e cila ka edhe ajo dritën e saj, e shtoi akoma më shumë ndriçimin e paktë që ishte në këtë mendje. Dajaku, vargonjtë, qelia, lodhja, dielli përvëlues i kampit, shtrati prej dërrasash i të burgosurve, bënë që ai të strukej në ndërgjegjen e vet dhe të mendohej thellë.

Ai u bë gjykatës.

Dhe, së pari, filloi të gjykonte vetveten.

E pranoi se nuk ishte i pafajshëm, as i dënuar padrejtësisht. Ai i pohoi vetvetes se kishte kryer një veprim të tejmë dhe të dëmshëm; se ndoshta nuk do t'ia kishte kursyer njeri atë copë bukë, po ta kishte kërkuar, se, sidoqë ta kishte sjellë puna, do të kishte qenë më e udhës ta kishte pritur qoftë nga mëshira, qoftë nga puna; se nuk është arsye, se cilës s'i përgjigjesh dot, të thuash: "A mund të presësh kur ke uri?" Se, së pari, qëllon shumë rrallë që të vdesësh krejtësisht vetëm nga uria, se, pastaj, fatkeqësisht apo lumturisht, njeriu është gatuar në mënyrë të atillë që të vuajë gjatë dhe shumë, moralisht dhe fizikisht, por pa arritur gjer në atë pikë sa të vdesë; se duhej, pra, durim; se kështu do të kishte qenë më mirë për fëmijët e varfër; se ishte një marrëzi për të, njeri fatkeq dhe i pafuqishëm, ta kapte për zverku me dhunë të gjithë shoqërinë dhe të kujtonte se mund të dilte nga mjerimi me anë të vjedhjes; se, kjo, ngado që ta ktheje, ishte një shteg i keq për të dalë nga mjerimi dhe një shteg përmes të cilit njeriu hyn në llumin e turpër; se, më në fund, ai s'kishte të drejtë.

Pastaj e pyeti veten:

Por a mos vallë ishte vetëm ai fajtor në historinë e tij fatale?

A nuk ishte vallë një gjë e rëndë të mos kishte punë ai, punëtori, të mos kishte bukë ai, aq i pakursyeri në punë? Pastaj, si e bëri gabimin dhe si e pohoi, ndëshkimi që mori ishte apo s'ishte i pashpirt dhe tejmasës? Kishte pasur më tepër shpërdorim nga ana e ligjit në ndëshkimin që dha apo nga ana e fajtorit në gabimin që bëri? Kishte apo nuk kishte mbingarkesë në njërën anë të peshores dhe pikërisht në atë ku qëndronte ndëshkimi? Mbingarkesa e dënimit ishte apo nuk ishte shlyerja e fajit dhe çonte apo nuk çonte në këtë rezultat: gjendja përmbysesj, gabimi i fajtorit zëvendësohej me gabimin e masës shtypëse, fajtori bëhej viktimë dhe borxhliu kreditor, dhe vendosej përfundimisht e drejta nga ana e vetë atij që e kishte dhunuar këtë të drejtë? Ky dënim i ndërlikuar me rëndime të njëpasnjëshme për shkak të orvatjeve për arratisje arrinte apo nuk arrinte të bëhej njëfarë atentati i më të fortit ndaj më të dobët, një krim i shoqërisë ndaj njeriut, një krim

që përsëritej çdo ditë, një krim që vazhdonte nëntëmbëdhjetë vjet?

Ai pyeti vetveten nëse kishte të drejtë shoqëria njerëzore t'i bënte anëtarët e vet të vuanin njëkohësisht nga moskujdesia e paarsyeshme dhe nga kujdesi i pamëshirshëm, si edhe të kapte e ta mbante një njeri të varfër përgjithmonë të mbërthyer midis një mungese dhe një teprie, midis mungesës së punës dhe teprisë së ndëshkimit. Në ishte apo jo me vend që shoqëria t'i trajtonte pikërisht kështu pjesëtarët e saj më skamës në ndarjen e të mirave që bën fati, dhe, rrjedhimisht, ata pjesëtarë që meritojnë më shumë kujdesin dhe mbrojtjen e saj.

Si bëri këto pyetje dhe u dha zgjidhje, ai e gjykoi shoqërinë dhe e dënoi.

E dënoi me kutin e urrejtjes së tij.

E bëri shoqërinë përgjegjëse për fatin që ai po vuante, dhe tha me vete se ndoshta ndonjë ditë nuk do të ngurronte t'i kërkonte llogari për këtë. Ai deklaroi me vete se nuk kishte masë e kandar midis dëmit që kishte shkaktuar ai dhe dëmit që i shkaktonte atij; më në fund, ai nxori si përfundim se, në të vërtetë ndëshkimi i tij nuk ishte një padrejtësi, por me siguri një mungesë paanësie.

Inati mund të jetë i çmendur dhe i pavend; njeriu mund të pezmatohet pa të drejtë; por ai mund të indinjohet vetëm atëherë kur, në themel, ka arsye në ndonjë drejtim. Zhan Valzhani e ndiente veten të indinjuar.

Pastaj shoqëria njerëzore i kishte bërë atij vetëm të këqija. Kurrë s'kishte parë nga shoqëria veçse atë fytyrë të zemëruar që ajo e quan Drejtësi dhe që ua tregon atyre që godet. Njerëzit e kishin prekur vetëm për t'i hapur plagë. Çdo kontakt me të kishte qenë një shuplakë për Zhan Valzhanin. Kurrë, që kur ishte fëmijë, që kur kishte nënën gjallë, që kur kishte motrën, kurrë nuk kishte hasur një fjalëz miqësore dhe një vështrim dashamirës. Nga vuajtja në vuajtje, ai erdhi e u bind se jeta ishte një luftë; dhe se në këtë luftë ai ishte i munduri. Ai s'kishte armë tjetër veç urrejtjes së tij. Vendosi, pra, që ta mpriste këtë urrejtje dhe ta merrte me vete kur të largohej.

Në Tulon kishte për të burgosurit një shkollë që mbahej

nga disa fretër injorantinë,⁹⁾ ku u mësoheshin gjërat më të domosdoshme atyre fatkeqëve që kishin vullnet. Zhan Valzhani hynte në numrin e njerëzve me vullnet. Vajti në shkollë në moshën dyzetvjeçare dhe nxuri të lexonte, të shkruante dhe të numëronte. Ai ndjeu se të forcosh diturinë, do të thotë të forcosh urrejtjen. Në disa raste, arsimi dhe drita mund të shërbejnë si një zgjatje e së keqes.

Si e gjykoi shoqërinë, që i kishte bërë të keqen, gjykoi pastaj dhe Zotin, që kishte bërë shoqërinë.

Dhe e dënoi, gjithashtu, edhe Zotin.

Kështu, në këta nëntëmbëdhjetë vjet torturash dhe skllavërie, ky shpirt edhe u ngjit lart, por edhe u ul poshtë në të njëjtën kohë. Në të, nga njëra anë, hyri drita dhe, nga tjetra, terri.

Zhan Valzhanin e pamë, nuk ishte i keq nga natyra. Ishte akoma i mirë kur arriti në burg. Aty ai e dënoi shoqërinë dhe ndjeu se po bëhej dashakeqës; e dënoi Zotin dhe ndjeu se po bëhej feshkelës.

Me siguri, dhe ne nuk duam ta fshehim, fiziologjisti vëzhgues do të shihte tek ai mjerimin e pandreqshëm, do t'ia kishte qarë hallin këtij njeriu që ligji e kishte sëmëmurur, por nuk do të kishte marrë mundimin as ta mjekonte; do ta kishte kthyer vështrimin mënjane për të mos ajgëtuat honet që do të kishte në këtë shpirt; dhe, siç bëri Dantja me portën e ferrit, do ta kishte shuar nga kjo krijesë e gjallë fjalën *Shpresë!*

A e kuptonte vallë Zhan Valzhani kaq qartë këtë gjendje të tij shpirtërore, sa ç'u përpoqëm t'ua paraqitnim ne lexuesve tanë? A shikonte ai vallë, shkoqur pas formimit të tyre dhe a i kishte parë shkoqur, dora-dorës që formoheshin, të gjitha elementet nga të cilat përngjizej mjerimi i vet moral? Ky njeri i ashpër dhe i pashkollë, a e kishte kuptuar qartë vazhdimësinë e ideve me të cilat ai, shkallë pas shkalle, ishte ngjitur e kishte zbritur deri te pamjet ogurzeza që përbënin qysh prej aq vjetësh horizontin e brendshëm të shpirtit të tij? A ishte vallë krejt i

⁹⁾ Fretërit e urdhrit të Shën-Zhan-Zotit e kishin marrë këtë emër si për përlje.

ndërgjegjshëm për çdo gjë që kishte ngjarë dhe për çdo gjë që trazohej brenda vetes së tij? Këtë gjë nuk do të guxonim ta thoshim; madje, një gjë të tillë as e besojmë, Zhan Valzhani ishte aq i padijshëm, sa, edhe pas kaq fatkeqësisht, s'kishte si të mos i mbeteshin shumë gjëra të paqarta. Herë-herë, ai s'e dinte mirë dhe me saktësi se çfarë ndiente. Zhan Valzhani ishte në mes të territ; vuante në terr; urrente në terr; mund të thuhet se ai urrente çdo gjë që gjente përpara. Rronte zakonisht në këtë errësirë, duke ecur qorrazi si ndonjë i verbër a si nëpër ëndërr. Veçse, hope-hope, atij i vinte papritmas, nga brenda ose nga jashtë një tronditje zemërimi, një tepri vuajtjeje, një shkretimë e zbehtë dhe e shpejtë, që shndriste gjithë shpirtin e tij dhe që bënte befaz të shfaqeshin kudo rreth tij, përpara dhe prapa, nën feksjet e një drite të lemerishme, honet e llahtarshme dhe perspektivat e errëta të fatit të tij.

Si kalonte vetëtimin, nata binte përsëri, dhe ku ishte pastaj? As ai s'e dinte më.

Veçoria e këtyre dënimeve, ku sundon e pamëshirshmja, domethënë shtazërujesja, është se ajo e shndërron njeriun, pak nga pak, me anë të një shpërfytyrimi pa mend, në një bishë të egër. Disa herë edhe në një shtazë gjakësore. Orvatjet e njëpasnjëshme dhe këmbëngulëse të Zhan Valzhanit për arratisje do të mjaftonin për të provuar atë veprim të çuditshëm që ushtron ligji mbi shpirtin e njeriut. Zhan Valzhani do t'i kishte përsëritur orvatjet e tij, aq katërcipërisht të padobishme e të çmendura, sa herë që t'ia sillte rasti, pa e çarë kokën asnjë grimë për përfundimin e as për ato që kishte hequr. Ai derdhej jashtë me vrull, ashtu si ujku kur e gjen kafazin hapur. Instinkti i thoshte: "Ik, shpëto!" Arsyetimi do t'i kishte thënë: "Qëndro!" Por përpara një tundimi kaq të fuqishëm, arsyetimi qe zhdukur; kishte mbetur vetëm instinkti. Vepronte vetëm shtaza. Kur e kapnin përsëri, sfilite që i shkaktonin shërbenin vetëm për ta egërsuar më tepër.

Një hollësi, që s'duhet ta lëmë në harresë, është se ai kishte një forcë fizike që nuk ia gjeje dot shoqen ndër gjithë banuesit e tjerë të kampit. Në punën e lodhshme për të thurur një kablllo, për të rrotulluar një rodhan, Zhan Valzhani bënte sa për katër

burra. Ai ngrinte dhe mbante herë-herë pesha shumë të rënda në shpinë dhe e zëvendësonte, kur e sillte puna, atë përdorësen që quhet kriko dhe që quhej qëmoti *orgëj*, prej nga ka marrë emrin, le ta themi kalimthi, edhe rruga “Montorgëj” pranë merkatos së Parisit. Shokët e vet ia kishin ngjitur emrin Zhan Krikoja. Njëherë, tek po meremetonin ballkonin e bashkisë së Tulonit, një nga statujat e mrekullueshme, vepër e Pyzhetit, që mbante këtë ballkon, u shkul nga vendi dhe mend ra. Zhan Valzhani, që u ndodh aty, i vuri supin statujës dhe u dha kohë punëtorëve ta vinin në vend.

Por ai kishte edhe një zhdërvjelltësi, që ia kalonte fuqisë së tij. Disa të burgosur, ëndërrues të vazhdueshëm arratisjesh, arrijnë ta gërshetojnë fuqinë dhe shkathtësinë e t'i bëjnë ato një shkencë të vërtetë. Kjo është shkenca e muskujve. Të burgosurit praktikojnë përditë një statikë misterioze. Ata ua kanë gjithmonë zilinë mizave dhe zogjve. T'i qepej një shpati të pjerrët dhe të gjente pikambështetjeje atje ku mezi të zë syri një të dalë, kjo ishte vetëm si një lojë për Zhan Valzhanin. Në një qoshe muri, duke nderë dhe shtytur shpinën dhe kofshët, duke kllaposur bërrylat e thembrat në zgavërat e murit, ai ngjitej si me magji deri në katin e tretë. Disa herë, ai ngjitej kësisoj gjer në pullazin e burgut.

Për të folur, fliste pak. Për të qeshur, nuk qeshte kurrë. Duhej ndonjë tronditje shumë e madhe për t'i shkëputur, një a dy herë në vit, atë qeshje të përzishme prej të burgosuri. Po ta vije re, ai dukej sikur vështronte vazhdimisht diçka të tmerrshme.

Në të vërtetë, ai ishte zhytur në mendime.

Përmes perceptimeve të sëmura të një natyre të gjymtë dhe të një mendjeje të pikëlluar, ai ndiente vagët se diçka e përbindshme i qëndronte mbi krye. Në këtë mugëtirë të errët e të venitur ku zvarritej, sa herë që kthente qafën dhe përpiqej të ngrinte vështrimin e tij, ai shikonte, me një tmerr të përzier me tërbim tek përvijohej, bëhej stivë dhe lartohej sipër tij, në një lartësi sa s'ta ha syri, me ca rrëpira të llahtarshme, njëfarë turre e frikshme gjërash, ligjesh, paragjykimesh, njerëzish e ngjarjesh, përvijimet e së cilës s'i kapte dot me sy dhe madhësia

e së cilës i kallte frikën; ajo nuk ishte gjë tjetër veçse ajo piramida vigane që ne quajmë qytetërim. Ai shquante aty-këtu në këtë tërësi gëluese dhe të përçudnuar, herë pranë tij, herë larg e mbi rrafshina të paarritshme, ndonjë grup, ndonjë hollësi të ndriçuar fort, këtu rojtarin e burgut dhe shkopin e tij, aty xhandarin dhe shpatën e tij, atje tej arqipeshkvin me mitër në kokë, dhe fare lart, në majë, në një gjë si diell, perandorin me atë kurorën që të verbonte sytë nga shkëlqimi. Atij i dukej se këto shkëlqime të largëta jo vetëm që nuk ia davaritnin errësirën, por e bënë atë më të përzishme dhe më sterrë. Të gjitha këto gjëra, ligje, paragjykime, ngjarje, njerëz, sende, shkonin e vinin sipër tij, sipas lëvizjes së ndërlikuar dhe misterioze të qytetërimit, që ecën mbi të duke e dërrmuar nuk di se me çfarë qetësie në atë mizori dhe rreptësi, në atë moskokëçarje. Shpirtrat e rënë në fund të fatkeqësisë më të plotë, njerëzit fatkeqë të humbur honeve më të thella ku bota nuk i hedhin më sytë, njerëzit që vuajnë nga ligji, ndiejnë se si rëndon mbi kokën e tyre me të gjithë peshën e saj kjo shoqëri njerëzore, aq e hatashme për ata që janë jashtë saj dhe aq e frikshme për ata që janë nën të.

Në këtë gjendje, Zhan Valzhani rrinte e thurte ëndrra; po çfarë ëndrrash thurte ai?

Në qoftë se kokrra e melit do të kishte mendime, ajo, pa dyshim, do të mendonte po ato gjëra që mendonte edhe Zhan Valzhani.

Të gjitha këto gjëra, realitete plot fantazma, fantazmagorira plot realitete, kishin arritur, më në fund, të krijonin njëfarë gjendjeje të brendshme shpirtërore, e cila gati-gati nuk mund të shprehet me gojë.

Hope-hope, ai e ndërpriste punën që bënte në kamp dhe fillonte të mendonte. Mendja e tij, njëkohësisht më e pjekur dhe më e turbulluar se dikur, revoltohej. Çdo gjë që i kishte ngjarë, i dukej pa asnjë kuptim, çdo gjë që e rrethonte, i dukej e pamundshme. Ai thoshte me vete: “Jam në ëndërr”. Vështronte rojtarin në këmbë disa hapa larg tij; dhe rojtari i shëmbëllente me një fantazmë; papritmas, fantazma i jepte një të goditur me shkop.

Natyra e dukshme mezi ekzistonte për të. Do të ishte pothuajse e vërtetë, po të thoshe se për Zhan Valzhanin nuk kishte fare as diell, as ditë të bukura vere, as qiell rrezatues, as agime të freskëta prilli. Nuk di se çfarë drite e zbehtë, e ardhur nga një dritarez e vogël qilari, ndriçonte zakonisht shpirtin e tij.

Më në fund, për të përmbledhur ato që mund të përmbliidhen dhe të kthehen në përfundime pozitive të gjitha ato sa kemi thënë më parë, ne do të kufizohemi të konstatojmë se gjatë nëntëmbëdhjetë vjetëve, Zhan Valzhani, ai krasitësi i urtë i Favërolës, galeriani i tmerrshëm i Tulonit, falë mënyrës me të cilën burgu e kishte gatuar, ishte bërë i zoti për dy farë veprimesh të këqija: së pari, për një veprim të keq të shpejtë, të pamenduar, të hutuar dhe fund e krye nën shtytjen e instinktit, si njëfarë mase shpagimi për të keqen që kishte vajtuar; së dyti, për një veprim të keq, të rëndë, serioz, të rrahur mirë e mirë në ndërgjegje dhe të menduar thellë, por të pleksur me idetë e rreme që mund të krijojë një fatkeqësi e tillë. Paramendimet e tij kalonin përmes tri fazash të njëpasnjëshme, që vetëm natyrat me njëfarë brumosjeje të veçantë mund të përshkojnë dhe që janë: arsyetimi, vullneti, këmbëngulja. Ai kishte si shtytje lëvizëse zemërimin e zakonshëm, vrerin e shpirtit, ndjenjën e thellë të padrejtësive që kishte pësuar dhe kundërveprimin, madje dhe kundërveprimin ndaj njerëzve të mirë, të pafajshëm dhe të drejtë, nëse ka të tillë. Pikënisja, ashtu si dhe pikëmbërritja e të gjitha mendimeve të tij ishte urrejtja ndaj ligjit njerëzor; kjo urrejtje, e cila, në qoftë se nuk ndalet në vend në zhvillimin e saj nga ndonjë ndodhi e fatit, bëhet, në një moment të caktuar, urrejtje ndaj shoqërisë, pastaj urrejtje ndaj gjinisë njerëzore, pastaj urrejtje ndaj krijimit dhe kthehet në një dëshirë të errët, të paprerë dhe shtazore për t'i bërë keq cilitdo qoftë, cilësdo qenie të gjallë. Siç e shihni, nuk ishte pa vend që pasaporta e cilësonte Zhan Valzhanin si *njeri shumë të rrezikshëm*.

Nga viti në vit ai shpirt ishte tharë shumë e më shumë, ngadalë, por në mënyrë fatale. Zemra e tharë ka sy të thatë. Kur doli nga burgu, ai kishte nëntëmbëdhjetë vjet që s'kishte derdhur lot.

VIII

Vala dhe hija

Një njeri në det!

Punë e madhe! Anija nuk ndalet. Era fryn, ajo anije e errët atje tej ka një udhë, të cilën është e detyruar ta vazhdojë. Dhe kalon.

Njeriu zhduket, pastaj duket përsëri, zhytet dhe ngjitet përsëri në sipërfaqe, thërret, zgjat krahët, askush nuk e dëgjon; anija, që dridhet nga stuhia, ka hall të manovrojë, detarët dhe pasagjerët as nuk e shohin më njeriun e fundosur; koka e fatkeqit është vetëm një pikë në mes të valëve vigane.

Ai lëshon thellësive britma të dëshpëruara. Çfarë fantazme genka ai vel që shkon tutje! Ai e vështron, e vështron ethshëm. Veli largohet, zbehet, zvogëlohet. Qëpari, ai ishte aty, ishte pjesëtar i ekuipazhit, shkonte e vinte mbi urë të anijes tok me të tjerët, kishte dhe ai pjesën e tij të ajrit e të diellit, ishte dhe ai i gjallë në mes të të gjallëve. Por tani, ç'ndodhi vallë? Ai shkau, ra, humbi.

Ai është në ujin e përbindshëm. Nën këmbë ka vetëm zbrazëti dhe rrokullimë. Valët, që shqyhen e thërrmohen nga era, e mbështjellin për lemeri, lëvrimet e humnerës e rrëmbejnë, të gjitha laprat e ujit përpëliten rreth kokës së tij, një mizëri dallgësh pështynë mbi të, hone të ngatërruara e gllabërojnë përgjysmë; sa herë që kridhet, ai ajgëton greminën plot terr; bimësira të llahtarshme dhe të panjohura e kapin dhe e pushtojnë, ia lidhin këmbët, e tërheqin pas vetes; ai ndien se po bëhet humnerë, shkrihet e bëhet njësh me shkumën, tallazet e hedhin dhe e presin, ai pi ujin e hidhur farmak, oqeani burracak i është vënë ta mbytë e s'i ndahet, kjo stërmadhësi luan me agoninë e tij. Duket sikur gjithë ai ujë është urrejtje.

Megjithatë, njeriu lufton, orvatet të mbrohet, orvatet të mbahet, nën përpjekje, noton. Ai, forcë e shterur përnjëherësh, lufton kundër së pashtershmes.

Ku është, pra, anija? Atje tej. Mezi duket në terret e zbehta të horizontit.

Erërat fryjnë; të gjitha shkumat po e pllakosin dhe po e rraskapitin. Ai ngre sytë përpjetë dhe sheh vetëm zbehtësinë e reve. Sheh, duke hequr shpirt, ndërkyerjen e pakufishme të detit. Kjo ndërkyerje po e sflit. Dëgjon zhurmë të huaja për njeriun, zhurmë që duken sikur vijnë prej matanë dheut dhe s'di se nga çfarë jashtësie e frikshme.

Ka zogj sipër reve, por çfarë mund të bëjnë ata për të? Ata fluturojnë, këndojnë, rrëshqasin në ajër, kurse ai, ai gulçon.

Ai e ndien veten të mbështjellë nga këto dy pafundësi, nga oqeani dhe qielli; njëri është varr, tjetri është qefin.

Nata zbret, u bënë orë të tëra që njeriu po noton, forcat e tij po shterin; ajo anije, ajo gjë e largët, ku kishte njerëz, u zhduk; është fill i vetëm në honin e paanë e të mugët, zhytet, ngurtësohet, përdridhet, ndien nën vete valët përbindëshe të së padukshmes, thërret.

S'ka më njerëz.

Thërret: "Shpëtomëni! shpëtomëni!" Ai thërret gjithmonë.

Asgjë në horizont. Asgjë në qiell.

Njeriu u përlutet hapësirës, valës, leshterikut, gumës; por ato janë të shurdhra. I lutet stuhisë; stuhia e patundur i bindet vetëm pafundësisë.

Rreth tij, errësira, mjegulla, vetmia, gjurulldia rrebeshore dhe e pavetëdijshe, palat e pafundme të ujërave të egërsuara. Brenda tij, llahtara dhe lodhja. Poshtë tij, gremina. Asnjë pikëmbështetje. Ai përfytyron aventurat e sterrosura që kalon një kufomë në terrin e pakufishëm. Të ftohtët e pafund e paralizon. Duart e tij ngërthehen e mbyllen dhe kapin hiçin. Erëra, re, shakullima, afshe, yje të padobishme! Ç'të bëjë? I dëshpëruari e lëshon veten, ai është i rraskapitur vendos të vdesë, le të vejë ku të vejë, heq dorë, dhe ja ku merr rrokullimën përgjithmonë në thellësitë ogurzeza të përpjertes.

O ecje e papërkulshme e shoqërive njerëzore! Humbje njerëzish në udhë e sipër! Oqean ku bie gjithçka që ligji lë të bjerë! Zhdukje e kobshme e ndihmës! O vdekje morale!

Deti është nata e papërkulshme shoqërore, ku ndëshkimi flak të dënuarit e vet. Deti është mjerimi i paanë.

Shpirti, që rrëmbehet në këtë humnerë, mund të bëhet një kufomë.

IX

Helme të reja

Kur erdhi ora të dilte nga burgu, kur Zhan Valzhani dëgjoi në vesh këtë fjalë të çuditshme: "Je i lirë!", çasti ishte i papërngjashëm dhe i padëgjuar, një rreze drite e fortë, një rreze e dritës së vërtetë të të gjallëve e përshkoi atë papritmas. Por kjo rreze nuk mënoi të zbehej. Zhan Valzhanit i ishin marrë sytë nga ideja e lirisë. Ai kishte besuar në një jetë të ré. Por e pa shpejt se çfarë ishte ajo liri e pajisur me një pasaportë të verdhë.

Dhe rreth kësaj lirie shumë helme. Ai kishte llogaritur se shuma që kishte mbledhur gjatë qëndrimit të tij në burg duhej të arrinte në njëqind e shtatëdhjetë franga. Është e udhës të shtojmë se ai kishte harruar të përfshinte në këto llogari pushimin e detyruar të të dielave dhe të festave, pushim i cili, për nëntëmbëdhjetë vjet, sillte një ulje prej afro njëzet e katër frangash. Sidoqë të që, kjo shumë kishte qenë katandisur, me anë të ca ndalesave lokale, në njëqind e nëntë franga e pesëmbëdhjetë *su*, që iu numëruan në dorë kur doli.

S'kishte marrë vesh asgjë në këtë punë dhe i që mbushur mendja se ia kishin hedhur. Le ta themi troç se e kishin vjedhur.

Të nesërmen e lirimit, në Grasë, ai pa përpara portës së një distilerie lulesh portokalli disa burra që po shkarkonin dengje. Kërkoi që të shërbente edhe ai. Puna s'priste, prandaj e pranuan. Dhe iu përvesh punës. Ai ishte i zgjuar, i fuqishëm dhe i shkathët; punonte si jo më mirë; i zoti i fabrikës dukej i kënaqur. Ndërsa ishte duke punuar, kaloi aty një xhandar, e vuri ré dhe i kërkoi dokumentet. Iu desh të tregonte pasaportën e verdhë. Si mbaroi kjo, Zhan Valzhani e filloi përsëri punën. Pakëz më parë, ai kishte pyetur njërin prej punëtorëve se sa fitonin në ditë me këtë punë; punëtori ishte përgjigjur. "Tridhjetë *su*". Kur erdhi mbrëmja, meqë ishte i detyruar të nisej të nesërmen në mëngjes, ai u paraqit te pronari i distilerisë dhe iu lut ta paguante. Pronari s'nxori asnjë fjalë nga goja dhe i dorëzoi njëzet e pesë *su*. Ai kundërshtoi. Pronari iu përgjigj: "Hajde se mjaft i ke këto". Ai nguli këmbë. Pronari e vështroi

mu në bebe të syrit dhe i tha: "Mblidh mendjen, se ja burgu!"

Edhe në këtë rast ai mendoi se e kishin vjedhur.

Shoqëria, shteti, duke ia zvogëluar shumën e fituar dhe të kursyer, e kishin vjedhur me shumicë. Tani i kishte ardhur radha individit, që po e vidhte me pakicë.

Lirimi nuk është çlirim. Njeriu shpëton nga burgu, por jo nga ndëshkimi.

Ja, kjo i ndodhi në Grasë. Por e pamë edhe se si e pritën në Dinjë.

X

Njeriu që zgjohet nga gjumi

Kështu pra, kur po binte ora dy e mëngjesit në sahatin e katedrales, Zhan Valzhani u zgjua. U zgjua, sepse shtrati ishte tepër i mirë. Po mbusheshin njëzet vjet që s'kishte fjetur në shtrat, dhe, megjithëse nuk ishte zhveshur, ndjesia ishte tepër e re për të mos ia turbulluar gjumin.

Kishte fjetur më shumë se katër orë. Lodhja i kishte kaluar. Ai qe mësuar që të mos harxhonte shumë orë për çlodhje.

Hapi sytë dhe vështroi një hop në errësirën rreth e rrotull, pastaj i mbylli prapë për të fjetur.

Kur shumë ndjesira të ndryshme ta kanë turbulluar ditën, kur shumë gjëra ta shqetësojnë mendjen, mund të të zërë gjumi, por, po u zgjove, s'mund të flesh më. Gjumi vjen më lehtë, por rikthehet me vështirësi. Kjo i ndodhi edhe Zhan Valzhanit. Nuk e zuri më gjumi, prandaj filloi të mendonte.

Ishte një nga ato çaste kur idetë që ka në kokë njeriu janë të turbullta. Ai kishte njëfarë ecejake në trurin e vet. Kujtimet e vjetra dhe ato të rejtat pluskonin aty lesh e li dhe kryqëzoheshin ngatërrueshëm, duke humbur trajtë, duke u zmadhuar pa masë dhe duke u zhdukur pastaj sakaq si në ujin amull dhe të trazuar. Atij i vinin shumë mendime në kokë, por njëri i shfaqej vazhdimisht dhe i përzinte të tjerët. Këtë mendim do ta themi

menjëherë: ai kishte vënë re ato të gjashtë takëmet prej argjendi dhe atë lugën e madhe që zonja Magluarë pati vendosur mbi tryezë.

Këto gjashtë takëme s'e linin të qetë e s'i shkuleshin nga mendja. Ato ishin atje. Ca hapa më tej. Në çastin kur kishte kaluar nëpër dhomën ngjitur për të ardhur në këtë ku ishte, shërbyesja plakë po i vendoste në një dollap në krye të shtratit. E kishte vënë re mirë atë dollap. Në të djathtë, kur hyn nga dhoma e bukës. Ishin të rënda. Dhe, për më tepër, takëme argjendi të moçme. Me lugën e madhe mund të nxirrje së paku dyqind franga. Dyfishin e atyre që kishte fituar për nëntëmbëdhjetë vjet. Është e vërtetë se ai do të kishte fituar më tepër në qoftë se "*administrata* nuk do ta kishte vjedhur".

Mendja e tij u lëkund një orë të tërë në luhatje, ku përzihej edhe njëfarë luftime. Ora ra tre. I hapi sytë përsëri, u çua vrik ndenjor, shtriu krahun dhe preku torbën, që e kishte hedhur në qoshen e kthinës, pastaj vari këmbët dhe i lëshoi mbi dysheme, dhe u gjend, gati pa e ditur as ai sesi, i ulur mbi shtrat.

Ndenji një hop i menduar në këtë qëndrim, i cili do t'i ishte dukur si diçka e kobshme atij që do ta kishte parë asisoj në atë errësirë, vetëm, të zgjuar në atë shtëpi të përgjumur. Sakaq u përkul, i hoqi këpucët dhe i vendosi ngadalë mbi qilimkën pranë shtratit, pastaj mori prapë qëndrim ëndërrues dhe ndenji përsëri pa lëvizur.

Në mes të këtij mendimi të llahtarshëm, idetë që treguam më lart i lëvrinin pa prerë në tru; hynin, dilnin, hynin përsëri dhe i rëndonin sipër si një barrë; pastaj ai e çonte mendjen gjithashtu, pa e ditur përse, dhe me atë ngulmim e vetvetishëm të ëndërritjes, te një i burgosur i quajtur Brevet, që e kishte njohur në burg, i cili mbante pantallona me një aski të vetme prej një trikoje pambuku. Disenjoja katrore - katrore e kësaj askie i sillej pa pushim në mendje.

Ai po qëndronte në këtë gjendje, dhe do të kishte qëndruar kushedi sa gjatë, gjersa të lindte dielli, në qoftë se nuk do të kishte dëgjuar një goditje të sahatit - çerekun ose gjysmën e orës. U duk sikur kjo goditje i tha: "O burra!"

U çua në këmbë, ngurroi një hop dhe mbajti vesh: gjithçka

heshtte në shtëpi; atëherë ai eci përpara me hapa të vegjël drejt dritares, që vetëm sa e shquante. Nata nuk ishte shumë e errët; kishte hënë të plotë, mbi të cilën rrëshqitnin rrethet e mëdha, që i shtynte era. Kjo shkaktoi përjashta herë terr, herë ndriçim, herë eklipse, pastaj feksje dhe përbrenda njëfarë mugëtire. Kjo mugëtirë, që mjaftonte sa për të gjetur udhën, e ndërprerë për shkak të reve, i përngjiste asaj zbehtësie që zbret nga dritareza e një qilari, përpara të cilit shkojnë e vijnë kalimtarë. Kur arriti te dritarja, ai e këqyri mirë. Dritarja s'kishte shufra hekuri, shikonte nga kopshti dhe ishte e mbyllur, sipas zakonisht të vendit, vetëm me një mandallëz. E hapi, por, meqenëse hyri me turr një erë e ftohtë dhe e fortë në dhomë, e mbylli përsëri menjëherë. Ai e vështroi kopshtin me atë vështrim të vëmendshëm, i cili më shumë studion sesa vështron. Kopshti ishte i rrethuar me një mur të bardhë mjaft të ulët, që mund të kapërcehej lehtë. Në fund, nga ana tjetër, ai dalloi disa maja pemësh, të vendosura në largësi të barabarta, gjë që tregonte se ky mur ndante kopshtin nga një bulevard ose rrugicë e mbjellë me pemë.

Pasi e hodhi këtë vështrim, ai bëri lëvizjen e një njeriu që i është mbushur mendja top, shkoi në kthinë, mori çantën, e hapi, kërkoi brenda, nxori soje një diçka që e vendosi mbi shtrat, vuri këpucët në njërin xhep, i mbylli përsëri të gjitha, ngarkoi çantën në kurriz, vuri kasketën dhe rrsi strehën mbi sy, kërkoi shkopin duke prekur verbtazi dhe vajti dhe e vendosi te qoshja e dritares, pastaj u kthye prapë te shtrati dhe kapi me vendosmëri sendin që kishte lënë aty. Kjo i përngjiste një shufre të shkurtër hekuri, të mprehur si ndonjë shish në njërin nga majat e saj.

Do të kishte qenë e vështirë të dalloje në terr për çfarë përdorimi mund të kishte qenë përpunuar ajo copë hekuri. A mos ishte ndoshta ndonjë levë? A mos ndoshta ishte ndonjë topuz? Ditën në dritë mund të dalloje që ajo s'ishte gjë tjetër veçse një qysqi minatori.

Asokohe të burgosurit i vinin të nxirrnin gurë nga kodrat e larta që rrethojnë Tulonin dhe shpesh ata përdornin vegla minatorësh. Qysqitë e minatorëve janë prej hekuri, me majëz

në fund, me anë të së cilës i ngulin në shkëmb.

E mori qysqinë në dorën e djathtë dhe, duke mbajtur frymën, duke ecur lehtë, u drejtua për nga dera e dhomës fqinje, dhomës së ipeshkvi, siç dihet. Kur arriti te kjo derë, ai e gjeti të hapur përgjysmë. Ipeshkvi s'e kishte mbyllur fare.

XI

Çfarë bën ai

Zhan Valzhani mbajti vesh. Asnjë zhurmë. Shtyu derën.

E shtyu me gisht, lehtë-lehtë, me butësinë rrëshqanore dhe plot ankth të asaj maces që kërkon të hyjë diku.

Dera iu bind shtytjes dhe bëri një lëvizje të pandjeshme dhe pa zhurmë, e cila e zgjeroi pakëz hapësirën.

Priti një hop, pastaj shtyu derën për të dytën herë më me guxim.

Ajo vazhdoi të bindej në heshtje. Hapësira ishte mjaft e madhe sa të mund të kalonte brenda. Por afër derës ndodhej një tryezë e vogël, e cila bënte me të një kënd pengues, që priste hyrjen.

Zhan Valzhani e kuptoi vështirësinë. Duhej me çdo kusht që hapësira të zgjerohej akoma.

E ndau mendjen dhe e shtyu derën për të tretën herë, me energji akoma më të madhe se dy herët e para. Kësaj radhe një menteshë e vajosur keq lëshoi befaz në këtë errësirë një gërvimë të mbytur dhe të zgjatur.

Zhan Valzhani u drodh i tëri. Zhurma e kësaj mentesheje i tingëlloi në vesh si një shpërthim i hatashëm, si buria e gjyqit të fundit.

Në zmadhimin fantastik të minutës së parë, iu duk gati-gati sikur kjo menteshë ishte ngjallur e kishte marrë befaz një jetë të tmerrshme dhe sikur po ulërinte si ndonjë qen për të lajmëruar të gjithë botën dhe për të zgjuar njerëzit që kishin rënë në gjumë.

U ndal duke u dridhur, i hutuar, dhe nga majat e këmbëve u ul mbi thembra. Dëgjonte se si i rrihnin damarët në tëmtha, si dy çekanë farkëtari, dhe i dukej sikur fryma i dilte nga gjoksi me zhurmën e erës që del nga ndonjë guvë. I dukej e pamundur që britma e hatashme e kësaj mentesheje të egërsuar të mos e kishte tundur të gjithë shtëpinë si ndonjë lëkundje tërmeti; dera që ai shtyu kishte dhënë kushtrimin dhe lëshuar berihanë; plakuri do të zgjohej, të dyja plakat do të bërtisnin, bota do të vraponte për ndihmë; pa kaluar çereku i orës qyteti do të gumëzhinte dhe xhandarmëria do të ishte e tëra në këmbë. Për një çast ai kujtoi se e mori lumi.

Ngriu në vend, si statujë prej kripe, duke mos guxuar të bënte asnjë lëvizje. Kaluan disa minuta. Dera ishte hapur fare. Kuturisi e vështroi brenda në dhomë. Asgjë s'kishte luajtur. Mbajti vesh. Asgjë s'lëvizte në shtëpi. Zhurma e menteshës së ndryshkur nuk kishte zgjuar asnjëri.

Ky rrezik i parë kishte kaluar, por ai ndiente brenda vetes një gumëzhitje të tmerrshme. Megjithatë, ai nuk bëri prapa. Bile, ai nuk ishte zbrapsur as kur kujtoi se ishte i humbur. S'donte gjë tjetër veç t'i jepte fund sa më shpejt. Bëri një hap dhe hyri në dhomë.

Në atë dhomë mbretëronte një qetësi e plotë. Dalloheshin aty-këtu ca forma të vagëta dhe të turbullta, të cilat ditën në dritë ishin letra të shpërndara mbi një tryezë, disa in-folio të hapura, disa vëllime të stivosura mbi një stol, një kolltuk i ngarkuar me rroba për të veshur, një fron lutjesh, të cilat në këtë çast dukeshin vetëm si disa skuta të errëta dhe vende të zbardhëlyera.

Zhan Valzhani bëri përpara me kujdes, duke u ruajtur se mos përpiquej pas mobiljeve. Ai dëgjonte frymëmarrjen e qetë dhe të barabartë të ipeshkvit, që po flinte.

Befas u ndal në vend. Ishte afër shtratit. Kishte arritur më shpejt sesa kujtonte.

Natyra ndonjëherë i ngatërron efektet dhe shfaqjet e saj me veprimet tona me njëfarë rastësie të errët e të zgjuar, a thua se don të na bëjë t'i vëmë gishtin kokës e të mendojmë. Kishte afro një gjysmë ore që një ré e madhe mbulonte qiellin. Në çastin

kur Zhan Valzhani u ndal përballë shtratit, kjo re u çor, sikur ta kishte bërë enkas, dhe një rreze hëne, duke përshkuar dritaren e gjatë, erdhi e ndriçoi menjëherë fytyrën e zbehtë të ipeshkvit. Ai flinte qetë. Ishte gati i veshur në shtrat, për shkak të netëve të ftohta të Alpeve të Ulëta, me një veshje të lehtë ngjyrë të murrme, që i mbulonte krahun gjer te kyçi i dorës.

Koka e tij ishte lëshuar mbi jastëk në qëndrimin e flashkët të çlodhjes; ai kishte varur dorën e zbukuruar me unazën baritore.

Zhan Valzhani ishte në errësirë, me qysqinë e hekurit në dorë, në këmbë, i palëvizur, plot frikë nga ky plak, që flakëronte dritë. S'kishte parë kurrë një gjë të tillë. Ky besim i kalte frikën. Bota morale nuk ka shfaqje më të madhe se kjo: një ndërgjegje e turbulluar dhe e shqetësuar, që kishte mbërritur në buzë të një veprimi të keq e që sodiste gjumin e një njeriu të drejtë.

Ai gjumë, në atë vetmi dhe me një fqinjë të atillë si ai, kishte diçka të madhërishme, të cilën ai e ndiente në mënyrë të vagët, por në mënyrë urdhëruese.

Askush s'do të mund të thoshte se çfarë po ngjiste brenda tij, bile as ai vetë. Që të mund ta kuptosh, duhet të marrësh me mend gjënë më të dhunshme ballë për ballë me atë më të ëmblën, mbi fytyrën e tij s'mund të dalloje asgjë me siguri. Ishte njëfarë habie e çakërdisur. Ai vështroi fytyrën e ipeshkvit. Asgjë tjetër. Por ç'mendonte vallë? Do të ishte e pamundur ta diktoje. Ajo që dukej çiltazi, ishte se ai vetë që i tronditur dhe i dërrmuar. Por e çfarë natyre ishte kjo tronditje?

Syri i tij nuk shkulej dot nga plakuri. E vetmja gjë që shquhej qartë nga qëndrimi dhe fizionomia e tij, ishte një pavendosmëri e çuditshme. Të thoshte mendja se ai ngurronte midis dy greminave, midis asaj ku bie e humbet dhe asaj nga ku shpëton. Dukej sikur ishte gati ta thyente atë kafkë ose ta puthte atë dorë.

Pas disa çastesh, krahu i tij i majtë u ngrit ngadalë drejt ballit të tij dhe hoqi kasketën, pastaj krahu i tij u ul me të njëjtën ngadalësi, dhe Zhan Valzhani filloi përsëri të tretej në soditje, me kasketën në dorën e majtë, me qysqinë në dorën e djathtë, me flokët të ngritur drizë përpjetë mbi kokën e tij të hakërryer.

Befas Zhan Valzhani e vuri përsëri kasketën në kokë, pastaj eci shpejt përgjatë shtratit, pa ia hedhur sytë ipeshkvit, drejt e te dollapi, që e ajgëtonte afër kreut të shtratit; ngriti qysqinë e hekurt si për të thyer bravën; çelësi ishte në bravë; e hapi; gjëja e parë që i zuri syri, ishte kanistra me takëmet e argjendta; e mori kanistrën, kaloi përmes dhomës me hapa të mëdhenj, pa farë kujdesjeje dhe, pa e çarë kokën për zhurmën, arriti te dera, hyri në oratorio, hapi dritaren, kapi shkopin, shaloi pezulin e dritares, vuri argjendarinë në çantë, flaku kanistrën, kapërceu kopshtin, kërceu sipër murit si ndonjë tigër dhe ua mbathi këmbëve.

XII

Ipeshkvi punon

Të nesërmen, me të lindur dielli, imzot Bienvënyi po shëtiste në kopshtin e vet. Zonja Magluarë ngau tek ai si e çakërdisur.

-Imzot, imzot, - klithi ajo, - a e di hirësia juaj se ku është kanistra e argjendëve?

-Po, - tha ipeshkvi.

-I bekuar qoftë Jezu Krishti! - vazhdoi ajo. - Nuk e dija se ç'ishte bërë.

Ipeshkvi sapo kishte ngritur kanistrën nga një lehe e kopshtit dhe ia tregoi zonjës Magluarë.

-Ja ku është.

-Po si? - tha ajo. - S'paska gjë brenda! Po argjendet?

-Ah! - ia priti ipeshkvi. - Për argjendet shqetësoheni? Nuk e di se ku janë.

-O Zot i madh e i mëshirshëm! Na i paskan vjedhur! I paska vjedhur ai që na erdhi mbrëmë!

Sa hap e mbyll sytë, me të gjithë gjallërinë e një plake të shkathët, zonja Magluarë ngau për në oratorio, hyri në kamaren e shtratit dhe u kthye përsëri te ipeshkvi. Ipeshkvi sapo ishte ulur dhe po vështronte duke psherëtirë një bisk luleje të thyer

nga kanistra që kishte rënë në mes të kopshtit. Ai u çua në këmbë kur dëgjoji klithmën e zonjës Magluarë.

-Imzot, ai burri paska ikur! Na paska vjedhur argjendet!

Teksa po lëshonte këtë britmë, asaj i vajtën sytë në një kënd të kopshtit ku dukeshin gjurmë shkapërcimi. Brezi i avllisë ishte shkullur.

-Ja! Që andej paska ikur! Paska kërcyer në rrugëzën "Shosëfilet!" Ah! I mallkuari! Na paska vjedhur argjendet!

Ipeshkvi qëndroi një hop në heshtje, pastaj ngriti sytë plot seriozitet dhe i tha zonjës Magluarë me të butë:

-Para së gjithash, ato argjende a ishin tonat?

Zonja Magluarë shtangu në vend. Vazhdoi heshtja edhe për një hop, pastaj ipeshkvi vazhdoi:

-Zonja Magluarë, ato argjende unë kam kohë që i mbaj dhe me të padrejtë. Ato u përkisnin të varfërve. Ç'ishte ai njeri? Një i varfër, me siguri.

-Ajmé, o zoti Krisht! - ia ktheu zonja Magluarë. - S'e kam as për vete, as për zonjushën. Aq na bën neve. Por e kam për imzotin. Me se do të hajë tani imzoti?

Imzoti e vështroi me çudi.

-Ah! Ashtu! Po pse, nuk ka lugë kallaji?

Zonja Magluarë ngriti supet.

-Kallaji ka një erë.

-Atëherë, prej hekuri.

Zonja Magluarë bëri një ngërdheshje plot kuptim.

-Hekuri ka një amëz.

-Po mirë, - tha ipeshkvi, - atëherë prej druri.

Pas disa çastesh, ai ishte duke ngrënë mëngjesin po në atë tryezë ku Zhan Valzhani kishte qenë ulur natën e kaluar. Teksa hante, imzot Bienvënyi u thoshte plot gaz së motrës, që s'thoshte asgjë, dhe zonjës Magluarë, që murmuriste nëpër dhëmbë, se nuk duheshin aspak as lugë, as pirunë, qoftë edhe prej druri, për të ngjyer copën e bukës në tasin e qumështit.

-Pse mendje i thonë kësaj? - thoshte zonja Magluarë vetë me vete duke vajtur e ardhur, - ta presësh tjetrin kështu! Dhe t'i bësh jatak aty pranë vetes! Moj mirë që vetëm vodhi e s'bëri

ndonjë të pabërë! Ah! O Zot, o perëndi! Të dridhet mishtë kur e mendon!

Ndërsa motra dhe vëllai po bëheshin gati të ngriheshin nga tryeza, dikush trokiti te porta.

-Hyni, - tha ipeshkvi.

Porta u hap. Një grup i çuditshëm dhe i rrëmbyeshëm u duk te pragu. Tre burra mbanin një të katërt për zverku. Të tre burrat ishin xhandarë; i katërti që Zhan Valzhani.

Një rreshter xhandarmërie, që dukej se udhëhiqte grupin, ishte afër portës. Hyri brenda dhe bëri përpara drejt ipeshkvit, duke nderuar ushtarakisht.

-Imzot,... - tha ai.

Me këtë fjalë, Zhan Valzhani, që ishte i zymtë dhe dukej i rraskapitur, ngriti kokën me habi.

-Imzot! - murmuriti ai. - S'qenkeni famullitar?

-Mbyll gojën! - tha një xhandar. - Ky është imzot ipeshkvi.

Ndërkohë, imzot Bienvényi ishte afruar me të shpejtë, aq sa ia lejonte mosha e tij e thyer.

-Ah! Këtu qenkeni! - bërtiti ai duke vështruar Zhan Valzhanin. - Më bëhet qejfi që po ju shoh. More, por unë ju kisha dhënë edhe shandanët, që janë prej argjendi si ato të tjerat dhe me të cilët mund të bënit fare mirë dyqind franga. Pse nuk i paskeni marrë tok me takëmet?

Zhan Valzhani hapi sytë dhe vështroi të përndershmin ipeshkv me një shprehje të cilën asnjë gjuhë njerëzore s'do të mund ta shprehte.

-Imzot, - tha rreshteri i xhandarmërisë, - domethënë ato që thoshte ky njeri paskan qenë të vërteta? Ne e takuam udhës. Ishte duke ecur sikur po e ndiqte njeri. E ndalëm për të parë. Kishte me vete këto argjende...

-Dhe ju tha, - e ndërpreu ipeshkvi duke buzëqeshur, - se këto ia kishte dhënë një prift babëlok plak, tek i cili kishte kaluar natën? Tani i rashë më të. Dhe ju e sollët këtu? Ky është një keqkuptim.

-Kështu që, - vazhdoi rreshteri, - mund ta lëmë të lirë të shkojë?

-Pa dyshim, - tha ipeshkvi.

Xhandarët e lëshuan Zhan Valzhanin, i cili u zbyth.

-Është e vërtetë që po më lëshojnë? - tha ai me një zë gati të shuar dhe sikur fliste nëpër gjumë.

-Po, po të lëshojmë, a nuk dëgjon? - tha një xhandar.

-Miku im, - vazhdoi ipeshkvi, - përpara se të largoheni së këtejmi, ja dhe shandanët. Merrini.

Vajti tek oxhaku, mori dy shandanët prej argjendi dhe ia pruri Zhan Valzhanit. Të dyja gratë po vështronin pa nxjerrë asnjë fjalë, pa bërë asnjë lëvizje, pa lëshuar asnjë vështrim që mund ta trazonte ipeshkvin.

Zhan Valzhanit i dridheshin të gjitha gjymtyrët. I mori të dy shandanët mekanikisht dhe me një pamje të çakërdisur.

-Tani, - tha ipeshkvi, - shkoni i qetë. Meqë ra fjala, kur të vini herë tjetër, o miku im, s'keni pse të kaloni nga kopshti. Mund të hyni e të dilni nga porta e rrugës. Ajo është e mbyllur vetëm me një mandallëz, ditë e natë.

Pastaj, duke u kthyer nga xhandarët:

-Zotërinj, mund të shkoni.

Xhandarët u larguan.

Zhan Valzhanit sa s'po i binte të fikët.

Ipeshkvi iu afrua dhe i tha me zë të ulët:

-Mos harroni, mos harroni kurrë se më keni dhënë fjalën që do ta përdorni këtë argjend për t'u bërë njeri i ndershëm.

Zhan Valzhani, të cilit s'i binte hiç ndër mend të kishte premtuar gjë, shtangu në vend. Ipeshkvi u mëshoi këtyre fjalëve kur i shqiptoi. Ai vazhdoi me njëfarë solemniteti:

-Zhan Valzhan, vëllai im, tani ju nuk jeni më rob i së keqes, por i takoni së mirës. Unë po jua blej shpirtin me këto; unë po e largoj shpirtin tuaj nga mendimet e errëta dhe nga fryma e shprishjes.

XIII

Zhervezi i Vogël

Zhan Valzhani doli nga qyteti, sikur të donte të shpëtonte nga burgu.

Nisi të ecte me nxitim të madh nëpër ara, duke marrë udhët e monopatat që i dilnin përpara, pa vënë re se në çdo çast ai po kthehej përsëri andej nga kishte ardhur. U end ashtu gjithë mëngjesin, pa ngrënë, por edhe pa ndier uri. Atë e kishin pllakosur një mori ndjesish të reja. Ndiante përbrenda njëfarë zemërimi, por as ai s'e dinte se kundër kujt. As vetë s'e dinte nëse ishte i prekur në zemër apo i poshtëruar. Hope-hope i hipte ndonjë ndjenjë e çuditshme butësie, të cilën e luftonte dhe i vinte përballë ashpërimitin e njëzet vjetëve të fundit. Kjo gjendje e lodhte. Ai shihte me ankth se po i lëkundej në brendësinë e tij ajo farë qetësie e llahtarshme që i kishte kallur padrejtësia e fatkeqësisë së tij. Pyeste vetveten se kush do t'ia zinte vendin kësaj. Ngandonjëherë, i vinte të ishte më mirë në burg me xhandarët dhe që punët të mos kishin ndodhur asisoj; kjo do ta kishte shqetësuar më pak. Megjithëse stina ishte shtyrë mjaft, aty-këtu nëpër gjerde kishte akoma nga ndonjë lule të vonë, era e së cilës, kur kalonte pranë, i sillte kujtime të fëmijërisë. Këto kujtime gati-gati i dukeshin të padurueshme, ngaqë kishte kaq kohë që nuk i qenë shfaqur.

Mendime të pashpjegueshme iu grumbulluan e iu bënë kështu lëmsh gjatë gjithë asaj dite.

Teksa dielli po ulej nga perëndimi, duke zgjatur mbi tokë edhe hijen e gurit më të vogël, Zhan Valzhani ishte ulur prapa një ferre në një fushë të madhe, të kuqërreme dhe krejt të shkretë. Në horizont dukeshin vetëm Alpet. Nuk dukej as kambanorja e ndonjë fshati të largët. Zhan Valzhani mund të ishte nja tri lega larg Dinjës. Një monopati, që priste fushën, kalonte disa hapa larg ferrës.

Në mes të këtij meditacioni, i cili s'do të kishte ndihmuar pak që ato zhele t'i dukeshin edhe më të frikshme ndonjërit që do të kalonte andej pari, ai dëgjoji një zhurmë të gëzuar.

Ktheu kokën dhe pa tek po vinte një savojas²⁰⁾ nja dhjetë vjeç, i cili po këndonte me violinën nën ije dhe me kutinë e marmotave²¹⁾ në kurriz; ishte një nga ata fëmijë të ëmbël dhe të gëzuar që venë nga një krahinë në tjetrën, me gjunjët që u duken nga vrimat e pantallonave të grisura.

Gjithë duke kënduar, fëmija e ndalte kohë më kohë të ecurit dhe luante si me ashikë me disa copë monedha që kishte në dorë dhe që ndoshta ishin gjithë pasuria e tij. Midis këtyre monedhave ishte një para dyzetsushe.

Fëmija u ndal bri ferrës, pa e parë Zhan Valzhanin, dhe i hodhi përpjetë *sutë*, të cilat gjer asaj radhe i kishte pritur me mjaft shkathtësi të gjitha në kurriz të dorës.

Kësaj here, monedha dyzetsushe i shpëtoi dhe erdh e u rrokullis drejt ferrës gjer te Zhan Valzhani.

Zhan Valzhani i vuri këmbën sipër.

Ndërkohë fëmija e kishte ndjekur monedhën me sy dhe e kishte parë.

Ai nuk u habit aspak dhe eci drejt njeriut.

Ishte një vend krejt i vetmuar. Sa të hante syri s'kishte njeri të gjallë, as në fushë, as monopati. Dëgjoheshin vetëm cicërimat e vogla dhe të dobëta të një trumbe zogjsh kalimtarë që përshkonin qiellin shumë lart. Fëmija i kishte kthyer shpinën diellit, i cili po i qëndiste fije ari në flokët dhe përkuqte në një dritë të përgjaktë fytyrën e egër të Zhan Valzhanit.

-Zotëri, - tha savojasi i vogël me atë besim fëmijësh të gatuar me padijeninë dhe pafajësinë, - mos e patë paranë time?

-Si të quajnë? - tha Zhan Valzhani.

-Zhervez i Vogël, zotëri.

-Hiq këtej, - tha Zhan Valzhani.

-Zotëri, - vazhdoi fëmija, - më jepni paranë time.

Zhan Valzhani uli kryet dhe nuk ktheu përgjigje.

Fëmija nisi përsëri:

-Paranë, zotëri.

Syri i Zhan Valzhanit mbeti i mbërthyer përdhé.

²⁰⁾ Një arkëz e përbërë prej dy pjesësh që futen brenda njëra-tjetrës.

-Paranë! - bërtiti fëmija, - paranë time të bardhë! Të hollat e mia!

Dukej se Zhan Valzhani s'dëgjonte hiç nga këto. Fëmija e kapi për jake të bluzës dhe e tundi. Dhe, në të njëjtën kohë, bënte përpjekje për ta lëvizur vendit atë këpucën e madhe me gozhdë që ishte vendosur mbi thesarin e tij.

-Dua paranë! Paranë time dyzetsushe!

Fëmija po qante. Zhan Valzhani ngriti kokën. Ai ishte gjithmonë ulur. Sytë i kishte të turbullt. E vërejti fëmijën me njëfarë habie, pastaj zgjati dorën nga shkopi dhe bërtiti me një zë të tmerrshëm.

-Kush është aty?

-Unë, zotëri, - u përgjigj fëmija. - Zhervezi i Vogël! Unë! Unë jam! Më jepni të dyzet sutë, ju lutem! Hiqeni këmbën, zotëri, ju lutem!

Pastaj, i inatosur, ndonëse fare i vogël, dhe duke u bërë gati-gati kërcënues:

-Ah! Për besë, do ta hiqni atë këmbë, apo jo? E pra, hiqeni një herë atë këmbë!

-Ah! Prapë ti qenke! - tha Zhan Valzhani dhe, duke brofur i tëri përpjetë e duke mbajtur gjithmonë këmbën mbi monedhën e argjendtë, shtoi: - Do ta këputësh qafën, apo si e ke hallin!

Fëmija u tremb, e vështroi dhe pastaj filloi të dridhej nga koka gjer te këmbët dhe, pas disa sekondash shastisjeje, ua mbathi këmbëve mesa fuqi që kishte, pa guxuar të kthente kokën, as të lëshonte ndonjë britmë.

Por pas njëfarë largësie, atij iu mor fryma dhe u detyrua të ndalej. Dhe Zhan Valzhani, përmes ëndërrimit të vet, e dëgjonte tek dëneste.

Pas një hopi, fëmija që zhdukur.

Dielli kishte perënduar.

Nata po binte rreth Zhan Valzhanit. Gjithë ditën e ditës ai s'kishte shtënë gjë në gojë; kishte të ngjarë që të ishte në ethe.

Zhan Valzhani ishte në këmbë dhe nuk kishte ndërruar qëndrim qëkurse fëmija ishte larguar. Frymëmarrja ia ngrinte kraharorin me intervale të gjata dhe të pabarabarta. Vështrimi

i tij i ngulur dhjetë a dymbëdhjetë hapa përpara dukej se po studionte me një vëmendje të thellë formën e një cefle fajance të kaltër që kishte rënë mbi bar. Papritmas e zuri një e dridhur; sapo kishte ndier t'i hynte të ftohtët e mbrëmjes.

Rrasi kasketën mbi ballë, kërkoi ashtu si kot të mbërthente e të kopsiste bluzën, bëri një hap dhe u ul për të marrë përdhë shkopin e tij.

Në këtë çast, atij i vajtën sytë te monedha dyzetsushe, që e kishte rrasur përgjysmë në dhé me këmbë dhe që shndriste në mes të zallit. Kjo gjë i shkaktoi atij një si dridhje korrenti.

-Ç'është kjo? - tha ai nëpër dhëmbë.

U zbyth tre hapa, pastaj qëndroi pa e shkukur vështrimin e vet nga ajo pikë mbi të cilën pati vënë këmbën një hop më parë, sikur ajo gjë që shndriste atje në errësirë të ishte një sy i hapur, i mbërthyer mbi të.

Pas disa minutash, ai u turr si i çakërdisur drejt monedhës së argjendtë, e kapi dhe, duke u ngritur përsëri, filloi të vështronte andej larg në fushë, duke hedhur sytë njëkohësisht drejt të gjitha pikave të horizontit, duke qëndruar në këmbë dhe duke u dridhur si një shtazë e egër e trembur që kërkon ndonjë strofkë ku të futë kokën.

Ai s'pa asgjë. Nata po binte, fusha ishte e ftohtë dhe e vagët, mjegullina të mëdha ngjyrë vjollce ngjiteshin përpjetë në dritën e mugëtirës.

Lëshoi një ah! dhe nisi të ecte me shpejtësi në njëfarë drejtimi, nga ana ku fëmija që zhdukur. Pas ndonja njëqind hapash, ai qëndroi; vështroi dhe s'pa gjë.

Atëherë thirri mesa fuqi që pati: "Zhervez i Vogël! Zhervez i Vogël!"

Heshti dhe priti.

Asgjë s'u përgjigj.

Fusha ishte e shkretë dhe e zymtë. Zhan Valzhanin e kishte rrethuar errësira. Asgjë s'kishte përreth veçse një hije ku humbiste vështrimi i tij dhe një heshtje ku humbiste zëri i tij.

Frynte një thëllim i akullt dhe u jepte gjërave përreth njëfarë jete kobzezë. Ca shkurre tundnin krahët e tyre të vegjël

e thatimë me një furi të pabesueshme. A thua se po kërcënonin e po ndiqnin dikë.

Nisi përsëri të ecte, pastaj u vu të vraponte e kohë më kohë ndalej dhe thërriste në këtë shkretëtirë me një zë që s'kishte ku të vente më i hatashëm e më i pikëlluar: "Zhervez i Vogël! Zhervez i Vogël!"

Me siguri që, po ta kishte dëgjuar, fëmija do të ishte frikësuar dhe s'do të kishte pasur guxim të shfaqej. Por fëmija tanimë ishte pa dyshim shumë larg.

Takoi një prift mbi kalë. Vajti tek ai dhe i tha:

-Zoti famullitar, mos patë të kalonte një fëmijë?

-Jo, - tha prifti.

-Një të quajtur Zhervez i Vogël?

-S'kam parë njeri.

Zhan Valzhani nxori nga qesja dy monedha pesëfrangëshe dhe ia dorëzoi priftit.

-Zoti famullitar, merrini këto për të vobektit tuaj. Zoti famullitar, është një vogëlush nja dhjetë vjeç që ka një marmotë, besoj, dhe një violinë. Po ecte udhës. Ishte një nga ata savojasit, e dini?

-S'kam parë fare.

-Zhervezin e Vogël? S'qenka nga fshatrat këndeje? A mund të më tregoni?

-Në qoftë kështu si thoni, mor mik, ai është fëmijë i huaj. Kësi fëmijësh kalojnë këtyre anëve. Por s'i njeh njeri.

Zhan Valzhani mori me turr dy monedha të tjera pesëfrangëshe dhe ia dha priftit.

-Për të vobektit tuaj, - tha ai.

Pastaj shtoi si i çakërdisur:

-Zoti abat, thirrni të më arrestojnë. Unë jam vjedhës.

Prifti u mëshoi të dy mamuzeve dhe ia mbathi shumë i trembur.

Zhan Valzhani filloi përsëri të vraponte në drejtimin që kishte marrë më parë.

Ai bëri kësioj një udhë mjaft të gjatë, duke vështruar e duke thirrur, por nuk takoi njeri. Dy a tri herë ai vrapoi fushës drejt ndonjë gjëje që i dukej si qenie e gjallë që rrinte shtrirë

ose në bisht; por këto s'ishin tjetër veçse ferra ose shkëmbinj që nxirrnin krye mbi tokë. Më në fund, në një vend ku kryqëzoheshin tri monopate, ai qëndroi. Hëna ishte ngritur në qiell. Ai solli vështrimin larg dhe thirri për herë të fundit: "Zhervez i Vogël!" Britma e tij u shua në mjegull, pa shkaktuar madje as ndonjë jehonë. Murmuriti akoma: "Zhervez i Vogël! Zhervez i Vogël!", por me një zë të dobët dhe gati të mekur. Kjo ishte përpjekja e tij e fundit; kofshët iu prenë dhe iu epën papritmas nën vete, sikur ndonjë fuqi e padukshme t'i kishte pllakosur befaz me peshën e ndërgegjes së saj të keqe; u rrëzua i rraskapitur mbi një gur të madh, me grushtet nëpër flokë dhe fytyrën ndër gjunjë, dhe bërtiti: "Mjerë unë i mjeri!"

Atëherë s'u përmbajt më dhe nisi të qante. Ishte e para herë që po qante që prej nëntëmbëdhjetë vjetësh.

Kur Zhan Valzhani kishte dalë nga shtëpia e ipeshkvit, siç e pamë, atij i kishin shkarë fare edhe ata pak tru që i kishin mbetur gjer atëherë. Nuk ishte në gjendje të kuptonte se çfarë po ngjiste brenda tij. Tendosej kundër veprimit engjëllor dhe fjalëve të buta të plakut. "Më keni premtuar të bëheni njeri i ndershëm". Kjo gjë i rrotullohej në kokë pa pushim. Ai vinte përkundër kësaj zemërgjerësie qiellore fodullëkun, i cili është brenda nesh, si kalaja e së keqes. Ai ndiente ashtu në tym se ndjesa e atij prifti ishte sulmi më i madh dhe goditja më e hatashme që e kishte tronditur ndonjëherë; ai ndiente se ashpërsia e tij do të ishte e përjetshme, në qoftë se do t'i bënte qëndresë asaj shpirtbutësie; se, po të jepej, do t'i duhej të hiqte dorë nga urrejtja, që e kishte aq fort për zemër dhe me të cilën i ishte mbushur shpirti gjatë sa e sa vjetëve nga veprimet e njerëzve; se kësaj here ai o do të fitonte, o do të mundej, dhe se lufta, një luftë vigane dhe vendimtare, kishte plasur midis ligësisë së tij dhe mirësisë së Bienvenyit.

Ballë gjithë këtyre dritave, ai ecte si ndonjë i dehur. Ndërsa ecte kështu, me sy të çakërritur, a kishte vallë ndonjë ndjesi të shkoqur se çfarë mund të dilte nga ngjarja që i kishte ndodhur në Dinjë? A i dëgjonte, vallë, ai të gjitha ato gumëzhitje misterioze që paralajmërojnë ose mërzitit shpirtin në disa çaste të jetës? A i thoshte vallë atij ndonjë zë në vesh se ai sapo e

kishte kaluar orën solemne të fatit të tij të ardhshëm, së s'kishte më udhë të mesme për të; se, në qoftë se tani e tutje nuk do të ishte më i miri i të mirëve, atëherë ai do të ishte më i keqi i të këqijve; se duhej, si të thuash, qysh tani të ngjitej më lart se ipeshkvi ose të binte përsëri më poshtë se i burgosuri; se, po të donte të bëhej i mirë, do të duhej të bëhej engjëll; se, po të donte të mbetej i keq, do të duhej të bëhej përbindësh?

Edhe këtu duhet t'ia bëjmë vetes ato pyetje që ia kemi bërë më përpara gjatë: a këpuste e përvetësonte vallë ai, ashtu më tym, ndonjë grimëz nga të gjitha këto në mendjen e tij? Sigurisht, fatkeqësia, e kemi thënë, ia mpreh mendjen njeriut dhe ia bën të hollë; por si zor që Zhan Valzhani t'i shkoqiste e t'i dallonte këto që po tregojmë këtu. Në qoftë se këto ide arrinin deri tek ai, ai këto më shumë i ajgëtonte sesa i shikonte, dhe ato nuk arrinin veçse ta zhytnin në një turbullim të padurueshëm dhe pothuajse të dhimbshëm. Kur doli nga ajo gjë e shëmtuar dhe e zezë që quhet burg, ipeshkvi ia kishte lënduar shpirtin, ashtu si një ndriçim tepër i fortë do t'ia kishte lënduar sytë duke dalë nga errësira. Jeta e ardhshme, jeta e mundshme që i dilte atij përpara, krejt e dëlirë dhe krejt rreze drite, e mbushte atë me dridhma dhe angushti. Ai nuk dinte se ku ishte. Ashtu si ndonjë kukuvajkë që do të shihte befas lindjen e diellit, të burgosurit i qenë marrë sytë dhe ishte bërë si i verbuar nga virtyti.

Ajo që ishte e sigurt, dhe për këtë ai nuk dyshonte fare, ishte se ai nuk që më po ai njeri, se gjithçka kishte ndryshuar në veten e tij, se nuk e kishte më në dorë të bënte sikur ipeshkvi të mos i kishte folur e të mos e kishte prekur.

Në këtë gjendje shpirtërore, ai kishte takuar Zhervezin e Vogël dhe ia kishte vjedhur të dyzet *sutë*. Pse? Sigurisht që ai nuk ishte në gjendje ta shpjegonte: mos ishte ky një efekt i fundit dhe një si përpjekje e epërme e mendimeve të këqija që kishte sjellë e mbartte me vete nga burgu? Një mbeturinë impulsive, një rrjedhim i asaj që quajmë në statikë *forca e fituar*? Po, ishte ndoshta akoma më pak se kjo. Le ta themi thjesht: nuk ishte ai që kishte vjedhur, nuk ishte njeriu, por ishte kafsha, e cila, për forcë zakoni dhe e shtyrë nga instinkti, kishte vënë

këmbën aq pa mend mbi atë monedhë, pikërisht në kohën kur mendja përpëlitej midis aq vegimesh këmbëngulëse të papara ndonjëherë dhe të reja. Kur mendja u zgjua nga gjumi dhe e pa këtë veprim prej kafshe, Zhan Valzhani u zbraps me ankth dhe lëshoi një klithmë frike.

Puna është se kjo dukuri e çuditshme mund të ngjiste vetëm në atë gjendje ku ndodhej; ai, duke ia vjedhur paranë atij fëmije, kishte kryer diçka, të cilën s'ishte i zoti ta bënte më.

Sidoqoftë, kjo vepër e keqe e fundit pati mbi të një efekt vendimtar; kjo vepër e përshtoi mes për mes atë kaos që kishte ai në tru dhe e davariti, vuri në një anë shtresat e errëta dhe në anën tjetër dritën, dhe veprooi mbi shpirtin e tij, në gjendjen ku ndodhej ai, ashtu siç veprojnë disa reaktivë kimikë mbi një përzjerje të turbullt, duke turbulluar një element dhe duke kulluar tjetrin.

Së pari fare, përpara se të shqyrtonte veten dhe të thellohej në mendime, i hallakatur si ndonjë njeri që kërkon të shpëtojë, ai dha e mori që të gjente fëmijën për t'i kthyer të hollat, pastaj, si e pa që kjo ishte punë e kotë dhe e pamundur, ai u ndal i dëshpëruar. Në çastin kur klithi: "Mjerë unë i mjeri!", ai e pa veten ashtu siç ishte, dhe ishte tanimë aq i ndarë nga vetvetja, sa i dukej se tani e tutje nuk ishte më veçse një fantazmë dhe se kishte aty përpara tij atë të burgosurin e neveritshëm, me shkopin në dorë, me bluzën të veshur, me çantën në shpinë, mbushur plot gjëra të vjedhura, me atë fytyrë të vendosur e të zymtë, me mendjen plot plane të llahtarshme, se kishte përpara tij Zhan Valzhani, dora vetë.

Fatkeqësia e tepërt, siç e kemi vënë re, e kishte bërë në njëfarë mënyre vegimtar. E gjithë kjo punë, pra, ishte si një vegim. Ai pa me të vërtetë atë Zhan Valzhan, atë fytyrë ogurzezë, përpara tij. Ai kishte arritur gati në atë pikë sa të pyeste veten se kush ishte ai njeri, dhe i erdhi llahtar.

Truri i tij ishte në një nga ato çaste të furishme e megjithatë tmerrësisht të qeta, ku ëndërrimi është aq i thellë, sa e përpin edhe vetë realitetin. Njeriu nuk i sheh më sendet që ka rreth vetes, dhe i shikon sikur të jenë jashtë tij figurat që janë në mendjen e tij.

Ai e soditi veten e vet, si të thuash, ballë për ballë, dhe në të njëjtën kohë, përmes kësaj zhgjëndrre, ai shikonte, në një thellësi misterioze, njëfarë drite, të cilën në krye e mori për pishtar. Duke e vështruar me më shumë vëmendje këtë dritë që po i behte në ndërgjegje, ai vuri re se ajo kishte trajtën njerëzore dhe se ky pishtar ishte ipeshkvi.

Ndërgjegjja e tij i shqyrtoi njërin pas tjetrit këta dy njerëz të vendosur para saj, ipeshkvin dhe Zhan Valzhanin. U desh vetëm i pari, e asgjë tjetër, për të shuar të dytin. Me anë të një prej atyre efekteve të pazakonta, që janë veti e këtyre lloj dallidisejeve, dora-dorës që ëndërrimi i tij zgjatej, ipeshkvi rritej dhe shkëlqente në sytë e tij, ndërsa Zhan Valzhani zvogëlohej e shuhej. Për një çast ai s'mbeti veçse një hije. Befas ai u zhduk fare. Kishte mbetur vetëm ipeshkvi. Ky ia mbushte të tërë shpirtin këtij të mjeri me një rrezatim të madhërishëm.

Zhan Valzhani qau një copë herë të gjatë. Qau me lot të nxehtë, qau me dënësia, më keq se një grua, me më shumë frikë se një fëmijë.

Ndërsa qante, drita po agonte gjithnjë e më shumë në trurin e tij, një dritë e jashtëzakonshme, një dritë magjiplote dhe njëkohësisht e tmerrshme. Jeta e tij e kaluar, gabimi i parë, ndëshkimi i gjatë, shtazërimi i jashtëm, ashpërsimi i brendshëm, dalja e tij në lirinë e ngazëllyer nga aq plane hakmarrjeje, ajo që i kishte ndodhur tek ipeshkvi, vepra e fundit që kishte kryer, ajo vjedhja e dyzet *suve* të fëmijës, krim aq më tepër burracak dhe i përbindshëm, sepse kryhej pas ndjesës së ipeshkvit, të gjitha këto i erdhën ndër mend dhe iu shfaqën qartë, por me një qartësi që s'e kishte parë kurrë gjer atëherë. Ai i hodhi një sy jetës së tij dhe kjo iu duk e llahtarshme; i hodhi një sy shpirtit të tij dhe ky iu duk i neveritshëm. Por, ndërkohë, një dritë e ëmbël qëndronte mbi këtë jetë e mbi këtë shpirt. Atij i dukej sikur shikonte satanin në dritën e parajsës.

Sa orë qau asisoj? Ç'bëri ai si qau? Këtë kurrë s'e mori vesh njeri. Megjithatë, duket sikur është e qartë, se, po atë natë, karrocieri që bënte asokohe shërbimin e Grenoblit dhe që arrinte në Dinjë rreth orës tre të mëngjesit, duke kaluar përmes rrugës së ipeshkvisë, pa një njeri duke u lutur në gjunjë mbi kalldrëm, në errësirë, përpara portës së imzot Bienvenyit.

Libri i tretë

NË VITIN 1817

I

Viti 1817

Viti 1817 është viti të cilin Luigji XVIII, me njëfarë vetësigurie mbretërore, së cilës nuk i mungonte krenaria, e cilësonte si vitin e njëzetedytë të mbretërimit të tij²¹). Është viti kur zoti Brygier dë Sorsumi ishte bërë i famshëm. Të gjitha dyqanet e floktarëve, që shpresonin te moda e pudrosjes dhe te kthimi i zogut mbretëror, ishin lyer me ngjyrë të kaltër dhe zbukuruar me lule zambaku. Ishte ajo kohë e dëlirë kur konti Lënç ulej çdo ditë si këshilltar në tryezën e punës, në Sen-Zhermen-de-Pré, veshur me petkat e parit të Francës, me kordonin e kuq dhe hundën e gjatë dhe me atë madhështinë e profilit të posaçëm të një njeriu që ka kryer një veprim të shkëlqyer. Veprimi i shkëlqyer që kishte kryer zoti Lënç ishte ky: duke qenë kryetar i bashkisë së Bordosë, ai ia pati dorëzuar qytetin pak si tepër herët zotit dukë D'Angulem²²). Ky ishte shkaku që kishte fituar titullin par. Më 1817 moda i zhyste çunat e vegjël nga katër gjer gjashtë vjeç nën ca kasketa të mëdha prej meshini të marokinuar me veshëza, që u përngjisnin mjaft mitrave²³) të eskimezëve. Ushtria frënge ishte veshur në të

²¹) Kapak trekëndësh që vihet mbi oxhak majë çatisë për ta mbrojtur nga era dhe shiu.

bardha, austriakçe, regjimentet quheshin legjione; në vend të shifrave, ato kishin emra krahinash. Napoleoni ndodhej në Shën-Helenë dhe, meqenëse Anglia nuk i jepte stof të gjelbër, ai i kthente nga ana tjetër rrobat e tij të vjetra. Më 1817, Pelegrini këndonte, zonjusha Bigotini kërcente; Potieja²³⁾ mbretëronte; Odria²³⁾ nuk ekzistonte akoma. Zonja Saki²⁴⁾ i zinte këmbën Foriozos²⁴⁾. Në Francë kishte akoma prusianë. Zoti Delalo²⁵⁾ ishte njeri me rëndësi. Legaliteti po përforcohej duke ia prerë duart, pastaj edhe kokën, Plenjesë, Karbonosë dhe Toleronit²⁶⁾. Princi Dë Talejrand²⁷⁾, shambelan i madh, dhe abat Luizi, ministër i ngarkuar me financat, e vështronin njëri-tjetrin duke qeshur si dy fatthënës, që të dy kishin kremtuar më 14 korrik 1790 meshën e Federatës në Fushën e Marsit; Talejrandi e kishte thënë meshën si ipeshkv, Luizi e kishte shërbyer si dhiak. Më 1817, nëpër kundërudhëzat e po kësaj Fushe të Marsit, mund të të zinte syri trungje të trasha druri, që dergjeshin në shi, që kalbeshin në mes të barit, të lyera me ngjyrë të kaltër dhe me gjurmë shqiponjash e bletësh²⁸⁾, të cilave u ishte larë varaku. Këto ishin kolonat që dy vjet më parë kishin mbajtur tribunën e perandorit në Kuvendin e Majit²⁹⁾. Ato ishin nxirë aty-këtu nga djegia e fushimit austriak të vendosur në baraka afër Gro-Kajusë. Dy a tri kolona ishin zhdukur nëpër zjarret e këtyre fushimeve dhe kishin ngrohur duart e mëdha si tapanxha të kajzerlikëve. Kuvendi i Majit kishte pasur këtë gjë interesante: ajo që zhvilluar në muajin e qershorit dhe në Fushën e Marsit. Në vitin 1817, dy gjëra ishin popullore: Volter-Tuketi³⁰⁾ dhe kutia e duhanit ala Shartë. Tronditja më e freskët që pësoi Parisi, ishte krimi i Dotenit, i cili e kishte flakur kokën e të vëllait në pellgun e Tregut të Luleve. Kishin filluar hetimet kundër ministrit të Marinës mbi atë fregatën fatale të "Meduzës", e cila duhej të mbulonte me turp Shomareiksin dhe me lavdi Zherikonë³¹⁾. Kolonel Selvesi shkante në Egjipt për t'u bërë aty Sulejman Pasha. Pallati i Termave, në rrugën e "Harpës", i shërbente si punishte një vozaxhiu. Mund të shikojë akoma në rrafshin e kullës tetëkëndëshe të pallatit "Klyni" banesëzën prej dërrasash që i pati shërbyer si observator Mesierit, astronom i marinës në kohën e Luigjit XIV. Dukësia

Dë Dyras u lexonte tre a katër miqve në buduarin e vet të mbuluar me x-se prej sateni të kaltër *Urikën* akoma të pabotuar. Shkronjat N po kruheshin në Luvër. Ura e Austerlicit rrëzohej nga fronti dhe titullohej Ura e Kopshtit Mbretëror, enigmë e dyfishtë që mbulonte në të njëjtën kohë edhe Urën e Austerlicit, edhe Kopshtin Botanik. Luigji XVIII, i shqetësuar, teksa shënonte me majën e thoit Horacin, për heronjtë që bëhen perandorë dhe për nallanexhinjtë që bëhen princër trashëgimtarë, kishte dy halle: Napoleonin dhe Matyrën Brynonë³²⁾. Akademia kishte shpallur një konkurs me temën "*Lumturia që sjell studimi*". Zoti Belart³³⁾ njihej zyrtarisht si gojëtar. Bota shihnin se si nën hijen e tij po mbinte ai prokurori i ardhshëm Dë Broé, që do të thumbohej me sarkazëm nga Pol-Lui-Kurjeja³⁴⁾. U gjet edhe një Shatobrian i rremë, i quajtur Marshanji, duke pritur ndërkohë që të dilte një Marshanji i rremë, i quajtur D'Arlenkur³⁵⁾. *Klerë d'Alba* dhe *Malek-Adeli* ishte kryevepra; zonja Koten³⁶⁾ ishte shpallur shkrimtarja më e madhe e kohës. Instituti lejonte të shuhej nga lista e vet akademikun Napoleon Bonaparti. Një urdhëresë mbretërore e ngrinte Angulemin në shkollë marine, sepse, duke qenë admiral i madh duka D'Angulem, ishte e ditur që edhe qyteti i Angulemit³⁷⁾ i gëzonte me ligj të gjitha privilegjet e një porti detar, pa të cilën parimi monarkik do të mbetej i cunguar. Në Këshillin e Ministrave shtrohej çështja në duheshin lejuar apo jo karikaturat që paraqitnin kërcime në litar dhe që zbukuronin afishet e Frankonit³⁸⁾ dhe tërhiqnin endacakët e rrugëve. Zoti Paer³⁹⁾, zoti i *Anjezes*, babëlok me fytyrë katrore, që kishte një kokrrizë si nishan në faqe, drejtonte koncertet e vogla në rreth të ngushtë të markezës Dë Sasenejë, në rrugën "Vilë-Evek." Të gjitha vajzat e reja këndonin *Ermitin e Shën Avelës* me fjalët e Edmond Zherodit. *Shkurtabiqi i verdhë*⁴⁰⁾ shndërrohej në *Pasqyrë*. Kafe "Lambieni" mbante anën e perandorit kundër kafes "Valua", që mbante anën e Burbonëve. Sapo ishte bërë martesë e një princeshe siçiliane me zotin dukë Dë Beri⁴¹⁾, të cilit ia kishte mbërthyer sytë Luveli nga fundi i errësirës. Ishte mbushur një vit që zonja Dë Stal kishte vdekur. Garda Mbretërore fërshëllente zonjushën Mars⁴²⁾. Gazetat e mëdha

ishin fare të vogla. Format i ishte i kufizuar, por nuk ishte e kufizuar liria⁴³). Gazeta "Konstitucional"⁴⁴) ishte kushtetuese, gazeta "Minerva" e quante Shatobrianin *Shatobriant*⁴⁵). Kjo shkronja t i shkulte së qeshuri borgjezët në kurriz të shkrimtarit të madh. Në gazetën e shitura, gazetarë të përdalë shanin të mërguarit e vitit 1815; skulptori David s'kishte më talent, Arnolti s'kishte më mendjemprehtësi, Karnoti⁴⁶) s'kishte më përpikmëri në zbatimin e detyrave qytetare, Sulti⁴⁷) s'kishte fituar asnjë betejë; ishte e vërtetë që Napoleoni s'kishte më gjeni. Gjithkush e dinte se është diçka e rrallë që letrat e drejtuara me postë një të mërguari të arrijnë në adresën e duhur, sepse policët e kanë për detyrë të shenjtë që t'i ndalojnë. Kjo nuk është ndonjë gjë e re; edhe Dekarti, kur ishte i mërguar, ankohej për një punë të tillë. Kështu, pra, meqenëse Davidi kishte treguar në një gazetë belge se nuk merrte letrat që i shkruheshin, kjo i zbaviste fletoret monarkiste, të cilat përfitonin nga ky rast dhe shanin të mërguarin. Të thoshe *mbretvrasësit* ose të thoshe *votuesit*, të thoshe *armiqtë* ose të thoshe *aleatët*, të thoshe *Napoleoni* ose të thoshe *Bonaparti*, kjo i ndante dy njerëz më shumë se ç'mund t'i ndante një greminë. Të gjithë njerëzit me mend në kokë ishin të një mendjeje se periudha e revolucioneve ishte shuar përgjithmonë nga mbreti Luigji XVIII, i mbiquajtur autori i pavdekshëm i Kartës⁴⁸). Në tabanin e Urës së Re skalitej fjala *Redivivus*⁴⁹), mbi piedestalin që priste statujën e Henrikut IV⁴⁹. Zoti Pietë përvijonte në rrugën "Terezë", Nr. 4, marrëveshjen e tij për të përforcuar monarkinë. Kryetarët e së djathtës në rrethana të vështira thoshin: "I duhet shkruar Bakotit"⁵⁰). Zotërinjtë Kanyel, O'Mahoni dhe Dë Shapëdëlen përvijonin pakëz edhe me aprovimin e zotërisë (mbretit), atë që më vonë do të quhej "komploti i bregdetit". Gjilpëra e Zezë⁵¹) komplotonte në anën e vet. Delaverderia hahej me Trogofin. Zoti Dekaz⁵²), një mendje deri diku liberale, sundonte. Shatobriani, duke qëndruar në këmbë çdo mëngjes përpara dritares së vet në Nr. 27 të rrugës "Sen-Dominik", veshur me kilota e mbathur me pantofla, me

⁴³) E ringjallur (lat).

ata flokë të thinjur, të mbështjellë me një shall madrasi⁵³), sytë ngulur mbi një pasqyrë, një pajim të plotë dentisti hapur përpara vetes, kuronte dhëmbët, që i kishte të mahnitshëm, dhe njëkohësisht i diktonte sekretarit të vet, zotit Pilorzhë, variantet e veprës *Monarkia sipas Kartës*. Kritika, që kishte mjaft autoritet çmonte më shumë Lafonin sesa Talmën⁵³). Zoti Dë Felec nënshkruante A., zoti Hofman nënshkruante Z.⁵⁴). Kursel Charl Nodjeja⁵⁵) nënshkruante *Tereza Obertin*. Ndarja e bashkëshortëve ishte e ndaluar me ligj. Licetë quheshin kolegje. Nxënësit e kolegjeve, me qafore të zbukuruara me një lule zambaku të artë, kacafyteshin për punën e mbretit të Romës⁵⁶). Kundërpolicia e kështjellës i denonconte madhërisë së saj zonjës mbretëreshë portretin e vendosur kudo të zotit dukë D'Orlean, i cili dukej më i pashëm me uniformën e gjeneral-kolonelit të husarëve, sesa zoti dukë Dë Beri me uniformën e gjeneral-kolonelit të dragonëve; telash i madh. Qyteti i Parisit, me shpenzimet e veta, lyente me ar kubënë e "Invalidëve"⁵⁷). Njerëzit seriozë pyesnin njëri-tjetrin se çfarë do të bënte në këtë apo atë rast zoti Trënkëlag⁵⁸); zoti Klozel dë Mental ndahej, në shumë pika, nga zoti Klozel dë Kuserg⁵⁹); zoti Dë Salaberi⁶⁰) nuk ishte i kënaqur. Aktori Pikar⁶¹), që ishte anëtar i Akademisë, anëtar i së cilës nuk pati mundësi të ishte aktori Molier, shfaqte "*Të dy Filibertët*" në "Odeon", mbi ballinën e të cilit vragat e shkronjave të shkullura lejonin të lexoheshin shkoqur fjalët: Teatri i Perandoreshës. Njerëzia ishin në favor ose kundër Kynie dë Montarlosë⁶²). Fabvieri ishte rebel; Bavui ishte revolucionar⁶³). Librari Pelisie bënte një botim të Volterit, nën këtë titull: "Veprat e Volterit, anëtar i Akademisë Frënge". "Kjo i ndjell blerësit" - thoshte ky botues i leshtë. Opinioni i përgjithshëm ishte se zoti Charl Luazon⁶⁴) do të mbetej gjeniu i shekullit; lakmia kishte filluar ta kafshonte dhe kjo ishte një shenjë lavdie; dhe bëheshin për të këto vargje:

Edhe kur Luazoni fluturon, ndihet që ka putra.

⁵³) Stof prej mëndafshi e pambuku me ngjyra të ndezura.

Meqë kardinal Feshi nuk pranonte të jepte dorëheqjen, zoti Dë Pën, arqipeshkv i Armazisë, administronte dioqezën e Lionit. Sherri për luginën e Dapës fillonte midis Zvicrës dhe Francës me një promemorie të kapiten Dyfurit, që ishte bërë gjeneral. Sen-Simoni, i lënë në harresë, përvijonte ëndrrën e vet të madhërisme. Në Akademinë e Shkencave kishte një Furie⁶⁵⁾ të famshëm, të cilin brezat e mëpasmë e kanë harruar, dhe nuk di se në çfarë biruce të errët kishte një Furier tjetër, të cilin e ardhmja do ta kujtojë. Lord Bajroni po fillonte të agonte; një shënim i një poeme të Milëvuasë ia paraqiste Francës me këto fjalë: "Njëfarë lord Bajroni". David d'Anzheri⁶⁶⁾ provonte të gatuate mermerin. Abat Karoni fliste plot lavdërime, në një komitet të vogël seminaristësh, në një qorrsokak të "Fëjantiveve", për një prift të panjohur të quajtur Felisitë Rober, i cili më vonë u quajt Lamënë⁶⁷⁾. Një vend që nxirrte tym dhe që rrihte ujët pllaq-plluq në lumin Senë, duke bërë një zhurmë si ai qeni kur noton, shkonte e vinte nën dritaret e "Tuilërive", nga Ura Mbretërore te Ura Luigji XV; ky ishte një mekanizëm që s'vlente ndonjë gjë të madhe, njëfarë lodre fëmijësh, një ëndërr prej shpikësi trutharë, një utopi: një anije me avull. Parizianët e shikonin këtë gjë të padobishme me mospërfillje. Zoti Dë Voblack, reformator i Institutit me anë të forcës, me urdhëresa e emërime të reja, autor i shquar i shumë akademikëve, si bëri e bëri të tjerët akademikë, nuk arriti të bëhej për vete i tillë. Lagjja "Sen-Zhermën" dhe pavijoni "Marson"⁶⁸⁾ lutnin që prefekti i policisë të bëhej zoti Delavo, për arsye të besnikërisë së tij. Dypytreni dhe Rekamieri ia fillonin sherrit në amfiteatrin e Shkollës së Mjekësisë dhe kërcënonin njëri-tjetrin me grushte për çështjen e hyznisë së Jezu Krishtit. Kyvieri, njërin sy te gjeneza dhe tjetrin te natyra, përpiquej t'i hynte në qejf reaksionit fetar, duke i pajtuar fosilet me shkrimet e shenjta dhe duke i bërë mastodontët të lajkatonin Moisinë. Zoti Fransua dë Nefshatò, lëvrues i lavdërueshëm i kujtimit të Parmantierit, rrihte e mihte që fjala *patate* të shqiptohej *parmantierë*, por më kot. Abat Greguari, ish-ipeshkv, ish-konvansionar, ish-senator, kishte hyrë në polemikën monarkiste me titullin "Greguar Faqeziu". Kjo

shprehje që sapo përdorëm: *kishte hyrë me titullin*, paditej si neologjizëm nga zoti Ruajer Kolari.⁶⁹⁾ Nën harkun e tretë të Urës së Jenës mund të shquaje për shkak të bardhësisë së tij gurin e ri, me të cilin dy vjet më parë e kishin mbathur vrimën e minës që kishte hapur Blyheri⁷⁰⁾ për ta hedhur urën në erë. Drejtësia thërriste në bankën e të paditurve një njeri i cili, duke parë kontin D'Artua tek hynte në katedralen e Shën Mërisë, kishte thënë me zë të lartë: "Dreq o punë! Më vjen keq për kohën kur shihja Bonapartin dhe Talmanin të hynin të zënë krah për krah në Bal-Sovazhë". Fjalë kryengritëse! Gjashtë muaj burg. Disa tradhtarë dilnin faqe botës me kopsa të zbërthyera; njerëz që s'e kishin pasur për gjë të kalonin në radhët e armikut duke u gdhirë dita e një beteje, dhe s'e fshihnin shpërblimin që kishin marrë, e mburreshin haptas me pasurinë dhe ofiqet e fituara; dezertorë të Linjisë dhe të Katrë-Brasit, të zhgërryer në poshtërsinë morale të paguar me para, e shisnin sheshit besnikërinë e tyre monarkiste krejt lakuriqe, duke harruar fare se çfarë është shkruar në murin e brendshëm të nevojtoveve publike në Angli: "Please adjust your dress before leaving".

Ja se ç'pluskon turbull, lesh e li mbi ujë nga viti 1817, i cili sot është harruar e s'kujtohet më. Historia i lë pothuajse pas dore të gjitha këto veçori, dhe nuk mund të bëjë ndryshe, sepse do ta zaptonte pafundësia. Megjithatë, të gjitha këto hollësi, të cilat pa të drejtë i quajnë tepër të vogla - nuk ka as ngjarje të vogla në shoqërinë njerëzore, as gjethe të vogla në bimësi - janë të dobishme. Sepse nga fizionomia e viteve përbëhet fytyra e shekujve.

Në këtë vit, 1817, katër të rinj parizianë bënë "një shaka të bukur".

⁶⁹⁾ Lutemi, rregulloni petkat para se të largoheni.

Katërsh i dyfishtë

Këta parizianë ishin njëri nga Tuluzi, tjetri nga Limozhi, i treti nga Kahorsi dhe i katërti nga Montobani; por ata ishin studentë, dhe, po the student, ke thënë parizian; të studiosh në Paris, do të thotë të lindësh në Paris.

Këta të rinj ishin fare të rëndomtë; gjithkush ka parë fytyra të tilla; katër mostra të zakonshme; as të mirë, as të këqij; as dijetarë, as të padijshëm, as gjeni, as trutharë; të bukur si të gjithë ata që janë në pranverën e jetës, njëzetvjeçarë. Ata ishin katër Oskarë të rëndomtë, sepse asokohe Arturët nuk ekzistonin: "Digjni për të parfumet e Arabisë", - bërtiste romanca. - "Oskari po vjen, Oskarin do të shoh!" Sapo kishte shpëtuar nga Osiani, eleganca ishte skandinave dhe skoceze, moda angleze e pastër do të mbizotëronte vetëm më vonë, dhe i pari i Arturëve, Uelingtoni, sapo e kishte fituar betejën e Vaterlosë.

Këta Oskarë quheshin njëri Feliks Tolomies nga Tuluzi, tjetri Listolier nga Kahorsi; tjetri Famëj nga Limozhi, i fundit Blashëvei nga Montobani. Natyrisht, secili kishte edhe të dashurën e vet. Blashëvei dashuronte Favuritën, e cila quhej kështu sepse kishte vajtur në Angli; Listolieri adhuronte Dahlien, e cila kishte marrë për emër luftarak emrin e një luleje; Famëji shkrihej pas Zefinës, shkurtim i Jozefinës. Tolomiesi kishte Fantinën, të mbiquajtur Leshverdha, për shkak të flokëve të saj të bukur ngjyrë dielli.

Favurita, Dahlia, Zefina dhe Fantina ishin katër vajza magjiplote, të parfumuara dhe të çiltra, akoma pak si punëtore, sepse ende nuk e kishin lënë gjilpërën, të ngacmuara nga dashuriçkat, por që kishin në fytyrë vulën e dëlirësisë së punës dhe në shpirt atë lule ndershmërie, e cila te gruaja jeton ende edhe pas rënies së parë në mëkat. Njëra nga të katra quhej "e reja", sepse ajo ishte më e vogla në moshë; dhe një tjetër quhej "plaka". Plaka ishte njëzet e tre vjeç. Që të mos ju fshehim asgjë, po themi që tri të parat ishin më të përvuajtura, më qejflesha

dhe më të hedhura në zhurmën e jetës, sesa Fantina, Leshverdha, që ishte akoma në ëndrrat e saj të para.

Dahlia, Zefina e sidomos Favurita nuk mund të thoshin se ishin në ëndrrat e para. Kishte më shumë se një episod në romanin e tyre të posafilluar, dhe dashnori, i cili quhej Adolf në kapitullin e parë, na dilte Alfons në të dytin dhe Gustav në të tretin. Varfëria dhe pispillosja janë dy këshilltare fatale; njëra grindet, tjetra lajkaton; dhe vajzat e bukura të popullit i kanë që të dyja këto gjëra; dhe këto u flasin në vesh me zë të ulët secila për hesap të vet. Këto shpirtra pa zot e pa shkop mbajnë vesh e dëgjojnë. Kjo është arsyeja e mëkateve që bëjnë dhe e gurëve që flasin mbi to. Bota i pllakos e i mbyt ato me shkëlqimin e gjithçkaje që është e panjolllosur dhe e paarritshme. Vaj medet! Po sikur Jungfrau^{*)} të kishte uri?

Favurita, meqenëse kishte qenë në Angli, adhurohej nga Zefina dhe Dahlia. Ajo kishte pasur shumë herët një shtëpi të sajën. I ati, dikur profesor matematike, ishte brutal dhe lëvdatëmadh; s'ishte i martuar dhe jepte mësimë private me gjithë moshën e shtyrë. Këtij profesori, kur ishte i ri, ia kishte marrë mendtë fustani i një shërbyeseje, dhe nga kjo dashuri kishte dalë Favurita. Favurita e takonte kohë më kohë të atin, i cili dhe e përshëndeste. Një mëngjes, një grua plakë me pamje prej besimtareje kishte hyrë në shtëpi të saj dhe i kishte thënë: "Nuk më njihni, zonjushë?" "Jo". "Unë jam nëna jote". Pastaj plaka kishte hapur bufenë, kishte ngrënë e kishte pirë, kishte sjellë një dyshek dhe qe vendosur aty. Kjo nënë gërnjare dhe besimtare nuk i fliste kurrë Favuritës me gojë, qëndronte orë të tëra pa nxjerrë fjalë nga goja, hante mëngjes, drekë e darkë sa për katër dhe zbriste për vizitë te portieri, ku s'linte fjalë pa thënë për të bijën.

Shkaku që e kishte bërë Dahlien të bashkohej me Listolierin, ndoshta edhe me të tjerë dhe të jepej pas jetës në limonti, ishte se ajo kishte ca thonj tepër të bukur ngjyrë trëndafili. E si t'i fuste në punë ata deli thonj? Kush do që të qëndrojë e virtytshme, nuk duhet të ketë mëshirë për duart e

^{*)} Maja e Alpeve të Bernës në Zvicër.

meta. Kurse Zefina e kishte fituar Famëjin me atë mënyrë të veçantë dhe për këdhele, kur thoshte: "Po, zotëri."

Djelmoshat ishin shokë, vajzat ishin mikeshat. Dashuri të tilla janë gjithmonë të shoqëruara me të tilla miqësi.

Të jesh i urtë dhe të jesh filozof, janë dy gjëra; dhe ajo që e provon këtë, është se, me gjithë rezervat tona mbi këto familje të vogla e të parregullta, Favurita, Zefina dhe Dahlia ishin vajza filozofe, dhe Fantina ishte vajzë e urtë.

E urtë do të thotë dikush? Po Tolomiesi? Solomoni do të ishte përgjigjur se dashuria është pjesë e urtësisë. Ne po themi vetëm se dashuria e Fantinës ishte dashuria e parë, një dashuri e vetme, një dashuri besnike.

Ajo ishte e vetmja ndër të katra që përkëdhelej nga një i vetëm.

Fantina ishte një nga ato qenie që bulojnë, si të thuash, nga gjiri i thellë i popullit. E dalë nga thellësitë më të pamatshme të territ shoqëror, ajo kishte në ballë shenjën e anonimes dhe të së panjohurës. Kishte lindur në Montrëj-syr-Mer. Nga cilët prindër? E kush mund ta thoshte? S'ia kishin njohur as babanë, as nënën. Quhej Fantinë. Po pse Fantinë? Kurrë s'i kishte njohur njeri emër tjetër. Në kohën kur lindi ajo, Direktorati ishte akoma në fuqi. Mbiemër s'kishte, se s'kishte familje, as emër pagëzimi, se kisha s'kishte dorë në këtë punë. Ajo u quajt ashtu si i pëlqeu të parit kalimtar që e takoi qysh fare të vogël, duke ecur këmbëzbathur në rrugë. Ajo mori një emër, ashtu siç hante mbi kokë të gjithë ujin e reve kur binte shi. E thirrën Fantina e Vogël. Askush nuk dinte më tej. Kjo krijesë njerëzore kishte ardhur në jetë kësajsoj. Kur u bë dhjetë vjeç, Fantina e la qytetin dhe vajti e hyri në shërbim te fermerët e atyre anëve. Kur u bë pesëmbëdhjetë vjeç, Fantina erdhi "për të kërkuar fatin". Ajo ishte e pashme dhe ndenji e panjollë sa më gjatë që mundi. Ishte një leshverdhëz e bukur me një palë dhëmbë të bukur. Ajo kishte si pajë ar dhe margaritarë, por ari ishte mbi kokën e saj dhe margaritarët i kishte në gojën e saj.

Fantina punoi për të jetuar; pastaj gjithmonë po për të jetuar, sepse edhe zemra ka urinë e vet, ajo ra në dashuri.

Dashuroi Tolomiesin.

Dashuriqë për djaloshin, pasion për vajzën. Rrugët e Lagjes Latine, që mbushen nga mizëria e studentëve dhe e vajzurinave, ishin dëshmitare të fillimit të kësaj ëndrre. Në ato rrugica të kodrës së Panteonit, ku sa e sa ndodhira lidhen e zgjidhen. Fantina i qe shmangur për një kohë të gjatë Tolomiesit, por në atë mënyrë që ta takonte gjithnjë. Ka një mënyrë të shmanguri që i përngjet të kërkuarit. Shkurt, poezia nisi fluturimin.

Blashëvei, Listolieri dhe Famëji përbënin njëfarë çete që kishte në krye Tolomiesin. Ky na ishte shpirti dhe mendja e asaj çete.

Tolomiesi ishte një student i tipit të vjetër; ishte i pasur; kishte katër mijë franga të ardhura, një mandat i shkëlqyeshëm ky në kodrën e Sentë-Zhënevievës. Tolomiesi ishte njeri i qejfeve, ishte tridhjetë vjeç, por i mbajtur keq. Ishte gjithë rrudha e dhëmbërenë; kishin filluar t'i binin edhe flokët; dhe për këtë ai thoshte edhe vetë, pa pikë trishtimi: "Tridhjetë vjeç na lanë flokët; dyzet vjeç do të na lënë edhe gjunjët". Stomaku s'i bluante mirë dhe i qe shpifur një sëmundje, për shkak të së cilës i lotonte njëri sy. Por, sa më shumë që i shuhej rinia, aq më shumë e ndizte gazmendin; ai i zëvendësonte dhëmbët me shakara e qyfyre, flokët me gaz dhe shëndetin me ironi, dhe syri, që i lotonte, qeshte pa pushim. Ishte i ronitur, por krejt i lulëzuar. Rinia e tij, që po merrte uratën përpara moshës, bënte tërheqje të rregullta, shpërthente në të qeshura dhe nuk shikoje tjetër veçse zjarr e flakë. Një pjesë teatrale, që pati shkruar, ia kishin hedhur poshtë në Teatrin e Vodevilit. Shkruante poshtë e lart vargje të rëndomta. Veç kësaj, ai dyshonte jashtëzakonisht për çdo gjë, forcë e madhe kjo në sy të të dobtëve. Pra, meqenëse ishte ironik e tullac, ishte edhe kryetar. *Iron* është një fjalë anglisht që do të thotë hekur. A mos vjen së këtejmi fjala ironi?

Një ditë Tolomiesi i mori mënjanë tre të tjerët, bëri një gjest orakulli dhe u tha:

-Ka plot një vit që Fantina, Dahlia, Zefina dhe Favurita na kërkojnë që t'u bëjmë ndonjë surprizë. Dhe ne ua kemi premtuar solemnisht. Gjithnjë na e zënë ngoje, sidomos mua. Ashtu sikundër në Napoli thërresin në janarin e shenjtë:

"Faccia gialluta, fa o miracolo", "O ti fytyrëverdhë, bëje mrekullinë tënde!", ato bukuroshet tona më thonë pareshtur: "Tolomies, kur do të na e pjellësh atë surprizën tënde?" Në të njëjtën kohë edhe prindërit po na shkruajnë. Na ka ngecur sharra në të dyja anët. Më duket se koha ka ardhur e s'pret më. Pra, le të kuvendojmë.

Në këtë e sipër, Tolomiesi e uli zërin dhe shqiptoi misteriozisht diçka aq gazmore, sa një e qeshur tallëse e madhe dhe entuziaste doli përnjëherësh nga të katër gojët dhe aq, sa Blashëveleti bërtiti: "Të lumtë, ja kësaj i thonë ide e bukur!"

Me t'u dalë përpara një kafene plot tym, ata hynë brenda, dhe pjesa tjetër e kuvendit të tyre humbi në terr.

Përfundimi i këtij terri na që një argëtim për shtatë palë qejfe, që u bë të dielën e mëpasme, ku të katër djelmoshat ftuan të katër vajzat.

III

Katër me katër

Se çfarë ishte një shëtitje e studentëve dhe e vajzurinave në fushë, jashtë qytetit, këtu e dyzet vjet të shkuar, sot nuk mund të merret edhe aq lehtë me mend. Parisi nuk i ka më po ato rrethina; figura e saj që mund ta quajmë jeta "rreth Parisit" ka ndryshuar kryekëput qysh prej një gjysmë shekulli e këtej; atje ku ishte karroca, tani është vagoni; atje ku ishte varka, tani është anija me avull; sot thua Fekamp, ashtu siç thoshe dikur Sen-Klud. Parisi i vitit 1862 është një qytet që ka si rrethinë Francën.

Të katër çiftet i kryen me ndërgegje të gjitha marrëzitë që mund të bëheshin asokohe arave. Po fillonin pushimet dhe ishte një ditë e nxehtë dhe e kthjellët vere. Një natë më parë, Favurita, e vetmja që dinte shkrim, i pati shkruar këto fjalë Tolomiesit në emër të të katrave: "Është një lumturi të dalësh herët". Për këtë arsye ata u ngritën që në orën pesë të mëngjesit. Pastaj

vajtën me karrocën e udhëtarëve në Sen-Klud, vështruan kaskadën e shteruar dhe bërtitën: "Kushedi sa e bukur duhet të jetë kur ka ujë!" Hëngrën drekë të *"Koka e Zezë"*, ku Kasteni⁷¹ akoma s'kishte kaluar, harxhuan ca para në lojën e unazave në parkun e hauzit të madh, hipën në fenerin e Diogjenit, luajtën me kuleçë të ëmbël në ruletën e Urës së Sevrës, mblodhën tufa lulesh në Pyto, blenë ca lodra si fyej në Neji, hëngrën kudo që vajtën ëmbëlsira me reçel mollësh, bënë, me një fjalë, kokrrën e qejfit.

Vajzat s'pushonin së kakarisuri dhe së cicërituri si turtullesha të hazdisura. Ishte një kllapi e vërtetë. Ato çoku u jepnin nga ndonjë të goditur të vogël djelmoshave. Dehje mëngjesore e jetës! Vite të adhureshme! Flatrat e pilivesave rrëqethen. Oh! Cilido qofsh ti, a të bie ndonjëherë ndër mend? A ke ecur ndonjëherë ferrave, duke larguar degëzat për t'i hapur rrugë kokës magjiplote që vjen prapa teje? A ke rrëshqitur ndonjëherë në ndonjë ledh të lagur nga shiu tok me ndonjë grua të dashur që të mban për dore e të bërtet: "Ah! E zeza unë! Si m'u bënë këpucët që i kam të reja fare!"

Le ta themi që tani se ky siklet gazmor, si një valë që kalon, nuk i ngjau kësaj çete gazmore, megjithëse Favurita pati thënë, kur u nisën, me një theks magjistrat e amësor: "Kaçamillët po shëtitin monopateve. Do të kemi shi, bijtë e mi".

Që të katra ishin marrëzisht të bukura. Një poet i vjetër e babaxhan klasik, asokohe me nam, një babëlok që kishte një Leonorë, zoti kalorës Dë Labuisë, tek endej asaj dite nën gështenjat e Sen-Kludit, i pa tek po kalonin aty nga ora dhjetë e mëngjesit; ai na paskësh bërtitur: "Njëra syresh është e tepërt", - duke e hedhur fjalën për të tri Hiret. Favurita, mikja e Blashëveleit, ajo njëzetetrevjeçarja, "plaka", vraponte përpara nën degët e mëdha të gjelbra, hidhte hendekët, kapërcente si e hazdisur ferrat dhe kryesonte gjithë këtë gaz me afshin e një bishëze të re. Zefina dhe Dahlia, të cilat fati i kishte bërë të bukura në mënyrë të atillë që, duke qëndruar afër, ia shtonin njëra-tjetrës bukurinë dhe e plotësonin shoqja-shoqen, nuk shqiteshin kurrë, jo nga miqësia, por më shumë nga instinkti i kapardisjes, dhe, duke u mbështetur pas shoqja-shoqes,

merrnin poza angleze: *keepsake-t*¹⁾ e para sapo kishin dalë, melankolia sa kishte qitur krye për gratë, ashtu sikundër më vonë bajronizmi për burrat, dhe flokët e seksit të butë kishin filluar t'i linin pas dore, Zefina dhe Dahlia i mbanin flokët të mbledhur kutullaç. Listolieri dhe Famëji i kishin hyrë një diskutimi mbi profesorët e tyre dhe i shpjegonin Fantinës ndryshimin që kishte midis zotit Delvinkur dhe zotit Blondo.

Blashëvei dukej se ishte krijuar apostafat për të mbajtur në krahun e vet shallin me vezhdë të Favoritës.

Tolomiesi vinte pas dhe sundonte çetën. Ishte shumë gaztor, por e ndieje sakaq edhe që ai sundonte; në gazmendin e tij kishte diktaturë: zbukurimi i tij kryesor ishin një palë pantallona të gjera poshtë, me stof nankini, me nënkëmbëza prej fijesh bakri të gërshetuara; kishte në dorë një goxha bastun të fortë dyqindfrangash dhe, meqenëse i lejonte vetes gjithçka, mbante në gojë një diçka të çuditshme, që quhet puro. Meqë ai s'e vriste për asgjë, pinte edhe duhan.

-Ky Tolomiesi është njeri i çuditshëm, - thoshin të tjerët me përnderim. - Ç'pantallona që të ka! Pastaj, ç'energji!

Kurse Fantina ishte gazi vetë. Dhëmbët e saj të shkëlqyeshëm kishin pasur me siguri si dhunti një funksion, të qeshurit. Ajo mbante më me qejf në dorë, sesa në kokë kapelën e saj prej kashte, të qepur me ca tizga të gjata, të bardha. Flokët e saj të dendur e të verdhë, që ishin të gatshëm të shprisheshin në erë dhe të zgjidheshin pa pikë zori, dhe që duhej t'i lidhje pareshtur, dukeshin sikur ishin krijuar për vrapin e Galatesë nën shelgjet. Buzët e saj, trëndafil i gjallë, çuquritnin plot magjepsje. Skajet e gojës së saj të ngritura lart plot afsh, si në maskaronet e lashta të Erigonës, dukeshin sikur të nxitnin për guxime të çartura; por qerpikët e saj, të gjatë e plot hije, uleshin hijerëndë mbi këtë pështjellim zulmëmadh të pjesës së poshtme të fytyrës, sikur donin të të thoshin: "Ndal!" I gjithë tualeti i saj ishte diçka që këndonte e që flakëronte. Ajo kishte një fustan leshi të hollë, ngjyrë vjollce të çelët, një palë këpucë të vogla si

¹⁾ Një lloj libri – album, zakonisht i ilustruar me gravura të holla, të cilët ishin në modë të dhuroheshin në epokën romantike.

sandale me lëkurë lustrafini të murrme në të kuq, të lidhura me rripa, që formonin x-e mbi çorapet e saj të holla e të bardha; ajo kishte dhe atë farë jeleku prej musëline, shpikje marsejeze, emri i të cilit, kanëzu, prishje e fjalës *quinz août*²⁾, të shqiptuar në Kanëbierë të Marsejës, do të thotë mot i bukur, nxehtësi dhe mesditë. Të tri vajzat e tjera, më pak të druajtura, siç e thamë, i kishin rënë shkurt; ishin fare dekolté, gjë që verës, nën kapelat e mbuluara me lule, ka hije dhe të ngacmon shumë; por krahas këtyre veshjeve të guximshme, kanëzujat e leshverdhës Fantinë, me ato cohëra të tejdukshme, me ato pjesë të zbuluara dhe të mbuluara, që fshihnin dhe tregonin po në të njëjtën kohë, dukej si një zbulim ngacmues i ndershmërisë, dhe oborri i famshëm i dashurisë, i kryesuar nga vikontesha Dë Setë, me ata sy të blertë si deti, do t'i kishte dhënë ndoshta çmimin si lozonjare kësaj kanëzujë, e cila konkurronte për papërlyerjen. Më i leshti del disa herë më i zgjuari. Gjëra që ndodhin këto.

Fytyrën plot shkëlqim, profilin delikat, sytë të kaltër të thellë, kapakët e syve të rëndë, këmbët të përhedhura dhe të vogla, qafat e duarve dhe noçkat e këmbëve të lidhura për bukuri, lëkurën të bardhë borë, që tregonte aty-këtu degëzimet ngjyrë qielli të damarëve të gjakut, faqen feminare dhe të kizët, qafën të bëshme si të Junoneve të Egjinës, zverkun të fortë dhe të zhdërvjellët, supet, sikur t'i kishte modeluar Kustui, kishin në qendër një gropëz epshore, e cila dukej përmes muselinës, një gaz të akullt ëndërrimi, skulpturale dhe e shijshme për të pirë në kupë; e tillë ishte Fantina; dhe njeriu, nën ato rroba dhe lidhëse, pikaste një statujë, dhe në këtë statujë, një shpirt.

Fantina ishte e bukur, por nuk e dinte mirë as ajo vetë. Ëndërruesit e rrallë, meshtarë misteriozë të së bukurës, që, në heshtje, çdo gjë e krahasojnë me përsosmërinë, do të kishin ajgëtuar në këtë punëto të vogël, përmes tejdukshmërisë së hijeshisë pariziane, euforinë e lashtë të shenjtë. Kjo vajzë e dalë nga errësira ishte një krijesë e fisme. Ishte e bukur në të dyja llojet, që janë stili dhe ritmi. Stili është forma e idealit, ritmi është forma e lëvizjes.

²⁾ Kenzu (frëngj.) – Pesëmbëdhjetë gusht.

Thamë se Fantina ishte gazi vetë; Fantina ishte gjithashtu dëlirësia vetë.

Për një vëzhgues që do ta kishte studiuar me kujdes, ajo që shpërthente prej saj, përmes gjithë asaj dehjeje të moshës, stinës dhe dashurisë, ishte shprehja e pamposhtshme e përmbajtjes dhe e modestisë. Ajo qëndronte pak si e habitur. Kjo habitje e dëlirë është ngjyrësia e hollë që ndan Psihenë nga Venusi. Fantina kishte gishta të gjatë, të bardhë e të hollë si ata të vestaleve^{*)}, që traznin hirin e zjarrit të shenjtë me një gjilpërë të artë. Megjithëse, siç do ta shikojmë, madje edhe me të tepërt, ajo s'i kishte refuzuar asgjë Tolomiesit, fytyra e saj, kur pushonte, s'kishte s'i bëhej më e virgjër; njëfarë dinjiteti serioz dhe gati i rëndë e pushtonte papritmas në disa çaste, dhe s'kishte gjë më të pazakontë e turbulluese sesa kur shikoje se sa shpejt i shuhej gazi dhe se si qetimi zinte vendin e shpërthimit. Kjo hije e rëndë e papritur, shpesh e theksuar ashpër, i përngjiste mospërfilljes së një perëndeshe. Balli, hunda dhe mjekra e saj jepnin atë drejtpeshim vijash, që dallohet qartë nga drejtpeshimi i përpjesëtimit, dhe prej së cilës spikat harmonia e fytyrës; në intervalin aq karakteristik që ndan bazën e hundës nga buza e sipërme, ajo kishte atë palëz të pakapshme dhe magjepsëse që është shenja misterioze e dëlirësisë, e cila e bëri Barbarosën të binte në dashuri me një Dianë të gjetur në gërmimet e Ikonës.

Dashuria është një gabim; ashtu qoftë. Fantina ishte pafajësia që pluskon mbi gabimin.

^{*)} Vestalet janë priftëreshat që ruanin zjarrin e përhershëm në Romën e lashtë.

IV

Tolomiesi është aq i gëzuar, sa këndon një këngë spanjolle

Ajo ditë ishte fund e krye një agim i vërtetë. E gjithë natyra dukej sikur ishte me pushime dhe e qeshur. Ngastrat e Sen-Kludit kundërmonin ajrin; afshi i Senës luhaste vagull gjethet; degët lëviznin nga era; bletët i ishin vënë plaçkitjes së jaseminëve; një mori fluturash silleshin e përdridheshin nëpër tërfil, barpezmet dhe tërshërat e egra; në parkun madhështor të mbretit të Francës kishte një trumbë endacakësh dhe këta ishin zogjtë.

Të katër çiftet, të gëzuar, të përzier me diellin, arat, lulet, pemët, shkëlqenin plot dritë.

Dhe në këtë bashkësi parajse, të tëra vajzat flitnin, këndonin, vraponin, kërcenin, gjuanin flutura, këputnin lule kumbona, njomnin çorapet ngjyrë trëndafili në barërat e gjata, të freskëta, të harlisura, plot dashamirësi, të gjitha këmbenin aty-këtu nga ndonjë të puthur me djelmoshat, përveç Fantinës së mbyllur në qëndresën e saj të vagullt, ëndërruese dhe të egër, sepse ajo dashuronte. "Ti, moj Fantinë, - i thoshte Favurita, - si shumë naze bën."

Këto janë gëzime. Këto kalime çiftesh të lumtur janë një thirrje e thellë ndaj jetës dhe natyrës dhe bëjnë të shpërthejë nga gjithçka përkëdhelja dhe drita. Na ishte njëherë një zanë, e cila i bëri luadhet dhe pemët enkas për dashnorët. Nga kjo ka mbetur zakoni që dashnorët të dalin jashtë qytetit dhe kjo rifillon pareshtur dhe do të vazhdojë sa të ketë korije dhe dashnorë. Që këtej rrjedh edhe popullariteti i pranverës midis mendimtarëve. Pasaniku dhe mëditësi i vogël, duka, pari dhe prifti, njerëzit e oborrit dhe njerëzit e qytetit, siç thuhej qëmoti, të gjithë janë robër të kësaj zane. Njerëzit qeshin, kërkojnë njëri-tjetrin dhe në ajër ka një dritë apoteoze. Eh, çfarë shpërftyrimi është të dashurosh! Edhe ndihmësit e noterëve bëhen perëndi. Edhe britmat e vogla, ndjekjet nëpër bar, të kapurit për beli

fluturimthi, ato zhargone që janë si melodi, ato adhurime që shpërthejnë nga mënyra se si thuhet një rrokje, ato qershi të shkëputura nga goja në gojë, të gjitha këto flakërojnë dhe kalojnë në lavditë qiellore. Vajzat e bukura e harxhojnë pa kujdes dhe plot ëmbëlsi veten e tyre. Kujtojnë se kjo jetë kështu nuk do të ketë kurrë të sosur. Filozofët, poetët, piktorët i vështrojnë këto dalldisje dhe nuk dinë ç'të bëjnë me to, kaq fort u merren sytë nga drita. "Nisja për në Siterë!"⁷²⁾ - bërtet Vatoi; Lankreti, piktori i vegjëlisë, i sodit këto bulëza që marrin fluturimin në kaltërsinë e qiellit; Didëroi u zgjat krahët të gjitha këtyre dashurizave, dhe D'Yrfe⁷³⁾ përziën me to edhe druidet⁷⁴⁾.

Pasi hëngrën drekë, të katër çiftet kishin shkuar të shihnin, në atë që asokohe quhej katrorja e mbretit, një bimë që sapo kishte ardhur nga India; emri i saj tani na ka dalë nga mendja, por asokohe ajo tërhiqte të gjithë Parisin në Sen-Klud; ishte njëfarë shkurreje me vistak të gjatë, me degë të panumërta, të holla si penjë, të shpupurishura, pa gjethe dhe të mbuluara nga një milion trëndafiltha të vegjël e të bardhë; kjo bënte që shkurrja të dukej si ndonjë bashkë leshi cit me lule. Turma nuk reshte së admiruari bimën.

Si e panë edhe shkurren, Tolomiesi kishte bërtitur: "Dua t'ju qeras me gomarë!", dhe, si bënë pazar me një pronar gomarësh, ata ishin kthyer duke kaluar përmes Vanvës dhe Isit. Në Isi u ngjau një aksident. Parku "Pasuri Kombëtare", pronë asokohe e fabrikantit të municioneve Burgën, rastësisht kishte qëlluar i hapur kat e kat. Kishin kapërcyer grilën, kishin vizituar ashkëtiun manekin në guvën e vet, kishin provuar efektet e vogla misterioze të kabinetit të famshëm të pasqyrave, kurth epshesh i denjë për një satir të bërë milioner ose për Tyrkaretin të shndërruar në Priap⁷⁴⁾. Kishin lëkundur mesa fuqi që kishin shilarsin e lidhur pas dy gështenjave, që i pati bekuar abat Dë Bernisi. Duke i lëkundur njëherë pas tjetrës bukuroshet e tyre, gjë që midis të qeshurave të përgjithshme ngrinte kinde fustanesh që fluturonin, ku Grezi⁷⁵⁾ do ta kishte gjetur hesapin e vet, tuluziani Tolomies, pak edhe si me dell spanjollit - Tuluzi

⁷²⁾ Priftëreshat e lashta të Galisë.

është kushëri me Tolozën këndonte sipas një melodie melankolike këngën e vjetër "gajega", ndoshta të frymëzuar nga ndonjë vajzë e bukur, e flakur me turr mbi ndonjë shilars midis dy drurëve.

*Soy de Badajo,
amor me llama,
toda mi alma,
es en mi ojos,
porque ensenas
a tus piernas."*

Vetëm Fantina nuk pranoi të tundej në shilars.

-Mua s'më pëlqejnë avaze të tilla, - murmuriti athët Favurita.

Me të lënë gomarët, tjetër dëfrim; e kaluan Senën në anije, dhe nga Pasia në këmbë arritën te barriera e Etualit. Ishin ngritur, siç e dimë, që në orën pesë të mëngjesit. "Por bah! s'ka lodhje të dielave", - thoshte Favurita. "Të dielave lodhja nuk punon." Aty nga ora tre, të katër çiftet, të dehur nga lumturia, rrëshqitnin në "malet ruse", ndërtesë e pazakontë që ndodhej asokohe në majat e Bozhonit, vija e së cilës, që gjarpëronte sipër pemëve të "Shanz-Elizeve", dukej që së largu.

Kohë më kohë, Favurita bërtiste:

-Po surpriza! Unë kërkoj surprizën.

-Durim, - përgjigjej Tolomiesi.

⁷⁵⁾ Unë jam nga Badahoza,
dashuria më thërret,
i tërë shpirti im
është në sytë e mi,
kur ti më tregon
këmbët e tua. (Spanjisht.)

Te "Bombarda"

Si ua pinë lëngun edhe "maleve ruse", atyre u ra ndër mend të hanin darkë, dhe tetëshja e gëzuar, më në fund edhe pak si e lodhur, kishte rënë në kabarenë "Bombarda", një degë që kishte ngritur në "Shanz-Elizé" ai i famshmi pronar restorantesh që quhej Bombarda, tabelën e të cilit mund ta shihje asokohe në rrugën "Rivoli" përkrah kalesës "Delormë".

Ishte një dhomë e madhe, por e shëmtuar, me një kamare e shtrat në fund (duke marrë parasysh se kabareja të dielave ishte deng me njerëz, atyre iu desh që ta pranonin këtë skutë); dy dritare, prej nga mund të soditje përmes vidhave skelën dhe lumin; një rreze madhështore e diellit të gushtit prekte shkarazi dritaret; dy tryeza: mbi njëren, një mal triumfues buqetash, të përziera me kapela burrash e grash; te tryeza tjetër, të katër çiftet, ulur rreth një morie pjatash, gotash e shishesh lesh e li; kana birre përzier me shishe vere; mbi tryezë kishte pak rregull, por nën tryezë kishte tamam çrregullime.

*"Ata bënë nën tryezë një zhurmë,
një trik-trak për faqe të zezë", - thotë Moliéri.*

Ja se ku kishte arritur aty nga ora katër e gjysmë e pasditës idili baritor i filluar në orën pesë të mëngjesit. Dielli po ulej, oreksi po shuhej.

"Shanz-Elizéja", cit me diell e me njerëz, ishte e tëra vetëm diell e pluhur, dy gjëra këto nga të cilat përbëhet lavdia. Kuajt e Marlisë, këta mermerë hingëllues, ngriheshin arithi nën një pluhur ari. Karrocat shkonin e vinin. Një eskadron rojash, që shkëlqente, me burizanin në krye, po zbriste nga bulevardi "Nëji"; flamuri i bardhë, pak si ngjyrë trëndafili nën diellin që perëndonte, valëvitej mbi kubenë e "Tuilërive". Sheshi i Konkordës, i cili asokohe ishte ripagëzuar Sheshi Luigji XV, ishte plot me shëtitës të kënaqur. Shumë syresh mbanin

lulezambakun^{*)} prej argjendi të varur në shiritin e shndritshëm, i cili më 1817 nuk ishte zhdukur akoma krejtësisht nga thiletë e jakave. Aty-këtu, midis kalimtarëve që formonin rreth dhe duartrokitnin ca vajza të reja që hidhnin vallen rrethçe, i dërgonin erës një këngë burboniane asokohe të famshme, që donte t'i bënte shkumb e hi të Njëqind Ditët dhe kishte si avaz:

*Jepnani babën tonë të Gandit!
Na jepni babën tonë!*

Tufa banorësh të rrethinave, të veshur si për festë, herë-herë edhe me lulezambakun, si borgjezët, të shpërndarë në sheshin e lodrave "Marinji", luanin unazash dhe silleshin rrotull mbi kuajt e drunjtë; të tjerët pinin; disa të tjerë, çirakë shtypshkronjash, mbanin në kokë kësula letre; të qeshurat e tyre dëgjoheshin aty rrotull. Gjithçka ishte shend e verë. Ishte një kohë paqeje të pakundërshtueshme dhe sigurie të thellë monarkiste; ishte ajo kohë kur një raport intim dhe i posaçëm i prefektit të policisë Angles, drejtuar mbretit mbi lagjet e rrethinave të Parisit, përfundonte me këto radhë: "Po t'i shohim punët hollë, Madhëri, s'duhet pasur frikë nga këta njerëz. Ata s'e çajnë kokën dhe janë të plogët si macet. Harbutëria e krahinave janë turbulluar, kurse ata të Parisit jo. Të gjithë janë njerëz të vegjël. Madhëri, edhe sikur t'i ngjitësh dy prej tyre njërin pas tjetrit, mezi do të bënë një prej granatierëve tuaj. S'ka asnjë rrezik nga ana e milletit të kryeqytetit. Është për t'u shënuar se edhe shtati i njerëzve, që prej pesëdhjetë vjetësh e këtej, është bërë akoma më i vogël në këtë popullsi, dhe popullsia e rrethinave të Parisit është më e vogël në numër se përpara Revolucionit. Ajo nuk është aspak e rrezikshme. Si rrjedhim, është një kope e urtë bagëtish".

Prefektëve të policisë nuk ua merr mendja që një mace mund të kthehet e të bëhet luan; e megjithatë, kjo është plotësisht e mundshme, dhe pikërisht këtu qëndron mrekullia e popullit të Parisit. Veç kësaj, macja, aq e përbuzur nga konti

^{*)} Embleme e mbretërisë.

Angles, nderohej e çmohej nga republikat e lashta; ajo mishëronte, në sytë e tyre, lirinë, dhe, si për të plotësuar Minervën pa flatra të Pireut, në sheshin publik të "Korintit", ndodhej kolosi prej bronzi i një maceje. Policia syleshe e restaurimit e shikonte me ngjyra "tepër të bukura" popullin e Parisit. Ky popull nuk është një "kope aq e urtë bagëtish", sa ç'mund të besohet. Pariziani është për francezët ashtu siç ishte athinasi për grekët; askush s'ia këput gjumit për shtatë palë qejfe si ai, s'ka njeri më mendjelehtë dhe përtac dhe që ta thotë hapur sa ai këtë, s'ia kalon dot njeri kur do të shtiret sikur ka harruar; e megjithatë, nuk i duhet zënë besë, ai është i zoti për çfarëdolloj moskokëçarjeje, por kur lavdia i shkëlqen atje në majë, ai s'e ka shokun për çfarëdolloj furie. Jepini një heshtë, dhe keni për të parë po s'e bëri 10 gushtin⁷⁶⁾, jepini një pushkë, dhe shihni po s'e bëri fora si në Austerlic. Ai është pikëmbështetja e Napoleonit dhe burimi i Dantonit. Është fjala për atdheun? Ai menjëherë rrëmben armët. Është fjala për lirinë? Ai menjëherë shkul kalldrëmin dhe ngre barrikada. Ruajuni! Flokët e tij të ngritur përpjetë nga tërbimi janë epikë: bluza e tij bëhet klamidë⁷⁾. Kini mendjen! Me të parën rrugë "Gërneta" që i del përpara, ai do të të bëjë të kalosh i kërrusur nën sfurqet kaudine⁷⁷⁾. Po të vijë ora, ky banor i rrethinave do të rritet, ky njeri i vogël do të çohet në këmbë dhe do të vështrojë në një mënyrë të tmerrshme, dhe fryma e tij do të bëhet stuhi, dhe do të dalë nga ai kraharor i varfër thatuq aq erë e murlan, sa për të tronditur palat e Alpeve. Sepse, falë rrethinave të Parisit, revolucioni, i përzier me ushtritë, pushton Evropën. Ai këndon, se ky është gëzimi i tij. Përpjesëtojeni këngën e tij me natyrën e tij, dhe pastaj do të shihni! Sa kohë që ai ka për refren "Karmanjolën", ai rrëzon vetëm Luigjin XVI; por bëjeni një herë të këndoje "Marsejezën", dhe shihni pastaj po s'e çliroi të gjithë botën.

Tani që shkruam këtë shënim në qenar të raportit të Anglesit, le të kthehemi përsëri te katër çiftet tona. Darka, siç e thamë, ishte në të mbaruar.

* Tunikë e grekëve të vjetër.

VI

Kapitulli ku njerëzit adhurojnë njëri-tjetrin

Fjalë tryeze e fjalë dashurie; edhe ato, edhe këto janë të pakapshme; fjalët e dashurisë janë ré, fjalët e tryezës janë tym.

Famëji dhe Dahlia këngëzonin nëpër dhëmbë; Tolomiesi pinte; Zefina qeshte, Fantina buzëqeshte. Listolieri po i frynte një trumbete druri të blerë në Sen-Klud. Favurita vështronte ëmbël Blashëvelin dhe i thoshte:

-Blashëvel, unë të adhuroj.

Kjo fjalë i hapi shteg një pyetjeje të Blashëvelit:

-Çfarë do të bëje ti, Favuritë, në qoftë se unë s'do të të dashuroja më?

-Unë! - bërtiti Favurita. - Ah! Mos e thuaj atë fjalë, as me shaka! Po të mos më dashuroje më, unë do të të hidhesha, do të të çirrja me thonj, do të të gërvishtja, do të të hidhja ujë, do të të kërkoja të të arrestonin.

Blashëveli buzëqeshi e u fry si kaposht, si ai që i gudulisin sedrën. Favurita vazhdoi:

-Po, po, do t'u thërritja rojave! Ah! S'do të më bëhej vonë hiç! Laro!

Blashëveli, fort i kënaqur, u lëshua mbi karrigen e vet dhe mbylli të dy sytë plot mburrje.

Dahlia, gjithë duke ngrënë, i tha me zë të ulët Favuritës në mes të asaj gjurulldie:

-Kaq shumë u digjke e u përvëluake ti pas atij Blashëvelit tënd.

-Unë, unë s'e shoh dot me sy, - u përgjigj Favurita po me atë ton, duke kapur përsëri pirunin. - Ai është koprrac. Unë dashuroj atë vogëlushin që e kam karshi shtëpisë. Është shumë i mirë ai djalosh, e njeh ti? Duket se është prerë e qepur për aktor. Unë i dua aktorët. Sa kthehet në shtëpi, e ëma thotë: Ah! O Zot! M'u prish qetësia fare. Prite tani kur të fillojë të bërtasë. More djalë, po ti na e bëre kokën daulle! Sepse ai vete në shtëpi, nëpër hatullat ku rrinë minjtë, nëpër vrima të errëta,

sa më lart që të mundë, dhe nis e këndon, e reciton, a di unë se ç'bën? Aq sa dëgjohet deri poshtë! Tanimë fiton njëzet su në ditë te një avokat për të shkruar aktpadie. Është bir i një psalti të dikurshëm të kishës Sen-Zhak-dy-Pa. Ah! Ai është deli djalë. Më adhuron aq fort, sa një ditë, tek më pa që po zija brumë, më tha: "Zonjushë, bëni petulla me dorashkat tuaja dhe të shihni po s'i hëngra!" Vetëm artistët thonë këso gjërash. Ah! Ai është xhevahir djalë. Po lë mend të pas atij njeriu. Megjithatë, Blashëveletit i them se e adhuroj. Ama, të gënjyer që bëj! Hë? Të gënjyer që bëj!

Favorita heshti një hop dhe vazhdoi:

-Dahlia, nuk e shikon sa e trishtuar jam! Gjithë verën e verës, vetëm shi ka rënë, era më prish nervat, era s'ta nxjerr marazin kurrë. Blashëveletit është shumë kurnac, po pati thjerrëza në pazar, s'dimë, të hamë gjë tjetër veç thjerrëzave; më ka zënë splini^{*)}, si i thonë anglezët. Gjalpi është i shtrenjtë! Dhe pastaj, shih këtu, ç'llahtar, hamë në një vend ku ka edhe një shtrat, kjo më pështiros jetën fare.

VII

Urtësia e Tolomiesit

Por, ndërsa një palë këndonin, të tjerët bisedonin me potere, dhe të gjithë tok s'ishin tjetër veç zhurmë. Tolomiesi ndërhyri.

-Të mos flasim më kuturu, as shumë shpejt, - bërtiti ai. - Le të thellohemi në mendime, në qoftë se duam të jemi njerëz të shkëlqyeshëm. Improvizimi i tepruar e zbraz mendjen kot më kot. Birra që rrjedh, nuk zë shkumë. Zotërinj, mos u ngutni. Le ta përziejmë madhështinë tok me gostinë. Le të hamë qetë e mendjembledhur; ta bëjmë qejfin ngadalë e të mos nxitohemi. Pa shikoni një herë pranverën; po të nxitohet, ajo vjen e ndizet

^{*)}Malli.

flakë, domethënë ngrin si akulli. Zelli i tepruar, i fik drurët e pjeshkave dhe të kumbullave. Zelli i tepruar, e fik hijeshinë dhe gazin e darkave të mira. Lëreni zellin, zotërinj! Grimond dë la Reinieri, është i një mendjeje me Talejrandin⁷⁶⁾.

Një rebelim i mbytur gjëmoi në mes të grupit.

-Tolomies, lërna të qetë, - tha Blashëveletit.

-Poshtë tirani! - tha Famëji.

-Bombarda, Bombanca dhe Bambosha! - bërtiti Listolieri.

-E diela ekziston, - vazhdoi Famëji.

-Ne jemi të matur, - shtoi Listolieri.

-Tolomies, - ia bëri Blashëveletit, - merr shembull nga *moncalme*.^{*)}

-Ti je markez, - u përgjigj Tolomiesi.

Kjo lojë e rëndomtë fjalësh bëri efektin e një guri që bie në një pellg. Markezi Dë Monkalm ishte asokohe një monarkist në zë. Të gjitha bretkosat heshtën.

-Miq, - bërtiti Tolomiesi me tonin e një njeriu që zotëron gjendjen, - mblidhni mendjen. Ky romuz i rënë nga qielli nuk duhet të na shastisë. Gjithçka që bie në këtë mënyrë, nuk është domosdo e denjë për entuziazëm e për respekt. Romuzi është si ajo glasa e mendjes që fluturon. Shakaja e trashë bie dokudo; dhe mendja, pasi ka pjellë një marrëzi, fluturon e zhytet në qiellin e kaltër. Një pllange e zbardhëlleme që përplaset mbi një shkëmb, nuk e ndalon fajkoin të fluturojë. Zoti mos e dhëntë që unë ta shaj e ta fyej romuzin! Unë e nderoj atë aq sa e meriton; asgjë më tepër. Gjithçka që është madhështore, më e lartë dhe më e këndshme në gjininë njerëzore, dhe ndoshta jashtë gjinisë njerëzore, ka bërë lojra fjalësh. Jezu Krishti ka bërë një lojë fjalësh për shën Pjetrin, Moisiu për Isakun, Eskili për Polinin, Kleopatra për Oktavin. Dhe mbani mend mirë që ajo lojë fjalësh që bëri Kleopatra ishte përpara betejës së Aktiumit dhe që, pa këtë lojë fjalësh, askush nuk do ta kuptonte qytetin e Torinës, emër grek, që do të thotë lugë poçesh. Pasi ju dhurova këto, po kthehem prapë të thirrja ime. Vëllezër, ja ku po e përsërit, s'duhet zell, as gjurulldira, as teprira, as

^{*)}Mon kalm (frëngj.) - Qetësia ime.

thumba, as gazmend, as shend, as lojra fjalësh. Dëgjomëni mua; se unë kam maturinë e Amfiarausit dhe urtësinë e Çezarit. Duhet një kufi edhe për rebuset. *Est modus in rebus.*^{*)} Një kufi duhet edhe për darkat. Juve ju pëlqejnë ëmbëlsirat me mollë, zonja, por mos e teproni as me këto. Duhet që, edhe në punë ëmbëlsirash, të tregojmë mençuri dhe art. Grykësia grykësit i ndëshkon. (*Gula punit Gulax*). Urgusja ka marrë urdhër nga Zoti që t'u mësojë moralin stomakëve. Dhe mbani mend këtë: secili nga pasionet tona, edhe vetë dashuria, ka nga një stomak, i cili s'duhet mbushur tepër. Në çdo gjë duhet shkruar në kohën e duhur fjala *finis*, duhet ta mbash veten kur s'pret puna, t'i zësh grykën oreksit, ta bësh zap fantazinë dhe t'i tregosh vendin vetes. I urtë është ai që në çastin e duhur di ta arrestojë veten e tij. Kini pak besim tek unë. Sepse kam nxënë edhe unë pak drejtësi, mesa e tregojnë provimet që kam dhënë, sepse e di ndryshimin që ka midis çështjes në veprim dhe çështjes së mbetur pezull, sepse unë kam mbrojtur një tezë në latinisht mbi mënyrën me të cilën bëheshin torturat në kohën kur Muniatus Demensi ishte kryetar i Bahavrasësit, sepse, meqenëse së shpejti, me gjasë, do të jem doktor, kjo nuk do të thotë se duhet domosdo të jem trutharë. Ju porosit që të jeni të matur në dëshirat tuaja. Është aq e vërtetë që flas mirë, se ç'është e vërtetë që quhem Feliks Tolomies. I lumtur është ai i cili, kur vjen ora, merr një vendim heroik dhe jep dorëheqjen si Sila ose si Origjeni⁷⁹⁾.

Favorita mbante vesh me një vëmendje të thellë.

-Feliks! - tha ajo. - Sa fjalë e bukur! Më pëlqen ky emër. Është latinisht. Do të thotë i lumtur.

Tolomiesi vazhdoi:

-Quirites^{**)}, xhentëlmenë, kavalierë, miqtë e mi! A doni të mos ndieni asnjë sëmbim, ta lini mënjane shtratin martesor dhe t'i bëni ballë dashurisë? S'ka gjë më të thjeshtë. Ja receta: limonatë, ushtrime të tepruara, punë të mundimshme,

^{*)} Est modus in rebus (lat.) – Për çdo gjë duhet masa. (Horaci, satira.)

^{**)} Kuirit – kështu thirreshin qytetarët në disa raste, në jetën civile.

kapituni, tërhiqni blloqe gurësh, mos flini, bëjeni natën ditë, pini sa të mundni pije nitroze^{*)} dhe lëngje nimfash, shijoni përzierje lëng lulekuqesh dhe agnus-kastusi^{**)}, shoqërojeni këtë punë me një periz të rreptë, ngordhni urie dhe shtoni në këtë mes banjat e ftohta, breza barishtesh, vendosjen e një pllake plumbi, locionet me lëngun e Saturnit dhe nxitjet me oksikrat^{***)}.

-Mua më pëlqen më shumë të kem një grua, - tha Listolieri.

-Grua! - vazhdoi Tolomiesi, - mos i zini besë gruas. Mjerë ai që i zë besë zemrës dredharake të gruas. Gruaja është tinëzare dhe të shpie në dyzet çezma e s'të jep një herë ujë. Ajo e urren gjarprin nga zilia e zanatit. Gjarpri është si ai dyqani kundruall që i bën konkurrencë.

-Tolomies, - thirri Blashëvei, - ti qenke dehur!

-Po, besa! - tha Tolomiesi.

-Atëherë, ji i gëzuar, - vazhdoi Blashëvei.

-E pranoj, - u përgjigj Tolomiesi.

Dhe, si mbushi gotën, u çua në këmbë:

-Lavdi verës! *Nunc te, Bacche canam*^{****)}. Më ndjeni, zonjushe, kjo është spanjisht. Dhe prova, senjoras, ja tek është: sipas popullit, edhe vozja. Arroba e Kastiljes merr gjashtëmbëdhjetë litra, kantaroja e Alikantes dymbëdhjetë, almuda e Kanarieve njëzet e pesë, kuartini i Balearëve njëzet e pesë, çizmja e car Pjetrit tridhjetë. Rroftë ai car, që ishte i madh, dhe çizmja e tij, që ishte akoma më e madhe! Zonja, ju këshilloj si mik: ndërrojeni fqinjin, po t'ju duket e udhës. Vetia e dashurisë është të bredhë. Dashuriza nuk është krijuar që të kërruset e të rrëgjohet si ndonjë shërbëtoreshë angleze që i kanë zënë gjunjët kallo. Dashuriza s'është krijuar për këso punësh, ajo bredh e gëzuar, e ëmbla dashuri! Kanë thënë se gabimi është njerëzor; kurse unë them: gabimi është dashuror. Zonja, unë ju adhuroj të gjithave sa jeni, si idhuj. O Zefinë, o Jozefinë, o

^{*)} Që përmban acid nitrik.

^{**)} Bimë mesdhetare me veti qetësuese.

^{***)} Një lloj pije e bërë me uthull e ujë që përdorej nga grekët e vjetër.

^{****)} Tani të jap të pish ty, o Bakus (lat.).

surrat oshafe, do të ishit shumë e lezetshme, po të mos ishit terse. Dukeni si një fytyrë e bukur, mbi të cilën dikush është ulur gabimisht. Përsa i përket Favuritës, o nimfa dhe muza, një ditë kur Blashëveveli po hidhte rrëkenë e rrugës “Gerën-Buaso”, ai pa një vajzë të bukur me çorape të bardha e të tërhequra mirë, e cila tregonte pulpat e saj. Ky prolog atij i pëlqeu, dhe Blashëveveli na ra në dashuri. Atë na e zuri qymyri me Favuritën. O Favuritë, ti ke buzë joniane. Na ishte njëherë motit një piktor grek, që e quanin Euforion, të cilin e kishin mbiquajtur piktor të buzëve. Vetëm ai greku do të kishte qenë i denjë ta pikturonte gojën tënde. Mbaj vesh këtu! Para teje, s’kishte krijesë të denjë për këtë emër. Ti je krijuar për ta marrë mollën si Venusi ose për ta ngrënë si Eva. Bukuria fillon te ti. Tani sa zura, ngoje Evën, por atë e ke krijuar ti. Ti meriton patentën e shpikjes së gruas së bukur. O Favuritë, s’po ju flas me “ti” e me “ty”, sepse po kaloj nga poezia në prozë. Ju, pak më parë, po flisnit për emrin tim. Kjo më ngazëlloi; për cilëtdo që të jemi, duhet të mos u zëmë besë emrave. Emrat mund të na gabojnë. Mua më quajnë Feliks (i lumtur), por i lumtur s’jam. Fjalët janë gënjeshtare. Nuk duhet t’i pranojmë qorrazi njohuritë që na japin ato. Do të ishte gabim të shkoje në Liezhë për të blerë tapa dhe në Pau për të blerë doreza. Mis Dahlia, po të isha unë në vendin tënd, do ta quaja veten Roza. Lulja duhet të ketë erë të mirë dhe gruaja duhet të ketë mend. S’po them gjë për Fantinën, ajo është ëndërruese, e menduar dhe e ndjeshme; ajo është një hije që ka trajtën e një nimfe dhe ndershmërinë e një gjysheje, që depërton në jetën e vajzës dorëhollë, por që vete e gjen strofkë në ëndrrën e rreme, dhe këndon, e lutet, e vështron qiellin e kaltër, pa ditur se çfarë sheh e çfarë bën, e me sy nga qielli, endet në një kopsht ku ka më shumë zogj nga sa ekzistojnë në të vërtetë! O Fantinë! Dije mirë se unë, Tolomiesi, jam një ëndërr e rreme; por kjo leshverdhë e ëndrrave as po më dëgjon fare! Megjithatë, ajo është e tëra freski, butësi, rini, dritë e ëmbël mëngjesore. O Fantinë, vajzë që meriton të të quajnë luleshqerrë ose margaritar, ti je një grua e gatuar me brumin e ngjyrën më të bukur. Zonja, dëgjoni edhe një këshillë të dytë; hiç mos u

martoni; martesë është një shartim; dhe shartimi mund të zërë mirë, por mund të zërë keq; largojuni këtij sherri. Por, bah! Ç’po lllomotit kështu unë? I humba edhe fjalët. Vajzat janë të pashërueshme kur është fjala për fejesë; dhe, sado të flasim ne, njerëzit me një barrë mend, kjo nuk do t’i ndalojë jellekeqepëset dhe këpucëbërëset të ëndërrojnë për burra të pasur me diamante. Fundi, ashtu qoftë; por ju, bukuroshe, mbani mend këtë; ju hani sheqer me të tepërt. Veç një faj keni ju, gra: që skërmitni sheqer. O seks brerësash, dhëmbët tuaj të bukur, të vegjël e të bardhë, e adhurojnë sheqerin. Por, mbajeni mend mirë, sheqeri është kripë. Çdo kripë të than e të regj. Sheqeri të than më shumë se çdo kripë tjetër. Ai thith përmes damarëve lëngjet e gjakut; nga kjo vjen mpiksja e gjakut, trashja, pastaj ngurtësimi i gjakut; nga kjo vijnë pastaj tuberkulet në mushkëritë; dhe nga kjo, vdekja. Dhe pikërisht për këtë arsye diabeti dhe ftizia janë motër e vëlla. Pra, po të mos breni sheqer, do të rroni gjatë! Tani, po u kthehem burrave. Zotërinj, zaptoni sa të mundni. Rrëmbejani, pa e çarë kokën, njëri-tjetrit dashnoret. Përzieni-kryqëzoni. Në dashuri s’ka miq. Kudo që ka një grua të bukur, sherri është i hapur. Asnjë mëshirë, luftë për vdekje. Një grua e bukur është një *casus belli**; një grua e bukur është një faj i hapët. Të gjitha sulmet e historisë janë shkaktuar nga fustanet. Gruaja është e drejta e burrit. Romulusi rrëmbeu Sabinat. Guljelmi rrëmbeu saksonet, Çezari rrëmbeu romaket. Burri që s’është i dashuruar, sillet si fajkua mbi dashnoret e të tjerëve; dhe, përsa më përket mua, të gjithë atyre të pafatve që janë të ve, unë u lëshoj thirrjen e lartë që Bonaparti i lëshoi ushtrisë së Italisë: “Ushtarë, juve ju mungon gjithçka. Armiku i ka të gjitha”.

Tolomiesi e preu fjalën.

-Merr pak frymë, Tolomies, - tha Blashëveveli.

Dhe, në të njëjtën kohë, Blashëveveli, i shoqëruar nga Listolieri dhe Famëji, ia nisi një avazi si më të qarë, një prej atyre këngëve të punishteve, të kompozuar me fjalët e para që vijnë në gojë, me rima të pasura ose pa rima fare, pa pikë

* Shkak lufte.

kuptimi, ashtu si lëvizja e degëve të drurëve dhe zhurma e erës, këngë që lindin nga tymi i çibukëve dhe shkrihen e fluturojnë bashkë me të. Ja se me çfarë kupleti ia ktheu ky grup përgjigjen llogos së Tolomiesit:

*Priftërit gjeldeta shtinë,
para një xhandari i dhanë
që Klermon-Toner efendinë
papë ta bënin për Shën Janë,
por Klermoni, prapseprapë,
pse s'qe prift, s'u bë dot papë;
dhe xhandari, i inatosur,
paratë ktheu i xhindosur.*

Por kjo nuk ia ftohu frymëzimin Tolomiesit; ai ktheu gotën, e mbushi përsëri dhe vazhdoi:

-Poshtë urtësia! Harrojini të gjitha ato që thashë më parë. S'duhet të jemi as të matur, as të urtë, as të virtytshëm. Këtë dolli e ngre për gëzimin; le të jemi të gëzuar! Le t'i plotësojmë studimet e Drejtësisë me marrëzinë dhe ushqimin. Edhe urgusje, edhe kanun. Le të jetë Justiniani mashkulli dhe gostia femra. Gëzim thellësirave! Rrofsh, o krijesë! Bota është një diamant i madh! Unë jam i lumtur! Zogjtë janë të mahnitshëm! Ç'festë paska gjithandej! Bilbili është Eleviu falas. Behar, të falem! O Luksemburg, o Gjeorgjike të rrugës "Madamë" dhe të shëtitores së "Observatorit!" O ushtarë ëndërrues! O ju, të gjitha shërbëtoret e lezetshme, që, ndërsa ruani fëmijët e të tjerëve, argëtoheni duke bërë edhe vetë fëmijë! Pampat e Amerikës do të më pëlqenin shumë, po të mos kisha harkoret e Odeonit. Shpirti im fluturon pyjeve të virgjra dhe savaneve. Gjithçka është e bukur! Mizat sillen e zhurmërojnë nëpër rrezet e dritës. Dielli e ka nxjerrë kolibrin nga hundët. Përqaqomë, Fantinë!

Ai lajthiti dhe puthi Favuritën.

VIII

Ngordhja e një kali

-Hahet më mirë tek "Edoni" se te "Bombarda", - bërtiti Zefina.

-Mua më pëlqen më shumë "Bombarda" se "Edoni", - ia pat Blashëve. - Këtu ka më shumë luks. Është më aziatik. Shihni sallën, poshtë. Aty ka pasqyra mureve.

-Pasqyrat dua t'i kem më mirë në pjatën time, - tha Favurita.

Blashëve nguli këmbë:

-Shikojini një herë thikat. Dorezat janë prej argjendi te "Bombarda", kurse tek "Edoni" prej kocke. Pra, argjendi është më i vlefshëm se kocka.

-Duke bërë përjashtim për ata që e kanë mjekrën prej argjendi, - vërejti Tolomiesi.

Ai vështronte në atë çast kubënë e "Invalidëve", që dukej nga dritaret e "Bombardës".

Ra heshtja për një hop.

-Tolomies, - thirri Famëji, - pak më parë Listolieri dhe unë kishim një diskutim.

-Diskutimi është i mirë, por zënka është akoma më e mirë.

-Po hahemi për punë filozofie.

-Ashtu qoftë.

-Cili të pëlqen më shumë, Dekarti apo Spinoza?

-Dezozhieri⁸⁰⁾, - tha Tolomiesi.

Si dha këtë mendim, piu një herë dhe ia nisi përsëri:

-Unë pranoj të jetoj. Gjithçka nuk ka humbur mbi këtë tokë, përderisa njeriu mund të flasë marrëzira. Për këtë, u falem perëndive të pavdekshme. Njerëzit gënjejnë, por edhe qeshin. Pohojnë, por edhe dyshojnë. E papritura shpërthen nga silogjizma. Sa bukur! Ka akoma në këtë dynja njerëz të cilët dinë t'i hapin e t'i mbyllin me gaz kutitë e surprizave të paradoksit. Kjo, zonjat e mia, që po pini me kaq qetësi, është verë nga Madera, lëng i pastër i Kural das Freirasit, që është

treqind e shtatëmbëdhjetë pashë mbi sipërfaqen e detit! Kini mendjen kur pini! Treqind e shtatëmbëdhjetë pashë! Dhe zoti Bombarda, ky gjellëbërës i madhërishëm, jua jep këto treqind e shtatëmbëdhjetë pashë për katër franga e pesëdhjetë qindarka.

Famëji e ndërpreu përsëri.

-Mendimet e tua për ne janë ligj. Cili është autori yt më i dashur?

-Ber...

-Keni?⁸¹

-Jo. Shui.

Dhe Tolomiesi vazhdoi:

-Lavdi Bombardës! Do të bëhej i barabartë me Munofisin e "Elefantit", po të mundte të më gjente një çingi, dhe me Tigjelionin e "Keronese", po të më sillte këtu një mikeshë! Sepse, o zonja, ka pasur Bombardë edhe në Greqi, edhe në Egjipt. Këtë na e thotë Apulei. Vaj medet! Gjithmonë po ato gjëra dhe asgjë të ré! Asgjë të pabotuar në krijimin e krijuesit! "Nil sub sole novum"^{*)} - thotë Solomoni; "Amor omnibus idem"^{**)} - thotë Virgjili; dhe Karabina hipën me Karabinin në kaiken e Sen-Kludit, ashtu si Aspasia hipte me Perikliun mbi flotën e Samosit. Edhe një fjalë të fundit. A e dini ju se kush ishte Aspasia⁸²⁾, o zonja? Megjithëse ajo jetoi në një kohë kur gratë s'kishin akoma shpirt, ajo ishte një shpirt; një shpirt me një ngjyrë si trëndafili dhe të purpurt, më të ndezur se zjarri, më të freskët se agimi. Aspasia ishte një krijesë, tek e cila puqeshin të dyja skajet e gruas; ajo ishte prostituta perëndeshë. Sokrati plus Manon Leskoja⁸³⁾. Aspasia pati qenë krijuar për atë rast kur Prometeut t'i duhej ndonjë grua e përdalë.

Ashtu siç e kishte marrë turrin Tolomiesi, vështirë që të reshtte, po të mos ishte rrëzuar një kalë buzë lumit tamam në atë çast. Nga kjo goditje e papritur, karro e orator shtangën në vend. Ishte një pelë nga krahina e Bosës, e plakur, ngordhalaqe dhe e denjë për kasapin, e cila tërhiqte një karro fort të rëndë.

*) Nil sub solem novum (lat.) - Asgjë e re nën këtë diell.

***) Amor omnibus idem (lat.) - Dashuria është e njëjtë për të gjithë.

Si kishte mbërritur përpara "Bombardës", kafsha, e lodhur dhe e rraskapitur, s'kishte dëgjuar të shkonte më tutje. Nga kjo ngjarje ishte grumbulluar një turmë e madhe. Karrocieri s'kishte mbaruar akoma së nëmuri dhe së shqiptuari me energjinë e duhur fjalën e shenjtëruar: *bushtër!* të shoqëruar me një goditje therëse me kamxhik, kur gërdalla ishte rrëzuar për të mos u çuar më. Mes gjurulldisë së njerëzve që kalonin, dëgjuesit e gëzuar të Tolomiesit kthyen kokën, dhe Tolomiesi përfitoi nga ky rast për të mbyllur fjalimin e tij me këtë strofë melankolike:

*Ajo rrinte në kët'botë, ku qerret dhe karrot
kanë po një fat,
dhe gërdallëza jetoi sa jetë kan'gërdallat,
sa bushtra, dhe e pat.*

-I mjeri kalë! - psherëtiu Fantina.

Dhe Dahlia bërtiti:

-Ja dhe kjo Fantina tani, do të fillojë t'u qajë hallin kuajve! Hajde, hajvane, hajde!

Në këtë çast, Favurita, duke kryqëzuar krahët dhe duke hedhur kokën prapa, vështroi me ngulm Tolomiesin dhe tha:

-Pa dale, një herë! Po surprizën ç'na e bëre?

-Tamam. Ka ardhur koha, - tha Tolomiesi. - Zotërinj, ora për të habitur këto zonja ka tingëlluar. Zonja, prisnani një hop.

-Kjo punë fillon me një të puthur, - tha Blashëvevi.

-Në ballë, - shtoi Tolomiesi.

Secili lëshoi rëndë-rëndë nga një të puthur mbi ballin e dashnores së vet, pastaj që të katër bënë për nga porta, njëri pas tjetrit, duke vënë gishtin në gojë.

Favurita përplasi duart kur ata dolën jashtë.

-Sa e lezetshme që pa nisur mirë, - tha ajo.

-Mos u mënoni shumë, - murmuriti Fantina. - Ju presim.

Fundi gazmor i gëzimit

Vajzat, si mbetën vetëm, u mbështetën me bërryla mbi pezul të dritareve duke kakaritur, duke përkulur kokën dhe duke folur me shoqja-shoqen nga një dritare te tjetra.

Ato i panë djelmoshat tek dolën nga kabareja "Bombarda", të zënë për krahu: ata u kthyen, ua bënë me dorë duke qeshur dhe u zhdukën në atë mizëri gjithë pluhur të së dielës, që vërshon çdo javë në "Shanz-Elizé".

-Mos mënoni shumë! - bërtiti Fantina.

-Ç'do të na sjellin vallë? - tha Zefina.

-Me siguri që do të jetë ndonjë gjë e bukur, - tha Dahlia.

-Unë, - ia nisi Favurita, - dua që të jetë diçka prej ari.

Pas pak ato u harruan pas lëvizjes së bregut të lumit, të cilin e shquanin përmes degëve të drurëve të mëdhenj. Ky bregu i lumit po i argëtonte fort. Ishte ora e nisjes së arkave të postës dhe e karrocave të udhëtarëve. Pothuajse të gjitha mjetet e mbartjes për në Jug dhe në Perëndim të vendit kalonin asokohe nëpër "Shanz-Elizé". Pjesa më e madhe shkonin gjatë bregut dhe dilnin nga ana e barrierës së Pasisë. Nga minuta në minutë, ndonjë karrocë e madhe, e lyster me të verdhë e me të zi, e ngarkuar rëndë, e tërhequr plot zhurmë, e përçudnuar nga baulet, arkat e valixhet, plot koka që zhdukeshin aty për aty, duke dërrmuar tabanin e rrugës e duke kthyer kalldrëmin në çakëll, turrej përmes turmës me të gjitha shkëndijat e një farke, me pluhur, në vend të tymit, dhe me një pamje si prej furie. Kjo gjurulldi e madhe i gëzonte vajzat e reja. Favurita këlthiste:

-Çfarë rrapëllime! A thua se janë vandakë zinxhirësh që ikin fluturimthi.

Qëlloi një herë që njëra nga karrocet, që mezi shquheshin përmes dendësisë së vidhave, qëndroi një hop, pastaj u nis përsëri me kup. Kjo gjë e habiti Fantinën.

-Sa çudi! - tha vajza. - Unë besoj se karroca e pasagjerëve nuk ndalej.

Favurita ngriti supet.

-Sa tuhafe paska qenë edhe kjo Fantina! Unë e shoh nga kërshtëria. Edhe gjërat më të thjeshta ia marrin mendtë fare. Ja, për shembull, ta zëmë se unë jam një udhëtar dhe i them karrocës: "Unë po shkoj përpara, do të më gjeni te bregu i lumit kur të kaloni andej". Karroca kalon, ndalet dhe më merr. Kjo punë ngjet përditë. Ti nuk e njeh jetën, moj e dashur.

Kaloi njëfarë kohe kështu. Befas, Favurita bëri një lëvizje, si një njeri që zgjohet nga gjumi.

-Eh, pra, por surpriza ç'u bë?

-Po, vërtet, - ia pat Dahlia, - po ajo surpriza e famshme?

-U mënuan shumë, - tha Fantina.

Teksa Fantina po i jepte fund kësaj psherëtime, kamerieri, që u kishte shërbyer darkën, hyri brenda. Ai mbante në dorë diçka që i përngjiste një letre.

-Ç'është kjo? - pyeti Favurita.

Kamerieri u përgjigj:

-Është një letër që ata zotërinjtë lanë për këto zonja.

-Pse nuk e sollët menjëherë?

-Sepse ata zotërinjtë, - vazhdoi kamerieri, - porositën që të mos ua dorëzojmë këtyre zonjave pa kaluar një orë.

Favurita e rrëmbeu copën e kartës nga duart e kamerierit. Me të vërtetë, ajo ishte një letër.

-Pa shih! - tha ajo. - S'paska as adresë. Por ja se ç'shkruan sipër:

KJO ËSHTË SURPRIZA

Shkoliti shpejt e shpejt letrën, e hapi dhe lexoi (dinte të lexonte):

"O dashnoret tona!

"Dijeni se ne kemi prindër. Por ju nuk e dini se ç'janë prindërit. Këta quhen etër dhe nëna në Kodin Civil, që është i padjallëzuar dhe i ndershëm. Por, ja që këta prindër rënkojnë, këta pleq na kërkojnë, këta burra të mirë dhe këto gra të mira na quajnë fëmijë plëngprishës, urojnë që të kthehemi dhe na taksin viça për gosti. Ne u bindemi atyre, se jemi djem të mbarë. Kur do të lexoni këtë letër, pesë kuaj të fortë do të jenë

duke na çuar tek etërit dhe nënat tona. Po qërohemi së këtejmi, siç thotë Bosyeti. Ne po shkojmë, jemi nisur. Ne po ikim në krahët e Lafitit dhe mbi flatrat e Kajardit⁸⁴⁾. Karroca e Tuluzit po na shkëlqon nga humnera, dhe humnera jeni ju, o vogëlushet e bukura! Ne po biem theror. Qanani shpejt e shpejt dhe zëvendësonani sa më parë. Në qoftë se kjo letër ju copëton zemrën, dorëzohani atij që jua solli. Lamtumirë!

“Për afro dy vjet, ju kemi bërë të lumtura. Mos na mbani mëri.

“Nënshkruar: *BLASHËVELEË
FAMËJ
LISTOLIER
FELIKS TOLOMIËS*”

Post-scriptum: *Darka është e paguar*”

Të katër vajzat e reja vështruan njëra-tjetrën.

Favurita e prishi e para qetësinë.

-Eh, pra, - bërtiti ajo, - sidoqoftë, kjo është një shaka e bukur.

-Sa e çuditshme, - tha Zefina.

-Blashëveleit do t'ia ketë pjellë mendja këtë punë, - vazhdoi Favurita. - Kjo më bën që të bie në dashuri pas tij. Larg syve, pranë zemrës. Kjo është e tërë historia.

-Jo, - tha Dahlia, - këtë do ta ketë shpikur Tolomiesi. Duket që atje tej.

-Atëherë, - vazhdoi Favurita, - vdekje Blashëveleit dhe rroftë Tolomiesi.

-Rroftë Tolomiesi! - bërtitën Dahlia dhe Zefina.

Dhe ia plasën gazit.

Fantina qeshi si të tjerat.

Një orë më pas, kur u kthye në dhomën e vet, ajo qau. Kjo, e thamë, ishte dashuria e saj e parë; i ishte dhënë atij, Tolomiesit, si i jepet gruaja burrit të vet, dhe vajza e shkretë priste një fëmijë.

Libri i katërt

TË LËSH AMANET,
DISA HERË DO TË THOTË TË DORËZOSH

I

Një nënë që takon një nënë tjetër

Në çerekun e parë të këtij shekulli, na ishte në Monfermej, afër Parisit, njëfarë taverne, e cila sot nuk është më. Kjo tavernë mbahej nga disa njerëz që quheshin Tenardie, burrë e grua. Ndodhej në rrugën “Bulanzhé”. Sipër derës shikoje një dërrasë të mbërthyer si pllakë në mur. Mbi këtë dërrasë ishte pikturuar diçka që ngjante me një si burrë, i cili mbante në shpinë një burrë tjetër që kishte supëza të mëdha gjenerali të lara në ar, me ca yje të mëdha të lara në argjend; disa njolla të kuqe tregonin gjakun; pjesa tjetër e tablosë ishte e tëra tym dhe paraqiste me gjasë një betejë. Përfund, lexohej ky mbishkrim: “TE RRESHTERI I VATERLOSË”.

S'ka gjë më të rëndomtë se një araba ose karro te porta e një bujtine. Por karroja ose, që të themi më mirë, copa e karros që pengonte rrugën përpara bujtinës të “Rreshterit të Vaterlosë”, asaj mbrëmjeje pranvere të vitit 1818 me madhësinë e saj do t'ia kishte tërhequr vëmendjen ndonjë piktori që do t'i qëllonte të kalonte asaj ane.

Ishte pjesa e përparme e atyre qerreve që përdoren në vende pyjore e që shërbejnë për të tërhequr trarë dhe trungje. Kjo pjesë përbëhej nga një bosht i trashë hekuri me një

strumbull, ku kllaposej një timon i rëndë dhe që e mbanin peshë dy rrota jashtë masës të mëdha. E gjithë kjo gjë ishte kaba, e rëndë dhe e shëmtuar. Të thoshte mendja se ishte shtrati i ndonjë topi vigan. Vragat e udhëve i kishin mbathur rrotat, rrathët, kokat e rrotave, boshtin dhe timonin me një kore llumi, përlyerje e neveritshme e verdheme dhe mjaft e përngjashme me ngjyrën që u japin rëndom katedraleve. Pjesët e drunjta ishin mbuluar nga balta dhe ato të hekurtat nga ndryshku. Nën bosht, varej si lak, një vargua i trashë, i denjë për Goliathin e dënuar me punë të rënda. Ky vargua të bënte të mendoje jo për trarët që kishte për zanat të mbartte, por për mastodontët⁸⁵⁾ dhe mamonët që mund të mbreheshin në të; ai vargua kishte pamjen e një burgu punësh të rënda, por të një burgu ciklopik e mbinjerëzor, dhe dukej sikur ishte shkëputur nga ndonjë përbindësh. Homeri do të kishte lidhur aty Polifemin dhe Shekspiri Kalibanin.⁸⁵⁾

Për ç'arsye ajo pjesë e përparme e asaj karroje ishte aty në rrugë? Së pari, për të zënë rrugën; pastaj, për t'u ronitur nga ndryshku. Në rendin e vjetër shoqëror ka një mori institucionesh që njeriu i has kësodore udhës së vet përjashta dhe që s'kanë asnjë arsye tjetër për të qenë aty.

Qendra e vargoit varej nën bosht fare afër tokës, dhe mbi pjesën e lakuar të vargoit, tamam si mbi litarin e ndonjë shilarësi, ishin ulur e mbledhur shuk asaj mbrëmjeje e ishin pushtuar për qejf dy vajza të vogla, njëra afro dy vjeç e gjysmë dhe tjetra tetëmbëdhjetëmuajshe, më e vogla në krahët e më së madhes. Një shami e lidhur me marifet nuk i linte ato të rrëzoheshin. Një nënë e kishte parë këtë vargua që të shtinte datën dhe kishte thënë: "Pa shih! Kjo qenka një lodër e mirë për fëmijët e mi".

Të dy fëmijët, të veshur e stolisur me shije dhe me njëfarë merak, shkëlqenin, të thoshe se ishin dy trëndafila në mes të hekurishteve; sytë e tyre ishin një triumf i vërtetë; faqet e tyre të kizëta qeshnin. Njëra ishte gështenjë, tjetra zeshkane. Fytyrat e tyre të padjallëzuara ishin të habitura e të kënaqura; një

⁸⁵⁾ Mamifer gjigant, i afërt me elefantin.

kaçubë që kishte lëshuar lule e që ndodhej aty afër, u dërgonte kalimtarëve një parfum, i cili dukej sikur vinte nga vajzat; ajo tetëmbëdhjetëmuajshe kishte lënë të zbuluar barkucin e saj të lezetshëm me atë paturpësinë e dëlirë të vogëlisë. Sipër e rreth e qark atyre dy kokave delikate, të brumosura në lumturi dhe të kredhura në dritë, lakohej si ndonjë qemer në hyrjen e shpellave pjesa e përparme vigane e karros, e nxirë nga ndryshku, pothuajse e tmerrshme, gjithë shkapërdredhur me bërryla e cepa të frikshëm. Disa hapa më tej, e ulur galiç mbi pragun e hanit, qëndronte e ëma, një grua që, nga të pamët, s'ishte edhe aq për të qenë, por që në atë çast të prekte, tek lëkundte të dy fëmijët e vet me anën e një gjalmi të gjatë, duke i kllaçitur me sy nga frika e ndonjë aksidenti, me atë shprehje shtazore e qiellore, që është veti e mëmësisë; në çdo vajtje-ardhje, hallkat e neveritshme lëshonin një gërvimë çjerrëse, e cila i përngjiste një britmë inati; vajzat e vogla po shkriheshin nga kënaqësia, dielli, që po perëndonte, përzihej me këtë gëzim, dhe s'kishte gjë më të hijshme sesa kjo tekë e rastit, që e kishte bërë atë vargua për titanë një ndenjëse shilarsi për engjëjt kerubinë.

Teksa tundte të dy vogëlushet e veta, nëna këndonte nëpër dhëmbë me një zë fals një romancë të famshme asokohe.

Ashtu duhet, - i thoshte një luftëtar...

Kënga dhe ruajtja e vajzave të veta nuk e linin të dëgjonte e të shikonte se çfarë po ngjiste në rrugë.

Ndërkohë, dikush i ishte afruar; teksa po fillonte strofën e parë të romancës, befas dëgjoi një zë që po i thoshte fare afër veshit:

-Paskeni dy fëmijë të bukur, zonjë.

Imozhinës së bukur e të ëmbël, - u përgjigj nëna duke vazhduar romancën e saj, pastaj ktheu kokën.

Një grua ndodhej përpara saj, disa hapa më tutje. Kjo grua kishte, edhe ajo, një fëmijë që e mbante në krah.

Veç kësaj, ajo mbante dhe një torbë mjaft të madhe, e cila dukej se ishte fort e rëndë.

Fëmija e kësaj gruaje ishte qenia më hyjnore që mund të shihje. Ishte një vajzë nja dy a tre vjeçe. Ajo mund të hahej fare mirë me dy vogëlushet e tjera për nga shija me të cilën qe veshur; ajo kishte një grykëse prej pëlhure të hollë, një bluzë me fjongo dhe një kapuç me dantella. Pala e fustanit të saj ishte ngritur dhe linte zbuluar kofshëzën e saj të bardhë, topolake dhe të ngjeshur si thelb. Ishte ngjyrë trëndafil dhe vinte e ardhangët. Të vinte t'ia kafshoje mollëzat e faqeve me dhëmbë. S'mund të thoshe gjë për sytë e saj, veç që ata duhej të ishin shumë të mëdhenj dhe që kishin ca qerpikë madhështorë. Fëmija flinte.

Flinte me atë gjumin plot besim, siç flenë të gjithë fëmijët e moshës së saj. Krahët e nënave janë mburjtur me dhembshuri: në ata krahë fëmijët flenë gjumë shqerrash.

Përsa i përket nënës, ajo kishte një pamje të varfër e të trishtuar. Ishte veshur si një punëtoare që po kthehet përsëri në fshatare. Ishte e re. A ishte e bukur? Ndoshta, por me atë veshje nuk dukej. Flokët e saj, nga kishte shpëtuar një balukez e verdhë, dukeshin shumë të dendur, por ishin mbuluar paq nën një skufje të shëmtuar të shtrënguar, të ngushtë dhe të lidhur nën mjekër, si ato të disa murgeshave. Të qeshurit tregon dhëmbët e bukur, kur njeriu ka të tillë; por ajo nuk qeshte fare. Sytë e saj nuk dukeshin të kishin shumë kohë që ishin tharë. Ajo ishte e zbehtë në fytyrë; dukej si shumë e lodhur dhe pak si e sëmurë; ajo e vështronte të bijën, të përgjumur në krahët e saj, me atë mënyrën e veçantë të një nëne që e ka ushqyer pjellën e vet. Një shami e gjerë ngjyrë qielli, si ato që përdorin invalidët për të shfryrë hundët, e palosur cep më cep, mbulonte pa pikë shijeje belin e saj. Duart i kishte të rreshkura nga dielli dhe era dhe të mbushura me pullëza të kuqe, gishtin tregues tërë kallo dhe të brejtur nga gjilpëra; kishte veshur një manto leshi të murrme dhe pa mëngë, një fustan basme dhe këpucë të mëdha. Kjo ishte Fantina.

Fantina, vështirë ta njihje. Megjithatë, po ta vëreje me kujdes, ajo e ruante akoma bukurinë e saj. Një rrudhë e trishtuar, që i përngjiste fillimit të ironisë, vijoste faqen e saj të djathtë. Përsa i përket veshjes e nisjes së saj, ajo veshje e lehtë

muselinash dhe fjongosh, që dukej sikur ishte prerë e qepur jo me plaçkë, por me gaz, marrëzi dhe muzikë, plot xhingla dhe e parfumuar me erën e zambakut, ajo veshje ishte fikur e bërë hije, si ato brymërat e bukura e të shndritshme që i pandeh se janë diamante në diell, por që shkrihen dhe e lënë degën krejt të zezë.

Kishin kaluar dhjetë muaj^{*)} që nga ajo "shakaja e bukur".

Çfarë kishte ndodhur gjatë atyre dhjetë muajve? Mund të merret me mend.

Pas braktisjes, pllakosën hallet. Fantina i kishte humbur menjëherë nga sytë Favuritën, Zefinën dhe Dahlien; lidhja, e këputur nga ana e burrave, ishte zhëdredhur nga ana e grave; po t'u kishe thënë pas pesëmbëdhjetë ditësh se kishin qenë mikështa me njëra-tjetrën, ato do të çuditëshin fare; s'kishte asnjë arsye pse të ishin mikështa. Fantina kishte mbetur vetëm. Babai i fëmijës së saj kishte ikur - medet! Këto ndarje janë të pandreqshme - dhe ajo u gjet fillikat vetëm; shprehia e punës i ishte shuar, kurse shija e qejfeve i ishte ndezur. E shtyrë nga lidhja me Tolomiesin, që ta përbuzte atë copëz mjeshtëri që dinte, ajo i kishte lënë mbas dore burimet e jetesës; këto burime ishin mbyllur. Asnjë mjet tjetër s'kishte. Fantina mezi dinte të lexonte, kurse për të shkruar nuk dinte fare; që kur ishte fëmijë i kishin mësuar sa të vinte firmën e saj; i kishte shkruar Tolomiesit një letër me anë të një shkruesi publik, pastaj një të dytë, mandej një të tretë. Tolomiesi s'i qe përgjigjur asnjëherë prej tyre. Një ditë Fantina dëgjoi ca ngjelka që thoshin duke vështruar të bijën: "A e vlen barra qiranë t'ua varësh edhe aq fort fëmijëve si kjo? Për kesi fëmijësh nuk duhet çarë kryet fare!" Atëherë ajo solli ndër mend Tolomiesin, i cili s'e çante kryet për fëmijën e tij dhe nuk ia varte fare kësaj krijese të pafajshme; dhe zemra iu mbush me vrer për këtë njeri. Po nga t'ia mbante? Kujt t'i drejtohej? Kishte bërë një gabim, por thelbi i natyrës së saj, siç e pamë, ishte ndershmëri dhe virtyt. Ajo ndjeu, ashtu

^{*)} Në faqen 179 thuhet se Kozeta ishte një vajzë dy a tri vjeçe, kurse këtu del se kanë kaluar vetëm dhjetë muaj nga ndarja e çiftit. Kjo është një inkoseguencë e autorit edhe në origjinal.

tymthi, se ishte në pragun e mjerimit dhe gati për të rrëshqitur poshtë e më poshtë. Duhej kurajë; mori zemër dhe e mbledhi veten. I ra në mendje të kthehej në qytetin ku kishte lindur, në Montréj-syr-Mer.

Atje ndoshta dikush do ta njihte dhe do t'i jepte punë. Po, por do t'i duhej të fshihte gabimin që kishte bërë. Ajo agjëronte si nëpër mjegull se patjetër do t'i duhej të përballonte ndonjë ndarje akoma edhe më të dhimbshme se të parën. Fantina, siç do ta shohim, ishte grua sokoleshë dhe dinte t'i bënte ballë jetës.

Ajo kishte hequr dorë me kurajë nga zbulimet, ishte veshur me rroba pëlhere dhe ia kishte vënë të gjitha mëndafshet, fjongot dhe dantelat së bijës, e vetmja mburrje që i kishte mbetur, mburrje e shenjtë. Ajo shiti ç'kishte e ç'nuk kishte, e me këto mbledhi dyqind franga, por, si lau disa borxhe të vogla, asaj s'i mbetën më tepër se tetëdhjetë franga. Në moshën njëzet e dy vjeç, një mëngjes të bukur pranvere, Fantina largohej nga Parisi, duke mbajtur të bijën në kurriz. Sikur t'i kishte parë ndokush ashtu duke kaluar të dyja, do t'i kishte ardhur shumë keq. Ajo grua s'kishte tjetër në botë veç asaj fëmije, dhe ajo fëmijë s'kishte tjetër në botë veç asaj gruaje. Fantina e kishte ushqyer vetë të bijën; kjo punë ia kishte lodhur kraharorin dhe çoku kollitej pak.

Nuk do të na takojë më rasti të flasim për Feliks Tolomiesin. Le të themi vetëm se njëzet vjet më pas, nën mbretërimin e Luigj-Filipit, ai ishte një avokat i madh krahine, me influencë dhe i pasur, zgjedhës i urtë dhe anëtar gjykate i rreptë, gjithmonë njeri i qejfeve.

Si kishte bërë mjaft udhë copa-copa, duke hipur herë pas here në ato që asokohe quheshin karrocat e vogla të rretheve të Parisit, me qëllim që të çlodhej, duke paguar nga tri-katër su për legë, Fantina, aty nga mesdita, u gjend në Monfermeij, në rrugëzën "Bulanzhé".

Tek po kalonte përpara hanit të Ténardieve, ato dy vajzat e vogla, që po shkriheshin nga kënaqësia mbi shilarësin e tyre të përbindshëm, ia kishin marrë sytë dhe ajo ishte ndalur përpara këtij vegimi të gëzimit.

Ka në botë gjëra që të magjepsin. Këto dy vajzat e vogla ishin një magjepsje e tillë për këtë nënë.

Ajo po i vështronte shumë e mallëngjyer. Prania e engjëjve është paralajmërim i parajsës. Asaj iu duk sikur pa mbi këtë bujtinë KËTU-në misterioze të fatit. Ato dy vogëlushet dukej sheshit që ishin aq të lumtura sa s'bëhej! Ajo i vështronte, i sodiste kaq e ngazëllyer, sa, në çastin kur nëna e tyre merrte frymë midis dy vargjesh të këngës së vet, Fantina nuk u përmbajt dot dhe i tha aty fjalët që lexuat më lart:

-Paskeni dy fëmijë të bukur, zonjë.

Edhe krijesat më shtazarake çarmatosen kur dikush ua ledhaton fëmijët e tyre. Nëna ngriti kokën dhe falënderoi, dhe e ftoi kalimtarin të ulej te banka e portës, kurse ajo vetë ishte ulur te pragu. Të dyja gratë ia nisën bisedës.

-Më thonë zonja Tenardie, - tha nëna e dy vogëlusheve. - Mbajmë këtë bujtinën këtu.

Pastaj, pa e kështur romancën e saj, vazhdoi si nëpër dhëmbë:

*Duhet, duhet, jam kalorës
që të shkoj për Palestinë.*

Kjo zonja Tenardie ishte grua kuqalashë, gjithë tul dhe kockëmadhe, tip i gruas si për ushtarë, në të gjithë kuptimin e rëndë të fjalës. Dhe, për çudi, kishte një pamje si të sëndisur për shkak të librave romaneskë që kishte lexuar. Ajo ishte një lozonjare me tipare burri. Romane të vjetra, që janë zhdedhur mbi imagjinata bujtinash, bëjnë efekte kësisoj. Ajo ishte akoma e re; ishte a s'ishte tridhjetë vjeç. Në qoftë se kjo grua, që qëndronte kruspull, do të qëndronte drejt në këmbë, ndoshta shtati i saj i madh dhe shpatullat e saj prej kolosi endacak si ata të panairëve do ta kishin trembur udhëtarin që me të parën, do t'ia kishin turbulluar besimin dhe do ta kishin tretur e zhdukur atë që do të tregojmë më pas. Një njeri rri ulur, në vend që të qëndrojë në këmbë; ja ku varet fati i tjetrit.

Udhëtarja e tregoi historinë e vet, por pakëz të ndryshuar.

Ajo tregoi se ishte punëtore; se i shoqi i kishte vdekur; se punë në Paris nuk kishte; dhe se po shkonte të gjente punë gjetkë, në vendlindjen e saj; se ishte nisur nga Parisi atij

mëngjesi në këmbë; se, meqenëse e kishte mbajtur fëmijën në krah, ishte lodhur dhe, kur kishte parë karrocën e Vilëmomblit, kishte hipur në të; se nga Vilëmomblit kishte ardhur në këmbë gjer në Monfermej, se e vogla kishte ecur ca, por jo dhe shumë, se ishte e mitur, se i qe dashur ta merrte në krah dhe se shpirtja ishte përgjumur.

Dhe, si tha këto fjalë, ajo e puthi me aq afsh të bijën, sa e zgjoi nga gjumi. Fëmija çeli sytë, ca sy të mëdhenj e të kaltër, gjallë sytë e s'ëmës, dhe vështroi çfarë? asgjë dhe gjithçka, me atë pamje serioze dhe disa herë të ashpër të fëmijëve të vegjël, që është një mister i pafajësisë së tyre plot dritë përpara mugëtirave të viryeteve tona. Thua se fëmijët e vegjël e ndiejnë veten engjëj dhe ne na dinë njerëz. Pastaj fëmija nisi të qeshte dhe, sadoqë e ëma e përmbajti, ajo rrëshqiti përdhé me energjinë e pamposhtme të një qenieje të vogël që do të vrapojë. Menjëherë i vajtën sytë tek ato dy të tjerat majë shilarësit, qëndroi në vend dhe nxori gjuhën; shenjë admirimi.

Nënë Tenardieja i zgjidhi të bijat, i zbriti nga vargoi dhe tha:

-Luani që të tria.

Në këtë moshë fëmijët afrohen shpejt, dhe, pas një minute, Tenardietë e vockla luanin me të porsaardhurën duke bërë vrima në tokë; qejf i madh!

Ajo e porsaardhura ishte shumë e gëzuar; mirësia e nënës është shkruar në gazin e vocërrakut; ajo kishte marrë një cefël druri, që i shërbente si lopatë, dhe gërmonte me energji një gropëz sa për një mizë. Puna e varrmihësit bëhet një punë e gëzuar kur kryhet nga një fëmijë.

Të dyja gratë vazhduan të bisedonin.

-Si ta quajnë vocërraken?

-Kozeta.

Kozeta, lexoni Eufrazia. Vogëlushja quhej Eufrazia. Por nga Eufrazi nëna e kishte bërë Kozetë, me atë ndjenjë të ëmbël e të hirshme të nënave dhe të popullit që e ndërron Josefën në Pepita dhe Françeskën në Sijeta. Kjo është një lloj prejardhjeje, që e çorodit dhe e lë me gisht në gojë të gjithë shkencën e etimologjistëve. Ne kemi njohur një gjyshe që kishte arritur ta kthente Teodorin, në Njon.

-Sa vjeç është?

-Po ecën për tre.

-Sa vajza ime e madhe.

Ndërkohë, të tria vajzat ishin grumbulluar në një qëndrim plot ankth të thellë dhe lumturi: diçka kishte ndodhur; një krimb i madh sapo kishte dalë nga toka; vogëlushet kishin frikë, por edhe ua kishte ënda.

Ballet e tyre rrezatore ishin puqur tok; të thoshte mendja se ishin tri koka në një brerorez të vetme.

-Si janë fëmijët, - bërtiti nënë Tenardieja, - njihen e miqësohen shpejt e shpejt! Ja, shihni. Kush i sheh, bën bé se janë tri motra!

Kjo fjalë ishte shkëndija që ndoshta priste nëna tjetër. Ajo i kapi dorën Tenardiesë e vështroi drejt në sy dhe i tha:

-A pranoni të ma mbani dhe të ma ruani fëmijën time?

Tenardieja bëri një nga ato lëvizje habie që s'janë as pranim, as mospranim.

Nëna e Kozetës vazhdoi:

-Shikoni këtu, unë s'mund ta marr fëmijën në fshat. Puna nuk ma lejon. Kur ke fëmijë, s'gjen dot vend për të punuar. Njerëzit janë tuhafë në atë fshat. Zoti i bekuar më bëri të kaloj përpara bujtinës suaj. Kur i pashë vogëlushet tuaja aq të bukura dhe aq të pastra, dhe aq të kënaqura, m'u prish mendja fare. Thashë: "Ja një nënë e mirë". Tamam qëlloi; kështu do të bëhen tri motra. Dhe pastaj, unë nuk do të mënoj shumë dhe do të kthehem. A pranoni të ma mbani fëmijën tim?

-Të shohim një herë, - tha Tenardieja.

-Do t'ju jap gjashtë franga në muaj.

Në këtë mes, një zë burri thirri nga fundi i bujtinës:

-Jo më pak se shtatë franga. Dhe gjashtë muaj parapagim.

-Gjashtë herë shtatë, dyzet e dy, - tha Tenardieja.

-Do t'i jap, - tha nëna.

-Dhe pesëmbëdhjetë franga jashtë hesapit për shpenzimet e para, - shtoi zëri i burrit.

-Gjithsej, pesëdhjetë e shtatë franga - tha zonja Tenardie. Dhe përmes këtyre shifrave, ajo këndonte mbytur:

-Do t'i jap, - tha nëna, - kam tetëdhjetë franga. Do të më mbeten aq sa për të shkuar në fshat. Duke ecur në këmbë. Do të fitoj para atje dhe, sapo të mbledh ca, do të kthehem ta marr shpirtkën.

Zëri i burrit ia pat përsëri:

-A i ka plaçkat vogëlushja?

-Është im shoq, - tha Tenardieja.

-I ka pa dyshim shpirtja ime e vogël. E mora me mend që ishte burri juaj. Dhe ç'plaçka të bukura se! Plaçka që s't'i pret mendja. Të gjitha i ka me duzina; dhe fustane mëndafshi si ndonjë zonjë e rëndë. I kam këtu në torbë.

-Duhet të na i jepni, - ia pat përsëri zëri i burrit.

-S'do mend që do t'jua jap! - tha nëna! - Do të ishte turp i botës, po ta lija time bijë fare lakuriq!

Fytyra e zotit të bujtinës u duk.

-Mirë, - tha ai.

Pazarllëku u përfundua. Nëna e kaloi natën në bujtinë, la paratë dhe fëmijën e vet, lidhi përsëri torbën e zbrazur dhe tanimë e lehtësuar nga veshmbathjet u nis të nesërmen në mëngjes, duke bërë hesap që të kthehej sa më parë. Këto nisje rregullohen shpejt e shpejt, por pastaj dalin të hidhura.

Një fqinjë e Tenardieve e takoi këtë nënë tek po largohej dhe u kthye aty duke thënë:

-Tani sa pashë një grua që po qante rrugës dhe m'u bë zemra copë.

Kur nëna e Kozetës kishte ikur, burri i tha gruas:

-Me këto do të paguaj kambialin prej njëqind e dhjetë frangash, që mbaron nesër. Më mungonin edhe pesëdhjetë franga. A e di ti që do të më vinte përmbaruesi i gjyqit dhe do të haja një protestë^{*)} të mirë? Ke ngritur një çark që s'bëhet më i miri me ato vogëlushet e tua.

-Pa e kuptuar, - tha grua.

^{*)} Term gjyqësor. Akt me anë të të cilit ftuesi i gjyqit bën të ditur që një shkresë a mandat, a faturë nuk është pranuar nga i interesuari.

Vizatimi i parë i dy fytyrave të dyshimta

Çarku kishte zënë një mi shumë të hajthët; por macja gëzohet edhe me një mi të dobët.

Ç'ishin këta Tenardietë?

Le të themi që tani nja dy fjalë për ta. Përvijimin tonë do ta plotësojmë më vonë.

Këto qenie bënin pjesë në atë racën bastarde që përbëhet nga njerëz të pagdhendur që kanë vënë pasuri dhe nga njerëz të zgjuar e të rënë nga dynjallëku. Kjo racë ndodhet midis klasës së quajtur të mesme dhe asaj të quajtur të ulët dhe që pleks disa nga të metat e së dytës me pothuajse të gjitha veset e së parës, pa pasur vrullin bujar të punëtorit, as rregullin e përpiktë të borgjezit.

Ata ishin nga ato krijesa shtatanike, të cilat, në qoftë se qëllon t'i ngrohë ndonjë zjarr i dyshimtë, bëhen shumë lehtë të përbindshme. Gruaja, në themel, ishte një shtazë, kurse burri nga brumi ishte një fundërrinë. Të dy kishin arritur shkallën më të lartë të atij lloj përparimi të neveritshëm që ecën drejt së keqes. Ka në botë të tilla shpirta që zbythen pa pushim si gaforret drejt terreve, që ecin mbrapsht në jetë, në vend që të bëjnë përpara, që përdorin përvojën për të shtuar shëmtitë e tyre, që bëhen pa pushim keq e më keq dhe që njollosen gjithmonë e më shumë me damkën e zezë që shkon duke u rritur. Të tilla shpirta ishin ai burrë dhe ajo grua.

Tenardieja do ta shtinte në andralla të mëdha fizionomistin. Mjafton që t'i shohësh me sy disa njerëz, për të mos u zënë besë kurrë. Ata nga prapa janë të shqetësuar, kurse përpara janë kërcënues. Te këta njerëz qëndron e panjohura. Nuk mund të përgjigjesh as për atë që kanë bërë, as për atë që do të bëjnë. Terri që kanë në vështrimin e tyre, i denoncon ata. Vetëm t'i dëgjosh të thonë ndonjë fjalë ose të shohësh të bëjnë ndonjë gjest, dhe pikas menjëherë sekrete të errëta në të kaluarën e tyre dhe mistere të errëta në të ardhmen e tyre.

Ky Tenardieja, po t'u zije besë fjalëve të tij, na paskësh qenë ushtar; rreshter thoshte ai; me gjasë kishte marrë pjesë edhe në luftërat e vitit 1815 dhe, mesa duket, paskësh treguar edhe trimëri. Do ta shohim më vonë se si qëndronte kjo punë. Tabela e tavernës së tij paraqiste një prej këtyre veprimeve luftarake. E kishte pikturuar me dorën e vet, sepse i vinte ndoresh nga pak për gjithçka; por keq, ama.

Ishte koha kur romani i hershëm klasik, i cili, pasi pati qenë "Klelia", nuk ishte më tjetër veçse "Lodoiska"⁸⁶⁾, gjithmonë fisnik, por gjithmonë e më shumë vulgar, që kishte rënë nga zonjusha Dè Skyderi te zonja Bartelemi Hadoja dhe nga zonja Dë Lafajetë⁸⁷⁾ te zonja Burnon-Malarme⁸⁸⁾, ndizte zjarr e flakë shpirtin dashuror të portierëve të Parisit dhe bile bënte kërdi pak edhe në rrethinat e qytetit. Zonja Tenardie kishte tamam aq mend sa për të lexuar kësisoj librash. Ajo ushqej me ta. Në këta libra ajo mbyste ata të paktë tru që kishte; kjo i kishte dhënë, sa kohë që pati qenë shumë e ré, madje edhe pak më vonë, njëfarë qëndrimi prej njeriu të zhytur në mendime, pranë burrit të vet, i cili ishte bataçqi pak a shumë i regjur, rrufjan me shkollë e me gramatikë, i vrazhdë dhe finok njëkohësisht, por, në punë sentimentalizmi, edhe pse kishte lexuar Pigo - Lëbrënin për "gjithçka që kishte të bënte me seksin", siç e thoshte edhe në zhargonin e vet, ai ishte një buf kënete i kulluar. Gruaja e tij ishte nja dymbëdhjetë a pesëmbëdhjetë vjet më e ré se ai. Më vonë, kur flokët e lëshuar në mënyrë romaneske filluan t'i thinjeshin, kur Megera shtrigë u shkëput nga Pamela⁸⁹⁾, Tenardieja s'mbeti më tjetër veçse një grua e trashë dhe shpirtligë, që kishte shijuar romane plot marrëzira. Kur lexon budallallëqe, nuk shpëton pa e pësuar. Si rrjedhim i kësaj, vajza e madhe u quajt Eponina. Përsa i përket së voglës, e shkreta vogëlushe mend na u quajt Gjylnare; nuk e di sesi e solli punën së mbari një roman i Dykrei-Dyminilit⁹⁰⁾ dhe ajo u quajt Azelma.

Por, fundi i fundit, mund ta themi kalimthi, se të gjitha gjërat nuk janë qesharake dhe të cekëta në këtë kohë kaq të çuditshme, për të cilën po bëjmë fjalë këtu dhe të cilën mund ta quajmë anarki të emrave të pagëzimit, se krahas elementit

romanesk, që sapo përmendëm, qëndron edhe simptome shoqërore. Sot nuk është diçka e rrallë që edhe lopçari të quhet Artur, Alfred ose Alfons dhe që vikonti - në pastë akoma vikontë - të quhet Toma, Pjer dhe Zhak. Kjo zhvendosje, që vë emrin "elegant" mbi harbutin dhe emrin fshatarak mbi aristoklatin, nuk është gjë tjetër veçse një shtjellë barazie. Edhe këtu, si në çdo gjë tjetër, kemi depërtimin e pandalshëm të frymës së re. Nën këtë shkurdisje, në dukje qëndron diçka e madhe dhe e thellë: Revolucioni Francez.

III

Lauresha

Nuk mjafton vetëm të jesh shpirtlig, për të çarë përpara. Taverna shkonte keq.

Falë pesëdhjetë e shtatë frangave të udhëtares, Tenardieja kishte mundur ta shmangte protestën dhe të mos e koriste nënshkrimin që kishte vënë. Muajin e mëpasme ata patën përsëri nevojë për të holla; gruaja çoi në Paris dhe la peng plaçkat e Kozetës për një shumë prej gjashtëdhjetë frangash. Me t'u sosur edhe kjo shumë, Tenardietë zunë ta vështronin vajzën e vogël vetëm si një fëmijë që e kishin marrë për lëmoshë, dhe kësisoj e trajtuan. Meqenëse ajo s'kishte më rroba, ata e veshën me fustanet dhe këmishët e vjetra të Tenardieve të vogla; domethënë me zhele. E ushqyen me mbeturinat e të gjithëve, pak më mirë se qenin dhe pak më keq se macen. Madje, macja dhe qeni ishin shokët e saj të zakonshëm në tryezë; Kozeta hante me ta nën tryezë në një sahan druri të njëllojtë me të tyrin.

Nëna, e cila kishte zënë punë, siç do ta shohim më poshtë, në Montrëj-syr-Mer, shkruante ose, më mirë, vinte njeri t'u shkruanin çdo muaj, me qëllim që të merrte ndonjë lajm për të bijën. Tenardietë përgjigjeshin po njëjloj: Kozeta ishte për mrekulli.

Si kaluan të gjashtë muajt, nëna dërgoi shtatë franga për muajin e shtatë, dhe i vazhdoi dërgesat e saj me mjaft

përpikmëri nga muaji në muaj. S'kishte kaluar akoma viti, kur Tenardieja tha: "Ama, të bukur nder që na bën edhe ajo! E ç'i thotë mendja asaj se mund të bëjmë ne me ato shtatë frangat e saj?" dhe shkroi për të kërkuar dymbëdhjetë. Nëna, të cilën ata e kandisnin se fëmija ishte e lumtur "dhe rritej e mbarë", u bind dhe dërgoi të dymbëdhjetë frangat.

Ka njerëz që nuk mund të dashurojnë nga një anë, pa urryer në anën tjetër. Nënë Tenardieja i donte me zjarr të dy të bijat, gjë që e bëri ta përbuzte bijën e huaj. Është e dhimbshme të mendosh se dashuria e një nëne mund të ketë edhe anët e saj të poshtra. Sado pak vend që të zinte Kozeta në shtëpi, Tenardiesë i dukej sikur këtë ua merrte fëmijëve të saj dhe sikur kjo vajzë e vogël ua pakësonte ajrin që thithnin dy të bijat. Kjo grua, si shumë gra të llojit të saj, kishte për çdo ditë një sasi të caktuar përkëdheljes, si edhe një sasi të caktuar goditjesh e të sharash për të shpenzuar. Po të mos e kishte pasur Kozetën, me siguri që të bijat, me gjithë ledhatimet e pekulet, do t'i hanin të gjitha në kurriz. Por e huaja u bëri një të mirë, se i ndolli të gjitha rrebeshet mbi krye të vet. Të bijave u ranë në pjesë vetëm përkëdheljet. Kozeta s'guxonte të lëvizte as kaq pa ngrënë mbi kokë një breshër ndëshkimesh të rrepta dhe të pamerituara. Krijesë e butë dhe e njomë, Kozeta ishte e detyruar të mos kuptonte asgjë nga kjo botë, të dënohej pareshtur, të shuhej, të trajtohej keq, të rrihej dhe të shikonte pranë saj dy krijesa të vogla, si ajo vetë, që jetonin si në një rreze agimi!

Tenardieja ishte shpirtligë për Kozetën, Eponina dhe Azelma ishin gjithashtu shpirtliga. Fëmijët në këtë moshë janë shembull i nënës. Veçse përmasa është më e vogël, dhe asgjë tjetër.

Kaloi një vit, pastaj dhe një tjetër.

Në fshat thoshin:

-Këta Tenardietë qenkan njerëz të mirë. S'janë as të pasur e, megjithatë, po rritin një fëmijë të varfër që ua kanë lënë në shtëpi!

Bota kujtonin se Kozetën e kishte harruar e ëma.

Ndërkohë, Tenardieja, i cili kishte mësuar s'dihet se me çfarë rrugësh të errëta se fëmija me gjasë ishte kopile dhe se e

ëma s'mund ta pohonte një gjë të tillë, kërkoi pesëmbëdhjetë franga në muaj, duke thënë se "krijesa" po rritej dhe "hante" dhe duke kërcënuar se do ta dëbonte. "Të mos ma çajë shumë kokën, - bërtiti ai, - se ia marr këtë copë këlyshe e ia plas në mes të rrugës, që ta marrin vesh i madh e i vogël se kush është. Unë dua shtesë, jo llafe". Nëna i pagoi të pesëmbëdhjetë frangat.

Nga viti në vit, fëmija u rrit, u rrit gjithashtu edhe mjerimi i saj.

Sa kohë që Kozeta ishte fare e vogël, hoqi të zité e ullirit nga të dy fëmijët e tjerë; sa filloi të hidhte pakëz shtat, domethënë përpara se të mbushte pesë vjeç, u bë shërbëtorja e shtëpisë.

Pesë vjeç, do të thoni ju, kjo duket e pabesueshme. Por fatkeqësisht kjo është e vërtetë. Vuajtja shoqërore fillon në çdo moshë. A nuk pamë, pak më parë, procesin gjyqësor të një të quajturit Dymolar, jetim, që u bë hajdut, që qysh në moshën pesë vjeç, siç thonë edhe dokumentet zyrtare, duke qenë fill i vetëm në këtë botë, "punonte për të jetuar dhe vidhte".

E vunë Kozetën të bënte pazarin, të fshinte dhomat, oborrin, rrugën, të lante enët, të mbante edhe ngarkesa në shpinë. Tenardietë e ndienin veten akoma më të autorizuar të vepronin kështu, përderisa nëna, e cila ndodhej në Montrëj-syr-Mer, filloi të mos u dërgonte paratë në rregull. Kishin mbetur prapa, pa u paguar, disa muaj.

Po të kishte ardhur kjo nënë në Monfermej në krye të tre vjetëve, s'do ta kishte njohur dot fëmijën e vet. Kozeta, që ishte aq e bukur dhe e freskët kur erdhi në atë shtëpi, tani ishte tharë e irnosur. Kishte edhe një nuk di se çfarë të ecuri të shqetësuar. Tinzare! thoshin Tenardietë.

Padrejtësia e kishte bërë grindavece dhe mjerimi e kishte bërë të shëmtuar. I kishin mbetur vetëm sytë e mëdhenj, të cilët ta copëtonin zemrën, sepse ashtu të mëdhenj siç ishin, dukej sikur shikoje në ta një sasi më të madhe trishtimi.

Të këputej shpirti ta shikoje dimrit atë fëmijë të shkretë, që s'i kishte mbushur akoma të gjashtë vjetët, tek dridhej nën zhele të vjetra e të grisura, duke fshirë rrugën, pa zbardhur

dita, me një goxha fshesë në duart e saj të vockla dhe të skuqura dhe me një bulëz loti në sytë e saj të mëdhenj.

Në fshat atë e quanin Lareshë. Popullit, të cilit i pëlqejnë figurat, i kishte pëlqyer ta thërriste me këtë emër këtë qenie të vogël, që s'ishte më e madhe se një zogth, që dridhej, trembej, përpëlitej, ngrihej e para mëngjeseve në shtëpi dhe në fshat, që dilte në rrugë ose në fushë përpara se të shkrepnte agimi.

Veçse e shkreta Lareshë nuk këndonte kurrë!

Libri i pestë

TATËPJETA

I

Historia e një përparimi në industrinë e rruazave prej qelqi të zi

Por, ndërkohë, ç'bëhej vallë kjo nënë, e cila, sipas fjalëve të banorëve të Monfermejit, e kishte braktisur fëmijën e vet? Ku ishte? Ç'bënte?

Si ua la vajzën e vogël Tenardieve, ajo kishte vazhduar udhën dhe kishte arritur në Montrëj-syr-Mer.

Siç mund të na kujtohet, ishte viti 1818.

Fantina ishte larguar nga krahina e vet, qysh prej nja shtatë vjetësh. Montrëj-syr-Meri kishte ndërruar pamje. Ndërsa Fantina kishte marrë ngadalë të tatëpjetën, duke rënë nga mjerimi në mjerim, qyteti i saj i lindjes kishte lulëzuar.

Qysh prej afro dy vjetësh, aty kishte ndodhur një nga ato ngjarjet industriale, që janë ngjarje të mëdha për vendet e vogla.

Kjo hollësi është e rëndësishme, dhe e shohim të udhës që ta zhvillojmë; gati-gati do të thoshim ta nënvizojmë.

Që prej kohësh që s'mbahen mend, Montrëj-syr-Meri kishte si industri të veçantë imitimim e qelbarit të zi anglez dhe të rruazave të zeza prej qelqi të Gjermanisë. Kjo industri kishte mbetur gjithmonë në vend për shkak të shtrenjtësisë së lëndëve të para, që vepronin në dëm të krahëve të punës. Në kohën kur Fantina u kthye në Montrëj-syr-Mer, një shndërrim

i padëgjuar ishte kryer në këtë prodhim të "artikujve të zinj". Aty nga fundi i vitit 1815, një njeri, një i panjohur, kishte ardhur e ishte vendosur në qytet dhe i kishte vajtur mendja ta zëvendësonte, në fabrikimin e këtyre artikujve, gomallakun me rrëshirën dhe, sidomos për byzlykët, mbërtheckat prej teneqeje të puqura me mbërthecka teneqeje të ngjitura. Ky ndryshim fare i vogël kishte qenë një revolucion i vërtetë.

Në të vërtetë, ky ndryshim fare i vogël e kishte ulur në mënyrë të habitshme çmimin e lëndës së parë, gjë që kishte lejuar, së pari, të ngrihej çmimi i krahëve të punës, që ishte në të mirë të fshatit; së dyti, të përmirësohej fabrikimi, që ishte në përfitim të blerësit; së treti, të shiteshin me çmim më të lirë, duke trefishuar të ardhurat, gjë e cila ishte në përfitim të fabrikantit.

Kështu, nga një ide, tri rezultate.

Në më pak se tre vjet, autori i kësaj mënyre prodhimi ishte bërë i pasur, gjë e mirë kjo, dhe i kishte bërë të pasur gjithë sa ishin rreth tij, gjë akoma më e mirë. Për zanafillën e tij, s' dihej asgjë; për fillimet e tij pak gjëra.

Tregonin se kishte ardhur në qytet me fare pak të holla, gjithë-gjithë disa qindra franga.

Me këtë kapital të vogël të vënë në shërbim të një ideje të mençur, të bërë pjellor me anë të rregullit dhe të mendimit, ai kishte krijuar pasurinë e tij dhe pasurinë e gjithë atij vendi.

Kur arriti në Montrëj-syr-Mer, ai s'kishte pasur gjë tjetër veç rrobave të trupit dhe sjelljet e të folurit e një punëtori.

Duket se po atë ditë kur ai po hynte ashtu si tinëz në qytetin e vogël Montrëj-syr-Mer, një mbrëmje dhjetori, me torbë në kurriz dhe shkop në dorë, sapo kishte plasur një zjarr i madh në ndërtesën e bashkisë. Ky njeri na ishte hedhur në zjarr dhe, duke vënë jetën e vet në rrezik, kishte shpëtuar dy fëmijë, të cilët paskëshin qëlluar të ishin fëmijët e kapitenit të xhandarmërisë; nga ky shkak, s'i kishte vajtur mendja njeriu t'i kërkonte pasaportën. Qysh atëherë ia mësuan edhe emrin. Ai quhej *xha Madëleni*.

II

Madëleni

Ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, me pamjen e një njeriu të menduar dhe të mirë. Kaq mund të thuhej gjithsej për të.

Falë përparimit të shpejtë të kësaj industrie, të cilën ai e kishte shndërruar në mënyrë aq të admirueshme, Montrëj-syr-Meri ishte bërë një qendër tregtare në zë. Spanja, që harxhon shumë qelibar të zi, bënte çdo vit porosi shumë të mëdha. Montrëj-syr-Meri, me këtë tregti, i bënte pothuajse konkurrencë Londrës dhe Berlinit. Fitimet e xha Madëlenit ishin të tilla, sa, qysh në vitin e dytë, ai kishte mundur të ndërtonte një fabrikë të madhe, në të cilën kishte dy punishte shumë të gjera, një për burrat, tjetër për gratë. Kush kishte mbetur pa bukë, mund të paraqitej aty dhe ishte i sigurt se do të gjente punë dhe bukë. Xha Madëleni u kërkonte burrave të ishin të zellshëm për punë, grave të kishin sjellje korrekte dhe të gjithëve të ishin të rregullt dhe të përpiktë. I kishte ndarë punishtet, me qëllim që të ndante sekset dhe që vajzat e gratë të qëndronin të urta. Mbi këtë pikë, ai ishte i papërkulshëm. Ishte e vetmja pikë në të cilën ai, si të thuash, nuk bënte asnjë lëshim. Tregohej, për më tepër, i rreptë, sepse Montrëj-syr-Meri ishte një qytet garnizoni, kështu që edhe rastet e shthurjes dhe të përdaljes ishin të shumta. Veç këtyre, ardhja e tij ishte një mirësi dhe prania e tij ishte një fat i madh. Para ardhjes së xha Madëlenit, çdo gjë lëngonte në atë vend; tani gjithçka jetonte aty jetën e shëndoshë të punës. Një qarkullim i fortë ngrohte gjithçka dhe depërtonte gjithkund. Papunësia dhe mjerimi nuk njiheshin. S'kishte mbetur xhep, sado i errët të ishte, që të mos kishte pak të holla, s'kishte shtëpi, sado e varfër të ishte, që të mos kishte pak gëzim.

Xha Madëleni shtinte në punë të gjithë njerëzit. Ai kërkonte vetëm një gjë: të ishte burrë i ndershëm! Të ishte vajzë e ndershme!

Siç e kemi thënë, në mes të gjithë kësaj veprimtarie, shkaku dhe boshti i së cilës ishte xha Madëleni, i cili po bënte pasuri, kishte diçka mjaft të pazakontë: ky njeri i thjeshtë tregtie nuk dukej të kishte si shqetësim kryesor vetëm pasurinë. Dukej se mendonte shumë për të tjerët dhe pak për veten e vet. Më 1820 dihej se kishte një shumë prej gjashtëqind e tridhjetë mijë frangash, të vendosura në bankën e Lafitit; por, përpara se t'i siguronte për vete ato të gjashtëqind e tridhjetë mijë frangat, ai kishte shpenzuar më shumë se një milion për qytetin dhe për të varfrit.

Spitali ishte i pajisur keq; ai kishte vendosur aty dhjetë shtretër të tjerë. Montrëj-syr-Meri ishte ndarë në lagjen e sipërme dhe në lagjen e poshtme. Lagjja e poshtme, ku banonte edhe ai vetë, kishte vetëm një shkollë, një rrënojë të keqe, që po binte copa-copa; ai kishte ndërtuar dy shkolla, njërën për vajzat, tjetrën për djemtë. Dy mësuesve u kishte caktuar nga të hollat e veta një shpërblim, që ishte sa dyfishi i rrogës së tyre të vogël zyrtare, dhe, një ditë, dikujt që u çudit për këtë punë, i pati thënë: “Dy nëpunësit e parë të shtetit janë mendësja dhe mësuesi.” Kishte krijuar me shpenzimet e veta një strehë dhe një arkë ndihme për punëtorët pleq e të paaftë, gjëra pothuajse të panjohura asokohe në Francë. Meqë fabrika ishte bërë qendër, një lagje e re me mjaft familje nevojtare ishte ngritur shpejt përreth; atje ai kishte vendosur edhe një farmaci, që jepte barna falas.

Në krye, kur e panë të fillonte nga puna, “zemërmirët” thanë: “Ky është një guximtar që dëshiron të pasurohet”. Kur e panë tek pasuronte vendin përpara se të pasurohej vetë, po ata “zemërmirë” thanë: “Ky qenka një njeri ambicioz”. Kjo dukej akoma edhe më e mundshme, sepse ky njeri ishte edhe fetar e, madje, edhe vepronte si i tillë gjer në njëfarë mase, gjë që mbahej në sy të mirë në ato kohë. Ai shkante e dëgjonte rregullisht meshën e vogël çdo të diel. Deputeti i vendit, i cili nuhaste kudo konkurrencat, nuk mënoi të shqetësohej edhe nga kjo fetari. Ky deputet, që kishte qenë anëtar i trupit legjislativ të Perandorisë, ishte i një mendjeje me idetë fetare të një ati të oratorios, të njohur me emrin Fushé, dukë i

Otrantos, krijesa dhe miku i të cilit ai kishte qenë. Larg syve të botës, ai tallej me perëndinë me zë të ulët. Por kur pa fabrikantin e pasur Madëlen të shkante në meshën e vogël të orës shtatë, ai pikasi te Madëleni një kandidat të mundshëm dhe vendosi që t’ia kalonte; mori një konfesor jezuit dhe vajti në meshën e madhe edhe në mbrëmësore. Asokohe ambicia ishte, me plot kuptimin e fjalës, një vrap drejt kambanores. Të varfrit përfituan nga ky tmerr që e kishte kapur këtë zotëri, ashtu sikurse përfitoi edhe perëndia, sepse i nderuari deputet vendosi, edhe ai, dy shtretër në spital; kështu që u bënë dymbëdhjetë.

Ndërkohë, më 1819, u hap fjala një mëngjes nëpër qytet se, me propozimin e zotit prefekt dhe duke marrë parasysh shërbimet e bëra ndaj vendit, xha Madëleni do të emërohej nga mbreti si kryetar i bashkisë së Montrëj-syr-Merit. Ata që e kishin shpallur të porsaardhurin si “ambicioz”, e kapën me gëzim këtë rast dhe bërtitën: “A e shihni? A nuk ju patëm thënë ne? Na doli fjala!” I gjithë Montrëj-syr-Meri gumëzhinte. Fjala e hapur ishte me bazë. Disa ditë më pas, emërimi i tij u botua në gazetën “Monitor”. Të nesërmen xha Madëleni nuk e pranoi.

Po në vitin 1819, prodhimet e mënyrës së fabrikimit të shpikur nga Madëleni u paraqitën në ekspozitën e industrisë; në bazë të raportit të jurisë, mbreti e emëroi shpikësin kavalier të “Legjionit të Nderit”. Prapë gumëzhitje në qytetin e vogël. E shihni, pra? Ai na paskësh dashur kryqin! Xha Madëleni nuk e pranoi as kryqin e “Legjionit të Nderit”.

Me siguri që ky njeri ishte një enigmë. “Zemërmirët” e hodhën edhe këtë herë lumin duke thënë: “Fund i fundit, ai është njëfarë aventurieri”.

Siç e pamë, vendi i detyrohej shumë atij njeriu; të varfrit i detyroheshin për gjithçka; ai ishte aq i dobishëm, sa, më në fund, iu desh të gjithëve ta nderonin, dhe ishte aq i ëmbël, sa, më në fund, iu desh edhe ta donin; punëtorët e tij, sidomos, e adhuronin; dhe ai e pranonte atë adhurim me njëfarë serioziteti melankolik. Kur e panë se ishte i pasur, “njerëzit e shoqërisë së lartë” e përshëndetën dhe e quajtën në qytet zoti Madëlen; punëtorët e tij dhe fëmijët vazhduan ta quanin *xha Madëlen*, dhe kjo ishte gjëja që e bënte të buzëqeshte më shumë. Sa më

shumë ngjitej, aq më shumë ftesat binin si breshëri mbi të. "Shoqëria" e quante si njeriun e saj. Sallonet e vogla të shtira të Montrëj-syr-Merit, të cilat sigurisht që kohët e para nuk e patën qasur, u hapën kat e kat përpara milionerit. I bënë një mijë ndere. Por ai nuk i pranoi.

Edhe kësaj radhe "zemërmirët" s'e patën vështirë. Është njeri i pagdhundur dhe me edukatë të ulët. E dimë se nga ka dalë. Nuk di si të mbahet në shoqëri. Askush s'e ka provuar në di të lexojë apo jo". Kur e panë që fitonte të holla, kishin thënë: "Qenka ambicioz". Kur e panë që as nderet nuk i pranoi, kishin thënë: "Qenka aventurier". Kur e panë që as shoqërinë e lartë nuk e përfilli, kishin thënë: "Qenka fare gdhë".

Më 1820, pesë vjet pas ardhjes së tij në Montrëj-syr-Mer, shërbimet që i kishte bërë vendit qenë aq të shkëlqyera dhe dëshira e rrethit e njëzëshme, sa mbreti e emëroi përsëri kryetar bashkie të qytetit. Ai as kësaj radhe nuk pranoi, por prefekti nguli këmbë përpara këtij mospranimi, paria erdhi e iu lut, populli në mes të rrugës i lutej, këmbëngulja që aq e madhe, sa, dha e dha, e, më në fund, pranoi. Vunë re se ajo që e bëri sidomos t'i jepte fund, ishte thirrja pothuajse me inat e një plake të popullit, që i bërtiti nga pragu i portës: "*Një kryetar bashkie i mirë është i dobishëm. A mund të zbrapset vallë njeriu kur ka në dorë të bëjë një të mirë?*"

Kjo ishte faza e tretë e ngjitjes së tij. Xha Madëleni ishte bërë zoti Madëlen, zoti Madëlen ishte bërë zoti kryetar.

III

Shumat e vendosura te Lafiti

Por, megjithatë, ai kishte mbetur po ai njeri i thjeshtë si ditën e parë që kishte ardhur. Flokët i kishte të thinjur, syrin serioz, ngjyrën e lëkurës të rreshkët si të punëtorëve, fytyrën të menduar si të një filozofi. Mbante zakonisht një kapelë me strehë të gjerë dhe një redingotë të gjatë stofi të trashë, të

mbërthyer gjer në grykë. Ai i kryente detyrat e kryetarit të bashkisë, por, jashtë këtyre, ai jetonte i vetmuar. Fjalët i kishte të shtrenjta. U vidhej mirësjelljeve, përshëndeste si mënjanë, largohej shpejt, buzëqeshte që të shpëtonte pa folur, jepte që të shpëtonte pa buzëqeshur. Gratë thoshin për të: "Çfarë ariu i butë që qenka!" Qejfi i tij ishte të shëtiste fushave.

Hante gjithmonë vetëm, me një libër të hapur përpara. Kishte një bibliotekë të rregulluar mirë. Librat i donte; librat janë miq të ftohtë e të sigurt. Sa më shumë pasuri vinte, aq më shumë kohë e lirë i mbetej, nga e cila përfitonte për të lëvruar mendjen. Që nga koha kur ndodhej në Montrëj-syr-Mer, njerëzia vinin ré se, nga viti në vit, të folurit e tij bëhej më i lëmuar, më i zgjedhur dhe më i butë.

Kur dilte shëtitje, merrte me qejf edhe një pushkë gjahu me vete, por rrallë e përdorte. Kur i qëllonte rastësisht që ta përdorte, ai kishte një nishan të pagabueshëm, që të kallte frikë. Kurrë nuk vriste kafshë që nuk ishin dëmtuese. Kurrë nuk shtinte mbi zogj të vegjël.

Megjithëse tani nuk ishte më i ri, tregonin se kishte një fuqi të habitshme. I jepte ndihmë gjithkujt që kishte nevojë, ngrinte ndonjë kalë të rrëzuar, shtynte ndonjë qerre të vithisur në baltë, kapte për brirësh dhe ndalonte ndonjë dem që kishte shpëtuar. Xhepat i kishte plot monedha kur dilte dhe të zbrazura kur kthehej në shtëpi. Kur kalonte përmes ndonjë fshati, camërdhokët e rreckosur i turreshin prapa gjithë gaz dhe e rrethonin si ndonjë tufë mizash të vogla.

Njerëzit ishin të mendjes se dikur ai duhej të kishte bërë jetë fshati, sepse kishte gjithfarë sekretesh të dobishme që ua mësonte fshatarëve. U mësonte se si të luftonin tenjën e grurit duke spërkatur dhe duke përmytur plasat e dyshemesë me një lëng kripe të rëndomtë dhe të gjuanin mizën e grurit duke varur gjithandej, në mure e pullaze, në avlli e në shtëpi, orviot të lulëzuar. Kishte "receta" të ndryshme për të çrrënjësuar sëmundjen e krimbave të mëndafshit, vrugun, grashinën, egrin, të gjitha barërat e këqija dhe parazitë që dëmtojnë grurin. Ai mbronte strofkën e lepujve të butë kundër minjve

vetëm duke u bërë të ndienin erën e një derri të vogël të Barbarisë që e vinte aty.

Një ditë prej ditësh, ai pa disa fshatarë që po jepnin e merrnin duke shkukur hithra. E vështroi atë vandak bimësh të shkultura me rrënjë e të përthara dhe tha: “Tani këto bimë kanë mbaruar, por këto bimë do të hynin shumë në punë, po të dinit t’i përdornit. Kur hithra është e njomë, gjethi i saj është një barishte e shkëlqyer; kur vjetrohet, hithra ka fije e deje si kërpë. Pëlhura e hithrës s’i lë gjë mangut pëlhurës së kërpit; po ta grish, hithra është një ushqim i mirë për shpendët; po ta thërrmosh e ta bluash, është e mirë për kafshët me brirë. Fara e hithrës, e përzier me silazhin, i jep shkëlqim qimes së kafshëve; rrënja e hithrës, e përzier me kripë, jep një ngjyrë të verdhë të bukur. Veç asaj, ajo është një bar i shkëlqyer, që mund ta kositësh dy herë. Dhe çfarë i duhet hithrës për t’u rritur? Pak tokë, asnjë kujdes dhe asnjë shërbim; vetëm se fara bie përtokë, dora-dorës që bima piqet, dhe është vështirë ta vjelësh. Po të mundohesh pak, hithra hyn shumë në punë; por ne s’ia varim fare dhe ajo bëhet e dëmshme. Atëherë, ne e asgjësojmë. Sa njerëz i përngjasin hithrës! - Dhe shtoi pas një heshtjeje: - Miqte e mi, mbani mend këtë: s’ka as bimë të këqija, as njerëz të këqij. Ka vetëm lëvrues të këqij.”

Fëmijët e donin edhe më shumë, sepse ai dinte të sajonte disa gjëra të vogla fort të lezetshme me kashtë dhe arra kokoje.

Ai bënte një mori veprash të mira, por duke u fshehur, që të mos merrej vesh, ashtu si fshihet njeriu për veprat e këqija. Hynte vjedhurazi mbrëmjeve nëpër shtëpitë; ngjitej shkallëve tinëz dhe pa u ndier. Ndonjë nevojtar i këputur, duke u kthyer në gërmadhën e tij, shihte që porta e tij ishte hapur, ndonjëherë edhe me dhunë, gjatë mungesës së tij. I shkreti njeri vinte ulërimën: “Do të ketë ardhur ndonjë keqbërës!” Hynte brenda, dhe gjëja e parë që shihte ishte ndonjë monedhë ari e harruar mbi ndonjë mobilje. “Keqbërësi” që kishte ardhur, ishte xha Madëleni.

Ai ishte i dhembshur dhe i trishtuar. Populli thoshte: “Ky është një njeri i pasur, por që s’mbahet kryelartë. Ky është një njeri i lumtur, por që s’duket të jetë i kënaqur.”

Një palë thoshin se ai qenkësh një personazh i mistershëm dhe pohonin se këmbë njeriu nuk hynte në dhomën e tij, e cila na paskësh qenë një qeli e vërtetë asketi, e pajisur me sahatë rëre me krahë, me fyej këmbësh të kryqëzuar dhe koka të vdekurish. Këto fjalë kishin marrë dhenë, aq sa disa gra elegante e çapkëne të Montrëj-syr-Merit i erdhën një ditë në shtëpi dhe e pyetën: “Zoti kryetar, tregonani pak atë dhomën tuaj. Thonë se është një guvë e vërtetë.” Ai buzëqeshi dhe i futi pa një pa dy në atë guvë”. Ato u ndëshkuan paq për kërsërinë e tyre. Ajo ishte një dhomë e pajisur pa të keq me mobilje mogani mjaft të shëmtuara, si të gjitha mobiljet e kësaj dore, dhe e veshur me letër dymbëdhjetësushe. Ato mundën të vërenin vetëm dy shandanë me formë të vjetruar, që dukeshin se ishin prej argjendi, “sepse ishin të kontrolluar”. Vërejtje që përputhej plotësisht me frymën e qyteteve të vogla.

Por, megjithatë, bota prapë vazhduan të thoshin se askush s’mund të hynte në atë dhomë dhe se ajo ishte një guvë, një vend ëndrrash, një vrimë, një varr.

Bota çuquritnin gjithashtu se ai kishte shuma “të mëdha”, të depozituara te Lafiti, me këtë veçanti, që ato i kishte në dorë kur t’i donte qejfi, mund të shkonte një mëngjes te Lafiti, të nënshkruante një dëftesë marrjeje dhe t’i merrte me vete dy a tre milionët e vet brenda dhjetë minutave. Në të vërtetë, ata “dy a tre milionët” katandiseshin, siç e kemi thënë, në gjashtëqind e tridhjetë a dyzet mijë franga.

IV

Zoti Madëlen në zi

Në fillim të vitit 1821, gazetata njoftuan vdekjen e zotit Miriel, ipeshkvi të Dinjës, “të mbiemëruar *imzot Bienvëny*”.

Ipeshkvi i Dinjës, për të shtuar këtu një hollësi që e harruan gazetata, kur vdiq, kishte vite që qe i verbër dhe i kënaqur që ishte i verbër, meqenëse e motra i ndodhej gjithnjë pranë.

Le ta themi kalimthi, të jesh i verbër dhe i dashuruar, është me të vërtetë, mbi këtë tokë ku asgjë s'është e përsosur, një nga format më çuditërisht të këndshme të lumturisë. Të kesh vazhdimisht pranë teje një grua, një vajzë, një motër, një qenie që përgjërohet për ty, që qëndron aty, sepse ti ke nevojë për të dhe sepse ajo s'ka si të bëjë pa ty, ta ndiesh veten të domosdoshëm për ata që për ty janë të nevojshëm, të mundësh vazhdimisht ta matësh dhembshurinë e saj me sasinë e pranisë që të jep dhe t'i thuash vetes sate: "Përderisa ajo më kushton mua të gjithë kohën, kjo do të thotë që unë ia kam rrëmbyer të gjithë zemrën; të shikosh mendimin në mungesë të fytyrës, të konstatosh eklipsin e një qenieje në eklipsin e botës, të ndiesh fëshfërimën e një fustani si një zhurmë flatrash, ta dëgjosh të vejë e të vijë, të dalë, të hyjë, të flasë, të këndojë, dhe të mendosh se ti je qendra e këtyre hapave, e kësaj fjale, e kësaj kënge, të shohësh në çdo minutë se ti i tërheq të tjerët pas vetes, ta ndiesh veten aq më të fuqishëm, sa më shumë që je i gjymtuar, të bëhesh në terr dhe me anën e territ ylli rreth të cilit vërtitet ai engjëll, të pakta janë ato lumturi që mund të barazohen me këtë. Lumturia më e lartë e jetës është bindja që të tjerët të duan; të duan për veten tënde, ta themi më mirë, të duan pavarësisht nga vetja jote, këtë bindje i verbri e ka. Në këtë hall që të ka pllakosur, të të shërbejnë të tjerët, do të thotë të të përkëdhelin. A të mungon gjë? Jo. Nuk e ke humbur aspak dritën kur ke dashurinë. Dhe çfarë dashurie! Një dashuri të gatuar tërësisht me virtyt. Atje ku ka siguri, s'ka aspak verbëri. Shpirti kërkon symbylltazi shpirtin dhe e gjen. Dhe ky shpirt i gjetur dhe i provuar është një grua. Në pastë një dorë që të mban, ajo është dora e saj; në pastë një buzë që prek lehtazi ballin tënd, ajo është buza e saj; në dëgjofsh pranë teje një frymëmarrje, është ajo. Të kesh gjithçka prej saj, që nga kulti e gjer te dhimbshuria, të mos e ndiesh kurrë veten të lënë vetëm, të kesh për ndihmë atë dobësi të ëmbël, të mbështetesh mbi atë thupërz të patundshme, ta marrësh e ta pushtosh në krahët e tu! Zemra, kjo lule qiellore e errët, hyn në një lulëzim të mistershëm. Këtë terr njeriu nuk do ta këmbente as me të gjithë dritën që ka bota. Ti ndien ngrohtësinë që po të afrohet, ja tek

është. Je i zhytur në dëlirësi, në gëzim, në dalldisje; je si një rrezatim në terrin e natës. Dhe, pastaj, një mijë kujdesje të vogla. Hiçe, të cilat, në këtë zbrazëti, janë të stërmëdha. Tonet më të pashprehshme të zërit femëror rrahin të të nanuritit dhe të zëvendësojnë botën e zhdukur. Të përkëdhelin me shpirt. Nuk sheh asgjë, por e ndien veten të adhuruar. Kjo është një parajsë terresh.

Njoftimi mbi vdekjen e tij u riprodhua nga gazeta lokale e Montrëj-syr-Merit. Zoti Madëlen doli të nesërmen i veshur i tëri në zi dhe me një shirit në kapelë.

Në qytet e vunë re këtë zi dhe filluan të dërdëllitnin. Kjo u duk si një dritëz mbi origjinën e zotit Madëlen. Nxorën si përfundim se ai do të kishte ndonjë lidhje me të përndershmin ipeshkv. "*Mban zi për ipeshkvin e Dinjës*", - thanë nëpër sallonet. Kjo ia rriti fort namin zotit Madëlen dhe i dha përnjëherësh dhe nga të gjitha anët njëfarë konsiderate në botën aristokrate të Montrëj-syr-Merit. Lagjja mikroskopike Sen-Zhermen e këtij qyteti mendoi t'i jepte fund karantinës së zotit Madëlen, farefis i mundshëm i një ipeshkvi. Zotit Madëlen i ra në sy ky përparim që po bënte, se plakati i kishin shtuar përkuljet dhe të rejat buzëqeshjet. Një mbrëmje, një kryeplakë e kësaj bote të vogël, së cilës për shkak të moshës i lejohej kureshtja, kuturisi dhe e pyeti: "Zoti kryetar është pa dyshim kushëri me të ndjerin ipeshkv të Dinjës?"

Ai tha: "Jo, zonzjë."

-Po, - ia pati përsëri plaka, - pse mbani zi për të?

Ai u përgjigj: "Sepse në të ri kam qenë shërbëtor në familjen e tij."

U kishte rënë në sy edhe diçka tjetër: sa herë që kalonte ndonjë savojas i vogël që bridhte nëpër krahinë dhe kërkonte për të fshirë ndonjë oxhak, zoti kryetar dërgonte ta thërritnin, e pyeste si e quanin dhe i falte të holla. Savojasit e vegjël ia thoshin njëri-tjetrit dhe kështu kalonin shumë të tillë.

Vetëtimia të vagëta në horizont

Pak nga pak dhe me kalimin e kohës, të gjitha kundërshtimet kishin rënë. Në krye, kundër zotit Madëlen u thurën shpifje dhe iu ngjitën njolla të zeza, një lloj ligji ky që i prek gjithmonë ata që ngrihen lart, pastaj u thanë vetëm fjalë dashakeqe, pastaj vetëm smire, pastaj të gjitha këto u shuan krejt; respekti u bë i plotë, i njëzëshëm, i përzemërt dhe erdhi një çast, aty nga viti 1821, kur fjala zoti kryetar u shqiptua në Montrëj-syr-Mer pothuajse po me atë theks që ishte shqiptuar fjala imzot ipeshkvi në Dinjë më 1815. Njerëzia vinin që prej dhjetë legash larg të këshilloheshin me zotin Madëlen. Ai u jepte fund mosmarrëveshjeve, ndalonte paditjet, pajtonte armiqhtë. Secili e pranonte si gjykatës të vetin për të mbrojtur të drejtat. Dukej sikur zoti Madëlen e kishte në shpirt librin e së drejtës së natyrshme. Kështu, si të thuash, përndërimi i preku që të gjithë, aq sa brenda gjashtë a shtatë vjetësh dalëngadalë përfshiu të gjithë krahinën.

Vetëm një njeri, në tërë qytetin e në tërë rrethin, iu shmang katërcipërisht kësaj epidemie, dhe çfarëdo që bëri xha Madëleni, ai nuk u tund nga e tija, a thua se një instinkt i pathyeshëm dhe i palakueshëm e mbante të zgjuar dhe e shqetësonte. Duket sikur me të vërtetë ekzistonte ndër disa njerëz një instinkt i vërtetë shtazor, i kulluar dhe i plotë, si çdo instinkt tjetër, që krijon antipatitë dhe simpatitë, që ndan në mënyrë fatale një natyrë njeriu nga një natyrë tjetër, që nuk ngurron, nuk turbullohet, nuk hesht e nuk përgënjeshtrohet kurrë, një instinkt i qartë në atë terrin e vet, i pagabueshëm, urdhërues, i shurdhët ndaj të gjitha këshillave të dijes dhe ndaj të gjitha veprimeve shkatërruese të arsyes, dhe që, sidoqë të jenë gatuar fatet e pritme, paralajmëron fshehtas njeriun-qen për praninë e njeriut-mace dhe njeriun-dhelpër për praninë e njeriut-luan.

Shpesh, kur zoti Madëlen kalonte në ndonjë rrugë, i qetë, i dashur, i rrethuar nga urimet e të gjithëve, ndodhte që një

njeri shtatlartë, i veshur me një redingotë ngjyrë gri plumbi, i armatosur me një bastun të trashë, me një kapelë të rrasur në kokë, kthehej papritmas prapa dhe e ndiqte me sy gjersa zhdukej, duke kryqëzuar krahët, duke tundur ngadalë kryet dhe duke ngritur buzën e sipërme dhe atë të poshtmen gjer te hunda, njëfarë ngërdheshjeje, kjo, kuptimplote, që mund të përkthehej kështu: “Ç’të jetë vallë ky njeri? Me siguri që diku e kam parë. Sidoqoftë, ai mua s’ma hedh dot.”

Ky person i rëndë, me një rëndësi pothuajse kërcënuese, ishte nga ana që e shqetësojnë vëzhguesin edhe kur ia zë syri shkarazi.

Ky njeri quhej Zhaver dhe ishte i policisë.

Ai kryente në Montrëj-syr-Mer detyrat e mundimshme, por të dobishme, të inspektorit. Fillimet e Madëlenit ai s’i kishte parë. Zhaveri ia detyronte postin që zinte përkrahjes së zotit Shabujet, sekretarit të ministrit të shtetit kontit D’Angles, asokohe prefekt i policisë në Paris. Kur pati ardhur Zhaveri në Montrëj-syr-Mer, fabrikanti i madh kishte kohë që kishte vënë pasuri dhe xha Madëleni ishte bërë zoti Madëlen.

Disa oficerë të policisë kanë një fizionomi të veçantë, ku përzihet një shprehje poshtërsie me një shprehje autoriteti. Zhaveri e kishte këtë fizionomi, me përjashtim të shprehjes së poshtërsisë.

Është bindja jonë se, në qoftë se shpirtat do t’i shikonim dot me sy, njeriu do të shikonte shkoqur atë gjë të çuditshme që secili individ i gjinisë njerëzore i përgjigjet ndonjëherë prej krijesave kafshore dhe do të mund ta pranonte lehtëzi këtë të vërtetë, të cilën sa mezi ia ka zënë syri mendimtarit, se, që nga goca e detit e gjer te shqiponja, që nga derri e gjer te tigri, të gjitha kafshët mund t’i gjesh te njeriu dhe secilën syresh mund ta gjesh te njeriu.

Kafshët s’janë tjetër veçse figurat e virtyteve dhe të veseve tona, që na sillen përpara syve e që janë fantazmat e dukshme të shpirtave tona. Perëndia na e tregon këtë për të na bërë që t’i vëmë gishtin kokës të mendohemi. Vetëm se, mbasi kafshët s’janë tjetër veçse hije, Zoti nuk i ka bërë të edukueshme në kuptimin e plotë të fjalës; e për ç’nevojë? Përkundrazi,

meqenëse shpirtrat tona janë realitete dhe kanë një mbarim që është i vetijshëm, Zoti u ka dhënë mendjen e ndritur, domethënë edukimin e mundshëm. Edukimi shoqëror, kur bëhet mirë, mundet gjithmonë të nxjerrë nga një shpirt, cilido qoftë ky, dobinë që mban në vetvete.

Tani, në qoftë se pranoni tok me ne se te çdo njeri ka një prej llojeve të kafshëve të krijimit, do ta kemi të lehtë të themi se çfarë ishte ky oficer i rendit publik, Zhaveri.

Fshatarët asturianë*) e kanë mendjen top se në çdo pjellë të ulkonjës ka edhe një qen, të cilin e ëma e vret, sepse, përndryshe, kur të bëhej i madh, do t'i hante këlyshët e tjerë.

Jepini një fytyrë njeriu këtij qeni këlysh-ulkonje, dhe do të keni Zhaverin të gjallë.

Zhaveri kishte lindur në burg nga një fallxheshë, burri i së cilës ishte dënuar me punë të rënda. Duke u rritur, ai mendoi se ishte jashtë shoqërisë dhe u bë pikë e vrer që nuk do të hynte dot kurrë në shoqëri. Ai vuri re se shoqëria mbante në mënyrë të pafalshme jashtë saj dy klasa njerëzish, ata që e sulmonin dhe ata që e ruanin; ai mund të zgjidhte e të merrte vetëm midis këtyre dy klasave; njëkohësisht ai ruante përbrenda nuk di çfarë fondi palakueshmërie, rregullsie dhe përpikmërie në të zbatuarit e rregullave qytetare, të përzier me një urrejtje të pashprehshme për atë racë endacakësh, në të cilën bënte pjesë edhe vetë. Ai hyri në polici.

Këtu i shkoi puna mbarë. Në moshën dyzetvjeçare ai ishte inspektor.

Kur ishte i ri, kishte shërbyer si rojtar në burgjet e Jugut.

Para se të shkojmë më tutje, le të merremi vesh mbi fjalën fytyrë njeriu, që i ngjitem pak më parë Zhaverit.

Fytyra njerëzore e Zhaverit përbëhej nga një hundë e shtypur me dy vrime të thella, drejt të cilave ngjiteshin mbi dy faqet e tij ca favorite shumë të mëdha. Nuk e ndieje veten mirë kur i shihje për herë të parë ato dy pyje dhe ato dy guva. Kur Zhaveri qeshte, gjë që ishte fort e rrallë dhe e tmerrshme, buzët e tij të holla largoheshin nga njëra-tjetra dhe zbulonin jo vetëm

*) Banorë të Asturisë, një provincë në Spanjë.

dhëmbët e tij, por edhe mishrat e dhëmbëve dhe vinte e sajohej rreth hundës së tij një palëzim pilloçak dhe i hakërryer si në turirin e ndonjë shtaze të egër. Kur rrinte serioz, Zhaveri ishte qen; kur qeshte, ishte tigër. Përveç kësaj, ai kishte fare pak kafkë, shumë nofull, flokë, që i mbulonin ballin e i binin mbi vetulla, midis dy syve një rrudhje qendrore të vazhdueshme, si ndonjë yll zemërimi, një vështrim të errët, një gojë të mbërthyer dhe të frikshme, një pamje komanduese të egër.

Ky njeri ishte gatuar me dy ndjenja shumë të thjeshta dhe relativisht shumë të mira, por që i bënte pothuajse të këqija për shkak se i tepronte: respektin ndaj autoritetit, urrejtjen ndaj rebelimit; dhe për sytë e tij, vjedhja, vrasja, të gjitha krimet, nuk ishin gjë tjetër veçse forma të rebelimit. Ai mbështillte me njëfarë besimi të verbër dhe të thellë çdo gjë që kishte një funksion në shtet, që nga kryeministri gjer te rojtësi i fshatit. Ai e mbulonte me përbuzje, me urrejtje dhe me neveri çdo gjë që kishte kaluar një herë prapun e ligjshëm të së keqes. Ishte fare i prerë dhe nuk pranonte përjashtime. Nga njëra anë, ai thoshte: "Funksionari nuk mund të gabohet; gjykatësi ka gjithmonë të drejtë". Nga ana tjetër, thoshte: "Këta janë të humbur e s'ndreqen më. Prej tyre s'mund të dalë asgjë e mirë." Ai ishte plotësisht i një mendjeje me njerëzit me pikëpamje ekstreme, të cilët i japin ligjit njerëzor nuk di çfarë pushteti që të bëjë ose, po deshët, të konstatojë të dënuarit dhe që venë një Stiks* përfund shoqërisë. Ishte stoik, serioz, i vrazhdë, ëndërrues, i zymtë, i përunjur dhe kryelartë si fanatikët. Vështrimi i tij ishte si ndonjë tryelë e gjallë. Ai vështrim ishte i ftohtë dhe depërtues. E gjithë jeta e tij qëndronte në këto dy fjalë: hap sytë e përgjo. Ai kishte futur vijën e drejtë në atë që është më e lakuara në botë; ai ishte i ndërgjegjshëm për dobinë e tij, kishte një besim fetar për detyrat e tij, dhe ishte spiun, ashtu si dikush tjetër do të ishte prift. Mjerë ai që binte në dorë të tij! Ai edhe të atin do ta kishte arrestuar, po të arratisesh nga burgu, dhe t'ëmën do ta kishte denoncuar, po të braktiste

*) Lumë që rrethon shtatë herë ferrin. Kush lahej në të, bëhej i paprekshëm (sipas biblës).

banesën bashkëshortore. Dhe do ta kishte bërë me atë lloj kënaqësie të brendshme që të jep virtyti. Tok me këto, bënte një jetë plot privacione, vetmi, vetëmohim, dëlirësi, pa kurrfarë argëtimi. Ai ishte detyra e papërkulshme, policia, ashtu siç e kuptonin spartanët Spartën; ai ishte një përgjim i pamëshirshëm, një ndershmëri e rreptë, një hafije zemërgur, si Bruti i shkrirë me Vidokun.

Gjithë qenia e Zhaverit shprehte njeriun që përgjon e që fshihet. Shkolla mistike e Zhozef të Mestrit, e cila asokohe i quante si kozmogoni të lartë ato që quheshin gazeta ultra, nuk do të ngurronte të thoshte se Zhaveri ishte një simbol. Ballin nuk mund t'ia shikoje, se i fshihej nën kapelë, sytë nuk mund t'ia shikoje, se ia mbulonin vetullat, mjekrën nuk mund t'ia shikoje, se i zhytej në kravatë, duart nuk mund t'ia shikoje, se i fuste në mëngët, bastunin nuk mund t'ia shikoje, se e mbante nën redingotë. Por, kur vinte rasti, shikoje se si nga gjithë kjo errësirë ia behnin papritur, si nga ndonjë pritë, një ballë qoshe-qoshe dhe i ngushtë, një vështrim ogurzi, një mjekër kërcënuese, një palë duar të stërmëdha dhe një shkop i përbindshëm.

Kur kishte kohë të lirë, gjë që ngjiste shumë rrallë, ai lexonte, megjithëse librat i urrente; kjo tregon se ai nuk ishte fare i pakënduar. Dhe këtë mund ta diktoje nga fjalitë e fryra që përdorte herë pas here.

Siç e thamë, ai s'kishte asnjë ves. Kur ishte i kënaqur nga vetja e vet, atëherë ai hiqte nganjëherë tabako. Vetëm nga kjo vjegë lidhej me njerëzit.

Kuptohet lehtë që Zhaveri ishte tmerrri i gjithë asaj klase, të cilën statistika e përvitshme e Ministrisë së Drejtësisë shënon nën rubrikën: *Njerëz pa punë e pa zanat*. Këta, sa dëgjonin emrin e Zhaverit, iknin nga sytë këmbët; sa ia shikonin fytyrën, ngrinin në vend nga frika.

I tillë ishte ky njeri i tmerrshëm.

Zhaveri ishte si ndonjë sy i ngulur pareshtur mbi zotit Madëlen. Sy plot dyshime dhe hamendje. Zoti Madëlen kishte arritur ta pikaste këtë gjë, por kjo dukej se s'i bënte përshtypje fare. S'i bëri as edhe një pyetje Zhaverit dhe as kërkonte ta

takonte, as i shmangej; dhe e duronte, me gjasë si pa gjë të keq, atë vështrim bezdisës dhe pothuajse të rëndë. Ai sillej me Zhaverin lirshëm dhe plot mirësi, ashtu si me gjithë të tjerët.

Nga disa fjalë që i kishin shpëtuar Zhaverit nga goja, mund të pikasje se Zhaveri kishte kërkuar fshehtëzi, me atë kureshtjen që është tipar i kësaj race njerëzish dhe ku hyn aq instinkt, sa edhe vullnet, të gjitha gjurmët e kohës së kaluar që xha Madëleni mund të kishte lënë gjetiu. Ai me gjasë dinte dhe shpesh e hidhte fjalën larg e larg se dikush kishte marrë disa njoftime në njëfarë fshati mbi njëfarë familjeje të zhdukur. Një ditë i qëlloi të thoshte duke folur me vete: "Tani besoj se e kam shtënë në dorë!" Pastaj ndenji tri ditë me radhë i zhytur në mendime dhe pa hapur gojë fare. Duket se filli, që besonte të kishte kapur, ishte këputur.

Veç kësaj, dihet se njeriu nuk është me të vërtetë i pagabueshëm dhe se vetia themelore e instinktit është pikërisht ajo që ky mund të hutohet, të zbulohet dhe të çoroditet. Po të mos ishte kështu, instinkti do të qe më i lartë se mendja dhe kafsha më e mençur se njeriu.

Zhaveri, sigurisht, u hutua pak nga qëndrimi fare i natyrshëm dhe i qetë i zotit Madëlen.

Por, një ditë prej ditësh, qëndrimi i çuditshëm i Zhaverit duket se i bëri mjaft përshtypje zotit Madëlen. Dhe ja me ç'rast.

VI

Xha Foshëlëvani

Një mëngjes, Madëleni po kalonte në një rrugicë të pashtruar me kalldrëm të Montrëj-syr-Merit. Dëgjoi zhurmë dhe pa aty më tutje një grup njerëzish. Vajti në vend. Një burrë plak, i quajtur xha Foshëlëvani, sapo kishte rënë nën karron e tij, se i qe gremisur kali.

Ky Foshëlëvani na ishte njëri nga të paktit armiq që kishte akoma asokohe zoti Madëlen. Kur Madëleni kishte ardhur në

fshat, xha Foshëlëvani, dikur biçim noteri dhe fshatar pothuajse i panxënë, ushtronte një tregti, e cila kishte filluar të merrte të tatëpjetën. Foshëlëvani e kishte parë këtë punëtor të thjeshtë tek po pasurohej, ndërsa ai vetë, që ishte mjeshtër, po rrënohej. Kjo gjë e kishte mbushur plot maraz, dhe kishte bërë ç'i kishte ardhur për dore, sa herë që i dilte rasti, për t'i bërë keq Madëlenit. Pastaj kishte ardhur falimenti dhe, si plak që ishte, duke mos pasur gjë tjetër pas shpirtit veç atë copë karro dhe një kalë, pa familje e pa fëmijë, ishte bërë karrocier sa për të jetuar.

Kali kishte thyer të dyja kofshët dhe nuk mund të çohet në këmbë. Plaku ishte zënë pisk në mes të dy rrotave. Rrëzimi kishte qenë aq ters, sa e gjithë karroja rëndonte mbi kraharorin e tij. Karroja ishte ngarkuar mjaft rëndë. Xha Foshëlëvani lëshonte gulçime që të këputnin shpirtin. Gjindja ishte mundur ta hiqnin, por më kot. Një përpjekje e gabuar, një ndihmë jo e shkathët, një tronditje pa vend, mund t'ia merrte shpirtin Foshëlëvanit. Ai mund të lirohej vetëm duke e ngritur karron që së poshtmi. Zhaveri, që kishte ardhur aty në çastin e aksidentit, kishte dërguar të kërkonin një kriko.

Zoti Madëlen ia mbërriti në vend. Sa ishin, u hapën plot respekt.

-Ndihmomëni! - thërriste Foshëlëvani plak. - Kush është ai djalë sokol që mund të më shpëtojë mua, plakun e gjorë?

Zoti Madëlen u kthye nga gjindja:

-A ka njeri ndonjë kriko këtu?

-Vajtën të kërkojnë një, - u përgjigj një fshatar.

-Përsa kohë do ta kemi këtu?

-Vajtën atje ku është më afër, te vendi që i thonë Flashò, ku ka një nallban; por sa para bën? një çerek ore të mirë e do se e do.

-Një çerek ore? - bërtiti Madëleni.

Një natë më parë kishte rënë shi, toka ishte bërë qull, karroja nga çasti në çast shkonte duke u vithisur në dhë dhe shtypte gjithnjë e më shumë kraharorin e karrocierit plak. Dukej sheshit se, pa kaluar të pesë minutat, atij do t'i bëheshin brinjët copë.

-Është e pamundur të presim një çerek ore, - u tha Madëleni fshatarëve, që po e vështronin në sy.

-Duhet bërë medoemos një derman!

-Por do të jetë tepër vonë, koha s'pret! A nuk e shihni që karroja po vithiset?

-Po, për besë!

-Dëgjoni këtu, - ia pat Madëleni, - ka mbetur akoma ca vend nën karro sa të futet një njeri dhe ta ngrejë me kurriz. S'duhet më shumë se gjysmë minute dhe ky burrë fatkeq nxirret e shpëton së andejmi. Kush nga ju ka kryqe të forta dhe zemër burri? Ka për të fituar pesë napolona flori.

Asnjeri nuk lëvizti nga grupi.

-Dhjetë napolona, - tha Madëleni.

Të pranishmit ulnin sytë. Njëri syresh murmuriti:

-Duhet të jesh i fortë si dreqi. Pastaj, ka rrezik të dërrmohesh e të bëhesh petë!

-O burrani! - filloi përsëri Madëleni, - njëzet napolona!

Po ajo heshtje.

-Vullneti nuk u mungon të shkretëve, - tha një zë.

Zoti Madëlen u kthye dhe njohu Zhaverin. S'ia kishte zënë syri kur kishte arritur aty. Zhaveri vazhdoi:

-Këtu është punë fuqie. Duhet të jesh ezhdërha për të ngritur mbi kurriz një karro si kjo.

Pastaj, duke ia ngulur vështrimin zotit Madëlen, ai vazhdoi duke i mëshuar secilës fjalë që shqiptonte:

-Zoti Madëlen, në jetën time vetëm një njeri kam njohur unë të zotin të bëjë atë që kërkon ju.

Madëlenit iu drodh shtati.

Zhaveri shtoi si pa të keq, por pa ia hequr sytë Madëlenit.

-Dhe ky ishte një i burgosur me punë të rënda.

-Ah! - ia bëri Madëleni.

-Nga kampi i Tulonit.

Madëleni u zverdh në fytyrë. Ndërkohë karroja vazhdonte të vithisej me ngadalë. Xha Foshëlëvani gulçonte dhe ulërinte:

-M'u mor fryma! M'u bënë brinjët copë! Një kriko! Bëmëni një derman! Ah!

Madëleni vështroi rreth e rreth vetes:

- S'paska njeri që do të fitojë njëzet napolona dhe t'ia shpëtojë jetën këtij plaku të ngratë?

Asnjë nga të pranishmit s'luajti vendit. Zhaveri nisi prapë:

-Vetëm një burrë kam njohur në jetën time që mund të zëvendësonte një kriko. Dhe ky ishte një i burgosur i dënuar me punë të rënda.

-Ah! Më dërrmoi fare! - bërtiti plaku.

Madëleni ngriti kokën, ndeshi syrin prej fajkoi të Zhaverit, që kishte mbetur i mbërthyer mbi të, vështroi fshatarët, që kishin mbetur si të ngrirë, dhe buzëqeshi i pikëlluar. Pastaj, pa thënë asnjë fjalë, ai u lëshua në gjunjë dhe u gjend nën karro, para se turma të kishte mbledhur mendjen e të lëshonte ndonjë britmë.

Kaloi një çast i llahtarshëm pritjeje dhe heshtjeje.

Gjindja e panë Madëlenin pothuajse fare barkas nën atë peshë të frikshme, tek u orvat dy herë më kot të mblidhte tok bërrylat dhe gjunjët. Dikush i thirri: "Xha Madëlen, hiquni së andejmi!" Edhe vetë plaku Foshëlëvan i tha: "Zoti Madëlen, hiquni tutje! Mua më qenka shkruar të vdes! Lërmëni, se do të shtypeni edhe vetë!" Madëleni s'ktheu përgjigje.

Të pranishmit po regëtinin. Rrotat kishin vazhduar të fundoseshin, dhe ishte bërë gati e pamundur që Madëleni të dilte nga poshtë karros.

Befas gjindja panë atë goxha masë të madhe të tundej vendit; karroja po ngrihej ngadalë, rrotat po dilnin përgjysmë nga hullitë. Ata dëgjuan një zë të mbytur që thërriste: "Hajdeni shpejt! Ndihamoni!" Ishte Madëleni, që po bënte një orvatje të fundit.

Gjithë sa ishin, u derdhën. Vetëmohimi i një njeriu të vetëm u kishte dhënë fuqi e zemër të gjithëve. Karroja u çua peshë nga njëzet krahë njëherësh. Plaku Foshëlëvan kishte shpëtuar.

Madëleni u ngrit. Ishte bërë dyllë i verdhë, megjithëse po kullonte në djersë. Rrobat i qenë grisur e mbuluar gjithë baltë. Të gjithë sa ishin aty, po qanin. Plaku po i puthte gjunjët dhe e quante Madëlenin zot shpëtimtar. Në këto çaste Madëlenit i kishte rënë në fytyrë nuk di çfarë nuri vuajtjeje të gëzuar dhe

qiellore, dhe ngulte sytë e tij të qetë mbi Zhaverin, i cili vazhdonte ta vështronte gjithmonë.

VII

Foshëlëvani bëhet kopshtar në Paris

Foshëlëvani, duke rënë, kishte nxjerrë kupën e gjurit. Xha Madëleni e çoi në një infermieri, që e kishte ngritur për punëtorët e tij brenda në ndërtesën e fabrikës dhe ku shërbenin dy murgësia. Të nesërmen në mëngjes plaku gjeti mbi komodinë një biletë njëmijëfrangëshe, me këto fjalë të shkruara nga vetë dora e xha Madëlenit: "*Jua kam blerë karron dhe kalin*". Karroja ishte bërë copë dhe kali kishte ngordhur. Foshëlëvani u shërua, por mbeti i gjymtuar nga gjuri. Zoti Madëlen, me anën e rekomandimeve të murgësive dhe të famullitarit, i gjeti plakut një punë si kopshtar në një kuvend grash të lagjes "Sent-Antuan" në Paris.

Disa kohë pas kësaj ngjarjeje, zoti Madëlen u emërua kryetar i bashkisë. Qysh herën e parë kur e pa zotin Madëlen të ngjeshur me sharpën që i jepte fuqi të plota mbi qytetin, Zhaveri ndjeu atë farë rrëqethjeje që do të ndiente një qen kur nuhat një ujk nën rrobat e të zotit. Që nga ai çast, ai iu shmang atij mesa munda. Kur nevojat e kërkonin medoemos dhe kur nuk kishte si t'ia bënte ndryshe e duhej të ndodhej së bashku me zotin kryetar, ai i fliste me një respekt të thellë.

Ky lulëzim i krijuar në Montrëj-syr-Mer nga xha Madëleni, përveç shenjave të dukshme që treguam, kishte edhe një simptomë tjetër, e cila, sadoqë s'ishte e dukshme, nuk ishte më pak kuptimplote. Dhe kjo nuk të gabon kurrë. Kur popullata vuan, kur puna mungon, kur tregtia ka rënë fare përtokë, bashkëdhënësi s'do të paguajë taksat, se s'ka me se, i ha dhe i kalon afatet, dhe shteti harxhon shumë të holla për shpenzime që kërkojnë veprimet e shtrëngesës dhe të vjeljes së detyruar të taksave. Kur punë ka sa të duash, kur vendi është i lumtur

dhe i pasur, taksa paguhet pa kurrfarë vështirësie dhe shtetit i kushton pak. Mund të themi se mjerimi dhe pasuria e popullit kanë një termometër të pagabueshëm, shpenzimet për vjeljen e taksave. Në shtatë vjet e sipër në rrethin e Montrëj-syr-Merit, shpenzimet e vjeljes së taksave ishin ulur tri të katërtat më pak, prandaj dhe zoti Dë Vilelë, ministër i Financave i asaj kohe, e vinte shpeshherë në pah këtë rreth, midis gjithë rretheve të tjera.

Kjo ishte gjendja e vendit kur erdhi Fantina. Askujt nuk i binte ndër mend se kush kishte qenë ajo. Për fat të mirë, porta e fabrikës së zotit Madëlen ishte si ajo fytyra e mikut dashamirës. Fantina u paraqit aty dhe u pranua në punishten e grave. Mjeshtëria ishte krejt e re për Fantinën, e cila nuk mund të ishte aq e shkathët sa duhej, kështu që asaj i takonte të nxirrte një mëditje të vogël, por, fundi i fundit, kjo mjaftonte, problemi ishte zgjidhur, sepse nxirrte aq sa për të jetuar.

VIII

Zonja Viktyrniën shpenzon tridhjetë e pesë franga për moralin

Kur e pa se po i bënte ballë jetesës, Fantina pati një çast gëzimi. Të jetosh me nder duke punuar, është një lumturi e vërtetë. Puna erdh e iu fut vërtet në zemër. Bleu një pasqyrë, u gëzua, kur këqyri në të rininë e saj, flokët dhe dhëmbët e saj të bukur, harroi shumë gjëra dhe mendoi vetëm për Kozetën dhe për të ardhmen e mundshme, dhe iu duk vetja pothuajse e lumtur. Zuri me qira një dhomë të vogël dhe e mobiloi me kredi, duke u mbështetur në punën e saj të ardhshme; kjo ishte një mbeturinë e zakoneve të saj kur bënte një jetë të çrregullt.

Meqë nuk mund të thoshe se ishte e martuar, ajo ishte ruajtur me kujdes, siç e kemi cekur edhe më parë, ta zinte në gojë vajzën e saj të vogël.

Gjatë këtyre kohëve të para, siç e pamë, ajo ua paguante

me përpikmëri detyrimet e veta Tenardieve. Meqenëse dinte të hidhte vetëm firmën, ajo ishte e detyruar t'u shkruante atyre me anë të një shkruesi publik.

Shkruante dendur. Dhe kjo ra në sy. Pa filluan thashethemet me zë të ulët në punishten e grave se "Fantina na shkruante letra" dhe na paskësh filluar "ta luante bishtin".

S'ka njeri më të keq se ai që përgjon dhe fut hundët kot në veprimet e të tjerëve. "Pse filan zotëri vjen gjithmonë në të errur?" "Pse filani nuk e var kurrë çelësin në gozhdë të enjteve?" "Pse shtegton gjithmonë rrugicave?" "Pse filan zonjë zbret nga karroca përpara se të arrijë në shtëpinë e vet?" "Pse dërgon t'i blejnë një fletore për letra", kurse ajo "të tilla ka në shtëpi sa të hajë qeni?" etj., etj. Ka asi njerëzish, të cilët, për të gjetur çelësin e këtyre enigmave, që nuk u hyjnë aspak në punë, prishin më shumë të holla, më shumë kohë, heqin më shumë keq nga sa do të duhej për të bërë dhjetë punë të mbara; dhe këtë e bëjnë krejt falas, nga qejfi, vetëm e vetëm se i bren kureshtja nga brenda. Do të venë e t'i bien pas e ta gjurmojnë të birin apo të bijën e botës me ditë të tëra, do të rrinë të bëjnë rojë e të përgjojnë me orë të tëra qosheve të rrugëve, nën qemeret e portave, natën, në të ftohtë e në shi, do të shtien kallauzë pas kallauzësh, do t'u japin të pinë e do të dehin karrocierë e shërbëtorë, do të blejnë ndonjë shërbyese, do të shtien në dorë ndonjë portier. E përse? Për asgjë. Kjo është një vardisje këmbëngulëse për të parë, për të mësuar dhe për të futur hundët në punët e tjetërkujt. U ha goja për të folur. Dhe shpesh këto sekrete të njohura, këto enigma të zgjidhura shkaktojnë katastrofa, dyluftime, falimente, rrënim familjesh, shkatërrim jetësh dhe u sjell gëzim të madh atyre që kanë "zbuluar gjithçka" pa asnjë interes, por vetëm nga instinkti. Ç'gjë e trishtuar!

Një palë njerëz janë të këqij vetëm e vetëm për shkak se s'u rrihet pa folur. Bisedimi i tyre, kuvendimi në sallon, llafet në dhomën e pritjes, janë si ata oxhakët që i djegin shpejt drutë; atyre u duhet shumë lëndë djegëse; dhe kjo lëndë djegëse është fqinji, i afërmi.

Kështu pra, e vëzhguan edhe Fantinën.

Përveç kësaj, edhe shumë syresh ishin ziliqare për flokët e saj të verdhë dhe dhëmbët e saj të bardhë.

Grave u kishte rënë në sy se në punishte, midis shoqeve të tjera, ajo kthente shpesh kokën mënjanë dhe fshinte ndonjë lot. Këto ishin çastet kur ajo mendonte për fëmijën e vet; ndoshta edhe për burrin që kishte dashuruar.

Këputja e vjegave të fshehta të së kaluarës është një punë e dhimbshme.

Vunë re se ajo shkruante, të paktën dy herë në muaj, gjithmonë po në atë adresë, dhe se letrës i ngjiste pulla poste. Arritën ta shtinin në dorë edhe adresën: *Zotërisë së tij, zotit Tenardie, bujtnar në Monfermeij*. Papo e kurdisën edhe shkruesin publik që të llotoste në kabaré. Ky shkruesi publik na ishte një burrë plak e babaxhan, i cili nuk mund ta mbushte barkun me verë të kuqe, pa zbrazur xhepin e sekreteve të tij. Shkurt, u mor vesh se Fantina na paskësh një fëmijë. "Duhej të ishte njëfarë vajze". U gjet edhe një ndrikull që bëri një udhëtim gjer në Monfermeij, foli me Tenardietë dhe tha, kur u kthye: "Vërtet harxhova tridhjetë e pesë franga, por tani e kam zemrën të larë dhe s'ma bren merak. E pashë fëmijën me këta sy!"

Ndrikulla që bëri këtë punë, na ishte një magjistrice që quhej zonja Viktyrnien, ruajtëse dhe mbrojtëse e virtytit të të gjithë botës. Zonja Viktyrnien ishte një grua pesëdhjetë e shtatë vjeç dhe e dyfishonte maskën e shëmtisë me maskën e pleqërisë. Kishte një zë që i dridhej dhe ishte mendje dhi. Sikur s'të besohej që kjo grua plakë të kishte qenë njëherë e një kohë e re. Kur ishte e re, tamam në vitin 93, ajo na qenkësh martuar me një murg që ishte arratisur nga manastiri me një kësulë të kuqe dhe që kishte kaluar nga urdhri i bernardinëve në partinë e jakobinëve. Ajo ishte e thatë, me një lëkurë si hoshaf, piperkë djegëse, turjelë, që s'linte gjë pa zhbiruar, thumbuese dhe gati helmatisëse; gjithmonë e sillte ndër mend dhe e kujtonte murgun e saj, që e kishte lënë vejushë dhe që e kishte bërë zap e përkulur. Ajo ishte një hithër e gjallë, që mbante akoma erë zhgun murgu. Kur erdhi rivendosja e monarkisë, ajo na qenkësh bërë fetare e madhe dhe me aq zell, sa priftëria ia kishin falur mëkatën që pati bërë duke u martuar me murgun. Kjo grua na

kishte një copë pasuri, të cilën ia linte me zhurmë e bujë si trashëgim një bashkësie fetare. Në ipeshkvinë e Arrasit e kishin marrë me sy shumë të mirë. Kjo, pra, na ishte zonja Viktyrnien, që na vajti në Monfermeij dhe u kthye duke thënë: "E pashë fëmijën me këta sy".

Gjithë kjo punë kërkoi mjaft kohë. Fantina kishte më shumë se një vit që kishte hyrë në fabrikë, kur, një mëngjes, kujdestarja e punishtes i dorëzoi nga ana e zotit kryetar të bashkisë pesëdhjetë franga, duke i thënë se nuk do të bënte më pjesë në punishte dhe duke e porositur, nga ana e zotit kryetar, që të largohej nga ajo krahinë.

Pikërisht po këtë muaj Tenardietë, pasi kishin kërkuar dymbëdhjetë, në vend të gjashtë frangave, kërkonin tani pesëmbëdhjetë, në vend të dymbëdhjetë frangave.

Fantinës sikur i ra qielli mbi kokë. Ajo nuk mund të largohej nga krahina, pastaj kishte edhe borxhet e qirasë dhe të mobiljeve. Të pesëdhjetë frangat nuk mjaftonin as për të larë këto borxhe. Fantina belbëzoi disa fjalë lutëse. Kujdestarja i njoftoi se ajo duhej të dilte atë çast nga punishtja. Pastaj ajo s'ishte as ndonjë punëtore e mirë. E dërrmuar, më shumë nga turpi sesa nga dëshpërimi, ajo doli nga punishtja dhe u kthye në dhomën e vet. Pra, gabimin e saj e dinin të gjithë tani!

S'kishte më fuqi të nxirrte asnjë fjalë nga goja. Disa e këshilluan të shkonte e të takohej me zotin kryetar, por ajo nuk guxoi. Zoti kryetar i jepte pesëdhjetë franga, sepse ishte njeri i mirë, dhe e përzinte, sepse ishte njeri i drejtë. Ajo iu nënshtrua këtij vendimi.

IX

Suksesi i zonjës Viktyrnien

Vejusha e murgut që, pra, e dobishme për të bërë pesë para punë. Nga ana tjetër, zoti Madëlen s'kishte pasur fare dijeni për këtë çështje. Këso gërshetime ngjarjesh jeta ka plot.

Zoti Madëlen e kishte zakon të mos hynte kurrë në punishten e grave. Kishte vënë në krye të kësaj punishteje një vajzë të thyer nga mosha, të cilën ia kishte dhënë famullitari e tek e cila kishte besim të plotë, grua me gjithë mend e respektueshme, e qëndrueshme, e drejtë, e dhimbshur vetëm për të dhënë, por jo edhe për të kuptuar dhe për të falur të metat. Zoti Madëlen mbështetej tek ajo për çdo punë e çështje. Edhe njerëzit më të mirë shpeshherë janë të shtrenguar t'ua ngarkojnë të tjerëve autoritetin e tyre. Dhe pikërisht duke pasur këtë pushtet të plotë dhe duke qenë e bindur se po vepron mirë, kujdestarja kishte kryer hetimet dhe e kishte gjykuar, dënuar dhe ekzekutuar Fantinën.

Përsa u përket të pesëdhjetë frangave, ato ajo i kishte dhënë nga një shumë që zoti Madëlen ia besonte për lëmosha dhe ndihma për punëtorët dhe për të cilën ajo nuk jepte llogari.

Fantina kërkoi të hynte si shërbyese në qytet; vajti derë më derë, por askush nuk e pranoi. Nga qyteti nuk kishte mundur të largohej. Tregtari i vjetërsirave, të cilit i kishte borxh mobiljet, dhe çfarë mobiljesh! i kishte thënë: "Po të ikni, do të kërkoj t'ju arrestojnë si vjedhëse." Pronari të cilit i kishte borxh qiranë, i kishte thënë: "Ju jeni e re dhe e bukur, ju mund të paguani." I ndau të pesëdhjetë frangat midis tregtarit të vjetërsirave dhe pronarit të shtëpisë, ia ktheu të parit tri të katërtat e mobiljeve, mbajti vetëm të domosdoshmet dhe u gjend pa punë e pa zanat, duke mos pasur gjë tjetër përveç shtratit dhe njëqind frangave borxh.

Fantina u vu të qepte këmishë të trasha për ushtarët e garnizonit dhe fitonte dymbëdhjetë su në ditë. E bija i kushtonte dhjetë. Pikërisht në këtë kohë ajo filloi të mos paguante në rregull Tenardietë.

Ndërkohë, një grua plakë, e cila i ndizte kandilin kur kthehej mbrëmjeve në shtëpi, i mësoi asaj artin se si të jetonte në mjerim. Prapa të jetuarit me pak, është të jetuarit me asgjë. Këto janë si dy dhoma: e para është e errët, e dyta është e zezë sterrë.

Fantina nxuri se si njeriu mund të bëjë edhe fare pa zjarr në dimër, si të heqë dorë nga një zog që të ha një kacidhe mel

çdo dy ditë, si ta bëjë zhuponin kuvertë dhe kuvertën zhupon, si ta kursejë qiririn duke ngrënë darkën nën dritën e dritares kundruall. Njeriut s'ia merr dot mendja se çfarë janë në gjendje të nxjerrin nga një su disa qenie të dobëta që janë plakur në skamje, por me nder. Fantina e përvetësoi këtë talent të madhërishtëm dhe mori pak zemër.

Në këtë periudhë ajo i thoshte një fqinjës së saj:

-Ja! Them me vete nganjëherë: Duke fjetur vetëm pesë orë dhe duke punuar gjithë kohën tjetër me të qepurat, do t'ia dal të nxjerr gjithmonë një kafshatë bukë. Dhe pastaj, kur je e brengosur, ha më pak. Kështu pra! Vuajtje, qedere, pakëz bukë, në njërën anë, vrere, në anën tjetër, të gjitha këto do të më ushqejnë.

Në këtë mjerim kaq të madh, do të ishte një lumturi e pazakontë, sikur ta kishte pranë edhe të bijën. Njëherë tha ta sillte e ta mbante me vete. Por si t'ia bënte? Ta bënte edhe të bijën të ndante skamjen me të? Pastaj, ajo u kishte borxhe edhe Tenardieve! Si të lahej me ta? Po udhëtimin me se ta paguante?

Ajo plaka, që i kishte dhënë ato që mund të quhen mësimë mbi jetën në skamje, ishte një vajzë shenjtoje, që quhej Margaritë, fetare, e varfër dhe e dhembshur për të varfrit, madje edhe për të pasurit, që dinte të shkruante vetëm aq sa të nënshkruante *Margaritë* dhe që i besonte Zotit, gjëra këto që përbënin, sipas mendjes së saj, të tërë shkencën.

Poshtë ka shumë nga këto virtyte; një ditë këto virtyte do të jenë lart. Kjo jetë ka një të nesërme.

Kohët e para, Fantinës i vinte aq turp, sa nuk guxonte të kapërcente as pragun e shtëpisë.

Kur ndodhej në rrugë, ajo e ndiente se njerëzit ktheheshin prapa saj dhe e tregonin me gisht; të gjithë e vështronin me sy, por askush s'i fliste me gojë; përbuzje e hidhët dhe e ftohtë e kalimtarëve i hynte në mish e në shpirt si ndonjë thëllim.

Në qytetet e vogla duket sikur një fatkeqe është lakuriq nën talljet therëse dhe kureshtjen e gjithë botës. Në Paris, të paktën, s'të njeh njeri, dhe kjo errësirë është si njëfarë veshjeje. Oh, sa luste e shkreta të ishte në Paris! Por ishte e pamundur.

Deshi s'deshi, u mësua me mospërfilljen e të tjerëve, ashtu

siç ishte mësuar me skamjen. Pak nga pak ajo e ndau mendjen. Pas dy a tre muajsh, ajo e flaku tej turpin dhe filloi përsëri të dilte, sikur të mos kishte ngjarë asgjë.

-Mua aq më bën! - tha ajo.

Dhe shkante e vinte, me kryet lart e me një buzëqeshje të hidhët, dhe ndjeu se po bëhej e paturpshme.

Zonja Viktyrnien disa herë e shikonte nga dritarja tek kalonte rrugës, e vinte re mjerimin e "asaj krijese", e cila falë saj "e kishte gjetur vendin", dhe i bëhej zemra mal. Zemërligjtë kanë një lumturi të zezë sterrë.

Puna e tepërt e lodhte Fantinën, dhe ajo kollëza e thatë që e kishte zënë iu shtua akoma më shumë. Hera-herës ajo i thoshte fqinjës së vet, Margaritë: "Pa m'i zini një herë duart, shikoni se sa të nxehta i kam!"

Megjithatë, mëngjeseve, kur krihte me një krehër të vjetër e të thyer flokët e saj të bukur, që i derdheshin si mëndafsh i flashkët, ajo gëzonte një minutë pispillosjeje të lumtur.

X

Vazhdimi i suksesit

Atë e kishin pushuar nga puna aty në të dalë të dimrit; kaloi si kaloi edhe vera, por dimri erdhi përsëri. Ditë më të shkurtra, punë më pak. Dimrit, pa ngrohje, pa dritë, pa mesditë; mbrëmja është njësh me mëngjesin, mjegull, mugëtirë; dritarja ka ngjyrën e hirit dhe njeriu nuk sheh qartë. Qielli është sa një dritarez e vogël. E tërë dita është një pus. Dielli ka pamjen e një varfanjaku. Stinë e llahtarshme! Dimri e shndërron në gur ujin e qiellit dhe zemrën e njeriut. Kreditorët nuk e linin të merrte as frymë.

Fantina fitonte tepër pak. Borxhet i zinin njëri-tjetrin. Tenardietë, që nuk paguheshin në rregull, i shkruanin orë e çast letra, përmbajtja e të cilave e brengoste pa masë dhe e rrëronte fare. Një ditë prej ditësh ata i shkruan se Kozeta e saj

e vogël paskësh mbetur fare lakuriq në atë të ftohtë të madh që bënte, se ajo kishte nevojë për një fustan të leshtë dhe se duhej që e ëma të dërgonte për këtë punë të paktën dhjetë franga. E mori letrën dhe e rrudhi në dorë gjithë ditën e ditës. Në mbrëmje hyri te një floktar që banonte te cepi i rrugës dhe hoqi krehrin që i kapte flokët. Flokët e saj të mrekullueshëm erdhën e t'iu derdhën gjer te beli.

-Ç'flokë të bukur! - bërtiti floktari.

-Sa më jepni? - tha ajo.

-Dhjetë franga.

-Prejini.

Ajo bleu një fustan të thurur dhe ua dërgoi Tenardieve. Ky fustan i xhindosi fare Tenardietë. Ata donin para jo fustan. Ia dhanë fustanin Eponinës. E shkreta Lareshë vazhdoi të dridhej si purteka.

Fantina mendoi: "Tani ime bijë nuk ka më ftohtë. E vesha me flokët e mi". Ajo vinte kësulëza të rrumbullakëta, të cilat ia mbulonin kokën e qethur dhe e tregonin akoma të bukur.

Shtjellime të errëta po përftoheshin në zemrën e Fantinës. Kur pa se nuk mund të krihte më flokët, ajo filloi t'i shihte me urrejtje e t'i merrte zët të gjitha gjërat që e rrethonin. Edhe ajo, si gjithë të tjerët, kishte një përnderim të madh për xha Madëlenin; por duke përsëritur me vete se ishte pikërisht ai shkaku i fatkeqësisë që e pllakosi, ajo arriti që ta urrente edhe atë, sidomos atë. Kur kalonte përpara fabrikës në orët kur punëtoret ishin te porta, ajo shtirej sikur qeshte e këndonte.

Një punëtoreshë e vjetër, tek e pa të këndonte dhe të qeshte kësisoj, tha:

-Kjo vajzë ka për të përfunduar keq.

Ajo zuri një dashnor, të parin që takoi, një burrë, të cilin ajo nuk e dashuronte, por e zuri për inat të botës, me zemër të plasur e të mbushur plot tërbim. Ai ishte një fatkeq, njëfarë muzikanti lypës, një dembel me vulë, që e rrihte dhe që e braktisi ashtu siç e pati marrë ajo, me neveri.

Fantina e adhuronte fëmijën e vet.

Sa më shumë binte tatëpjetë, aq më e zymtë bëhej gjithçka rreth saj dhe aq më shumë ai engjëllth i butë rrezatonte në

thelësi të shpirtit të saj. Ajo thoshte: “Kur të bëhem e pasur, do të mbaj Kozetën me vete; dhe qeshte. Kolla s’i ndahej fare dhe kurrizi i lëmekej nga djersët.

Një ditë ajo mori një letër të sajuar kështu: “Kozeta është e sëmure nga një sëmundje që është përhapur shumë këtyre anëve. Asaj na i thënkkan ethe puçrrizash. Duhet ilaçe të shtrenjta. Kjo po na rrënon krejt dhe nuk kemi me se t’i paguajmë. Po nuk na dërguat dyzet franga brenda tetë ditëve, vogëlushja do të vdesë.”

Filloi të qeshte me të madhe dhe i tha fqinjës së saj të vjetër: “Ah! Të mençur njerëz që qenkan! Dyzet franga! Bukur, besa! Dyzet franga i thonë dy napolona ar! E ku të vete t’i gjej unë? Qenkan vërtet hajvanë këta fshatarët!”

Megjithatë, ajo vajti te shkallët pranë një dritareje të vogël dhe e lexoi përsëri letrën. Pastaj zbriti shkallëve dhe doli duke vrapuar e duke kërcyer, gjithmonë duke qeshur. Dikush, që e takoi në rrugë, i tha:

-Ç’ju gjeti që qenkeni kaq e gëzuar?

Ajo u përgjigj:

-Qesh me një marrëzi të bukur që më kanë shkruar disa fshatarakë. Më kërkojnë dyzet franga. Hajde fshatarë, hajde!

Tek po kalonte përmes sheshit, ajo pa një grumbull njerëzish rreth një karroce me formë të çuditshme, mbi sediljen e së cilës po mbante llogo në këmbë një njeri i veshur me petka të kuqe. Ishte një xherah dhëmbëtar e pehlivan, që endej nga një vend në tjetrin. Ai i ofronte gjindjes proteza dhëmbësh, barna me bazë opiumi, pluhura dhe eliksire.

Fantina u përzie me grupin dhe filloi të qeshte si të tjerët me këtë llogo të përzier me argo për harbutërinë dhe me zhargon për njerëzit e kënduar. Dhëmbëtari e pa atë vajzë aq të bukur që po qeshte dhe bërtiti papritmas: “Paske dhëmbë të bukur ti, moj vajzë, që po më qesh aty. Po të duash të m’i shesësh ato dy paftat e tua, po të jap për secilën një napolon ar, në dorë.

-Ç’janë këto paftat e mia? - pyeti Fantina.

-Paftat, - ia priti profesori dhëmbëtar, - janë dhëmbët e përparmë, ata dy të sipërmit.

-Ç’llahtarë! - bërtiti Fantina.

-Dy napolona! - foli si me gërnjë një plakë pa dhëmbë që ndodhej aty. - Ja kush na qenka me fat!

Fantina ua mbathi këmbëve dhe zuri veshët për të mos e dëgjuar më atë zë të ngjirur që i thërriste:

-Vëri gishtin kokës, moj bukuroshe: dy napolona bëjnë shumë punë. Po ta deshi zemra, eja sonte në hanin “Tijak d’arzhan”, se aty më ke.

Fantina hyri në shtëpi tërë inat dhe ia kallëzoi punën fqinjës së saj të mirë, Margaritës.

-Si i thoni ju kësaj pune? Është apo s’është i urrejtshëm ai burrë? Si lejuakan njerëz të tillë të enden këtyre vendeve! Të më shkulë të dy dhëmbët e përparmë! Por unë do të duksha e llahtarshme. Flokët dalin e rriten përsëri, po dhëmbët! Ah! Ai paska qenë vërtet përbindësh! Më mirë të hidhem me kokën poshtë nga kati i pestë drejt e në kalldrëm! Më tha se sonte do të ishte në hanin “Tijak d’arzhan”.

-Dhe çfarë jepte ai? - pyeti Margarita.

-Dy napolona.

-Dy napolona bëjnë dyzet franga.

-Po, - tha Fantina, - dyzet franga bëjnë.

Ajo mbeti e menduar dhe ia filloi punës. Pas një çerek ore e la qepjen dhe shkoi te shkallët ta lexonte edhe një herë letrën e Tenardieve.

Kur u kthye brenda, i tha Margaritës, që punonte pranë saj:

-E ç’është kjo ethe me puçrriza? E dini ju ç’është?

-Po, - tha lënësja, - është një sëmundje.

-Duhet shumë barna?

-Oh! Barna të tmerrshme.

-Ku të kap kjo sëmundje?

-Sëmundje është, të kap ku të duash.

-I goditka edhe fëmijët?

-Sidomos fëmijët.

-A vdes njeriu nga ajo?

-Vdes që ç’ke me të, - tha Margarita.

Fantina doli dhe shkoi edhe një herë ta lexonte letrën te shkallët.

Në mbrëmje ajo zbriti, dhe e panë tek po drejtohej nga ana e Rrugës së Parisit, ku janë hanet.

Të nesërmen në mëngjes, Margarita, tek po hynte në dhomën e Fantinës, para se të zbardhte dita, sepse punonin gjithmonë së bashku dhe kësisoj digjnin të dyja vetëm një qiri, e gjeti Fantinën të ulur mbi shtrat, të verdhë dyllë dhe të ftohtë akull. Nuk kishte rënë për të fjetur. Kësulëza i kishte rënë mbi gjunjët. Qiriri kishte mbetur i ndezur gjithë natën e natës dhe ishte pothuajse në të mbaruar.

Margarita u ndal te pragu dhe ngriu në vend nga ky çrregullim i madh. Ajo bërtiti:

-O Zot i madh! Qiriri qenka djegur i tëri! Kushedi se ç'hata do të ketë ndodhur!

Pastaj ajo vështroi Fantinën, e cila po kthente drejt saj kokën pa flokë.

Brenda një nate Fantina ishte plakur sa për dhjetë vjet.

-Jezus! - tha Margarita, - ç'paskeni kështu, moj Fantinë?

-S'kam asgjë, - u përgjigj Fantina. - Përkundrazi. Fëmija ime nuk do të vdesë nga ajo sëmundja e llahtarshme për mungesë barnash. Jam e kënaqur.

Duke folur në këtë mënyrë, ajo i tregonte lëneshës dy napolona, që shndritnin mbi tryezë.

-Ah, o zoti Krisht! - tha Margarita. - Por kjo është një pasuri e tërë! Ku i paskeni gjetur këto luigje ari?

-I kam gjetur, - u përgjigj Fantina.

Në të njëjtën kohë ajo buzëqeshi. Qiriri lëshonte dritë mbi fytyrën e saj. Kjo ishte një buzëqeshje e përgjakur. Ca jargë të kuqërremta i lersonin cepin e buzëve dhe një vrimë e zezë i dukej në gojë.

Të dy dhëmbët ishin shkukur. Ajo i dërgoi të dyzet frangat në Monfermej. S'do mend që kjo ishte një dhelpëri e sajuar nga Tenardietë për të zhvatur të holla. Kozeta nuk kishte qenë e sëmurë.

Fantina e flaku pasqyrën nga dritarja. Kishte kohë që e kishte lënë qelën e saj të katit të dytë dhe kishte zënë një

papafingo, që mbyllej me një mandallë nën çati; ishte një nga ato kthinat ku çatia formon një kënd të ngushtë me dyshtemë dhe ku e përplaste kokën orë e çast. I varfëri nuk mund të vejë në fund të dhomës së vet, ashtu siç nuk vete në fund të fatit të vet, veçse duke u përkulur shumë e më shumë. Ajo s'kishte më shtrat, i kishte mbetur vetëm një cergë e grisur, që e quante mbulojë, një dyshek për toke dhe një karrige, së cilës i mungonte kashta. Edhe një trëndafil të vogël që kishte, edhe ai ishte tharë në një qoshe, i harruar fare. Në qoshen tjetër ishte një poç gjalpi për ujë, që ngrinte e bëhej akull dimrit dhe ku nivelet, e ndryshme të ujit qëndronin për një kohë të gjatë, të shënuara me rrahtë akulli. Ajo e kishte ngrënë turpin me bukë, prandaj humbi edhe sqimën. Shenja e fundit. Ajo dilte me kësulëza të ndyta. Qoftë ngaqë nuk kishte kohë, qoftë ngaqë nuk ia varte fare, ajo nuk i arnonte më të linjtat e saj. Kur i griseshin thembrat e çorapeve, ajo i tërhijte çorapet brenda në këpucë. Kjo i dukej nga disa rrudha të pingulta që formonin çorapet. Ajo çoku i shtinte ndonjë andër korsesë së vet të vjetër dhe të përdorur, duke e mballosur me copa bezeje, që griseshin me të bërë lëvizjen më të vogël. Njerëzit te të cilët kishte hyrë borxh, i kurdisnin "skena" dhe nuk e linin kurrë të qetë. Ajo i gjente ata në rrugë dhe pastaj te shkallët e shtëpisë së vet. Kalonte net të tëra duke qarë dhe duke menduar. Sytë i kishte shumë të shndritshme dhe ndiente një dhimbje të ngulët në sup, nga pjesa e sipërme e shpatullës së majtë. Kolla s'i ndahej fare. Ajo e urrente thellë Madëlenin, por nuk ankohej kurrë. Qepte shtatëmbëdhjetë orë të tëra në ditë; por një sipërmarrës i punës së burgjeve, që u jepte të burgosurve pagë të ulët, shkaktoi papritmas uljen e çmimeve, gjë që e katandisi mëditjen e punëtorëve të lira në nëntë su. Shtatëmbëdhjetë orë punë për nëntë su në ditë! Kreditorët e saj tregoheshin më të pamëshirshëm se kurrë. Tregtari i vjetërsirave, që ia kishte marrë përsëri pothuajse të gjitha mobiljet, i thoshte vazhdimisht: "E kur do të m'i paguash borxhet, moj horruce?" E çfarë s'i kërkonin asaj, o Zot i madh! Ajo e ndiente veten të përndjekur dhe në shpirt të saj po zhvillohej një ndjenjë prej shtaze të egër. Në këtë kohë Tenardieja i shkroi se me gjithë

mend kishte pritur me një zemërgjerësi të tepruar dhe se i duheshin njëqind franga, bile menjëherë; ndryshe do ta përzinte Kozetën e vogël, që sapo kishte filluar ta merrte veten nga sëmundja e rëndë që kishte hequr, do ta nxirrte në mes të të ftohtit, udhëve, ku të bënte ç'të donte, dhe le të ngordhte, po t'i donte qejfi. "Njëqind franga", - mendoi Fantina. - "Por ku ka ndonjë zanat në botë me të cilin njeriu mund të fitojë njëqind *su* në ditë?"

-Hajde! - tha ajo, - le ta shesim edhe atë që na ka mbetur. Dhe e pafata u bë grua publike.

XI

Ç'është vallë kjo historia e Fantinës?

Është shoqëria që blen një skllave.

Kujt ia blen? Mjerimit.

Urisë, të ftohtit, vetmisë, braktisjes, skamjes. Tregti e dhimbshme. Një shpirt për një krodhe bukë. Mjerimi ofron, shoqëria pranon.

Thonë se skllavëria është zhdukur nga qytetërimi evropian. E kanë gabim. Skllavëria ekziston gjithmonë, por ajo rëndon tanimë mbi gruan dhe quhet kurvëri.

Ajo rëndon mbi gruan, domethënë mbi hijeshinë, mbi krijesën e brishtë, mbi bukurinë, mbi amësinë. Kjo gjë nuk është një nga turpet më të vogla të njeriut.

Në këtë pikë të kësaj drame të dhimbshme ku kemi arritur, Fantinës nuk i mbetet kurrgjë nga ajo që ka qenë dikur. Ajo është bërë mermer duke u bërë baltë. Kush e prek, ndien të ftohtë. Ajo kalon, ju nënshtrohet dhe ju injoron; ajo është figura e çnderuar dhe e rreptë. Jeta dhe rendi shoqëror i kanë thënë asaj fjalën e fundit. Asaj i ka ndodhur gjithçka që mund t'i ndodhë. Ajo i ka përndier të tëra, i ka duruar të tëra, i ka përjetuar të tëra, i ka vuajtur të tëra, i ka humbur të tëra, i ka qarë të tëra. Ajo është përrulur me atë përrulje që i përngjet

moskokëçarjes, ashtu si vdekja që i përngjet gjumit. Ajo nuk i shmanget tanimë asgjëje. Ajo s'ia ka më frikën asgjëje. Le të rrjedhin të gjitha retë mbi të dhe le të kalojë mbi të i tërë oqeani! Asaj aq i bën! Ajo është si ai sfungjeri që është ngopur cit më cit me ujë.

Të paktën ajo kështu beson, por është gabim të mendosh se mund të shterësh fatin dhe të prekësh fundin e çfarëdo gjëje goftë.

XII

Zoti Bamatabua pa punë e pa zanat

Ka në të gjitha qytetet e vogla, dhe sidomos në Montrëj-syr-Mer, një klasë djemsh të rinj, që skërmitin një mijë e pesëqind livra rentë, po ashtu si të ngjashmit e tyre, që gllabërojnë në Paris dyqind mijë franga në vit. Këto janë qenie të gjinisë së madhe asnjane; dema të tredhur, parazitë, krejt pa vlerë, që kanë pak tokë, pak fara në kokë dhe pak mendjemprehtësi, të cilët do të dukeshin si fshatarakë në një sallon dhe që hiqen si fisnikë në kabare, që thonë: "Livadhet e mia, pyjet e mia, bujqit e mi"; që fishkëlajnë aktoret e teatrit për të provuar se janë njerëz me shije, që grinden e zihen me oficerët e garnizonit për të treguar se janë njerëz të luftës, që dalin për gjah, pinë duhan, hapin gojën si për gjumë, pinë, kundërmojnë era duhan, luajnë bilardo, vështrojnë udhëtarët tek zbresin nga karroca, jetojnë në kafene, hanë darkë në han, kanë një qen, që ha kockat nën tryezë, dhe një dashnore, që vendos gjellët mbi të, gjellë që hahen për një *su*, vishen sipas modës, por me tepri, admirojnë tragjeditë, përbuzin gratë, grisin çizmet e tyre të vjetra, kopjojnë Londrën përmes Parisit dhe Parisin përmes Pont-a-Musonit, plaken guakë, nuk punojnë, nuk shërbejnë për asgjë dhe nuk sjellin ndonjë dëm të madh.

Zoti Feliks Tolomiesi do të ishte një burrë si këta, po të

kishte qëndruar në krahinë dhe po të mos e kishte parë kurrë Parisin.

Po të ishin më të pasur, për ta do të thoshin: “Këta janë elegantë!” Po të ishin më të varfër, do të thoshin: “Këta janë punëkotë.” Por këta janë thjesht njerëz pa punë e pa zanat. Midis tyre ka njerëz të mërzitshëm, të mërzitur, ëndërrues dhe tuhafë.

Asokohe një zotëri elegant mbante një kollare të ngritur, një kravatë të madhe, një sahat me qostek, tri zhilera të vëna njëri mbi tjetrën dhe me ngjyra të ndryshme, ngjyrën e kaltër dhe të kuqen përbrenda, një kostum ngjyrë ulliri të prerë shkurt, me bisht, me nga dy radhë kopsash argjendi, të qepura ngjeshur njëri pas tjetrës, që ngjiten deri në sup, dhe një palë pantallona ngjyrë ulliri më të çelur, të zbukuruara në të dyja të qepurat me një numër të pacaktuar vazhdash, por gjithmonë me numër tek, që ndryshonte nga një gjer në njëmbëdhjetë, kufi, ky, që nuk kalohej kurrë. Shtojuni gjithë këtyre një palë këpucë me qafa me pafta hekuri te takat, një kapelë të lartë në formë cilindri dhe me strehë rrethore të ngushtë, flokë si driza, një bastun shumë të madh dhe një bisedë të kripur me kalamburet e Potiesë. Dhe, mbi të gjitha këto, mamuze dhe mustaqe. Në atë kohë mustaqet donin të thoshin borgjez dhe mamuzet donin të thoshin këmbësor.

Eleganti i krahinës mbante mamuze më të gjata dhe mustaqe më të përdredhura.

Ishte koha e luftërave të republikave të Amerikës së Jugut kundër mbretit të Spanjës, e Bolivarit kundër Morijos. Kapelat me strehë të ngushta ishin mbretërore dhe quheshin morijo; liberalët mbanin kapele me strehë të gjerë dhe quheshin bolivarë.

Pra, tetë a dhjetë muaj pas atyre që treguam në faqet e mëparshme, aty në ditët e para të janarit 1823, një mbrëmje kur kishte rënë dëborë, njëri nga këta elegantët, njëri nga këta birçet pa punë e pa zanat, një njeri “me mendime të mira”, sepse mbante një morijo në kokë dhe, veç të tjerave, ishte mbështjellë ngrohtë me një prej atyre mantove të mëdha, të cilat plotësonin në stinë të ftohtë kostumin që hiqej në modë, po argëtohej duke

ngacmuar njëri-njër prej atyre krijesave, që endej e veshur me fustan balloje dekolte, me lule në kokë, përpara xhamit të kafenesë së oficerëve. Ky elegant na pinte edhe duhan, sepse ashtu ishte moda.

Sa herë që kjo grua kalonte përpara tij, ai bashkë me një shtëllungë tymi të puros që pinte, i hidhte ndonjë fjalë, që ai kujtonte se ishte e hollë dhe gazmore, si për shembull: “Sa e shëmtuar që më qenke! - Hiqmu nga sytë! - Ti s’paske as dhëmbë!” etj., etj. Ky zotëri na quhej Bamatabua. Gruaja, hije e trishtuar dhe e stolitur, që shkante e vinte mbi dëborë, nuk i përgjigjej atij dhe as ia hidhte sytë fare, por kryente në heshtje dhe me një rregullsi të zymtë shëtitjen e vet, e cila e risillte çdo pesë minuta nën fshikullën e talljeve therëse, ashtu si atë ushtarin e dënuar, që është i detyruar të kthehet në kamxhikun, që e rreh. Meqë talljet e tij s’patën efekt, kjo e sëmboi birçen e papunë, i cili, duke përfitur nga një çast kur ajo po kthehej, bëri përpara drejt saj duke ecur majë gishtave dhe duke përmbajtur të qeshurit, u ul, mori përdhe një shuk dëbore dhe ia shtiu papritmas në kurriz midis dy supeve të zhveshura. Vajza lëshoi një ulërimë, u kthye, u hodh si ndonjë panterë dhe iu vërsul djaloshit, duke ia ngulur thonjtë në fytyrë dhe duke i lëshuar një breshëri fjalësh nga më të llahtarshmet që mund të nxjerrë goja e njeriut. Këto të shara, të vjella me një zë të ngjirur nga rakia, dilnin aq ndyrë nga ajo gojë, së cilës në të vërtetë i mungonin dy dhëmbët e përparmë! Kjo ishte Fantina.

Nga zhurma që u shkaktua, oficerët dolën turmë nga kafeneja, kalimtarët u grumbulluan, dhe u formua kështu një rreth që qeshte, që bërtiste dhe që duartrokiste, rreth asaj shakulline të përbërë nga dy qenie, ku ishte vështirë të dalloje një burrë dhe një grua, burri, që po përpëlitej me kapelën përtokë, gruaja, që godiste me shkelma dhe me grushte, pa kësulë, duke ulëritur, pa dhëmbë dhe pa flokë, e nxirë nga inati, e llahtarshme.

Befas një burrë shtatgjatë doli me vërtik nga turma, e kapi gruan nga jeleku prej sateni të llangosur me baltë dhe i tha: “Eja pas meje!”

Gruaja ngriti kryet; zëri i saj i egërsuar u mek papritmas.

Sytë e saj ishin bërë si xham i mjegulluar, fytyra, e nxirë nga inati, erdhi e u zbeh; ajo fërgëllonte plot llahtarë. Kishte njohur Zhaverin.

Birboja elegant kishte përfituar nga kjo ndodhi dhe ishte larguar vjedhurazi.

XIII

Zgjidhja e disa çështjeve të policisë bashkiake

Zhaveri i largoi të pranishmit, çau rrethin dhe filloi të ecte me hapa të mëdhenj drejt zyrës së policisë, që ndodhej në skajin e sheshit, duke tërhequr pas vetes vajzën fatkeqe. Ajo bindej mekanikisht. As ai, as ajo nuk këmbenin asnjë fjalë. Trumba e spektatorëve, në kulmin e gëzimit, po i përcillte me tallje e shpoti. Mjerimi i madh bëhet shkak për fëlliqësirat më të mëdha.

Si arriti në zyrën e policisë, një sallë e ulët, e ngrohur nga një por dhe e ruajtur nga një truprojë, me një portë me xhamllëk dhe grila në rrugë, Zhaveri hapi portën, hyri së bashku me Fantinën dhe e mbylli portën pas, me gjithë dëshpërimin e madh të kureshtarëve, të cilët ngriheshin mbi majat e këmbëve dhe zgjatnin kokën përpara xhamit të turbullt të truprojës, duke u përpjekur që të shikonin brenda. Kureshtja është grykësi. Të shikosh, do të thotë të gllabërosh.

Si hyri në dhomë, Fantina shkoi e u plas në një qoshe, pa lëvizur dhe gojëkyçur, e mbledhur shuk si ato konet që kanë frikë.

Rreshteri i postës solli një qiri të ndezur dhe e vendosi mbi një tryezë. Zhaveri u ul, nxori nga xhepi një fletë zyrtare dhe filloi të shkruante.

Ligjet tona i kanë lënë gratë e kësaj kategorie plotësisht në dorë të policisë. Ajo bën me to si të dojë, i dënon si t'ia ketë qejfi dhe konfiskon si t'i tekjet ato dy gjërat e trishtuara që ato quajnë "mjeshtëri dhe liri e tyre". Zhaveri qëndronte i patundur;

fytyra e tij serioze nuk shprehte asnjë emocion. E megjithatë, ai ishte i preokupuar rëndë dhe thellë. Ishte një nga ato çastet kur ai ushtronte pa kontroll, por me të gjithë skrupujt e një ndërgjegjeje të rreptë pushtetin e tij të hatashëm arbitrar. Në këtë çast, ai e ndiente këtë, stoli i tij prej polici ishte një gjyq i vërtetë. Ai gjykonte. Ai gjykonte dhe dënonte. Ai përqendronte të gjitha mendimet që kishte në tru rreth kësaj gjëje të madhe që bënte. Sa më shumë e shqyrtonte çështjen e kësaj vajze, aq më tepër e ndiente veten të revoltuar. Ishte e qartë se pak më parë ai kishte parë të kryhej një krim. Ai sapo kishte parë atje në rrugë shoqërinë, të përfaqësuar nga një pronar-zgjedhës, të fyer dhe të sulmuar nga një krijesë e përdalë fare. Një grua e përdalë kishte bërë atentat kundër një borgjezi. Ai, Zhaveri, i kishte parë këto me sytë e vet. Vazhdoi të shkruante në heshtje.

Kur mbaroi së shkruari, ai vuri nënshkrimin, palosi letrën dhe i tha rreshterit të postkomandës, duke i dorëzuar dokumentin: "Merrni tre ushtarakë dhe çojeni këtë vajzë në bllok". Pastaj, duke iu kthyer Fantinës: "Ke gjashtë muaj burg."

Fatkeqja u drodh e tëra.

-Gjashtë muaj! Gjashtë muaj burg! - bërtiti ajo. - Gjashtë muaj që do të fitoj shtatë *su* në ditë! Por si do t'i vejë halli Kozetës? O vajza ime! O vajza ime e mjerë! Por unë u kam akoma borxh njëqind franga Tenardieve, zoti inspektor, a e dini ju këtë?

Ajo u hoq zvarrë mbi pllakat e lagura nga çizmet plot baltë të gjithë këtyre burrave, pa u ngritur, duke bashkuar duart, duke bërë hapa të mëdhenj me gjunjët e saj.

-Zoti Zhaver, - tha ajo, - ju kërkoj falje. Ju siguroj se nuk kam bërë asnjë gabim. Po ta kishit parë si filloi sherri, do të ishit çuditur! Ja ku po ju betohem, për atë Zot mëshirëmadh, se unë nuk pata ndonjë faj. Ishte ai zotëria borgjez, të cilin unë s'e njoh fare, që më shtiu dëborën në kurriz. A ka kush të drejtë të na shtjerë dëborë në kurriz kur kalojmë ashtu të qeta, pa i rënë më qafë njeriu? Edhe mua pastaj më hipën të miat. Jam pak si e sëmure, që thoni ju! Pastaj u bë një copë herë që hidhte turli fjalësh fyese. Jo ti je e shëmtuar! Jo ti s'paske dhëmbë! Unë e di fort mirë që nuk kam dhëmbë. Unë e shkreta s'po bëja

gjë; thosha me vete: "Ky zotëri kërkon të argëtohet e të tallet me mua." Unë isha fare në rregull, nuk po i flisja fare me gojë. Dhe pikërisht në këtë çast ai më shtiu dëborën. Zoti Zhaver, i miri zoti inspektor! A nuk ka njeri aty që i ka parë të gjitha këto me sy dhe t'ju thotë se këto që po ju kallëzoj unë janë të vërteta? Ndoshta pata faj që u zemërova. Por ju e dini që në çastet e para njeriu nuk e mban dot veten. Njeriu ka edhe ai huqet e veta. Dhe pastaj, të vijë i biri i botës dhe të të shtjerë një gjë aq të ftohtë tamam papritur e pakujtuar! Nuk bëra mirë që ia dëmtova kapelën atij zotërisë. Pse iku e u vodh ai? Unë do t'i kërkoja të falur. Oh! Zot, unë s'e kam për gjë t'i kërkoj të falur. Falmëni sot, kësaj here, zoti Zhaver. Dëgjoni këtu, ju ndoshta nuk e dini, por në burg njeriu fiton vetëm shtatë *su* në ditë, dhe, jo se e ka fajin qeveria, por shtatë *su* të shkreta fitohen, dhe merrni me mend tani që unë kam për të paguar njëqind franga. Në mos i pagofsha, do të ma kthejnë mbrapsht vogëlushen time. O Zot i madh! Nuk mund ta mbaj me vete. Kjo që bëj unë është punë e ndyrë! O Kozeta ime, o engjëllushja ime e së mirës dhe e së shenjtës virgjëreshë Mari, si do të katandiset e shkreta koteleza ime! Ja ku po jua them, ata Tenardietë janë hanxhinj, fshatarë, që nuk hanë arsye. Atyre u duhen para. Mos më futni në burg! A e kuptoni që këtu është fjala për një fëmijë të vogël që do ta nxirrnin në mes të katër rrugëve, nga sytë këmbët, në pisk të dimrit, dhe që duhet të kini mëshirë për atë copë krijesë, i miri zoti Zhaver. Po të ishte më e madhe, do të mund të fitonte një krodhe bukë, por ajo aq është e shkreta, atë moshë ka. Thellë-thellë unë nuk jam ndonjë grua e keqe. Unë nuk u katandisa në këtë shkallë as nga poshtërsia, as nga grykësia. Vërtet kam pirë raki, por nga halli dhe mjerimi kam pirë. Unë nuk e dua rakinë, por ja që ajo e shkretë ta turbullon mendjen dhe të bën të harrosh hallet e brengat. Në kohën kur isha e lumtur, veç t'i shikoje dollapet e mia, do të vije re qartë se unë nuk isha nga ato gratë pispili që bëjnë jetë të çrregullt. Unë kisha të linjta, shumë të linjta. Kini mëshirë për mua, zoti Zhaver!

Kjo fliste kësisoj, e thyer më dysh, e troshitur nga psherëtimat, e verbuar nga lotët, gushëzbuluar, duke përdredhur

duart e duke u kollitur me një kollë të thatë dhe të shkurtër, duke belbëzuar butë-butë me zërin e agonisë. Dhembja e madhe është një rreze hyjnore dhe e tmerrshme, që i shpërfytyron njerëzit e mjerë. Pikërisht në këtë çast, Fantina ishte bërë përsëri e bukur. Herë pas here ajo ndalej dhe puthte plot ëmbëlsi fundin e kapotës së hafijes. Ajo do ta kishte zbutur edhe një zemër graniti, po a zbutet një zemër druri?

-Hajde! - tha Zhaveri, - mjaft të dëgjova. Ke më gjë tjetër për të thënë? Ec tani! I ke hak të gjashtë muajt; as vetë ati i amshuar s'ka ç'të të bëjë tani.

Me këtë fjalë solemne, *as vetë ati i amshuar s'ka ç'të të bëjë tani*, ajo kuptoi se vendimi ishte dhënë. U mblodh kruspull duke murmuritur:

-Mëshirë!

Zhaveri ktheu kurrizin.

Ushtarët e kapën për krahësh.

Që prej disa minutash, një burrë kishte hyrë brenda, pa e vënë re njeri. Ai kishte mbyllur derën, kishte mbështetur shpinën pas saj dhe kishte dëgjuar lutjet e dëshpëruara të Fantinës.

Në çastin kur ushtarët vunë dorë mbi vajzën fatkeqe, e cila nuk donte të çohet në këmbë, ai bëri një hap në errësi dhe tha:

-Prisni pak, ju lutem!

Zhaveri ngriti sytë dhe njohu zotin Madëlen. Nxori kapelën dhe, duke përshëndetur si me zor dhe zemërim, tha:

-Më falni, zoti kryetar i bashkisë...

Kjo fjalë, zoti kryetar i bashkisë, bëri mbi Fantinën një efekt të çuditshëm. Ajo brofi në këmbë njëherësh e tëra si ndonjë fantazmë që del nga dheu, shtyu ushtarët me të dy krahët, eci drejt zotit Madëlen para se ta ndalonte kush dhe, duke e vështruar ngultas, me sytë e çakërdisur, bërtiti:

-Ah! Ti na paske qenë zoti kryetar!

Pastaj ia plasi të qeshurit dhe e pështyu në fytyrë.

Zoti Madëlen fshiu fytyrën dhe tha:

-Inspektor Zhaver, lëreni të lirë këtë grua.

Zhaverit iu duk sikur do të çmendej. Ai po merrte në këtë

çast goditje pas goditjeje, dhe pothuajse të përziëra tok, emocionet më të dhunshme që kishte ndier në jetën e tij. Të shihte një vajzë publike të pështynte në fytyrë një kryetar bashkie, kjo ishte një gjë aq e përbindshme, sa, në supozimet e tij më të llahtarshme, do ta kishte quajtur si një sakrilegj. Nga një anë tjetër, thellë në mendjen e tij, ai bënte turbull një afrim krahasues të lemerishëm midis faktit se ç'ishte kjo grua dhe asaj se ç'mund të ishte ky kryetar, dhe atëherë ai ajgëtonte me llahtarë nuk di se ç'gjë fare të thjeshtë në këtë atentat të hatashëm. Por kur e pa këtë kryetar, këtë funksionar, të fshinte qetë-qetë fytyrën dhe të thoshte: "Lirojeni këtë grua", atij iu verbuan sytë fare dhe shtangu në vend, iu lidhën fare edhe mendja, edhe goja; shuma e habitës së mundshme kishte tejkaluar çdo kufi. Ai mbeti i nemitur.

Por edhe Fantinës kjo fjalë nuk i kishte shkaktuar një goditje më pak të pazakontë. Ajo ngriti krahun e saj lakuriq dhe u mbërthye pas çelësit të porit, si ndonjë njeri që i merren këmbët. Ndërkohë ajo vështronte rreth vetes dhe filloi të fliste me zë të ulët, sikur po fliste me vete.

-E lirë! Lermëni të shkoj! Nuk do të bëj gjashtë muaj burg! Kush i tha këto fjalë? S'është e mundur t'i ketë thënë njeri. Do të më kenë bërë veshët. Nuk duhet të ketë qenë ai kryetari përbindësh. A mos jeni ju, o i miri zotëria im, zoti Zhaver, ai që tha të më lënë të lirë të shkoj? Oh! Dëgjoni këtu! Do t'i numëroj të tëra dhe pastaj më lini të shkoj. Ky kryetar përbindësh, ky plak matuf, ky është shkaku i të gjitha të zezave. Pa mendoni njëherë, zoti Zhaver, se ky më ka përzënë për shkak të një tufë grash rrjepacake, që përhapin thashetheme në punishte. S'ka punë më të llahtarshme se të përzësh nga puna një copë vajzë të varfër që kryen punën me nder! Kësisoj unë nuk munda të fitoja mjaft të holla dhe ja, më pllakosi fatkeqësia. Në radhë të parë, këta zotërinjtë e policisë duhet patjetër të bëjnë një përmirësim, të ndalojnë sipërmarrësit e burgjeve t'u shkelin të drejtën njerëzve të varfër. Dëgjoni, se do t'jua shpjegoj si është puna. Ti fiton dymbëdhjetë su për një këmishë, por kjo ulet e bëhet nëntë su, kështu që s'ka më se si të jetosh. Detyrohet njeriu i shkretë pastaj të bëjë si të mundet. Unë, për vete, kisha

Kozetën time të vogël dhe u detyrova të bëhesha grua e keqe. Ju e kuptoni tani që tërë të keqen ma ka bërë ky kryetari i lig. Pas kësaj, shkela me këmbë kapelën e atij zotërisë borgjez përpara kafenesë së oficerëve. Por ai, ama, ma prishi fustanin me atë dëborë që më shtiu në trup. Ne, dora jonë, kemi vetëm nga një fustan mëndafshi për mbrëmje. Dijeni se nuk kam bërë ndonjë të keqe me vetëdashje, apo s'është kështu, zoti Zhaver, dhe unë shoh gjithandej gra që janë shumë më të këqija se unë dhe që janë shumë më të lumtura. O zoti Zhaver, ju e thatë atë fjalë që të më lënë të lirë, apo jo? Merrni informata, flisni me të zotin e shtëpisë ku banoj, tani unë e paguaj qiranë, dhe ai do t'ju thotë me siguri që jam e ndershme. Ah! O Zot, ju kërkoj ndjesë, paskam prekur, pa e pasur mendjen aty, çelësin e porit dhe porit po bën tym.

Zoti Madëlen e dëgjonte me vëmendje të thellë. Ndërsa ajo fliste, ai kishte kërkuar në xhepin e jelekut, kishte nxjerrë që andej qesen dhe e kishte hapur. Por ajo paskësh qenë bosh. E kishte vënë përsëri në xhep. I tha Fantinës:

-Sa thatë se kishit borxh?

Fantina, e cila vështronte vetëm Zhaverin, u kthye nga ai:

-Të foli njeri ty?

Pastaj, duke iu drejtuar ushtarëve:

-Pa më thoni ju këtu, a e patë se si e pështyva mu në fytyrë?

Ah! Ti, zoti kryetar, je një maskara i regjur dhe vjen këtu për të më frikësuar, por unë s'kam frikë nga ti. Kam frikë nga zoti Zhaver, po. Kam frikë nga i miri zoti Zhaver!

Duke folur kështu, ajo u kthye nga inspektori.

-Për këto çështje, a më kuptoni, zoti inspektor, njeriu duhet të jetë i drejtë. Unë e kuptoj që ju jeni njeri i drejtë, zoti inspektor. Në të vërtetë, puna është fare e thjeshtë; një njeri që luan duke i vënë pak dëborë në kurriz një gruaje, kjo i bënte oficerët të qeshnin, pastaj njeriu duhet patjetër që të argëtohet me diçka, dhe ne, dora jonë, jemi në këtë botë që të argëtohen të tjerët, apo jo? Dhe pastaj vini ju, dhe ju jeni të detyruar domosdo që të vendosni rendin, e merrni gruan që ka bërë faj, por, duke e thelluar më tej punën, si njeri i mirë që jeni, thoni dhe jepni urdhër që të më lënë të lirë; është më shumë për atë

të voglën, sepse gjashtë muaj burg do të më pengonin të ushqeja fëmijën tim. Por shiko se mos e përsëritësh më, moj horruce, se të preu e zeza! Oh! S'do ta përsërit kurrë, zoti Zhaver! Sikur dhe mishin të ma presin copa-copa dhe të më bëjnë ç'të duan tani, unë s'lëviz më. Veçse sot, duhet të më kuptoni, nëse bërtita, bërtita se më dhembti shumë, nuk i prisja fare ato shuka dëbore që më shtiu ai zotëria; dhe pastaj, ju thashë, nuk jam edhe aq mirë me shëndet, kam kollë dhe këtu në stomak kam një si lëmsh që më djeg e përvëlon dhe mjeku më thotë: "Mjekohu". Ja, prekeni këtu, ma jepni dorën, mos kini frikë, këtu e kam.

Ajo nuk po qante më, zëri i saj ishte bërë përkëdhelës. Ajo mbështeste mbi gushën e saj të bardhë dhe të brishtë dorën e madhe të ashpër të Zhaverit dhe e vështronte atë duke buzëqeshur.

Befas ajo rregulloi shpejt e shpejt veshjen dhe uli cepat e fustanit, i cili, nga të ecurit zvarrë, ishte ngritur pothuajse gjer te gjuri, dhe eci drejt derës, duke u thënë me gjysmë zëri ushtarëve dhe duke u bërë atyre një shenjë miqësore me kokë.

-Djema, zoti inspektor tha që të më lënë të lirë, dhe unë po shkoj.

Ajo vuri dorën mbi rezen e derës. Dhe një hap më tutje, ajo do të ndodhej në rrugë.

Zhaveri gjer në këtë çast kishte mbetur në këmbë, pa lëvizur, me sytë të ngulur përdhe, tërthorazi në mes të kësaj skene, si ndonjë statujë që po e lëvizin dhe që pret ta vënë në ndonjë qoshe.

Zhurma që bëri rezja, e zgjoi. Ai ngriti kokën me shprehjen e një autoriteti sovran, shprehje e cila duket akoma më e frikshme kur pushtetin e marrin ca që janë më poshtë, mizore te bisha, gjakësore te njeriu pa peshë.

-Rreshter, - bërtiti ai, - a nuk po e shihni se kjo maskareshë po largohet! Kush ju tha që ta lini të shkojë?

-Unë, - tha Madëleni.

Fantina, kur dëgjoi zërin e Zhaverit, u drodh e tëra dhe e lëshoi rezen, si ai hajduti që kapet me presh në duar. Kur dëgjoi zërin e Madëlenit, ajo u kthye, dhe qysh nga ai çast, pa shqiptuar asnjë fjalë, madje pa guxuar as të merrte frymë lirisht, vështrimi

i saj u end herë nga Madëleni te Zhaveri dhe herë nga Zhaveri te Madëleni, sipas radhës kur fliste njëri ose tjetri.

Dukej sheshit se Zhaveri duhej të kishte "dalë fare nga kondaku", si i thonë fjalës, që i lejoi vetes t'i bërtiste rreshterit, ashtu siç i bërtiti, pas urdhrit të kryetarit të bashkisë për të lënë të lirë Fantinën. A mos vallë kishte arritur gjer në atë pikë sa të harronte praninë e zotit kryetar? A mos kishte arritur gjer atje sa t'i shpallte vetvetes se ishte diçka e pamundur që një "autoritet" të kishte dhënë një urdher të tillë, dhe se me siguri që zoti kryetar duhej të kishte thënë padashje një gjë për një tjetër. Apo mos vallë përpara këtyre hatarave që po shihte e dëgjonte që prej dy orësh, i thoshte vetes se duhej kthyer përsëri te vendimet supreme, se ishte e domosdoshme që i vogli të bëhej i madh, që hafija të bëhej gjykatës, që njeriu i policisë të bëhej njeri i drejtësisë, dhe se në këtë situatë të skamje rendi, ligji, morali, qeveria, e tërë shoqëria, mishëroheshin tek ai, Zhaveri?

Sidoqë të qe puna, kur zoti Madëleni tha fjalën unë, që dëgjuam pak më parë, ata që ishin aty e panë inspektorin e policisë, Zhaverin, të kthehej nga zoti kryetar, i verdhë dyllë, i ftohtë, me buzët të mavijosura, me vështrim të dëshpëruar, me tërë trupin, që i fërgëllonte nga një e dridhmë e pakuptueshme, dhe, gjë e paparë dhe e padëgjuar, t'i thoshte, me sytë përdhe, por me zë të patundur:

-Zoti kryetar, kjo është punë që s'bëhet.

-Si? - tha Madëleni.

-Kjo horre ka fyer një borgjez.

-Inspektor Zhaver, - ia pati Madëleni me një theks pajtues dhe të qetë, - dëgjoni këtu. Ju jeni njeri i ndershëm, dhe nuk e kam aspak të vështirë që të shpjegohem me ju. Ja si qëndron e vërteta. Unë po kaloja përmes sheshit në kohën kur ju po merrnit me vete këtë grua; aty kishte akoma grupe-grupe njerëzish, unë mora të dhëna, i mësova të gjitha; fajin e ka borgjezi, të cilin ju, si polic i mirë, duhej ta kishit arrestuar.

Zhaveri tha përsëri:

-Kjo maskareshë fyejti zotin kryetar të bashkisë.

-Kjo është një punë që më takon mua, - tha Madëleni. -

Fyerja është për mua, më duket, dhe unë mund të bëj si të dua vetë.

-I kërkoj ndjesë zotit kryetar. Fyerja nuk i përket atij, por i përket drejtësisë.

-Inspektor Zhaver, - ia ktheu zoti Madëlen, - drejtësia e parë është ndërgjegjja. Unë e dëgjova vetë këtë grua dhe e di se ç'duhet të bëj.

-Ndërsa unë, zoti kryetar, nuk e di se çfarë po shoh.

-Atëherë, binduni dhe kënaquni me kaq.

-Unë i bindem detyrës sime. Detyra ime kërkon që kjo grua të bëjë gjashtë muaj burg.

Zoti Madëlen u përgjigj me të butë:

-Mbani vesh mirë këtu. Nuk do të bëjë asnjë ditë.

Me të dëgjuar këtë fjalë vendimtare, Zhaveri guxoi ta vështronte kryetarin ngultas dhe i tha, por me një zë gjithmonë plot respekt të thellë:

-Më vjen shumë keq që po i kundërshtoj zotit kryetar, kjo është e para herë që po më ngjet në jetën time, por zoti kryetar le të denjojë të më lejojë t'i vë në dukje se çështja e kompetencave të mia ka vajtur atje tek s'mban më. Gjersa zoti kryetar e kërkon, unë po qëndroj vetëm në çështjen e borgjezit. Unë isha aty, dhe pashë me këta sy që kjo vajzë iu hodh zotit Bamatabua, i cili është zgjedhur dhe pronar i asaj shtëpisë së bukur me ballkon që formon qoshen e sheshit, shtëpi me tri kate dhe e ndërtuar me gurë të gdhendur. Më në fund, në këtë botë ka shumë gjëra! Sidoqoftë, zoti kryetar, kjo është një çështje policore që ndodhi në rrugë, ndaj ajo më përket mua, dhe gruan e quajtur Fantinë po e mbaj vetë.

Atëherë zoti Madëlen kryqëzoi krahët dhe tha me një zë të ashpër, që askush në qytet s'e kishte dëgjuar ndonjëherë:

-Çështja për të cilën po flisni është një çështje që ka të bëjë me policinë bashkiake. Sipas neneve nëntë, pesëmbëdhjetë e gjashtëdhjetë e gjashtë të kodit të hetuesisë penale, për këto çështje jam unë gjykatës. Urdhëroj që kjo grua të lihet e lirë.

Zhaveri deshi të bënte edhe një orvatje të fundit:

-Po, zoti kryetar...

-Dhe juve po jua kujtoj edhe një herë nenin tetëdhjetë e

një të ligjit, datë 13 dhjetor 1799, mbi burgimin arbitrar.

-Zoti kryetar, më lejoni...

-Asnjë fjalë tjetër.

-E megjithatë...

-Dilni jashtë, - tha zoti Madëlen.

Zhaveri e mori goditjen në këmbë, ballë për ballë dhe drejt e në gjoks si ushtar rus. Përshëndeti zotin kryetar dhe duke u përkulur gjer përdhe doli.

Fantina u rras te dera dhe e vështroi si e shastisur tek kaloi përpara saj.

Por edhe atë vetë e kishte pushtuar një tronditje e çuditshme. Ajo kishte parë se si u hëngrën pak më përpara për të ato dy fuqi të kundërta. Ajo kishte parë se si luftuan përpara syve të saj dy burra që kishin në duart e tyre lirinë e saj, jetën e saj, shpirtin e saj, fëmijën e saj; njëri prej këtyre burrave e tërhiqte drejt errësirës, tjetri e sillte drejt dritës. Në këtë luftë, të ajgëtuar përmes atij zmadhimi të gjërave që shkakton frika, këta dy burra i qenë dukur si dy gjigantë; njëri fliste si demon për të, tjetri si engjëlli i saj mbrojtës. Engjëlli e kishte mposhtur demonin, dhe ajo që e bënte të dridhej nga koka gjer te këmbët, ky engjëll, ky çlirues, ishte pikërisht njeriu që ajo urrente, ai kryetari të cilin ajo e kishte quajtur si autorin e të gjitha të këqijave që e kishin pllakosur, Madëleni; dhe pikërisht në çastin kur ajo sapo e kishte fyer aq keq, ai po e shpëtonte! Mos ishte gabuar vallë?... Nuk dinte ç'të mendonte dhe dridhej si purteka. Ajo mbante vesh e çakërdisur, vështronte e trembur, dhe në çdo fjalë që thoshte zoti Madëlen, ajo ndiente tek shkriheshin e shembeshin në veten e saj terret e llahtarshme të urrejtjes dhe tek i lindte në zemër nuk di çfarë ndjenje që i ngrohte zemrën, diçka e pashprehshme, që ishte gëzim, besim dhe dashuri.

Si doli Zhaveri, zoti Madëlen u kthye nga ajo dhe i tha me një zë të ngadalshëm, sepse e kishte të vështirë të fliste si njeri serioz, që e mban veten të mos qajë:

-I dëgjova ato që thatë. Nuk dija asgjë nga ato që dëgjova. Besoj se janë të vërteta dhe e ndiej që janë të vërteta. Nuk e dija aspak, madje, që ju paskëshin përzënë nga punishtet e mia.

Pse nuk m'u drejtuat mua? Por ja se si do të bëjmë: unë do t'i paguaj të gjitha borxhet që keni, fëmijën do ta sjell këtu ose do të shkoni të takoheni vetë me të. Mund të qëndroni këtu, në Paris ose ku të dëshironi. Marr përsipër fëmijën dhe ju. Nuk do të punoni fare, po të doni. Do t'ju jap të gjitha të hollat që do t'ju duhen. Do të bëheni përsëri grua e ndershme dhe e lumtur. Madje, ja ku po jua them qysh tani, dëgjoni, në qoftë se puna qëndron ashtu si thoni ju, dhe për këtë nuk dyshoj aspak, ju keni qenë pa pushim një grua e virtytshme dhe e shenjtë. Oh! E mjera grua!

Kjo ishte diçka kaq e madhe, sa e shkreta Fantinë nuk ishte në gjendje ta përballonte. Të kishte Kozetën pranë! Të dilte nga kjo jetë e turpshme! Të jetonte e lirë, e pasur, e lumtur, e ndershme me Kozetën! Të shikonte papritmas të bulonin e të çelnin në mes të mjerimit të saj të gjitha këto gjëra që përbënin një parajsë të vërtetë! Ajo e vështroi si e shastisur atë burrë që i fliste kësisoj dhe nuk mundi veçse të lëshonte dy a tri psherëtimë: Oh! Oh! Oh! Këmbët iu prenë fare, ra në gjunjë përpara zotit Madëlen, dhe, para se ai ta mbante, ai ndjeu se ajo i kapi dorën dhe buzët e saj po e puthnin atë dorë.

Pastaj asaj i ra të fikët.

Libri i gjashtë

ZHAVERI

I

Fillimi i çështjes

Zoti Madëlen urdhëroi që ta mbartnin Fantinën në infermierinë që kishte në shtëpinë e vet. Ai ua la në dorë motrave, të cilat e shtruan në shtrat. Asaj i kishte hipur një zjarrmi e madhe. E kaloi një pjesë të natës në kllapi dhe duke folur me zë të lartë. Por, më në fund, e mposhti gjumi.

Të nesërmen, aty afër mesditës, Fantina u zgjua, dëgjoi një frymëmarrje fare afër shtratit të saj, largoi perden dhe pa zotin Madëlen në këmbë.

Zoti Madëlen ishte shpërfytyruar tanimë në sytë e Fantinës. Asaj i dukej sikur ai ishte mbështjellë me dritë dhe ishte zhytur në njëfarë lutjeje. Ajo e soditi kështu për një kohë të gjatë, pa guxuar ta ndërpriste. Më në fund, ajo i tha si me druajtje:

-Ç'po bëni ashtu?

Zoti Madëlen kishte një orë që po qëndronte në këtë vend. Ai po priste që të zgjohej Fantina. I mori dorën, i preku pulsën dhe u përgjigj:

-Si jeni?

-Mirë, kam fjetur, - tha ajo, - më duket sikur jam më mirë. Nuk do të jetë gjë.

Gjithë natën dhe gjithë mëngjesin e asaj dite, zoti Madëlen e kishte kaluar duke mbledhur të dhëna. Tani ai i dinte të gjitha. Ai e dinte me të gjitha hollësitë e dhimbshme historinë e Fantinës. Ai vazhdoi:

-Keni vuajtur shumë, o nënë e shkretë...

Ai psherëtiu thellë. Ndërkohë ajo po i buzëqeshte me atë buzëqeshjen e madhërishtme, së cilës i mungonin dy dhëmbë.

Zhaveri, po asaj nate, kishte shkruar një letër. Ai e dorëzoi vetë atë të nesërmen në mëngjes në zyrën e postës së Montrëj-syr-Merit. Ishte për në Paris dhe mbante këtë mbishkrim: *Zotit Shabujet, sekretar i zotit prefekt të policisë*. Meqenëse çështja e komandës së policisë kishte marrë dhenë, drejtoresha e zyrës së postës dhe disa veta të tjerë që e panë letrën përpara se të nisej dhe që e njohën shkrimin e Zhaverit në adresë, menduan se ai kishte paraqitur e përcjellë dorëheqjen e vet.

Zoti Madëlen u shkroi pa humbur kohë Tenardieve. Fantina u detyrohej atyre njëqind e njëzet franga. Ai u dërgoi treqind franga, duke u thënë që nga ajo shumë të mbanin sa u takonte dhe të sillnin menjëherë fëmijën në Montrëj-syr-Mer, ku po e priste e ëma e sëmurë.

Kjo ia mori mendtë fare Tenardiesë. "Dreq, - i tha ai së shoqes, - nuk duhet ta lëshojmë këtë fëmijë. Kjo rebeckë e hajthme do të na bëhet lopë race. I kam rënë pikës unë. Ndonjë torollak do të ketë rënë në dashuri me t'ëmën."

Ai ktheu përgjigje me një përkujtesë të hartuar fort bukur për një shumë pesëqind e ca frangash. Në këtë përkujtesë figuronin dy fatura të pakundërshtueshme prej më shumë se treqind frangash, njëra e lëshuar nga një mjek dhe tjetra nga një farmacist, të cilat kishin mjekuar dhe kuruar Eponinën dhe Azelmën. Kozeta, siç e kemi thënë, nuk kishte qenë e sëmurë. Puna qëndronte te një zëvendësim i vogël emrash. Tenardieja shënoi në fund të përkujtesës: "Marrë paradhënie treqind franga".

Zoti Madëlen dërgoi menjëherë treqind franga të tjera dhe shkroi: "Dërgoni sa më parë Kozetën."

-Për gjak të Krishtit! - tha Tenardieja, - s'duhet lëshuar fëmija.

Ndërkohë Fantina nuk po e merrte aspak veten. Ajo ndodhej gjithmonë në infermieri.

Motrat infermiere në fillim e kishin pritur dhe mjekuar "atë vajzë" me shumë neveri. Kush i ka parë basorelievet e Remsit, sjell ndër mend përfryrjen e buzës së poshtme të virgjëreshave të urta tek vështrojnë virgjëreshat e çmendura. Kjo përbuzje e lashtë e vestaleve për gratë kurtizane është një nga instinktët më të thella të dinjitetit femëror; këtë gjë kishin përndier edhe motrat, por të dyfishuar për shkak të ndjenjave të tyre fetare. Por brenda pak ditëve Fantina i kishte çarmatosur ato. Ajo thoshte gjithfarë fjalësh të përvuajtura dhe të ëmbla, dhe ndjenjat prej nëne që shprehte ua zbutnin zemrën të tjerëve. Një ditë prej ditësh, motrat e dëgjuan tek po fliste nëpër ethe: "Kam qenë mëkatore, por, kur të kem fëmijën pranë, kjo do të thotë se Zoti m'i ka falur fajet. Kur kisha rënë aq poshtë, nuk doja që ta kisha Kozetën time pranë, nuk do të kisha mundur t'i duroja dot ata sytë e saj të habitur dhe të trishtuar. E megjithatë, unë për atë bija aq poshtë dhe për këtë arsye Zoti m'i fal mëkatet. Unë do ta ndiej bekimin e Zotit mëshirëmadh kur të vijë Kozeta këtu. Do ta vështroj dhe do të më bëjë mirë kur ta shoh me sy atë krijesë të pafajshme. Ajo s'di asgjë. Ajo është engjëll, o motrat e mia. Në moshën e saj, flatrat engjëjllore nuk kanë rënë akoma.

Zoti Madëlen shkonte e shikonte dy herë në ditë, dhe çdo herë ajo e pyeste:

-A do ta shoh së shpejti Kozetën time?

Ai i përgjigjej:

-Ndoshta nesër në mëngjes. Duhet të arrijë nga çasti në çast, po e pres.

Dhe fytyra e zbehtë e nënës lëshonte rreze drite.

-Oh! - thoshte ajo, - sa e lumtur që do të jem!

Thamë më lart se ajo nuk po e merrte veten. Përkundrazi, gjendja e saj po rëndohej nga java në javë. Ai shuk dëbore i rrasur mbi lëkurën midis dy shpatullave kishte zhdukur papritur djersitien, dhe sëmundja, që kllçoiste qysh prej shumë

vjetësh, erdhi e shpërtheu me furi. Asokohe kishin filluar të ndiqnin, për studimin dhe mjekimin e sëmundjeve të krahavorit, udhëzimet e bukura të Lënekut. Mjeku e kontrolloi Fantinën dhe tundi kokën.

Zoti Madëlen i tha mjekut:

-Eh, pra?

-Mos ka ndonjë fëmijë që dëshiron ta shohë? - tha mjeku.

-Po.

-Eh, pra, mos mënoni ta sillni sa më shpejt.

Zotit Madëlen iu drodh i tërë trupi.

Fantina e pyeti:

-Çfarë tha mjeku?

Zoti Madëlen u përpoq të buzëqeshte.

-Tha që të sjellim fëmijën. Kjo do t'ju shërojë dhe do t'ju sjellë shëndet të plotë.

-Oh! - vazhdoi ajo, - ai ka të drejtë! Por ç'kanë vallë këta Tenardietë që po ma mbajnë akoma Kozetën time! Oh! Do të vijë. Ja, më në fund, tek po e shoh lumturinë fare afër meje!

Ndërkohë Tenardieja nuk "e lëshonte fëmijën" dhe nxirrte njëqind sebepe të këqija. Jo Kozeta ishte pak si pa qejf dhe nuk mernte dot udhën në mes të dimrit, jo kishin mbetur edhe disa borxhe të vogla e të ngutshme aty në fshat dhe po mblidhte faturat përkatëse etj., etj.

-Do të dërgoj njeri të vejë e ta marrë Kozetën, - tha xha Madëleni. - Po e deshi puna, do të vete vetë.

Ai shkroi, nën diktatin e Fantinës, letrën e mëposhtme, të cilën ia dha ta nënshkruante:

Zoti Tenardie,

Dorëzohani Kozetën prurësit të kësaj letre.

Do t'ju paguhen në dorë të gjitha borxhet e vogla.

Kam nderin t'ju përshëndet me respekt

FANTINA

Në këto e sipër, ngjau një ndodhi e rëndë. Më kot mundohemi të gdhendim sa më mirë që mundim bllokun

misterioz nga i cili është ngjizur jeta jonë, damari i zi i fatit rishfaqet gjithmonë.

II

Si mund të bëhet Zhani Sham

Një mëngjes zoti Madëlen ishte në zyrën e vet dhe po merrej me rregullimin e disa çështjeve të ngutshme të bashkisë, që t'i linte gati në rast se do t'i mbushej mendja të bënte udhëtimin për në Monfermej, kur erdhën dhe i thanë se inspektori i policisë, Zhaveri, kërkonte të bisedonte me të. Kur dëgjoji këtë emër, zoti Madëlen nuk u përmbajt dot pa shprehur atë përshtypje të pakëndshme që ndjeu. Qysh nga ngjarja në zyrën e policisë, Zhaveri ishte munduar t'i shmangej më shumë se kurdoherë tjetër, kështu që zoti Madëlen nuk e kishte parë më.

-Le të hyjë, - tha ai.

Zhaveri hyri.

Zoti Madëlen kishte qëndruar ulur pranë oxhakut, me penën në dorë dhe sytë mbi një dosje, që po e shfletonte dhe po e mbushte me shënime. Kjo dosje mbante procesverbale kundërvajtjesh të policisë rrugore. As që lëvizi fare kur hyri Zhaveri. Nuk mund të mos i shkonte mendja tek e shkreta Fantinë, prandaj i vinte vetvetiu të qëndronte i ftohtë akull.

Zhaveri e përshëndeti plot respekt zotin kryetar, i cili i kishte kthyer shpinën. Zoti kryetar nuk ia hodhi fare sytë dhe vazhdoi të bënte shënime në dosjen që kishte përpara.

Zhaveri bëri nja dy-tre hapa në zyrë dhe u ndal pa prishur qetësinë.

Ndonjë fizionomist që do ta kishte njohur nga afër natyrën e Zhaverit, që do të kishte studiuar qysh prej kohësh këtë njeri të egër në shërbim të qytetërimit, këtë sajim të çuditshëm të romakut, të spartanit, të murgut dhe të rreshterit, këtë spiun, që nuk dinte ç'ishte gënjeshtër, këtë hafije virgjërore, ndonjë

fizionomist që do ta kishte ditur urrejtjen e tij të vjetër për zotin Madëlen, konfliktin e tij me kryetarin për çështjen e Fantinës, dhe që do ta kishte vëzhguar Zhaverin në këtë çast, do të kishte thënë me vete: "Çfarë do t'i ketë ngjarë vallë kështu?" Për atë që do ta kishte njohur këtë ndërgjegje të drejtë, të qartë, të sinqertë, të çiltër, të ashpër dhe gjakatare, ishte fare e qartë se Zhaveri po dilte nga ndonjë tronditje e brendshme e madhe. Zhaverit ç'kishte në shpirt i dilte mbi fytyrë. Ashtu si të gjithë njerëzit e dhunshëm, ai bënte kthesa të papritura. Kurrë fizionomia e tij nuk kishte qenë aq e çuditshme dhe aq e papritshme. Kur hyri, ai u përkul përpara zotit Madëlen, me një vështrim ku nuk kishte as mllaf, as zemërim, as mosbesim; ai ishte ndalur disa hapa prapa kolltukut të kryetarit të bashkisë; dhe tani ai qëndronte aty, në këmbë, me një qëndrim pothuajse disiplinor, me atë ashpërsinë naive dhe të ftohtë të një njeriu që s'di se ç'është butësia, të një njeriu që ka qenë gjithmonë i duruar; ai po priste, pa thënë asnjë fjalë, pa bërë asnjë lëvizje, me një përlësi të vërtetë dhe me një bindje të qetë, pa u bërë merak nëse zoti kryetar do të kthehej apo jo; qëndronte i qetë, serioz, me kapelë në dorë, me sytë përdhe, me një shprehje që ishte midis asaj të ushtarit përpara oficerit të vet dhe fajtorit përpara gjykatësit të vet. Ishin zhdukur të gjitha ndjenjat, ashtu si edhe të gjitha kujtimet që mund të të thoshte mendja se i përjetonte. Nuk kishte më asgjë tjetër në këtë fytyrë të papërshtueshme dhe të thjeshtë si graniti përveç një trishtimi të zymtë. E tërë qenia e tij diaste përlëjen dhe qëndresën dhe një nuk di çfarë pikëllimi plot kurajë.

Më në fund zoti kryetar la penën dhe u kthye përgjysmë:

-Epo, ç'kemi? Si është puna, Zhaver?

Zhaveri qëndroi një hop i heshtur, sikur donte të mblidhte veten, pastaj ngriti zërin me njëfarë solemniteti të trishtuar, i cili, megjithatë, ishte njëkohësisht edhe i thjeshtë.

-Është puna, zoti kryetar, për një faj që është kryer.

-Çfarë faji?

-Një agjent i ulët i autoritetit ka shkelur rëndë respektin ndaj një funksionari. Unë erdha këtu, ashtu siç e kam për detyrë, t'jua bëj të njohur veprimin në fjalë.

-Dhe kush është ai agjent? - pyeti zoti Madëlen.

-Unë, - tha Zhaveri.

-Ju?

-Unë.

-Dhe kush na qenka funksionari që mund të ankohej ndaj agjentit?

-Ju, zoti kryetar.

Zoti Madëlen brofi nga kolltuku. Zhaveri vazhdoi me një pamje të rreptë dhe me sytë gjithmonë përdhë.

-Zoti kryetar, erdha t'ju lutem të kini mirësinë që të provokoni pranë autoritetit përkatës shkarkimin tim nga detyra.

Zoti Madëlen, i habitur, hapi gojën. Zhaveri e ndërpreu.

-Ju do të thoni se unë mund të jepja dorëheqjen, por kjo nuk është e mjaftueshme. Të japësh dorëheqjen, është punë e nderuar. Unë kam gabuar, prandaj duhet të dënohem. Duhet të pushohem nga puna.

Dhe, pas një pushimi, ai shtoi:

-Zoti kryetar, atë ditë ju u sollët shumë ashpër ndaj meje, pa të drejtë. Silluni sot po ashtu, por me të drejtë.

-Pa dale njëherë! Pse? - bërtiti zoti Madëlen. - Ç'janë këto fjalë pa krye kështu? Ç'do të thotë kjo? Ku qëndron në këtë mes faji i bërë kundër meje nga ana juaj? Çfarë më keni bërë. Çfarë keni bërë kundër meje? Ju po e akuzoni vetë veten tuaj dhe kërkoni që të zëvendësoheni...

-Të pushohem, - tha Zhaveri.

-Të pushoheni, ashtu qoftë. Fort mirë. Por unë nuk po kuptoj asgjë në këtë mes.

-Do ta kuptoni, zoti kryetar.

Zhaveri psherëtiu një herë nga thellësia e krahavorit dhe, vazhdoi përsëri po me atë mënyrë të ftohtë dhe të trishtuar.

-Zoti kryetar i bashkisë, gjashtë javë të shkuara, pas asaj skenës për shkak të asaj vajzës, isha bërë si i tërbuar dhe ju denoncova.

-Më denoncuat!

-Në prefekturën e policisë të Parisit.

Zoti Madëlen, i cili nuk qeshte kurrë më shumë se Zhaveri, filloi të qeshte.

-Si kryetar bashkie që ka marrë nëpër këmbë policinë?

-Si ish-i dënuar me burgim dhe punë të rënda.

Kryetari i bashkisë u zverdh në fytyrë.

Zhaveri, i cili s'i kishte ngritur fare sytë, vazhdoi:

-Kështu më ishte mbushur mendja. Kishte kohë që po bluaja me mendje. Njëfarë përngjashmërie, disa informata që çuat e mblodhët në Faverolë, forca e belit tuaj, aventura e plakut Foshëlëvan, shkathtësia juaj në qitje me pushkë, ajo këmba juaj që shqepon pakëz, e ku di unë se çfarë budallallëqe! Më në fund, unë ju merrja për një të quajtur Zhan Valzhan.

-Një të quajtur?... Si e thatë atë emrin ashtu?

-Zhan Valzhan. Ky është një i dënuar me punë të rënda, që e kam parë këtu e njëzet vjet të shkuar, kur isha ndihmësgardian në Tulon. Si doli nga burgu, ky Zhan Valzhani, mesa duket, kishte vjedhur në shtëpinë e një ipeshkvi, pastaj na paskësh kryer edhe një vjedhje tjetër me dhunë, në një udhë publike, ndaj një savojasi të vogël. Që prej tetë vjetësh, ai kishte mundur të fshihej nuk dihet sesi, dhe policia e kërkonte. Nuk më shkante mendja... - Fundi, unë e bëra këtë gjë! E bëra nga inati, ju denoncova në prefekturë.

Zoti Madëlen, i cili e kishte marrë përsëri në dorë dosjen qysh prej disa çastesh, ia filloi përsëri me një theks që s'kishte si bëhej më mospërfillës:

-E ç'përgjigje ju kthyen?

-Më thanë se isha çmendur.

-Atëherë?

-Eh, pra, ata kishin të drejtë.

-Sa mirë që e pranoni këtë!

-Domosdo, gjersa Zhan Valzhani i vërtetë është gjetur.

Fleta që mbante zoti Madëlen i shpëtoi nga duart, ai ngriti kokën, vështroi ngultas Zhaverin dhe tha me një theks që nuk mund të shprehet me fjalë:

-Ah!

Zhaveri vazhdoi:

-Ja si qëndron puna, zoti kryetar. Duket se na paskësh qenë

në krahinë, andej nga ana e Aji-lë-Ho-Kloshit, njëfarë burri që na quhej xha Shamatjë. Ai ishte shumë i mjerë. As ia varte njeri torbën. Këta lloj njerëzish nuk dihet se si e me se jetojnë. Kohët e fundit, këtë vjeshtë, Xha Shamatjëi u arrestua për një vjedhje mollësh për musht... Por, s'ka rëndësi! U konstatua se ai kishte vjedhur, kishte kapërcyer murin dhe kishte thyer disa degë të mollës. Kështu, na e arrestuan Shamatjëin tonë. Na e zunë me degë në dorë dhe na e mbërthyen qerratanë. Gjer këtu çështja mbetet në shkallën e një mase korrektimi. Por fati ndërhyri ndryshe. Duke qenë se qela e burgut ishte në gjendje të keqe, zoti gjykatës hetues e gjeti me vend që ta transferonte Shamatjëin në Arras, ku ndodhet burgu i qarkut. Në burgun e Arrasit na u ndodhka edhe një i dënuar me punë të rënda i quajtur Brëvet, që është burgosur nuk e di përse dhe që, për shkak se sillet mirë, e kanë caktuar si sportelist të dhomës. Zoti kryetar, Shamatjëi ynë nuk kishte arritur mirë në burg, kur Brëveti bërtet me të madhe: "More! Por unë e njoh këtë burrë. Ky është një hapsanik. Pa më shih një herë në sy, more burri i dheut! Ju qenkeni Zhan Valzhani!" "Zhan Valzhani! Ç'është ky Zhan Valzhan?" Shamatjëi shtiret sikur habitet. "Hajde, hajde, mos na u hiq si guak", - thotë Brëveti. "Ti je Zhan Valzhani, dora vetë! Ti ke qenë në kampin e punëve të rënda të Tulonit. Para njëzet vjetësh kemi qenë atje të dy së bashku". Shamatjëi mohon. Besa besën! Ju e kuptoni. Organet kompetente i hyjnë punës për ta thelluar çështjen. Fillojnë dhe e gërmojnë këtë ngjarje. Dhe ja se çfarë gjejnë: ky Shamatjëi na paskësh qenë këtu e nja tridhjetë vjet të shkuar punëtor krasitësh pemësh në shumë fshatra, sidomos në Favërolë. Këtu gjurmët e njeriut tonë humbasin. Shumë kohë më pas, ai duket në Orvenjë, pastaj na del në Paris, ku thotë se na paska qenë qerraxhi dhe na paska pasur një vajzë që punonte si rrobalarëse, por të gjitha këto nuk janë provuar me fakte; më në fund, na del në këtë fshat. Por, para se të shkante në kampin e punëve të rënda për vjedhje të stërholluar, çfarë ishte Zhan Valzhani? Krasitës pemësh. Ku? Në Favërolë. Tjetër fakt. Ky Valzhani na quhej sipas emrit të pagëzimit Zhan dhe e ëma na quhej nga i ati Matjë. A ka gjë më të natyrshme që të mendosh se ai, kur doli nga burgu, do të

ketë marrë emrin e s'ëmës për të fshehur gjurmët dhe do të jetë quajtur Zhan Matjë? Ai vetë në Orvenjë. Emrin Zhan fshatarët e këtyre anëve e shqiptojnë Shan, pra atë e quajnë Shan Matjë. Burri i botës nuk bën asnjë kundërshtim dhe ja tek shndërrohet në Shamatjë. Po më dëgjoni, apo jo? Informohen organet përkatëse në Favërolë. Familja e Zhan Valzhanit nuk gjendet më aty. Dhe nuk dihet se ku ndodhet. Siç e dini, në këto shtresa shoqërore ndodhin shpesh firasje të një familjeje të tërë. Kërkojnë andej e kërkojnë këtej, por nuk gjejnë më asgjë. Këta lloj njerëzish, kur nuk janë baltë, janë pluhur. Dhe pastaj, meqë fillimi i këtyre historive është që prej tridhjetë vjet përpara, nuk ka mbetur më njeri që ta ketë njohur Zhan Valzhanin. Merren informata në Tulon. Së bashku me Brëvetin, vetëm dy të burgosur të tjerë e kishin parë Zhan Valzhanin me sy. Këta janë të dënuarit me burgim të përjetshëm Koshëpajë dhe Shenildjë. I nxjerrin nga burgu dhe i sjellin. I ballafaqojnë me të pandehurin Shamatjë. Ata nuk ngurrojnë aspak. Për ta, ashtu si edhe për Brëvetin, ai është Zhan Valzhani, dora vetë. Po ajo moshë, pesëdhjetë e katër vjeç, po ai shtat, po ajo pamje, me një fjalë, ai është dora vetë dhe s'e luan topi. Pikërisht në këtë kohë unë dërgoja denoncimin tim në prefekturën e Parisit. Më përgjigjen se më paskan lënë mendtë fare dhe se Zhan Valzhani është në Arras në duart e drejtësisë. Ju e merrni me mend mirë se sa më ka habitur kjo punë, mua, që besoja se e kisha mbërthyer këtu Zhan Valzhanin! I shkruaj zotit hetues. Ai më urdhëron të vete në vend dhe më sjellin përpara Shamatjëin në fjalë...

-Eh, pra? - e ndërpreu zoti Madëlen.

Zhaveri u përgjigj me atë fytyrën e tij të pakorruptueshme dhe të trishtuar:

-Zoti kryetar, e vërteta është e vërtetë. Më vjen keq, por ai burri në fjalë është vetë Zhan Valzhani. Dhe unë vetë e njoha.

Zoti Madëlen vazhdoi me zë shumë të ulët:

-Jeni i sigurt?

Zhaveri filloi të qeshte me atë të qeshur plot dhembje, që shpërthen nga një besim i thellë:

-Oh, i sigurt që ç'ke me të!

Ai qëndroi për një çast i menduar, duke marrë mekanikisht me majë të gishtave nga pak pluhur druri për të tharë bojën e shkrimit në kutinë që ndodhej mbi tryezë, dhe shtoi:

-Madje, tani që pashë me sytë e mi Zhan Valzhanin e vërtetë, nuk po e marr vesh se si munda të besoja diçka tjetër. Ju kërkoj ndjesë, zoti kryetar.

Duke i drejtuar këto fjalë lutëse dhe të rënda atij, që gjashtë javë më parë e kishte poshtëruar mu në mes të trupërojës dhe i kishte thënë: "Dilni jashtë"! Zhaveri, ky njeri kryelartë, ishte, pa e ditur as vetë, plot thjeshtësi dhe dinjitet. Zoti Madëlen iu përgjigj lutjes së tij me këtë pyetje të befasishme:

-Dhe çfarë thotë ky njeri?

-Ah, për besë! Zoti kryetar, puna është e ngatërruar. Po të jetë Zhan Valzhani, kemi të bëjmë me një faj përsëritës. Kur një fëmijë kapërcen një mur, thyen një degë dhe vjedh mollë, kësaj i thonë punë sherreti; kur këtë e bën një burrë i pjekur, i thonë delikt; po e bëri një i dënuar me punë të rënda, i thonë krim. Kapërcim muri dhe vjedhje, të gjitha janë brenda. Këtu nuk hyn më policia korrektuese, por gjykata vetë. Nuk është më fjala për disa ditë burgim, por për punë të detyrueshme përjetë. Pastaj, është edhe çështja e atij savojasit, e cila, kam shumë shpresë, do të dalë mbi ujë. Për besë! Pisk e ka punën, apo jo? Po të qe ndonjë tjetër, po, por jo Zhan Valzhani. Zhan Valzhani është dhelpër e regjur. Dhe pikërisht kjo gjë më bind që është vërtet ai. Po të ishte ndonjë tjetër, do ta ndiente se puna po nxehej dhe do të përpëlitej, do të bërtiste me të madhe, se çajniku këndon kur është vënë në zjarr, do ta pranonte që është Zhan Valzhani etj., etj. Kurse ai, ai shtiret sikur nuk kupton asgjë dhe thotë: "Unë jam Shamatjëi dhe nuk luaj asnjë gisht nga kjo!" Ka një pamje si të habitur, hiqet si hajvan, dhe kjo është shumë e hollë. Oh! Është i shkathët, shejtani. Por s'ka asnjë rëndësi, provat janë sheshit. Atë e kanë njohur katër veta, dhe horri plak do të dënohet patjetër. Çështja ka vajtur në gjykatën e qarkut, në Arras. Do të vete atje si dëshmitar. Jam caktuar nga trupi gjykues.

Zoti Madëlen kishte filluar përsëri të merrej me shkresat zyrtare, kishte kapur përsëri dosjen dhe po e shfletonte i qetë,

herë duke lexuar, herë duke shkruar, si njeri që s'e presin punët. U kthye nga Zhaveri dhe i tha:

-Mjaft, Zhaver. Në të vërtetë, të gjitha këto hollësi më interesojnë fort pak. Po humbasim kohën kot, dhe kemi çështje të ngutshme. Zhaver, do të shkoni menjëherë tek ajo gruaja e mirë që quhet Bysopie dhe që shet barishte atje poshtë, te qoshja e rrugës "Sen-Solve". Do t'i thoni që ta paraqitë ankesën e saj kundër karrocierit Pjer Shenëlong. Ai është njeri brutal, që mend shtypi edhe gruan, edhe të birin. Duhet të dënohet. Do të shkoni pastaj te zoti Sharsëlej, në rrugën "Montrë-dë-Shampinji". Ai ankohet se një ulluk nga një shtëpi fqinje derdhka ujët e shiut mbi shtëpinë e tij dhe i gërryen themelet e shtëpisë. Pastaj do të konstatooni disa kundërvajtje policore, që më kanë njoftuar në rrugën "Giburg" te vejusha Doris, dhe në rrugën "Garro-Blan" te zonja Rëne Lë Bose, dhe do të hartoni procesverbalet përkatëse. Por po ju ngarkojmë shumë punëra kështu. Ju do të mungoni për disa kohë, apo jo? A nuk thatë se do të shkonit në Arras pas tetë ose dhjetë ditësh për atë çështjen?...

-Më shpejt, zoti kryetar.

-Po kur, pra?

-Por më duket se i thashë zotit kryetar se çështja do të gjykohet nesër dhe se do të nisesha me karrocën e postës të mbrëmjes.

Zoti Madëlen bëri një lëvizje të pakapshme.

-Dhe sa kohë do të vazhdojë çështja?

-Të shumtën një ditë. Vendimi do të jepet nesër, natën.

Por unë nuk do ta pres vendimin, i cili do të merret patjetër. Me të paraqitur dëshminë time, do të kthehem përsëri këtu.

-Mirë, - tha zoti Madëlen.

Dhe i bëri shenjë me dorë që të largohej.

Zhaveri nuk u largua.

-Më falni, zoti kryetar, - tha ai.

-Ç'keni akoma? - pyeti zoti Madëlen.

-Zoti kryetar, më mbetet edhe diçka që duhet t'ju kujtoj.

-Çfarë?

-Është puna se unë duhet të shkarkohem nga detyra.

Zoti Madëlen u çua në këmbë.

-Zhaver, ju jeni një burrë i ndershëm dhe ju çmoj si të tillë. Ju po e zmadhoni tepër gabimin tuaj. Veç kësaj, kjo është një fyerje që më përket mua. Zhaver, ju meritoni të ngriheni në përgjegjësi dhe jo të uleni. Unë jam i mendimit që ju ta mbani vendin tuaj.

Zhaveri e vështroi zotin Madëlen me atë bebëzën e çiltër, në fund të së cilës dukej sikur shikoje atë ndërgjegje pak të ndriçuar, por të paepur dhe të papërlyer, dhe tha me një zë të qetë:

-Zoti kryetar, unë nuk mund të jem në një mendje me ju.

-Po jua përsërit, - ia ktheu zoti Madëlen, - se kjo çështje më përket vetëm mua.

Por Zhaveri, i cili i vinte rëndësi vetëm mendimit të vet, vazhdoi:

-Sa për atë që thoni se unë i zmadhoj tepër gjërat, nuk i zmadhoj aspak. Ja se si arsyetoj unë. Kam dyshuar për ju pa të drejtë. Kjo nuk është asgjë. Është e drejta jonë, e njerëzve të dorës sonë, që të dyshojmë, megjithëse është shpërdorim të dyshosh për ata që ke eprorë. Por, duke mos pasur as prova, në zemërim e sipër, me qëllim që të hakmerresha, ju kam denoncuar si të burgosur me punë të rënda, ju, që jeni njeri i respektueshëm, kryetar bashkie, funksionar! Kjo është e rëndë. Shumë e rëndë. Unë kam fyer autoritetin në personin tuaj, unë, agjenti i autoritetit! Sikur ndonjë nga vartësit e mi të kishte bërë atë që kam bërë unë, do ta kisha deklaruar të padenjë për shërbim dhe do ta kisha pushuar në vend. Eh, pra? Dëgjoni, zoti kryetar, akoma edhe një fjalë. Shpesh kam qenë i rreptë në jetën time. Për të tjerët. Kjo ishte një gjë e drejtë. Bëja mirë. Tani, po të mos jem i rreptë për veten time, çdo gjë e drejtë që kam bërë do të shndërrohet në të padrejtë. A duhet ta kursej veten time më shumë se të tjerët? Jo. Pse unë qenkam vetëm për të ndëshkuar të tjerët, kurse veten time jo? Por atëherë unë do të isha një njeri i ulët! Atëherë ata që thonë: "Ky Zhaveri qenka horr"! do të kishin të drejtë! Zoti kryetar, unë nuk lut që ju të më trajtoni me dashamirësi, mirësia juaj ma ka prishur shumë gjakun kur ka qenë për të tjerët. Nuk e dua një mirësi të

tillë për veten time. Atë mirësi që i jep të drejtë gruas publike t'i vërsulet borgjezit, agjentit të policisë t'i turret kryetarit të bashkisë, atij që është poshtë të ngrihet kundër atij që është lart, atë mirësi unë e quaj mirësi të keqe. Sepse pikërisht me këtë lloj mirësie çorganizohet shoqëria. Për besë! Është punë e lehtë të jesh i mirë, por është e vështirë të jesh i drejtë. Ja kështu! Sikur ju të kishit qenë ai që besoja unë, unë nuk do të isha aspak i mirë për ju, unë! Do ta shihnit edhe ju vetë! Zoti kryetar unë duhet ta trajtoj veten time ashtu siç do të trajtoja cilindro tjetër: Kur shtypja keqbërësit, kur i dëmtoja horrat, thosha shpesh me veten time: "Dëgjo këtu, po u përkule ti, po të kapa në gabim, do të ta ndreq samarin si duhet!" Unë u përkula, e kapa veten në gabim, mirë të më bëhet tani! Ja kështu, ju duhet të më përzhini, të më shkarkoni, të më mërgoni! Kështu duhet bërë. Krahët shëndoshë, do të punoj tokën, aq më bën mua. Zoti kryetar, e mira e shërbimit kërkon një shembull. Unë kërkoj thjesht shkarkimin nga detyra të inspektor Zhaverit.

Të gjitha këto fjalë ishin shqiptuar me një theks të përvuajtur, krenar, të dëshpëruar dhe të bindur, që i jepte nuk di çfarë pamje të pazakontë këtij burri të çuditshëm dhe të ndershëm.

-Do ta shohim këtë punë, - ia bëri zoti Madëlen.

Dhe i zgjati dorën.

Zhaveri u zmbraps dhe tha me një ton të rëndë:

-Më falni, zoti kryetar, por kjo nuk duhet të ndodhë. Një kryetar bashkie nuk ia jep dorën një hafijeje.

Dhe shtoi si nëpër dhëmbë:

-Po, hafije, përderisa unë e shpërdorova policinë, tani nuk jam veçse një hafije.

Pastaj ai përsëndeti, duke u përkulur thellë, dhe bëri për nga dera.

Atje u rrotullua dhe me sytë gjithmonë përdhe foli:

-Zoti kryetar i bashkisë, do ta vazhdoj shërbimin gjer në çastin kur të zëvendësohem.

Ai doli. Zoti Madëlen mbeti si i zhytur në ëndërritje, duke mbajtur vesh atë hap të vendosur dhe të sigurt që po largohej mbi pllakat e korridorit.

Libri i shtatë

ÇËSHTJA SHAMATJË

I

Mendjemprehtësia e usta Skoflerit

Nga bashkia zoti Madëlen shkoi në skaj të qytetit, te një flamand, tek usta Skofleri, i cili lëshonte me qira kuaj dhe "karroca sipas dëshirës".

Për të vajtur te ky Skofleri, më shkurt i binte të merrje një rrugë që shkelej pak, andej nga qela e famullisë, ku banonte zoti Madëlen. Famullitari ishte, siç thoshin, një burrë i denjë dhe i respektueshëm, që jepte edhe këshilla të mira. Në çastin kur zoti Madëlen arriti përpara qelës, në rrugë kishte vetëm një kalimtar, dhe ky kalimtar vuri re këto gjëra: zoti kryetar, si e kaloi banesën famullitare, u ndal, qëndroi në vend pa lëvizur, pastaj u kthye prapa dhe bëri për nga dera e qelës, një deriçkë me një trokëllitës prej hekuri. Ai vuri dorën me gjallëri mbi trokëllitësin dhe e ngriti; pastaj u ndal përsëri dhe qëndroi si i ngrirë dhe si i menduar, dhe, pas disa sekondash, në vend që ta linte të binte plot zhurmë trokëllitësin, ai e uli ngadalë dhe mori përsëri udhën me njëfarë ngutjeje që nuk e pati përpara.

Zoti Madëlen e gjeti usta Skoflerin në shtëpi të vet tek po ndreqte disa pajime kuajsh.

-Usta Skofler, - pyeti ai, - a keni ndonjë kalë të mirë?

-Zoti kryetar, - tha flamandi, - të gjithë kuajt të mirë i kam

unë. Ç'doni të thoni me këtë fjalë: "Një kalë të mirë"?
-E kam fjalën për ndonjë kalë që të bëjë njëzet lega në një ditë.

-Dreq o punë! - tha flamandi, - njëzet lega!

-Po.

-Të mbrehur në një kabrioletë?

-Po.

-Dhe sa kohë do të çlodhet ai pas vrapit?

-Po të jetë nevoja, duhet që të niset të nesërmen..

-Dhe duhet të bëjë përsëri të njëjtën rrugë?

-Po.

-Dreq o dreq! Dhe janë plot njëzet lega?

Zoti Madëlen nxori nga xhepi një copë letër ku kishte shkarravitur me laps disa shifra dhe ia tregoi flamandit. Ishin shifrat 5, 6, 8½.

-Ja shikojeni, - tha ai. - Shuma, nëntëmbëdhjetë e gjysmë, të themi rrumbullak njëzet lega.

-Zoti kryetar, - vazhdoi flamandi, - do ta rregullojmë edhe punën tuaj. Kam atë kalin e vogël, të bardhin. Duhet ta keni parë ndonjëherë duke kaluar. Është një kafshë e vogël nga Buloneja e poshtme. Është zjarr i tëri. Në fillim donin ta bënin kalë shale. Bah! E ku shtrohej ai? Ngrihej e shtinte me shkelma dhe më t'i hidhte të gjithë përdhe. Kujtonin se ishte kalë me huqe dhe nuk dinin si t'ia bënin. Unë vendosa dhe e bleva. E mbreha në kabrioletë. Zotëri, këtë donte edhe ai. Është i butë si ndonjë vashëz dhe vrapon si era. Ah! Sakën se ia hipën. Nuk është për kalë shale ai. Sikush ka tekat e veta. Të tërheqë, po. Të mbajë në kurriz, jo. Ty të thotë mendja se ka bërë be e rrufé për këtë.

-Dhe do ta bëjë këtë udhëtim?

-Të njëzet legat tuaja. Gjithmonë me revan dhe në më pak se tetë orë. Por, ama, me këto kushte:

-Flisni.

-Së pari, do ta lini të marrë frymë një herë në gjysmën e udhës; duhet të hajë dhe duhet t'i qëndroni te koka gjatë kësaj kohe për të ndaluar djalin e hanit t'i vjedhë tagjinë; sepse kam

vënë re që në hanet tagjinë më shumë e përllajnë shërbyesit e haureve, sesa e hanë kuajt.

-Do t'i qëndroj qiri mbi kokë.

-Së dyti... kaloshina është për zotin kryetar?

-Po.

-A di ta ngasë zotëria juaj?

-Po.

-Mirë, pra, zotëria juaj do të udhëtojë vetëm dhe pa bagazhe, me qëllim që kali të mos ngarkohet shumë.

-Ashtu qoftë!

-Por, meqë zotëria juaj nuk do të ketë njeri me vete, atëherë duhet të marrë mundimin ta mbikëqyrë vetë tagjinë.

-Ka marrë fund ajo punë.

-Dua tridhjetë franga në ditë. Duhet paguar edhe ditët e pushimit. Asnjë qindarkëz më pak, dhe ushqimi do të jetë nga qesja e zotit kryetar.

Zoti Madëlen nxori nga qesja tre napolona ar dhe i vuri mbi tryezë.

-Ja dy ditë paradhënie.

-Së katërti, për një vrap të tillë kaloshina do të ishte tepër e rëndë dhe do ta lodhte kalin. Do të duhej që zoti kryetar të pranonte të udhëtonte në një tilburi të vogël që kam këtu.

-Qoftë e bërë!

-Tilburia është e lehtë, por është e hapur.

-Aq më bën.

-A ka menduar, zoti kryetar, se jemi në dimër tani?...

Zoti Madëlen nuk u përgjigj. Flamandi vazhdoi më tutje:

-Dhe se bën ftohtë?

Zoti Madëlen nuk bëri zë. Usta Skofleri vazhdoi:

-Dhe se mund të bjerë shi?

Zoti Madëlen ngriti kokën e tha:

-Tilburia dhe kali do të jenë përpara portës së shtëpisë sime nesër në orën katër e gjysmë të mëngjesit.

-E mora vesh, zoti kryetar, - u përgjigj Skofleri; pastaj, duke kruar me thoin e gishtit të madh një njollë mbi dërrasën e tryezës, vazhdoi si pa të keq, ashtu siç e kanë zakon flamandët ta përziejnë këtë me finokërinë e tyre:

-Po daleni, se tani më ra ndër mend! Zoti kryetar nuk po më thotë se ku do të shkojë. Ku po shkon zotëria juaj, zoti kryetar?

Atij vetëm aty i punonte mendja që në fillim të bisedës, por as ai s'e dinte se pse i qe lidhur goja e s'ia kishte mbajtur t'ia bënte këtë pyetje.

-A i ka të mira këmbët e përparme ai kali juaj? - tha zoti Madëlen.

-Po, zoti kryetar. Veç do ta mbani pakëz në të tatëpjetat. A ka shumë të tatëpjeta që këtu e gjer atje ku do të shkoni?

-Mos harroni të gjendeni te porta ime në orën katër e gjysmë të mëngjesit, por të mos luajë as minuta, - u përgjigj zoti Madëlen dhe doli.

Flamandi mbeti "tamam si guak", siç thoshte vetë pas disa kohësh.

Zoti kryetar kishte dy a tri minuta që kishte dalë, kur porta u hap përsëri; ishte zoti kryetar.

Kishte gjithë po atë pamje të gurtë dhe të shqetësuar.

-Zoti Skofler, - tha ai, - sa parà e çmoni kalin dhe tilburinë që do të më jepni me qira, njërin duke mbajtur tjetrën?

-Njërin duke tërhequr tjetrën, zoti kryetar, - tha flamandi duke qeshur me të madhe.

-Ashtu qoftë. Atëherë?

-A mos vallë zoti kryetar dëshiron të m'i blejë?

-Jo, por sidoqë të ngjasë, dua t'ju siguroj. Kur të kthehem, ju do të ma ktheni përsëri shumën. Sa ju bëjnë karroca e kali bashkë?

-Pesëqind franga, zoti kryetar.

-Ja ku i keni.

Zoti Madëlen lëshoi një bankënotë mbi tryezë, pastaj doli e kësaj radhe nuk u kthye më nga udha.

Usta Skofleri u pendua shumë që nuk tha një mijë franga. Pastaj, kali dhe tilburia bashkë vlenin njëqind skude.

Flamandi thirri të shoqen dhe ia tregoi çështjen. Ku dreqin mund të shkojë vallë kryetari i bashkisë? U mblodhën në kuvend për ta pleqëruar punën. "Vete në Paris", - tha gruaja. "S'ma ha mendja", - tha burri. Zoti Madëlen kishte harruar mbi

oxhak atë copëz letër ku kishte shkarravitur disa shifra. Flamandi e mori dhe e studioi. "Pesë, gjashtë, tetë e gjysmë". Kjo duhet të shënojë vendqëndrimet e postës dhe pikat e ndërrimit të kuajve". Ju kthye së shoqes: "E gjeta". "Si?" "Pesë lega janë që këtu e gjer në Hesdën, gjashtë nga Hesdëni në Sen-Pol, tetë e gjysmë nga Sen-Poli në Arras. Në Arras vajtka".

Ndërkohë zoti Madëlen ishte kthyer në shtëpinë e vet.

Për t'u kthyer nga shtëpia e usta Skoflerit, ai kishte marrë udhën më të gjatë, sikur porta e presbiterit të ishte një tundim, të cilit ai donte t'i shmangej. Ishte ngjitur në dhomën e vet dhe ishte mbyllur brenda, kjo ishte diçka fare e thjeshtë, sepse ai kishte qejf dhe zakon të flinte herët. Megjithatë, portierja e fabrikës, e cila ishte njëkohësisht edhe e vetmja shërbyese e zotit Madëlen, vuri ré se drita e tij u fik në orën tetë e gjysmë, dhe ia tha këtë gjë arkëtarit, i cili po kthehej në shtëpi, duke shtuar:

-Mos është gjë i sëmurë zoti kryetar? M'u duk si krejt ndryshe sonte.

Arkëtari banonte në një dhomë që ndodhej pikërisht nën dhomën e zotit Madëlen. Ai s'ua vuri aspak veshin fjalëve të portieres, u shtri në shtrat dhe e zuri gjumi. Aty nga mesi i natës ai u zgjua papritmas; kishte dëgjuar, ashtu si nëpër gjumë, një zhurmë, aty lart mbi kokën e tij. Mbajti vesh. Ishte një hap që shkonte e vinte, sikur dikush ecte në dhomën sipër. Mbajti vesh më me kujdes dhe njohu çapin e zotit Madëlen. Kjo iu duk e çuditshme. Zakonisht nuk dëgjohej asnjë zhurmë në dhomën e zotit Madëlen përpara orës së zgjimit. Pas një hopi, arkëtari dëgjoji diçka që i përngjante një dollapi që hapej e mbyllet përsëri. Pastaj një mobilje lëvizti nga vendi, u bë një heshtje, dhe çapi filloi përsëri punën e vet. Arkëtari u çua ndenjtur, u zgjua fare, vështroi dhe, përmes xhamit të dritares së vet, dalloi mbi murin përballë flakëritjen e kuqërremtë të një dritareje të ndriçuar. Sipas drejtimit të rrezeve të dritës, s'duhej të ishte tjetër veç dritares së dhomës së zotit Madëlen. Flakëritja dridhej, sikur të vinte më shumë nga ndonjë zjarr i ndezur, sesa nga ndonjë dritë. Hija e kanatës me xhama nuk vizatohej në mur, gjë që tregonte se dritarja ishte hapur kat e

kat. Me atë të ftohtë që bënte, ajo dritare e hapur ashtu ishte diçka e habitshme. Arkëtari u përgjum përsëri. Pas një a dy orësh, ai u zgjua përsëri. Po ai çap i ngadalshëm dhe i lehtë shkonte e vinte gjithmonë mbi kokën e tij.

Flakëritja vizatohej akoma mbi mur, por tani ishte e zbehtë dhe e gjatë, si refleksi i një llambe ose qiriu. Dritarja ishte gjithnjë e hapur.

Ja se ç'po ngjiste në dhomën e zotit Madëlen.

II

Stuhi në shpirt

Pa dyshim lexuesi e ka pikasur se zoti Madëlen s'është tjetër veçse Zhan Valzhani.

Edhe më përpara kemi vështruar në thellësitë e kësaj ndërgjegjeje; ka ardhur çasti të vështrojmë edhe një herë. Por këtë nuk po e bëjmë pa u tronditur dhe pa u dridhur. S'ka gjë më të frikshme e më të hatashme se kjo lloj soditjeje. Syri i shpirtit nuk mund të gjejë askund më shumë shkëlqim, as më shumë terr, sesa te njeriu; nuk mund të ngulet mbi asgjë tjetër më të frikshme, më të ndërlikuar, më misterioze dhe më të pafundme. Ka një shfaqje edhe më të madhe se deti, dhe kjo është qielli; ka një shfaqje edhe më të madhe se qielli, dhe kjo është brendësia e shpirtit.

Të bësh poemën e ndërgjegjes njerëzore, qoftë edhe për një njeri të vetëm, qoftë edhe për atë më të fundmin e botës, kjo do të thotë të shkrih të gjitha epopetë në një epopë më të lartë dhe përfundimtare. Ndërgjegjja është kaosi i ëndrrave, i lakmive dhe i orvatjeve, furra e ëndërrimeve, shpella e ideve për të cilat kemi turp; është kryeqendra e sofizmave, është fusha e luftës së pasioneve. Në një çast të caktuar depërto përmes fytyrës së zbehtë të një qenieje njerëzore që ka rënë në mendim, dhe vështro prapa, vështro brenda në këtë shpirt, vështro në këtë terr. Aty, nën heshtjen e përjetshme, ka luftime viganësh

si te Homeri, përleshje dragonjsh, kuçedrash dhe trumba fantazmash si te Miltoni, spirale vegimtare si te Dantja. Sa gjë e errët është ai pambarimi që ka me vete çdo njeri dhe me të cilin ai mat me dëshpërim vullnetet e trurit të vet dhe veprimet e jetës së vet!

Aligieri hasi një ditë një derë të përzishme, përpara së cilës ai dyzoi. Ja, tani, një derë e tillë qëndron edhe përpara nesh. Në pragun e saj edhe ne po dyzojmë. E megjithatë, le të hyjmë.

S'kemi t'u shtojmë veçse pak gjëra atyre që lexuesi di qysh më parë mbi çka i kishte ngjarë Zhan Valzhanit që nga ndodhia me Zhervezin e Vogël. Siç e pamë, që nga ai çast, ai u bë tjetër njeri. Ai e zbatoi atë që Bienvënyi deshi për Zhan Valzhanin. Ky ishte më shumë se një shndërrim, ishte një shpërfytyrim.

Ai ia arriti të zhdukte gjurmët, shiti argjendarinë e ipeshkvit duke mbajtur vetëm shandanët si kujtim, rrëshqiti nga një qytet në tjetrin, i ra Francës rreth e rrotull, erdhi në Montrëj-syr-Mer, pati atë idenë që thamë, plotësoi ato që treguam, arriti të bëhej i pakapshëm dhe i paarritshëm, dhe, qysh atëherë, i vendosur në Montrëj-syr-Mer, i lumtur që e vriste ndërgjegjja për të kaluarën, i lumtur për pjesën e dytë të jetës së tij, që përgënjeshtronte të parën, ai jetoi i qetë, i sigurt dhe plot shpresa, duke pasur vetëm dy mendime: të fshihte emrin dhe të shenjtëronte jetën e vet.

Këto dy mendime ishin përzier aq ngushtë në shpirtin e tij, sa përbënin një mendim të vetëm; që të dy mendimet ishin po aq tërheqëse dhe urdhëruese sa njëri tjetri dhe sundonin deri dhe veprimet e tij më të vogla. Zakonisht ato puqeshin me njëri-tjetrin për të rregulluar sjelljen e jetës së tij; ato e bënë të qëndronte në hije, e bënë dashamirës dhe të thjeshtë; ato i këshillonin të njëjtat gjëra. Por, megjithatë, disa herë kishte edhe konflikte midis këtyre dy mendimeve. Në këtë rast, siç e mbajmë mend, njeriu, të cilin i gjithë Montrëj-syr-Meri e quante zoti Madëlen, nuk lëkundej të sakrifikonte mendimin e parë për të dytin, sigurimin e tij për virtytin e tij. Kështu, në kundërshtim me çdo rezervë e maturi, ai i kishte ruajtur shandanët e Bienvënyit, kishte mbajtur zi për të, kishte thirrur e pyetur të gjithë savojasit e vegjël që kalonin andej, kishte

marrë njoftime mbi familjet e Favërolës dhe i kishte shpëtuar jetën plakut Foshëlëvan, me gjithë romuzet shqetësuese të Zhaverit. Siç e kemi vënë re edhe më përpara, ai dukej se mendonte që, nën shembullin e të gjithë të urtëve, të drejtëve, detyra e tij e parë nuk ishte që të shikonte veten e vet.

Sidoqoftë, dhe kjo duhet thënë, kurrë ndonjëherë më përpara s'i ishte paraqitur një rast si ky. Kurrë ndonjëherë të dyja idetë që qeverisnin e rregullonin këtë njeri fatkeq, vuajtjet e të cilit po i tregojmë këtu, nuk ishin futur në një përleshje kaq të rëndë. Ai e kuptoi ashtu tymthi, por thellë, qysh me fjalët e para që shqiptoi Zhaveri kur hyri në zyrën e tij. Në çastin kur u shqiptua në mënyrë aq të çuditshme ai emër, të cilin ai e kishte mbuluar me aq e aq shtresa të trasha, ai mbeti i shastisur dhe si i dehur nga kjo rastësi e kobshme e fatit të tij, dhe përmes kësaj shastisjeje, ai pati një të rrëqethur si ato që vijnë përpara tronditjeve të mëdha; ai u përkul si ndonjë lis në të afruar të stuhisë, si ndonjë ushtar në të afruar të ndonjë sulmi. Ai e ndjeu që po i vinin mbi krye hije të ngarkuara me rrufera dhe shkrepitima. Kur po dëgjonte Zhaverin të fliste, atij i erdhi njëherë të shkonte, të vraponte, ta padiste vetveten, ta shpëtonte atë Shamatjën nga burgu dhe të futej vetë brenda; ky mendim ishte i dhimbshëm e therës si ndonjë thikë që futet thellë në mishin e gjallë, pastaj gjithë kjo kaloi, dhe ai tha me vete: "Pa dale! Pa dale njëherë!" E shtypi dhe e mposhti këtë ndjenjë bujare dhe u zmbraps përpara heroizmit.

Pa dyshim që do të ishte shumë bukur sikur, pas fjalëve të shenjta të ipeshkvit, pas kaq vjet pendesash dhe vetëmohimi, në mes të një pendese të filluar aq mirë, ky njeri, dhe përpara një turbullimi kaq të tmerrshëm, të mos lëkundej për asnjë çast dhe të vazhdonte të ecte me të njëjtin çap drejt asaj humnere të hapur, në fund të së cilës ishte qielli; do të ishte shumë bukur, por ja që nuk ndodhi ashtu. Na duhet medoemos t'i tregojmë ato që po ndodhnin në këtë shpirt, dhe nuk mund të themi tjetër veçse atë çka kishte në të. Në krye sundoi ndjenja e vetvetishme e vetëruajtjes; ai i mblodhi shpejt e shpejt idetë e veta, i mbyti mallëngjimet, e shqyrtoi mbarë e prapë praninë e Zhaverit, këtë rrezik të madh, anulloi çdo vendim me ngulmin

e llahtarës, e humbi fare se ç'duhej të bënte dhe pastaj erdhi e fitoi përsëri gjakftohtësinë, ashtu si ai luftëtari që merr mburojën e vet.

Pjesën tjetër të ditës ai ishte në këtë gjendje: përbrenda, një shkullinë, përjashta, një qetësi e thellë; ai mori vetëm ato që mund të quhen "masa mbrojtëse". Gjithçka ishte ende e mjegullt dhe përplasej pas trurit të tij; turbullimi ishte aq i madh, sa nuk kishte asnjë ide të qartë; as ai vetë s'mund të thoshte dot gjë për veten e tij, në mos atë që sapo kishte ngrënë një goditje të rëndë. Vajti si zakonisht pranë shtratit të vuajtjes së Fantinës dhe e zgjati vizitën e tij nga ndjenja e vetvetishme e mirësisë, duke thënë me vete se kështu duhej të vepronte; ia rekomandoi Fantinën murgeshave, po të qëllonte të largohej nga shtëpia. Ndjeu ashtu mbyturazi se ndoshta duhej të vinte në Arras dhe, pa qenë aspak i vendosur për këtë udhëtim, ai tha me vete se, meqë ishte larg çdo dyshimi, nuk do të kishte asnjë ngatërresë sikur të ishte dëshmitar i asaj që do të ngjiste aty, dhe kësisoj ai pajtoi tilburinë e Skoflerit, me qëllim që të ishte i përgatitur për çdo të papritur.

Hëngri darkë me mjaft oreks.

Kur hyri në dhomë, e mblodhi veten.

E shqyrtoi gjendjen dhe iu duk si diçka që s'ishte parë e dëgjuar ndonjëherë; kaq fort e paparë dhe e padëgjuar, sa, në mes të ëndërrimeve të tij, nuk di se nga ç'shtytje ankthi gati të pashpjegueshëm, ai u ngrit nga karrigia dhe e mbylli derën me shul. Kishte frikë se mos i hynte akoma ndonjë gjë tjetër. Ai u fortifikua kundër gjithçkaje që mund t'i ndodhte.

Pas një hopi shoi dritën. Drita e shqetësonte.

I dukej sikur mund ta shihnin bota.

Kush, bota?

Medet! Ajo që ai donte ta dëbonte jashtë, kishte hyrë brenda; ajo që ai donte të verbonte, po e vështronte me sy. Ishte ndërgjegjja e vet...

Megjithatë, në çastin e parë, sikur e gënjeu mendja; pati një ndjenjë sigurie dhe vetmie; si e vuri shulin, ai e kujtoi veten të pakapshëm; si fiku qiriun, ai e ndjeu veten të padukshëm. Atëherë ai e mori veten në dorë; vendosi të dy bërrylat mbi

tryezë, mbështeti kryet mbi dorë dhe filloi të mendonte në terr.

-Ku jam kështu vallë? Mos jam vallë në ëndërr? Ç'më thanë ashtu? A është tamam e vërtetë që e pashë Zhaverin dhe që më foli asisoj? Ç'mund të jetë vallë ky Shamatjëi? Më përngjan, pra? Ah! Kur mendoj se dje isha i qetë dhe larg çdo dyshimi! Ç'bëja, pra, dje në këtë orë? Ç'ka në këtë ndodhi të papritur? Si do të zgjidhet vallë? Ç'të bëj?

Ja se në çfarë sflitjeje ndodhej ai. Truri i tij e kishte humbur forcën që i duhej për të mbajtur idetë, ato kalonin si valë, dhe ai e kapte ballin me të dyja duart për t'i ndalur në vend.

Nga gjithë kjo trazirë që përmbyste vullnetin dhe arsyen e tij dhe prej së cilës donte të nxirrte ndonjë gjë të qartë e ndonjë vendim, nuk shpërthente asgjë tjetër përveç angështisë.

Koka i digjej furrë. Vajti te dritarja dhe e hapi krejt. Në qiell s'kishte fare yje. U kthye përsëri dhe u ul pranë tryezës.

Kështu kaloi ora e parë.

Ndërkaq, pak nga pak disa përvijime të mjegullta filluan të formoheshin dhe të hidhnin rrënjë në mendimin e tij, dhe ai mundi të shihte nëpër të, me përpikmëri e realitet, jo gjithë gjendjen në tërësi, por disa hollësira.

Ai filloi të pranonte se, sado e jashtëzakonshme dhe kritike të ishte kjo gjendje, ai ishte plotësisht zot i saj.

Nga kjo, shastisja iu shtua akoma më shumë.

Pavarësisht nga qëllimi i rreptë që ndiqnin veprimet e tij, gjithçka që kishte bërë ai deri atë ditë, s'ishte gjë tjetër veçse një gropë, të cilën ai e hapte për të varrosur aty emrin e tij. Asaj që i trembej më shumë, në orët e shqyrtimit të vetvetes, në netët kur s'e merrte gjumi, ishte se mos dëgjonte ndonjëherë të shqiptohej ai emër; ai thoshte me vete se, po të ngjiste kjo, do të vinte fundi; se ditën kur ai emër do të shfaqej përsëri, do ta bënte pluhur e hi, rreth tij, jetën e tij të re dhe, kushedi, ndoshta? brenda në veten e tij shpirtin e tij të ri. I rrëqethej tërë trupi edhe vetëm kur mendonte se kjo mund të ndodhte ndonjëherë. Sigurisht, në qoftë se dikush do t'i thoshte në ato çaste se do të vinte ora kur ai emër do të tingëllonte në veshët e tij, kur kjo fjalë e llahtarshme, Zhan Valzhan, do të dilte befas

nga terri dhe do të shfaqej përpara tij, kur ajo dritë e madhërishtme e destinuar për të zbuluar misterin me të cilin ai mbështillej do të flakërinte papritur mbi kokën e tij; dhe se ky emër nuk do ta kërcënonte, ajo dritë nuk do të përvëlonte tjetër veçse një terr akoma më të trashë, ai vel i grisur do ta shtonte akoma më shumë misterin, ky tërmet do ta përforconte ndërtesën e tij, ajo ndodhi e çuditshme nuk do të kishte tjetër përfundim, në qoftë se do t'ia kishte ënda edhe atij vetë, veçse që ta bënte jetën e tij njëkohësisht më të qartë dhe më të padepërtueshme, dhe se nga ballafaqimi i tij me fantazmën e Zhan Valzhanit, borgjezi i denjë dhe i mirë, zoti Madëlen, do të dilte më i nderuar, më i qetë dhe më i respektuar se asnjëherë - në qoftë se dikush do t'ia kishte thënë këtë gjë, ai do të kishte tundur kokën dhe këto fjalë do t'i kishte quajtur si të marra. Eh, pra! Por ja që pikërisht të gjitha këto sapo kishin ngjarë, e gjithë ajo stivë e së pamundshmes ishte një fakt i gjallë, dhe ato gjëra të marra ishin bërë të vërteta!

Ëndërrimi i tij vazhdonte të sqarohej. Ai po e kuptonte gjithnjë e më mirë gjendjen e tij.

I dukej sikur sapo ishte zgjuar nga nuk e di se çfarë gjumi dhe sikur po rrëshqiste në një rrëpirë në mes të natës, me këmbë, gjithë duke u dridhur, duke u zmbrapsur më kot, në buzën e tejme të një humnere. Ai ajgëtonte qartë në terr një të panjohur, një të huaj, të cilin fati e kishte marrë për të dhe e shtynte në humnerë në vend të tij. Që të mbyllej kjo humnerë, duhej që dikush të binte brenda, ose ai, ose tjetri.

Ai s'kishte ç'të bënte veç t'i linte punët të rrokulliseshin vetë.

Qartësia u bë e plotë, dhe ai i pohoi vetes këtë: "Se vendi i tij ishte bash në galerat, se më kot kishte punuar aq shumë, se galerat e prisnin gjithmonë, se vjedhja ndaj Zhervezit të Vogël e çonte përsëri aty, se ai vend i zbrazët po e priste dhe do ta tërhiqte gjersa të vinte aty, se kjo ishte e pashmangshme dhe fatale". Dhe pastaj tha me vete se në këtë çast ai kishte një zëvendës, se, siç dukej, një i quajtur Shamatjë kishte pasur fatin e keq dhe se, sa për atë vetë, tani e tutje i pranishëm në burg nën lëkurën e atij Shamatjëit, i pranishëm në shoqëri nën emrin

e zotit Madëlen, ai s'kishte përse të tutej, mjaft që të mos i ndalonte njerëzit të vulosnin mbi kokën e Shamatjëit atë gur turpi e çnderimi, që, si rrasa e varrit, bie një herë dhe nuk ngrihet më kurrë.

E gjithë kjo ishte kaq e dhunshme dhe kaq e çuditshme, sa ai bëri papritmas atë lëvizje të papërshkrueshme, që asnjëri nuk e provon më shumë se dy a tri herë në jetën e tij, njëfarë përpëlitjeje të ndërgjegjes, e cila shkund çdo gjë që zemra ka të dyshimtë, që përbëhet nga ironia, gëzimi dhe dëshpërimi dhe që mund ta quajmë shpërthim qeshjeje të brendshme.

Ai e ndezi papritmas edhe një herë qiriun.

-Eh, pra, çfarë! - tha ai me vete, - nga se të kem frikë unë? Ç'kam që mendohem kësisoj? Ja, unë tani kam shpëtuar. Çdo gjë ka marrë fund. Kisha vetëm një portë të hapur, nga e cila e kaluara ime mund të vështronte në jetën time; ja dhe kjo portë u muros tani! Për jetë të jetëve! Ai Zhaveri, që po më turbullon prej kohësh, ai instinkt i tmerrshëm, që dukej sikur më kishte pikasur, që më kishte pikasur, për besë! dhe që më ndiqte prapa kudo, ai qen i llahtarshëm gjahu, që më vëzhgonte pareshtur, ja ku i humbi gjurmët, ja ku po merret gjetiu, toruahumbur! Tanimë është i kënaqur, do të më lërë të qetë, Zhan Valzhanin, që kërkonte, e gjeti dhe e ka në dorë! Dhe bile, kushedi, ndoshta do të kërkojë të largohet nga qyteti! Dhe e gjithë kjo punë është bërë pa mua! Unë s'hyj fare në këtë çështje! Pa dale njëherë! Ç'të keqe ka në këtë mes? Kush të më shikonte, për fjalë të nderit që do të thoshte se më ka ndodhur ndonjë katastrofë! Fundi i fundit, në qoftë se dikë e ka pllakosur e keqja, kjo s'është aspak për fajin tim. Të gjitha këto gjëra i ka kurdisur vetë fati. Duket se kështu e dashka fati! A kam të drejtë unë të prish atë që rregullon ai? Ç'kërkoj unë tani? Ç'punë kam të përzihem në këtë mes? Kjo s'është punë që më përket mua. Si! S'qenkam i kënaqur. Po ç'dua tjetër? Qëllimin që kërkoj të arrij që prej kaq vjetësh, ëndrrën e netëve të mia, objektin e lutjeve të mia, sigurinë, e arrita! Por vetë Zoti ka vendosur kështu. Unë s'kam ç'të bëj kundër vullnetit të Zotit. Po pse Zoti e ka vendosur kështu? Që unë të vazhdoj atë që kam filluar, që unë të bëj të mira, që unë të jem një ditë prej ditësh një shembull i madh

dhe inkurajues, që të thuhet se pata, më në fund, një grimë lumturi pas tërë atyre mundimeve që kam hequr dhe atij virtyti ku jam kthyer! Me të vërtetë, unë s'po e kuptoj përse pata frikë qëpari të hyja tek ai famullitari i mirë dhe t'ia kallëzoja të gjitha si ndonjë rrëfimtari dhe t'i lypja këshilla; me siguri, këto gjëra do të më kishte thënë edhe ai. Kjo punë mori fund, le t'i lëmë gjërat të ecin në udhën e tyre.

Ai fliste kështu me vete në thellësitë e ndërgjegjes së tij, i kërrusur mbi atë që mund ta quajmë humnerën e tij. U ngrit nga karrigia dhe filloi të ecte nëpër dhomë.

-Hajde, - tha ai, - s'duhet menduar më për këtë çështje. Tani vendimi u mor!

Por ai s'ndjeu asnjë gëzim. Përkundrazi.

Mesa është e mundur të ndalosh detin të rikthehet në breg, aq është e mundur të ndalosh edhe mendimin të rikthehet te një ide. Për detarin kjo quhet baticë; për fajtorin kjo quhet vrasje e ndërgjegjes.

Mbas disa çastesh, u orvat më kot, se ai e filloi përsëri këtë dialog të errët, në të cilën vetë fliste dhe vetë dëgjonte, duke thënë ato gjëra që ai do të dëshironte të mos i thoshte, duke mbajtur vesh ato gjëra që ai s'do të dëshironte t'i dëgjonte, duke iu bindur asaj fuqie të mistershme që i thoshte: "Mendo!" Ashtu siç i thoshte, këtu e dy mijë vjet të shkuar, një të dënuari tjetër "Shko!"⁹¹⁾

Para se të shkojmë më tutje dhe me qëllim që të kuptohemi plotësisht, le të ndalemi pak mbi një vërejtje të domosdoshme.

Sigurisht që njeriu flet me vete, dhe s'ka qenie të mençur që të mos e ketë provuar këtë. Madje, mund të themi se fjala nuk është kurrë një mister i madhërishtëm veçse atëherë kur vete në brendësinë e njeriut, nga mendimi në ndërgjegje dhe kthehet nga ndërgjegjja te mendimi. Dhe vetëm në këtë kuptim duhen marrë fjalët që shpesh përdoren në këtë kapitull, *ai tha*, *ai bërtiti*. Njeriu thotë, flet, bërtet me vete, pa prishur jashtë qetësinë. Vjen e bëhet një gumëzhitje e madhe; gjithçka flet brenda nesh, përveç gojës. Realitetet e shpirtit, edhe pse s'janë aq të dukshme dhe aq të prekshme, nuk janë më pak realitete.

Ai e pyeti veten se gjer ku kishte arritur. Pyeti veten mbi

atë “vendim që kishte marrë”. Iu rrëfyte vetvetes se të gjitha ato sa kishte sajuar e rregulluar në mendjen e vet ishin gjëra të përbindshme, se “t’i lësh gjërat të ecin në udhën e tyre dhe ta lësh Zotin e madh të veprojë”, kjo ishte diçka e llahtarshme. Ta lësh të kryhet gabimin e fatit dhe të njerëzve, të mos e ndalosh, t’i japësh dorë me anë të heshtjes, të mos bësh asgjë, fundi i fundit, kjo është njëlloj sikur të kesh bërë gjithçka. Kjo ishte shkalla e fundit e padenjësisë hipokrite! Ishte një krim i ulët, burracak, tinzar, faqezi, i ndyrë!

Për të parën herë, që prej tetë vjetësh, i shkreti burrë sapo kishte ndier amëzën e hidhur të një veprimi të keq.

E pështyu i pështirosur.

Ai vazhdoi t’i bënte pyetje vetvetes. E pyeti me rreptësi se çfarë kishte parasysh me fjalët: “Unë qëllimit ia kam arritur”. Ai deklaroi se jeta e tij në të vërtetë kishte një qëllim. Por çfarë qëllimi? Të fshihte emrin e vet? Të mashtronte policinë? Mos i kishte bërë të gjitha ato sa kishte bërë për një gjë aq të vogël? A nuk kishte vallë një qëllim tjetër, një qëllim të madh, qëllim të vërtetë? Të shpëtonte jo veten e tij, por shpirtin e tij. Të bëhej i ndershëm dhe i mirë! Të ishte njeri i drejtë! A nuk ishte kjo mbi të gjitha, kjo e vetëm kjo, ajo që kishte dashur gjithmonë, ajo që i kishte urdhëruar ipeshkvi? T’i mbyllte derën të kaluarës së tij? Por ai nuk po e mbyllte! Por po e hapte përsëri duke bërë një veprim faqezi! Po bëhej përsëri një vjedhës dhe më i urryeri i vjedhësve! Ai po i vidhte një tjetri të qenët, jetën, paqen, vendin e tij në botë! Po bëhej një vrasës! Ai po vriste, po vriste moralisht një njeri të mjerë, po e bënte që të vuante vdekjen e llahtarshme që për së gjalli, atë vdekje në qiell të hapët, që quhet burg i punëve të rënda!

Ndërsa, përkundrazi, po të dorëzohej, po ta shpëtonte atë njeri të goditur nga një gabim aq kobzi, po të merrte përsëri emrin e tij, po të bëhej, sepse e kishte për detyrë, edhe një herë i burgosuri Zhan Valzhan, atëherë ai me të vërtetë do ta kryente plotësisht e gjer në fund ringjalljen e vet dhe do ta mbyllte për jetë të jetëve ferrin prej nga kishte dalë! Në dukje, do të binte në ferr; por në të vërtetë, do të dilte soje! Dhe, po të mos e bënte këtë, ai s’kishte bërë asgjë! E gjithë jeta e tij do të ishte e

padobishme, e gjithë pendesa e tij do të shkonte kot, dhe s’i mbetej më tepër për të thënë veçse: “E ç’nxora nga e gjithë kjo punë?” Ai e ndiente se Bienvënyi ishte aty, se Bienvënyi ishte i pranishëm, megjithëse kishte vdekur, se Bienvënyi e vështronte ngultas, se tanimë kryetari i bashkisë Madëlen, me të gjitha virtytet e tij, do të ishte njeri i neveritshëm, dhe se i burgosuri Zhan Valzhan do të ishte njeri i admirueshëm dhe i pastër përpara tij. Se njerëzit shikonin maskën e tij, por ipeshkvi shikonte fytyrën e tij. Se njerëzit shikonin jetën e tij, por ipeshkvi shikonte ndërjegjen e tij, Duhej, pra, të shkonte në Arras, ta lironte Zhan Valzhanin e rremë dhe të kallëzonte të vërtetën! Medet! Kjo ishte sakrifica më e madhe, fitorja më therëse, pragu i fundit që duhej kapërcyer; por duhej bërë.

-Eh, pra, - tha ai, - le ta marrim këtë anë! Le ta bëjmë detyrën tonë! Le ta shpëtojmë këtë njeri!

I shqiptoi ato fjalë me zë të lartë, pa e kuptuar as ai se po fliste fort. Mori librat e llogarive, i kontrolloi dhe i vuri në rregull. Hodhi në zjarr një tufë kredish që i kishte me disa tregtarë të vegjël, të cilët kishin rënë ngushtë. Shkroi një letër, të cilën e mbylli dhe e vulosi. Po të kishte qenë njeri në dhomën e tij, do të kishte mundur të lexonte mbi këtë zarf: *Zotit Lafit, bankier, rruga “Artua”, në Paris.*

Nxori nga një sirtar i fshehtë një portofol me disa bankënota dhe pasaportën, që kishte përdorur po atë vit për të vajtur në zgjedhjet. Kush do ta kishte parë tek po kryente këto veprime të ndryshme, me të cilat pleksej një meditacion aq serioz, s’do të kishte pikasur fare se çfarë po ngjiste tek ai. Veçse hope-hope buzët e tij lëviznin; hope të tjera ai ngrinte kokën dhe e ngulte vështrimin mbi një pikë të çfarëdoshme të murit, a thua se pikërisht atje kishte diçka që donte ta kthjellonte ose të pyeste.

Si e mbaroi letrën për zotin Lafit, e vuri në xhep bashkë me portofolin dhe filloi përsëri të ecte.

Mendja i rrihte po në një vend. Vazhdonte të shikonte qartë detyrën e tij të shkruar me shkronja të ndritshme, që i flakëronin para syve dhe lëviznin gjithmonë andej nga hidhte vështrimin: “Ec! Trego emrin! Padite veten!”

Ai shikonte gjithashtu, dhe i dukej sikur lëviznin përpara tij me forma të ndjeshme, të dyja idetë që kishin qenë gjer atëherë rregulli i dyfishtë i jetës së tij: të fshihte emrin, të shenjtëronte shpirtin. Për të parën herë ato i shfaqeshin tani krejt shkoqur, dhe shikonte ndryshimin që ndante njëren nga tjetra. Ai e pranonte se njëra prej këtyre ideve ishte domosdo e mirë, ndërsa tjetra mund të bëhej e keqe; se ajo ishte vetëmohimi, kurse kjo tjetra personaliteti; se njëra thoshte: i *afërti* dhe tjetra thoshte: *unë*; se njëra vinte nga drita dhe tjetra nga nata.

Këto ide luftonin njëra-tjetrën dhe ai i shikonte tek luftonin. Dora-dorës që mendonte, ato ishin rritur përpara syrit të shpirtit të tij; ato kishin hedhur tani secila nga një shtat kolosal; dhe tani, brenda vetes, në atë pambarim për të cilin folëm pak më parë, në mes të terreve e të dritave, atij i dukej sikur shikonte një perëndeshë dhe një gjigante që luftonin.

Atë e kishte pushtuar frika, por i dukej se mendimi i mirë po fitonte mbi mendimin e keq. Ai po ndiente se po prekte çastin tjetër vendimtar të ndërgjegjes dhe të fatit të tij, se ipeshkvi kishte shënuar fazën e parë të jetës së tij të re dhe se ky Shamatjëi shënonte të dytën. Pas krizës së madhe, sprova e madhe.

Ndërkaq, ethja, si ishte tullitur për një çast, po fillonte ta kapte pak nga pak. Mijëra mendime e përshkonin, por ato vazhdonin t'i jepnin fuqi e zemër në vendosmërinë e tij.

Një çast, ai kishte thënë me vete: "Se po e merrte çështjen, mbase, me një zjarr si të tepruar, se, fundi i fundit, ky Shamatjëi nuk ishte kushedi se kush, se, fundi i fundit, ai kishte vjedhur". Dhe ishte përgjigjur me vete: "Në qoftë se ky njeri me të vërtetë ka vjedhur diçka mollë, këtu është puna për një muaj burg dhe s'ka si të dënohet me punë të rënda. Por kushedi vallë? A ka vjedhur? A është provuar? Emri i Zhan Valzhanit e shtyp dhe e dërrmon, dhe duket se s'ka nevojë për prova. A nuk veprojnë rëndom kësioj prokurorët e mbretit? Ata besojnë se është vjedhës, meqë e dinë se është dënuar me punë të rënda."

Një çast tjetër ai mendoi se, po ta padiste veten, ndoshta do të merrej parasysh heroizmi i veprimit të tij, jeta e tij e

ndershme qysh prej shtatë vjetësh dhe gjithë ajo që kishte bërë për vendin, dhe kështu do ta falnin.

Por kjo hamendje u shkri shumë shpejt, dhe ai buzëqeshi hidhët, duke menduar se vjedhja e dyzet suve Zhervezit të Vogël e bënte atë përsëritës faji, se kjo çështje me siguri do të dilte përsëri mbi ujë dhe, në mbështetje të dispozitave të prera të ligjit, do ta dënonte me punë të rënda përjetë.

Ai i ktheu shpinën çdo zhgjiëndrre, u shkëput shumë e më shumë nga toka dhe kërkoi ngushëllim e forcë tjetërkund. Tha me vete se duhej të kryente detyrën që i takonte; se ndoshta nuk do të ishte më i mjerë pasi ta kishte kryer detyrën, sesa pasi t'i ishte shmangur asaj; se, po t'i linte gjërat të *ndiqnin rrjedhën e tyre*, po të qëndronte në Montrëj-syr-Mer, nderi, nami, veprat e mira, respekti, përnderimi, mirëbërjet, pasuria, popullariteti, virtyti i tij, të gjitha këto do të përlyheshin me një krim; ç'shije do të kishin këto gjëra të shenjta, të lidhura me këtë gjë të llahtarshme! Ndërsa, po të kryente therorinë e tij, me burgun, me trikëmbëshin, me vargonjtë, me kësulën e gjelbër, me punën e pandërprerë, me trupin e pamëshirshëm, do të përzihej një ide qiellore!

Më në fund, ai tha me vete se këtu qëndronte një domosdoshmëri, se kështu ishte shkruar fati i tij, se nuk kishte as fuqi, as të drejtë të prishte rregullimet e bëra nga lart, se, sidoqë të ishte puna, duhej të zgjidhte: ose virtytin nga jashtë dhe shëmtinë nga brenda, ose shenjtërinë nga brenda dhe poshtërimin nga jashtë.

Të përbluarit e këtyre mendimeve kobzeza nuk ia thyente kurajën, por trurin, ama, ia lodhte. Ai fillonte padashur të mendonte për gjëra të tjera, për gjëra fare të parëndësishme.

Rrembat e gjakut i rrihnin fort në tëmthat. Ai vazhonte të shkonte e të vinte pa pushim. Mesnata tingëlloi, së pari në famulli, pastaj në bashki. I numëroi të dymbëdhjetë të goditurat e të dy sahatëve dhe krahasoi tingullin e të dy kabanave. Me këtë rast, atij i ra ndër mend se, para diçka ditësh, kishte parë te një tregtar hekurishtesh një kabanë të vjetër për t'u shitur, mbi të cilën ishte shkruar ky emër: *Antuan Albën dë Romënvilë*.

Kishte ftohtë. Ndezi pak zjarr. As që i shkoi ndër mend ta

mbyllte dritaren. Ndërkohë kishte rënë përsëri në shastisje. I duhej të bënte përpjekje të mëdha për t'u kujtuar se çfarë po bluante me mend para se të binte mesnata. Më në fund, ia doli.

-Ah! Po, - tha me vete! - kisha vendosur t'i shfaqesha gjyqit.

E pastaj, papritmas, i vajti mendja te Fantina.

-Pa dale! - tha ai, - po ajo e varfra grua!

Këtu plasi një krizë e ré.

Duke u shfaqur befas në ëndërrimin e tij, Fantina u bë si rrezja e një drite të papritur. Iu duk sikur gjithçka po ndryshonte pamje rreth tij dhe bërtiti:

-Tamam, besa! Gjer këtu unë kam parë vetëm veten time! Kam parë vetëm interesat e mia. Të hesht apo të shfaqem, të fsheh veten time apo të shpëtoj shpirtin, të jem një magjistrat i përbuzshëm dhe i respektuar apo një i burgosur emërkeq dhe i përnderueshëm, unë, gjithmonë unë, vetëm unë! Por, për besë, e gjitha kjo është egoizëm! Këto janë forma të ndryshme të egoizmit, por, sidoqoftë, egoizëm është! Po sikur të mendoja pakëz edhe për të tjerët? Shenjtëria kryesore është të mendosh për tjetrin. Pa dale, ta pleqërojmë njëherë. Sikur unë të hiqem nga ky mes, sikur unë të harrohem, si do t'i vejë filli kësaj pune? Sikur t'i shfaqem gjyqit? Do të më kapin, do ta lëshojnë atë Shamatjëin, do të më rrasin përsëri në burg; mirë, gjer këtu, E pastaj? Çfarë do të ngjasë këtu? Ah! Këtu ka një krahinë, një qytet, një fabrikë, një industri, punëtorë, burra, gra, babagyjshë të vjetër, fëmijë të varfër! Të gjitha këto i kam krijuar unë, me duart e mia, të gjithë këta jetojnë nga duart e mia; kudo që tymos një oxhak, jam unë ai që ka vënë pishën në zjarr dhe mishin në tenxhere; kam krijuar jetën pa halle, qarkullimin, kreditin; para meje s'kishte asgjë; i gjithë ky vend është ngritur, gjallëruar, ka marrë shpirt, është begatuar, nxitur, pasuruar nga unë; po u hoqa unë, u hoq shpirti. Po u largova unë, vdiq çdo gjë. Po ajo grua, që ka hequr të zité e ullirit, që ka aq merita në rëniën e saj, ajo grua, së cilës, pa dashjen time, i kam shkaktuar të gjitha fatkeqësitë që e kanë pllakosur! Po ajo fëmija, për të cilën i premtova s'ëmës se do të shkoja ta merrja vetë! A nuk i detyroj gjithashtu diçka asaj gruaje, si shkëmbim të së keqes që i kam bërë? Në u zhduksha unë, si do t'i vejë filli?

Nëna do të vdesë. Fëmijën do ta marrë lumi. Ja se ç'do të ngjasë po të vete të shfaqem. Po në mos u shfaqesha? Pa të shohim, ç'do të ngjasë po të mos shfaqem?

Si ia bëri vetes këtë pyetje, ai qëndroi: pati një çast ngurrimi dhe përpëlitjeje; por ky çast vazhdoi pak, dhe u gjegj me vete qetë-qetë:

-Mirë, pra, ai njeri vete në galera, vërtet, por, për besë! ai ka vjedhur! Le të them sa të dua unë që s'ka vjedhur, po ai ka vjedhur, ama! Unë do të qëndroj këtu dhe do të vazhdoj. Brenda dhjetë vjetëve, do të kem fituar dhjetë milionë, dhe këto të holla do t'i shpërndaj në krahinë, s'do të mbaj asgjë për vete, ç'më duhen mua ato? Gjithçka që bëj, s'e bëj për vete! Begatia e të gjithëve shkon duke u shtuar, industrinë po zhvillohen dhe po nxitin njëra-tjetrën, manifakturat dhe uzinat po shumëzohen, po ashtu edhe familjet, njëqind familje, një mijë familje! janë të lumtura; treva po popullohet, po lindin fshatra atje ku ka vetëm ferma, po lindin ferma atje ku s'ka asgjë; mjerimi po zhduket dhe tok me mjerimin po zhduken përdalja, kurvëria, vjedhja, vrasja, të gjitha veset, të gjitha krimet! Dhe ajo nëna e shkretë rrit fëmijët e vet! Dhe ja tek e ke një krahinë të tërë të pasur e të ndershme! Pa shih sa i marrë paskam qenë, paskam dalë fare nga kondaku, ç'qe ajo që më hipi të flisja për t'u shfaqur para gjyqit? Duhet ta kem mendjen, me të vërtetë, dhe të mos ngutem për asgjë. E çfarë! Sepse më pëlqeka mua të shitem si i madh e zemërgjerë - në fund të fundit, kjo është melodramë! - sepse mendoj veç për vete, vetëm për veten time; si, për të shpëtuar nga një dënim, ndoshta pakëz si të tepruar, por i drejtë në themel, një të panjohur, një vjedhës, me siguri një palo burrë, u dashka që të vdesë një krahinë e tërë! U dashka që një grua e shkretë të ngordhë në spital! Që një vajzë e shkretë të ngordhë në mes të katër udhëve si qeni! Ah! Por kjo është mynxyrë e zezë! Bile, pa e parë nëna të bijën! Pa e njohur e bija t'ëmën! Dhe të gjitha këto për atë maskaranë, për atë vjedhësin e mollëve, i cili, si një e një që bëjnë dy, i ka hak galerat edhe për gjëra të tjera, në mos qoftë për këtë! Ama, të bukur skrupuj, besa! Shpëto një fajtor dhe merri në qafë të pafajshmit, shpëto një vagabond të regjur, i cili, fundi i fundit, e ka ngrënë

pothuajse krejt livadhin dhe nuk do të jetë më i mjerë në burg, sesa në gërmadhën e tij, dhe shko e merr më qafë një popullatë të tërë, nëna, gra, fëmijë! Pastaj, po ajo Kozeta e shkretë, që s'ka tjetër në këtë botë veç meje dhe që tani do të jetë mavijosur fare nga të ftohtët në gërmadhën e atyre Tenardieve! Ja, edhe ata qen e bij qensh janë! Dhe unë t'u bëj bisht detyrave të mia ndaj këtyre krijesave të ngrata! Dhe të vete të shfaqem! Dhe të vete e ta bëj këtë marrëzi të poshtër! Le të shohim anën më të keqe të çështjes. Le ta zëmë sikur unë kam bërë një veprim të keq për vete në këtë mes dhe ndonjë ditë të më qortojë ndërgjegjja. Në qoftë se, për të mirën e të tjerëve, unë i pranoj këto qortime që më ngarkojnë vetëm mua, këtë veprim të keq që komprometon vetëm shpirtin tim, këtij i thonë vetëmohim, kësaj i thonë burri.

U ngrit në këmbë dhe filloi përsëri të ecte. Kësaj here i dukej sikur ishte i kënaqur.

Diamantet gjenden vetëm në terrin e tokës; të vërtetat gjenden vetëm në thellësitë e mendimit. Atij i dukej se, pasi kishte zbritur në këtë thellësi, pasi kishte kërkuar tymthi për shumë kohë në pjesën më të zezë të këtij terri, e kishte gjetur, tek e mbamja, njërin prej këtyre diamanteve, njërin prej këtyre të vërtetave, dhe e mbante në dorë; atij i merreshin e i verboheshin sytë tek e shikonte.

“Po, - mendoj ai, - kështu është. Tani e gjeta të vërtetën. Zgjidhjen e kam në dorë. Njeriu duhet ta ndajë mendjen e të kapet pas një dege. Tani m'u mbush mendja top. Le t'i lëmë gjërat të grisen ashtu si janë nisur! Le të mos lëkundemi e të mos zbythem më. Kjo është në interesin e të gjithëve dhe jo në interesin tim. Jam Madëlen dhe mbetem Madëlen. Mjerë ai që është Zhan Valzhan! Unë s'jam më Zhan Valzhani. Unë atë njeri s'e njoh fare, nuk e di se ç'është, dhe në qëlloftë që në këto çaste dikush të jetë Zhan Valzhan, le t'i bëjë derman vetes! Kjo punë s'ka të bëjë hiç me mua. Ky është një emër fatal që pluskon në terrin e natës; në qëndroftë e pllakostë mbi ndonjë kokë, mjerë ajo!”

U vështrua në pasqyrën e vogël që ndodhej mbi oxhak dhe tha:

-Pa shih! Sikur u çlirova që mora një vendim! Tani jam krejt ndryshe.

Bëri akoma edhe ca hapa dhe u ndal në vend.

-Hajde! - tha ai, - s'duhet ngurruar përpara asnjë rrjedhimi që mund të sjellë vendimi që kam marrë. Ka akoma disa fije që më lidhin me këtë Zhan Valzhanin. Duhet t'i këput! Pikërisht në këtë dhomë janë disa sende që do të më paditnin, gjëra të heshtura që do të ishin dëshmitare, por fjala është fjalë, të gjitha duhet të zhduken.

Kërkoj në xhep, nxori soje kuletën, e hapi dhe mori një çelës të vogël. E futi atë çelës në një bravë, së cilës mezi i dukej vrima, sepse ishte fshehur nëpër imtësitë më të ngatërruara të vizatimit që mbulonte letrën e ngjitur pas murit. U hap një kamarez e fshehtë, njëfarë dollapi i rremë, i sajuar midis qoshes së murit dhe vazhdës së oxhakut. Në këtë kamarez të fshehtë kishte vetëm disa zhele, një xhakëtë pëlhure mavi, një palë pantallona të vjetra, një çantë shpine të vjetër dhe një shkop të trashë murrizi, të mbathur me hekur në të dyja skajet. Ata që e kishin parë Zhan Valzhanin në kohën kur kalonte nëpër Dinjë, në tetor 1815, do t'i kishin njohur pa vështirësi të gjitha pjesët e kësaj veshjeje të mjerë.

Ai i kishte ruajtur ato, ashtu siç kishte ruajtur edhe shandanët e argjendte për ta kujtuar gjithmonë pikënisjen e tij. Veçse ato që vinin nga burgu, ai i fshihte, ndërsa ato që vinin nga ipeshkvi, i linte sheshit.

Hodhi tinëz një vështrim nga dera, sikur të kishte pasur frikë se mos hapej, megjithëse ishte mbyllur me kllapë, pastaj, me një lëvizje të gjallë dhe të prerë, pa u hedhur asnjë vështrim këtyre gjërave, që i kishte ruajtur me aq fanatizëm dhe rrezik për vite të tëra, i mori të gjitha, me zhele, me shkop e me çantë, dhe i hodhi në zjarr.

E mbylli përsëri dollapin e rremë dhe, duke dyfishuar kujdesjet, tanimë të padobishme, përderisa kamarja ishte e zbrazët, ia fshehu kanatën duke vendosur aty një mobilje të madhe, të cilën e shtyu gjer në vend.

Pas disa sekondash, dhoma dhe muri përballë u ndriçua nga një flakërimë e kuqe që dridhej. Gjithçka po digjej. Shkopi

prej murrizi po kërciste dhe flakte shkëndija gjer në mes të dhomës.

Çanta e shpinës, duke u zhuritur me ato lecka të llahtarshme që kishte brenda, kishte lënë zbuluar një send që shndriste në hi. Në qoftë se dikush do të ishte përkulur, do të kishte njohur pa vështirësi një monedhë argjendi. Pa dyshim, ajo ishte monedha dyzetsushe që ia kishte vjedhur savojasit të vogël.

Ai as që e vështronte zjarrin, por shkante e vinte me të njëjtin hap. Papritmas, sytë i vajtën mbi të dy shandanët, të cilët flakërima i ndriçonte vagët mbi oxhak.

“Pa dale! - mendoj ai. - I tërë Zhan Valzhani është aty brenda. Duhet asgjësuar edhe këto”.

I mori të dy shandanët. Kishte mjaft zjarr sa për t'i deformuar ata shpejt e shpejt dhe për të bërë syresh njëfarë mase metali, që të mos njihej gjë.

U kërrus mbi vatër dhe u ngroh një hop. Ndjeu një mirëqenie të vërtetë.

-Sa ngrohtë! - tha ai.

Përzjeu prushin me njërin nga të dy shandanët. Pas një minute, të dy shandanët u gjendën në zjarr.

Në këtë çast, iu bë sikur dëgjonte një zë që po i thërriste nga brenda: “Zhan Valzhan! Zhan Valzhan!”

Flokët iu ngritën drizë përpjetë dhe erdh e u bë si një njeri që mban vesh ndonjë gjë të tmerrshme.

-Po, ashtu është, jepi fund! - thoshte zëri. - Çoje deri në fund atë që po bën! Prishi ata shandanë! Asgjësoje atë kujtim! Harroje ipeshkvin! Harroji të gjitha! Merrë më qafë Shamatiëin! O burra, se mirë e ke! Duartrokite vetveten! Kështu qenka ujdishur, qenka vendosur, qenka thënë, ja një burrë, një plak, i cili s'di se ç'po i kërkojnë, i cili, ndoshta, s'ka bërë asgjë, një njeri i pafajshëm, të cilin e ka pllakosur fatkeqësia për shkak të emrit tënd, një njeri, mbi të cilin emri yt rëndon si ndonjë krim, të cilin do ta marrin për ty, do të dënohet, do t'i ngrysë ditët në mes të mynxyrës dhe të llahtarës! Të lumtë! Ji njeri i ndershëm, ti. Qëndro zoti kryetar, qëndro i ndershëm e i nderuar, pasuro qytetin, ushqe të vobektët, rrit jetimë, jeto i lumtur, i virtutshëm

dhe i admiruar, dhe në këtë kohë, ndërsa ti do të jesh në mes të gëzimit dhe të dritës, një tjetërkush do të mbajë setrën tënde të kuqe, do të mbajë emrin tënd në llumin e turpit dhe do të heqë branë vargonjtë e tu në burg! Po, bukur e paske ujdishur punën kështu! Ah, ore i mjerë!

Djersa po i kullonte ballit. U kishte ngulur atyre shandanëve një vështrim të çakërdisur. Ndërkohë, zëri që fliste brenda tij, nuk kishte mbaruar akoma së foluri. Ai zë vazhdonte:

-Zhan Valzhan! Rreth teje do të ketë shumë zëra që do të bëjnë zhurmë të madhe, që do të flasin fort dhe që do të të bekojnë. Por do të ketë edhe një zë, një zë të vetëm, që askush nuk do ta dëgjojë dhe që do të të mallkojë nëpër terre. E pra! Mbaj vesh këtu, o i poshtër! Të gjitha ato bekime do të shemben përpara se të kenë arritur në qiell dhe vetëm mallkimi do të jetë ai që do të ngjitet gjer te Zoti!

Ky zë, në fillim fare i dobët dhe i dalë nga skutat më të errëta të ndërgjegjes së tij, ishte bërë pak nga pak kumbues dhe i hatashëm, dhe ai e dëgjonte tani mu te veshi. I dukej sikur kishte dalë nga vetja e vet dhe sikur tani po fliste jashtë tij. Iu bë sikur fjalët e fundit i dëgjoji aq shkoqur, sa hodhi sytë e vështroi nëpër dhomë, i pushtuar nga njëfarë tmerri.

-Mos ka njeri këtu? - pyeti ai me zë të lartë, fare i çakërdisur.

Më pas ai filloi me një të qeshur që i përngjiste të qeshurit të një teveqeli.

-Sa hajvan paskam qenë! Këtu s'ka si të ketë njeri.

I vendosi shandanët mbi oxhak.

Atëherë ai e filloi përsëri atë ecjen monotone dhe të përzishme, e cila ia turbullonte ëndrrat dhe e zgjonte me të brofur njeriun e përgjumur në katin poshtë.

Kjo ecje sikur e lehtësonte dhe njëkohësisht e dehte Zhan Valzhanin. Duket se, ngandonjëherë, në çaste të epërme, njeriu lëviz për t'u këshilluar me gjithçka që mund të takojë, duke u zhvendosur andej-këtej. Si kaluan edhe disa çaste, ai nuk dinte më fare se ku ishte.

Tani ai po zmbropsej i llahtarisur njëlloj përpara të dyja vendimeve që kishte marrë njërin pas tjetrit. Të dyja idetë që i

jepnin këshilla, i dukeshin të kobshme, si njëra, ashtu edhe tjetra. Çfarë fataliteti! Çfarë rastësie paskësh qenë edhe ky Shamati, që merrej për Zhan Valzhan! Të vesh e të gremisesh në hon pikërisht po nga ajo dorë të cilën providenca dukej në fillim se ia kishte ngjitur për ta mëkëmbur!

Pati një çast kur ai shqyrtoi të ardhmen. Të vesh, o Zot i madh, e të shfaqesh! Të dorëzohesh! Me një dëshpërim të pafund, ai solli para syve të gjitha ato që duhej të braktiste, të gjitha ato që duhej t'i niste nga fillimi. I duhej thënë, pra, lamtumirë kësaj jetese kaq të mirë, kaq të pastër, kaq të ndritur, atij respekti që i shprehnin të gjithë, nderit, lirisë! Nuk do të shkonte më të shëtiste arave, nuk do të dëgjonte më zogjtë të këndonin në maj, nuk do t'u jepte më lëmoshë fëmijëve të vegjël! Nuk do ta ndiente më ëmbëlsinë e vështrimeve plot mirënjohje dhe dashuri që derdheshin mbi të! Ai do ta braktiste atë shtëpi që e kishte ndërtuar me dorën e vet, atë dhomë, atë dhomëz të vogël! Tani çdo gjë i dukej plot bukuri mahnitëse. Nuk do të lexonte më në ata libra, nuk do të shkruante më mbi atë tryezë prej druri të bardhë! Portierja e tij e vjetër, e vetmja shërbyese që kishte, nuk do t'ia ngjiste kafenë mëngjesëve. O Zot i madh! Në vend të këtyre, burgu, prangat, setra e kuqe, gjylet në këmbë, lodhja, biruca, shtrati i kampit, të gjitha ato gjëra të llahtarshme që i kishte njohur njëherë e një kohë! Dhe në atë moshë, pasi kishte qenë ai që ishte! Të paktën të qe i ri! Por, duke qenë plak njeri, të të flasë pa pikë respekti kush të dojë e kush të mundë, të të kontrollojë gardiani, të të shqepë në dru xhandari i rojës! T'i kesh këmbët lakuriq, të mbathura në këpucë me gozhdë! T'ia zgjatësh këmbën mëngjes e mbrëmje çekanit të rojes që kontrollon prangat! T'i nënshtrohesh kureshtjes së të huajve, të cilëve do t'u thonë: "Ai atje është Zhan Valzhani, me famë, që ka qenë kryetar bashkie në Montrëj-syr-Mer!" Dhe në mbrëmje, qull në djersë, i rraskapitur nga lodhja, me kësulën e gjelbër mbi sy, të ngjitesh dy nga dy, nën kamxhikun e rreshterit, shkallëve të drunjta të burgut lundruer! Oh, çfarë mjerimi! A mund të jetë vallë fati shpirtkeq si ndonjë qenie me mend dhe të bëhet i përbindshëm si zemra e njeriut!

Dhe, ngado që t'ia mbante, ai binte përsëri në atë dilemën therëse, që qëndronte thellë në mendjen e tij: të qëndrosh në parajsë, dhe aty të bëhesh demon! të hysh në skëterrë, dhe aty brenda të bëhesh engjëll!

Ç'të bënte, o Zot i madh, ç'të bënte!

Stuhia, nga e cila kishte dalë me aq mundime, shpërtheu përsëri brenda tij. Idetë filluan t'i përziheshin. Ato morën nuk di se çfarë sajimi të hutuar e mekanik, që është tipari i dëshpërimit. Ai emri i Romënvilit i vërtitej pareshtur në mendje tok me dy vargje të një kënge që e kishte dëgjuar njëherë e një kohë. Ai sillte në mend se Romënvili është një pyll i vogël afër Parisit, ku dashnorët e rinj shkojnë e mbledhin zambakë në prill.

Ai lëkundej si jashtë, ashtu edhe brenda. Ecte si ai fëmija i vogël që e kanë lënë të çapitet vetëm.

Kohë më kohë, duke luftuar kundër rraskapitjes, bënte përpjekje për ta mbledhur përsëri mendjen. Rrekej t'ia shtronte vetes për herë të fundit dhe përfundimisht problemin mbi të cilin kishte rënë, si të thuash, i dërrmuar fuqish. Të shfaqem? Apo të hesht? Dhe nuk arrinte të shikonte asgjë qartë. Pamjet e vagëta të të gjitha arsytetimeve të përvijuara nga ëndërrimi i tij luhateshin dhe shkriheshin njëri pas tjetrit si tymi. Veçse ai ndiente që, cilëndo anë që të merrte e të vendoste, patjetër që diçka nga vetja nuk do të shpëtonte dot pa vdekur; që ai hynte në një varr si në të majtë, ashtu edhe në të djathtë; që ai po hiqte një agoni; agoninë e lumturisë së tij ose agoninë e virtytit të tij.

Vaj medet! Të gjitha këto pavendosmëria e kishin pushtuar përsëri. Ai s'kishte bërë asnjë hap përpara dhe ishte po atje ku e kishte nisur.

Format që merr vuajtja gjatë gjumit

Sapo kishte tingëlluar ora tre e mëngjesit, dhe po bëheshin pesë orë që ai ecte ashtu, pothuajse pareshtur, kur vajti e u lëshua mbi karrige.

Aty e zuri gjumi dhe pa një ëndërr.

Kjo ëndërr, si shumica e ëndrrave, lidhej me gjendjen e tij vetëm me një nuk di se ç'gjë të kobshme dhe therëse, por i bëri përshtypje. Kjo ëndërr e keqe e tronditi aq shumë, sa më vonë edhe e shkroi. Është një nga shkresat që e ka hartuar me dorën e vet dhe e ka lënë. Besojmë se e kemi për detyrë që ta sjellim këtu fjalë për fjalë.

Sidoqë të jetë kjo ëndërr, historia e asaj nate nuk do të ishte e plotë, po ta linim mënjanë. Ajo është aventura e zymtë e një shpirti të sëmurë.

Ja shkresa. Mbi zarf gjejmë këtë rresht të shkruar: "Ëndrra që kam parë asaj nate.

"Isha në një fushë. Fushë e gjerë dhe e zymtë, ku nuk kishte asnjë fije bari. Nuk më dukej as se bënte ditë, as se bënte natë.

"Po shëtitja me tim vëlla, me vëllanë e viteve të fëmijërisë, me vëllanë, që, duhet të them, nuk e kujtoj kurrë dhe që nuk e sjell pothuajse fare ndër mend.

"Bisedonim dhe takonim udhëtarë. E kishim fjalën për një fqinj që e kemi pasur dikur dhe që, qysh prej kohës kur banonte buzë rrugës, punonte gjithmonë me dritare të hapur. Teksa bisedonim, kishim ftohtë, për shkak të asaj dritareje që rrinte gjithmonë e hapur.

"Në fushë s'kishte drurë.

"Pamë një njeri që na kaloi pranë. Ai ishte krejt lakuriq, ngjyrë hiri, hipur mbi një kalë ngjyrë dheu. Flokë s'kishte fare; mund t'ia shikoje kafkën me sy dhe mbi kafkë mund t'i dalloje rrembat e gjakut. Mbante në dorë një thupër, e cila ishte e

përkulshme si një bisk hardhie dhe e rëndë si hekuri. Ky kalorës na kaloi pranë dhe s'na foli me gojë.

"Im vëlla më tha: "Të marrim udhën e thellë."

"Aty kishte vërtet një udhë të thellë, ku s'të zinte syri asnjë gjurmë shkurreje dhe asnjë fije myshku. Gjithçka ishte ngjyrë dheu, edhe vetë qielli. Pas disa hapash, nuk m'u përgjigj njeri kur fola. Vura re se im vëlla nuk ishte më me mua.

"Pashë një fshat dhe hyra në të. Ëndërrova sikur ky fshat ishte Romënvili (pse vallë Romënvili? ")

"Rruga e parë ku hyra, ishte e shkretë. Hyra në një rrugë të dytë. Prapa qoshes që formonin të dyja rrugët, ishte një njeri që qëndronte në këmbë pas murit. I thashë këtij njeriu: "Cili është ky fshat? Ku jam kështu?" Njeriu nuk u përgjigj. Pashë portën e hapur të një shtëpie dhe hyra brenda.

"Dhoma e parë ishte e shkretë. Hyra në të dytën. Prapa derës së kësaj dhome ishte një njeri që qëndronte në këmbë pas murit. E pyeta këtë njeri: "E kujt është kjo shtëpi? Ku jam kështu?" Njeriu nuk u përgjigj. Shtëpia kishte një kopsht.

"Dola nga shtëpia dhe hyra në kopsht. Kopshti ishte i shkretë. Prapa pemës së parë, gjeta një njeri që po qëndronte në këmbë. I thashë këtij njeriu: "Ç'është ky kopsht? Ku jam kështu?". Njeriu nuk u përgjigj.

"Po endesha nëpër fshat dhe pashë se ky fshat ishte një qytet. Të gjitha rrugët ishin të shkreta, të gjitha portat ishin të hapura. Asnjëri i gjallë nuk kalonte rrugëve, nuk ecte dhomave, as nuk shëtiste kopshteve. Por prapa çdo qosheje muri, prapa çdo porte, prapa çdo peme, ishte një njeri që qëndronte në këmbë dhe heshtte. Asnjëherë nuk mund të shihje më shumë se një njeri të vetëm. Këta njerëz më vështronin tek kaloja.

"Dola nga qyteti dhe fillova të ecja nëpër ara.

"Pas njëfarë kohe, u ktheva dhe pashë një mori të madhe njerëzish që po vinin pas meje. I njoha të gjithë njerëzit që kisha parë në qytet. Ata kishin ca koka të çuditshme. Dukej se ata nuk nguteshin, e, megjithatë, ecnin më shpejt se unë. Duke

^{*)} Kjo kllapë ishte nga dora e Zhan Valzhanit.

ecur, nuk bënin asnjë zhurmë. Në një çast, kjo turmë më arriti dhe më rrethoi. Fytyrat e këtyre njerëzve ishin ngjyrë dheu.

"Atëherë, ai i pari, që e kisha parë dhe pyetur kur hyra në qytet, më tha: "Ku po shkoni kështu? A nuk e dini që keni vdekur që prej shumë kohësh?"

"Hapa gojën për t'iu përgjigjur dhe pashë se s'kishte njeri rreth meje".

Ai u zgjua nga gjumi. Kishte ngrirë e ishte bërë kallkan. Një erë, e ftohtë si era e mëngjesit, vërtiste mbi mentesha kanatet e dritares, që kishte mbetur e hapur. Zjarri ishte shuar. Qiriu ishte në të mbaruar, ishte akoma natë e errët.

U ngrit dhe vajti te dritarja. Në qiell vazhdonte të mos kishte yje.

Nga dritarja e tij shikojë oborrin e shtëpisë dhe rrugën. Një zhurmë e thatë dhe e fortë, që tingëlloi papritmas mbi truall, e bëri të hidhte sytë poshtë.

Ai pa nën vete dy yje të kuqe, rrezet e të cilave zgjateshin e shkurtoheshin në mënyrë të çuditshme në errësirë.

Meqë mendjen e kishte akoma të kredhur në mjegullën e ëndrrave:

-Pa dale! - mendoi ai, - këso yjesh nuk ka në qiell. Ato tani janë mbi tokë.

Por, ndërkohë, kjo turbullirë u qartësua, një zhurmë e dytë, e njëjtë me atë të parën, e zgjoi fare; vështroi dhe pa se ato dy yjet ishin fenerët e një karroce. Nga drita që lëshonin, ai mundi të shquante formën e asaj karroce. Ishte një tilburi e mbrehur me një kalë të vogël, të bardhë. Zhurma që kishte dëgjuar, ishin të trokiturat e këmbëve të kalit mbi kalldrëm.

"Ç'qenka kjo karrocë? - tha me vete. - Kush ardhka kështu kaq herët?"

Në këtë çast, dikush trokiti lehtë te dera e dhomës së tij.

U rrëqeth i tëri nga koka gjer te këmbët dhe bërtiti me zë të tromaksur:

-Kush është aty?

Dikush u përgjigj:

-Jam unë, zoti kryetar.

Ai njohu zërin e plakës, portieres së tij.

-E pra, - vazhdoi ai, - ç'është?

-Zoti kryetar, këtë çast ora është plot pesë e mëngjesit.

-E ç'më hyn në punë kjo mua?

-Zoti kryetar, erdhi karroca.

-Cila karrocë?

-Tilburia.

-Cila tilburi?

-Po a nuk kërkoi zotëria e tij, kryetari, një tilburi?

-Jo, - tha ai.

-Karrocieri thotë se ka ardhur të marrë zotin kryetar.

-Cili karrocieri?

-Karrocieri i zotit Skofler.

-Zoti Skofler?

Ky emër e bëri të rrëqethej, sikur t'i kishte kaluar ndonjë vetëtimë përpara fytyrës.

-Ah, po! - vazhdoi ai, - zoti Skofler.

Po ta kishte parë plaka atë çast, asaj do t'i kishte hyrë tmerri.

U bë një heshtje mjaft e gjatë. Ai po këqyrte si i shastisur flakën e qiriut dhe merrte rreth fitilit dyllë të nxehtë, të cilin e rrotullonte nëpër gishta. Plaka po priste. Megjithatë, ajo e kuturisi dhe e ngriti zërin më fort.

-Zoti kryetar, çfarë përgjigje duhet t'i kthej?

-Thuajini mirë, tani po zbres poshtë.

IV

Gjalma nëpër këmbë

Asokohe, shërbimi i postave nga Arrasi në Montrëj-syr-Mer kryhej akoma me karroca të vogla të kohës së Perandorisë. Këto karroca quheshin kabrioleta, ishin me dy rrota, përbrenda të veshura me lëkurë të kuqërremtë dhe të mbajtura peshë mbi disa susta me pompë. Ato kishin vetëm dy vende, një për

karrocierin dhe tjetrin për udhëtarin. Rrotat ishin të armatosura me ca boshte të gjata, të cilat i detyrojnë karrocet e tjera të ruajnë largësinë. Këso rrotash mund të shohësh edhe sot e kësaj dite udhëve të Gjermanisë. Arka e letrave, një kuti e stërmadhe gjatoshë, ishte vendosur prapa kabrioletës dhe bënte një trup të vetëm me të. Arka ishte e ngjyrosur me të zezë, kurse kabrioleta me të verdhë.

Këto mjete mbartëse, të cilave asgjë s'u përngjet më në ditët e sotme, kishin nuk di se ç'gjë të shëmtuar dhe gungaçe. Dhe, kur i shikoje së largu të kalonin e të rrëshqitnin në ndonjë udhë në horizont, ato u përngjishnin atyre insekteve që u thonë, besoj, thnegla të bardha, të cilat, megjithëse kanë një parzëm të vogël, tërheqin prapa një bisht shumë të madh. Por, sidoqoftë, ato ecnin shumë shpejt. Posta që nisej nga Arrasi çdo natë në orën një, pasi kalonte postën e Parisit, arrinte në Montrëj-syr-Mer pakëz përpara orës pesë të mëngjesit.

Asaj nate, karroca e postës që po zbriste në Montrëj-syr-Mer nga udha e Hesdenit, në kthesën e një rruge, në çastin kur po hynte në qytet, ndeshi me një tilburi të vogël me një kalë të bardhë që po vinte në drejtim të kundërt. Tilburia kishte vetëm një njeri, një burrë të mbështjellë me një manto. Rrota e tilburisë hëngri një të goditur mjaft të fortë. Postari i thirri burrit që të ndalej, por udhëtari s'ia vuri veshin dhe vazhdoi udhën e tij me revan të shpejtë.

-Sa me ngut e paska punën! - tha postari.

Njeriu që ngutej asisoj, është po ai që sapo e pamë të jepte e të merrte mes ca përpëlitjesh, që me siguri janë për t'u mëshiruar.

Ku po shkonte ashtu? As ai vetë s'mund ta thoshte. Përse po nxitonte aq shumë? As vetë s'e dinte. Ai shkonte përpara kuturu. Ku? Në Arras, pa dyshim; por ndoshta shkonte edhe gjetkë. Hope-hope ai e ndiente këtë gjë dhe rrëqethej i tëri.

Udhëtari zhytej në terrin e asaj nate si në ndonjë humnerë. Diçka e shtynte, diçka e tërhiqte. Se ç'po ngjiste brenda tij, këtë askush nuk mund ta thoshte. Cili është ai burrë që s'ka hyrë, qoftë edhe një herë të vetme, në këtë shpellë të errët të së panjohurës?

Fundi i fundit, ai s'e kishte ndarë mendjen për asgjë, s'kishte vendosur asgjë, s'kishte përfunduar asgjë. Asnjë nga veprimet e ndërgjegjes së tij s'kishte qenë përfundimtare. Tani ishte më shumë se kurrë tamam siç ishte në çastin e parë.

Përse po shkonte në Arras?

Përsëriste me vete të gjitha ato sa kishte thënë më parë, kur zuri me qira kabrioletën e Skoflerit, se cilido që të ishte përfundimi, nuk kishte asgjë të keqe sikur të shikonte me sytë e vet, t'i gjykonte gjërat vetë; se kjo ishte bile një punë e urtë, se duhej të dinte se çfarë do të ngjiste, se s'mund të vendoste asgjë, pa shqyrtuar dhe gërmuar: se, kur i shikon gjërat nga larg, të duken të gjitha si mal; se, në fund të fundit, kur ta shihte me sy atë Shamatjën, ndonjë palo burrë, ndërgjegjja e tij ndoshta do të qetësohej që po e linte të shkonte në burg në vendin e tij: se, në të vërtetë, atje do të ishin edhe Zhaveri, edhe ai Breveti, edhe ai Shënildjëi, edhe ai Koshëpaji, ish - të burgosur, që e kishin njohur prej kohësh; porse, me siguri, si një e një që bëjnë dy, ata nuk do ta njihnin fare; bah! Çfarë ideje! se Zhaveri ishte njëqind hostenë larg së vërtetës; se të gjitha rrethanat dhe të gjitha hamendjet ishin ngulur mbi atë Shamatjën, dhe s'ka gjë më kryeneçe se hamendjet dhe rrethanat; se, kësisoj, në këtë mes, nuk kishte asnjë rrezik.

Se pa dyshim ky ishte një çast i errët, porse do ta hidhte edhe këtë lumë; se, tek e mbramja, fatin e kishte në dorë, sado i keq që të ishte; se ai ishte zot i fatit. Ai kapej e kacavirrej pas këtij mendimi.

Pra, po të flasim me zemër të hapur, ai do të kishte dashur më mirë të mos shkonte fare në Arras.

E megjithatë, ai atje se atje po vente.

Ndërsa mendonte këto gjëra, ai i binte kalit me kamxhik, dhe kali ngiste revan, me atë revanin e mirë, të rregullt dhe të sigurt, që bën dy lega e gjysmë në orë. Sa më shumë bënte përpara kabrioleta, aq më shumë ndiente se diçka po e shtynte të zmbrajsej.

Kur agoi dita, ai ndodhej në fushë të hapët; qyteti i Montrëj-syr-Merit ishte shumë larg prapa tij. Ai vështroi horizontin, që po zbardhëllonte; vështroi, pa i parë, tek kalonin

përpara syve të tij, të gjitha figurat e ftohta të një agimi dimëror. Edhe mëngjesi ka hijet e veta, ashtu si mbrëmja. Ai nuk i shikonte, por, pa e kuptuar as vetë dhe me anën e një depërtimi pothuajse fizik, ato hije të zeza pemësh e grigjesh i shtonin gjendjes së rëndë të shpirtit të tij nuk di se ç'gjë të zymtë dhe të kobshme.

Sa herë që kalonte përpara ndonjërës prej atyre shtëpive të vetmuara që ndodhen buzë rrugëve, ai thoshte me vete: "E, megjithatë, aty ka njerëz që flenë!"

Revani i kalit, zilkat e pajimeve, rrotat mbi kalldrëm bënin një zhurmë të ëmbël dhe monotone. Këto gjëra janë shumë të këndshme kur njeriu është i gëzuar dhe kobzeza kur njeriu është i trishtuar.

Ishte gdhirë fare kur arriti në Hesden. U ndal përpara një hani, që ta linte kalin të merrte pak frymë dhe të hante pak sanë.

Ky kalë ishte, ashtu siç pati thënë Skofleri, nga një racë e vogël e Bulonesë, që ka kokë të madhe me tepri, bark me tepri dhe bel të pamjaftueshëm, por që ka gjoks të gjerë, vithe dyshek, kofshë të thatë, por të thantë dhe thundër të fortë; racë e shëmtuar nga të pamët, por dërdënge dhe e shëndoshë. Ajo kafshë e shkëlqyer kishte bërë pesë lega në dy orë dhe nuk kishte asnjë pikë djerse mbi vithe.

Ai nuk kishte zbritur nga tilburia. Shërbyesi i stallës, që po sillte sanën, u përkul befas dhe këqyri rrotën e majtë.

-Keni për të bërë udhë të largët kështu? - tha shërbyesi.

Ai u përgjigj, pothuajse pa u shkëputur nga ëndërrimi:

-Pse?

-Nga larg vini kështu?

-Pesë lega larg prej këtej.

-Ah!

-Pse po bëni, ah!

Shërbyesi u përkul përsëri, qëndroi një çast i heshtur, me sy të ngulur te rrota, pastaj u ngrit dhe tha:

-Bëj ah! se kjo rrotë që ka bërë pesë lega, edhe mund t'i ketë bërë, për këtë s'e vë dorën në zjarr, por, ashtu si ka katandisur tani, jam i sigurt që nuk do të bëjë asnjë çerek lege.

Ai kërceu poshtë nga tilburia.

-Ç'po thoni kështu, miku im?

-Them se është një mrekulli që keni bërë pesë lega, pa u rrokullisur ju bashkë me kalin tuaj në ndonjë hendek të xhadesë. Por më mirë shikojeni vetë.

Me të vërtetë, rrota ishte dëmtuar rëndë. Përplasja e karrocës postare kishte çarë dy rreze të rrotës dhe kishte bluar boshtin, kllapa e të cilit s'mbante më.

-O mik, - i tha ai shërbyesit të stallës, - a ka ndonjë karrondreqës këtu?

-Pa dyshim që ka, zotëri.

-Bëmëni një shërbim; shkoni e ma thërritni pak.

-Ja, këtu e kemi, dy hapa larg. Hej! Usta Burgajard!

Usta Burgajardi, karrondreqësi, ishte te pragu i portës së vet. Erdhi e këqyri rrotën dhe e rrudhi fytyrën, si ai kirurgu që sheh ndonjë këmbë të thyer.

-A mund ta meremetoni në çast këtë rrotë?

-Po, zotëri.

-Kur do të mund të nisem për udhë?

-Nesër.

-Nesër!

-Këtu ka një ditë të tërë punë. Ndoshta zotërinë tuaj s'e pret puna?

-S'më pret hiç. Duhet të nisem të shumtën pas një ore.

-E pamundur, zotëri.

-Paguaj sa të bëjë.

-E pamundur.

-Mirë, pra, pas dy ore.

-S'është e mundur për sot. Duhet bërë të reja dy rreze dhe një bosht. Zotëria juaj s'ka si niset përpara ditës së nesërme.

-Puna që kam, nuk mund të presë gjer nesër. Por sikur, në vend që ta meremetoni, të vinit një rrotë tjetër në vend të saj?

-E si u bëka kjo punë?

-A jeni karrondreqës?

-Pa dyshim, zotëri.

-Nuk keni ndonjë rrotë për të shitur? Kështu do të mund të nisesha menjëherë.

-Të këmbej rrotën?
 -Po.
 -S'kam ndonjë rrotë të gatshme për kabrioletën tuaj. Dy rrota bëjnë një palë. Dy rrota nuk shkojnë së bashku kot së koti.
 -Atëherë, shitmëni një palë rrota.
 -Zotëri, të gjitha rrotat nuk u shkojnë të gjitha boshteve.
 -Provojeni njëherë.
 -Është punë pa prokopi, zotëri. Unë vetëm rrota karrosh kam për të shitur. Jemi fshat i vogël këtu?
 -Mos do të kishit ndonjë kabrioletë me qira?
 Ustai karrondreqës, që qysh me syrin e parë e kishte pikasur që tilburia ishte nga ato karroca që lëshohen me qira, ngriti supet.
 -I rregulluakeni paq kabrioletat që merrni me qira! Edhe sikur të kisha, unë nuk do t'ju lëshoja.
 -Po mirë, ma shitni njëherë.
 -S'kam.
 -Çfarë! As ndonjë kariolë? Siç e shihni edhe vetë, unë s'bëj shumë naze.
 -Jemi fshat i vogël. Vërtet, kam atje nën strehë, - shtoi karrondreqësi, - një kaloshinë të vjetër të një borgjezi të qytetit, që ma ka lënë t'ia ruaj dhe që e përdor në çdo lëmë duhani. Me gjithë qejf do t'jua lëshoja, se ç'më kushton mua? Por nuk duhet që ta shohë borgjezi kur të kalojë; dhe pastaj, ajo është kaloshinë e do dy kuaj.
 -Do të marr kuaj ndërrimi.
 -Ku udhë e mbarë zotëria juaj?
 -Në Arras.
 -Dhe zotëria juaj don të arrijë sot?
 -Posi.
 -Duke marrë kuaj ndërrimi?
 -E pse jo?
 -A ju prish punë, zotëri, sikur të arrini në orën katër të mëngjesit?
 -Po, me siguri që më prish.
 -Është puna se, ju e kuptoni mirë, e kam fjalën se, po të

merrni kuaj ndërrimi... - A ka pasaportë zotëria juaj?

-Po.

-E pra, po të marrë kuaj ndërrimi, zotëria juaj nuk do të arrijë dot në Arras para ditës së nesërme. Këtu jemi në rrugën më të shkurtër. Pikat e ndërrimit nuk shërbejnë mirë, kuajt janë fushave. Tani fillon stina e lëvrimeve me damalukë të mëdhenj dhe duhen kafshë tërheqëse të forta, kështu që njerëzit i marrin kuajt nga janë e nga s'janë, në postat e ndërrimit e kudo gjetkë. Zotëria juaj do të presë tri a katër orë në çdo postë. Pastaj, këtyre anëve kali ecën me hap. Ka shumë të përpjeta për të ngjitur.

-Atëherë pra, do të vete me kalë. Çmbrejeni kabrioletën. Dikush do të më shesë ndonjë shalë kali këtu, në fshat.

-S'ka dyshim. Por ky kalë a e mban dot shalën?

-Ashtu është, mirë që ma kujtuat. Ai s'duron dot shalë.

-Atëherë...

-Por a do të gjej dot në fshat ndonjë kalë me qira?

-Një kalë për të vajtur gjer në Arras me një frymë?

-Po.

-Do t'ju duhej një kalë që s'ke ku e gjen këtyre anëve tona. Së pari, duhet ta blini, sepse s'ju njeh njeri. Por as për ta blerë, as me qira, as për pesëqind franga, as për një mijë, nuk do të gjeni dot!

-Si t'ia bëjmë?

-Ta them me zemër të hapur që e mira e të mirave është ta shtyni udhëtimin tuaj për nesër.

-Nesër do të jetë tepër vonë.

-Sa keq!

-A ka karrocë poste që vete për në Arras? Kur kalon ajo?

-Nesër mbrëma. Të dyja karrocet e bëjnë shërbimin natën, edhe ajo që bën përpjetë, edhe ajo që bën poshtë.

-Si kështu! Ju duhet një ditë për të meremetuar këtë rrotë?

-Një ditë, dhe të mirë bile!

-Edhe duke vënë dy punëtorë?

-Edhe dhjetë sikur të vë!

-Po sikur t'i lidhnim rrezet me ca litarë?

-Rrezet, po; por boshtin, jo. Pastaj, edhe koka e rrotës është në gjendje të keqe.

-A ka njeri që të lëshojë karroca me qira këtu në qytet?

-Jo.

-A ka ndonjë karrondreqës tjetër?

Shërbyesi i stallës dhe karrondreqësi u përgjigjën njëkohësisht duke tundur kokën.

-Jo.

Ai ndjeu një gëzim shumë të madh.

Dukej sheshit se zoti i fatit po vinte gisht në këtë punë. Vetë zoti i fatit e kishte thyer rrotën e tilburisë dhe po e ndalte në udhë e sipër. Ai nuk i ishte dorëzuar këtij paralajmërimi të parë; i kishte bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të vazhduar udhëtimin e tij; me ndërgjegje të plotë i kishte përdorur të gjitha mjetet që i kishin ardhur për dore; s'ishte zbrapsur as përpara stinës, as përpara lodhjes, as përpara shpenzimeve; nga kjo anë, ai s'mund ta qortonte veten për asgjë. Në qoftë se nuk shkonte dot më tutje, kjo ishte diçka që s'e kishte më në dorë ai vetë. S'ishte më për faj të tij; kjo ishte jo për shkak të ndërgjegjes së tij, se ai e kishte të larë, por për shkak të zotit e të fatit.

Mori frymë. Mori frymë lirisht me tërë kraharorin, për të parën herë që nga vizita e Zhaverit. I dukej sikur ajo dorë e hekurt që i shtrëngonte zemrën që prej njëzet orësh, sapo e kishte liruuar.

I dukej se tani zoti ishte me të dhe e kishte thënë fjalën e tij.

Ai tha me vete se s'kishte lënë kusur dhe se tani s'i mbetej tjetër veçse të kthehej qetë-qetë andej nga kishte ardhur.

Sikur biseda e tij me karrondreqësin të ishte zhvilluar në ndonjë dhomë të hanit, ajo nuk do të kishte pasur fare dëshmitarë, s'do ta kishte dëgjuar njeri, punët do të kishin mbetur me aq, dhe mbase ne nuk do të kishim përse të tregonim asnjë prej ngjarjeve që do të lexoni më poshtë; por kjo bisedë ishte bërë në rrugë. Çdo bisedë në rrugë përfton në mënyrë të pashmangshme një rreth. Gjenden gjithmonë njerëz që s'kërkojnë tjetër veçse të bëjnë sehir. Ndërsa ai po pyeste

karrondreqësin, disa njerëz që po kalonin lart e poshtë kishin qëndruar rreth tyre. Si kishte mbajtur vesh për disa minuta, një djalosh i ri, të cilin s'e kishte vënë re njeri, ishte shkëputur nga grupi duke ngarë vrap.

Në çastin kur udhëtari, pas atij çlirimi të brendshëm që treguam pakëz më parë, po ndante mendje të kthente udhë, ky djalosh po kthehej përsëri. Po vinte së bashku me një grua plakë.

-Zotëri, - tha gruaja, - im bir më thotë se paskeni qejf të merrni me qira një kabrioletë.

Kjo fjalë e thjeshtë, e shqiptuar nga një plakë, të cilën po e udhëhiqte një fëmijë, e bëri që t'i kullonin djersët çurg në bel. Atij iu bë sikur ajo dorë që e kishte çliruar, po shfaqej përsëri në terr prapa tij, gati që ta kapte përsëri.

Ai u përgjigj:

-Po, moj grua e mirë, kërkoj një kabrioletë me qira.

Dhe u ngut të shkonte:

-Por këtu në fshat nuk paska.

-Po si s'paska, - tha plaka.

-Ku kështu? - ia pati karrondreqësi.

-Në shtëpinë time, - ia ktheu plaka.

Ai u rrëqeth i tëri. Dora fatale e kishte mbërthyer përsëri.

Plaka na paskësh me të vërtetë nën një strehë njëfarë kariole të thurur me xunkth. Karrondreqësi dhe shërbyesi i stallës, të dëshpëruar që u shpëtoi dore udhëtari, ndërhyjnë.

Ishte një rrangallë që të fuste datën; ishte fare pa susta - dhe vërtet, sedilet ishin të varura përbrenda me rripa lëkure; ç'binte jashtë binte dhe brenda; rrotat ishin të ndryshkura dhe të ngrëna nga lagështia; ishte aty-aty me tilburinë - një karakatinë për ibret! Zotëria e tij nuk do të bënte mirë të hipte në të, etj., etj.

Të gjitha këto ishin të vërteta, por kjo rrangallë, kjo karakatinë, ajo farë gjëje, sidoqë të ishte, rrëkëllehej mbi dy rrotat e saj dhe në Arras mund të vente.

Pagoi sa i kërkuan, e la tilburinë të meremetohej te karrondreqësi, që ta gjente aty në të kthyer, e mbrehu kalin e

bardhë pas kariolës, hipi sipër dhe ia nisi përsëri udhës që po ndiqte që në pikë të mëngjesit.

Në çastin kur kariola u nis për udhë, ai pohoi me vete se disa çaste më parë kishte pasur njëfarë gëzimi, duke menduar se nuk do të shkonte atje për ku ishte nisur. Ai e këqyri këtë gëzim me njëfarë inati dhe iu duk pa kuptim. Pse po gëzohej që po kthehej prapa? Pastaj, në fund të fundit, ai këtë udhëtim po e bënte me kokë të tij. Askush nuk e shtrëngonte. Dhe, me siguri, nuk do të ndodhte asgjë veç asaj që ai vetë dëshironte.

Tek ishte duke dalë nga Hesdeni, dëgjoi një zë që po i thërriste: “Ndalni! Ndalni!” Ai e ndali kariolën me një lëvizje plot gjallëri dhe me një diçka si përpëlitje e fërgëllim, që i përngjante shpresës.

Ishte djali i vogël i plakës.

-Zotëri, - tha ai, - kariolën jua gjeta unë.

-E pastaj?

-S'më dhatë gjë.

Atij, që u jepte të gjithëve dhe e kishte gjithmonë qesen të zgjidhur, kjo kërkesë iu duk e tepruar dhe e urrejtshme.

-Ah! Ti paske qenë, mor qerrata? - tha ai, - S'të jap asnjë dysh!

I ra kalit me kamxhik dhe iku përsëri me revan të shpejtë.

Kishte humbur shumë kohë në Hesden dhe do të kishte dashur që ta kapte këtë kohë të humbur. Kali i vogël ishte i guximshëm dhe tërhiqte sa dy kuaj bashkë; por ishte shkurt; kishte rënë shi; rrugët ishin të këqija. Pastaj, nuk ishte më ajo tilburia e parë. Kariola ishte e fortë dhe shumë e rëndë. E, veç këtyre, kishte dhe shumë të përpjeta.

Iu deshën afro katër orë për të vajtur nga Hesdeni në Sen-Pol. Katër orë për pesë lega udhë.

Në Sen-Pol e çmbrehu kalin te hani i parë që gjeti dhe porositi që ta çonin kalin në haur. Ashtu siç i kishte dhënë fjalën Skoflerit, ai ndenji pranë grazhdit në kohën kur kali po hante. Bluante ndër mend gjëra të trishtuara dhe të ngatërruara.

Gruaja e hanxhiut hyri në stallë.

-Mos do të hajë drekë zotëria juaj?

-Pa shih, vërtet, - tha ai, - bile kam shumë uri.

I vajti pas kësaj gruaje me fytyrë të freskët e plot gaz. Ajo e përcolli në një sallë të ulët, ku kishte disa tryeza të mbuluara me mushama.

-Shpejtoni pakëz, - tha ai, - më duhet të nisem përsëri për udhë. S'kam nge të pres.

Një shërbyese trashamane flamande shtroi shpejt e shpejt tryezën. Ai e vështronte këtë vajzë me një ndjenjë mirëqenieje.

“Tani po e marr vesh se ç'kisha, - mendoj ai. - S'kisha ngrënë”.

I sollën për të ngrënë. Iu turr bukës, kafshoi një herë, pastaj e vendosi ngadalë mbi tryezë dhe s'e zuri më me dorë.

Një karrocier po hante bukë në një tryezë tjetër. I tha karrocierit:

-Pse buka e këtyre qenka kaq e hidhur?

Karrocieri ishte gjerman dhe nuk dëgjoi fare.

U kthye në stallë pranë kalit.

Një orë më vonë, ai e kishte lënë pas Sen-Polin dhe po drejtohej për në Tenkë, që mban vetëm pesë lega nga Arrasi.

Ç'bënte vallë ai gjatë kësaj copë udhe? Ç'mendonte? Ashtu siç bëri edhe në mëngjes, ai po shikonte tek kalonin drurët, pullazet prej kashte, arat e punuara dhe davaritjet e peizazhit, që shtrihet pas çdo bërryli të udhës. Kjo soditje ndonjëherë i mjafton shpirtit dhe e largon bile edhe nga mendimet. A ka gjë më prekëse e më të thellë sesa të shikosh një mijë sende për të parën dhe të fundit herë? Të udhëtosh, do të thotë të lindësh dhe të vdesësh në çdo çast. Ndoshta në trevën më të vogël të mendjes së tij, ai bënte krahasime midis këtyre horizonteve, që ndërroheshin, dhe jetës njerëzore. Të gjitha gjërat e jetës zhduken vazhdimisht përpara nesh. Errësimet e ndriçimet përzihen njëri me tjetrin; pas një drite verbuese, një eklipsi ti vështron, nxiton, zgjat duart për ta kapur atë që kalon; çdo ngjarje është një kthesë e udhës; dhe, papritur e pakujtuar, ja tek e sheh veten tënde plak. Ti ndien njëfarë tronditjeje, gjithçka është e zezë, ajgëton një portë të errët, ai kali i zymtë i jetës që të tërhiqte ndalet, dhe ti sheh dikë të mbështjellë me vello e të panjohur që çmbreh kalin në terr.

Po binte muzgu, kur disa fëmijë, që po dilnin nga shkolla,

e vështruan këtë udhëtar të hynte në Tenkë. Është e vërtetë që ishim në ditët e shkurtra të vitit. Ai nuk u ndal në Tenkë. Tek po dilte nga fshati, një punëtor rrugësh, që po mbathte udhën me gurë, ngriti kokën dhe tha:

-Ky kalë qenka lodhur e këputur fare.

Ç'është e vërteta, kafsha e shkretë e kishte prerë revanin dhe po ecte me hap.

-Mos vini gjë në Arras? - shtoi punëtori.

-Po.

-Po të ecni kështu, nuk do të arrini dot herët.

E ndali kalin dhe e pyeti punëtorin:

-Sa mban akoma që këtu Arrasi?

-Nja shtatë lega të mira.

-Si kështu? Libri i postës shënon vetëm pesë lega e një çerek.

-Ah! - vazhdoi kantonieri, - si nuk e ditkeni që udha është në meremetim e sipër? Do ta gjeni të ndërprerë një çerek ore prej këtu. S'ka si shkoni më larg.

-Vërtet?

-Do të merrni më të majtën udhën që çon në Karansi, do të hidhni lumin dhe, kur të jeni në Kamblen, do të ktheheni më të djathtë; aty është udha e Mon-Sen-Eluajt, që të shpie në Arras.

-Por po na zë nata dhe unë do të humbas udhën.

-Nuk jeni nga ky vend?

-Jo.

-Këtyre anëve ka vetëm udhë që i bien shkurt. Dëgjoni këtu, zotëri, - vazhdoi punëtori, - doni t'ju jap një këshillë? Kali juaj është i rraskapitur, kthehuni në Tenkë. Aty ka një han të mirë. Bini e flini aty. Shkoni nesër në Arras.

-Duhet të jem sonte atje.

-Atëherë ndryshon puna. Megjithatë, shkoni në atë han dhe merrni një kalë përforcimi. Çuni i kalit do t'ju përcjellë në udhën më të shkurtër.

Ndoqi këshillën e punëtorit, ktheu udhë dhe, pas një gjysmë ore të mirë, ai po kalonte po në atë vend, por me revan të shpejtë, me një kalë të mirë përforcimi. Një shërbyes stalle,

që quhej edhe karrocier poste, ishte ulur në ndenjësën e kariolës.

Megjithatë, ai po e ndiente se po humbiste kohë. Nata kishte rënë plotësisht.

I ranë shkurt. Udha erdh e t'u bë e llahtarshme. Kariola binte nga një varg në tjetrën. Ai i tha karrocierit të postës:

-Mbajeni gjithnjë me revan, se do t'ju jap dy bakshishe bashkë.

Pas një troshitjeje, u thye boshti i të mbrehurit.

-Zotëri, - tha postari, - ja dhe boshti i të mbrehurit na u thye. Tani as vetë s'e di se si do ta mbaj kalin, kjo rrugë është shumë e keqe natën; po të dëshironit të ktheheshit për të fjetur në Tenkë, nesër në mëngjes herët do të mund të arrinim në Arras.

Ai u përgjigj:

-A ke ndonjë copë litar dhe ndonjë thikë me vete?

-Po, zotëri.

Ai preu një degë nga një pemë dhe bëri soje një bosht për mbrehje.

Edhe kjo ishte një humbje tjetër kohe prej njëzet minutash; por tani u nisën kupthi.

Fusha ishte sterrë e zezë. Mjegullina të ulëta, të shkurtra të zeza zvarriteshin mbi kodrat dhe shkëputeshin prej tyre si tymra. Përmes reve kishte ca ndriçime të zbardhëllyera. Një erë e madhe, që vinte nga deti, bënte anekënd horizontit një zhurmë sikur dikush po lëvizte mobilje. Çdo gjë që të ajgëtonte syri, kishte një pamje të tmerrshme. Sa e sa gjëra rrëqethen nën këto ofshe të natës!

Të ftohtët po i hynte në palcë. Ai s'kishte ngrënë që një natë më parë. Sillte ndër mend vrapin e tij të mëparshëm, natën në fushën e madhe të Dinjës. Kishin kaluar tetë vjet; por i dukej sikur ishte dje.

Një sahat tingëlloi diku në një kambanore të largët. Ai e pyeti çunin:

-Sa do të jetë ora?

-Ora është shtatë, zotëri. Në Arras do të jemi në tetë. Na kanë mbetur vetëm tri lega.

Në këtë çast i erdhi për herë të parë ky mendim, dhe u çudit se si nuk i kishte shkuar më parë ndër mend: - Ndoshta tërë ky mundim që po bënte ishte i kotë; ai nuk e dinte orën e gjyqit; të paktën, të ishte informuar për orën; ishte punë e kotë të shkonte kështu përpara, pa e ditur nëse kjo do të vlente për diçka apo jo. Pastaj përvijoi disa llogaritje në mendjen e tij. Zakonisht seancat gjyqësore fillonin në orën nëntë të mëngjesit; ajo çështje nuk duhej të zgjaste shumë kohë; vjedhja e mollëve do të ishte një çështje shumë e shkurtër; më pas do të mbetej vetëm çështja e identitetit të të pandehurit - katër a pesë dëshmitarë, dhe avokatëve u mbetej fare pak gjë për të thënë; ai do të arrinte atëherë kur çdo gjë do të kishte marrë fund!

Postari u binte kuajve me kamxhik. Ata e kishin kaluar lumin dhe e kishin lënë prapa Mont-Sent-Eluanë.

Nata sa vinte e bëhej më e thellë.

V

Motra Semplis vihet në provë

Ndërkohë, në këto çaste, Fantina ishte tërë gëzim.

Kishte kaluar një natë shumë të keqe. Kishte kollë të llahtarshme, ethe të forta, kishte parë edhe ëndrra. Në mëngjes, kur e vizitoi mjeku, ajo ishte në kllapi. Ai dukej shumë i shqetësuar dhe kishte porositur që, me të ardhur zoti Madëlen, ta lajmëronin.

Gjithë mëngjesin ajo qëndroi e zymtë, foli pak, bëri pala në çarçafët duke murmuritur me zë të ulët disa shifra që dukeshin si llogaritje largësirash. Sytë i kishte të zgavruar, të mbërthyer dhe të palëvizur. Ata dukeshin gati të shuar, por pastaj, hope-hope, ndizeshin përsëri dhe llamburitnin si yje.

Sa herë që motra Semplis e pyeste se si e ndiente veten, ajo përgjigjej gjithmonë njësoj:

-Mirë. Desha të shihja zotin Madëlen.

Disa muaj të shkuar, në çastet kur Fantina sapo kishte

humbur cipën e fundit të nderit të saj, turpin e saj të fundit dhe gëzimin e saj të fundit, ajo ishte hija e vetes së saj; tani ajo ishte fantazma e vetes së saj. E keqja fizike e kishte plotësuar veprën e së keqes morale. Kjo krijesë njëzet e pesë vjeç e kishte ballin të rrudhur, faqet të lëshuara, flegrat të holluara, dhëmbët të rënë, ngjyrën të hirtë, qafën kockë e lëkurë, kockat e gjoksit të dala jashtë, gjymtyrët të telikosura, lëkurën ngjyrë dheu të vrrarë, dhe flokët e saj të verdhë bënë majë të përzier me flokë të thinjur. Sa keq! Si e sajon sakaq pleqërinë sëmundja e shkretë!

Në drekë mjeku erdhi përsëri, dha disa porosi, u informua nëse zoti kryetar ishte dukur në infermieri dhe tundi kokën.

Zoti Madëlen zakonisht vinte në orën tre për të parë të sëmurën. Meqenëse përpikmëria ishte një mirësi, ai ishte i përpiktë.

Aty nga ora dy e gjysmë, Fantina filloi e po shqetësohej. Brenda njëzet minutave, ajo e pyeti mbi dhjetë herë murgeshën: "Motra ime, sa është ora?"

Ra ora tre. Në tingullin e tretë, Fantina u ngrit ndenjurr; ajo, që mezi lëvizte në shtrat, bashkoi me njëfarë pushtimi përpëlitës të dyja duart e verdha e të thara kockë e lëkurë, dhe murgesha dëgjoi të dilte nga kraharori i saj një nga ato psherëtimat e thella, që duket sikur ngrejnë peshë diçka të lodhur e të dërrmuar. Pastaj Fantina u kthye dhe hodhi sytë nga dera.

Asnjëri s'hyri, dera s'u hap fare.

Ajo qëndroi kështu për një çerek ore, me sytë të mbërthyer te dera, pa lëvizur dhe duke mbajtur frymën. Motra nuk guxonte as t'i fliste. Sahati i kishës tingëlloi tre e një çerek. Fantina u lëshua e ra përsëri mbi jastëk.

S'foli dhe filloi përsëri të bënte pala me çarçafët.

Kaloi edhe një gjysmë ore, pastaj një orë. S'erdhi njeri. Sa herë që ora tingëllonte, Fantina çohet e vështronte nga ana e derës, pastaj binte përsëri.

Mund ta shikoje qartë mendimin e saj, por ajo nuk shqiptonte asnjë emër, nuk nxirrte asnjë ankim, nuk padiste asnjëri. Vetëm se kollitej me një zhurmë të zymtë.

Të thoshte mendja se diçka e errët ishte duke zbritur mbi të. Ishte fare e zbehtë dhe buzët i kishte të mavijosura. Hope-hope buzëqeshte.

Ora tingëlloi pesë. Atëherë motra e dëgjoji tek thoshte me zë shumë të ulët e të ëmbël:

-Por, gjersa unë nesër do të shkoj, ai s'bën mirë që nuk vjen sot!

Edhe vetë motra Semplis po çuditej me vonesën e zotit Madëlen.

Ndërkohë Fantina vështronte kubënë e shtratit të saj. Dukej sikur po kërkonte të sillte ndër mend diçka. Papritmas, ajo nisi të këndonte me një zë të dobët si dihatje. Murgesha mbajti vesh. Ja se çfarë këndonte Fantina:

*Do të blejmë gjëra, oh! për bukuri,
kur të shkoj qytetit me shoqet e mia.
Ç'qenka trëndafili lule për stoli,
por më t'ëmbël s'paska, s'paska se fëmija!*

*Pranë vatrës sime, virgjëra Mari
erdhi dje tek unë me fustan qëndisur
dhe më tha: "Merre, fshehur në pëqi,
vajzën që kërkove; ja, ta kam stolitur.
Rend drejt në qytet dhe pëlhurë bli,
penjë edhe gishtëz merr për t'ia qëndisur".*

*Do të blejmë gjëra, oh! për bukuri,
kur të shkoj qytetit me shoqet e mia.*

*Virgjërëz e shenjtë, pranë vatrës sime,
seç vura një djep tizgash zbukuruar.
Në më dhëntë zoti yj prej vetëtime,
As e ndërroj vajzën që më ke dhuruar.
-Ç'të bëj me pëlhurën, moj ti, zonja ime?
-Bëmi ca pajime vajzës së bekuar.*

Laje, moj, pëlhurën te lumi matanë

*dhe më bëj me të, se do t'ia vesh vashës,
një fustan të bukur me ca si gajtanë,
Do t'i qëndis vashës gjith'lulet e fushës.
-Zonjë, vajza shkoi; ç'të bëj, as më thua?
-Bëma, moj, qejfin dhe mbulomë mua!*

*Do të blejmë gjëra oh! për bukuri,
kur të shkoj qytetit me shoqet e mia,
Oh! Ky trëndafili lule për stoli,
por më t'ëmbël s'paska, s'paska s'e fëmija!*

Kjo këngë ishte një romancë e moçme djepi, me të cilën dikur ajo vinte në gjumë Kozetën e vogël. Kjo këngë s'i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend qysh prej pesë vjetësh që s'e kishte më vajzën me vete. Ajo e këndonte me një zë aq të trishtuar dhe me një melodi aq të ëmbël, sa i vinte për të qarë edhe një murgeshe. Motra, megjithëse e rrahur me gjëra të dhimbshme, ndjeu se i buloi një lot në sytë.

Ora ra gjashtë. Fantina u duk sikur nuk dëgjoji gjë. Dukej sikur s'po ia vinte më veshin asgjëje rreth saj.

Motra Semplis dërgoi një vajzë që shërbente te portierja e fabrikës të merrte vesh nëse ishte kthyer zoti kryetar dhe nëse do të ngjitej së shpejti në infermieri. Vajza u kthye pas disa minutash.

Fantina qëndronte gjithnjë e palëvizur dhe dukej se ishte përqendruar e tëra në mendimet e saj.

Shërbyesja i tregoi me zë shumë të ulët motrës Semplis se zoti kryetar ishte larguar atij mëngjesi para orës gjashtë me një tilburi të mbrehur me një kalë të vogël, të bardhë, me gjithë atë të ftohtë që bënte, se ishte nisur vetëm, pa marrë me vete as ndonjë karrocier, se s'e dinte njeri ç'udhë kishte marrë, se një palë thoshin që e kishin parë tek kishte bërë për nga udha e Arrasit, se disa të tjerë siguronin që e kishin takuar në udhën që çon për në Paris. Se, duke u larguar, kishte qenë si zakonisht shumë i butë dhe se portieres i kishte thënë vetëm që të mos e prisnin sonte natën.

Në kohën kur të dyja gratë, me shpinën kthyer shtratit të

Fantinës, po pëshpëritnin, motra duke pyetur dhe shërbyesja duke rrëfyer, Fantina, me atë gjallërinë e ethshme të disa sëmundjeve organike që gërshetojnë zhdërvjelltësinë e njeriut të shëndoshë me drobitjen e frikshme të atij që është në buzë të varrit, ishte ngritur në gjunjë mbi shtratin e vet, me dy grushtet mbërthyer e mbështetur mbi jastëk, kokën kaluar nëpër të çarën e perdeve, dhe po mbante vesh. Papritmas ajo bërtiti:

-Për zotin Madëlen po flisni ashtu? Pse po flisni kaq ulët? Ç'po bën ai? Pse nuk po vjen?

Zëri i saj ish aq i prerë dhe aq i ngjirur, sa të dyja gratë, kujtuan se ai ishte zë burri; u kthyen të frikësuara.

-Përgjigjuni, pra! - thirri Fantina.

Shërbyesja belbëzoi:

-Portierja më tha se ai nuk do të vinte dot sonte.

-Bija ime, - tha motra, - rrini e qetë dhe shtrihuni.

Fantina, pa ndërruar qëndrim, ia nisi përsëri me zë të lartë dhe me një theks njëkohësisht urdhërues e therës:

-S'do të mund të vijë? Pse kështu? Ju e dini arsyen. Po e pëshpëritnit aty midis jush. Dua ta di edhe unë.

Shërbyesja nxitoi e i tha në vesh murgeshës:

-Përgjigjuni se është i zënë me këshillin bashkiak.

Motra Semplis u skuq pakëz; shërbyesja i propozonte të thoshte një gënjeshtër. Nga ana tjetër, ajo e dinte mirë se, po t'ia thoshte të vërtetën së sëmurës, kjo do të ishte pa farë dyshimi sikur t'i jepte një goditje të tmerrshme, gjë që ishte e rëndë për gjendjen në të cilën ndodhej Fantina. Ky i kuq mbajti pak. Motra ngriti drejt Fantinës sytë e saj të qetë e të trishtuar dhe tha:

-Zoti kryetar ka shkuar.

Fantina brofi dhe u ul mbi thembra. Sytë i lëshuan shkëndija. Një gëzim i paparë rrezatoi mbi atë fytyrë të brejtur nga dhembja.

-Paska shkuar! - bërtiti ajo. - Ka vajtur të marrë Kozetën!

Pastaj zgjati të dyja duart nga qielli dhe gjithë fytyrën ia mbuloi një nur që s'rrëfeket. Buzët e saj po lëviznin; ajo po falej me zë të ulët.

Si mbaroi lutjen:

-Motërza ime, - tha ajo, - do të shtrihem me gjithë qejf, do të bëj si të më urdhërojnë; pak përpara u bëra e keqe; ju kërkoj ndjesë që fola me zë aq të lartë, është shumë keq të flasësh me zë të lartë, unë e di mirë, o motërza ime e mirë, por, siç e shikoni, tani unë jam shumë e kënaqur. Zoti i bekuar është i mirë, zoti Madëlen është i mirë; pa mendoni njëherë, ai ka vajtur të marrë Kozetën time të vogël në Monfermej.

U shtri përsëri e i ndihmoi murgeshës të rregullonte jastëkun.

-Bija ime, - tha motra, - përpiquni të pushoni tani dhe mos flisni më.

Fantina mori në duart e saj të lëmekura dorën e motrës, e cila vuante shumë tek i ndiente këtë djersë.

-Qenka nisur për të vajtur në Paris. Në të vërtetë, ai s'ka nevojë të kalojë nga Parisi. Monfermeji është pakëz në të majtë kur vjen. A ju kujtohet se si më thoshte dje, kur unë i flisja për Kozetën: "Së shpejti, së shpejti?" Do të më bëjë një surprizë. E dini? Më dha të nënshkruaja një letër për t'ua marrë Tenardieve. Ata s'do të kenë ç'të thonë, apo s'është kështu? Ata do ta dorëzojnë Kozetën. Gjersa hakun ua paguajnë. Njerëzit e pushtetit nuk do të lejojnë që Tenardietë ta mbajnë fëmijën, përderisa i paguajnë. Motra ime, mos më bëni me shenjë se s'duhet të flas. Jam shumë e lumtur, jam shumë mirë, s'më dhemb gjëkund fare, do ta shoh Kozetën, bile kam shumë uri për të ngrënë. Po bëhen afro pesë vjet që nuk e kam parë. Ju s'e merrni dot me mend se si ta këputin zemrën fëmijët! Pastaj, ajo do të jetë aq e urtë dhe e dashur, do ta shihni vetë! Sikur ta dinit se çfarë gishtash të vegjël ngjyrë trëndafil që ka! Së pari, ajo do të ketë duar shumë të bukura. Kur ishte motake, kishte ca doçka për të qeshur. Kështu! Ajo duhet të jetë shumë e madhe tani. I ka mbushur shtatë vjet plot. Është tamam zonjushë. Unë Kozetë i thërres, por atë e quajnë Eufrazia. Ja, sot në mëngjes, po vështroja ca pluhur që ishte mbi oxhak dhe më ishte mbushur mendja top se së shpejti do ta shikoja Kozetën. O Zot? Sa gabim i madh është të rrih kaq vjet pa e parë fëmijën tënd! Duhet t'i vësh gishtin kokës, se jeta nuk është e amshuar! Oh!

Sa njeri i mirë është ky zoti kryetar, që shkoi ta marrë! Me të vërtetë, po bën shumë ftohtë! A e mori të paktën mantelin? Nesër do të jetë këtu, apo jo? Nesër do të kemi festë. Nesër në mëngjes, o motërza ime, do të më kujtoni të vë atë kësulën që është me dantellë. Monfermeji është goxha fshat. Dikur e kam bërë në këmbë atë rrugë. M'u pat dukur udhë e gjatë shumë. Por karrocën e udhëtarëve shkojnë shumë shpejt! Nesër atë e kemi këtu tok me Kozetën. Sa mban që këtu në Monfermej?

Motra, që s'kishte fare haber nga largësitë, u përgjigj:

-Oh! Edhe unë besoj se nesër do të jetë këtu.

-Nesër! Nesër! - tha Fantina. - Do ta shoh Kozetën nesër! Pa shihni, moj motërza e mirë e zotit të bekuar, tani s'jam më e sëmurë. Jam si e çmendur. Po të më thoshte njeri të hidhja valle, unë do ta hidhja.

Po ta kishte parë ndokush nja një çerek ore më parë, nuk do të kishte marrë vesh gjë prej gjëje. Tani ajo ishte e tëra ngjyrë trëndafil, fliste me një zë të gjallë e të natyrshëm, i qeshte nuri. Hope-hope ajo qeshte duke folur me vete me zë të ulët. Gëzimi i nënës është pothuajse si gëzimi i fëmijës.

-Kështu pra, - ia nisi përsëri murgësja, - tani që jeni e lumtur, duhet të më bindeni; mos flisni më.

Fantina vuri kokën mbi jastëk dhe tha me gjysmë zëri:

-Po, shtrihu rri urtë, meqenëse së shpejti do të të vijë fëmija. Motra Semplis ka të drejtë. Gjithë sa janë këtu, kanë të drejtë.

Pastaj, pa lëvizur, pa e luajtur kokën, ajo filloi të vështronte gjithandej me ata sytë e saj të hapur fort, me një pamje të gëzuar, dhe nuk foli më asgjë.

Motra mbylli perdet e shtratit, duke shpresuar se ajo do të tulatej.

Midis orës shtatë dhe tetë erdhi mjeku. Meqë s'dëgjoi asnjë zhurmë, ai kujtoi se Fantina po flinte, hyri ngadalë dhe iu afrua shtratit në majë të gishtave. Hapi pakëz perden dhe në dritën e kandilit pa sytë e mëdhenj e të qetë të Fantinës, që po e vështronin.

Ajo i tha mjekut:

-Zotëri, si thoni ju, a do të ma lini ta vë të flejë pranë meje në një shtrat të vogël?

Mjeku kujtoi se ajo ishte duke folur përçart. Fantina shtoi:

-Pa shikoni njëherë, edhe vendi është tamam.

Mjeku e mori mënjanë motrën Semplis, e cila i tregoi se si qëndronte puna, se zoti Madëlen do të mungonte për një ditë a dy dhe se nuk u ishte dukur e udhës ta zhgënjenin të sëmurën, e cila besonte se zoti kryetar kishte shkuar për në Monfermej; se, fundi, kishte të ngjarë që ajo t'i kishte rënë në të. Mjeku e aprovoi.

Ai iu afrua shtratit të Fantinës, e cila nisi përsëri:

-Është puna se, siç mund ta kuptoni, mëngjeseve, kur zgjohet, do t'i them mirëmëngjes asaj qenushes së vogël, dhe natën, meqenëse unë nuk vë gjumë në sy, do ta dëgjoj kur të flejë. Frymëmarrja e saj aq e ëmbël do të më bëjë mirë.

-Ma jepni dorën, - tha mjeku.

Ajo zgjati dorën dhe bërtiti duke qeshur:

-Ah! Shih! Shih! S'e kisha mendjen fare, është e vërtetë, ju s'e dini si qëndron puna! Puna është se unë jam shëruar. Kozeta arrin nesër.

Mjeku u habit. Ajo ishte më mirë. Gulçi ishte më i vogël. Puls i kishte marrë përsëri forcë. Njëfarë jete, që kishte spikatur papritmas, i jepte rishtas gjallëri kësaj krijese të varfër e të rraskapitur.

-Zoti doktor, - vazhdoi ajo, - a ju tha gjë motra që zoti kryetar ka shkuar për të më marrë çupkën?

Mjeku porositi të mbahej qetësi dhe të mënjanohet çdo emocion i mundimshëm. Porositi t'i bëhej një infuzion kinine të papërzier dhe, në rast se ethet do të shfaqeshin përsëri natën, t'i jepej një lëng qetësues. Kur po largohej, ai i tha motrës:

-Po merr për mbarë. Sikur, për fat të mirë, zoti kryetar të arrinte pikërisht nesër me fëmijën, kushedi? Ka ca kriza aq të çuditshme dhe ka pasur raste kur gëzime të mëdha ua kanë prerë shkurt udhën sëmundjeve; unë e di mirë se kjo sëmundje është një sëmundje organike dhe shumë e zhvilluar, por të gjitha këto punë janë një mister i tillë që s'e merr vesh njeri! Ndoshta edhe mund ta shpëtonim.

*Udhëtari që arrin, merr masa
për të ikur përsëri*

Ora ishte afro tetë e mbrëmjes, kur karroca, që e lamë në udhë e sipër, hyri nën portën e madhe të Hotelit të Postës në Arras. Njeriu, që kemi ndjekur prapa gjer në këtë çast, zbriti nga karroca, iu përgjigj pa e pasur mendjen kujdesjeve të njerëzve të bujtinës, ktheu mbrapsht kalin e përforcimit dhe çoi me dorë të vet në stallë kalin e vogël të bardhë; pastaj shtyu derën e një salle bilardoje, që ishte në katin përdhes, u ul aty dhe u mbështet në një tryezë. Kishte bërë katërmbëdhjetë orë udhë, në vend që të bënte gjashtë. Ai shfaqësohej duke thënë se nuk ishte faji i tij; por, po ta shihje hollë-hollë, ai s'ishte aspak i zemëruar nga kjo punë.

Zonja e hotelit hyri brenda.

-Urdhëroni, zotëri, doni të flini? Mos doni të hani darkë, zotëri?

Ai bëri me kokë një shenjë mohuese.

-Çuni i stallës thotë se kali i zotërisë suaj është shumë i lodhur!

Këtu ai e theu heshtjen.

-A do të jetë vallë në gjendje kali të vihet përsëri në udhë nesër në mëngjes?

-Oh, zotëri, atij i duhen të paktën dy ditë çlodhje.

Ai pyeti:

-Mos është këtu zyra e postës?

-Po, zotëri.

Dhe zonja e hotelit e shpuri në zyrë; ai tregoi pasaportën dhe u informua nëse kishte ndonjë mënyrë për t'u kthyer po atë natë në Montrëj-syr-Mer me karrocën e postës; tamam vendi përbri karrocierit ishte i lirë; e zuri këtë vend dhe e pagoi.

-Zotëri, - tha nëpunësi, - duhet të ndodheni këtu, për t'u nisur, tamam në orën një të mëngjesit.

Si e kreu edhe këtë punë, ai doli nga hoteli dhe filloi të ecte nëpër qytet.

Arrasin nuk e njihte, rrugët ishin të errëta dhe ai shkante kuturu. Megjithatë, ai dukej sikur ngulte këmbë të mos i pyeste qytetarët për rrugën që kërkonte. Kaloi lumin e vogël Krënshon dhe u gjend në një rrjetë rrugicash të ngushta, ku e humbi udhën fare. Një borgjez po ecte asaj ane me një fener në dorë. Si ngurroi disa herë, ai mori guxim t'i drejtohej këtij borgjezi, por jo pa vështruar së pari përpara e prapa, sikur të kishte frikë se mos e dëgjonte ndokush pyetjen që do të bënte.

-Zotëri, - tha ai, - ju lutem, ku është pallati i drejtësisë?

-Nuk jeni nga ky qytet, zotëri? - u përgjigj borgjezi, që ishte një burrë mjaft i shtyrë në moshë, - e, pra, ejani pas meje. Edhe unë andej e kam udhën, nga pallati i drejtësisë, domethënë, më mirë të themi, nga pallati i prefekturës. Sepse këto kohë pallatin e drejtësisë po e meremetojnë, dhe hëpërhë gjyqet zhvillohen në prefekturë.

-Aty zhvillohen edhe seancat e gjykatës penale? - pyeti ai.

-Pa dyshim, zotëri. Kjo që sot është prefekturë, ka qenë ipeshkvi para revolucionit. Zoti Dë Konzié, që ishte ipeshkëv në vitin tetëdhjetë e dy, ndërtoi aty një sallë të madhe. Në këtë sallë bëhen gjyqet.

Në udhë e sipër borgjezi tha:

-Në qoftë se zotëria juaj don të shohë ndonjë proces gjyqësor, jeni pak si vonë. Zakonisht seancat marrin fund në orën gjashtë.

Ndërkohë, meqenëse po arrinin te Sheshi i Madh, borgjezi i tregoi katër dritare të gjata e të ndriçuara në ballin e një ndërtese të madhe e të errët.

-Për besë, zotëri, keni arritur në kohë, paskeni fat. A i shihni ato katër dritaret atje? Atje është gjykata penale. Paska dritë. Kështu, gjyqi s'paska marrë fund akoma! Çështja do të jetë zvarritur dhe, siç duket, do të jenë duke bërë edhe një seancë të mbrëmjes. Interesoheni gjë për çështjen që po gjykojnë? Për ndonjë krim bëhet procesi? Mos jeni gjë dëshmitar?

Ai u përgjigj:

-Nuk vij për asnjë çështje gjyqësore, dua vetëm të flas me një avokat.

-Atëherë, ndryshon puna, - tha borgjezi. - Ja porta, zotëri. Atje ku është roja. S'keni tjetër veç të ngjitni shkallët e mëdha.

Bëri siç i tha borgjezi dhe, pas disa minutash, u gjend në një sallë plot e përplot me njerëz, ku avokatë të veshur me uniforma, të përzier midis grupeve, pëshpëritnin aty-këtu.

Të ndrydhet zemra sa herë që i sheh këta grumbuj njerëzish të veshur në të zi, që murmuritin midis tyre me zë të ulët te pragu i sallave të gjyqit. Rrallë ndodh që të gjitha ato fjalë që thuhet aty të jenë fjalë faljeje e mëshire. Më dendur, që aty dalin dënime të caktuara qysh më parë. Të gjitha këto grupe, vëzhguesit që kalon e që ëndërron, i duken posi ca zgjoje të errëta, ku disa lloj shpirtrash që gumëzhijnë ndërtojnë së bashku gjithfare ndërtesash të sterrosura.

Ajo sallë shumë e gjerë dhe e ndriçuar nga një llambë e vetme, ishte një paradhomë e dikurshme e ipeshkvisë dhe shërbente si sallë pritjeje për gjyqet. Një portë me dy kanate, tani për tani e mbyllur, e ndante këtë nga dhoma e madhe ku zhvillohej gjyqi penal.

Ishte aq errët, sa ai nuk pati druajtje t'i drejtohej avokatit të parë që ndeshi përpara.

-Zotëri, - tha ai, - në ç'pikë janë?

-Mbaroi, - tha avokati.

-Mbaroi!

Kjo fjalë u shqiptua me një të tillë theks, sa avokati u kthye nga ai.

-Më falni, zotëri, mos jeni ndonjë farefis i tij?

-Jo, nuk njoh njeri këtu. Po a u dha ndonjë dënim?

-Pa dyshim, s'kishte si bëhej ndryshe.

-Me punë të rënda?...

-Përjetë.

Ai vazhdoi me një zë aq të dobët, sa mezi dëgjohej:

-Kështu, identiteti u provua?

-Çfarë identiteti? - u përgjigj avokati. - S'kishte punë identiteti aty. Çështja ishte e thjeshtë. Ajo gruaja e kishte vrarë fëmijën e vet, dhe kjo vrasje u provua, trupi gjykuës e la mënjanë paramendimin, ajo u ndëshkua me dënim të përjetshëm.

-Paska qenë grua? - tha ai.

-Sigurisht. Vajza Limozen. Por ju ku e keni fjalën?

-Askund. Por, gjersa kjo punë ka mbaruar, si bëhet që salla qëndron akoma e ndriçuar?

-Është fjala për atë çështjen tjetër, që ka nja dy orë që ka filluar.

-Çfarë çështjeje tjetër?

-Oh! Edhe ajo e qartë është. Është njëfarë rrjepacaku, një i pandehur për krime të përsëritura, një galerian, që ka vjedhur. As po më bie fare ndër mend emri i tij. Pastaj, ka edhe një fytyrë kusari të vërtetë. Vetëm për atë surrat që ka, unë do ta dërgoja në galerat.

-Zotëri, - pyeti ai, - a ka se si hyhet në sallë?

-Të them të drejtën, s'besoj se ka. Aty brenda është mizëri. Por seanca është ndërprerë për pushim. Shumë njerëz kanë dalë, prandaj, kur të fillojë përsëri seanca, provoni njëherë të hyni.

-Nga hyhet?

-Nga ajo porta e madhe.

Avokati u largua. Brenda disa çasteve, ai kishte ndier, pothuajse njëkohësisht, pothuajse të trazuara bashkë, të gjitha tronditjet e mundshme. Fjalët e këtij njeriu mospërfillës ia kishin përshkuar zemrën herë si ca gjilpëra akulli dhe herë si tehe të skuqura. Kur pa se asgjë s'kishte marrë fund, mori frymë thellë; por nuk do të ishte në gjendje të thoshte nëse ajo që ndiente ishte kënaqësi apo ishte dhembje.

Iu afrua grupeve dhe mbajti vesh se çfarë po thoshin. Rendi i ditës i sesionit ishte shumë i ngarkuar, kryetari i gjykatës kishte vënë në të njëjtën ditë dy çështje të thjeshta dhe të shkurtra. Kishin filluar me vrasësen e fëmijës dhe tani vazhdonin me galerianin, me atë që i kishte përsëritur krimet e veta, me "çjapin që kthehet përsëri te kasapi". Ky njeri na paskësh vjedhur mollë; por kjo dukej se nuk ishte provuar mirë; ishte provuar vetëm se ai na paskësh qenë dy herë në galerat e Tulonit. Kjo e rëndonte çështjen. Veç kësaj, pyetjet për të pandehurin kishin marrë fund, gjithashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve; por kishte mbetur akoma mbrojtja e avokatit dhe akuza e prokurorit publik; dhe kjo punë s'kishte sy të

mbaronte përpara mesnatës. I pandehuri, me gjasë, do të dënohej; prokurori ishte shumë i zoti dhe nuk i *shpëtonin dot nga thonjtë* të paditurit që kishte përpara; ai ishte një djalë mendjehollë, që bënte edhe vjersha.

Një portier qëndronte në këmbë përpara portës që lidhej me sallën e gjyqit penal. Ai e pyeti portierin:

-Zotëri, a do të hapet porta tani shpejt?

-Nuk do të hapet, - tha portieri.

-Si kështu! Nuk do të hapet kur të fillojë përsëri seanca? Nuk është ndërprerë seanca?

-Seanca sapo rifilloi, - u përgjigj portieri, - por porta nuk do të hapet.

-Pse?

-Se salla është plot.

-Si kështu! S'paska asnjë vend fare?

-Asnjë për bé. Porta është e mbyllur. Askush nuk mund të hyjë më. - Portieri shtoi pas një heshtjeje: - Kanë mbetur dhe nja dy a tri vende aty prapa zotit kryetar, por zoti kryetar pranon aty vetëm zyrtarë.

Si tha këto, portieri i ktheu kurrizin.

Ai u tërhoq kokulur, kaloi përmes paradhomës dhe i zbriti përsëri shkallët ngadalë, sikur të ngurronte mbi çdo shkallare. Siç duket, ai këshillohej me vetveten. Lufta e ashpër që po zhvillohej brenda tij që një ditë më parë, akoma nuk kishte marrë fund; dhe në çdo çast ai kalonte nga një peripeci të re të këtij luftimi. Kur arriti te sheshi që ndan shkollën nga një kat te tjetri, u mbështet me shpinë pas parmakut dhe kryqëzoi krahët. Befas hapi redingotën e tij, mori portofolin dhe nxori soje një laps, grisi një fletë dhe shkroi shpejt e shpejt mbi këtë fletë nën dritën e fenerit këta rreshta: "Zoti Madëlen, kryetar i bashkisë së *Montrëj-syr-Merit*". Pastaj i ngjiti përsëri shkallët me hapa të mëdhenj, çau turmën, eci drejt portierit, i dorëzoi letrën dhe i tha me autoritet:

-Çojani këtë letër zotit kryetar.

Portieri e mori letrën, i hodhi një sy dhe u bind.

VII

Hyrje për njerëz të zgjedhur

Pa e ditur as vetë, kryetari i bashkisë së Montrëj-syr-Merit kishte fituar njëfarë emri të shquar. Që prej shtatë vjetësh fama e tij si njeri i virtytshëm, që kishte mbushur krahinën e Bulonesë së Poshtme, kishte arritur t'i kapërcente kufijtë e një vendi të vogël dhe ishte përhapur në dy a tri qarqe fqinje. Përveç shërbimit të madh që i kishte bërë kryeqendrës së krahinës, duke vendosur aty industrinë e rruazave prej qelqi të zi, s'kishte komunë, nga të dyqind e dyzet komunat e rrethit të Montrëj-syr-Merit, që të mos i detyrohej për ndonjë të mirë që i kishte bërë. Madje, ai kishte ditur, kur kishte qenë nevoja, të ndihmonte e të vinte në udhë të mbarë edhe industrinë e rretheve të tjera. Kështu, ai kishte ndihmuar e përkrahur, kur kishte qenë rasti, me kreditë dhe fondet e tij, fabrikën e tyleve në Bulonjë, filaturën e lirit në fabrikën mekanike të Frevantit dhe manufakturën hidraulike të pëlhurave në Buber-syr-Kanshë. Kudo e përmendnin me përnderim emrin e zotit Madëlen. Arrasi dhe Dueja ia kishin zili kryetarin qytetit të vogël të Montrëj-syr-Merit.

Këshilltari në gjykatën mbretërore të Duesë, që kryesonte këtë seancë të gjyqit penal të Arrasit, e njihte si të tërë këtë emër kaq shumë të nderuar nga të gjithë. Kur portieri, duke hapur me druajtje derën që të çonte nga dhoma e këshillit në sallën e seancës, u përkul prapa kolltukut të kryetarit të gjykatës dhe i dorëzoi letrën ku ishte shkruar rreshti që posa lexuam, duke shtuar: "Ky zotëria dëshiron të marrë pjesë në seancën gjyqësore", kryetari bëri një lëvizje të gjallë respekti, kapi një penë, shkroi disa fjalë në fund të letrës dhe ia dorëzoi portierit duke thënë: "Lëreni të hyjë."

Njeriu fatkeq, historinë e të cilit po e tregojmë këtu, kishte mbetur pranë portës së sallës po në atë vend dhe po në atë qëndrim ku e kishte lënë portieri kur u largua. Ai dëgjoi, përmes ëndërrimit të tij, dikë që po i thoshte: "A do të kishte mirësinë

zotëria juaj të më bënte nderin të vinte pas meje?” Ishte po ai portier që i kishte kthyer kurrizin një çast më parë dhe që tani po e përshëndeste duke u përkulur gjer në tokë. Portieri, në të njëjtën kohë, i dorëzoi edhe letrën. Ai e shpalosi dhe, meqë rastisi të ishte pranë llambës, mundi të lexonte sa vijon:

“Kryetari i gjykatës penale i paraqit respektet e tij zotit Madëlen”.

Ai e zhubrosi letrën në dorë, sikur ato pak fjalë të kishin pasur një shije të çuditshme dhe të hidhur.

Shkoi pas portierit.

Pas disa minutash, ai u gjend vetëm në njëfarë zyre me muret të vaisura sipas pjerrësisë së çatisë, me pamje të rëndë dhe të ndriçuar nga dy qirinj, që ishin vendosur mbi një tryezë të veshur me stof të blertë. Akoma i tingëllonin në vesh fjalët e fundit të portierit, që sapo ishte larguar: “Zotëri, këtu jeni në dhomën e këshillit, tani s’keni veç të rrotulloni dorezën prej bakri të asaj porte dhe do të gjendeni në sallën e gjyqit prapa kolltukut të zotit kryetar.” Këto fjalë ngatërroheshin në mendjen e tij me një kujtim të vagët korridoresh të ngushta dhe shkallësh të errëta që sapo kishte përshkuar.

Portieri e kishte lënë vetëm. Tani kishte arritur çasti suprem. Ai kërkonte të mblidhte veten, por nuk mundte. Pikërisht, në çastet kur njeriu ka më shumë nevojë se kurrë t’i lidhë me realitetin e jetës të gjitha fijet e mendimit, këto fije këputen në trurin e tij. Ishte tamam në vendin ku gjyqtarët thonë fjalën e tyre dhe dënojnë. Ai e vështronte me një qetësi të shushatur atë dhomë të qetë e të frikshme, ku sa e sa jetë njerëzish ishin bërë copë e thërrime, ku pas pak emri i tij do të tingëllonte me të madhe dhe ku fati i tij i ardhshëm po e përshkonte mes për mes. Ai vështronte murin, pastaj vështronte vetveten, duke bërë çudi që ishte ajo dhomë dhe që ishte ai vetë.

S’kishte shtënë gjë në gojë që prej dyzet e katër orësh, ishte i dërrmuar nga troshitjet e karrocës, por ai nuk e ndiente; dukej sikur nuk ndiente asgjë.

Iu afrua një kuadri të zi, të varur në mur, që mbante nën xham një letër të vjetër me autografin e Zhan-Nikola Pashit,

kryetar bashkie i Parisit dhe ministër, e cila pa dyshim e kishte datën gabim, 9 qershor viti II, dhe me anë të së cilës Pashi i dërgonte komunës listën e ministrave dhe të deputetëve të mbajtur në arrest në shtëpitë e tyre. Po ta kishte parë ndonjë dëshmitar dhe ta kishte vëzhguar mirë atë çast, pa dyshim do të mendonte se ajo letër po i dukej fort e çuditshme, sepse ky nuk po ia ndante sytë fare dhe e lexoi dy a tri herë. Ai e lexonte pa e pasur mendjen aty dhe pa ditur se ç’po bënte. Mendja i rrinte te Fantina dhe te Kozeta.

Tek po ëndërronte kështu, ai u rrotullua dhe sytë e tij ranë mbi dorezën e bakërt të derës që e ndante nga salla e gjyqit penal. Gati-gati e kishte harruar fare atë derë. Vështrimi i tij, në krye i qetë, u ndal aty, qëndroi tek ajo dorezë bakri; pastaj ai vështrim erdh e u bë i trembur dhe i ngulët dhe u pushtua nga një frikë e madhe.

Pika djerse i bulonin përmes flokëve dhe i rridhnin tëmthave. Në një çast të caktuar, ai bëri me dorë me njëfarë autoriteti të përzier me rebelim një lëvizje të papërshekrueshme, që don të thotë e që thotë aq mirë: “Për besë! Kush po më detyron mua kështu?” Pastaj u rrotullua plot gjallëri, pa përpara tij derën nga e cila kishte hyrë, vajti aty, e hapi dhe doli jashtë. Nuk ishte më në atë dhomë, ishte jashtë, në një korridor, në një korridor të gjatë, të ngushtë, të ndarë në shkallare, me sportele, që bënte gjithfarë bërrylash, të ndriçuar aty-këtu nga disa fenerë, si ata kandilat që u ndezin të sëmurëve, ishte në korridorin prej nga kishte ardhur. Mori frymë dhe mbajti vesh: asnjë zhurmë prapa tij; asnjë zhurmë përpara tij; nisi të ikte, sikur po e ndiqte njeri nga pas.

Kur ktheu disa nga bërrylat e atij korridori, ai mbajti vesh përsëri. Ishte po ajo heshtje dhe po ajo hije rreth tij. Po i merrej fryma dhe po i merreshin këmbët, prandaj u mbështet pas murit. Guri ishte i ftohtë, djersa i që bërë akull mbi ballë; u ngrit përsëri duke u rrëqethur.

Atëherë, aty, fill i vetëm, në këmbë në atë errësirë, duke u dridhur nga të ftohtët dhe nga diçka tjetër ndoshta, filloi të mendonte.

Kishte menduar gjithë natën, kishte menduar gjithë ditën;

brenda vetes së tij, ai dëgjonte vetëm një zë që thoshte: "Medet!"

Kaloi kështu një çerek ore. Më në fund, vaisi kokën, psherëtiu me ankth, i lëshoi krahët dhe u kthye përsëri andej nga kishte ardhur. Ecte ngadalë dhe si i dërrmuar. Dukej sikur dikush e kishte kapur duke ikur dhe po e sillte prapë atje ku që përpara.

Hyri në dhomën e këshillit. Gjëja e parë që pa, ishte doreza e derës. Ajo dorezë e rrumbullakët prej bakri të lëmuar shndriste për të si ndonjë yll i frikshëm. Ai e vështronte si ndonjë dele që vështron syrin e një tigri. S'po i shkuleshin dot sytë së andejmi.

Kohë më kohë bënte nga një hap dhe i afrohej derës.

Po të kishte mbajtur vesh, ai do të kishte dëgjuar një si murmuritje të mbytur, zhurmën e sallës fqinje; por ai s'mbante vesh dhe nuk dëgjonte asgjë.

Befas, pa e kuptuar as ai sesi, u gjend pranë derës. E kapi dorezën duke u përpëlitur; dera u hap.

Ai ishte në sallën e gjyqit.

VIII

Një vend ku janë duke u formuar bindje

Bëri një hap përpara, mbylli mekanikisht derën prapa tij dhe qëndroi në këmbë, duke peshuar ato që po shikonte.

Ishte një sallë mjaft e gjerë, e ndriçuar fare pak, që herë binte në heshtje e herë gumëzhinte nga zhurma, ku gjithë mekanizmi i një procesi kriminal zhvillohej me një seriozitet meskin dhe kobzi në mes të turmës.

Në një skaj të sallës, skaji ku gjendej ai vetë, ishin disa gjykatës, që dukeshin sikur s'e kishin mendjen fare atje, me petka të fërkuara, duke ngrënë thonjtë ose duke dremitur; në skajin tjetër, një turmë e veshur me zhele; disa avokatë në gjithfarë qëndrimesh të ndryshme; ushtarë me fytyra të ndershme dhe të vrazhda; mobilje e pajisje druri të vjetra e

plot njolla, një tavan i ndotur, tryeza të veshura me cohë, që ishte më shumë e verdhë se e gjelbër, dyer të nxira nga duart; në gozhdët e ngulura në veshjen prej dërrase të murit, disa llamba vajguri, nga ato që përdoren në kafenetë e vogla, bënin më shumë tym sesa dritë; mbi tryezat, qirinj të ngulur në shandanë bakri; terr, shëmti, trishtim; dhe nga të gjitha këto të lindte një përshtypje hijerëndë dhe plot nderim, sepse aty njeriu ndiente atë gjënë e madhe njerëzore që quhet ligj dhe atë gjënë e madhe hyjnore që quhet drejtësi.

Asnjëri nga turma nuk ia vuri veshin atij. Të gjitha vështrimet përqendroheshin drejt një pike të vetme, drejt një banke druri, të mbështetur pas një dërrase të vogël, përgjatë murit, në të majtë të kryetarit. Mbi këtë bankë, të ndriçuar nga një numër i madh qirinjsh, ndodhej një burrë midis dy xhandarësh.

Ky burrë ishte ai njeriu. Zhan Valzhani nuk e kërkoi, por e pa menjëherë. Sytë i vajtën atje në mënyrë të natyrshme, sikur ta kishin ditur që më parë se ku ishte ajo fytyrë.

Iu bë sikur po shikonte veten e vet të plakur, pa dyshim jo fare të ngjashëm nga fytyra, por po me atë qëndrim dhe pamje si të tijën, po me ata flokë të ngritur lart si të iriqit, po me atë bebe syri të egër e të shqetësuar, me atë bluzë, ashtu siç ishte ai atë ditë kur hyri në Dinjë, tërë urrejtje e duke fshehur në shpirt të vet atë thesar të neveritshëm mendimesh të lemerishme, për të cilat i qenë dashur nëntëmbëdhjetë vjet që t'i grumbullonte në truallin e burgut të punëve të rënda. Ai tha me vete duke u rrëqethur:

-O Zot! Mos do të bëhem përsëri kështu?

Ajo krijesë dukej të ishte të paktën gjashtëdhjetëvjeçare. Kishte nuk di ç'gjë të ashpër prej guaku e të trembur.

Kur dëgjuan zhurmën e derës, të tjerët u reshtën për t'i bërë vend, kryetari ktheu kokën dhe, duke kuptuar se personi që sapo erdhi ishte zoti kryetar i Montrëj-syr-Merit, e përshëndeti. Prokurori, që e kishte parë zotin Madëlen në Montrëj-syr-Mer, ku detyra e vet e kishte thirrur më se një herë, e njohu dhe e përshëndeti gjithashtu. Atij mezi ia zuri syri këto përshëndetje. Ai kishte rënë në njëfarë kllapie me sy hapët; dhe vetëm vështronte pa parë.

Disa gjykatës, një shkruer, xhandarë, një mori kokash gjithë kureshtje të egër, këto ai i kishte parë njëherë, dikur, këtu e njëzet e shtatë vjet të shkuar. Këto gjëra kobzeza ai po i gjente përsëri; ishin aty të gjalla, lëviznin, ekzistonin. Këto s'ishin përpjekje të kujtesës, as vegime të mendjes së tij, por ishin xhandarë të vërtetë, gjykatës të vërtetë, një turmë e vërtetë dhe njerëz të vërtetë prej mishi e kocke. E pat, ai po shikonte tek shfaqeshin dhe jetonin rishtas rreth tij, me të gjithë atë që ka të stërmadhe e të tmerrshme e vërteta lakuriqe, aspektet e përbindshme të së kaluarës së tij.

E gjithë kjo ishte si një hon gojëhapur përpara tij. U lemerit, mbylli sytë dhe bërtiti që nga fundi më i thellë i shpirtit të tij: "Kurrë!"

Dhe nga një lojë tragjike e fatit, e cila bënte t'i dridheshin të gjitha idetë dhe që gati-gati po e çmendte, atje ishte një tjetër vete e tij! Këtë burrë, që po e gjykonin, të gjithë e quanin Zhan Valzhan!

Ai kishte para syve të tij, vegim i padëgjuar, njëfarë rishfaqjeje të çastit më të llahtarshëm të jetës së tij, të luajtur nga një hije e tij.

Çdo gjë ishte në vendin e vet, po ai aparat, po ajo orë e natës, pothuajse po ato fytyra gjykatësishe, ushtarësh e spektatorësh. Veçse, mbi kokën e kryetarit të gjyqit kishte një kryq me Krishtin mbërthyer, gjë që mungonte në kohën e dënimit të tij. Atëherë, kur e kishin dënuar atë, zoti mungonte.

Prapa tij ishte një karrige; u lëshua mbi të, i tmerruar nga mendimi se mund ta shihnin. Kur u gjend ulur, ai përfitoi nga një piring dosarësh që ndodhej mbi tryezën e gjykatësve për t'ia fshehur fytyrën sallës. Tani ai mund të shikonte pa e parë njeri. Pak nga pak erdhi dhe e mblodhi veten. Hyri plotësisht në realitetin që e rrethonte, arriti atë farë qetësie kur njeriu është në gjendje të mbajë vesh.

Zoti Bamatabua ishte njëri prej gjykatësve.

Kërkoj Zhaverin, por nuk ia zuri syri. Banka e dëshmitarëve ishte fshehur prapa tryezës së shkruerit. Dhe pastaj, siç thamë edhe më lart, salla ishte fare pak e ndriçuar.

Në çastin kur kishte hyrë, avokati që mbronte të

pandehurin, po i jepte fund mbrojtjes së tij. Vëmendja e të gjithëve ishte në kulm; gjyqi po vazhdonte që prej tri orësh. Që prej tri orësh, turma vështronte të përkulej pak e nga pak nën peshën e një përngjashmërie të tmerrshme një njeri, një të pandehur, njëfarë krijese të mjerë, fare të budallallepsur ose shumë finoke. Ky njeri, siç e dimë edhe që më parë, ishte një endacak, që kishte qenë kapur në një arë duke marrë me vete një degë me mollë të pjekura, të cilën e kishte këputur nga një pemë në një kopsht aty afër, që quhej kopshti "Pieron". Cili ishte ky njeri? U bë një hetim; u dëgjuan edhe dëshmitarë; ata ishin të njëzëshëm; dolën shumë sqarime nga të gjitha debatet që u bënë. Akuza thoshte: "Ne nuk kemi këtu vetëm një vjedhës, pemësh, një endacak; ne këtu kemi në dorë një të dënuar që përsërit krimet e veta, një ish-të dënuar me punë të rënda, një njeri të hurit e të litarit nga më të rrezikshmit, një keqberës të quajtur Zhan Valzhan, të cilin drejtësia e kërkon që prej shumë kohësh dhe i cili këtu e tetë vjet të shkuar, duke dalë nga kampi i Tulonit, ka kryer një kusari, duke qenë i armatosur, kundër një fëmije savojase të quajtur Zhervez i Vogël, krim i parashikuar nga neni 383 i kodit penal, për të cilin krim ne rezervohemi të kryejmë ndjekjet më pas, kur identiteti të përcaktohet në mënyrë gjyqësore. Ai tani ka kryer një vjedhje tjetër. Ky është një faj i përsëritur. Dënojeni për veprimin e ri; më vonë ai do të dënohet për veprimin e vjetër".

Përpara kësaj padie, përpara dëshmitarëve të njëzëshëm, i pandehuri dukej më shumë i çuditur. Bënte lëvizje me dorë dhe shenja, që donin të mohonin, ose rrinte e kundronte tavanin. Fliste me vështirësi, përgjigjej duke mos ditur nga t'ia niste e ku të mbaronte; por, që nga koka e gjer te këmbët, e tërë qenia e tij mohonte. Ishte si ndonjë idiot përpara gjithë atyre mendjendriturve të rreshtuar për betejë rreth tij dhe si ndonjë i huaj në mes të asaj shoqërie, që po e kapte për gryke. Ndërkohë shtrohej çështja e së ardhmes së tij plot kërcënime, gjasa shtohet për minutë, dhe e gjithë ajo turmë vështronte me më shumë ankth se ai vetë këtë paditje plot gjëma, që rëndonte mbi të gjithnjë e më shumë. Me gjasë, veç punëve të rënda, mund të kishte edhe ndonjë dënim të mundshëm me vdekje,

në qoftë se do të përcaktohej e njihej identiteti dhe në qoftë se çështja e Zhervezit të Vogël do të përfundonte më vonë me ndonjë dënim. Ç'ishte vallë ky njeri? E ç'natyre ishte vallë apatia e tij? Ishte ndonjë e metë mendore apo dhëlpëri? Kuptonte tepër, apo s'kuptonte gjë fare? Këto pyetje e ndanin turmën dhe trupin gjykues më dysh. Në këtë proces kishte edhe nga ato gjëra që të kallin frikën, por edhe nga ato që të futin dyshimin; drama nuk ishte vetëm e zyrtë; ajo ishte e errët.

Avokati mbrojtës kishte bërë një mbrojtje mjaft të mirë, me atë gjuhën e krahinës, e cila ka qenë për një kohë të gjatë gojëtaria e trupit avokator dhe që e përdornin dikur të gjithë avokatët, si në Paris, ashtu edhe në Romoranten ose në Monbrizon, dhe e cila sot, duke qenë se është bërë klasike, flitet vetëm nga oratorët zyrtarë të gjyqeve, të cilëve u vjen për shtat për shkak të tingëllimit të saj hijerëndë dhe të rrjedhshmërisë së saj madhështore; gjuhë, ku një burrë quhet *bashkëshort*, gruaja *bashkëshorte*, Parisi *qendra e arteve dhe e qytetërimit*, imzot ipeshkvi *veqili i shenjtë*, prokurori *interpreti gojëmprehtë i padijes*, padijet *theksat që u dëgjuan*, shekulli i Luigjit XIV *shekulli i madh*, teatri *tempulli i Melpomenit*, familja mbretërore *gjaku august i mbretërve tanë*, koncerti *solemnitet muzikor*, zoti gjeneral komandant i qarkut *luftëtar i shquar*, i cili etj., nxënësit e seminarit *këta levite*⁷⁾ të butë, gabimet që u ngarkoheshin gazetave *shpifje poshtëruese që vërshojnë nëpër kolonat e këtyre organeve etj., etj.* Avokati, pra, kishte filluar të shpjegohej për vjedhjen e mollëve, gjë që ishte e vështirë për t'u shprehur në stil të bukur; por edhe vetë Beninj Bosityeja ka qenë i detyruar ta hidhte fjalën për një pulë mu në mes të një fjalimi të përmortshëm, dhe ia doli ta bënte plot madhështi. Avokati kishte parashtruar se vjedhja e mollëve nuk ishte provuar materialisht. Klienti i tij, të cilin ai, si avokat mbrojtës, ngulmonte ta quante Shamatjë, s'kishte qenë parë nga asnjëri duke kapërcyer murin ose duke thyer degën. E kishin arrestuar me degën në dorë (që kishte qejf ta quante më mirë lastar); për të cilën ai thoshte se e pati gjetur në tokë dhe

⁷⁾Anëtarë të tribusë së Levit që shërbejnë në tempull.

e pati marrë. Ku ishte prova e kundërt? Pa dyshim ajo degë ishte thyer dhe vjedhur pas kapërcimit të murit, pastaj hedhur aty nga vjedhësi, i alarmuar; pa dyshim këtu një vjedhës kishte. Po ç'gjë e provonte që ky vjedhës ishte Shamatjë? Vetëm kjo. Faktin që ai njeri ishte dënuar dikur me punë të rënda, avokati nuk e mohonte, se, për fat të keq, ky fakt ishte konstatuar mirë; i pandehuri kishte banuar në Favërolë; i pandehuri kishte qenë aty si krasitës pemësh; emri Shamatjë mund të kishte fare mirë për zanafillë emrin Zhan Matjë; të gjitha këto ishin të vërteta; më në fund, katër dëshmitarë pohonin pa dyzuar se Shamatjë ishte galeriani Zhan Valzhan; kundrejt këtyre të dhënave, këtyre dëshmimeve, avokati nuk mund të vinte veçse mohimin e klientit të vet; por edhe sikur të mendohej se ky ishte i burgosuri Zhan Valzhan, a provonte kjo se ai ishte vërtet vjedhës i mollëve? Kjo ishte më tepër një hamendje, por jo një provë. Ishte e vërtetë se i pandehuri kishte zgjedhur "një sistem të keq vetëmbrojtjeje", dhe këtë avokati mbrojtës në mirëbesim ishte i detyruar ta pranonte. I pandehuri ngulte këmbë t'i mohonte të gjitha, edhe vjedhjen, edhe faktin që ishte dënuar dikur me punë të rënda. Po ta kishte pohuar këtë pikë të fundit, me siguri që kjo do t'i kishte vlejtur më shumë dhe do të kishte ngjallur mëshirën e trupit gjykues; edhe avokati e kishte këshilluar për këtë; por i pandehuri e kishte hedhur poshtë me këmbëngulje, duke menduar pa dyshim se do të shpëtonte gjithçka duke i mohuar të gjitha. Por ky ishte gabim; po a nuk duhej marrë parasysh edhe mendjeshkurtësia e të pandehurit? Ky njeri dukej sheshit që ishte i metë. Fatkeqësia për një kohë të gjatë në burg, mjerimi për një kohë të gjatë jashtë burgut, e kishin shtazëruar fare etj., etj. I pandehuri mbrohej keq; por pse, a ishte kjo një arsye për ta dënuar? Përsa i përkiste çështjes së Zhervezit të Vogël, avokati s'kishte si e diskutonte, sepse kjo nuk bënte pjesë në çështjen që po gjykohej. Avokati i dha fund duke iu lutur edhe trupit gjykues, edhe gjykatës, në qoftë se identiteti i Zhan Valzhanit u dukej i qartë, t'i jepnin dënimet policore që i përkasin një ish-të dënuari dhe jo dënimin e llahtarshëm që godet të dënuarin me punë të rënda kur përsërit krimin.

Prokurori i ktheu përgjigje mbrojtësit. Ai foli ashpër dhe me gojëtarë, ashtu siç bëjnë zakonisht prokurorët.

Ai e përgëzoi mbrojtësin për "ndershmërinë" e tij dhe përfitoi me shkathtësi nga kjo ndershmëri e avokatit. Avokati dukej se ishte i mendimit që i pandehuri ishte Zhan Valzhani. Prokurori e mori shënim dhe e kapi këtë gjë. Ky njeri ishte, pra, Zhan Valzhani. Këtë gjë akuza e kishte kapur dhe nuk mund të kundërshtohet më. Këtu, me anën e një antonomazie^{*)} të shkathët, duke u ngjitur te burimet dhe shkaqet e kriminalitetit, prokurori u lëshua me bubullima kundër imoralitetit të shkollës romantike, e cila në agimin e saj quhej *shkollë satanike*, siç ia kishin ngjitur kritikët e gazetave "*Oriklamë*" dhe "*Kotidien*"; ai ia ngarkoi, jo pa përngjashmëri, ndikimit të asaj letërsie të mbrapshtë deliktin e Shamatjëit ose, më mirë, deliktin e Zhan Valzhanit. Si i shteri këto konsiderata, ai kaloi te Zhan Valzhani vetë. Ç'ishte Zhan Valzhani? Përshkrim i Zhan Valzhanit. Një përbindësh bir përbindëshi etj. Modeli i këtyre lloj përshkrimeve gjendet në tregimin e Teramenës, i cili nuk i vlen tragjedisë, por i sjell çdo ditë shërbime të mëdha gojëtarisë gjyqësore. Auditori dhe trupi gjykues u "rrëqethën". Si mbaroi përshkrimin, prokurori vazhdoi me një hov të tillë gojëtarie, që të nesërmen në mëngjes ajo e nxiti në kulm entuziazmin e Gazetës së Prefekturës.

-Dhe ky njeri i tillë është etj., etj., etj., vagabond, lypës, pa plang e pa shtëpi, etj., etj. - i mësuar nga e kaluara e tij për veprime të dëmshme dhe fare pak i ndrequr nga qëndrimi i tij në kampin e punëve të rënda, ashtu siç e provon krimi i kryer kundër Zhervezit të Vogël, etj. etj. - dhe një i tillë, i gjetur në rrugën publike në delikt të hapët për vjedhje, pak hapa nga një mur që kishte kapërcyer, duke mbajtur akoma në dorë sendin e vjedhur, mohon deliktin e hapët, vjedhjen, kapërcimin, mohon gjithçka, mohon deri emrin e tij, mohon deri identitetin e tij! Përveç të njëqind e një provave, te të cilat nuk po kthehem, atë e njohin katër dëshmitarë, Zhaveri, i përkryeri inspektor i

policisë, dhe tre nga shokët e turpit e të poshtërsisë, të burgosurit Brevet, Shënildjé dhe Koshëpaj. Ç'i kundërvë ai këtij njëzëri dërrmues? Ai mohon. Ç'njeri i regjur! Ju duhet të zbatoni drejtësinë, zotërinj gjyqtarë, etj., etj.

Ndërsa prokurori fliste, i pandehuri mbante vesh, me gojë hapur, me njëfarë çudie, ku përzihej edhe njëfarë admirimi. Atij i dukej patjetër çudi e madhe që një njeri mund të fliste ashtu. Kohë më kohë, në çastet më "energjiqe" të pretencës, në ato çaste kur gojëtaria, që s'mund të përmbahet më, vërshon me një baticë cilësorësh demaskues dhe e mbështjell të pandehurin si ndonjë stuhi, ai tundte kokën ngadalë nga e djathta në të majtë dhe nga e majta në të djathtë; kjo ishte njëfarë proteste e trishtuar dhe e nemitur, të cilën ai po e bënte qysh në fillim të debateve. Dy a tri herë, spektatorët që ishin vendosur më afër tij, e dëgjuan të thoshte me gjysmë zëri:

-Ja se si ngatërrohen punët kur nuk pyetet zoti Balup!

Prokurori i përgjithshëm i tërhoqi vëmendjen trupit gjykues për atë qëndrim prej guaku, të bërë me siguri enkas, me qëllime të caktuara, qëndrim i cili nxirrte sheshit jo të metën mendore, por shkathtësinë, dhëlpërinë, zakonin për të mashtruar drejtësinë, qëndrim i cili nxirrte fare lakuriq "shthurjen e thellë" të këtij njeriu. Ai përfundoi duke shprehur rezervat e veta lidhur me çështjen e Zhervezit të Vogël dhe duke kërkuar një dënim të rreptë.

Mbrojtësi u ngrit, filloi të përgëzonte "zotin prokuror të përgjithshëm" për fjalën "e tij të admirueshme", pastaj u përgjigj si munda, po zëri sa vinte e i dobësohej; dukej haptazi se toka po i rrëshqiste nën këmbë.

^{*)} Figurë letrare me anë të cilës zëvendësohet një emër me vetinë më tipike të sendit që ai përfaqëson.

IX

Sistemi i mohimeve

Koha për t'u mbyllur debatet kishte ardhur. Kryetari i tha të pandehurit të çohej dhe i drejtoi pyetjen që zakonisht u bëhet të pandehurve:

-Keni gjë për të shtuar për mbrojtjen tuaj?

Burri, në këmbë, duke sjellë nëpër duart një kësulë që të shtinte krupën, duket se nuk dëgjoi. Kryetari e përsëriti pyetjen.

Kësaj here njeriu dëgjoi. U duk sikur kuptoi, bëri një lëvizje sikur u zgjua nga gjumi, endi sytë rreth tij, vështroi publikun, xhandarët, avokatin e tij, gjykatësit, gjyqin, vuri grushtin e tij të përbindshëm mbi buzën e parmakut para bankës së tij, vështroi akoma dhe befas, duke e ngulur vështrimin e tij mbi prokurorin e përgjithshëm, filloi të fliste. Ishte si ndonjë shpërthim vullkani. Nga mënyra se si shpërthenin fjalët prej gojës së tij, të palidhura, rrëmbimthi, duke u përplasur me njëra-tjetrën mishmash, dukej sikur po nxitonin të gjitha tokë të dilnin në të njëjtën kohë. Ai tha:

-Kam për të thënë këtë. Se kam qenë karrondreqës në Paris, bilé te zoti Balup, në daçi të dini. Është zanat i rëndë. Në këtë qerrata zanat duhet të punosh gjithmonë jashtë, ndër oborre, qëllon edhe nën strehë, kur godet në ndonjë usta të mirë, por kurrë në punishte të mbyllura, se do vend të hapët, që thoni ju. Dimrit të pret aq shumë të ftohtët, sa je i detyruar të rrahësh krahët për t'u ngrohur, mirëpo ku të lënë ustallarët? Ata të thonë se humbet kohën kot. Hajde të zësh hekur me dorë kur ka ngrirë toka kallkan, të lutem; gjë e rëndë, për besë! Kjo punë e dërrmon njeriun. Plakesh kur je akoma i ri në këtë palo zanat. Po mbushe dyzet vjeç, e ke ngrënë kullotën. Unë isha pesëdhjetë e tre dhe hiqja të zitë e ullirit. Pastaj, edhe nga punëtorët gjen belanë, se janë të këqij. Kur njeriu i shkretë plakët, nisin e ta quajnë matuf, gomar i zgjebosur e ku ta di unë. Nuk nxirrja më shumë se tridhjetë su ditën, më paguanin sa që e mundur më pak, ustallarët përfitonin nga mosha ime.

Veç kësaj, kisha dhe time bijë, që ishte rrobalarëse atje në breg të lumit. Edhe ajo nxirrte diçka nga ana e saj. Kur ishim dy, çka, shkonim hiq e mos e këput. Edhe ajo hiqte keq në punë. Gjithë ditën e perëndisë futur në një kazan gjer në brez, në shi, në dëborë, me thëllimin që të pret fytyrën si brisk: edhe në bëftë ngricë, do s'do, duhet të lash. Ka njerëz që s'kanë shumë ndërresa dhe të rrinë në këmbë e të presin; po të mos lash, të mori lumi, të mori. Dërrasat janë të plasaritura dhe të rrjedh ujët çurg gjithandej. Fustane e funde të bëhen fare qull sipër e poshtë. Të hyn lagështia gjer në mish. Ajo ka punuar edhe në lavanterinë e Fëmijëve të Kuq, ku ujët vjen me rubineta. Kështu që atje nuk hyn në kazan. Lan përpara në rubinet e pastaj shpëlan prapë në postaf. Meqë aty je në vend të mbyllur, s'do mend që edhe të ftohtë ke më pak në trup. Por aty të ngrihet njëfarë avulli i ujit të nxehtë, që është i tmerrshëm, e të verbon nga sytë. Kthehej në shtëpi aty nga ora shtatë e mbrëmjes dhe binte në gjumë shumë shpejt; ishte e këputur nga puna. I shoqi e rrihte. Pastaj e shkreta vdiq. S'pamë ndonjë ditë të bardhë. Ajo ishte një vajzë sokoleshë, që s'të shkelte kurrë në kallo dhe që ishte fort e urtë. Mbaj mend, një të martë të të vdekurve, ajo vajti e fjeti në orën tetë. Ja kështu. Më thertë, në gënjej. Pyesni, po deshët. Ah, po, tamam, pyesni! Sa hajvan që jam! E ku të pyesësh në Paris? Parisi është një hon i tërë. E kush e njeh xha Shamatjëin atje? E megjithatë, unë ja ku po jua them, atij i thonë zoti Balup. Shkoni e pyesni njëherë te zoti Balup. Ndryshe, unë s'po marr vesh fare se ç'kërkoni ju prej meje.

Njeriu heshti dhe qëndroi në këmbë. I kishte thënë këto gjëra me zë të lartë, të shpejtë, të mbytur, të vrazhdë e të ngjirur, me njëfarë naiviteti të acaruar dhe të egër. Njëherë ai u ndal për të përshëndetur dikë në mes të turmës. Ato farë mohimesh, që dukej sikur i vërviste kuturu përpara tij, i vinin si lemza, dhe shtonte pas çdo pohimi një lëvizje druvari që çan dru. Kur mbaroi, salla ia plasi gazit. Ai vështroi publikun dhe, duke parë se po qeshnin dhe duke mos kuptuar gjë, filloi edhe vetë të qeshte.

Kjo ishte e kobshme.

Kryetari, njeri i vëmendshëm dhe dashamirës, ngriti zërin.

U përmendi "zotërinjve të trupit gjykues" se "zoti Balup, ai ustai karrondreqës, tek i cili i pandehuri thoshte se kishte punuar, ishte përmendur më kot. Ai kishte pësuar faliment dhe nuk kishte qenë e mundur të gjendej". Pastaj, duke iu kthyer të akuzuarit, e ftoi të mbante vesh mbi çka do të thoshte dhe shtoi:

-Ju jeni në një gjendje që duhet t'i vini gishtin kokës e të mendoni. Mbi ju peshojnë hamendjet më të rënda, që mund të sjellin rrjedhime kapitale. I pandehur, në interesin tuaj, po jua kujtoj për herë të fundit, shpjegohuni qartë mbi këto dy gjëra: e keni kapërcyer apo jo murin rrethues të kopshtit "Pieron", a e keni thyer degën dhe i keni vjedhur mollët, domethënë a e keni kryer krimin e vjedhjes me kapërcim muri? E dyta, a jeni ju i burgosuri i liruar Zhan Valzhan, apo jo?

I pandehuri tundi kokën plot kuptim, si ndonjë njeri që e ka kuptuar mirë dhe që e di se çfarë do të përgjigjet. Hapi gojën, u kthye nga kryetari dhe tha:

-Së pari...

Pastaj vështroi kësulën, vështroi tavanin dhe heshti.

-I pandehur, - ia nisi përsëri prokurori me zë të ashpër, - kini mendjen. S'po i përgjigjeni asgjëje nga ato që po ju pyesin. Vetë turbullimi juaj tregon se jeni fajtor dhe ju dënon. Duket sheshit që ju nuk quheni Shamatjë dhe që jeni ish-i burgosuri Zhan Valzhan, i fshehur, në krye, nën emrin Zhan Matjë, që ishte emri i nënës suaj, që nuk keni vajtur në Overnjë, që keni lindur në Favërolë, ku keni qenë krasitës pemësh. Duket haptazi se, duke kapërcyer murin, keni vjedhur mollë të pjekura në kopshtin "Pieron". Zotërinjtë gjyqtarë do t'i vlerësojnë të gjitha këto.

I pandehuri ndërkaq ishte ulur; ai brofi me turr sa mbaroi prokurori dhe bërtiti:

-Ju paskeni qenë shumë shpirtlig! Ja se çfarë desha të them. Në fillim s'e gjeja dot fjalën. Unë s'kam vjedhur asgjë. Jam fukara njeri unë, që s'e ngop dot barkun çdo ditë me bukë. Po vija nga Aija, po ecja nëpër fshat pas një shiu të stuhishëm, që e kishte bërë fushën krejt të verdhë, sa edhe pellgjet vërshonin, sa edhe nga dheu nxirrnin kokën vetëm disa fije të vogla bari buzë rrugës, kur gjeta përdhé një degë të thyer ku

kishte mollë, e mora degën, pa më vajtur mendja se ajo do të më sillte gjithë këto kusure. U bënë tre muaj që ndodhem në burg e po më sorollatin kot. Tani as unë s'di se ç'të them. Ngrihen bota e flasin kundër meje dhe më thonë: "Përgjigju!" Xhandari, që është xhanan djalë, më shtyn me bërryl e më thotë me zë të ulët: "Përgjigju, bre burrë!" Unë nuk di t'i kulloj mirë punët, se jam pa gramë e jam fukara njeri. Ja, pikërisht këtu s'e keni drejt punën ju. Unë i shkreti s'kam vjedhur gjë, kam marrë mollët që ishin përdhé. Ju thoni jo Zhan Valzhan, jo Shamatjë e ku ta di unë! Unë këta njerëz as i njoh fare. Këta janë katundarë, mor jahu. Kurse unë kam punuar te usta Balupi në bulevardin "Hopital". Mua më thonë Shamatjë. Le, por doni të më shtini në kurth duke më pyetur se ku kam lindur. E ku e di unë i shkreti se ku kam lindur? Se mos kanë gjithë bota shtëpi ku të lindin? Kjo do të që punë tepër e rehatshme. Më thotë mendja se babai dhe nëna që kam pasur unë kanë qenë njerëz pa plëng e pa shtëpi dhe endeshin udhëve. Por as që e di fare se si qëndron kjo punë. Kur isha fëmijë, bota më thërrisnin voc, tani më thërresin plak. Këta janë emrat e mi të pagëzimit. Quajeni këtë punë si t'jua dojë qejfi. Besa, kam qenë edhe në Overnjë, kam qenë edhe në Favërolë! Por mirë, a nuk mund të ketë qenë njeriu në Overnjë, a nuk mund të ketë qenë në Favërolë, pa qenë në burg me punë të rënda? Ja ku po jua them, se unë s'kam vjedhur dhe jam xha Shamatjëi. Kam punuar te zoti Balup, aty edhe flija. Si shumë po më mërzitni me këto budallallëqet tuaja, papa gjene. Ç'dreqin kanë që më janë vënë të gjithë pas me bukë në torbë?

Prokurori kishte mbetur në këmbë; ai iu drejtua kryetarit:

-Zoti kryetar, përpara mohimeve të errëta, por shumë finoqe, të të pandehurit, i cili ka shumë qejf të shtiret si truthatë, por që nuk do t'ia arrijë atij qëllimi - po e paralajmërojmë - ne kërkojmë që të kini mirësinë ju e të ketë mirësinë gjykata të thirren edhe një herë në këtë sallë të dënuarit Brevet, Koshëpajë dhe Shenildjë, si dhe inspektori i policisë Zhaver, dhe të pyeten për herë të fundit mbi identitetin e të pandehurit me të burgosurin Zhan Valzhan.

-I tërheq vëmendjen zotit prokuror, - tha kryetari, - se

inspektori i policisë, Zhaveri, i thirrur nga detyrat e tij në kryeqendrën e një rrethi fqinjë, është larguar nga seanca, madje edhe nga qyteti, menjëherë sa bëri dëshminë e vet. Ia dhamë autorizimin për këtë çështje me pëlqimin e zotit prokuror dhe të avokatit mbrojtës të të pandehurit.

-Është e drejtë, zoti kryetar, - vazhdoi prokurori. - Në mungesë të zotit Zhaver, besoj se e kam për detyrë t'u rikujtoj zotërinjve të trupit gjykues se çfarë tha ai me gojë të vet, këtu, para pak orësh. Zhaveri është një njeri i çmuar, i cili nderon me ndershmërinë e tij të ashpër e të përpiktë funksione të shkallës së ulët, por që janë të rëndësishme. Ja fjalë për fjalë dëshmia e tij: "Unë s'kam nevojë bilë as për paragjykimet morale, as për provat materiale për të përgënjeshtuar mohimet e të pandehurit. Unë e njoh fare mirë. Ky njeri nuk quhet Shamatjë; ky është një ish-i burgosur me punë të rënda, shumë i keq dhe shumë i rrezikshëm, i quajtur Zhan Valzhan. Edhe kur e liruan në mbarim të burgimit, organet kompetente e bënë aq me pahir, sa s'kishte ku të vinte, por s'kishin se ç'të bënin. Ai ka vuajtur nëntëmbëdhjetë vjet punë të rënda për vjedhje të stërholluar. Ishte orvatur nja pesë a gjashtë herë të arratisëj. Përveç vjedhjes që i bëri Zhervezit të Vogël dhe Pieronit, unë dyshoj për të edhe për një vjedhje të kryer në shtëpinë e shenjtërisë së tij, të ndjerit ipeshkëv të Dinjës. E kam parë shpesh në kohën kur isha ndihmësgardian në kampin e Tulonit. Përsërit se e njoh fare mirë."

Kjo deklaratë kaq e përpiktë duket se shkaktoi një përshtypje të thellë mbi publikun dhe trupin gjykues. Prokurori i dha fund ndërhyrjes së tij, duke ngulur këmbë që, në mungesë të Zhaverit, të tre dëshmitarët, Breveti, Shënildjëi dhe Koshëpaji, të dëgjoheshin përsëri dhe të pyeteshin solemnisht.

Kryetari ia pasoi urdhrin një ftuesi, dhe pas një hopi dera e dhomës së dëshmitarëve u hap. Ftuesi, i shoqëruar nga një xhandar që qëndronte gati për ta ndihmuar, futi në sallë Brevetin. Njerëzit mbanin frymën, dhe të gjithë kraharorët përpëliteshin, sikur të kishin pasur një shpirt të vetëm.

Ish-i burgosuri Brevet mbante xhakëtën e zezë e ngjyrë hiri të burgjeve qendrore. Breveti ishte një burrë rreth të

gjashtëdhjetave, që kishte një fytyrë matrapazi dhe një pamje horri. Këto të dyja ngandonjëherë hasen bashkërisht. Në burg, ku për horrllëqe të ndryshme ishte futur përsëri, ishte bërë diçka si ata nëpunësit e sporteve. Ishte një njeri, për të cilin përgjegjësit e tij thoshin: "Ky përpiket të bëhet i dobishëm". Lëmosharët, priftërinjtë e burgut sillnin dëshmi të mira për zakonet e tij fetare. Nuk duhet harruar që këto gjëra ngjishnin nën regjimin e Restaurimit.

-Brevet, - tha kryetari, - ju jeni goditur nga një dënim poshtërues, prandaj nuk mund të bëni betim...

Breveti uli sytë.

-Megjithatë, - vazhdoi kryetari, - edhe te njeriu të cilin ligji e ka degraduar, mund të mbetet, kur mëshira hyjnore e lejon, njëfarë ndjenje nderi dhe paanësie. Dhe pikërisht kësaj ndjenje i bëj thirrje unë në këtë orë vendimtare. Në qoftë se kjo ndjenje ndodhet te ju, dhe unë shpresoj se ndodhet, kini parasysht, nga njëra anë, këtë njeri, të cilin një fjalë juaja mund ta humbasë, dhe, nga ana tjetër, kini parasysht drejtësinë, të cilën një fjalë juaja mund ta ndriçojë. Çasti është solemn, dhe keni kohë akoma të tërhiqni ato që keni thënë, në qoftë se besoni se jeni gabuar. I pandehur, çohuni në këmbë. Brevet, vështrojeni mirë të pandehurin, përqendroni kujtesën tuaj dhe thuajnani, me dorë në zemër, nëse ngulni akoma këmbë të thoni se ky njeri është shoku juaj i dikurshëm i burgut, i quajtur Zhan Valzhan.

Breveti vështroi të pandehurin, pastaj u kthye nga trupi gjykues.

-Po, zoti kryetar. Jam unë ai që e kam njohur i pari dhe ngul këmbë në fjalën time. Ky njeri është Zhan Valzhani. Ka hyrë në Tulon më 1796 dhe ka dalë më 1815. Unë kam dalë vitin më pas. Tani ka pamjen e një hajvani, por duket se këtë e ka nga mosha; në burg ishte ters i tersëve. Unë e njoh me dhëmbë e me dhëmballë.

-Shkoni e uluni, - tha kryetari. - I pandehur, qëndroni në këmbë.

Futën në sallë Shënildjëin, i dënuar me punë të rënda përjetë, siç e tregonin xhaketa e tij e kuqe dhe kësula e gjelbër. Ai e vuante dënimin në kampin e Tulonit, prej nga e kishin

tërhequr pikërisht për këtë çështje. Ishte një burrë shtatvogël, rreth të pesëdhjetave, i gjallë, i rrudhur, i dobët, i verdhë, i pacipë, i ethshëm, i cili kishte në të gjitha gjymtyrët dhe në të gjithë trupin e tij njëfarë dobësie të sëmure dhe në vështrimin e tij njëfarë force të paanë. Shokët e tij të burgut e kishin mbiquajtur Je-nie-Dieu^{*)}.

Kryetari i drejtoi pothuajse po ato fjalë që i drejtoi Brevetit. Në çastin kur i rikujtoi se gjendja e tij poshtëruese ia hiqte të drejtën të bënte betim, Shënildjëi ngriti kokën dhe vështroi drejt turmën, pa i bërë bef syri. Kryetari e ftoi të mblidhte mendjen dhe e pyeti, si Brevetin, nëse ngulte këmbë se e njihte të pandehurin.

Shënildjëi ia plasi të qeshurit.

-Dreq! Si s'e njohkam? Ne kemi bërë pesë vjet të lidhur tok me të njëjtin zinxhir. Mos don të tallesh ti, lum miku?

-Shkoni uluni, - tha kryetari.

Ftuesi solli Koshëpajin. Ky i dënuari tjetër me burgim të përjetshëm, i ardhur nga kampi dhe i veshur me të kuq si Shënildjëi, ishte një fshatar nga Lurda dhe një gjysmari i Pirenejve. Kishte ruajtur bagëtinë maleve, dhe nga bari kishte shkarë e ishte bërë kusar. Koshëpaji nuk dukej më pak i egër dhe dukej akoma më guak se i pandehuri. Ishte një nga ata burrat fatkeqë të cilët natyra i ka përvijuar si shtazë të egra dhe shoqëria i katandis në galerianë.

Kryetari u përpoq ta shkundte me anë të disa fjalëve patetike dhe serioze dhe e pyeti, si dy të tjerët, nëse ngulte këmbë, pa lëkundje e pa turbullim, se e njihte njeriun që qëndronte në këmbë para tij.

-Ky është Zhan Valzhani, - tha Koshëpaji. - Bilé, atë e quanin Zhan Krikoja, aq i fortë ishte.

Secili nga pohimet e të tre burrave, që dukeshin sheshit se ishin të sinqerta dhe të besueshme, kishte shkaktuar në mes të njerëzve, një murmuritje ogurkeqe për të pandehurin. Murmuritje, që rritej e zgjatej gjithmonë e më tepër, sa herë që një deklaratë e re vinte e i shtohej deklaratës së mëparshme. I

^{*)} Zhë ni djë (frëngj.) – Unë mohoj zotin.

pandehuri, nga ana e tij, i kishte dëgjuar këto deklaratata me atë fytyrë të habitur, e cila, sipas akuzës, ishte mjeti i tij kryesor për mbrojtje. Në deklaratën e parë, xhandarët që ishin pranë tij e kishin dëgjuar të llototiste nëpër dhëmbë: "Pa shih! Ky na qenka e ç'na qenka!" Pas deklaratës së dytë, ai tha me zë pak më të lartë, me një pamje pothuajse të kënaqur: "Mirë!" Pas së tretës, ai bërtiti: "Bukuri në dynja!"

Kryetari e pyeti:

-I pandehur, e dëgjuat? Ç'keni për të thënë?

Ai u përgjigj:

-Them: "Bukuri në dynja!"

Një zhurmë e mbytur shpërtheu në publik dhe pastaj edhe në trupin gjykues. Dukej sheshit që njeriu e kishte humbur davanë.

-Ftues, - tha kryetari, - vendosni qetësinë. Tani do t'i mbyll debatet.

Në këtë çast u bë një lëvizje fare afër kryetarit. U dëgjua një zë që thërriste:

-Brevet, Shënildjë, Koshëpajë! Vështroni njëherë nga kjo anë këtej.

Të gjithë ata që e dëgjuan këtë zë, ngrinë në vend, aq i vajtueshëm dhe i tmerrshëm ishte ai. Sytë u kthyen drejt pikës nga vinte zëri. Një burrë, i vendosur në mes të spektatorëve të privilegjuar, që ishte ulur prapa trupit gjykues, sapo ishte ngritur në këmbë, kishte shtyrë derëzën që ndante tribunën e gjykatës nga publiku dhe po qëndronte në këmbë në mes të sallës. Kryetari, prokurori, zoti Bamatabua, njëzet veta e njohën dhe bërtitën njëzëri:

-Zoti Madëlen!

Shamatjëi çuditet shumë e më shumë

Ai ishte, dora vetë. Llamba e shkruesit ndriçonte fytyrën e tij. Kapelën e mbante në dorë, në veshjen e tij nuk kishte asnjë çrregullim, redingota e tij ishte e kopsitur me kujdes. Ai ishte zbehur në fytyrë dhe dridhej nga pak. Flokët, që ishin akoma ngjyrë hiri kur mbërriti në Arras, ishin bërë tani krejt të bardhë. Ata flokë ishin zbardhur qysh prej një ore që ndodhej aty.

Të gjithë sa ishin, ngritën kokën. Buja ishte e papërshkrueshme. Pati në sallë një çast ngurrimi. Zëri ishte aq therës, burri që qëndronte aty dukej aq i qetë, sa në çastet e para nuk mori vesh njeri se ç'po ndodhte. Njerëzit pyetën njëri-tjetrin se kush kishte thirrur ashtu. S'mund ta besonte kush se ishte pikërisht ai njeri i qetë që kishte lëshuar atë britmë të llahtarshme.

Kjo mëdyshje vazhdoi vetëm disa minuta. Përpara se kryetari dhe prokurori të nxirrnin ndonjë fjalë nga goja, përpara se ftuesit dhe xhandarët të mund të bënë ndonjë lëvizje, njeriu, të cilin të gjithë e quanin akoma në këtë çast zoti Madëlen, kishte bërë përpara drejt dëshmitarëve Koshëpajë, Brevet dhe Shënildjë.

-Nuk po më njihni? - tha ai.

Që të tre mbetën të ngrirë e gojëkryçur dhe treguan me anë të një shenje të kokës se nuk e njihnin fare. Koshëpaji, pak si i frikësuar, përshëndeti ushtarakisht. Zoti Madëlen u kthye nga gjyqtarët dhe tha me zë të butë:

-Zotërinj gjyqtarë, urdhëroni lirimin e të pandehurit. Zoti kryetar, urdhëroni të më arrestojnë. Njeriu që kërkoni ju, nuk është ai, por jam unë. Zhan Valzhani jam unë.

Asnjë gojë s'merrte frymë. Pas tronditjes së parë, të shkaktuar nga habia, kishte mbretëruar një heshtje varri. Ndihej në sallë ai farë tmerri fetar që kap turmën kur kryhet ndonjë gjë e madhërishme.

Ndërkohë, fytyra e kryetarit ishte pushtuar nga një ndjenjë

simpatie dhe trishtimi; ai këmbëu një shenjë të shpejtë me prokurorin dhe disa fjalë me zë të ulët me ndihmësgjyqtarët. Pastaj iu drejtua publikut dhe pyeti me një theks që u kuptua nga të gjithë:

-A ka ndonjë mjek këtu?

Prokurori mori fjalën:

-Zotërinj gjyqtarë, kjo ndodhi kaq e pazakontë dhe e papandehur që po turbullon të gjithë dëgjuesit na ngjall, ashtu sikundër edhe juve, vetëm një ndjenjë, të cilën s'kemi nevojë ta shprehim. Ju e njihni të gjithë, të paktën nga nami, të nderuarin zotin Madëlen, kryetarin e bashkisë së Montrëj-syr-Merit. Në qoftë se ka ndonjë mjek në sallë, ne bashkohemi në një mendje me zotin kryetar për t'iu lutur të ketë mirësinë t'i vijë në ndihmë zotit Madëlen dhe ta shoqërojë gjer në banesën e tij.

Zoti Madëlen s'e la fare prokurorin ta mbaronte fjalën. Ai e ndërpreu me një theks plot butësi dhe autoritet. Ja fjalët që tha ai; pikë për pikë ashtu si u shkruan menjëherë pas zhvillimit të gjyqit nga njëri prej dëshmitarëve të kësaj ngjarjeje, ashtu si tingëllojnë akoma edhe sot të gjalla në veshët e atyre që i dëgjuan, këtu e afro dyzet vjet të shkuar.

-Ju falemnderit, zoti prokuror, por unë nuk jam i çmendur. Do ta shikoni. Ju ishit duke bërë një gabim të madh, lëreni të lirë këtë njeri, unë po plotësoj një detyrë, ai i dënuari fatkeq jam unë. Unë jam i vetmi njeri që shoh qartë në këtë mes, dhe po ju them të vërtetën. Mund të më kapni, meqenëse më keni këtu. Megjithatë, unë pata bërë ç'më erdhi për dore. U fsheha prapa një emri, u bëra i pasur, u bëra edhe kryetar bashkie; desha të hyja në radhën e njerëzve të ndershëm. Siç duket, kjo qenka e pamundur. Më në fund, ka shumë gjëra që s'mund t'i them, nuk do t'ju kallëzoj jetën time, një ditë do ta dinë të gjithë. Unë kam vjedhur imzot ipeshkvin, kjo është e vërtetë; kam vjedhur Zhervezin e Vogël, kjo është e vërtetë. Kanë pasur të drejtë ata që ju kanë thënë se Zhan Valzhani ishte një fatkeq shumë shpirtlig. I gjithë gabimi, ndoshta, s'bie mbi të. Mbani vesh, zotërinj gjyqtarë, një njeri që ka rënë aq poshtë sa unë, s'ka si të ankohet për fatin e tij, as s'ka si t'i japë këshilla

shoqërisë; por, shikoni këtu, poshtërimi prej ku u orvata që të dilja, është një gjë e dëmshme. Galerat bëjnë galerianin. Mbajeni shënim këtë, po të doni. Para se të bija në burg, kam qenë një fshatar shumë pak i zgjuar, njëfarë idioti; burgu më ndryshoi. Isha trutharë dhe u bëra shpirtkeq; isha dru i pagdhendur dhe u bëra urë e zjarhtë. Më vonë, shpirtbutësia dhe mirësia më patën shpëtuar, ashtu sikundër ashpërsia më pati humbur. Por, më falni, ju nuk mund t'i kuptoni këto që po them unë. Do të gjeni në shtëpinë time, në hirin e vatrës, monedhën dyzetsushe që ia vodha shtatë vjet të shkuar Zhervezit të Vogel. S'kam ç'të shtoj tjetër. Kapmëni. O Zot! Zoti prokuror po tund kokën, ju thoni: "Zoti Madëlen është çmendur"; ju nuk më besoni! Kjo është për të ardhur keq. Të paktën, mos e dënoni këtë njeri! Si? Këta burra nuk më njohkan? Do të doja që edhe Zhaveri të ishte këtu. Ai, po, ai do të më njihnte menjëherë.

S'ka penë që mund ta përshkruajë se çfarë melankolie dashamirëse dhe të errët kishte në theksin që shoqëronte këto fjalë.

Ai iu kthye tre të burgosurve:

-Eh, pra, unë ju njoh ju! Brevet! A ju kujtohet?...

E ndërpreu fjalën, ngurroi një çast dhe tha:

-A të kujtohen ato tirantat me katrore prej trikoje që kishe ti në burg?

Breveti u rrëqeth e u hodh përpjetë nga çudia dhe e vështroi nga koka gjer te këmbët me fytyrë të trembur. Ai vazhdoi:

-Shënildjë, që e mbiquaje veten zot-mohues, ti e ke të gjithë supin e djathtë të djegur thellë, sepse një ditë e shtrive supin mbi një mangall të mbushur me prush për të fshirë të tri shkronjat P.D.P., të cilat, megjithatë, dallohen edhe sot e kësaj dite. Përgjigju, është e vërtetë apo jo?

-E vërtetë është, - tha Shënildjëi.

Pastaj iu drejtua Koshëpajit.

-Koshëpaj, ti ke në mes të llërës së krahut të djathtë një datë të shkruar me shkronja blu me barut të djegur. Kjo datë

është data e zbarkimit të perandorit në Kanë, 1 mars 1815. Përvishe mëngën.

Koshëpaji përveshi mëngën. Të gjitha vështrimet u derdhën mbi krahun e tij të zbuluar. Një xhandar afroi aty një llambë; data ishte me të vërtetë në llërë.

Burri i mjerë u kthye nga dëgjuesit dhe gjyqtarët me një buzëqeshje, nga e cila, ata që e panë, preken akoma edhe sot e kësaj dite kur e sjellin ndër mend. Ishte buzëqeshja e triumfit, por ishte gjithashtu edhe buzëqeshja e dëshpërimit.

-E shikoni mirë e bukur që unë jam Zhan Valzhani.

Në këtë sallë s'kishte më as gjyqtarë, as paditës, as xhandarë; kishte vetëm sy të mbërthyer dhe zemra të mallëngjyera. Asnjëriut s'i binte ndër mend roli që duhej të luante; prokurori harroi që ishte aty për të paditur, kryetari që ishte aty për të kryesuar, mbrojtësi që ishte aty për të mbrojtur. Sa çudi, nuk u bë asnjë pyetje, nuk ndërhyri asnjë autoritet. Vetia e shfaqjeve të madhërishtme është se ato rrëmbejnë e bëjnë për vete të gjithë shpirtat dhe të gjithë dëshmitarët i bëjnë spektatorë. Asnjëri syresh, ndoshta, nuk po kuptonte se çfarë ndiente në ato çaste; asnjëri, pa dyshim, nuk thoshte me vete se po shikonte atje tek flakërinte një dritë e madhe; të gjithë ndienin përbrenda se u ishin marrë sytë nga kjo dritë.

Ishte e qartë se para tyre ishte Zhan Valzhani. Ishte e qartë si rrezja e diellit. Shfaqja e këtij njeriu kishte mjaftuar për ta mbushur me dritën e së vërtetës këtë ndodhi, e cila ishte aq e errët pak çaste më parë. Pa qenë nevoja për asnjë shpjegim të mëtejshëm, e gjithë ajo turmë, si të ishte përpara ndonjë zbulimi elektrik, kuptoi aty për aty dhe me një vështrim atë histori të thjeshtë dhe madhështore të një njeriu që shfaqej e dorëzohej, me qëllim që një njeri tjetër të mos dënohej në vend të tij. Hollësitë, ngurrimet, kundërshtimet e vogla të mundshme humbën e u tretën në këtë bëmë të pafundme e të shkëlqyer.

Përshtypje që kaloi shpejt, por që atë çast ishte e papërmbajtshme.

-Nuk dua ta shqetësoj më tej sallën, - mori e foli përsëri Zhan Valzhani. - Po largohem së këtejmi, meqenëse s'po më arreston njeri. Kam shumë gjëra akoma për të bërë. Zoti

prokuror e di tani se kush jam unë, e di se ku po vete; ai mund të më arrestojë kur të dojë.

Ai u drejtua për nga dera e daljes. Asnjë zë s'pipëtiu, asnjë dorë nuk u zgjat për ta ndalur. Të gjithë i lëshuan udhë. Në këtë çast, kishte nuk di se ç'gjë hyjnore që i bën turmat e njerëzve të zmbropsen dhe të radhiten përpara një njeriu të vetëm. Ai kaloi përmes turmës me hapa të ngadalshëm. Kurrë nuk u mor vesh se kush e hapi derën, por është e sigurt se dera u gjend e hapur kur ai mbërriti aty. Si arriti aty, ai u kthye e tha:

-Zoti prokuror, mbetem në dispozicionin tuaj.

Pastaj iu drejtua sallës:

-Ju të gjithë, të gjithë sa jeni këtu, do të thoni se unë meritoj mëshirë, apo jo? O perëndi! Kur mendoj për atë që matesha të bëja e për një fije nuk e bëra, them se jam për t'u pasur zili. Megjithatë, unë do të desha më mirë që të gjitha këto të mos ngjisnin fare.

Ai doli, dhe porta u mbyll përsëri ashtu siç ishte hapur, sepse ata që bëjnë disa gjëra të madhërishme, janë gjithmonë të sigurt se dikush nga turma do t'u shërbejë.

Pas më pak se një ore, vendimi i trupit gjykues shkarkonte nga çdo paditje të quajturin Shamatjë, dhe Shamatjëi, i liruar aty për aty, largohej i habitur dhe i hutuar, duke besuar se të gjithë njerëzit ishin të çmendur dhe duke mos kuptuar gjë nga ky vegim.

Libri i tetë

KUNDËRGODITJE

I

Në cilën pasqyrë zoti Madëlen vështron flokët e tij

Dita kishte filluar të agonte. Fantina kishte kaluar një natë me ethe dhe pa gjumë, por të mbushur, nga ana tjetër, me vegime të gëzuara; në mëngjes e qepi gjumi. Motra Semplis, që i kishte ndenjtur tërë natën te koka, përfitoi nga kjo dremitje dhe vajti për të përgatitur një pije të re kinine. Kjo motër e denjë ndodhej që prej disa çastesh në laboratorin e infermierisë, e kërrusur mbi barnat e shishet e saj, për të parë më nga afër për shkak të asaj mjegulle që mugëtira përhap mbi sendet. Befas ajo ktheu kokën dhe lëshoi një britmë të lehtë. Përpara saj qëndronte zoti Madëlen. Ai sapo kishte hyrë pa bërë zhurmë.

-Ju qenkeni, zoti kryetar? - bërtiti ajo.

Ai u përgjigj me zë të ulët:

-Si vete ajo gruaja e shkretë?

-Tani s'është keq. Por ta dini se sa të shqetësuar që kemi qenë!

Motra i shpjegoi se çfarë kishte ndodhur, se Fantina një natë më parë kishte qenë shumë keq dhe se tani ishte më mirë,

sepse besonte që zoti kryetar kishte vajtur për të kërkuar fëmijën e saj në Monfermej. Motra nuk guxoi ta pyeste zotin kryetar, por e kuptoi mirë nga pamja e tij se ai nuk po kthehej aspak së andejmi.

-Mirë keni bërë, - tha ai, - keni pasur të drejtë që nuk e paskeni gënjyer.

-Po, - mori e foli përsëri motra, - por tani, zoti kryetar, kur ta kuptojë se nuk do ta shohë me sy fëmijën e vet, çfarë do t'i themi?

Zoti Madëlen qëndroi një çast i zhytur në mendime.

-Zoti do të na frymëzojë, - tha ai.

-Por, megjithatë, njeriu nuk mund të gënjejë, - murmuriti motra me gjysmë zëri.

Në dhomë dita kishte zbardhur fare. Drita i binte zotit Madëlen drejt e në fytyrë. Rastësisht motra ngriti sytë.

-O Zoti im, zotëri! - bërtiti ajo, - ç'ju paska ndodhur kështu? Ju qenkan zbardhur flokët krejt!

-Qenkan zbardhur! - tha ai.

Motra Semplis nuk kishte ndonjë pasqyrë; kërkoi në një çantë dhe nxori soje një pasqyrëz, që e përdorte mjeku i infermierisë për të parë ndonjë të sëmurë që vdiste e nuk merrte më frymë. Zoti Madëlen e mori pasqyrën, këqyri flokët dhe tha: "Shiko! Shiko!"

Këto fjalë i shqiptoi me moskokëçarje dhe sikur mendonte për tjetër gjë.

Motra ngriu e tëra akull nga nuk di se ç'gjë e panjohur që pikaste në të gjithë këtë çështje. Ai pyeti:

-A mund ta shoh të sëmurën?

-Por, zoti kryetar, zotëria juaj nuk do t'ia sjellë fëmijën? - tha motra. Ajo mezi guxoi ta lëshonte një pyetje të tillë.

-Pa dyshim, por duhen, të paktën, dy a tri ditë.

-Në qoftë se nuk do ta shikonte zotin kryetar gjer atëherë, - vazhdoi me druajtje motra, - ajo nuk do ta dinte që zoti kryetar është kthyer, kështu do të ishte më lehtë që ta kandisnim të bënte durim dhe, kur të arrinte fëmija, ajo do të mendonte krejt natyrshëm se zoti kryetar ka arritur tok me fëmijën. Kësisoj, nuk do të ishim as të detyruar të gënjenim.

Zoti Madëlen u duk sikur u mendua për disa çaste, pastaj tha me seriozitetin e tij të qetë:

-Jo, motra ime, duhet ta shoh. Ndoshta s'më pret puna.

Motra sikur nuk e vuri re këtë fjalë "ndoshta", e cila u jepte një kuptim të errët e të pazakontë fjalëve të zotit kryetar. Ajo u përgjigj duke ulur sytë dhe me zërin plot respekt:

-Tani ajo po pushon, por zoti kryetar mund të hyjë.

Ai bëri disa vërejtje rreth një porte që s'mbyllej mirë, zhurma e së cilës mund ta zgjonte të sëmurën, pastaj hyri në dhomën e Fantinës, iu afrua shtratit dhe hapi pakëz perdet. Ajo flinte. Fryma i dilte nga kraharori me atë zhurmë tragjike që është karakteristike për këto lloj sëmundjesh dhe që ua pikëllojnë zemrën nënave kur rrinë natën te koka e fëmijës së tyre të dënuar e të përgjumur. Por kjo frymëmarrje e dhimbshme mezi turbullonte njëfarë kthjelltësie të papërshkrueshme që i ishte përhapur mbi fytyrë dhe që e shpërftyronte teksa flinte. Zbehja e saj ishte kthyer në bardhësi; faqet e saj ishin bërë kuq si molla. Qerpikët e saj të gjatë e të verdhë, e vetmja bukuri që i kishte mbetur akoma nga virgjëria dhe bukuria e saj, përpëliteshin nga pak, megjithëse qëndronin të mbyllur e të ulur. I gjithë shtati i saj dridhej nuk di se nga ç'rrahje flatrash gati që të hapeshin dhe ta rrëmbenin me vete, flatra që i ndieje tek dridheshin, por që nuk i shikoje dot me sy. Tek e shikoje kështu, nuk të thoshte mendja kurrë se ajo ishte një e sëmurë gati e pashpresë. Ajo i përngjiste më shumë një krijese që do të fluturojë, sesa një krijese që do të vdesë.

Dega, kur një dorë afrohet për t'i këputur lulen, rrëqethet dhe duket njëkohësisht edhe sikur tërhiqet, por edhe sikur jepet. Trupi i njeriut ka diçka nga kjo rrëqethje kur vjen çasti që gishtat e mistershëm të vdekjes ta rrëmbejnë shpirtin.

Zoti Madëlen qëndroi disa kohë i palëvizur pranë këtij shtrati, duke vështruar herë të sëmurën, herë kryqin, ashtu siç bënte dy muaj më parë, ditën kur pati ardhur për të parën herë ta shikonte në këtë azil. Ata ishin përsëri që të dy në të njëjtin qëndrim, ajo duke fjetur dhe ai duke u falur; veçse tani, pas

atyre dy muajve që kishin rrjedhur, ajo i kishte flokët ngjyrë hiri dhe ai ngjyrë të bardhë.

Motra nuk kishte hyrë bashkë me të. Ai qëndronte pranë këtij shtrati, në këmbë, me gishtin mbi gojë, sikur desh t'i thoshte dikujt në dhomë që të mos fliste.

Ajo hapi sytë, e pa dhe tha qetë-qetë, me një buzëqeshje:

-Po Kozeta?

II

Fantina e lumtur

Ajo s'bëri ndonjë lëvizje habie të papritur, as ndonjë lëvizje gëzimi; ishte e tëra shend e verë. Ajo pyetje e thjeshtë: "Po Kozeta?" ishte bërë me një besim aq të thellë, me aq shumë siguri, pa pikë shqetësimi dhe dyshimi, saqë ai nuk gjeti dot asnjë fjalë për t'iu përgjigjur. Ajo vazhdoi:

-Unë e dija që ishit këtu. Po flija, por unë ju shikoja. Ka kohë që po ju shoh. Ju kam ndjekur me sy gjithë natën e natës. Ishit në mes të një drite lavdie dhe kishit rreth vetes gjithfarë fytyrash qiellore.

Ai ngriti sytë.

-Po, - ia nisi përsëri ajo, - thujmëni, pra, ku është Kozeta? Pse nuk e vutë mbi shtratin tim, që ta shihja kur të zgjohesha?

Ai u përgjigj mekanikisht me ca fjalë, të cilat s'pati kurrë mundësi t'i rikujtonte më vonë. Lumturisht, mjeku, të cilin e kishin lajmëruar, erdhi mbi këto e sipër. Ai i erdhi në ndihmë zotit Madëlen.

-Bija ime, - tha mjeku, - qetësohuni. Fëmijën këtu e keni.

Sytë e Fantinës erdhën e u ndezën dhe mbuluan me dritë gjithë fytyrën e saj. Ajo i bashkoi duart me një shprehje që përmbante gjithçka mund të ketë të dhunshme dhe të ëmbël lutja.

-Oh! - bërtiti ajo, - sillmani këtu!

Vetëgënjim prekës i nënës! Kozeta për të ishte gjithmonë fëmija i vogël që priste t'ia sillnin pranë.

-Akoma jo, - vazhdoi mjeku, - jo tani. Keni akoma edhe pak ethe. Po ta shikoni fëmijën, do të tronditeni dhe do të bëheni më keq. Duhet njëherë të shëroheni, pastaj.

Ajo e ndërpreu me turr.

-Por unë jam shëruar! Ja ku po jua them që jam shëruar! Oh, edhe ky mjeku paska qenë fare hajvan! Pa dale! Dua ta shoh fëmijën, unë!

-A e shikoni se si rrëmbeheni? - tha mjeku. - Përsa kohë që do të jeni kështu, unë do të kundërshtoj që t'jua sjellin fëmijën. Nuk mjafton vetëm ta shikoni, por duhet edhe të rroni për të. Kur të bëheni e arsyeshme, do t'jua sjell fëmijën me dorën time.

E shkreta nënë uli kokën.

-Zoti mjek, ju kërkoj ndjesë, ju kërkoj me të vërtetë shumë ndjesë. Herë tjetër, nuk do të kisha folur ashtu siç bëra tani; më kanë pllakosur aq shumë fatkeqësira, sa disa herë as vetë nuk e di se ç'them. Unë e kuptoj, ju keni frikë se mos tronditem; pra, unë do të pres sa të doni ju, por ju betohem se, po ta shoh vajzën, nuk do të pësoj asnjë të keqe. Unë e shoh atë dhe s'po e ndaj nga sytë qysh dje mbrëma. A doni të dini një gjë? Le të ma sjellin tani dhe do të shihni se si do të flas ëmbël e butë. Kaq kisha. A nuk është krejt e natyrshme që të kem dëshirë të shoh fëmijën tim, të cilin kanë vajtur apostafat të ma sjellin nga Monfermeji. S'më vjen inat për asgjë. Unë e di fort mirë që do të jem e lumtur. Gjithë natën e natës kam parë gjëra të bardha dhe njerëz që më buzëqeshnin. Zoti doktor do të ma sjellë Kozetën kur të dojë. Tani s'kam më ethe, përderisa jam shëruar; e ndiej fort mirë që tani s'kam gjë fare, por unë do të bëj sikur jam e sëmurë për t'ua bërë qejfin këtyre zonjave këtu. Kur ta shihni se jam fare e qetë, ju do të thoni: "I duhet dhënë fëmija."

Zoti Madëlen ishte ulur mbi një karrige që ndodhej bri shtratit. Ajo u kthye nga ai; dukej sheshit që ajo bënte shumë përpjekje për t'u dukur e qetë dhe "shumë e urtë", siç thoshte vetë, në atë dobësim nga sëmundja që i përngjete fëmijërisë, me qëllim që, duke e parë aq të qetë, të mos i nxirrnin ndonjë

vështirësi për t'i sjellë Kozetën. Megjithatë, ajo edhe përmbahej, edhe nuk mund të rrinte pa i drejtuar zotit Madëlen një mijë e një pyetje.

-A udhëtuar mirë, zoti kryetar? Oh! Sa i mirë jeni që vajtët e ma morët! Thuajmëni vetëm si është. A u lodh ndopak nga udhëtimi? Medet! Ajo nuk do të më njohë fare mua! Që prej asaj kohe do të më ketë harruar, koteleza ime e shkretë! Fëmijët s'të kanë hiç kujtesë. Janë njësoj si zogjtë. Sot ata shohin një gjë e nesër një tjetër, dhe s'mendojnë më për asgjë. A kishte ndërresa të bardha, të paktën? Si e ushqenin? Oh! Ta dini se sa kam vuajtur e hequr kur ia bëja vetes këto pyetje në kohën e mjerimit tim! Tani këto shkuan e vanë! Zoti kryetar, si ju duket vallë, a ju duket e bukur? Thuani, a nuk është e bukur vajza ime? Duhet të keni pasur shumë ftohtë në karrocën e pasagjerëve! A s'ka si ta sillni këtu vetëm një çikëz, sa ta shoh me sy? Merreni prapë menjëherë pastaj. Thuajmëni! Ju që jeni kryetar, po të dëshironit, mund të ma sillnit.

Ai i mori dorën.

-Kozeta është e bukur, - tha ai, - Kozeta është mirë me shëndet, do ta shikoni për së shpejti, por qetësohuni tani. Po flisni shumë me rrëmbim, dhe pastaj po nxirrni edhe krahët nga shtrati, dhe nga kjo ju kap kolla.

Dhe vërtet, një kollë e shkretë e si lezmë e pengonte Fantinën në çdo fjalë që thoshte.

Fantina nuk pipëtiu më; ajo pati frikë se mos, për shkak të ndonjë ankimi të shprehur me zjarr të tepruar, e kishte vënë në dyshim besimin që donte t'u ngjallte njerëzve që e rrethonin; kështu, ajo filloi të fliste për gjëra pa rëndësi.

-Monfermeji është mjaft i bukur, apo jo? Verës njerëzia shkojnë atje për të bërë qejf. Po ata Tenardietë si i kanë hallet, a u shkojnë mirë punët? Andej nga fshati i tyre nuk kalojnë edhe shumë udhëtarë. Ajo bujtina aty është si ndonjë birucë e shkallës së fundit.

Zoti Madëlen vazhdonte t'i mbante dorën dhe e këqyrte me ankth e shqetësim; dukej sheshit se ai kishte ardhur për t'i thënë disa gjëra, përpara të cilave mendja e tij ngurronte e s'dinte nga t'ia mbante. Mjeku, si mbaroi vizitën, ishte larguar.

Vetëm motra Semplis kishte mbetur pranë tyre.

Ndërkohë, në mes të kësaj qetësie, Fantina bërtiti:

-Po e dëgjoj! O Zot! Po e dëgjoj!

Ajo zgjati krahun për t'i bërë të tjerët rreth saj të heshtnin, mbajti frymën dhe filloi të mbante vesh me një kënaqësi shumë të madhe.

Ishte një fëmijë që po lodronte në oborr: fëmija e portieres ose e ndonjë punëtoreje. Këto janë nga ato rastësi që mund t'i hasësh gjithmonë dhe që duken sikur bëjnë pjesë në vënie në skenë të ngjarjeve kobzeza. Fëmija paskësh qenë një vajzë e vogël, që shkonte, vinte e vraponte për t'u nxehur, qeshte e këndonte me zë të lartë. Medet! E ku nuk u përziekan lodrimet e fëmijëve! Ajo ishte një vajzë e vogël, që Fantina e dëgjonte tek ia thoshte këngës.

-Oh, - vazhdoi ajo, - kjo është Kozeta ime! Ia njoh zërin unë!

Fëmija u largua ashtu siç kishte ardhur, zëri u shua, Fantina mbajti vesh edhe për disa çaste, pastaj fytyra e saj u err, dhe zoti Madëlen e dëgjoi të thoshte me zë të ulët:

-Sa shpirtkeq paska qenë edhe ky doktori, që s'më lë ta shoh time bijë. Që në fytyrë duket që është i keq ky njeri!

Por, ndërkohë, fundi i gazmendshëm i ideve të saj u ngjall përsëri. Ajo vazhdoi të fliste me vete, me kokë mbështetur mbi jastëk.

-Oh! Sa të lumtura do të jemi! Do të kemi një kopsht të vogël, njëherë! Zoti Madëlen ma ka premtuar. Ime bijë do të luajë në kopsht. Tani ajo duhet të ketë mësuar edhe shkrim. Do ta vë të m'i lexojë fjalët germë për germë. Do të vrapojë lëndinave duke ndjekur fluturat. Dhe unë do ta kundroj. Dhe pastaj do të bëjë krezmimin e saj të parë. Pa dale! Kur i bie ta bëjë krezmimin?

Ajo nisi të numëronte me gishta.

-...Një, dy, tre, katër... tani është shtatë vjeç. Duhet edhe pesë vjet. Do të ketë një vello të bardhë, çorape me azhur, do të ketë pamjen e një nuseje të vogël. O moj motërza ime e mirë, ju s'e dini se sa budallaqe jam unë, e shihni? Po bëj hesap e po vras mendjen për krezmimin e parë të sime bije!

Dhe filloi të qeshte.

Zoti Madëlen ia kishte lëshuar dorën Fantinës. Ai i mbante vesh këto fjalë, ashtu siç dëgjon njeriu erën tek fryn, me sytë për dhë, me mendjen të zhytur në mendime pa fund. Papritmas ajo pushoi së foluri dhe kjo e bëri zotin Madëlen të ngrinte kokën mekanikisht. Fantina ishte bërë e llahtarshme.

Ajo nuk po fliste më, nuk po merrte më frymë; ishte ngritur përgjysmë ndenjtur, supi i thatë i dilte nga këmisha; ajo fytyrë, pak më parë plot rrezatime, kishte marrë hijen e vdekjes dhe dukej sikur ishte ngulur mbi diçka të hatashme, përpara saj, në skajin tjetër të dhomës, sytë i ishin zmadhuar nga tmërri.

-O Zot! - bërtiti ai. - Ç'keni kështu, Fantinë?

Ajo s'u përgjigj, as nuk e lëshoi nga sytë atë farë sendi që dukej se shikonte, ajo i preku krahun me njëren dorë dhe me tjetrën i bëri shenjë të vështronte prapa.

Ai u kthye dhe pa Zhaverin.

III

Zhaveri i kënaqur

Ja se ç'kishte ndodhur.

Ora kishte rënë dymbëdhjetë e gjysmë e natës, kur zoti Madëlen kishte dalë nga salla e gjykatës penale të Arrasit. Ishte kthyer në bujtinë tamam në kohën e duhur për t'u nisur përsëri me karrocën e postës, ku, siç mbahet mend, ai kishte zënë një vend. Pak përpara orës gjashtë të mëngjesit kishte mbërritur në Montrëj-syr-Mer dhe pati kujdes të hidhte menjëherë në postë letrën drejtuar zotit Lafit, pastaj të hynte në infermieri dhe të shikonte Fantinën.

Ndërkohë, sa ishte larguar nga salla e gjykatës penale, prokurori, si e kishte mbledhur mendjen pas habitës së parë, kishte marrë fjalën për të shprehur keqardhjen ndaj veprës së çmendur të të nderuarit kryetar të bashkisë së Montrëj-syr-Merit, për të deklaruar se bindjet e tij s'kishin ndryshuar aspak

për shkak të asaj ndodhie të çuditshme, e cila do të sqarohet më vonë, dhe për të kërkuar hëpërhë dënimin e atij Shamatjëit, i cili kishte gjasë të ishte Zhan Valzhani i vërtetë. Këmbëngulja e prokurorit ishte në kundërshtim të hapur me ndjenjën e të gjithë të tjerëve, me atë të publikut, të gjykatës dhe të trupit gjykues. Avokati mbrojtës s'e pati shumë të vështirë ta kundërshtonte e ta rrëzonte atë llogo dhe të vendoste se, si rrjedhim i zbulimeve të zotit Madëlen, domethënë të Zhan Valzhanit të vërtetë, procesi ishte përmbysur nga kreu në fund dhe se trupi gjykues nuk kishte përpara syve veçse një njeri të pafajshëm. Avokati kishte nxjerrë me këtë rast disa vërejtje sensacionale, fatkeqësisht jo fort të reja, mbi gabimet gjyqësore etj., etj. Kryetari në përmbylljen e tij kishte marrë anën e avokatit mbrojtës, dhe trupi gjykues, brenda disa minutave, e kishte nxjerrë Shamatjëin të pafajshëm.

Por prokurorit i duhej një Zhan Valzhan dhe, tek i doli dore Shamatjëi, kapi Madëlenin.

Menjëherë, pas lirimit të Shamatjëit, prokurori u mbyll në dhomë me kryetarin. Ata biseduan tok "mbi domosdoshmërinë e vënies dorë mbi personin e kryetarit të bashkisë së Montrëj-syr-Merit." Kjo frazë ku ka dy *mbi* është e zotit prokuror, tërësisht e shkruar nga dora e tij mbi konceptin e raportit drejtuar prokurorit të përgjithshëm. Si kaloi tronditja e parë, kryetari nuk bëri shumë kundërshtime. Drejtësia duhej patjetër të bënte të sajën. Dhe pastaj, për t'i thënë të gjitha, ndonëse kryetari ishte njeri i mirë dhe i zgjuar, ishte në të njëjtën kohë edhe një monarkist pothuajse i flaktë dhe ishte prekur në sedër që kryetari i bashkisë së Montrëj-syr-Merit pati thënë *perandori* dhe jo *Bonaparti*.

Kështu pra, urdhri i arrestimit u lëshua. Prokurori e dërgoi në Montrëj-syr-Mer me anë të një kalorësi të posaçëm, të nisur në pikë të vrapit, dhe ngarkoi për zbatim inspektorin e policisë, Zhaverin.

Dihet se Zhaveri ishte kthyer në Montrëj-syr-Mer menjëherë pasi pati parashtruar dëshminë e tij.

Zhaveri u zgjua nga gjumi pikërisht në çastin kur kalorësi i posaçëm i dorëzoi urdhrin e arrestimit dhe mandatin e

shoqërimit. Kalorësi i posaçëm ishte vetë njeri i policisë dhe fort i stërvitur e i kuptueshëm, i cili me dy fjalë e vuri në dijeni Zhaverin mbi çka kishte ndodhur në Arras. Urdhri i arrestimit, i nënshkruar nga prokurori, ishte përpiluar kështu: "Inspektor Zhaveri do të kapë dhe do të rreshtojë zotin Madëlen, kryetarin e bashkisë së Montrëj-syr-Merit, i cili në seancën e sotme u njoh se ishte i burgosuri me punë të rënda, tani në lirim, i quajtur Zhan Valzhan."

Ndokush që nuk do ta kishte njohur që më parë Zhaverin dhe që do ta kishte parë në çastin kur hyri në paradhomën e infermierisë, nuk do të kishte pikasur se ç'po ngjiste dhe do t'i ishte dukur njeri krejt i zakonshëm nga të pamët. Ishte i ftohtë, i qetë, hijerëndë, flokët e thinjur në tëmthat i kishte krehur e lëpirë në mënyrë të përsosur dhe i kishte ngjitur shkallët me atë hapin e tij të ngadalshëm, siç e kishte zakon. Ai që do ta kishte njohur thellë dhe që do ta kishte këqyrur me kujdes, do të ishte dridhur i tëri. Tokëza e qafores së tij prej lëkure, në vend që të ishte mbi zverk, ishte mbi veshin e tij të majtë. Kjo tregonte se atë e kishte pushtuar një shqetësim i padëgjuar.

Zhaveri ishte njeri me karakter të patundur; ai nuk lejonte rrudha as në detyrë, as në uniformën e tij; metodik me keqbërësit, i papërkulshëm me kopsat e uniformës së tij. Përderisa e kishte vënë keq tokëzën e qafores, medoemos që brenda tij kishte një nga ato tronditjet që mund t'i quajmë tërmete të brendshme.

Kishte ardhur ashtu thjesht, kishte kërkuar një tetar dhe katër policë në postëkomandën fqinje, i kishte lënë ushtarët në oborr dhe kishte kërkuar t'i tregonte dhomën e Fantinës portieres, të cilën s'e brejti dyshimi për asgjë, sepse ajo ishte mësuar me njerëz të armatosur që kërkonin zotin kryetar.

Si arriti te dhoma e Fantinës, Zhaveri rrotulloi çelësin, shtyu derëzën lehtë-lehtë, ashtu siç bëjnë rojtarët e të sëmurëve ose hafijet, dhe hyri brenda.

Për të folur më saktë, ai nuk hyri. Qëndroi në këmbë te dera e hapur gojë, me kapelën në kokë, me dorën e djathtë në redingotën e mbërthyer deri nën mjekër. Në palën e bërlylit

dukej doreza prej plumbi e shkopit të tij të madh që fshihej prapa tij.

Qëndroi kështu afro një minutë, pa e pikasur njeri praninë e tij aty. Befas Fantina ngriti sytë, e pa dhe e bëri zotin Madëlen të kthehej.

Në çastin kur vështrimi i zotit Madëlen u ndesh me vështrimin e Zhaverit, Zhaveri, pa luajtur vendit, pa lëvizur, pa u afruar, u bë i llahtarshëm. S'ka ndjenjë njerëzore që të arrijë të të tmerrojë më shumë se sa gëzimi i armikut.

Ishte fytyra e një demoni që sapo gjen përsëri viktimën e vet.

Siguria se, më në fund, ai kishte shtënë në dorë Zhan Valzhanin, bëri që të spikatnin mbi fizionominë e tij të gjitha ato sa kishte brenda në shpirt. Fundi i trazuar u ngjiti në sipërfaqe. Zhaveri ndiente njëfarë poshtërimi që i kishte humbur pakëz gjurmët dhe ishte gabuar për disa minuta lidhur me atë Shamatjëin. Por ky poshtërim shuhej nën mburrjen që ai kishte rënë në erë i pari dhe që kishte pasur për një kohë të gjatë një nuhatje aq të hollë e të përpiktë. Kënaqësia e Zhaverit shpërtheu në qëndrimin e tij sovran. Përçudnia e triumfit buloi mbi atë ballë të ngushtë. Ishte me të vërtetë shpalosja e gjithë llahtarës që mund të paraqitë një fytyrë e kënaqur.

Zhaveri në atë çast dukej sikur kishte zënë qiellin me dorë. Pa e kuptuar qartë as ai vetë, por, megjithatë, me një intuitë të mjegullt të domosdoshmërisë dhe të suksesit të tij, ai, Zhaveri, mishëronte drejtësinë, dritën dhe të vërtetën në tagrin e tyre qiellor për të dërrmuar e shtypur të keqen. Ai kishte prapa dhe rreth vetes së tij, në një thellësi të pafundme, autoritetin, arsyen, gjënë e gjykuar, ndërjegjen e përligjur, ndëshkimin publik, të gjitha yjet e qiellit; ai mbronte rendin, shpërthente nga ligji rrufenë, merrte shpagimin e shoqërisë, i vinte në ndihmë absolutes; ai çohet përpjetë, i rrethuar nga lavdia; në fitoren e tij kishte një mbeturinë sfide dhe luftimi; në këmbë, krenar, i tëri dritë, ai shpaloste e vinte në pah, mu në mes të kaltërsisë, shtazërinë mbinjerëzore të një kryeengjëlli gjakësor; hija e frikshme e veprimit që kryente, bënte të dukej në grushtin e tij të shtrënguar llamburitjen e vagët të shpatës së shoqërisë; i

lumtur dhe i zemëruar, ai i kishte vënë thundrën në grykë krimet, vesit, rebelimit, zvetënimet, ferrit dhe rrezatonte, shfaroste, buzëqeshte; dhe kishte një madhështi të pakundërshtueshme në këtë shën Mëhill të përbindshëm.

Zhaveri ishte i llahtarshëm, por s'kishte asgjë të poshtër.

Drejtësia, sinqeriteti, papërlyerja, bindja, ndjenja e detyrës, janë gjëra që, po të lajthitin, mund të bëhen të neveritshme, por që, edhe duke qenë të neveritshme, mbeten të mëdha; madhështia e tyre, e vetvetishme ndaj ndërgjegjes njerëzore, vazhdon të qëndrojë edhe në llahtarë. Këto janë virtyte që kanë një ves, tmerrin. Gëzimi i ndershëm e i pamëshirshëm i një fanatiku mizor ruan në vetvete nuk di se çfarë rrezatimi të përnderueshëm në mënyrë të lemerishme. Pa e pikasur as ai vetë, Zhaveri, në atë lumturinë e tij të hatashme, ishte për t'i qarë hallin, ashtu si çdo injorant që triumfon. S'kishte gjë më therëse e më të tmerrshme se ajo fytyrë, ku dilte në pah ajo që mund të quhet e gjithë e keqja e së mirës.

IV

Pushteti i ligjshëm i fiton përsëri të drejtat e veta

Fantina s'e kishte parë fare Zhaverin që nga ajo ditë kur zoti Madëlen e kishte shpëtuar nga thonjtë e këtij njeriu. Truri i saj i sëmurë nuk pikasi asgjë, veçse ajo nuk pati asnjë dyshim se ai kishte ardhur për ta marrë. Fantina nuk mundi ta duronte atë fytyrë të neveritshme, ndjeu sikur i ra pika, mbuloi fytyrën me të dyja duart dhe thirri me ngashërim:

-Zoti Madëlen, shpëtomëni!

Zhan Valzhani - nuk do ta quajmë ndryshe tani e tutje - ishte çuar në këmbë. Ai i tha Fantinës me zërin më të butë e më të qetë që mund të bëhej:

-Rrini e qetë. Ai nuk vjen për ju.

Pastaj iu drejtua Zhaverit dhe i tha:

-E di se çfarë doni, e di.

Zhaveri u përgjigj:

-Hajde, shpejt!

Pati në tonin e zërit që shoqëroi këto dy fjalë nuk di se ç'gjë shtazore e ç'drithërim. Zhaveri nuk tha: "Hajde, shpejt!" ai tha: "Haj shpet!" Asnjë ortografi nuk mund ta jepte theksin me të cilin u shqiptuan ato fjalë: ajo s'ishte më një fjalë njerëzore, por një ulërimë bishe.

Zhaveri nuk veproi aspak sipas zakonit; nuk hyri fare në çështje; nuk e tregoi urdhrin e arrestimit dhe të shoqërimit. Për të, Zhan Valzhani ishte një luftëtar i mistershëm dhe i pakapshëm, një mundës i terreve, të cilin e mbante të pushtuar qysh prej disa vjetësh, pa mundur që ta shtinte poshtë. Ky arrestim nuk kishte një fillim, por një mbarim. Prandaj ai u mjaftua vetëm me këto fjalë: "Hajde, shpejt!"

Duke folur kësisoj, ai s'bëri asnjë hap përpara; vërviti mbi Zhan Valzhanin atë vështrim që e lëshonte si ndonjë sfurk dhe me të cilin e kishte zakon të tërhiqte me dhunë fatkeqët pas vetes. Dhe pikërisht një vështrim të tillë kishte ndier Fantina t'i hynte gjer në palcë dy muaj të shkuar.

Kur dëgjoji Zhaverin, Fantina kishte hapur përsëri sytë. Por zoti kryetar ishte aty. Pse të kishte frikë ajo? Zhaveri bëri përpara gjer në mes të dhomës dhe bërtiti:

-More ti! Do të vish apo jo?

E mjera grua vështroi rreth saj. S'kishte njeri tjetër aty veç murgeshës dhe zotit kryetar. Kujt mund t'i drejtoheshin vallë këto fjalë aq të urrejtshme? Vetëm asaj. Dhe iu rrëqeth i tërë shtati.

Atëherë ajo pa diçka të paparë e të padëgjuar, aq të paparë e të padëgjuar, sa kurrë ndonjëherë s'e kishte ndeshur as në kllapitë më të zeza të etheve. Ajo pa hafijen Zhaver të kapte për zverku zotin kryetar; pa zotin kryetar të ulte kokën. Iu duk sikur bota po venitej e po shuhej e tëra.

Zhaveri, në të vërtetë, e kishte kapur Zhan Valzhanin për zverku.

-Zoti kryetar! - bërtiti Fantina.

Zhaveri ia plasi të qeshurit, një të qeshuri të llahtarshëm, që ia zbulonte të gjithë dhëmbët.

-S'ka më "zoti kryetar" këtu!

Zhan Valzhani nuk bëri asnjë përpjekje ta trazonte atë dorë që kishte kapur qaforen e redingotës së tij. Ai tha:

-Zhaver...

-Quamëni zoti inspektor.

-Zotëri, - vazhdoi Zhan Valzhani, - desha t'ju them një fjalë veçan.

-Flisni me zë të lartë! Me zë të lartë! - vazhdoi Zhaveri, - me mua flitet me zë të lartë!

Zhan Valzhani vazhdoi duke ulur zërin:

-Është puna për një lutje që dua t'ju bëj...

-Të them të flasësh me zë të lartë.

-Por atë që do t'ju them unë, duhet ta dëgjoni vetëm ju...

-E ç'më hyn në punë mua kjo? S'dua të dëgjoj fare unë!

Zhan Valzhani u kthye nga ai dhe i tha shpejt e shpejt e me zë të ulët:

-Më jepni tri ditë! Tri ditë sa të vete e të kërkoj fëmijën e kësaj gruaje të mjerë! Do të paguaj gjithçka që do të nevojitet. Po të doni, edhe mund të më shoqëroni.

-Dashke dhe të tallesh! - bërtiti Zhaveri. - Hajde, hajde! S'të dija kaq hajvan! Ti po më kërkon tri ditë për t'ua mbathur këmbëve pastaj! Dhe thua se i do për të vajtur e për të marrë vajzën e kësaj gruaje! Ah! Ah! Bukur, besa! Kjo na qenka ç'na qenka!

Fantina pati një të dridhur.

-Fëmijën tim! - bërtiti ajo, - për të marrë fëmijën tim! S'paska qenë këtu, pra! Motra ime, përgjigjuni, ku është Kozeta? Dua vajzën time! Zoti Madëlen! Zoti kryetar!

-Ja dhe kjo tjetra, tani! Do ta mbyllësh gojën apo jo, moj kuçkë! Çfarë vendi i ndyrë paskësh qenë edhe ky! Këtu të burgosurit na paskëshin qenë autoritete shtetërore dhe gratë publike na u kuruakëshin sikur të ishin kontesha! Ah! Po të gjitha këto gjëra do të ndryshojnë; kupa është mbushur me kohë!

Ai ia nguli sytë Fantinës dhe shtoi duke kapur përsëri me

një dorë edhe kravatën, edhe këmishën, edhe jakën e Zhan Valzhanit:

-Ja ku po të them se këtu s'ka më zoti Madëlen, as zoti kryetar. Këtu ka një vjedhës, një kusar, ka një të burgosur të quajtur Zhan Valzhan! Dhe është pikërisht ky që kam në dorë! Ja se ç'ka këtu!

Fantina brofi përpjetë dhe, duke u mbajtur mbi krahët e saj të ngrirë dhe mbi duart, vështroi Zhan Valzhanin, vështroi Zhaverin, vështroi murgeshën dhe hapi gojën, sikur desh të fliste. Një gulçimë doli nga thellësia e fytit të saj, dhëmbët i kërcitën, shtriu krahët me ankth, duke hapur duart me përpëlajtje, dhe kërkoi rreth saj, sikur po kërkonte dikë që po mbytej; pastaj u plas papritur mbi jastëk. Koka iu përplas pas kokës së shtratit dhe iu var mbi kraharor, goja i mbeti e çelur dhe sytë të hapur e të shuar.

Ajo kishte vdekur.

Zhan Valzhani vuri dorën e vet mbi dorën e Zhaverit, që po e mbante mbërthyer, e hapi atë dorë, sikur të kishte hapur dorën e një fëmije, pastaj i tha Zhaverit:

-Ju e vratë këtë grua.

-Do t'u japim fund këtyre avazeve, apo jo? - bërtiti Zhaveri, i tërbuar. - Unë s'kam ardhur këtu për të dëgjuar arsyetime. Mjaft e zgjatëm. Roja është poshtë. Hajde, shpejt përpara, ose t'i hodha prangat!

Në një kënd të dhomës ishte një shtrat hekuri në gjendje mjaft të keqe, i cili shërbente për motrat kur rrinin natën e përgjonin të sëmurën. Zhan Valzhani shkoi drejt atij shtrati, shkuli soje sa hap e mbyll sytë kokën e krevatit, që ishte fort e ronitur, gjë fare e lehtë për muskuj si ata të tijtë, kapi si me tapanxhë shufrën e sipërme dhe qëndroi e këqyri Zhaverin. Zhaveri u zbraps nga dera.

Zhan Valzhani, me shufrën e hekurt në dorë, eci ngadalë drejt shtratit të Fantinës. Kur arriti aty, u kthye dhe i tha Zhaverit me një zë që sa mezi dëgjohej:

-Nuk ju këshilloj të ma prishni qetësinë në këtë çast.

Ajo që ishte e sigurtë që se Zhaveri po dridhej.

Tha njëherë me mend të shkonte e të thërriste rojën, por

Zhan Valzhani mund të përfitonte nga kjo minutë për t'u arratisur. Qëndroi, pra, kapi bastunin nga maja dhe u mbështet me shpinë pas kornizës së derës, pa ia shkukur sytë Zhan Valzhanit.

Zhan Valzhani vendosi bërrylin mbi kreun e shtratit dhe ballin mbi dorën e vet dhe filloi të sodiste Fantinën të palëvizur dhe të shtrirë. Qëndroi kështu si i humbur e i heshtur dhe, me gjasë, duke mos menduar më për asgjë nga kjo jetë. Në fytyrën dhe në qëndrimin e tij s'kishte më tjetër veçse një mëshirë që nuk mund të shprehet me gojë. Disa çaste pas këtij ëndërrimi, ai u përkul mbi Fantinën dhe i foli me zë të ulët.

Çfarë i tha? Çfarë mund t'i thoshte vallë ai burrë, që ishte për lumë, asaj gruaje, që kishte vdekur? Ç'ishin ato fjalë? Askush mbi dhë nuk i ka dëgjuar. Por e vdekura a i dëgjoi vallë? Ka disa iluzione prekëse që ndoshta janë të vërteta kulmuese. Ajo që është jashtë çdo dyshimi, është se motra Semplis, e vetmja dëshmitare e kësaj gjëje që po ndodhte, ka treguar shpesh se në çastin kur Zhan Valzhani i foli në vesh Fantinës, ajo pa shkoqur të bulonte një buzëqeshje që s'rrëfëhet mbi ato buzë të zbehta dhe në ato bebëza syri të mjegullta, të përmbytura nga habia e varrit.

Zhan Valzhani e mori me të dyja duart kokën e Fantinës dhe e rregulloi mbi jastëk, ashtu siç mund të kishte bërë një nënë për fëmijën e vet, i lidhi kordonin e këmishës dhe ia futi flokët nën skufje. Si mbaroi këto, ai ia mbylli edhe sytë.

Në këtë çast, fytyra e Fantinës dukej çuditërisht e ndritur.

Dora e Fantinës varej jashtë shtratit. Zhan Valzhani u përgjunj përpara kësaj dore, e çoi peshë butë-butë dhe e puthi.

Pastaj u çua në këmbë dhe, duke u kthyer nga Zhaveri:

-Tani, - tha ai, - jam në dorën tuaj.

V

Varr i përshtatshëm

Zhaveri e dorëzoi Zhan Valzhanin në burgun e qytetit.

Arrestimi i zotit Madëlen shkaktoi në Montrëj-syr-Mer një bujë të madhe ose, më mirë të themi, një tronditje të jashtëzakonshme. Jemi të pikëlluar që s'kemi si e fshehim se, me t'u dëgjuar fjala: "Ishte një *galerian*", pothuajse të gjithë e braktisën. Në më pak se dy orë, të gjitha të mirat që kishte bërë u harruan e shkuan dhe ai s'mbeti tjetër "veçse një galerian." Duhet thënë se njerëzit s'i dinin akoma hollësitë e ngjarjes së Arrasit. Gjithë ditën e ditës dëgjoheshin në të gjitha anët e qytetit bisedime si këto:

-Si? S'e ditkeni? Ai na kishte qenë një i burgosur i liruar! Kush kështu? Kryetari i bashkisë. Bah! Zoti Madëlen? Po. Vërtet? Nuk quhej Madëlen, por paske pasur një emër për llahtarë, Bezhan, Bozhan, Buzhan. Ah, o Zot, o Zot! U arrestua! U arrestua! Në burg brenda, në burgun e qytetit, gjersa ta transferojnë! Të transferojnë! Do ta transferojnë! Po ku do ta transferojnë? Do të kalojë para gjyqit penal për një vjedhje në rrugë të madhe që paskësh kryer dikur. Eh, pra! Mua ma ndiente zemra. Ai njeri ishte tepër i mirë, tepër i përkryer dhe shitej tepër i butë. Nuk pranonte Dekoraten e Kryqit, u jepte parë të gjithë kalamajve të vegjël që takonte udhës. Gjithmonë më ka thënë mendja se në këtë mes do të kishte ndonjë mesele të keqe.

"Sallonet", sidomos, nuk lanë gjë pa thënë rreth kësaj çështjeje. Një zonjë e shtyrë në moshë, e abonuar në gazetën: "Drapeau blanc",⁹² shfaqti këtë mendim, thellësinë e të cilit është pothuajse e pamundur ta matësh:

-S'më vjen hiç keq, jo. Kjo punë do t'u sjellë mendtë bonapartistëve!

Kështu pra, ajo hije që kishte qenë quajtur zoti Madëlen u davarit e u venit në Montrëj-syr-Mer. Vetëm tre a katër veta në të gjithë qytetin i qëndruan besnikë këtij kujtimi. Në këtë numër përfshihej edhe portierja plakë që i kishte shërbyer.

Mbrëmjen e po asaj dite, kjo plakë e denjë ishte ulur në kthinën e vet, akoma e trembur dhe e zhytur në mendime plot trishtim. Fabrika kishte qenë mbyllur gjithë ditën e ditës, porta e madhe e karrocave ishte kyçur, rruga ishte e shkretë. Në shtëpi kishin mbetur vetëm dy murgeshat, motra Perpetua dhe motra Semplis, të cilat përgjonin pranë trupit të Fantinës.

Rreth orës kur zoti Madëlen kishte zakon të kthehej në shtëpi, portierja e mirë u ngrit mekanikisht, mori çelësin e dhomës së zotit Madëlen në një sirtar dhe pishtarin e qiriut që ai përdorte çdo mbrëmje për t'u ngjitur në dhomën e vet, pastaj e vari çelësin te gozhda ku e merrte zakonisht dhe vendosi pishtarin mënjanë, sikur me gjithë mend e priste. Pastaj u ul përsëri në karrigen e saj dhe filloi prapë të mendonte. E shkreta plakë i kishte bërë të gjitha këto pa qenë fare e vetëdijshme për ato që bënte.

Vetëm pas dy orësh, ajo u shkëput nga ky ëndërrim dhe bërtiti: "Pa shih, pa shih! O zoti Krisht, o zonja shën Mëri! Unë korba paskam varur çelësin në gozhdë!"

Në këtë çast, dritareza e kthinës u hap, një dorë kaloi nëpër të, kapi çelësin e pishtarin dhe ndezi qiriun në shandanin vezullues. Portierja mbeti gojëhapur, i erdhi një britmë në fyt, por e përmbajti. Ajo e njihte këtë dorë, atë krah, atë mëngë redingote.

Ishte zoti Madëlen.

Para se të hapte gojën për të folur, ajo mbeti për disa sekonda e *mbërthyer*, siç e thoshte vetë më vonë, duke treguar ndodhinë e saj.

-O perëndi, zoti kryetar, - bërtiti ajo më në fund, - unë ju kujtoja në...

U ndal aty; fundi i frazës do të ishte fare pa respekt për fillimin. Zhan Valzhani ishte për të gjithmonë zoti kryetar.

Ai e mbaroi mendimin e saj.

-Në burg, - tha, - isha në burg. Theva shufrën e hekurt të një dritareje, u hodha poshtë ngamaja e një pullazi dhe tani ja ku jam këtu. Po ngjitem në dhomë, shkoni e ma thërritni motrën Semplis. Do të jetë pa dyshim pranë asaj gruas së shkretë.

Plaka u bind pa një pa dy.

Ai s'e porositi për asgjë; ishte fare i sigurt se ajo do ta ruante më mirë se ç'mund të ruhej vetë.

Nuk u mor vesh kurrë se si kishte arritur të hynte në oborr, pa e hapur deriçkën. Kishte, dhe e mbante gjithmonë me vete, një çelës kopil, që hapte një portëz anësore; por duhej t'ia kishin kontrolluar xhepat dhe t'ia kishin gjetur çelësin kopil. Kjo pikë s'ka qenë sqaruar.

Ngjiti shkallët që çonin në dhomën e tij. Si arriti lart, la qiriun në shkallaren e fundit të shkallëve; hapi derën pa bërë zhurmë dhe vajti të mbyllte verbatazi dritaren dhe kanatën; pastaj u kthye e mori qiriun dhe hyri në dhomën e vet.

Kujdesi ishte me vend; mund t'ju kujtohet se dritarja e tij shihej nga ana e rrugës.

Hodhi një vështrim rreth vetes, mbi tryezë, mbi karrigen, mbi shtratin e tij, që nuk ishte prishur qysh prej tri ditësh. Nuk kishte mbetur asnjë gjurmë nga çrregullimi i asaj nate të kaluar. Portierja e kishte "rregulluar dhomën". Vetëm se i kishte nxjerrë nga hiri dhe i kishte vendosur pastër mbi tryezë të dyja skajet e shklopit të mbathur me hekur dhe monedhën dyfrangëshe të nxirë nga zjarri.

Mori një fije letër, mbi të cilën shkroi: "Ja, këto janë të dyja skajet e shklopit tim të mbathur me hekur dhe monedha dyfrangëshe që ia kam vjedhur Zhervezit të Vogël, për të cilin fola në gjykatën penale", dhe vendosi mbi atë fletë monedhën e argjendtë dhe të dyja copat e hekurit, në mënyrë që ato të ishin gjëja e parë që të binin në sy kur të hynte njeri në dhomë. Nxori nga dollapi një këmishë të vjetër, të cilën e grisiti. Me të bëri disa copa, ku mbështolli të dy shandanët e argjendtë. Nuk ngutej, as ishte i tronditur, dhe, ndërsa mbështille shandanët e ipeshkvit, kafshonte nganjëherë një copë bukë të zezë. Ka të ngjarë që të ishte buka e burgut, që do ta kishte marrë me vete duke u arratisur.

Kjo gjë u konstatua nga thërrimet e bukës që u gjendën mbi dyshemenë e dhomës, kur organet gjyqësore bënë më vonë një bastisje.

Dikush trokiti dy herë te dera.

-Hyni, - tha ai.

Ishte motra Semplis.

Ajo ishte e zbehtë në fytyrë, sytë i kishte të kuq, shandani që mbante i kolovitej në dorë. Ashpërsitë e fatit kanë këtë anë të veçantë, që, sado të përsosur ose të ftohtë që të jemi, ato na e nxjerrin nga thellësia e brendësisë natyrën njerëzore dhe e detyrojnë që të shfaqet përsëri përjashta. Në tronditjet e asaj dite, murgësja ishte bërë përsëri grua. Kishte qarë dhe po dridhej e tëra.

Zhan Valzhani sapo kishte mbaruar së shkruari një letër, të cilën ia dha murgëshës duke thënë:

-Motra ime, këtë letër do t'ia dorëzoni zotit famullitar.

Letra ishte e hapur. Ajo i hodhi një sy.

-Mund ta lexoni, - tha ai.

Murgësja lexoi: *"I lutem zotit famullitar të ketë kujdes mbi gjithçka që po lë këtu. Do të ketë mirësinë të paguajë me një pjesë të tyre shpenzimet e mia gjyqësore dhe ato të varrimit të gruas që vdiq sot. Pjesa tjetër që mbetet, do të jetë për të varfrit."*

Motra deshi të fliste, por mezi arriti të belbëzonte disa tinguj të palidhur. Megjithatë, ia doli të thoshte:

-A nuk dëshiron zoti kryetar i bashkisë ta shohë për të fundit herë atë fatkeqen e shkretë?

-Jo, - tha ai, - po më ndjekin, do të më arrestonin në dhomën e saj dhe kjo gjë do t'i prishte qetësinë.

S'e kishte mbaruar mirë fjalën, kur një zhurmë e madhe u dëgjua te shkallët. Ata dëgjuan një rrapëllimë këmbësh që ngjiteshin lart dhe portieren plakë që thërriste sa mundte me zërin e vet therës:

-Imzot, ja ku po ju bëj bé në perëndinë që këtu s'ka hyrë njeri, as ditën, as natën, dhe që unë s'jam larguar as nga porta!

Një burrë u përgjigj:

-E, megjithatë, në dhomë ka dritë.

Ata njohën zërin e Zhaverit.

Dhoma ishte sajuar në atë mënyrë që dera, duke u hapur, fshihte qoshen e murit në të djathtë. Zhan Valzhani i fryu qiriut dhe zuri vend në atë qoshe.

Motra Semplis ra në gjunjë afër tryezës.

Dera u hap. Zhaveri hyri brenda.

Dëgjohej pëshpëritja e shumë burrave dhe kundërshtimet e portieres në korridor. Murgësja nuk i ngriti sytë. Ajo po falej.

Shandani ishte mbi oxhak dhe jepte pak dritë.

Zhaveri pa motrën dhe u step.

Secilit i kujtohet se vetë Zhaveri ishte gatuar asisoj që përnderimi ndaj çdo lloj pushteti ishte për të si buka që hante dhe si ajri që thithte. Ishte një kallëp i tëri dhe nuk pranonte as vërejtje, as kufizime në këtë pikë. S'do mend që për të pushteti kishtar ishte i pari nga të gjithë. Ai ishte fetar, i sipërfaqshëm dhe korrekt në këtë pikë, ashtu si edhe për të gjitha pikat e tjera. Për sytë e tij, një prift ishte një mendje që s'gabon kurrë, një murgësje ishte një krijesë që nuk bën kurrë mëkat. Ata ishin shpirtra të murosur në këtë botë me një portë të vetme që nuk hapej kurrë veçse për të lënë vetëm të vërtetën të kalonte.

Por, veç kësaj, ishte edhe një detyrë tjetër që e mbante mbërthyer dhe e shtynte në mënyrë urdhëruese në drejtim të kundërt. Shtytja e dytë ishte që të qëndronte dhe të hidhte të paktën një pyetje.

Ishte ajo motra Semplis, që s'kishte gënjyer kurrë në jetën e saj. Zhaveri e dinte dhe për këtë e përnderonte në mënyrë të veçantë.

-Motra ime, - tha ai, - vetëm jeni në këtë dhomë?

Erdhi një çast i llahtarshëm, gjatë të cilit portieres së varfër për pak sa s'i ra të fikët. Motra ngriti sytë dhe u përgjigj:

-Po.

-Ashtu, - vazhdoi Zhaveri, - më falni në qoftë se ngul këmbë, por unë e kam për detyrë, nuk keni parë sonte një njeri, një burrë? Ai është arratisur, dhe ne po e kërkojmë, - atë të quajturin Zhan Valzhan, nuk e keni parë?

Motra u përgjigj:

-Jo.

Ajo gënjeu. Gënjeu dy herë me radhë, aty për aty, pa ngurruar, ashtu shpejt e shpejt, sikur të kishte bërë ndonjë veprim fetar.

-Më falni, - tha Zhaveri dhe u largua duke u përkulur thellë.

Pohimi i motrës për Zhaverin ishte një diçka aq vendimtare, sa që ai nuk e vuri ré fare sesa i pazakontë ishte ai qiriu që sapo ishte shuar e që po lëshonte edhe tym mbi tryezë.

Një orë më vonë, një burrë, duke ecur përmes drurëve e hijeve, po largohej me të shpejtë nga Montrëj-syr-Meri në drejtim të Parisit. Ky burrë ishte Zhan Valzhani. Është përcaktuar me anë të dëshmisë së dy a tre karrocierëve që e kishin takuar se ai mbante në dorë një pako dhe se ishte veshur me një bluzë. Ku e kishte marrë atë bluzë? Kjo nuk u mor vesh kurrë. Ndërkohë një punëtor plak kishte vdekur disa ditë më parë në infirmierinë e fabrikës, duke mos lënë gjë tjetër veç bluzës së tij. Ndoshta ishte ajo.

Një fjalë të fundit për Fantinën.

Ne të gjithë kemi një nënë, tokën. Ia kthyen Fantinën kësaj nëne.

Famullitari kujtoi se kishte bërë mirë, dhe ndoshta mirë bëri, duke ruajtur nga ato që kishte lënë Zhan Valzhani sa më shumë të holla për të vobektit. Fundi i fundit, për cilët ishte fjala? Për një të burgosur dhe për një vajzë publike. Për këtë arsye, ai e thjeshtoi varrimin e Fantinës, dhe e katandisi në atë gjë ngushtësisht të domosdoshme që quhet varr i përbashkët.

Fantina u varros në atë skaj të varrezave që jepet falas dhe që u përket të gjithëve dhe askujt dhe ku të varfrit humbasin pa nam e pa nishan.

E shtrinë Fantinën nëpër terr në mes të kockave që u gjetën përpara; ajo iu nënshtrua përzierjes poshtëruese. Ajo u përplas në varrin e përbashkët. Varri i saj i përngjau shtratit të saj.

Pjesa e dytë

.....

KOZETA

Libri i parë

VATERLOJA

I

Çfarë takon njeriu kur ujen nga Nivelà

Vitin që shkoi (1861), një mëngjes të bukur maji, një udhëtar, ai që tregon këtë histori, mbërrinte nga Nivelà dhe po drejtohej për në La Hypë. Ecte në këmbë. Ai po ndiqte, midis dy radhë drurësh, një xhade të gjerë, të shtruar me kalldrëm, që dallgëzonte mbi disa kodra të cilat vijnë njëra pas tjetrës, e ngrenë udhën lart dhe pastaj e lënë të ulet dhe formojnë aty ca si dallgë vigane. E kishte lënë prapa Liluanë dhe Bua-Senjër-Izakun. Ai shquante në perëndim atë kambanoren e Brenë-l'Alëdit, mbuluar me petëza guri, që ka formën e një vazoje të përmbysur. Sapo kishte lënë prapa një pyll mbi një stom dhe një kabaré, që kishte në ballë këtë tabelë: "*Nga të katër anët. Eskabò, kafe private*", e cila ndodhej në qoshen e një udhëze tërthore, përbri një direku të harmuar krimbash, që mbante mbishkrimin: *Ledhi i vjetër N:4*.

Një gjysmë çerek lege më tutje nga kjo kabare, ai arriti në fund të një lugine të vogël, ku ka ca ujë që kalon nën një qemer të sajuar në ledhin e udhës. Tufa e pemëve të rralla, por shumë të blerta, që mbush luginën në njërin krah të xhadesë, përhapet

aty-këtu në krahun tjetër nëpër livadhe e shkon plot hijeshi dhe si pa rregull drejt Brenë-l'Alëdit.

Aty në të djathtë, buzë udhës, kishte një bujtinë, një karro me katër rrota përpara portës, një vandak të madh purtekash për të mbajtur bisqet e sumbullares, një parmendë, një kopicë ferrash të thata pranë një gardhi, shkurre, ca gëlqere, që avullonte në një gropë katrore, një shkallëz lëvizëse përgjatë një hangari të vjetër me çatma kashte. Një vajzë e re po prashiste në një arë, ku një afishe e madhe me ngjyrë të verdhë, me gjasë afishja e ndonjë shfaqjeje panairi, bërë me rastin e ndonjë të kremteje fetare, po valëvitej në erë. Te cepi i bujtinës, bri një pellgu ku po lundronte një flotëz rosash, një monopati i shtruar keq me kalldrëm futej mes ferrash e shkurresh. Ky udhëtar u rras aty brenda.

Pas nja njëqind hapash, si kaloi përgjatë një muri të shekullit të pesëmbëdhjetë, me në krye një majuc trekëndësh të mprehtë, ndërtuar me tulla ngjyrash të ndryshme, ai u gjend përpara një porte të madhe guri me hark, i cili mbështetej mbi një kornizë vijëdrejtë, në stilin hijerëndë të kohës së Luigjit XIV, dhe me dy medaljone të sheshta anash. Një ballore e zymtë sundonte mbi këtë portë; një mur pingul me balloren gati-gati e prekte portën dhe formonte befasi një kënd të drejtë me të. Mbi livadhin përpara portës dergjeshin tri lesa, përmes të cilave kishin mbirë lesheli të gjitha lulet e majit. Porta ishte e mbyllur. Ajo mbyllej me dy kanate të harmuara e të zbukuruara me një çekan trokitës të ndryshkur.

Dielli ishte shumë i këndshëm, degët kishin atë fërgëllim të ëmbël të majit, që duket sikur vjen më shumë nga foletë e zogjve, sesa nga era. Një zog i vogël trimosh, ndoshta i ndezur nga dashuria, po çahet së kënduari si i çmendur, në një pemë të madhe.

Kalimtari u përku dhe këqyri në gurin majtas, në fund të këmbëzës së djathtë të portës, një gropë mjaft të gjerë e rrumbullake, që dukej si zgavra e ndonjë topthi. Në atë çast të dyja kanatet u hapën dhe doli një fshatare.

Ajo e pa kalimtarin dhe vërejti se çfarë po këqyrte.

-Këtë e ka bërë kështu një gjyle franceze, - i tha ajo.

Dhe shtoi:

-Ajo që shikoni atje, më lart, në portë, pranë një gozhde, është vrima e një pushke të madhe biskajene. Biskajena nuk e ka shpuar dot drurin tejtej.

-Si quhet ky vend këtu? - pyeti kalimtari.

-Hugomont, - tha fshatarja.

Kalimtari u çua në këmbë. Bëri disa hapa dhe shkoi e po vështronte sipër gjerdheve. Dalloi në horizont, përmes pemëve, njëfarë bregoreje dhe mbi këtë bregore një diçka, e cila së largu i përngjiste një luani.

Ai ndodhej në fushën e betejës së Vaterlosë.

II

Hugomonti

Ai, Hugomonti, atje, ka qenë bërë një vend i përzishëm, fillimi i pengesës, qëndresa e parë që hasi në Vaterlo ai druvari i madh i Evropës, që quhej Napoleon; gdhëri i parë ku ndeshi sëpata.

Hugomonti kishte qenë një kështjellë, ndërsa tanimë ishte katandësur në një fermë. Hugomonti, për atë që merret me gjërat e lashta, është *Hygomonsi*. Kjo kështjellë ka qenë ndërtuar nga Hygoi, zot i Somerelit, po ai që pajisi kapëlaninë e gjashtë të abacisë së Vilerit.

Kalimtari shtyu portën, hasi me bërryl një kaloshinë të vjetër, që ndodhej nën qemer, dhe hyri në oborr.

Gjëja e parë që i ra në sy në këtë copë avlli, ishte një portë e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, që duket sikur sajton një harkore, meqenëse gjithçka rreth saj është rrënuar e shembur. Pamja monumentale lind shpesh nga rrënoja. Pranë harkores hapet në një mur një tjetër portë me gurë qemeri e kohës së Henrikut IV, përmes së cilës duken drurët e një pemishteje. Bri asaj porte, një gropë plehu, kazma e lopata, disa qerre, një pus i vjetër me rrasë guri dhe me rodhan hekuri, një mës që

kërcen, një gjeldeti që fryhet, një kishëz mbi të cilën qëndron një kambanore e vogël, një dardhë në lule me një pritë të rrasur pas murit të kishëzës: ja ç'ishte ai oborr, pushtimi i të cilit u bë ëndrra e Napoleonit. Po ta kishte marrë atë cep trualli, ai do ta kishte fituar ndoshta të gjithë botën. Disa pula qëmtojnë andej e këtej pluhurin me sqep. Dëgjohet një hungërimë; është një qen i madh që skërfit dhëmbët dhe që zëvendëson anglezët.

Anglezët qëndruan si burrat. Të katër kompanitë e rojave të Kukut i bënë ballë për shtatë orë rresht sulmit të tërbuar të një ushtrie të tërë.

Po ta shikosh në hartë, në plan gjeometrik, duke përfshirë ndërtesat dhe avllinë, Hugomonti paraqet njëfarë katërkëndëshi të parregullt, nga i cili njëri kënd është i prerë e i këputur. Pikërisht në këtë kënd ndodhet porta jugore e ruajtur nga ai mur, prej të cilit mund ta përvëlosh e ta vrasësh tjetrin edhe me flakën e pushkës. Hugomonti ka dy porta: portën jugore, atë të kështjellës, dhe portën veriore, atë të fermës. Napoleoni dërgoi kundër Hugomontit vëllanë e vet, Zheromin; aty u ndeshën divizionet e Gijëminotit të Fuait dhe të Bashëlyisë; aty pothuajse i gjithë korpusi i Rejit u fut në luftime dhe u thye; gjylet e Kelermanit u shkrinë të tëra aty mbi atë copë mur heroik. Nuk mjaftoi vetëm brigada e Bodyenit për ta sulmuar Hugomontin në veri, u desh ta cënonte në jug edhe brigada e Suajit, pa ia dalë dot ta merrte.

Ndërtesat e fermës janë buzë oborrit nga krahu jugor. Një pjesë e portës veriore, e thyer nga francezët, kacavirret në mur. Ka katër dhoga të mbërthyera me gozhdë mbi dy breza të tërthortë, ku dallohen akoma vratat e sulmit.

Porta e veriut, që e shembën francezët dhe së cilës tani banorët e atjeshëm i kanë vënë një copë dërrasë për të zëvendësuar atë copën që rri varur në mur, hapet gojë në fund të oborrit; ajo është çelur drejt e në një mur, i cili poshtë është prej guri dhe sipër prej tullash dhe mbyll oborrin nga ana e veriut. Është një portë e thjeshtë qerresh, ashtu siç ka në të gjitha fermat, me dy kanate të bëra me dhoga të pagdhendura; përtej, livadhe. Kacafytja për të marrë këtë hyrje, ka qenë e tërbuar. Për një kohë të gjatë dukeshin akoma mbi trarin e

sipërm të portës njolla duarsh të gjakosura. Pikërisht këtu u vra Bodyeni.

Stuhia e luftimit qëndron akoma e gjallë në këtë oborr; llahtara duket me sy; rrokullima e përleshjes ka ngrirë në vend; ajo jeton, ajo vdes; sikur ka ndodhur dje. Muret heqin shpirt, gurët bien, zgërdhelet bërtasin; vrimat janë plagë; pemët e vaisura e duke u dridhur duken sikur po mundohen t'ia mbathin nga sytë këmbët.

Ky oborr më 1815 kishte më shumë ndërtime se sot. Disa ndërtime, që janë prishur e hedhur poshtë, formonin aty kllapa, qoshe e bërryla kënddrejtë.

Këtu ishin barrikaduar anglezët, francezët hynë brenda, por nuk mundën të mbaheshin. Bri kishëzës ngrihet e rrënuar ose barkshpuar një krah i kështjellës, e vetmja mbeturinë që ka qëndruar në këmbë nga kështjella e Hugomontit. Kështjella shërbeu si kullë, kishëza shërbeu si blokhaus. Aty luftëtarët u therën e u kërdisën. Francezët u grinë nga plumbat, që vinin nga të katër anët, nga prapa mureve, nga maja e pullazeve, nga thellësia e qilareve, nga të gjitha dritaret, nga të gjitha bimcat, nga të gjitha të çarat e gurëve. Francezët sollën vandakë me shkarpa dhe u vunë zjarrin mureve dhe njerëzve; breshëria pati si përgjigje zjarrin.

Në krahun e rrënuar, përmes dritaresh të pajisura me shufra hekuri, mund të dallosh dhomat e shkatërruara të një ndërtese me tulla; në këto dhoma ishin ngujuar ushtarët e gardës angleze; shkalla në formë spiraleje, e bërë shoshë që nga kati përdhes e gjer në çati, duket si pjesa e brendshme e ndonjë guaske deti të thyer copë-copë. Shkalla ka dy kate; anglezët, të rrethuar pisk te shkallët dhe të grumbulluar në shkallaret e sipërme, i kishin prerë shkallaret e poshtme. Tani kanë mbetur disa rrasa të gjera guri mavi, që formojnë një kopicë nëpër hithrat. Një duzinë shkallaresh qëndrojnë akoma në mur; mbi të parën është gdhendur figura e një sfurku tredhëmbësh. Këto shkallë, që s'i arrin dot njeri, janë të forta në zgavrat e tyre. Gjithë pjesa tjetër i përngjet një nofullë dhëmbërenë. Aty janë edhe dy pemë të vjetra; njëra është vvarë e tharë, tjetra është plagosur në rrëzë të trungut dhe bleron në

prill. Që prej vitit 1815, ajo ka nisur të mbijë e të zhvillohet përmes shkallëve.

Në kishë u bë kasaphanë. Të duket çudi që ka rënë përsëri qetësia brenda. Nuk është thënë asnjë meshë që kur u bë kasaphana. Megjithatë, lteri ka mbetur aty, një lter druri i gdhendur trashë e i mbështetur pas një muri gurësh të palatuar. Katër mure të lara me lëng gëlqereje, një portë përballë lterit, dy dritare të vogla me qemer, mbi portë një kryq i madh druri, sipër kryqit një dritarez katrore si frëngji e mbushur me një vandak bari të thatë, në një qoshe, përtokë, një kanatë xhamllëku copë e thërrime, e tillë është kjo kishëz. Pranë lterit është mbërthyer me gozhdë një statujë druri e shën Anës, e shekullit të pesëmbëdhjetë; kokën e Krishtit fëmijë e kishte përllarë predha e një biskajene. Francezët, pasi u bënë për një çast zotër të kishëzës, prej nga pastaj u larguan, i vunë zjarrin. Flakët e përpinë tërë karabinanë; ajo u bë një furrë e vërtetë; porta u dogj, dyshemeja u dogj. Krishti prej druri nuk u dogj. Zjarri i brejti këmbët, të cilat kanë mbetur të cinguara e të nxira, pastaj u ndal. Mrekulli, sipas vendasve.

Muret janë të mbuluara me mbishkrime. Pranë këmbëve të Krishtit lexohet ky emër: *Henkuinez*. Pastaj këta emra të tjerë: *Konti de Rio Major, markezi dhe markezja Almagro (Havana)*. Ka emra francezë me pikëçuditëse, shenjë tërbimi. Më 1849 e zbardhën murin me gëlqere. Kombet, aty, shaheshin e poshtëroheshin njëri me tjetrin.

Tamam te porta e kësaj kishëze u gjet e u mbart një kufomë që mbante një shpatë në dorë. Kjo kufomë ishte e nëntoger Lëgrosë.

Si del nga kishëza, në të majtë, shikon një pus. Ka dy puse në këtë oborr. Pyesin: "Pse nuk ka kovë dhe rodhan te ky pusi këtu?" "Sepse aty s'mbush më njeri ujë". "Pse s'mbush më njeri ujë?" "Sepse është plot me eshtëri njerëzish".

I fundmi që mbushi ujë nga ky pus, quhej Gijom Van Kilsom. Ky ishte një fshatar që banonte në Hugomont dhe punonte aty si kopshtar. Më 18 qershor 1815 familja e tij mori nga sytë këmbët dhe vajti e u fsheh në pyll.

Pylli rreth abacisë së Vilerit strehoi gjatë shumë ditëve e

netëve të gjithë këtë popullsi fatkeqe të shpërndarë. Edhe sot e kësaj dite, disa mbeturina që bien në sy, si trungje pemësh të djegura, shënojnë vendin e atyre strehimeve të varfra, që dridheshin në thellësitë e zabeleve.

Gijom Van Kilsomi qëndroi në Hugomont "për të ruajtur kështjellën" dhe u struk në një qilar. Aty anglezët e zbuluan, e shkulën nga vendi ku që fshehur dhe, duke e goditur me faqet e shpatave, e detyruan këtë njeri të llahtaritur nga frika që t'u jepte ujë. Ata kishin etje; ky Gijomi na u sillte për të pirë. Ujët ai e mbushte pikërisht nga ky pus. Shumë syresh pinë aty gllënjken e tyre të fundit. Këtij pusi, ku pinë aq të vdekur, iu desh që të vdiste edhe vetë.

Pas luftimeve u desh që kufomat të varroseshin me ngut. Vdekja ka një mënyrë të vetën për t'iu qepur fitores nga pas e për të mos e lënë të qetë dhe sjell pas lavdisë murtajën. Tifoja është një shtojcë e triumfit. Ky pus ishte i thellë, dhe njerëzia e bënë varrezë. Hodhën aty brenda treqind të vdekur. Ndoshta u ngutën tepër. A ishin vallë të gjithë të vdekur? Legjenda thotë se jo. Duket se natën, pas groposjes, u dëgjuan nga pusi zëra të mekur që rënktonin e thërrisnin.

Ky pus është i vetmuar në mes të oborrit. Tri mure, gjysmë gur e gjysmë tullë, të palosura si flatrat e një paraventi dhe që dukeshin si ndonjë kullëz katrore, e rrethojnë pusin nga tri anë. Ana e katërt është e hapur. Nga ky krah vinin e mbushnin ujë. Mori në fund ka njëfarë dritareje pa formë, ndoshta është ndonjë vrimë gjyleje. Kjo kullëz ka pasur edhe tavan, nga i cili kanë mbetur vetëm trarët. Hekuri lidhës i murit të djathtë vizaton një kryq. Po të përkulesh, syri të humbet në një cilindër të thellë tullash, i tëri terr. Rreth e rrotull pusit këmbët e mureve humbasin nëpër hithra.

Ky pus nuk ka aspak për qepen atë rrasën mavi, që u shërben si mbulesë gjithë puseve të Belgjikës. Rrasa mavi këtu është zëvendësuar me një traversë, pas së cilës mbështeten pesë a gjashtë trungje druri gjithë nyja dhe të thatë, që duken si kockurina të mëdha. Pusi s'ka më as kovë, as zinxhir, as rodhan; por ka akoma postafin e gurtë, që shërbente për të derdhur ujët. Uji i shirave mblidhet aty, dhe kohë më kohë ndonjë zog i

pyjeve aty afër vjen të pijë dhe pastaj merr fluturimin.

Në këtë rrënojë, një shtëpi, shtëpia e fermës, është e banuar edhe sot e kësaj dite. Porta e kësaj shtëpie të nxjerr në oborr. Bri një pllake të bukur gotike në këtë portë ka një dorezë hekuri në formë tërfili, të vendosur pak si tërthorazi. Në çastin kur togër Uilda nga Hanovra kapte këtë dorezë për të gjetur strehë brenda në fermë, një zapator francez ia këputi dorën me një të goditur sëpate.

Familja që banon në shtëpi, ka pasur gjysh kopshtarin plak Van Kilsom, i cili ka vdekur prej kohësh. Një grua e thinjur vjen e të thotë: “Unë kam qenë këtu. Isha tre vjeç. Motra ime më e madhe kishte frikë dhe qante. Na morën e na shpunë në pyll. Unë isha në krahët e sime ëme. Njerëzia rrasnin veshin për tokë për të dëgjuar. Unë imitoja topin dhe bëja bum-bum!”

Një portë e oborrit, aty në të djathtë, siç e thamë, të çon në pemishte. Pemishtja është e tmerrshme.

Ajo është tripjesëshe ose gati-gati mund të thoshim e ndarë në tri akte. Pjesa e parë është një kopsht, e dyta është pemishtja që thamë, e treta është një pyll. Këto tri pjesë kanë një si avlli të përbashkët: nga krahu i hyrjes, ndërtesat e kështjellës dhe të fermës; në fund, një mur. Muri i djathtë është me tulla, muri i fundit është me gurë. Së pari hyn në kopsht. Ky vjen si i pjerrët dhe është mbjellë me rrush toke, përzier me bimësi të egra. Kopshti mbyllet nga një mur mbajtës monumental gurësh të gdhendur me parmakë dybarqesh. Ky ishte një kopsht fisniku në atë stilin e parë francez, që ka qenë para Lënotrit⁹³⁾ sot është një gërmadhë e ferrë e gjallë. Shtyllëzat kanë sipër globe që duken si gjyle guri. Mund të numërosh edhe sot e kësaj dite dyzet e tri shtyllëza mbi këmbëzat e tyre në trajtë kubi; të tjerat dergjen shtrirë në bar. Pothuajse të gjitha kanë skërfitje nga breshëritë e mushqetave. Një shtyllëz e thyer është vendosur mbi parmak si ndonjë këmbë e cunguar.

Pikërisht në këtë kopsht, që është më i ulët se pemishtja, gjashtë këmbësorë të të parit regjiment të lehtë, si hynë aty brenda dhe si nuk mundën të dilnin dot, të kapur si në kurth e të përndjekur si arinjte në strofkë, pranuan luftimin kundër dy kompanish hanovrase, njëra prej të cilave ishte e armatosur

me karabina. Hanovrasit ishin përgjatë atyre shtyllëzave dhe shtinin nga lart. Këta këmbësorë, duke iu përgjigjur nga poshtë, gjashtë kundër njëqindtëve, si trima me fletë dhe duke pasur për mburoja vetëm rrushtë e tokës, bënë një çerek ore gjersa vdiqën.

Si ngjit disa shkallare, kalon nga kopshti në pemishten e vërtetë. Atje, në disa metra katrorë, ranë një mijë e pesëqind veta brenda në më pak se një ore. Muri duket sikur është gati t'ia fillojë përsëri luftimit. Të tridhjetë e tetë frëngjitë e hapura nga anglezët në lartësira të ndryshme, janë akoma aty. Përpara frëngjisë së gjashtëmbëdhjetë ndodhen dy varre angleze prej graniti. Frëngji ka vetëm në murin nga jugu; sulmi kryesor që andej vinte. Këtë mur e mbulon nga jashtë një gardh i madh ferrash; francezët erdhën duke besuar se kishin të bënë vetëm me gardhin, e kapërcyen dhe gjetën atë mur, pengesë dhe pusi, me gardën angleze prapa, me tridhjetë e tetë frëngjitë, që villnin zjarr të gjitha njëherësh, me një rrebesh breshërisht e plumbash; dhe brigada e Suajit atje u thye. Kështu filloi Vaterloja.

Megjithatë, pemishtja u mor. Shkallë s'kishin, por francezët u kacavorën me thonj. U ndeshën e luftuan fytafyt nën pemët. I gjithë ai bar u la në gjak. Një batalion i Nasaut, shtatëqind shpirt, u përta e u shua i tëri aty. Faqja e jashtme e murit, kundër të cilit u drejtuan të dy bateritë e Kelermanit, është e brejtur nga breshëria.

Kjo pemishte është e ndjeshme, si të gjitha pemishtet e tjera, në muajin maj. Aty ka luleverdha e luleshqerra, bari ngrihet gjer në gju, aty kullotin kuaj parmende, litarë krini, ku thahen të linjtat, përshkojnë largësitë midis pemëve dhe i detyrojnë kalimtarët të ulin kokën. Kur ecën në këtë djerrinë, të fundoset këmba në gropat e hapura prej urithëve. Në mes të barit, të bie në sy një trung i shkukur me rrënjë, që dergjet i shtrirë e bleron. Këtu u mbështet me shpinë e dha shpirt major Bllekmeni. Nën një pemë të madhe aty pranë ra gjenerali gjerman Dyplat, pinjoll i një familjeje franceze, që ishte arratisur kur ra nga fuqia edikti i Nantës.⁹⁴⁾ Tamam përbri vaiset një dru molle i vjetër e i sëmurë, të cilin e kanë lidhur me një bandazh kashte dhe ginë. Pothuajse të gjithë drurët e mollëve

po roniten nga të plakurit. S'ka asnjë syresh që të mos ketë ngrënë ndonjë plumb ose ndonjë predhë biskajene. Eshtëritë e pemëve të thara janë me shumicë në këtë pemishte. Degëve fluturojnë korbata, ndërsa poshtë ka një pyll plot me manushaqe.

Bodyeni i vrarë, Fuai i plagosur, zjarri, masakra, kasaphana, një rrëké e përbërë nga gjak anglez, gjerman e francez, e përzier plot tërbim, një pus i mbushur cit me kufoma, regjimenti i Nasoit dhe regjimenti i Brunsvikut të shkatërruar, Dyplati i vrarë, Bllekmeni i vrarë, gardistët anglezë të sakatuar, njëzet batalione franceze mbi të dyzet batalionet e korparmatës së Rejit të dhjetuara, tri mijë burra vetëm në këtë gjermadhë të Hugomontit, të prerë me shpata, të bërë thela-thela, të therur, të pushkatuar, të djegur, dhe të gjitha këto që një fshatar të vijë e t'i thotë sot udhëtarit: "Zotëri, më jepni tri franga, po deshët që t'juja shpjegoj atë punën e Vaterlosë".

III

18 qershori i vitit 1815

Le të kthehemi prapa, kjo është një nga të drejtat e tregimtarit, dhe le të vendosemi në vitin 1815, madje edhe pak më përpara epokës kur fillon veprimi i treguar në pjesën e parë të këtij libri.

Po të mos kishte rënë shi natën duke u gdhirë 18 qershori i vitit 1815, e ardhmja e Evropës do të kishte ndërruar faqe. Disa pika uji më shumë ose më pak e bënë Napoleonin të vaisej. Që Vaterloja të bëhej fundi i Austerlicit, fati pati nevojë vetëm për pakëz shi; dhe një ré që përshkoi qiellin, diçka e papritur për atë stinë, mjaftoi për të përmbysur një botë të tërë.

Beteja e Vaterlosë - dhe kjo i dha dorë Blyherit të arrinte në kohë, - mundi të fillonte vetëm në orën njëmbëdhjetë e gjysmë. Pse? Sepse toka ishte e lagur. U desh të pritej pak sa të thahej, me qëllim që artileria të mund të manovronte si duhej.

Napoleoni ishte oficer artilerie, dhe këtë ai e ndiente thellë.

Në thelb të këtij kapiteni të mrekullueshëm ishte njeriu i cili në raportin që i bëri Direktoratit mbi Abukirin⁹⁵) thoshte: "Aksh gjyle jona vrau gjashtë njerëz." Të gjitha planet e betejave të tij janë bërë për predhat e topit. Përqendrimi i artilerisë mbi një pikë të caktuar, ky ishte për të çelësi i fitores. Ai e trajtonte strategjinë e gjeneralit armik si ndonjë kështjellë, të cilin e godiste dhe e bënte fërtele. Pikën e dobët e dërrmonte me breshëri; i lidhte dhe i zgjidhte betejat me grykën e topit. Në gjeninë e tij kishte qitje me top. Të çante formacionet katrore, të dërrmonte e të shpërndante masat, kjo ishte për të gjithçka, të godiste, të godiste pareshtur, dhe këtë punë ia besonte gjyles së topit. Metodë e frikshme, e cila, e bashkuar me gjenium, e bëri të pamposhtur për pesëmbëdhjetë vjet me radhë këtë atlet të zymtë të boksit të luftës.

Më 18 qershor 1815 ai i varte aq më tepër shpresat mbi artilerinë, sepse kishte për vete edhe epërsinë në numër. Uelingtoni kishte vetëm njëqind e pesëdhjetë e nëntë gryka zjarri, Napoleoni kishte dyqind e dyzet.

Merreni me mend sikur toka të ishte e thatë, gjë që do t'i jepte dorë artilerisë të lëvizte dhe veprimet të nisnin në orën gjashtë të mëngjesit! Beteja do të kishte qenë fituar dhe mbaruar në orën dy, tri orë përpara peripecisë prusiane.

Ç'sasi gabimi ka nga ana e Napoleonit në humbjen e kësaj beteje? Për mbytjen e një anijeje a mund t'i ngarkohet faji timonierit?

A mos vallë tatëpjeta e dukshme fizike e Napoleonit ndërlikohej asokohe me njëfarë pakësimi të fuqisë së tij të brendshme? A mos vallë njëzet vjet luftë e kishin brejtur tehun ashtu si millin, shpirtin ashtu si trupin? A mos vallë kapiteni ndiente me keqardhje se kishte hyrë në sërën e veteranëve? Me një fjalë, mos vallë ky gjeni, ashtu siç patën besuar shumë historianë të njohur, po venitej e po shuhej? A mos vallë rropatej e përpëlitej në tërbim për t'ia fshehur vetvetes dobësinë që e kishte pllakosur? A mos vallë, gjë e rëndë për një gjeneral, po bëhej i pandërgjegjshëm për rrezikun që i kanosej? Në këtë klasë njerëzish të mëdhenj praktikë, që mund t'i quajmë viganë të veprimit, a mos vallë ka ndonjë moshë në të cilën gjeniu bëhet

dritëshkurtër? Pleqëria nuk ka ç't'u bëjë gjenive të idealit; për Dantet e për Mikelanxhelot, të plakesh, do të thotë të rritesh; për Hanibalët dhe Bonapartët, a mos vallë do të thotë të zvogëlohesh? A mos vallë Napoleoni e kishte humbur ndjenjën e fitores? A mos qe katandisur gjer në atë shkallë sa të mos i njihite më shkëmbinjtë e rrezikshëm nën ujë, të mos pikaste dot kurthin, të mos dallonte tanimë buzën e ronitur të humnerave? A mos i mungonte vallë nuhatja e katastrofave? Ai që dikur, i dinte të gjitha rrugët e triumfit dhe që nga maja e karros së tij prej vetëtimash i tregonte këto rrugë me një gisht sovran, a mos vallë ishte pushtuar tani nga ajo çoroditje kobzezë, që e bënte t'i çonte drejt greminave ato legjione të mbrehura në karron e tij luftarake? A mos vallë në moshën dyzetegjashtëvjeçare e kishte mbërthyer ndonjë marrëzi e epërme? Ky karrocier titanik i fatit mos ishte katandisur vallë në ndonjë qafëthyes vigan?

Ne nuk mendojmë aspak kështu.

Plani i tij i betejës, siç e pohojnë të gjithë, ishte një kryevepër. Sipas planit, ai do t'i binte drejt e në qendër vijës së të besëlidhurve, do t'i hapte armikut një të çarë, do ta ndante armikun më dysh, do ta shtynte gjysmën britanike mbi Halin dhe gjysmën prusiane mbi Tongrën, do t'i bënte Uelingtonin dhe Blyherin dy cungje, do të rrëmbente me sulm Mon-Sen-Zhanin, do të kapte Brukselin, do ta flakte gjermanin në Rin dhe anglezin në det. E gjitha kjo, për Napoleonin, do të kryhej në këtë betejë. Pastaj do të shihte e do të bënte.

Natyrisht ne nuk pretendojmë të tregojmë këtu historinë e Vaterlosë; një nga skenat ku ka lindur drama që po tregojmë, lidhet me këtë betejë; por kjo histori nuk është subjekti ynë; nga ana tjetër, kjo histori është bërë, dhe është bërë në mënyrë mjeshtërore, nga një pikëpamje prej Napoleonit, nga pikëpamja tjetër prej një plejade të tërë historianësh.^{*)} Përsa na përket neve, ne po i lëmë historianët të hahen njëri me tjetrin; ne jemi vetëm një dëshmitar i largët, një kalimtar në fushë, një kërkues i përkulur mbi këtë tokë të gatuar me mish e me gjak njeriu, që

^{*)} Uollter Skoti, Lamartini, Volabeli, Sharasi, Kineti, Tieri.

merr ndoshta dukuritë për realitete; ne nuk e kemi atë të drejtë që të hahemi në emër të shkencës me një tërësi ngjarjesh, kur pa dyshim ka edhe vegime të rreme; ne s'kemi as praktikën ushtarake, as kompetencën strategjike, që i japin peshë dhe autoritet një sistemi; sipas nesh, një vargëzim fatesh të rastit sundon në këtë Vaterlo mbi të dy kapitenët; dhe, kur është fjala për fatin, për këtë të akuzuar misterioz, ne gjujkojmë si populli, si ky gjykatës naiv.

IV

A

Ata që duan ta përfytyrojnë qartë betejën e Vaterlosë, nuk kanë veçse të përfytyrojnë mbi tokë një A të madhe. Këmbëza e majtë e A-së është udha e Nivelës, këmbëza e djathtë është udha e Zhenapës, purteka e A-së është udha e thellë e Ohenit në Brenë-l'Aléd. Kulmi i A-së është Mon-Sen-Zhani; këtu është Uelingtoni; majuci i poshtëm majtas është Hugomonti; atje është Reji me Zherom Bonapartin; majuci i poshtëm djathtas është Belë-Aliansa, atje është Napoleoni. Pak më poshtë pikës ku purtekëza e A-së takon dhe pret këmbëzën e djathtë, është Hé-Senta. Në mesin e kësaj purtekëze ndodhet tamam pika ku është thënë fjala e fundit e betejës. Në këtë vend kanë vendosur luanin, simbol i pavullnetshëm i heroizmit më të lartë të gardës perandorake.

Trekëndëshi që përfshihet në kulmin e A-së, midis dy këmbëzave dhe purtekëzës, është rrafshina e Mon-Sen-Zhanit. Kush e kush ta merrte këtë rrafshinë, kjo ishte gjithë beteja.

Krahët e të dy ushtrive shtrihen në të djathtë e në të majtë të të dy udhëve të Zhenapës dhe të Nivelës: D'Erloni ishte përballë Piktonit, Reji përballë Hillit.

Prapa kulmit të A-së, prapa rrafshinës së Mon-Sen-Zhanit, është pylli i Suanjës.

Përsa i përket vetë fushës, merrni me mend një trevë të gjerë dallgë-dallgë; çdo kind sundon mbi kindin e mëtejshëm,

dhe të gjitha dallgëzimet ngjiten drejt Mon-Sen-Zhanit e mbarojnë në pyll.

Dy ushtri armike në një fushë beteje janë si dy mundës. Është një kacafytje. Njëra ushtri përpiket ta shtrijë tjetrën përdhé. Këtu secila kapet me thonj pas gjithçkaje; një ferrë është një pikëmbështetjeje; një qoshe muri është një ledh mbrojtës; në mungesë të një vendi, qoftë edhe të fortifikuar sidokudo, një regjiment jepet e thyhet, sepse s'ka se ku të mbështetet; një gërryerje e fushës, një dallgëzim toke, një udhëz tërthore e rastit, një pyll, një përrua mund edhe ta ndalin thundrën e këtij kolosi që e quajmë ushtri, ta pengojnë e ta zmrapsin. Kush del nga fusha e luftës, e ka humbur davanë. Ja përse është e domosdoshme për udhëheqësin përgjegjës, të shqyrtojë edhe tufën më të vogël me pemë dhe ta studiojë thellë edhe relievin më të vogël.

Të dy gjeneralët e kishin studiuar me vëmendje fushën e Mon-Sen-Zhanit, që sot quhet fusha e Vaterlosë. Që një vit më parë Uelingtoni, me një mprehtësi parashikuese, e kishte studiuar këtë fushë për ndonjë rast beteje të madhe. Mbi këtë truall dhe për këtë dyluftim, më 18 qershor, Uelingtoni kishte anën e mirë, Napoleoni të keqen. Ushtria angleze ishte më të lartë, ushtria franceze më të ulët.

Është pothuajse e tepërt të përvijojmë këtu pamjen e Napoleonit në kalë, me tejqyrë në dorë, mbi lartësinë e Rosomës, në agim të 18 qershorit 1815. Përpara se ta tregojmë ne, e gjithë bota e ka parë. Ai profil i qetë nën kapelën e vogël të shkollës së Brienës, ajo uniformë e gjelbër, jaka e bardhë, që fsheh dekoratat, redingota e hirtë, që mbulon supëzat, këndi i kordonit të kuq nën jelek, kilotat prej lëkure, kali i bardhë me mutafin prej kadifeje të purpurt nën shalë, me N-ra të kurorëzuar dhe me shqiponja në cepat, çizmet kalorëse mbi çorape mëndafshi, mamuzet të argjendta, shpata e Marengos, e gjitha kjo figurë e Çezarit të fundit qëndron në këmbë dhe e gjallë në imagjinatat, e brohoritur nga disa, e vështruar vëngër nga të tjerët.

Kjo figurë ka qenë për një kohë të gjatë e tëra në dritë; kjo shkaktonte nga njëfarë errësimi legjendar, që lëshojnë pjesa

më e madhe e heronjve dhe që mbulon të vërtetën për një kohë pak a shumë të gjatë: por sot edhe historia, edhe drita janë aty për të zbuluar të vërtetën.

Kjo dritë, historia, është e pamëshirshme; ajo ka këtë gjë të çuditshme dhe hyjnore se, sadoqë është fund e krye një dritë, dhe pikërisht pse është dritë, ajo vë shpeshherë hije atje ku përpara njerëzit shikonin rreze drite; me të njëjtin njeri ajo sajton dy fantazma të ndryshme, dhe njëra fantazmë sulmon tjetrën dhe vendos drejtësinë, dhe terrinat e despotit luftojnë me shkëlqimin e kapitenit. Nga kjo rrjedh një matës i vërtetë në vlerësimin përfundimtar të popujve. Babilona e dhunuar e zvogëlon Aleksandrin; Roma e lidhur me pranga e zvogëlon Çezarin; Jeruzalemi i vrarë e zvogëlon Titusin. Tirania ndjek tiranin. Është fatkeqësi për një njeri që të lërë prapa vetes një terr që ka formën e tij.

V

"Quid obscurum-i") i betejave*

Gjithë bota e dinë fazën e parë të kësaj beteje, fillim i turbullt, i pasigurt, i lëkundur, kërcënues për të dyja ushtritë, por shumë më tepër për anglezët, sesa për francezët.

Kishte rënë shi gjithë natën e natës; toka ishte gërryer nga rrebeshi; ujët ishte mbledhur aty-këtu në lugjet e fushës, si nëpër kazanë; në disa vende, ekuipazheve të njëjësive tërheqëse u vinte ujët gjer te boshti i rrotave; nënbarkëzat e kuajve kullonin llucë; në qoftë se grunjërat e thekrat, të shtrira përtokë nga ajo hordhi karrosh në ecje, nuk do t'i kishin mbathur hullitë dhe të kishin formuar një farë tabani nën rrotat, çdo lëvizje, veçanërisht në luginat nga ana e Papëlotës, do të kishte qenë e pamundur.

Puna filloi vonë; Napoleoni, siç e kemi shpjeguar, e kishte zakon që ta mbante të gjithë artilerinë në dorën e tij, tamam si

*) "E panjohura" (lat.)

ndonjë kobure, duke marrë në shenjë herë një pikë, herë një pikë tjetër të betejës, dhe kishte dashur të priste që bateritë e tërhequra me kuaj të mund të rrëshqitnin dhe të ngisnin kupthi lirisht; për këtë punë duhej të dilte dielli dhe të thante tokën. Por dielli nuk doli. Nuk ishte më përpjekja e Austerlicit. Kur u bë goditja e parë me top, gjenerali anglez Kolvil vështroi sahatin e vet dhe pa se ora ishte njëmbëdhjetë e tridhjetë e pesë minuta.

Veprimi filloi me furi, ndoshta me më shumë furi nga ç'mund të kishte dashur perandori, nga ana e krahut francez mbi Hugomontin. Në të njëjtën kohë Napoleoni sulmoi qendrën, duke lëshuar me turr brigadën e Kiotit mbi Hé-Sentën, dhe Neji lëshoi krahun e djathtë francez kundër krahut të majtë anglez, që mbështetej mbi Papëlotë.

Sulmi mbi Hugomontin kishte për qëllim të krijonte njëfarë mashtrimi; kishte për qëllim ta tërhiqte aty Uelingtonin, ta bënte të anonte nga e majta, i tillë ishte plani. Ky plan do të dilte faqebardhë, në qoftë se kompanitë e gardës angleze dhe belgët trima të divizionit të Perponsherit nuk do ta kishin mbajtur fort pozicionin, dhe Uelingtoni, në vend që të grumbullohej aty, u kufizua duke dërguar aty gjithsej si përforsim katër kompani të tjera të gardës dhe një batalion të Brunsvikut.

Sulmi i krahut të djathtë francez mbi Papëlotë u bë me turr; qëllimi i këtij sulmi ishte aq i qartë sa s'kishte ku të vinte; të shtynte prapa krahun e majtë anglez, të këpuste udhën e Brukselit, t'u priste kalimin prusianëve, që mund të vinin, të pushtonte Mon-Sen-Zhanin, të zmbrapste Uelingtonin mbi Hugomont, së andejmi mbi Brenë-l'Alëd, së andejmi mbi Halin. Me përjashtim të disa incidenteve, ky sulm doli faqebardhë. Papëlotë u pushtua; Hé-Senta gjithashtu u mor.

Një hollësi për t'u shënuar. Në këmbësorinë angleze, veçanërisht në brigadën e Kemptit, kishte shumë rekrutë. Këta ushtarë të rinj, përpara këmbësorëve tanë të tmerrshëm, qëndruan si trima me fletë; atyre u mungonte përvoja, por ia dolën mbanë me anë të guximit; ata u treguan sidomos pushkatarë të shkëlqyer; ushtari si pushkatar, i lënë pak si në kokë të vet, bëhet, si të thuash, gjeneral i vetvetes; këta rekrutë

treguan diçka nga fryma krijuese dhe furia franceze. Kjo këmbësori, e re në mjeshtëri, u tregua e zjarrtë. Kjo nuk i pëlqeu Uelingtonit.

Pas marrjes së Hé-Sentës, beteja u lëkund.

Këtë ditë, nga dreka deri në orën katër, ka një interval të errët; mesi i kësaj beteje është pothuajse i padallueshëm dhe bën pjesë në fazën e errët të përlëshjes. Mbi të bie muzgu. Njeriu mund të ajgëtojë lëkundje të mëdha në këtë mjegullinë, një fanepsje marramendëse, pajisjet luftarake të asaj kohe janë pothuajse të panjohura sot, kallpakët me xhufka, palldëmet valëvitëse, rripat e kryqëzuar, vezmet e granatave, dollomatë e husarëve, çizmet e kuqe me një mijë rrudha, shakot, ato kapela të rënda, stolisura si me thekë të gërshetuar, këmbësoria pothuajse e zezë e Brunsvikut, e përzier me këmbësorinë kuqalashë të Anglisë, ushtarët anglezë, që kanë për supëza thekë të mëdhenj e të bardhë në formë rrethi, kalorësit e lehtë hanovras me përkrenaret e tyre gjatoshë prej lëkure, me shirita prej bakri dhe me lafshore prej krini të kuq, skocezët me gjunjët jashtë dhe me fustanellat me katrore, getat e mëdha e të bardha të granatierëve tanë, tablora dhe jo vija strategjike, pikërisht ajo që i duhet Salvator Rozës⁹⁶⁾ dhe jo ajo që i duhet Gribovalit.⁹⁶⁾

Njëfarë sasive rrebeshi përzihet gjithmonë në një betejë. *Quid obscurum, quid divinum**). Secili historian shënon pak a shumë përvijimin që i pëlqen në këtë përlëshje. Cilido që të jetë kombinimi i gjeneralëve, përplasja e masave të armatosura ka zbatika, që s'mund të llogariten; në veprim e sipër, të dyja planet e të dy udhëheqësve kllaposen njëri me tjetrin dhe deformohen njëri nga tjetri. Një pikë e fushës së betejës gllabëron më shumë luftëtarë se një pikë tjetër, ashtu si ato tokat më shumë ose më pak të shkriëta, që e thithin më shpejt ose më ngadalë ujin që hedhim mbi to. Njeriu është i detyruar të derdhë aty më shumë ushtarë sesa dëshiron. Shpenzime që i kërkon e papritura. Vija e betejës valëvitet e gjarpëron si ndonjë fill, rrëketë e gjakut rrjedhin në mënyrë të palogjikshme,

*) *Kuid obscurum, kuid divinum* (lat.) – Ajo që është e errët, ajo që është hyjnore.

ballet e ushtrive valëzojnë, regjimentet, që hyjnë ose dalin si pyka, sajojnë kepa ose gjire, të gjithë këta shkëmbinj të nënujshëm lëvizin vazhdimisht njëri përpara tjetrit; atje ku ishte këmbësoria, arrin artileria; atje ku ishte artileria, vrapon kaloria; batalionet janë tymra. Në qoftë se aty kishte gjë, kërkoheni dhe do shihni se është zhdukur, zbrazëtitë zhvendosen; palëzat e errëta bëjnë përpara e zbrapsen; njëfarë ere varri i shtyn, i zbraps, i bymen dhe i davarit këto mori tragjike. Ç'është një përlëshje? Një luhatje. Palëvizshmëria e një plani matematik shpreh një minutë dhe jo një ditë të tërë. Për të pikturuar një betejë, duhen asi piktorësh të fuqishëm që ta kenë kaosin në majë të penelit; Rembrandti vlen më shumë se Van Der Mëleni.⁹⁷⁾ Van Der Mëleni i përpiktë në mesditë, gënjen në orën tre. Gjeometria të mashtron, vetëm stuhia është e vërtetë. Kjo i jep Folardit të drejtë ta kundërshtojë Polibin.⁹⁸⁾ Le të shtojmë se ka gjithmonë një çast kur beteja degjeneron në luftim, grimcohet dhe copëtohet në ndodhi të panumërta, të cilat, ashtu si thotë Napoleoni, vetë, "kanë të bëjnë më shumë me jetëshkrimin e regjimenteve, sesa me historinë e ushtrisë". Historiani në këtë rast ka të drejtën e dukshme të bëjë përmbledhje. Ai mund të kapë vetëm përvijimet kryesore të luftimit, por asnjë përshtuesi, sado i ndërgjegjshëm që të jetë, nuk i jepet e drejta ta fiksojë në mënyrë absolute trajtën e kësaj reje të hatashme që quhet betejë.

Kjo gjë, që është e vërtetë për të gjitha ndeshjet me armë, është posaçërisht e aplikueshme për Vaterlonë.

Sidoqoftë, në pasdreke, erdhi një çast dhe beteja u përcaktua.

VI

Ora katër pasdreke

Aty nga ora katër, gjëndja e ushtrisë angleze ishte e rëndë. Princi D'Oranzhë komandonte qendrën, Hilli krahun e djathtë, Piktoni krahun e majtë. Princi D'Oranzhë, i hutuar dhe sypatrembur, u bërtiste holando-belgëve: "Nasau! Brunsvik! Kurrë prapa!" Hilli, i dobësuar, vinte e mbështetej pas Uelingtonit; Piktoni ishte vrarë. Në atë minutë, kur anglezët u kishin rrëmbyer francezëve flamurin e regjimentit 105 sulmues, këta u kishin vrarë anglezëve gjeneral Piktonin me një plumb tejetë kokës. Për Uelingtonin, beteja kishte dy pikëmbështetje, Hugomontin dhe Hé-Sentën; Hugomonti mbahej akoma, por po digjej flakë; Hé-Senta ishte marrë. Nga batalioni gjerman që e mbronte, vetëm dyzet e dy veta kishin mbetur gjallë; të gjithë oficerët, përveç pesëve, ishin vrarë ose zënë rob. Tri mijë luftëtarë ishin bërë fërtele në këtë plevicë. Një rreshter i gardës angleze, boksieri i parë i Anglisë, për të cilin shokët e vet kishin hapur fjalën se ishte i paprekshëm, që vrarë aty nga një tamburist i vogël francez. Baringu ishte nxjerrë jashtë llogoreve, Alteni kishte rënë nga një goditje shpate. Shumë flamuj kishin humbur, nga të cilët një i divizionit të Altenit dhe një i batalionit të Lyneburgut, që mbahej nga një princ i familjes së Dë-Pontëve. Skocezët e hirtë nuk ishin më gjallë, dragonët shtatmëdhën të Ponsobit ishin bërë përsesh. Kjo kavaleri trime ishte përkulur nën heshtarët e Broit dhe nën koracierët e Traverit; nga të një mijë e dyqind kuajt kishin mbetur vetëm gjashtëqind; nga tre kolonelë, dy kishin mbetur të shtrirë përdhe, Hamiltoni që plagosur, Materi që vrarë. Ponsobi kishte rënë vdekur, i shpuar nga shtatë goditje heshte. Gordoni kishte vdekur. Marshi kishte vdekur. Dy divizione, i pesti dhe i gjashti, ishin shkatërruar.

Hugomonti ishte cënuar, Hé-Senta ishte marrë, kishte mbetur vetëm një nyjë, qendra. Kjo nyjë vazhdonte gjithnjë të qëndronte. Uelingtoni e përforcoi. Ai thirri aty Hillin, që

ndodhej në Merbë-Brenë, thirri Shasenë, që ndodhej në Brenë-Alëd.

Qendra e ushtrisë angleze, pak si e lugëzuar, shumë e dendur dhe shumë kompakte, ishte në pozita të forta. Ajo mbante rrafshinën e Mon-Sen-Zhanit, duke pasur prapa saj fshatin dhe përpara rrëpirën, e cila asokohe ishte mjaft e thepisur. Ajo mbështetej pas asaj shtëpie të fortë guri, e cila asokohe ishte pasuri e përbashkët e Nivelës dhe shënon pikën ku bashkohen udhët, një bina e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, aq e fortë, saqë gjylet binin mbi të e rrëshqitnin pa e cënuar fare. Rreth e rrotull rrafshinës, anglezët i kishin prerë aty-këtu gjerdhet, kishin bërë disa si frëngji përmes murrizave, kishin vënë një grykë topi midis dy degësh dhe i kishin përforcuar ferrat me bedena. Artileria kishte zënë pusi nën ferrat. Ky lloj maskimi, i lejuar në mënyrë të pakundërshtueshme nga lufta, që pranon çdo lloj kurthi, ishte bërë aq bukur, sa Haksoi, që ishte dërguar nga perandori për të zbuluar bateritë armike, s'kishte parë asgjë nga këto dhe ishte kthyer e i kishte thënë Napoleonit se s'kishte ndonjë pengesë, përveç dy barrikadave që prisnin udhët e Nivelës dhe të Zhenapës. Ishte koha kur grunjërat kishin hedhur shtat; buzë pyllit të rrafshinës, një batalion i brigadës së Kempit, i 96-ti, i armatosur me karabina, ishte shtrirë barkas midis grunjërave.

E siguruar dhe e mbështetur kësisoj, qendra e ushtrisë anglo-holandeze qëndronte në pozita të mira.

Rrezik për këtë pozicion ishte pylli i Suanjës, i cili asokohe ishte ngjitur me fushën e betejës dhe i ndërprerë nga kënetat e Groenandelit dhe të Buasfortit. Asnjë ushtri nuk mund të tërhiqej asaj ane, pa u shkrirë e tëra; regjimentet aty do të shkoqeshin menjëherë. Artileria do të humbiste nëpër kënetat. Tërheqja, sipas mendimit të shumë njerëzve të artit ushtarak, mendim të cilin e kundërshtojnë të tjerët, është e vërtetë, do të qe shndërruar aty në një ik të ikim.

Uelingtoni i shtoi kësaj qendre një brigadë të Shasesë, që e hoqi nga krahu i djathtë, dhe një brigadë të Uinkes, që e hoqi nga krahu i majtë, veç divizionit të Klintonit. Anglezëve të tij, regjimenteve të Halketit, brigadës së Miçellit, gardistëve të

Meitlendit, u dha si përforcim e mbështetje këmbësorinë e Brunsvikut, kontigjentin e Nasaut, hanovrasit e Kielmanseges dhe gjermanët e Omptedës. Ky veprim i dha në dorë njerëzit e gjashtë batalioneve. *Krahu i djathtë*, siç thotë Sharasi,⁹⁹⁾ u *zmbrops prapa qendrës*. Një bateri shumë e madhe ishte maskuar me thasë dheu në vendin ku ndodhet sot ai që quhet "Muzeu i Vaterlosë". Veç kësaj, në njëfarë lugu, Uelingtoni kishte edhe dragonët-gardistë të Somersetit, një mijë e katërqind kuaj. Kjo ishte gjysma tjetër e asaj kavalerie angleze, që me shumë të drejtë ishte bërë e famshme. Pansobi u shkatërrua, por mbetej Somerseti.

Bateria, e cila, po të qe përfunduar do të kishte qenë pothuajse një kamp i fortifikuar, ishte vendosur prapa një muri shumë të ulët kopshti, të veshur ngutazi me thasë të mbushur me rërë dhe me një ledh të gjerë dheu. Kjo vepër e fortifikuar nuk ishte mbaruar; nuk kishte pasur kohë as të ngulnin pengesa hunjsh.

Uelingtoni, i shqetësuar, por gjakftohtë, ishte në kalë dhe qëndroi aty gjithë ditën e ditës, pa luajtur vendit, pakëz përpara mullirit të vjetër të Mon-Sen-Zhanit, i cili është edhe sot e kësaj dite, nën një vidh, të cilin një anglez, qysh prej asaj kohe, si vandal entuziast, e bleu për dyqind franga, e sharroi dhe e mori me vete. Uelingtoni qëndroi atje heroik, i ftohtë. Gjylet binin si breshër. Adjutanti i tij, Gordoni, sapo kishte rënë i vdekur pranë tij. Lordi Hill, duke i treguar një gjyle që plasi, i tha: "Milord, cilat janë udhëzimet tuaja dhe çfarë urdhrash na lini, në qoftë se e lini veten të vriteni?" "Të bëni si unë", - u përgjigj Uelingtoni. Klintonit i tha shkurt: - "Të qëndroni këtu gjer tek i fundit." Dukej qartë që dita po merrte për ters. Uelingtoni u thërriste shokëve të tij të vjetër të luftës në Talaverë, Vitoria dhe Salamankë¹⁰⁰⁾: *Boys* (djema)! A ua thotë zemra ta lëshojmë vendin? Mendoni për Anglinë, plakë!"

Aty nga ora katër vija angleze u lëkund e bëri prapa. Befas mbi kreshtën e rrafshinës shikoje vetëm artilerinë dhe pushkatarët, pjesa tjetër u zhduk; regjimentet, të dëbuara nga predhat e gjylet franceze, u tërhoqën në gropën që përshkon sot monopatin e fermës së Mon-Sen-Zhanit, u bë një lëvizje

prapësimi, fronti anglez i betejës u tërhoq, Uelingtoni u zbraps. "Fillimi i tërheqjes!" - bërtiti Napoleoni.

VII

Napoleoni është në qejf

Perandori, megjithëse ishte i sëmurë dhe e shqetësonte mbi kalë një dhembje lokale, s'kishte qenë kurrë aq në qejf sa atë ditë. Qysh në mëngjes ajo mbyllja e tij në vetvete ishte kthyer në buzëqeshje. Më 18 qershor 1815, ai shpirt i thellë, i maskuar me mermer, rrezatonte verbtazi. Burri, që ishte i zymtë në Austerlic, u bë shend e verë në Vaterlo. Paracaktime të mëdha të fatit kanë kësoj kundërshtimesh.

"*Ridet Caesar, Pompeius flebit*"^{*)},¹⁰¹⁾ - thoshin legjionarët e legjionit *Fulminatrix*^{**)}. Pompeu kësaj radhe nuk duhej të qante, por është e sigurt që Çezari qeshte.

Qysh në vigjilje, natën, në orën një, duke bërë me kalë, mes stuhisë dhe shiut, bashkë me Bertrandin, zbulimin e kodrave pranë Rosomës, i kënaqur që shikonte vijën e gjatë të zjarreve angleze, që ndriçonin të gjithë horizontin nga Frishëmonti në Brenë-l'Alëd, i ishte dukur sikur fati, të cilin e kishte vendosur me dorë të vet në ditë të caktuar mbi këtë fushë beteje të Vaterlosë, ishte i përpiktë; ai e kishte ndalur kalin dhe kishte qëndruar njëfarë kohe pa lëvizur, duke vështruar vetëtimat e duke mbajtur vesh bubullimën, dhe ishte dëgjuar ky fatalist të lëshonte në terrin e natës këtë fjalë misterioze: "Jemi në një mendje". Napoleoni gabohej, ata nuk ishin më në një mendje.

Ai s'kishte marrë asnjë sy gjumë, të gjitha çastet e asaj nate kishin për të nga një gëzim. Ai e kishte shëtitur të gjithë vijën e gardistëve të mëdhenj, duke u ndalur aty-këtu për t'u folur atyre

^{*)} Çezari qeshte, Pompeu qante (lat.).

^{**)} Rrufegjuajtës (lat.).

që bënin rojë. Në orën dy e gjysmë, pranë pyllit të Hugomontit, ai kishte dëgjuar hapin e një kolone në marshim; për një çast ai i kishte zënë besë tërheqjes së Uelingtonit. I kishte thënë Bertrandit: "Praparoja angleze po tundet vendit për t'ua mbathur këmbëve. Do t'i zë rob ata gjashtë mijë anglezë që sapo kanë arritur në Ostandë". Ai bisedonte me zjarr; i ishte ngjallur përsëri ai vërtiku i zbarkimit të një marsit, kur i tregonte mareshalit të madh fshatarin entuziast të gjirit Zhuan, duke bërtitur: "Eh, pra, Bertrand, ja na erdhi edhe përforcimi!" Natën e 17-18 qershorit ai tallej hidhur me Uelingtonin. "Ky spurdhjak anglez ka nevojë për një mësim", thoshte Napoleoni. Shiu sa vinte e shtohet; dhe ndërsa perandori fliste, bubullima gjëmonte.

Në orën tre e gjysmë të mëngjesit ai kishte humbur një iluzion; disa oficerë të dërguar për zbulim i kishin njoftuar se armiku nuk ishte duke bërë asnjë lëvizje. Asgjë s'lëvizte; asnjë zjarr i kampit nuk ishte shuar. Ushtria angleze flinte. Heshtja ishte e thellë mbi tokë; zhurmë kishte vetëm në qiell. Në orën katër korrierët i kishin sjellë një fshatar, ky fshatar i kishte shërbyer si udhërrëfyes një brigade angleze të kavalerisë, me gjasë brigadës së Vivianit, e cila vinte të zinte pozicion në fshatin Ohen, në skaj të krahut të majtë. Në orën pesë dy dezertorë belgë i kishin raportuar se sapo kishin braktisur regjimentin e tyre dhe se ushtria angleze po e priste betejën. "Aq më mirë", - kishte bërtitur Napoleoni. - "Dua më mirë të shpartalloj sesa të zbraps."

Në mëngjes, mbi ledhin që formon këndin e udhës së Plansenuait, ai i kishte zbritur kalit, kishte zhytur këmbët në baltë, kishte urdhëruar t'i sillnin nga ferma e Rosomës një tryezë kuzhine dhe një karrige fshatari, ishte ulur me një vandak kashte poshtë këmbëve dhe kishte shpalosur mbi tryezë hartën e fushës së betejës, duke i thënë Sultit: "Shah i bukur!"

Për shkak të shirave të natës, karvanet që sillnin ushqime, të zhytura në lerën e udhëve gjithë gropa, nuk kishin mundur të arrinin në mëngjes, ushtarët s'kishin vënë gjumë në sy, ishin të lagur qull dhe s'kishin vënë gjë në gojë; kjo gjendje s'e kishte penguar Napoleonin t'i thërriste plot gaz Nejit: "Kemi

nëntëdhjetë shanse mbi njëqind". Në orën tetë i kishin sjellë perandorit për të ngrënë mëngjesin. Këtu ai kishte ftuar shumë gjeneralë. Tek ishte duke ngrënë, i kishin treguar se Uelingtoni, dy net përpara, kishte qenë në ballon e Brukselit te dukeshja Dë Rishmond, dhe Sulti, njeri i rrahur në luftë, por me fytyrë arkipeshkvi, kishte thënë: "Balloja është sot". Perandori ishte tallur me Nejin, që thoshte: "Uelingtoni nuk do të jetë aq i leshtë sa të presë madhërinë tuaj". Kështu e kishte ai. "Ai kishte qejf të tallej e të qeshte", - thotë Flëri dë Shabuloni. "Nga natyra ai ishte njeri gaztor", - thotë Gurgodi. "Ai i kishte shakatë në majë të gjuhës", - thotë Benzhamën Konstani. Ia vlen barra qiranë që t'i nënvizosh këto të qeshura prej vigani. Ai vetë u kishte ngjitur granatierëve të vet emrin "gërnjarë"; shkonte e ua pickonte veshët ose ua tërhiqte mustaqet. "Perandori s'bënte gjë tjetër veçse na punonte ndonjë rreng"; kjo është fjala e njerit prej granatierëve. Gjatë udhëtimit misterioz nga ishulli i Elbës në Francë, më 27 shkurt, në mes të detit, anija luftarake franceze "Zefiri", tek e takoi anijen "Inkonstanti", ku Napoleoni ishte fshehur, dhe tek i kërkoi "Inkonstantit" lajme mbi Napoleonin, perandori, i cili në atë çast mbante kokardën bardhë e kuq të qëndisur me bletë, të adoptuar prej tij në ishullin e Elbës, kishte marrë duke qeshur burinë zëdhënëse dhe ishte përgjigjur vetë: "Perandori është mirë me shëndet." Kush qesh kësisoj, domethënë se është lidhur ngushtë me ngjarjet e mëdha. Napoleoni ia kishte plasur disa herë të qeshurit kësisoj, gjatë ngrënies së mëngjesit të Vaterlosë. Pas buke ishte çlodhur një çerek ore; pastaj dy gjeneralë ishin ulur mbi vandakun me kashtë, me penë në dorë, me një fletë karte mbi gjunjë, dhe perandori u kishte diktuar urdhrin luftarak.

Në orën nëntë, në çastin kur ushtria franceze, e skalionuar dhe e vënë në lëvizje në pesë kolona, u përhap në formacion luftimi, divizionet në dy vija, artileria midis brigadave, me në ballë bandën që u binte marsheve luftarake, me gjëmimin e tambureve dhe me tingujt e trumbetave, e fuqishme, e gjerë sa të hante syri, e gëzuar, det kokoresh, shpatash dhe bajonetash në horizont, perandori, i emocionuar, kishte bërtitur dy herë me radhë: "Madhështore! Madhështore!"

Nga ora nëntë gjer në orën dhjetë e gjysmë, e gjithë ushtria, gjë që duket si e pabesueshme, kishte zënë pozicion dhe ishte rreshtuar në gjashtë vija, duke formuar, për të përsëritur shprehjen e perandorit, "figurën e gjashtë V-ve". Disa çaste pas formimit të frontit të betejës në mes të kësaj heshtjeje të thellë të fillimit të stuhisë që ngjet para përleshjeve, duke parë të parakalonin të tri bateritë dymbëdhjetëshe, të shkëputura me urdhër të tij nga të tri korpuset, të D'Erlonit, të Rejit dhe të Loboit, dhe të caktuara që të fillonin veprimin duke rrahur Mon-Sen-Zhanin, ku priten rrugët e Nivelës dhe të Zhenapës, perandori kishte goditur mbi supin e Haksoit, duke i thënë: "Ja njëzet e katër vajza të bukura, gjeneral."

I sigurt për përfundimin, ai i kishte dhënë zemër me një buzëqeshje, kur kaloi para tij, kompanisë së zapatorëve të korpusit të parë, kompani të cilën ai vetë e kishte caktuar të barrikadohej në Mon-Sen-Zhan, me t'u pushtuar fshati. E gjithë kjo qetësi kishte qenë përshkuar vetëm nga një fjalë mëshire kryelartë; kur pa në të majtë të tij, në vendin ku sot ndodhet një varr i madh, tek po grumbulloheshin ata skocezët e hirtë me kuajt e tyre madhështorë, ai kishte thënë: "Sa keq, gjynah!"

Pastaj ia kishte hipur kalit, kishte dalë përpara Rosomës dhe kishte zgjedhur për pikë vrojtimi një sop të ngushtë lëndine në të djathtë të udhës që çon nga Zhenapa në Bruksel; ky ishte vendqëndrimi i dytë gjatë betejës. Vendqëndrimi i tretë, ai i orës shtatë të mbrëmjes, midis Belë-Aliansës dhe Hé-Sentës, të shtie frikën; është një sop mjaft i lartë, që ndodhet edhe sot e kësaj dite dhe prapa të cilit garda ishte grumbulluar në një pjerrësi të fushës. Rreth këtij sopi gjylet binin e përflakeshin mbi kalldrëmin e xhadesë, gjer te Napoleoni. Ashtu si edhe në Brienë, mbi kokën e tij vërshëllenin plumbat dhe biskajenet. Njerëzit kanë mbledhur pothuajse në vendin ku ishin këmbët e kalit të tij gjyle të ronitura, tehe të vjetra shpatash dhe predha të shtypura, të brejtura nga ndryshku. *Scabra rubiqine*. Para disa vjetësh nxorën nga dheu një gjyle gjashtëdhjetëshe, që ishte akoma e mbushur, maja e së cilës ishte thyer mu në rrëzë të pjesës së mbushur të bombës. Pikërisht në këtë vendqëndrim perandori i thoshte udhërrëfyesit Lakost, fshatar me qëndrim

armiqësor, i trembur e i lidhur pas shalës së kalit të një husari, që kthehej pas çdo breshërie dhe që mundohej të fshihej prapa tij: "Budalla, është turp, kështu do të vritesh nga kurrizi." Ai që po shkruan këta rreshta, ka gjetur me dorë të vet në rrëpirën e shkrifët të këtij sopi, duke gërmuar rërën, mbeturinat e grykës së një bombe të ronitur nga ndryshku i dyzet e gjashtë vjetëve dhe copa të vjetra hekuri, që thërmoheshin me dorë si shkopinjt shtogu.

Gjithkush e di se dallgëzimet e fushave të prera në drejtime të ndryshme, atje ku u zhvillua ndeshja e Napoleonit dhe e Uelingtonit, tani nuk janë më ashtu siç ishim më 18 qershor 1815. Duke i marrë kësaj fushe të përzishme gjithçka që duhej për të ngritur një përmendore, ia kanë hequr fare relievin e saj të vërtetë, dhe historia, e ndodhur ngushtë, nuk e njeh fare vetveten. Duke dashur që t'i thurin lavdi, këtë fushë e kanë shpërfytyruar krejt. Dy vjet më pas, kur e pa përsëri Vaterlonë, Uelingtoni bërtiti: "Ma paskan ndërruar fushën e betejës." Atje ku është sot piramida e madhe prej dheu, mbi të cilën qëndron një luan, ishte një kreshtë, e cila, në drejtim të udhës së Nivelës, ulej në një të tatëpjetë ku mund të ecej, por që nga ana e xhadesë së Zhenapës ishte pothuajse një rrëpirë e prerë thikë. Lartësia e kësaj rrëpire mund të matet akoma edhe sot e kësaj dite me anën e lartësisë së dy sopeve të dy varrezave të mëdha, që marrin në mes rrugën nga Zhenapa në Bruksel, në njërin sop janë varrezat angleze, në të majtë; në tjetrin janë varrezat gjermane, në të djathtë. Varreza franceze këtu s'ka fare. Për Francën, e gjithë kjo fushë është një varrezë e tërë. Falë mijëra e mijëra karrocave me dhé, që u përdorën për ngritjen e bregores, njëqind e pesëdhjetë këmbë e lartë dhe një gjysmë mile rreth e rreth, sot mund t'i ngjitesh rrafshinës së Mon-Sen-Zhanit me të përpjetë të shtruar; ditën e betejës, sidomos nga krahu i Hé-Sentës, rrafshina kishte një të përpjetë të ashpër e të prerë thikë. Faqja e kodrës ishte aq shumë e prerë, sa topat anglezë nuk e shikonin poshtë tyre fermën që ndodhej në fund të luginës dhe që ishte qendra e luftimit. Më 18 qershor 1815, shirat e kishin bërë akoma më të pjerrët këtë rrëpirë, balta e vështirësonte ngjitjen përpjetë dhe njerëzit jo vetëm i qepeshin këmbadoras, por zhyteshin edhe në baltë. Përgjatë kreshtës së

rrafshinës kalonte njëfarë hendeku, të cilin s'mund ta pikaste dot një vrojtues i largët.

Ç'ishte ky hendek? Le ta themi. Brenë l'Alëdi është një fshat i Belgjikës, Oheni një fshat tjetër. Këto fshatra, të fshehura që të dyja në lakimet e tokës, janë të lidhura me një udhë afro një legë e gjysmë të gjatë, që kalon përmes një fushe me faqe të dallgëzuara, dhe shpesh humbet nëpër disa kodra si ndonjë brazdë, kështu që në pika të ndryshme kjo udhë është më shumë një përrua, sesa një udhë. Më 1815, ashtu si edhe sot, kjo udhë e priste kreshtën e rrafshinës së Mon-Sen-Zhanit midis dy xhadeve të Zhenapës dhe të Nivelës; veçse sot kjo udhë është rrafsh me tokën, kurse asokohe ishte një udhë e thellë. Të dyja ledhet që kishte ia kanë marrë për të ngritur atë kodrën-monument që zumë në gojë. Kjo udhë ishte dhe është akoma një llogore e vërtetë gjatë pjesës më të madhe të saj; llogore e thellë, që disa herë arrin deri në dymbëdhjetë këmbë; ledhet e saj të prera tepër thikë shembeshin aty-këtu, sidomos në dimër, kur binin shirat me rrebesh. Ngjisinin aty edhe aksidente. Udhë ishte aq e ngushtë në të hyrë të Brenë l'Alëdit, sa një udhëtar kishte qenë bluar nga një karro, ashtu siç e vërteton një kryq guri, i cili qëndron në këmbë pranë varrezave dhe tregon emrin e të vdekurit, "*Zoti Bernard Debrie, tregtar në Bruksel*", dhe datën e aksidentit, *shkurt 1637*".*)

Ajo udhë ishte aq e thellë mbi rrafshinën e Mon-Sen-Zhanit, sa një fshatar, Matje Nikezi, kishte qenë dërrmuar më 1783 nga një shembje ledhi, ashtu siç e provonte një tjetër kryq guri, koka e të cilit ka humbur gjatë çeljes së tokave të reja, por piedestali i të cilit, i rrëzuar, duket edhe sot e kësaj dite me sy mbi ledhin mbi lëndinë, në të majtë të xhadesë midis He-Sentës dhe fermës së Mon-Sen-Zhanit.

*) Ja mbishkrimi:

KËTU KA QENË SHYTPUR
PËR FAT TË KEQ
NËN NJË KARRO
ZOTI BERNARD
DEBRIE, TREGTAR
NË BRUKSEL (e palexueshme)
SHKURT 1637

Kjo udhë e gërryer, të cilën s'kishte si e pikasje, kalonte buzëkreshtës së Mon-Sen-Zhanit dhe ishte një hendek në majë të rrëpirës, një vrage në tokë. Ajo, në një ditë beteje, ishte e padukshme, domethënë e tmerrshme.

VIII

Perandori i bën një pyetje udhërrëfyesit Lakost

Kështu, pra, atë mëngjes të Vaterlosë, Napoleoni ishte i kënaqur. Kishte të drejtë; plani i betejës, që kishte sajuar ai, siç e kemi parë, ishte me të vërtetë i adhureshëm. Me t'u ndezur beteja, peripecitë e saj të shumëllojshme qëndresa e Hugomontit, këmbëngulja e Hé-Sentës, vrasja e Badunit, dalja jashtë luftimit e Fuait, fortifikata e papritur pas të cilit ishte dërrmuar brigada e Suajit, çoroditja fatale e Gijëminotit, i cili s'kishte as kapsula, as qeska me barut, ngecja në lerë e baterive, të pesëmbëdhjetë topat pa trupa shoqërues, të cilët i zbrapsi e i rrëkëlëu Uksbrixhi në një udhë të lugët, efekti i paktë i bombave që binin në vijat angleze, që nguleshin në tokën e qullur nga shirat dhe që s'bënin tjetër veçse shkaktonin vullkane balte, që bënte që breshëria të shndërrohej në spërka lere, manovra e kotë e Piresë¹⁰²⁾ mbi Brenë-l'Alëd, e gjithë ajo kavaleri, pesëmbëdhjetë eskadronë, pothuajse e katandisur në hiç, krahu i djathtë anglez fare i pashqetësuar, krahu i majtë i goditur dobët, keqkuptimi i çuditshëm i Nejit, që i grumbulloi, në vend që t'i shkallëzonte, të katër divizionet e korpusit të parë, rreshtimet e thella të formacioneve prej njëzet e shtatë radhësh dhe fronti prej dyqind ushtarësh, të lëshuar kështu nën breshëri, zbrazëtitë e frikshme që shkaktonin gjylet në këto masa njerëzish, kolonat e sulmit të palidhura, bateria e vendosur brinjazi dhe e zbuluar anash tyre, Burzhuasi, Donzëloti dhe Dyryti, të komprometuar, Kioti, i zbrapsur, toger Vjëji, ky Herkul i dalë nga shkolla politeknike, i plagosur në çastin kur po çante me sëpatë portën e He-Sentës nën zjarrin

depërtues të barrikadës angleze, që kishte prerë bërrylin e rrugës nga Zhenapa në Bruksel, divizioni Markonjet, i kapur pisk midis këmbësorisë dhe kavalerisë, i grirë flakë për flakë nga afër ndër grunjërat prej Bestit dhe Pekut, i grirë me shpatë prej Ponsobit, bateria e tij shtatë topëshe e ngujuar në vend, princi i Saksë-Vaimarit, i cili përkundër kont d'Erlonit, mbante e ruante pozitat e Frishëmtonit dhe Smohenit, flamuri i të 105-tit i marrë, flamuri i të 45-tit i marrë, ai husari i zi prusian i arrestuar nga pararojat e kolonës lëvizëse, të përbërë nga treqind gjuetarë që sillëshin midis Vavrës dhe Plansenuajit gjërat shqetësuese që ky rob lufte kishte thënë, vonesa e Grushiut¹⁰³⁾, të një mijë e pesëqind njerëzit e vrarë në më pak se një orë në pemishten e Hugomontit, të një mijë e tetëqind njerëzit e shtrirë në një kohë akoma më të shkurtër rreth Hé-Sentës, të gjitha këto incidente të stuhishme, që kalonin si retë e betejës përpara Napoleonit, mezi ia kishin turbulluar synë dhe nuk ia kishin vrenjtur aspak fytyrën e qetë perandorake. Napoleoni ishte mësuar ta vështronte luftën drejt e në sy; ai nuk e bënte kurrë shifër pas shifre mbledhjen therëse të hollësive; shifrat për të kishin pak rëndësi, mjaftonte që ato të jepnin këtë total; fitoren; edhe në qoftë se fillimet e betejës çoroditeshin, ai nuk alarmohej aspak, sepse ai e quante veten zot dhe sundues të mbarimit të betejës; ai dinte të priste, sikur s'kishte të bënte me asgjë, dhe e trajtonte fatin sikur ai dhe fati të ishin të barabartë njëri me tjetrin. Ai dukej sikur i thoshte shortit: "Ti s'do të guxosh të luash me mua."

Gjysmëdritë e gjysmëhije, Napoleoni e ndiente veten të mbrojtur në të mirë dhe të falur në të keq. Ai kishte ose besonte se kishte për vete si bashkëpunëtorë, bile mund të themi si bashkëfajtorë rrethanat, ashtu si njerëzit në kohët e lashta që kishin vetinë të mos vriteshin nga armët.

Megjithatë, kur ke prapa Berezinën, Lajpcigun dhe Fontenëblonë,¹⁰⁴⁾ duket se mund t'ia kesh frikën Vaterlosë. Një vrenjtje vetullash misterioze spikat e duket në fund të qiellit.

Në çastin kur Uelingtoni u tërhoq prapa, Napoleoni u drodh i tëri. Ai pa menjëherë rrafshinën e Mon-Sen-Zhanit të zbrazej dhe frontin e ushtrisë angleze të zhdukej. Ushtria po

rigrupohej e po lidhej, por po i shmangej përpjekjes. Perandori u ngrit përgjysmë mbi yzengji. Shkreptima e fitores kaloi në sytë e tij.

Uelingtoni i zbrapsur pas pyllit të Suanjës dhe i shkatërruar - ja, kjo ishte barazi me rrëzimin përfundimtar përtokë të Anglisë nga ana e Francës; kështu merrej haku i Kresit, Puatiesë, Malplaketit dhe i Ramilisë.¹⁰⁵⁾ Njeriu i Marengos i hiqte vizë Azenkurit.¹⁰⁶⁾

Atëherë, perandori, duke bluar me mend peripecinë e tmerrshme, u hodhi sy për të fundit herë me tejqyrën e vet të gjitha pikave të fushës së betejës. Garda e tij, e cila i qëndronte prapa me armët pranë këmbës, e kundronte nga poshtë me njëfarë ndjenje fetare. Ai mendonte, shqyrtonte faqet e kodrave, shënonte pjerrësitë, hante me sy tufën e pemëve, arën katrore me thekër, monopatin; ai dukej sikur po numëronte çdo ferrë. Vështroi me njëfarë ngulmi barrikatad angleze të të dyja xhadeve, dy stiva drurësh të rrëzuar, ajo e xhadesë së Zhenapës përmbi Hé-Sentën, e armatosur me dy topa, të vetmit topa të artilerisë angleze që shikonin fundin e fushës së betejës, dhe ajo e xhadesë së Nivelës, ku shkreptinin bajonetat holandeze të brigadës Shasé. Ai vuri ré afër kësaj barrikade kishëzën e vjetër të Shën Kollit të lyer me të bardhë, që është në këndin e rrugës tërthore që shkon drejt Brenë-l'Alëdit. U përkul dhe i foli me zë të ulët udhërrëfyesit Lakost. Ky bëri një shenjë mohuese me kokë, me shumë gjasë, të pabesë.

Perandori u çua përsëri dhe u përmbodh.

Uelingtoni ishte zbrapsur. Nuk mbetej më tjetër veçse t'i jepte fund kësaj zbrapsjeje me anë të një veprimi dërrmues.

Napoleoni, duke u kthyer me vërtik, nisi me shpejtësi të madhe një korrier me kalë për në Paris për të njoftuar aty se beteja ishte fituar.

Napoleoni ishte një prej atyre gjenive nga lind e shpërthen bubullima.

Ai e kishte gjetur tanimë se ku do të lëshonte goditjen e tij prej vetëtime.

U dha urdhër koraciereve të Milhodit të merrnin me sulm rrafshinën e Mon-Sen-Zhanit.

IX

E papritura

Ata ishin tri mijë e pesëqind dhe formonin një front një çerek lege të gjerë. Ata ishin njerëz viganë, të hipur mbi kuaj kolosë. Ishin njëzet e gjashtë eskadronë; dhe kishin prapa tyre si mbështetje divizionin e Lëfebvrë-Dënuetit, të njëqind e gjashtë xhandarët e elitës, gjuetarët e gardës, një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë burra, dhe heshtarët e gardës, tetëqind e tetëdhjetë heshta. Ata mbanin përkrenare pa krifë dhe parzmore hekuri të rrahur, kobure në hejbetë e shalës dhe shpata të gjata. E gjithë ushtria i kishte admiruar kur, në orën nëntë, nën tingujt e trumbetave dhe të të gjitha bandave muzikore, që i binin himnit "Të mbrojmë perandorinë", ata kishin ardhur me kolona të gjera, me njërën prej baterive të tyre anash e tjetrën në qendër, duke u përhapur në formacion luftimi në dy rreshta midis xhadesë së Zhenapës dhe të Frishëmونتit, dhe kishin zënë vend për betejë në atë vijë të dytë të fuqishme, që e kishte sajuar me aq mençuri Napoleoni dhe që, duke pasur në krahun e majtë koracierët e Kelermanit dhe në skajin e djathtë koracierët e Milhodit, kishte, si të thuash, dy krahë të hekurt.

Adjutanti i fushës, Bernardi, u solli urdhrin e perandorit. Neji zhveshi shpatën dhe doli në krye. Eskadronët viganë u vunë në lëvizje.

Atëherë u shfaq një pamje e tmerrshme.

Tërë ajo kavaleri, me shpata përpjetë, me flamuj dhe trumbeta në ajër, e rreshtuar në kolonë me divizione, me një lëvizje të vetme dhe sikur të ishte një njeri i vetëm, me përpikmërinë e një kryedashi prej bronci që hap një zgërdhelë, zbriti kodrën e Belë-Alliansës, u zhyt në lugun e frikshëm, ku pak më parë ishin vlarë aq burra, u zhduk aty nëpër tym, pastaj, duke dalë nga ajo hije, u duk përsëri në anën tjetër të luginës, gjithmonë e pashkoqur dhe e ngjeshur, duke ngjitur me revan të shpejtë, përmes një breshërie të stuhishme që përplasej pas

saj, rrëpirën e frikshme dhe plot baltë të Mon-Sen-Zhanit. Ata ngjiteshin hijerëndë, kërcënues e të palëkundur; në ndërprerjet e breshërive të musketave dhe të artilerisë, dëgjohej rrapëllima kolosale e thundrave të kuajve. Duke qenë dy divizione, ata ishin dy kolona; divizioni i Uatierit kishte krahun e djathtë, divizioni i Delordit kishte të majtin. Duke i parë së largu tek ngjiteshin ashtu drejt kreshtës së rrafshinës, të thoshte mendja se ishin dy bullarë viganë prej çeliku. Kjo gjë e përshkoi betejën si ndonjë çudi mahnitëse.

Një gjë e tillë nuk ishte parë që nga koha kur kavaleria e rëndë pati marrë me sulm kampin e madh të fortifikuar të Moskovës; Myrati mungonte, por Neji¹⁰⁷⁾ ishte aty përsëri. Dukej sikur kjo masë ishte shndërruar në përbindësh dhe kishte një shpirt të vetëm. Çdo eskadron dallgëzonte e fryhej si ndonjë unazë polipi. Ata shquheshin përmes një tymi të madh, të çjerrë aty-këtu. Një lesheli përkrenaresh, britmash, shpatash, brofje të stuhishme vithesh të kuajve në zhurmën e topit dhe të fanfarës, mori e disiplinuar dhe e tmerrshme; sipër tyre parzmoret dukeshin si luspat mbi kuçedrën.

Këto tregime duket sikur i përkasin ndonjë epoke tjetër. Diçka e ngjashme me këtë pamje shfaqej pa dyshim në epopetë e lashta orfike, që tregojnë mbi njerëzit-kuaj, hipantropët e qëmoçëm, ata titanë me fytyrë njeriu dhe me parzma kuajsh, të cilët e kapërcenin fluturimthi Olimpini, krijesa të llahtarshme, të paprekshme, sipërore; perëndi dhe kafshë.

Rastisje e çuditshme numerike: njëzet e gjashtë batalione do të prisnin për ndeshje këta njëzet e gjashtë eskadronë. Prapa kreshtës së rrafshinës, nën hijen e baterisë së maskuar, këmbësoria angleze, e formuar në trembëdhjetë katrorë, dy batalione për katror, dhe në dy vija, shtatë në të parën, gjashtë në të dytën, me qytë në sup, duke marrë në shenjë ata që po vinin, e qetë, e heshtur, e palëvizur, po priste. Këmbësoria nuk i shikonte koracierët dhe koracierët nuk e shihnin këmbësorinë. Ajo mbante vesh tek po ngjitej kjo baticë e madhe njerëzish. Ajo e dëgjonte zmadhimin e zhurmës të tri mijë kuajve, rrahjen e këmbyer dhe simetrike të thundrave në revan të shpejtë, përplasjen e parzmoreve, tringëllimën e shpatave dhe njëfarë

dihatjeje të madhe e të tmerrshme. U bë një heshtje që të kalte frikën, pastaj, befas, një varg i gjatë krahësh të ngritur përpjetë, duke vringëlluar shpatat, u duk sipër kreshtës, pastaj përkrenaret dhe trumbetat, dhe flamujt, dhe tri mijë koka me mustaqe thinjoshe duke bërtitur: "Rroftë perandori!" E gjithë kjo kavaleri shpërtheu mbi rrafshinë, dhe u bë sikur ra ndonjë tërmet i madh.

Befas, diçka tragjike, në krahun e majtë të anglezëve, në të djathtën tonë, kreu i kolonës së koracierëve u çua kas me një britmë të frikshme. Si kishin arritur në pikën më të lartë të kreshtës, të dalldisur dhe të papërmbajtur në tërbimin dhe vrapin shkatërrues mbi katrorët dhe topat, koracierët sapo kishin dalluar midis tyre dhe anglezëve një hendek, një hon. Ishte udha e thellë e Ohenit.

Çasti ishte i llahtarshëm. Përroi ishte aty, i papritur me gojën hapur, i prerë thikë nën këmbët e kuajve, i thellë më shumë se dy bojë njeriu, midis dy ledheve; rreshti i dytë shtyu të parin, dhe i treti shtyu të dytin; kuajt ngriheshin përpjetë, hidheshin prapa, binin mbi vithe, rrëshqitnin me të katër këmbët përpjetë, duke i bluar e qorollisur kalorësit e tyre, asnjë mundësi për t'u kthyer prapa, e tërë kolona s'ishte më tjetër veçse një predhë e vetme, turri që ishte marrë për të dërrmuar anglezët, shtypi francezët, përroi i papërkulshëm nuk mund të dorëzohej veçse kur të ishte mbushur deng; kalorës e kuaj u rrëkëllyen aty lesheli, duke e dërrmuar e shembur njëri-tjetrin, duke e bërë mish të gjallë atë hon, dhe, kur kjo gropë u mbush me njerëz të gjallë, të tjerët ecën sipër dhe ata që kishin mbetur kaluan. Gati një e treta e brigadës Dybua u rrëkëllye në atë greminë.

Kjo e nisi fill humbjen e betejës.

Një traditë e vendit, e cila me siguri që e tepron, thotë se dy mijë kuaj dhe një mijë e pesëqind burra u mbuluan në udhën e thellë të Ohenit. Kjo shifër, mesa duket, përfshin edhe kufomat e tjera që u hodhën në këtë përrua të nesërmen e luftimit.

Le të shënojmë kalimthi se brigada Dybua, që pësoi atë gjëmë aq të madhe, ishte pikërisht ajo që një orë më parë, duke

u hedhur në sulm veças, kishte rrëmbyer flamurin e batalionit të Lyneburgut.

Napoleoni, përpara se t'i kishte urdhëruar për këtë sulm koracierët e Milhodit, kishte këqyrur mirë terrenin, por nuk kishte mundur të shikonte atë udhë të thellë, e cila nuk bënte as edhe një rrudhë mbi sipërfaqen e rrafshinës. Megjithatë, një kishëz e bardhë, që shënon këndin e xhadesë së Nivelës, e kishte vënë në dyshim Napoleonin dhe e kishte bërë t'i hapte sytë; për këtë arsye, ndoshta duke parashikuar ndonjë pengesë të rastit, ai i kishte bërë një pyetje udhërrëfyesit Lakost. Udhërrëfyesi ishte përgjigjur: "Jo". Gati-gati mund të thuhet se katastrofa e Napoleonit lindi nga kjo shenjë e kokës e një fshatari.

Duhej të dilnin akoma prapësira të tjera. A ishte vallë, e mundur që Napoleoni ta fitonte këtë betejë? Ne përgjigjemi se jo. Pse? Për shkak të Uelingtonit? Për shkak të Blyherit? Jo. Napoleoni fitues në Vaterlo nuk përputhej më me ligjin e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Po përgatitej një seri tjetër ngjarjesh, ku Napoleoni s'kishte më vend e pjesë. Vullneti i keq i ngjarjeve kishte bërë majë që prej shumë kohësh. Kishte ardhur koha që ky njeri vigan të rrëzohej poshtë.

Pesha jashtë çdo mase e këtij njeriu në fatin e njerëzimit e turbullonte drejtpeshimin. Ky njeri, vetëm për vetëm, kishte një peshë më të madhe se tërë gjithësia. Gjithë ky vitalitet njerëzor, i përqendruar me tepri në një kokë të vetme, kjo botë e tërë, e përmbledhur në trurin e një njeriu, të gjitha këto do të ishin vdekjeprurëse për qytetërimin, në qoftë se do të vazhdonin gjatë. Drejtësisë së natyrshme, asaj drejtësie të pathyeshme dhe sipërore i kishte ardhur koha që të bënte paralajmërimin e vet. Me gjasë, parimet dhe elementet, prej nga varen gravitacionet e rregullta në rendin moral, ashtu si në rendin lëndor, po ankoheshin. Gjaku që avullon, varrezat të mbushura cit, nënat dhe lotët, të gjitha këto janë akte padijeje të frikshme. Kur toka vuan nga një mbingarkesë, atëherë fillojnë e shpërthejnë rënkime të territ, të cilat humnera i dëgjon.

Napoleoni ishte paditur në pafundësi, dhe rënia e tij ishte vendosur e vulosur. Ai i kishte rënë më qafë perëndisë.

Vaterloja nuk është aspak një betejë, ajo është një ndërrim fronti i gjithësisë.

X

Rrafshina e Mon-Sen-Zhanit

Njëkohësisht me përruan ishte zbuluar edhe bateria.

Koracierët u përvëluan flakë për flakë si me zjarr rrufeje nga të gjashtëdhjetë topat dhe të trembëdhjetë katrorët. I patremburi gjeneral Delordi e përshëndeti ushtarakisht baterinë angleze.

E gjithë bateria lëvizëse kishte hyrë kupthi brenda në mes të katrorëve. Koracierët nuk u ndalën për asnjë grimë. Batërdia e udhës së thellë i kishte dhjetuar ata, por nuk ua kishte ligështuar zemrën. Ata ishin asi burrash që kur pakësohen në numër, shtohen në trimëri.

Vetëm kolona e Uatierit kishte pësuar nga batërdia; kolona e Delordit, të cilën Neji e kishte shmangur nga e majta, sikur ta kishte parandier kurthin, kishte arritur e tëra, e pacënuar.

Koracierët u lëshuan me vërtik mbi katrorët anglezë. Në pikë të vrapit, frerët lëshuar, shpatat ndër dhëmbë, koburet në dorë, kështu u bë goditja. Në betejat ka çaste kur shpirti e nguros njeriun gjer në atë shkallë sa ta shndërrojë ushtarin në statujë, dhe gjithë ai mish i gjallë bëhet granit. Batalionet angleze, të sulmuara tërbimthi, nuk luajtën vendit. Atëherë u bë llahtara.

Të gjitha ballet e katrorëve anglezëve u sulmuan njëherësh. Një stuhi e tërbuar i mbështolli fund e krye. Por kjo këmbësori e ftohtë qëndroi e patundur. Rreshti i parë, me gju përdhé, i priste koracierët me majat e bajonetave, rreshti i dytë i gjuante me pushkë; prapa rreshtit të dytë artilierët mbushnin topat, balli i katrorit hapej, linte të kalonte një vullkan breshërie dhe mbyllej përsëri. Koracierët përgjigjeshin duke e shtypur armikun. Kuajt e mëdhenj ngriheshin kas, kapërcenin rreshtat, kërcenin sipër bajonetave dhe binin si viganë në mes të këtyre

katër mureve të gjalla. Gjylet hapnin zbrazëtira midis koracierëve, koracierët hapnin zgërdhele në katrorët. Rreshta të tërë njerëzish zhdukeshin të dërrmuar nën kuajt. Bajonetat nguleshin në barqet e këtyre centaurëve. Nga të gjitha këto ishte shkaktuar një mishmash plagësh, që ndoshta s'është parë tjetërkund. Katrorët, të brejtur nga kjo kavaleri e tërbuar, tkurrëshin, por nuk luanin vendit. Ata nuk e shternin kurrë breshërinë dhe shkaktonin shpërthime në mes të atyre që sulmonin. Fytyra e këtij luftimi ishte e përbindshme. Këta katrorë nuk ishin më batalione, por gryka vullkanesh: këta koracierë nuk ishin më një kavaleri, por një stuhi e vërtetë. Çdo katror ishte një vullkan i sulmuar nga një vetëtimë; llava luftonte me rrufenë.

Katrori i tejmë i krahut të djathtë, më i zbuluar i të gjithëve, fare i zbuluar, pothuajse u asgjësua krejt që me përpjekjet e para. Ky katror përbëhej nga i 75-ti regjiment i malësorëve skocezë. Ai që i binte gjajdes në qendër, në kohën kur të tjerët vriteshin e priteshin njëri me tjetrin rreth e rrotull tij, duke ulur me një mospërfillje të thellë syrin e tij melankolik, të mbushur me pasqyrimin e pyjeve dhe të liqeneve, i ulur mbi një tambur, me gjajden e tij nën sqetull, luante këngët e malësisë. Këta skocezë vdisnin duke çuar mendjen te Ben Lotiani, ashtu si bënin dikur grekët duke kujtuar Argosin.¹⁰⁸⁾ Shpata e një koracieri, duke rrëzuar gjajden dhe krahun që po e mbante, e bëri këngën të pushonte duke vranë këngëtarin.

Koracierët, relativisht të paktë në numër, të pakësuar nga katastrofa e përroit, kishin aty kundër tyre pothuajse të gjithë ushtrinë angleze, por ata shtoheshin në numër, sepse njëri vlente sa për dhjetë. Por, ndërkohë, disa batalione hanovrase u tërhoqën. Uelingtoni e pa këtë gjë dhe mendoi për kavalerinë e tij. Në qoftë se Napoleoni po atë çast do të kishte menduar për këmbësorinë e tij, do ta kishte fituar betejën. Kjo harresë ishte gabimi i tij i madh e fatal.

Papritmas koracierët sulmues e panë se po sulmoheshin. Kavaleria angleze ishte prapa shpinës së tyre. Përpara tyre katrorët, prapa Somerseti; Somerseti donte të thoshte të një mijë e katërqind dragonët e gardës. Somerseti kishte në të

djathtë e tij Dornbergun me kavalerinë e lehtë gjermane dhe në të majtë Tripin me karabinierët belgë; koracierët, të sulmuar krahasi dhe ballazi, përpara dhe prapa nga këmbësoria dhe kavaleria, u detyruan që t'u bënin ballë të gjithë krahëve. Por atyre aq u bënte. Ata ishin një rrebesh i gjallë. Trimëria e atyre casteve as që mund të rrëfehët me fjalë.

Veç këtyre, ata kishin prapa baterinë, që gjëmonte pareshtur. U desh edhe kjo që këta burra të plagoseshin në shpinë. Një prej parzmoreve të tyre, e shpuar nga shpatulla e majtë prej një biskajene, ndodhet në koleksionin që quhet muzeumi i Vaterlosë. Për të tillë francezë duheshin vetëm të tillë anglezë.

Nuk ishte më një përleshje, por një shakullinë, një furi, një flakërimë e mahnitshme shpirtrash e zemrash, një stuhi e madhe shpatash të rrufeshme. Brenda një çasti të një mijë e katërqind dragonët - gardistë nuk mbetën më shumë se tetëqind; Fyleri, nënkoloneli i tyre, ra vdekur në tokë. Neji ngarendi me heshtëtarët dhe gjuetarët e Lefebvrë-Desnuetit. Rrafshina e Mon-Sen-Zhanit u mor, u rimor, u mor përsëri. Koracierët braktisnin kavalerinë për t'iu kthyer këmbësorisë ose, më mirë të themi, e gjithë kjo hordhi e tmerrshme ishte bërë mishmash dhe njëra palë s'e lëshonte palën tjetër. Katrorët vazhdonin gjithmonë të qëndronin. U bënë dymbëdhjetë sulme. Nejit iu vranë katër kuaj nën vete. Gjysma e koracierëve mbetën mbi rrafshinë. Kjo luftë mbajti dy orë.

Ushtria angleze u trondit rëndë. S'ka asnjë dyshim se, po të mos ishin dobësuar në ndeshjen e parë, nga batërdia e udhës së thellë, koracierët do ta kishin thyer qendrën dhe do të kishin vendosur fitoren. Kjo kavaleri e jashtëzakonshme e habiti Klintonin, i cili kishte parë edhe betejat e Talaverës dhe të Badajozit¹⁰⁹⁾. Uelingtoni, tre çerek i mundur, admironte me heroizëm. Ai thoshte me gjysmë zëri: "Splendid!"^{*)}.

Koracierët asgjësuan shtatë nga të trembëdhjetë katrorët, kapën ose nxorën jashtë përdorimit gjashtëdhjetë topa dhe u rrëmbyen regjimenteve angleze gjashtë flamuj, të cilët i morën

^{*)} E madhërishtme! (angl.).

tre koracierë e tre gjuetarë e ia shpunë perandorit përpara fermës së Belë-Aliansës.

Gjendja e Uelingtonit ishte keqësuar. Kjo betejë e çuditshme ishte si një dyluftim midis dy të plagosurish që luftojnë dhëmb për dhëmb e që secili, nga ana e vet, duke luftuar e duke rezistuar, humbet deri pikën e fundit të gjakut. Cili nga këta të dy do të rrëzohet i pari?

Luftimi në rrafshinë vazhdonte.

Gjer ku patën vajtur koracierët? Askush nuk do të ishte në gjendje ta thoshte. Por një gjë është e sigurt se të nesërmen e betejës një koracier dhe kali i tij u gjetën të vdekur në skelën e peshores së karrove në Mon-Sen-Zhan, tamam te pika ku ndërpriten dhe takohen të katër udhët e Nivelës, Zhenapës, Hulpës dhe të Brukselit. Ky kavalier i kishte çarë radhët angleze. Njëri prej burrave që e ka ngritur kufomën e tij, jeton akoma në Mon-Sen-Zhan.

Ai quhet Dehaz. Asokohe ai ishte tetëmbëdhjetë vjeç.

Uelingtoni po ndiente se po e merrte tatëpjeta. Kriza ishte e afërt.

Koracierët nuk ia kishin dalë mbanë, me këtë kuptim, që qendra nuk ishte thyer. Rrafshinën e kishin të dyja palët, por askush nuk qe zot i saj, dhe, në fund të fundit, pjesa më e madhe u mbetej anglezëve. Uelingtoni kishte fshatin dhe fushën kulmuese; Neji kishte vetëm kreshtën dhe rrëpirën. Të dyja palët dukeshin sikur kishin zënë rrënjë në këtë truall të përzishëm.

Por dobësimi i anglezëve dukej i pandreqshëm. Hemoragjia e kësaj ushtrie ishte e llahtarshme. Kempiti, në krahun e majtë, kërkonte përforcime. "Përforcime s'ka", - përgjigjej Uelingtoni. - "Le të shuhet në vend!" Pothuajse në të njëjtën minutë, përqsasje e pazakontë, që pikturon rraskapitjen e të dyja ushtrive, Neji i kërkonte këmbësori Napoleonit, dhe Napoleoni bërtiste: "Këmbësori! E ku ta marr unë? Mos do që ta pjell?"

Megjithatë, ushtria angleze ishte më e sflitura. Sulmet e furishme të këtyre eskadronëve me parzmore hekuri dhe me gjokse çeliku e kishin bluar këmbësorinë. Disa burra rreth një

flamuri shënonin vendin e një regjimenti, aksh batalion komandohej nga një kapiten ose nga një toger; divizioni i Altenit, i sakatosur në Hé-Sentë, pothuajse ishte shkatërruar; belgët sypatrembur të brigadës Van Kluzë dergjeshin nëpër thekrat gjatë rrugës së Nivelës; nuk kishte mbetur pothuajse asgjë nga ata granatierët holandezë, të cilët më 1811, të përzier në Spanjë me radhët tona, luftonin Uelingtonin dhe më 1815, të lidhur me anglezët, luftonin Napoleonin. Humbjet në oficerë ishin të mëdha. Lord Aksbrixhit, i cili të nesërmen varrosi këmbën e tij, i qe bërë gjuri copë-copë. Në qoftë se nga ana e francezëve, në këtë luftim të koracierëve, Delordi, Lheritieri, Kolberti, Dnopi, Traversi dhe Blankardi ishin nxjerrë jashtë luftimi, nga ana e anglezëve, Altenti ishte plagosur, Barni ishte plagosur, Delanseji ishte vvarë, Van Merleni ishte vvarë, Omptedi ishte vvarë, gjithë shtabi madhor i Uelingtonit ishte dhjetuar, dhe Anglisë i kishin rënë hisja më e keqe në këtë drejtpeshim të përgjakshëm. Regjimenti i dytë i gardistëve këmbësorë kishte humbur pesë nënkolonelë, katër kapitenë dhe tre flamurbajtës; batalioni i parë i të 30-it regjiment të këmbësorisë kishte humbur njëzet e katër oficerë dhe njëqind e dymbëdhjetë ushtarë; i 79-i regjiment malor kishte njëzet e katër oficerë të plagosur, tetëmbëdhjetë oficerë të vvarë, katërqind e pesëdhjetë ushtarë të vvarë. Husarët hanovras të Kamberlendit, një regjiment i tërë, me në krye kolonelin e vet Heik, i cili më vonë do të gjykohej e pastaj do të falej, kishin bërë prapaktheu përpara përleshjes dhe kishin marrë nga sytë këmbët nëpër pyllin e Suanjës, duke mbjellë panik e duke shkaktuar edhe thyerjen e reparteve të tjera deri në Bruksel. Karrot, mjetet mbartëse të artilerisë, bagazhet, karrocot plot me të plagosur, duke parë francezët, që po fitonin tokë dhe po i afroreshin pyllit, tërhiqeshin me rrëmbim dhe pa rregull; holandezët, nën mëshirën e shpatave të kavalerisë franceze, bërtisnin: "Alarm!" Nga Ver-Kukuja gjer në Grënendel, mbi një gjatësi prej afro dy legash në drejtim të Brukselit, sipas të thënave të dëshmitarëve që jetojnë edhe sot e kësaj dite, ishte bërë një mishmash njerëzish, që iknin për të shpëtuar kokën. Ky panik ishte aq i madh, sa pushtoi edhe princin e Kondesë

në Malinë dhe Luigjin XVIII në Gand.¹¹⁰⁾ Me përjashtim të rezervës së dobët të skalionuar prapa ambulancës së vendosur në fermën e Mon-Sen-Zhanit dhe të brigadave të Vivianit e të Vandelerit, që mbështetnin krahun e majtë, Uelingtonit s'i kishte mbetur më tjetër kavaleri. Shumë bateri dergjeshin të zbërthyer. Këto fakte i ka pohuar edhe Siborni; edhe Prëngli, duke e fryrë tepër shkatërrimin, arrin gjer atje sa të thotë se ushtria anglo-holandeze ishte katandisur në tridhjetë e katër mijë njerëz. Duka i Hekurt¹¹¹⁾ qëndronte i qetë, por buzët i qenë bërë si meit. Komisari austriak Vensan, komisari spanjoll Alava, të pranishëm në betejë pranë shtatmadhorisë angleze, kujtonin se Dukën e kishte marrë lumi. Në orën pesë, Uelingtoni nxori sahatin dhe ata që ndodheshin aty rreth dëgjuan tek shqiptoi këto fjalë të zymta: "Ja Blyheri, ja mortja!"

Pikërisht rreth këtij çasti një vijë e largët bajonetash shkrepiti mbi lartësitë nga ana e Frishëmونتit.

Këtu qëndron peripecia e kësaj drame vigane.

XI

Udhërrëfyes i keq për Napoleonin, udhërrëfyes i mirë për Bylovin

Gjithkush e di gabimin e rëndë të Napoleonit; ai shpresonte t'i vinte Grushiu, por ia behu Blyheri; vdekja në vend të jetës.

Fati i ka këto kthesa; njeriu pret të hipë në fron për të sunduar botën, por ja ku i del përpara ishulli i Shën-Helenës.

Në qoftë se bariu i vogël që i shërbente si udhërrëfyes Bylovit, mëkëmbësit të Blyherit, do ta kishte këshilluar të dilte nga pylli mbi Frishëmонт, në vend që të dilte nën Plansënua, forma e shekullit XIX do të kishte qenë ndoshta ndryshe,

¹¹⁰⁾ E ka fjalën për Uelingtonin. I mbiquajtur kështu për forcën e tij të madhe fizike.

Napoleoni do ta kishte fituar betejën e Vaterlosë. Sikur të mos kishte kaluar nga udha nën Plansënua, por gjetiu, ushtria prusiane do të dilte përballë një përroi të pakapërcyeshëm për artilerinë, dhe Bylovi nuk do të arrinte dot.

Kështu pra, sikur të kishte një orë vonesë, këtë e thotë vetë gjenerali prusian Myfling,¹¹¹⁾ Blyheri nuk do ta kishte gjetur më Uelingtonin në këmbë; "beteja do të qe e humbur".

Ishte tamam koha, siç duket qartë, që Bylovi të arrinte. Madje, ai edhe shumë ishte vonuar. Ai kishte ngritur kampin në Dion-le-Mont dhe ishte nisur qysh në agim. Por udhët ishin të pavozitshme dhe divizionet e tyre kishin mbetur në llucë. Hullitë e gërryera arrinin gjer te boshti i rrotave të topave. Veç kësaj, u desh që të kalohej lumi Dilë mbi urën e ngushtë të Vavrës; rrugës që shpinte te ura, i qe vënë zjarri nga francezët; duke qenë se arkat e municioneve dhe karvani i karrove të artilerisë nuk mund të kalonin midis dy radhëve të shtëpive në flakë, kishin qenë të detyruar të prisnin sa të shuhej zjarri. Ishte mesditë dhe pararoja e Bylovit s'kishte mundur të kapte akoma Shapelë-Sen-Lambertin.

Sikur veprimi të kishte filluar dy orë më herët, ai do të kishte marrë fund në orën katër, dhe Blyheri do të kishte rënë në betejën e fituar nga Napoleoni. Të tilla janë këto rastësitë e pamasa, të përpjesëtuara në pafundësi, të cilat s'na i kap dot mendja.

Qysh në mesditë, perandori, i pari, me tejqyrën e vet, kishte shquar në horizontin e tejmë diçka që i kishte tërhequr vëmendjen. Ai kishte thënë: "Po shoh atje tej një re, e cila më duket se është një ushtri." Pastaj kishte pyetur Dukun e Dalmacisë: "Sult, çfarë shihni ju në drejtim të Shapelë-Sen-Lambertit?" Mareshali e kishte vënë në sy tejqyrën dhe ishte përgjigjur: "Katër a pesë mijë burra, madhëri. Ka të ngjarë të jetë Grushiu." Mirëpo gjithë ajo ré qëndronte e palëvizur në mjegull. Të gjitha tejqyrat e kishin studiuar "renë" e shënuar nga perandori. Disa kishin thënë: "Janë kolona që kanë qëndruar në vend." Shumica kishin thënë: "Janë drurë". E vërteta ishte se reja nuk po lëvizte. Perandori kishte shkëputur

për zbulim drejt asaj pike të errët divizionin e kavalerisë së lehtë të Demonit.

Bylovi, në të vërtetë, s'kishte lëvizur vendit. Pararoja e tij ishte shumë e dobët dhe s'mund të bënte asgjë. Atij i duhej të priste shumicën e korparmatës, dhe kishte marrë urdhër t'i përqendronte forcat përpara se të hynte në vijën e luftimit; por në orën pesë, duke parë rrezikun e Uelingtonit, Blyheri i dha urdhër Bylovit të godiste dhe shqiptoi këto fjalë të shënuara: "I duhet dhënë dorë ushtrisë angleze të marrë frymë."

Pas pak divizionet e Losthinit, Hilerit, Heikut e të Risellit u hapën në formacion luftimi përpara korpusit të Loboit, kavaleria e princ Vilhelmit të Prusisë ia behte nga Pylli i Parisit, Plansënuai ishte në flakë dhe gjylet prusiane fillonin të binin si breshër gjer te rreshtat e gardës në rezervë, prapa Napoleonit.

XII

Garda

Gjithkush e di se ç'ngjau më pas: një armatë e tretë hyri në sulm me vërtik, beteja u hallakat, tetëdhjetë e gjashtë gryka zjarri bubulluan papritmas, Pirshi I ia behu tok me Bylovin, kavaleria e Zitenit udhëhiqej nga vetë Blyheri, francezët u zbrapsën, Markonjeti u përta nga rrafshina e Ohenit, Dyrtyti u shkul nga Papëlota, Donzeloti dhe Kioti u zbrapsën, Loboit u godit krahazi, beteja u vërsul ndaj të ngrysur mbi regjimentet tona të copëtuara, e gjithë vija angleze e filloi përsëri mësymjen dhe bëri përpara, një zgërdhelë vigane u hap në radhët e ushtrisë frënge, breshëria angleze dhe breshëria prusiane i ndihnin njëra-tjetrës, asgjësimi, shkatërrimi ballazi, shpartallimi krahazi; u desh që edhe garda të hynte në vijën e luftimit, nën këtë rrënim të llahtarshëm.

Garda, e cila sikur e ndiente se do të vdiste, bërtiti: "Rroftë perandori!" Historia s'ka gjë më tronditëse sesa një agoni të tillë, që shpërthen e shndërrohet në brohoritje.

Qielli kishte qenë i mbuluar me ré gjithë ditën e ditës. Befas, pikërisht po atë çast, ora ishte tetë e mbrëmjes, retë e horizontit u përhapën dhe lanë të kalonte, përmes vidhave, kuqëlimin e madh e të përzishëm të diellit, që po perëndonte. Në Austerlic diellin e kishin parë tek po lindte.

Çdo batalion i gardës komandohej për këtë rast nga një gjeneral. Aty ishin Frianti, Misheli, Rogeti, Harleti, Maleti, Pore dhe Morvani. Kur kësulata e larta të granatierëve të gardës, me atë pllakën e gjerë me shqiponjë, ia behën, ashtu simetrike, të renditura, të qeta, madhështore, në mjegullën e kësaj përleshjeje, armiku e ndjeu respektin ndaj Francës; u duk sikur në fushën e betejës hynë njëzet fitore, me krahë të hapur, dhe ata që ishin fitimtarë, e panë veten të mundur, u zbrapsën; por Uelingtoni bërtiti: "Në këmbë, gardistë, dhe shtini në mish!" Regjimenti i kuq i gardistëve anglezë, shtrirë barkazi prapa gjerdheve, u çua në këmbë; një breshëri si vetëtimja e bëri shoshë flamurin tringjyrësh, që valëvitej rreth shqipeve tona; të gjithë u turrën, dhe kasaphana filloi. Garda perandorake ndjeu në terr se ushtria u ligështua dhe u zbraps rreth saj; ajo ndjeu edhe lëkundjen e paanë të shpartallimit; ajo dëgjoi klithmën: "Ik të ikim!", që kishte zëvendësuar britmën: "Rroftë perandori!" dhe, me ikjen prapa saj, ajo vazhdoi të ecte përpara, gjithmonë e përvëlur si me zjarr rrufeje dhe duke vdekur gjithmonë e më shumë në çdo hap që bënte. Asnjë nuk dyzoi dhe asnjë nuk u ligështua. Ushitari në këtë regjiment ishte po aq hero sa edhe gjenerali. Asnjë burrë nuk i bëri bisht vetëvrasjes.

Neji, i dalldisur, i madh me të gjithë lartësinë e atij që e ka marrë vdekjen në sy, u vinte gjoksin përpara të gjithave goditjeve në këtë stuhi. Aty iu vra i pesti kalë ku kishte hipur. I mbytur në djersë, me sy që i shkrepnin, me buzë të shkumëzuara, me uniformë të zbërthyer, me një prej supëzave të prerë përgjysmë nga goditja me shpatë e një gardisti-kalorës, me pllakën e shqipes së madhe të gungëzuar nga një plumb, i përgjakur, i lerosur, i madhërishtë, me një shpatë të thyer në dorë, Neji thoshte: "Ejani të shikoni se si vdes një mareshal i Francës në fushën e betejës!" Por më kot; ai nuk vdiq. Ai ishte

i çakërdisur dhe i indinjuar. I lëshonte Druet d'Erlonit këtë pyetje: "Po ti a nuk do që të vritesh?" Bërtiste ai në mes të të gjithë asaj artilerie, që po bluante një grusht njerëz: "S'paska mbetur gjë për mua! Oh! Do të dëshiroja që të gjitha këto gjyle angleze të më hynin mua në bark!" Për ty ishin ruajtur të gjitha gjylet franceze, or fatzi!

XIII

Katastrofa

Shpartallimi në shpinë të gardës ishte vdekjeprurës.

Ushtria u thye papritmas dhe nga të gjitha anët njëherësh, nga Hugomonti, nga Hé-Senta, nga Papëlota, nga Plansënuaji. Britma: "Tradhti!" u vijua nga britma: "Shpëtoni të shpëtojmë!" Ushtria që zbërthehet, është si akulli që shkrihet. Gjithçka epet, plasaritet, kriset, pluskon, rrëkëllehet, rrëzohet, përplasat, ngutet, lëshohet turr. Shkoqje e paparë dhe e padëgjuar! Neji merr hua një kalë, i kërcen sipër dhe, kokëjashtë, pa kravatë, pa shpatë, zë vend në mes të xhadesë së Brukselit, duke ndalur njëkohësisht edhe anglezët, edhe francezët. Ai orvatet ta përmbajë ushtrinë, i bën thirrje e shan, kacavirret si me thonj pas shpartallimit. Por gjithçka vërshon mbi të. Ushtarët i largohen duke marrë nga sytë këmbët dhe duke bërtitur: "Rroftë mareshal Neji" Dy regjimente të Dyrytit shkojnë e vijnë të hutuar e të trembur dhe si të hedhur topthi midis shpatës së ulanëve dhe breshërisë së pushkëve të brigadave të Kemptit, Bestit, Pekut dhe Railandtit; më e keqja e përleshjeve është shpartallimi; miqtë vriten njëri me tjetrin për t'ua mbathur këmbëve; eskadronet dhe batalionet shpërndahen dhe dërrmohen njëri me tjetrin; shkumë vigane e betejës. Loboï në një skaj, ashtu si Reji në tjetrin, merr rrokullimën në valën që kalon. Më kot Napoleoni bën mure ndalese me çka i mbetet nga garda; më kot i harxhon ai, në një orvatje të fundit, eskadronet e veta të shërbimit. Kioti zbrapset përpara

Vivianit, Kelermani përpara Vandëlërit, Loboï përpara Bylovit, Morandi përpara Pirshit, Domoni dhe Syberviku përpara princ Vilhelmit të Prusisë. Gijoti, që udhëhoqi në sulm eskadronet e perandorit, bie nën këmbët e dragonëve anglezë. Napoleoni vrapon me kup përgjatë ushtarëve në ikje, u flet, i shtrëngon, i kërcënon, u lutet. Të gjitha ato gojë që thërrisnin atij mëngjesi "Rroftë perandori", tani qëndrojnë të hapura e të heshtura; ushtarët sa mezi e njohin perandorin e tyre. Kavaleria prusiane, e posaardhur, lëshohet, fluturon me krahë, godet me shpatë, pret, copëton, vret, asgjëson. Kuajt tërheqës ngasin me turr, topat marrin arratinë; ushtarët e karvanit shmbrehin arkat e municioneve dhe marrin kuajt për të ikur e për të shpëtuar kokën; karro të gremisura me të katër rrotat në ajër pengojnë rrugën dhe bëhen shkak për kasaphanë. Njerëzit shtypen njëri me tjetrin, përplasen, shkelin mbi të vdekurit dhe mbi të gjallët. Krahët janë si të çakërdisur. Një mori e hatashme mbush udhët, monopatet, urat, fushat, kodrat, luginat, pyjet, të bëra lesheli nga kjo ikje e dyzet mijë burrave. Britma, dëshpërim, çanta e pushkë të hedhura në thekrat, kalesa të hapura me goditje shpatash, s'ka më shokë, s'ka më oficerë, s'ka më gjeneralë, një frikë që s'mund të rrëfehët. Zietenit godet me shpatë Francën sipas qejfit. Luanët janë bërë sorkadhe. E tillë pati qenë kjo ikje.

Në Zhenapë u orvatën të ktheheshin përsëri, të bënin front, të ndalnin sulmin armik. Loboï mblodhi andej-këtej treqind burra. Ata e barrikaduan hyrjen e fshatit; por, me të krisur breshëria e parë prusiane, të gjithë ua mbathën përsëri këmbëve; dhe Loboï u kap rob. Edhe sot e kësaj dite shihet ajo breshëri që ka lënë vrage mbi ballinën me majuc të një ndërtese të vjetër me tulla, në të djathtë të rrugës, disa minuta përpara se të hysh në Zhenapë. Prusianët u turrën brenda në Zhenapë, të tërbuar pa dyshim që ishin aq pak fitimtarë. Ndjekja ishte e përbindshme. Blyheri urdhëroi të shfarosej çdo francez. Rogeti e kishte pas dhënë këtë shembull kobzi, duke kërcënuar me vdekje çdo granatier francez që do të sillte një rob prusian të gjallë. Blyheri ia kaloi Rogetit. Gjenerali i gardës së re, Dyhesmi, i ngujuar te porta e një hani të Zhenapës, ia dorëzoi shpatën e

vet një husari të vdekjes, i cili e mori shpatën dhe vrau robin. Fitorja u mbyll me therjen e të mundurve. Le të dënojmë, përderisa ne jemi historia: Blyheri plak u mbulua me turp. Kjo egërsi gjakpirëse i vuri kapakun shkatërrimit. Shpartallimi i dëshpëruar përshkoi Zhenapën, përshkoi Katrë-Brasin, përshkoi Goselinë, përshkoi Frasnën, përshkoi Sharlëruanë, përshkoi Teunin dhe nuk u ndal veçse në kufi. Medet! E kush vallë po ua mbathte këmbëve kësisoj? Ushtria e madhe.

Më të ngrysur, në një arë pranë Zhenapës, Bernardi dhe Bertrandi kapën pas çipit të redingotës dhe ndalën një burrë të çakërdisur, të rënë në mendime, të përzishëm, i cili, i tërhequr gjer aty nga rrjedha e shpartallimit, sapo kishte zbritur nga kali, kishte kaluar frerin e kalit në krah dhe me sy të çakërritur po kthehej vetëm drejt Vaterlosë. Ishte Napoleoni, që po orvatej akoma të shkonte përpara, somnambul vigan i kësaj ëndrre të shembur.

XIV

Katrori i fundit

Disa katrorë të gardës, të palëvizur në rrjedhën e shpartallimit, si ndoca shkëmbinj në ujët që rrjedh, u mbajtën gjersa erdhi nata. Po binte nata dhe bashkë me të edhe vdekja, dhe ata, të patundur, e lanë këtë hije të dyfishtë t'i mbështillte. Secili regjiment, i veçuar nga të tjerët dhe duke mos pasur më lidhje me ushtrinë, që ishte thyer në çdo anë, vdiste për hesap të vet. Ata kishin zënë pozicione, për të kryer këtë veprim të fundit, disa mbi lartësitë e Rosomës, të tjerët në fushën e Mon-Sen-Zhanit. Atje, të braktisur, të mundur, të tmerrshëm, këta katrorë të zymtë po hiqnin shpirt në mënyrë të hatashme. Me ato regjimente po vdisnin e mbaronin Ulmi, Vagrami, Jena, Fridlandi.¹¹²⁾

Ndaj të ngrysur, rreth orës nëntë të mbrëmjes, në pjesën e ulët të rrafshinës së Mon-Sen-Zhanit po qëndronte akoma

një katror. Në këtë luginë kobzezë, në këmbët e asaj pjerrësie, së cilës iu qepën koracierët dhe ku tani kishin vërshuar mizëritë angleze, nën zjarrin e përqendruar të artilerisë armike fitimtare, nën një dendësi të frikshme predhash, ky katror luftonte. Ai komandohej nga një oficer i panjohur që quhej Kambron.¹¹³⁾ Në çdo zbrazje, katrori zvogëlohej dhe përgjigjej me zjarr. Ai i përgjigjej breshërisë me të shtëna pushkësh, duke i tkurrur pareshtur të katër muret e veta. Nga larg, ushtarë që po iknin, duke qëndruar kohë më kohë për të marrë frymë, mbanin vesh dhe dëgjonin këtë bubullimë të errët, që sa vinte e zvogëlohej.

Kur ky legion kishte mbetur vetëm një grusht njerëzish, kur flamuri i tyre kishte mbetur vetëm një zhele, kur pushkët e tyre me fishekë të sosur kishin mbetur vetëm si shkopinj, kur vandaku i kufomave ishte bërë më i madh se grupi që kishte mbetur gjallë, fituesit i përshkoi njëfarë tmerrri i shenjtë rreth këtyre njerëzve të madhërisëm që po vdisnin, dhe artileria angleze, duke marrë frymë për t'u çlodhur, heshti fare. U bë njëfarë pushimi. Këta luftëtarë kishin rreth tyre një si mizëri fantazmash, hije njerëzish hipur mbi kuaj, hijet e zeza të topave, qiellin e zbardhëllemë, që dukej përmes rrotave dhe grykave të topave; koka kolosale e vdekjes, që heronjtë ajgëtojnë gjithmonë në tym në thellësi të betejës, po ecte përpara drejt mbi ta dhe po i vështronte. Ata mundën të dëgjonin në hijen e mugëtirës se armiku po i mbushte topat, fitilat të ndezur tamam si sy tigrash në terrin e natës sajuan një rreth përçark kokave të tyre, të gjithë zjarrvënësit anglezë iu afruan topave, dhe atëherë, i mallëngjyer, duke e mbajtur pezull minutën supreme përmbi kokat e këtyre burrave, një gjeneral anglez, Kolvili sipas disave, Meitlandi sipas të tjerëve, u thirri: "Trima francezë, dorëzohuni!" po Kambroni u përgjigj: "Një mut!".

Kambroni

Meqenëse lexuesi francez kërkon që të respektohet, edhe sikur fjalën më të bukur të ketë thënë një francez, ai s'do t'ia përsëritësh më këtë fjalë. Është e ndaluar të vendosësh madhështi mbi historinë.

Ne po i marrim në sy të gjitha rreziqet dhe po e shkelim këtë gjë të ndaluar.

Kështu pra, midis gjithë atyre gjigantëve, pati një titan, dhe ky ishte Kambroni.

Të thuash atë fjalë, dhe pastaj të vdesësh. E ku ka gjë më të madhe! Sepse, po deshe ta thuash, duhet të vdesësh pastaj, dhe nuk është faji i këtij njeriu në qoftë se, edhe pasi u bë shoshë nga plumbat, mundi të jetonte.

Njeriu që fitoi betejën e Vaterlosë, s'është as Napoleoni, që u thye, as Uelingtoni, që u tërhoq në orën katër dhe mbeti në një gjendje të dëshpëruar në orën pesë, as Blyheri, që nuk luftoi fare; njeriu që e fitoi betejën e Vaterlosë, është Kambroni.

Ta përvëlosh si me rrufe bubullimën që po të vret, don të thotë të mposhtësh, të fitosh.

T'i kthesh një përgjigje të tillë katastrofës,¹¹⁴⁾ t'ia thuash atë fjalë fatit, t'i japësh këtë bazë luanit të ardhshëm, t'ia kthesh fjalën kësaj shiut të natës, murit tradhtar të Hugomontit, udhës së thellë të Ohenit, vonesës së Grushiut, arritjes së Blyherit, të jesh ironi e gjallë brenda në varr, të veprosh asisoj, që të mbetesh në këmbë edhe pasi të jesh rrëzuar përdhé, ta mbytësh në një rrokje të vetme besëlidhjen evropiane, t'u dhurosh mbretërve këto nevojtoje, që dikur i kanë pas njohur edhe cezarët, të marrësh e ta bësh të parën fare fjalën më të fundit, duke përzier me të shkrepimën e Francës, ta mbyllësh Vaterlonë me të martën e të lidhurave, ta plotësosh Leonidën me Rabëlenë, ta përmbledhësh këtë fitore në një fjalë sipërore, që është e pamundur ta shqiptosh, të humbasësh tokën, por të ruash historinë, pas asaj kasaphane të kesh me vete ata që

qeshin, kjo është një gjë që s'ka as anë, as fund.

Kjo është një fyerje ndaj rrufesë. Kjo gjë arrin madhësinë eskiliane.

Fjala e Kambronit bën efektin e një thyerjeje. Është thyerja e kraharorit nga përbuzja; kjo është agonia që i ka ardhur majë hundës e që bën shpërthimin. Kush ka fituar? Mos vallë Uelingtoni? Jo. Pa Blyherin, atë do ta kishte marrë lumi. Mos vallë Blyheri? Jo. Po të mos kishte filluar Uelingtoni, Blyheri s'do të kishte mundur të mbaronte. Ky Kambron, ky kalimtar i orës së fundit, ky ushtar i panjohur, kjo gjëzë e parëndësishme e luftës, ndjeu që në këtë mes ka një gënjeshtër, një gënjeshtër në një katastrofë, dyfish therëse, dhe, në çastin kur ai po pëlçet nga tërbimi për këtë gënjeshtër, i ofrojnë këtë gjë kaq qesharake e përlulëse, jetën! E si të mos kërcesh përpjetë pastaj?

Atyjanë të gjithë mbretërit e Evropës, gjeneralët e lumtur, Jupiterët bubullues, ata janë njëqind mijë ushtarë fitimtarë, dhe prapa të njëqind mijëve, një milion; topat e tyre, me fitila ndezur, e kanë hapur grykën sa një shpellë; ata kanë nën thundër gardën perandorake dhe armatën e madhe; sapo e dërrmuan Napoleonin dhe nuk ka mbetur tjetër veç Kambronit; s'ka mbetur tjetër njeri për të protestuar përveç këtij krimbi të dheut. Ai do të protestojë. Atëherë ai kërkon një fjalë, ashtu siç kërkon njeriu një shpatë. Atij i mbushet goja shkumë, dhe nga kjo shkumë del fjala që i duhet. Përpara kësaj fitoreje të hatashme dhe gjysmake, përpara kësaj fitoreje pa fitimtarë, ky njeri i dëshpëruar çohet në këmbë; ai ndien madhësinë e kësaj fitoreje, por konstaton edhe hiçin e saj; dhe ai pështyn mbi këtë fitore, madje bën më shumë; dhe nën peshën e madhe të numrit, të forcës dhe të materies, ai i gjen shpirtit një shprehje, të pëgërët. Po e përsëritim. Ta thuash këtë, ta gjesh këtë, do të thotë të jesh fitues.

Fryma e ditëve të mëdha depërtoi te ky burrë i panjohur në këtë minutë fatale. Kambroni e gjen fjalën për Vaterlonë, ashtu si Rozhe dë Lili gjen "Marsejezën"¹¹⁵⁾ me anën e frymëzimit. Këtë fjalë të përbuzjes titanike Kambroni nuk ia vërvit vetëm Evropës në emër të perandorisë, kjo do të ishte pak; ai ia vërvit së kaluarës në emër të Revolucionit. Njeriu e

dëgjon dhe njeh te Kambroni shpirtin e lashtë të gjigantëve. Duket sikur flet Dantoni ose sikur buçet Kleberi.¹¹⁶⁾

Fjalës së Kambronit, zëri anglez iu përgjigj me fjalën: "Zjarr!" Bateritë flakërinë, kodra u drodh, të gjitha ato gryka bronci vollën për të fundit herë një breshëri të tmerrshme; një tym shumë i madh, i zbardhëlyer vagët nga lindja e hënës, rrëshqiti dhe, kur tymi u përhap e u davarit, s'kishte mbetur më asgjë. Kjo mbeturinë e hatashme ishte asgjësuar; garda kishte dhënë shpirt. Të katër muret e kampit të gjallë të fortifikuar dergjeshin përtokë, me zor dallohej aty-këtu ndonjë përpëlitje në mes të kufomave; dhe kësisoj legjionet franceze, më të mëdha se legjionet romake, dhanë frymën e tyre të fundit në Mon-Sen-Zhan, mbi tokën e lagur me shi e me gjak, në grynjërat e zymta, në vendin ku tani kalon, në orën katër të mëngjesit, duke vërshtëlyer e duke rrahur me kamxhik plot gaz kalin e tij, Zhozefi, që bën shërbimin postar të Nivelës.

XVI

Quot libras in duce? "

Beteja e Vaterlosë ishte një enigmë. Ajo është po aq e errët si për ata që e fituan, ashtu edhe për atë që e humbi. Për Napoleonin, ajo është një panik;^{**)} Blyheri në këtë betejë nuk shikon tjetër veçse zjarr; Uelingtoni s'merr vesh asgjë. Shikojini raportet. Buletinet janë të errëta, komentet janë të ngatërruara. Njëra palë belbëzon, palës tjetër i mbahet goja. Zhomini¹¹⁷⁾ e ndan betejën e Vaterlosë në katër momente; Myflingu e ndan në tri peripeci; Sharasi, megjithëse për disa pika ne kemi një

^{*)} Cila është pesha, fuqia e udhëheqësit? (lat.)

^{**)} Një betejë e përfunduar, një ditë e mbaruar, masa të marra keq, të ndrequra më pas, suksese akoma më të mëdha, të siguruar për të nesërmen, gjithçka humbi nga një çast terrori plot panik.

(Kujtime të Napoleonit të diktuar nga Shën-Helena.)

vlerësim të ndryshëm nga ai i tij, është i vetmi që ka kapur me syrin e tij krenar përvijimet karakteristike të kësaj katastrofe të gjenisë njerëzore në përfytyje me fatin hyjnor. Të gjithë historianët e tjerë janë si të verbuar nga shkëlqimi; dhe nga ky farë verbimi ata ecin verbtazi. Në të vërtetë, ajo ishte një ditë e rrufeshme, ishte rrënimi i monarkisë ushtarake, e cila, për çudinë e madhe të mbretërve, tërhoqi pas vetes të gjitha mbretëritë; ajo ishte rrëzimi i forcës, shpartallimi i luftës.

A u heq gjë Gjermanisë dhe Anglisë sikur t'ua heqësh Vaterlonë Uelingtonit dhe Blyherit? Jo. As kjo e shkëlqyera Angli, as kjo augustja Gjermani nuk hyjnë në çështjen e Vaterlosë. Popujt janë të mëdhenj jashtë aventurave kobzeza të shpatës. As Gjermania, as Anglia, as Franca nuk mund të futen në mill të shpatës. Në epokën kur Vaterloja s'është veçse një vringëllimë shpatash, Gjermania përmbi Blyherin ka Gëten dhe Anglia përmbi Uelingtonin ka Bajronin. Një lindje vigane idesh e karakterizon shekullin tonë dhe në këtë agim Anglia dhe Gjermania kanë dritën e tyre të shkëlqyer. Ato janë të madhërishme, sepse mendojnë. Ngritja e nivelit që i sjellin qytetërimin, është një veti e tyre e brendshme; kjo buron vetiu nga ato vetë dhe jo nga ndonjë aksident. Madhështia që ato kanë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, nuk e ka burimin te Vaterloja. Vetëm popujt barbarë mund të kenë rritje të menjëhershme pas një fitoreje. Kjo është si ajo mburrja boshe e përrenjve, që fryhen pas ndonjë stuhie. Popujt e qytetëruar, sidomos në kohët tona, nuk ngrihen, as nuk ulen për shkak të fatit të mirë ose të keq të një udhëheqësi ushtarak. Pesha e tyre specifike në gjininë e njerëzve buron nga një diçka që është më e madhe se një luftim. Nderi i tyre, dinjiteti i tyre, drita e tyre, gjëma e tyre, nuk janë numra, që heronjtë dhe pushtuesit, këta bixhozçinj, mund të vënë si dec në llogarinë e betejave. Shpesh një betejë e humbur është një përparim i fituar. Më pak lavdi, më shumë liri. Tamburi hesht, arsyeja e merr fjalën. Kjo është si ajo loja ku ai që humbet, fiton. Le të flasim, pra, për Vaterlonë me gjakftohtësi nga të dyja anët. Ç'është Vaterloja? Një fitore? Jo. Një sheshbesh. Sheshbesh i fituar nga Evropa dhe i paguar

nga Franca. S'e vlen dhe aq shumë barra qiranë që të vendoset atje një luan si monument.

Veç të tjerash, Vaterloja është ndeshja më e habitshme që mund të gjendet në histori. Napoleoni dhe Uelingtoni. Ata s'janë armiq, por të kundërtit e njëri-tjetrit. Kurrë zoti, i cili i ka qejf antitezat, s'ka bërë ndonjë kontrast kaq të mprehtë dhe një ballafaqim kaq të jashtëzakonshëm. Nga njëra anë, përpikmëria, parashikimi, gjeometria, parakujdesi, sigurimi për tërheqje, kursimi i rezervave, një gjakftohtësi këmbëngulëse, një metodë e palëkundshme, strategjia që përfiton nga terreni, taktika që drejtpeshon batalionet, vrasja e rregulluar me pé, lufta e kurdisur me sahat në dorë, asgjë e lënë vullnetarisht në dorë të fatit, kuraja e lashtë klasike, korrektesia absolute; nga ana tjetër, intuita, nuhatja, çudia ushtarake, instinkti mbinjerëzor, syri flakërues, një nuk di çfarë që vështron si shqiponja e që godit si rrufeja, një art i mrekullueshëm në një hov përbuzës, të gjitha misteret e një shpirti të thellë, shkrija me fatin, lumin, fushën, pyllin, kodrën, të urdhëruara dhe në njëfarë mënyre të detyruara që të binden, despoti që arrin gjer atje sa ta tiranizojë fushën e betejës, besimi te ylli i fatit, i pleksur me shkencën strategjike që e rrit, por që edhe e turbullon. Uelingtoni ishte Baremi¹¹⁸⁾ i luftës, Napoleoni ishte Mikelanxheloja; edhe kësaj radhe gjenia u mund nga llogaritja.

Nga të dyja anët pritej dikush. Faqebardhë në këtë mes doli llogaritësi i përpiktë. Napoleoni priste Grushiun; ai nuk erdhi. Uelingtoni priste Blyherin; ai erdhi.

Uelingtoni është lufta klasike që merr shpagim. Bonaparti në agim të jetës së vet ishte ndeshur me luftën klasike dhe e kishte mundur me bujë të madhe. Kukumjaçka e vjetër krisi e iku përpara fajkoit të ri.¹¹⁹⁾ Taktika e vjetër jo vetëm që ishte përvëlur me zjarr rrufeje, por edhe ishte poshtëruar fare. Ç'ishte vallë ky korsikan njëzetvjeçar, ç'donte të thoshte ky injorant i shkëlqyer, i cili, duke pasur gjithçka kundër tij, asgjë për vete, pa ushqime, pa municione, pa topa, pa këpucë, pothuajse pa ushtri, me një grusht burrash kundër mizërive, vërsulej mbi Evropën e besëlidhur dhe korrtë në mënyrë

absolute fitore atje ku dukej krejt e pamundur? Që nga dilte ky i tërbuar i vetëtimshëm, i cili, pothuajse pa u ndalur për të marrë frymë dhe po me atë grusht luftëtarësh në dorë, i bënte pluhur e hi njërën pas tjetrës të pesë armatat e perandorit të Gjermanisë, duke dërrmuar dhe përplasur Boljënë mbi Alvincin, Vyrmserin mbi Boljënë, Melasin mbi Vyrmserin, Makun mbi Melasin? Ç'ishte ky i porsaardhur i luftës, që s'i bënte syri bef përpara askujt? Shkolla akademike e çkishëronte, por duke i lëshuar udhë. Së këtejmi rridhte ajo mëri plot vrer e cezarizmit të vjetër kundër të riut, e shpatës së përpiktë kundër pallës flakëruese dhe e lojës së shahut kundër gjenisë. Më 18 qershor 1815, kjo mëri pati fjalën e fundit dhe nën Lodin, Montebelon, Montenoten, Mantovën, Marengon, Arkolën ajo shkroi: Vaterlo. Triumfi i gjysmakëve që lëpihen pas shumicës. Fati i lëshoi rrugë kësaj ironie. Kur po i ngryste ditët e veta, Napoleoni e gjeti përsëri Vyrmserin e ri.

Për të pasur Vyrmserin e vërtetë, mjafton që të zbardhësh flokët e Uelingtonit.

Vaterloja është një betejë e dorës së parë, e fituar nga një kapiten i dorës së dytë.

Në betejën e Vaterlosë, ajo që duhet admiruar, është Anglia, është qëndrueshmëria angleze, është vendosmëria angleze, është gjaku anglez; e vetmja gjë e madhërishme në këtë mes, le të mos i vijë keq, ishte vetë Anglia. Nuk ishte kapiteni i saj, por ushtria e saj.

Uelingtoni, çuditërisht mosmirënjohës, deklaroi në një letër dërguar lord Bathërrit se ushtria e tij, ushtria që luftoi më 1815, ishte "një ushtri e përbuzshme". Por çfarë mendon për këtë ajo mizëri e sterrosur kockash, e mbuluar nën brazdat e Vaterlosë?

Anglia u tregua tepër modeste ndaj Uelingtonit. Ta bësh Uelingtonin kaq të madh, do të thotë ta bësh Anglinë të vogël. Uelingtoni është një hero si çdo hero tjetër. Ata skocezët ngjyrë hiri, ata kalorësit gardistë, ato regjimentet e Meitlendit dhe të Miçellit, ajo këmbësoria e Pakut dhe e Kemptit, ajo kavaleria e Ponsobit dhe e Somersetit, ata malësorët që u binin gajdeve nën breshërinë e predhave, ato batalionet e Railendit, ata

rekrutët fare të rinj që mezi dinin të përdornin musketën dhe që u bënë gjoks hordhive të vjetra të Eslingut dhe të Rivolit, ata, po, ata janë të mëdhenj. Uelingtoni ishte këmbëngulës, dhe kjo qe merita e tij, dhe këtu nuk duam t'i hamë hakun, por edhe më i vogli i këmbësorëve dhe i kalorësve të tij ishte po aq i qëndrueshëm sa edhe vetë Uelingtoni. Ushtari i hekurt e vlen Dukën e Hekurt. Përsa na përket neve, gjithë lavdërimi ynë i shkon ushtarit anglez. Në qoftë se ka ndonjë trofé, kjo trofé i takon Anglisë. Kolona e Vaterlosë do të ishte më e drejtë, në qoftë se, në vend të fytyrës së një njeriu, do të çonte lart gjer në retë statujën e një populli.

Por kjo Anglia e madhe do të zemërohet me këto që themi këtu. Ajo, edhe pas 1688-s së saj dhe 1789-s sonë, ka akoma iluzionin feudal. Ajo beson në trashëgiminë dhe hierarkinë. Ky popull, të cilit s'ia kalon kush për nga fuqia dhe lavdia, e çmon veten si komb, por jo si popull. Si popull, ai nënshtrohet me qejf dhe e merr një lord për një kokë të madhe. Si punonjës, ai s'bën zë pse përbuzet; si ushtar, ai s'bën zë pse rrihet. Mbahet mend se në betejën e Inkermanit një rreshter, i cili, mesa duket, e kishte shpëtuar ushtrinë, nuk mundi të përmendej në urdhrin e ditës si i dalluar nga lord Regleni, sepse hierarkia ushtarake angleze nuk lejon të përmendet në një raport asnjë hero që është nën gradën e oficerit.

Ajo që ne admirojmë mbi të gjitha, në një ndeshje si ajo e Vaterlosë, është shkathtësia e habitshme e fatit. Shiu i natës, muri i Hugomontit, udha e thellë e Ohenit, Grushiu, që bëri veshin të shurdhër ndaj topit, udhërrëfyesi që mashtroi Napoleonin, udhërrëfyesi që sqaroi Bylovin, tërë kjo kataklizëm është drejtuar në mënyrë të mrekullueshme.

Së fundi, le ta themi këtu, në Vaterlo u bë më shumë masakër sesa betejë.

Vaterloja, nga të gjitha betejat e rregullta, është beteja që ka frontin më të vogël, në krahasim me një numër aq të madh luftëtarësh. Napoleoni kishte tre çerek lege, Uelingtoni gjysmë lege; shtatëdhjetë e dy mijë luftëtarë në secilën anë. Për shkak të kësaj dendësie ndodhi edhe kasaphana.

Është bërë një llogari dhe është vendosur ky përpjesëtim:

humbje njerëzish: në Austerlic francezë katërbëdhjetë për qind, rusë tridhjetë për qind, austriakë dyzet e katër për qind. Në Vagram francezë trembëdhjetë për qind, austriakë katërbëdhjetë. Në Moskova francezë tridhjetë e shtatë për qind, rusë dyzet e katër. Në Baucen francezë trembëdhjetë për qind, rusë e prusianë katërbëdhjetë. Në Vaterlo francezë pesëdhjetë e gjashtë për qind, aleatë tridhjetë e një. Totali për Vaterlo dyzet e një për qind. Njëqind e dyzet e katër mijë luftëtarë, gjashtëdhjetë mijë të vdekur.

Fusha e Vaterlosë ka sot qetësinë, që është veti e tokës, e këtij tabani të pandjeshëm ndaj brengave të njeriut, dhe u përngjet të gjitha fushave.

Megjithatë, natën, shpërthen soje njëfarë mjegulle vegimtare, dhe, në qoftë se ndonjë udhëtar endet aty, në qoftë se vështron, në qoftë se mban vesh, në qoftë se ëndërron si Virgjili përpara fushave të përkohshme të Filipit,¹²⁰⁾ atë e kap dhe e pushton zhgjëndrra e katastrofës. Data e frikshme e 18 qershorit jeton akoma; ajo kodër-monument e rreme fshihet nga faqja e dheut, ai luan i çfarëdoshëm shkrihet e zhduket, dhe fusha e betejës merr përsëri realitetin e vet; rreshta këmbësorie dallgëzojnë në fushë, vrapime kuajsh kupthi përshkojnë horizontin, ëndërrimtari, i frikësuar, sheh shkrepimën e shpatave, shkëndijimet e bajonetave, flakërimën e bombave, kryqëzimin e përbindshëm të rrufeve; ai dëgjon një si gulçim në fund të një varri, rrapëllimën e mbytur të betejës fantazmë; ato hije atje janë granatierët; ato drita atje më tej janë koracierët; ai skeleti atje është Napoleoni; ai skeleti tjetër atje është Uelingtoni; të gjitha këto s'janë më, por ndeshen e luftojnë akoma; dhe përrënjtë skuqen, dhe pemët dridhen, dhe furia ngjitet gjer në retë, dhe nëpër terre, të gjitha këto lartësira, që të kallin frikën, Mon-Sen-Zhani, Hugomonti, Frishëmonti, Papëlota, Plansënuaji, duken turbull, si të kurorëzuara me shakullira fantazmash që theren njëra me tjetrën.

A duhet ta quajmë të mirë Vaterlonë?

Ka një shkollë liberale shumë të respektueshme, që nuk e urren aspak Vaterlonë. Ne s'jemi të kësaj shkolle. Për ne Vaterloja nuk është gjë tjetër veçse data e habitur e lirisë. Që të dalë një shqiponjë e tillë nga një vezë e tillë, kjo pa pikë dyshimi është gjë e papritur dhe e papandehur.

Vaterloja, në qoftë se vendosemi në pikën kulminante të çështjes, është me kast një fitore kundërrevolucionare. Është Evropa kundër Francës, janë Petërburgu, Berlioni dhe Vjena kundër Parisit, është *status quo*-ja kundër iniciativës, është 14 korriku 1789 i sulmuar nga 20 marsi 1815,¹²¹⁾ është dyndja me rrënjë e me degë e monarkive kundër kryengritjes së pamposhtshme franceze. Ta shuanin, më në fund, këtë popull të madh, që shfrynte si vullkani që prej njëzet e gjashtë vjetësh, kjo ishte ëndrra e tyre. Solidariteti i Brunsvikëve, i Nasove, i Romanovëve, i Hohenzollernëve, i Habsburgëve me Burbonët. Vaterloja mbart në shpirtin e saj të drejtën hyjnore. Është e vërtetë se, përderisa perandoria kishte qenë despotike, monarkia, për reaksion të natyrshëm të gjërave, duhej të ishte domosdo liberale dhe se nga Vaterloja doli me pahir një rend kushtetues për keqardhjen e madhe të fituesve. Kjo do të thotë se revolucionin nuk mund të mposhtet me të vërtetë, ai rishfaqet gjithmonë përpara Vaterlosë me Bonapartin, që rrëzon poshtë fronet e vjetra, pas Vaterlosë me Luigjin XVIII, që dekreton dhe i përulet Kartës. Bonaparti vë një karrocier në fronin e Napolit dhe një rreshter në fronin e Suedisë,¹²²⁾ duke përdorur pabarazinë për të provuar e vërtetuar barazinë; Luigji XVIII në Sen-Uen kundërfirmon deklaratën e të drejtave të njeriut. A doni ta kuptoni se ç'do të thotë revolucion? Quajeni atë përparim; dhe a doni ta kuptoni se ç'është përparimi? Quajeni atë e nesërmja. E nesërmja bën në mënyrë të pandalshme punën e vet dhe e bën qysh sot. Ajo ia arrin gjithmonë qëllimit në mënyrë të çuditshme. Ajo e përdor Uelingtonin që ta bëjë

Fuanë, që ishte vetëm një copë ushtar, orator, Fuai bie në Hugomont dhe ngrihet përsëri në tribunë.¹²³⁾ Kështu vepron përparimi. S'ka vegël të keqe për një punëtor si ky. Ai puq me punën e vet hyjnore, pa u tundur fare, njeriun që ka kapërcyer Alpet dhe bablokun e mirë, po të sëmure, që mezi mbahet në këmbë, të xha Elizeut. Ai e përdor ulokun nga këmbët ashtu siç përdor edhe pushtuesin; pushtues nga jashtë dhe ulok nga brenda. Vaterloja, duke ia prerë shkurt rrugën shkatërrimit të froneve me anë të shpatës, nuk pati pasojë tjetër veçse të bënte që puna revolucionare të vazhdonte nga një krah tjetër. Njerëzit e shpatës mbaruan, tani u erdhi radha mendimtarëve. Shekulli, të cilin Vaterloja deshë ta ndalte në vend, kaloi sipër dhe vazhdoi udhën e vet. Kjo fitore e kobshme u mund nga liria.

Në fund të fundit, dhe në mënyrë të pakundërshtueshme, ajo që triumfonte në Vaterlo, ajo që buzëqeshte prapa Uelingtonit, ajo që i sillte atij të gjithë shkopinjtë e mareshalit të Evropës, ajo që rrëkëllente plot gaz karrocat e dorës të mbushur deng me kocka për të ngritur bregoren e luanit, ajo që shkroi triumfalisht mbi këtë pedestal datën: *18 qershor 1815*, ajo që i jepte zemër Blyherit të grinte me shpatë ushtarët në thyerje, ajo që nga kulmi i rrafshinës së Mon-Sen-Zhanit përkulej mbi Francën, sikur të përkulej mbi ndonjë gjah, ishte kundërrevolucionin. Ishte kundërrevolucionin ai që murmuriste këtë fjalë faqezezë: "copëtim". Kur kundërrevolucionin arriti në Paris, e pa grykën e vullkanit nga afër, ndjeu se ai hi po ia digjte këmbët, dhe e mblodhi mendjen. Kundërrevolucionin u detyrua të shqiptonte një Kartë, por duke iu mbajtur goja.

Le të mos shohim te Vaterloja vetëm atë që është në Vaterlo. Liri me gjithë mend, aspak. Kundërrevolucionin ishte liberal pa dashje dhe kundër vullnetit të vet, ashtu sikundër që, nga një fenomen analog, Napoleoni ishte revolucionar kundër vullnetit të vet. Më 18 qershor 1815, Roberspierrin u rrëzua nga kali.

XVIII

Malcim i së drejtës hyjnore

Fundi i diktaturës. Një sistem i tërë i Evropës u shemb.

Perandoria u vithis në një terr që i përngjan territ të botës romake në kohën kur hiqte shpirt. Njerëzia e panë humnerën ashtu si në kohën e barbarëve. Veçse barbaria e vitit 1815, të cilën duhet ta thërresim shkurt kundërrevolucion, s'kishte këllqe të forta, iu mor fryma dhe ngeci në vend. Perandorinë, le ta pohojmë, njerëzia e qanë, dhe e qanë sy heroikë. Në qoftë se lavdia në majë të kordhës kthehet në skeptër, perandoria ishte lavdia vetë. Ajo kishte hapur mbi tokë të gjithë dritën që mund të japë tirania, dritë të errët. Ose më mirë: dritë sterrë. Po ta krahasosh këtë dritë me ditën e vërtetë, atëherë ajo është natë. Kjo zhdukje e natës bëri efektin e një eklipsi.

Luigji XVIII hyri në Paris. Vallet e 8 korrikut e shuan entuziazmin e 20 marsit. Korsikani u bë antiteza e bearnezit.¹²⁴⁾ Flamuri i Kubesë së Invalidëve u bë i bardhë. Në fron hipi mërgimi. Tryeza prej pisehe e Hartuellit¹²⁵⁾ zuri vend përpara kolltukut me zambakë të Luigjit XVIII. U fol për Buvinën¹²⁶⁾ dhe Fontenuanë¹²⁶⁾ sikur të ishte dje, sepse Austerlici na paskësh genë vjetëruar. Lteri dhe froni u vëllazëruan me madhështi. Një prej formave më të pakundërshtueshme të shpëtimit të shoqërisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë u vendos mbi Francë e mbi kontinent. Evropa mori e vuri kokardën e bardhë. Trestajoni¹²⁷⁾ u bë i famshëm. Parulla "*Non pluribus impar*"^{*)} doli përsëri sheshit nëpërmjet ca rrezeve mbi gur, që paraqisnin një diell në balloren e kazermës së Ké d'Orseit. Atje ku kishte pasur një gardë perandorake, u vu një shtëpi e kuqe. Arku i Karuselit, i ngarkuar i tëri me fitore sa mezi i mbante, i hutuar nga këto gjëra të reja, pak si i turpëruar ndoshta për Marengon dhe Arkolën, e hodhi lumin paq me statujën e dukës së

^{*)} Parullë e Luigjit XIV, mbretit diell. *Non pluribus impar* do të thotë: jo i pabarabartë me shumë (nënkuptohet diej). Në fakt: më i lartë se të gjithë.

Angulemit.¹²⁸⁾ Varreza e Madëlenës, kjo gropë e përbashkët, e frikshme e vitit 93, u vesh me mermer e me diaspër, sepse eshtrat e Luigjit XVI dhe të Maria-Antuanetës ndodheshin në këtë pluhur. Në gropën e Vënsenës një kolonë pa kapitel doli nga dheu për të përkujtuar se duka i Engienit¹²⁹⁾ kishte vdekur po këtë muaj kur Napoleoni ishte kurorëzuar perandor. Papa Piu VII, që kishte bërë këtë kurorëzim shumë afër kësaj vdekjeje, e bekoj plot qetësi rënien, ashtu sikurse pati bekuar edhe hipjen në fron. Në Shënbrën na ishte një hijez e vogël katër vjeç. Po të thoshte ndokush se ky vocërrak ishte mbreti i Romës, do të quhej si njeri që ishte kundër rendit. Dhe të gjitha këto gjëra ngjanë, dhe këta mbretër morën përsëri fronet e tyre, dhe zoti i Evropës u fut në një kafaz, dhe regjimi i vjetër u bë regjim i ri, dhe gjithë errësira dhe gjithë drita e tokës ndërruan vend, sepse në pasdrekën e një ditë vere një bari i tha një prusiani në një pyll: "Kaloni këtej e jo andej!"

Ky viti 1815 u bë si ndonjë prill kobzi. Realitetet e sotshme të pëgëra dhe helmatuese u mbuluan me dukuri të reja. Gënjeshtra u martua me vitin 1789, e drejta hyjnore e mbretërve u maskua me një Kartë, rrenat u veshën me rrobën kushtetuese, paragjykimet, besëtytnitë dhe prapamendimet me nenin 14¹³⁰⁾ në zemër u lustruan me vernikun e liberalizmit. Gjarpërinjtë ndërruan lëkurë.

Napoleoni e kishte zmadhuar dhe zvogëluar njeriun në të njëjtën kohë. Ideali, nën këtë mbretërim të materies së shkëlqyer, kishte marrë emrin e çuditshëm të ideologjisë. Është një pakujdesi e madhe për një njeri të madh të tallet me të ardhmen. Por megjithatë, popujt, ky mish për top që e don aq fort topçin, e kërkonin me sy nga çdo anë. Ku është vallë? Vallë ç'po bën? "Napoleoni vdiq", - i thoshte një kalimtar një të gjymtuari të Marengos e të Vaterlosë. "Ai të ketë vdekur?" - bërtiste ky ushtar. - "Por ju e njihni mirë se kush është ai!" Imagjinatat e sfidonin këtë burrë, që ishte mundur e shtrirë përdhé. Sfondi i Evropës pas Vaterlosë u bë sterrë. Një diçka e stërmadhe qëndroi për një kohë të gjatë e zbrazët me zhdukjen e Napoleonit.

Mbretërit zunë vend në këtë zbrazëti. Evropa plakë përfitoi nga kjo për t'u riformuar.

U krijua Besëlidhja e Shenjtë. Besëlidhja e Bukur e kishte përcaktuar që më parë fushën fatale të Vaterlosë.

Në prani dhe përballë kësaj Evrope plakë të riformuar, u përcaktuan përvijimet e një France të re. E ardhmja, me të cilën ishte tallur perandori, hyri në skenë. Kjo e ardhme kishte në ballë një yll, Lirinë. Sytë e zjarrtë të gjeneratave të reja u kthyen drejt kësaj së ardhmeje. Sa e çuditshme: njerëzit i rrëmbeu njëkohësisht e ardhmja, Liria, dhe e kaluara, Napoleoni. Shpartallimi e kishte bërë akoma më të madh të mundurin. Bonaparti i rrëzuar dukej më i lartë se Napoleoni në këmbë. Ata që kishin triumfuar, patën frikë. Anglia vuri Hatson Lovin ta ruante dhe Franca vuri Montshenynë ta përgjonte Napoleonin.¹³¹⁾ Ata krahët e tij të kryqëzuar i shqetësonin fronet e mbretërve. Aleksandri e quante: "Pagjumësia ime." Kjo frikë e madhe rridhte nga sasia e revolucionit që Napoleoni kishte në veten e vet. Kjo gjë shpjegon dhe për ligj liberalizmin bonapartist. Kjo fantazmë i fuste të dridhura botës së vjetër. Mbretërit mbretëruan si mbi gjemba, me shkëmbin e Shën-Helenës në horizont.

Në kohën kur Napoleoni hiqte shpirt në Longvud, të gjashtëdhjetë mijë burrat të rënë në fushën e Vaterlosë u kalbën qetë-qetë, dhe diçka nga paqja e qetësia e tyre u përhap nëpër botë. Kongresi i Vjenës bëri traktatet e 1815-s, dhe Evropa e quajti këtë gjë restaurim.

Ja, kjo është Vaterloja.

Por ç'i hyjnë në sy e në punë këto gjëra pafundësisë? Gjithë ajo stuhi, gjithë ai rrebesh, ajo luftë, pastaj ajo paqe, gjithë ajo hije nuk e turbulluan për asnjë çast dritën e syrit të stërmadh, përpara të cilit një buburrec, që kërcen nga një fije bari te tjetra, është baras me shqiponjën, që fluturon nga një kambanore te tjetra në kullat e katedrales së Shën-Mërisë.

Fusha e betejës natën

Le të kthehemi në fushën fatale të betejës, sepse kjo është e domosdoshme për këtë libër.

Më 18 qershor 1815 hëna ishte e plotë. Ky ndriçim i dha dorë ndjekjes së egër të Blyherit, zbuloi gjurmët e atyre që iknin, e la këtë masë të shkatërruar në mëshirën e kavalerisë prusiane, që e ndiqte këmba-këmbës, dhe i ndihua kasaphanës. Heraherës, në katastrofat, nata ka teka e qejfe të tilla tragjike.

Pas shtënies së fundit të topit, fusha e Mon-Sen-Zhanit mbeti e shkretë.

Anglezët pushtuan vendfushimin e francezëve; konstatimi i zakonshëm i fitores është të flesh në shtratin e të mundurit. Ata vendosën fushimin e tyre matanë Rosomës. Prusianët, të lëshuar mbi ushtrinë e shpartalluar, bënë përpara. Uelingtoni, vajti në fshatin e Vaterlosë për të hartuar raportin për lord Bethërsin.

Në qoftë se mund të përdorej ndonjëherë shprehja *sic vos non vobis-i*¹⁾, me siguri që duhej t'i përshtatej fshatit të Vaterlosë. Vaterloja s'bëri asgjë dhe qëndroi një gjysmë lege larg veprimeve luftarake. Mon-Sen-Zhani u rrah me top, Hugomonti u dogj, Papëlota u dogj, Plansënuaji u dogj, Hësenta u mor me sulm, Bel-Aliansa i pa me sy të dy fituesit kur u përqaftuan; nuk dihen tamam emrat e tyre, dhe Vaterloja, që s'punoj hiç në betejë, i ka përvetësuar të gjitha nderimet. Ne nuk jemi nga ata që i bëjnë lajka luftës; kur paraqitet rasti, ne ia themi të vërtetën në sy. Lufta ka bukurira të llahtarshme, të cilat s'i kemi fshehur aspak; ajo ka, le ta pranojmë, edhe disa shëmtira. Një nga shëmtitë më të habitshme është zhveshja sa hap e mbyll sytë e të vdekurve pas fitores. Agimi që vjen pas një beteje, zbardh mbi kufoma lakuriqe.

Kush e bën këtë punë? Kush e njollos kështu triumfin?

¹⁾ Kjo gjë s'ju takon juve. (lat.).

Ç'është ajo dorë e ndyrë dhe tinzare që rrëshqet në xhepin e fitores? Ç'janë këta vjedhacakë që veprojnë prapa lavdisë? Disa filozofë, midis të tjerëve edhe Volteri, pohojnë se janë pikërisht ata që e kanë bërë lavdinë. Janë po ata njerëz, thonë këta filozofë, dhe s'ka sesi të jetë ndryshe, janë ata që, duke qenë në këmbë, plaçkitin ata që dergjen përtokë. Heroi i ditës është lugat i natës. Por neve na duket si e pamundur që e njëjta dorë të këputë dafina dhe të vjedhë këpucët e një të vdekuri.

Një gjë është e sigurt që zakonisht pas fituesve vijnë vjedhësit. Por le ta lëmë ushtarin, sidomos ushtarin e kohëve tona, jashtë kësaj çështjeje.

Çdo ushtri ka edhe një bisht dhe pikërisht ky bisht duhet paditur. Këto janë ca qenie si lakuriqë të natës, gjysma hajdutë e gjysma shërbëtorë, të gjitha llojet e lakuriqëve të natës që përfton ai muzg të cilin ne e quajmë luftë, njerëz me uniformë që nuk hyjnë në luftë, njerëz që shtihen të sëmurë, sakatë të tmerrshëm, kantinierë^{*)} tinzarë, që ngasin vrap, hera-herës edhe me gratë e tyre, mbi ca karro të vogla dhe që vjedhin atë që shesin, lypës që u dalin si udhërrëfyes oficerëve, bataçinjtë, endacakë. Ushtritë në marshim, dikur - nuk flasim për kohën e sotme - i tërhiqnin të gjitha këto qenie pas bishtit, aq sa në gjuhën e posaçme këta njerëz quheshin "bishtra". Asnjë ushtri dhe asnjë komb nuk ishte përgjegjës për këto qenie; ato flisnin italisht dhe u vinin pas gjermanëve; flisnin frëngjisht dhe u vinin pas anglezëve. Dhe ka qenë pikërisht një nga këta maskarenjtë, një bisht spanjoll, i cili fliste frëngjisht, që vrau tradhtisht markezit Dë Fervak dhe e plaçkiti në fushën e betejës, natën pas fitores së Cerizolës. Markezi i varfër u mashtrua nga të folurit mbytur të dialektit të Pikardisë të këtij njeriu dhe e mori për njeri tonin. Nga endacakëria lindte endacaku vjedhacak. Maksima e neveritshme "*Të jetosh në kurriz të armikut*", e përftonte këtë lepër, të cilën mund ta shëronte vetëm një disiplinë e fortë. Ka njerëz në zë që të mashtrorjnë; nuk dihet gjithmonë se ku qëndron arsyeja që disa gjeneralë, madje edhe të mëdhenj, kanë qenë aq popullorë.

^{*)} Përgjegjës i një kantine ushtarake.

Tyrenin e adhuronin ushtarët e vet, sepse ai lejonte plaçkitjen; e keqja e lejuar bën pjesë në të mirën. Tyreni ishte aq i mirë, sa lejoi të digjnin e të masakronin Palatinatin.^{*)} Prapa ushtrive shikoje më pak ose më shumë plaçkaxhinj, sipas udhëheqësit më shumë ose më pak të ashpër. Hoshi dhe Marsoja nuk kishin aspak bishtra; Uelingtoni, të themi të drejtën, me zemër të hapur, kishte pak bishtra.

E megjithatë, natën e 18 e 19 qershorit të vdekurit u zhveshën. Uelingtoni dha urdhër të prerë: të pushkatohej kushdo që do të gjendej me presh në dorë; por plaçkitja është kryeneçe. Një palë vjedhacake vidhte në një skaj të fushës së betejës, në kohën kur në skajin tjetër pushkatohej një palë tjetër.

Hëna ishte kobzezë mbi këtë fushë.

Aty nga mesnata, një burrë po endej tinëz ose, më mirë, po hiqej zvarrë nga ana e udhës së thepisur të Ohenit. Ishte me gjasë një nga ata që sapo i përshkruam, as anglez, as francez, as fshatar, as ushtar, më pak njeri se lugat, i ndjellë nga era e të vdekurve, që kishte për fitore vjedhjen, që vinte të plaçkiste Vaterlonë. Kishte veshur një bluzë që ishte një si farë kapote, ishte i shqetësuar dhe i guximshëm, shkante përpara dhe vështronte prapa. Ç'të ishte vallë ky njeri? Nata, kishte të ngjarë, dinte më shumë gjëra mbi të sesa dita. Ndonjë thes me vete nuk kishte, por me siguri do të kishte xhepa të mëdhenj nën kapotën e tij. Kohë më kohë ai qëndronte, vëzhgonte fushën rreth e rrotull për të parë se mos e përgjonte njeri, përkulej me turr, lëvizte në tokë diçka të heshtur e të palëvizshme, pastaj çohet dhe bëhet firë. Zvarritja e tij, qëndrimet e tij, lëvizjet e tij të shpejta dhe misterioze e bënë t'u përngjiste atyre lugetërve të natës, që enden gërmadhve dhe që legjendat e moçme normandase i quajnë Alorë.

Disa zogj të natës që u ngjasin lejlekëve bëjnë këso hijesh nëpër kënetë.

Në qoftë se ndonjë vështrim do të kishte vrojtuar me vëmendje në gjithë këtë mjegull, ai do të kishte mundur të

^{*)} Provincë, territor që qeveriset nga një i zgjedhur Palatin.

dallonte, në njëfarë largësie, të ndalur dhe si të fshehur prapa shtëpisë së vjetër buzë xhadesë së Nivelës, në qoshen e udhës që shpie nga Mon-Sen-Zhani në Brenë l'Aléd, njëfarë karroje të vogël e të mbuluar që përdorin tregtarët e pijeve dhe ushqimeve, me një kulm xunkthi të lyer me katran, të mbrehur pas një gërdalle të uritur, që kulloste hithra përmes gojzës së frerit, dhe në këtë karro njëfarë gruaje të ulur mbi disa sëndukë dhe paketa. Ndoshta kishte ndonjëfarë lidhjeje midis kësaj karroje dhe këtij endacaku.

Nata ishte e kthjellët? Asnjë rë në qiell. Le të jetë e kuqe toka sa të dojë, hëna e bardhë se e bardhë mbetet. Këto janë mospërfilljet e qiellit. Nëpër livadhet, degë pemësh të thyera nga breshëria, por që vareshin e mbaheshin pezull nga lëvorja, lëkundeshin qetë-qetë në erën e natës. Një duhmë, pothuajse një frymëmarrje, i luhaste drizat. Në lëndinë kishte ca si përpëlitje që ngjisnin me fluturime shpirtrash.

Mbyturazi dëgjoheshin së largu, tek shkonin e vinin, patrullat dhe rojat e fushimit anglez.

Hugomonti dhe Hè-Senta vazhdonin të digjeshin, duke bërë, njëri në lindje e tjetra në perëndim, dy flakadanë të mëdhenj, me të cilët vinte e bashkohej, si ndonjë varg i zgjidhur rubinësh që ka në skajet e tij dy tokëza lidhëse, kordoni i zjarreve të fushimit anglez, të shtrira në një gjysmërreth shumë të madh mbi kodrat e horizontit.

Ne e treguam katastrofën e Ohenit. Kur mendon se ç'vdekje i priti gjithë ata burra trima, zemra të dridhet nga llahtara.

Në ka gjë të llahtarshme, në ka realitet që ia kalon ëndrrës, është ky: të jetosh, të shikosh diellin, të jesh në lulen e forcës burrërore, të kesh shëndet e gaz, të qeshësh si burrat, të ngasësh vrap drejt një lavdie të shkëlqyer që ke përpara, të ndiesh në kraharor mushkëritë që marrin frymë, një zemër që rreh, një vullnet që arsyeton, të flasësh, të mendosh, të shpresosh, të dashurosh, të kesh një nënë, të kesh një grua, të kesh fëmijë, të kesh dritën, dhe, pastaj, papritmas, sa hap e mbyll sytë, në më pak se një minutë, të gremisesh në një humnerë, të biesh, të rrokullisesh, të shtypësh e të shtypesh, të shohësh kallinj, lule, gjethe, degë dhe të mos kesh se ku të mbahesh, ta ndiesh se

shpata s'të bën më dobi, të shohësh njerëz të tjerë nën vete, kuaj mbi vete, të përpëlitesh më kot, të ndiesh një takë që po të nxjerr sytë jashtë, të kafshosh plot tërbim potkonj kuajsh, të të merret fryma, të gjëmosh, të përdridhesh i tëri, të jesh aty poshtë dhe të thuash me vete: "Pak më parë, unë isha njeri i gjallë!"

Atje ku kishte gulçuar kjo mynxyrë e kobshme, tani çdo gjë kishte rënë në heshtje. Udhë e thellë ishte mbushur buzë më buzë me kuaj e kalorës bërë lesheli. Përleshje e tmerrshme. Ledhet e udhës nuk dukeshin më. Kufomat e mbushnin udhën rrafsh me fushën dhe vinin deri në buzë, si ndonjë shinik me elb, që është matur e rrafshuar paq. Një kapicë të vdekurish mbi sop, një lumë gjaku poshtë; kështu ishte ajo udhë mbrëmjen e 18 qershorit 1815. Gjaku kullonte gjer në xhadenë e Nivelës dhe përhapej si ndonjë pellg i gjerë përpara drurëve të prerë që zinin xhadenë, në një vend që tregohet edhe sot e kësaj dite. Siç mund t'ju kujtohet, në pikën e përkundërt, drejt xhadesë së Zhenapës, ngjau gremisja e koracierëve. Dendësia e kufomave përpjesëtohej me thellësinë e udhës së gërryer. Aty nga mesi, në vendin ku udha bëhej rrafsh me fushën, atje ku kishte kaluar divizioni i Delordit, shtresa e të vdekurve ishte më e hollë.

Endacaku i natës, që sapo ia ajgëtuam lexuesve, shkante nga ky krahu. Ai po qëmtonte në këtë varr të madh. Ai vështronte. Kalonte si në një revistë të lemerishme gjithë ata të vdekur. Ecte me këmbët në gjak.

Befas u ndal në vend.

Disa hapa larg tij, në udhën e thellë, në pikën ku mbaronte kapica e të vdekurve, që poshtë atij grumbulli njerëzish e kuajsh, dilte një dorë e hapur, e ndriçuar nga hëna.

Ajo dorë kishte në gisht një diçka që shndriste dhe që ishte një unazë ari.

Njeriu u përkul, qëndroi një çast i kërrusur dhe, kur u çua në këmbë, dora s'kishte më unazë.

Ta themi më saktë, nuk u çua në këmbë, por mbeti në një qëndrim prej bishe të trembur, duke i kthyer kurrizin kapicës së të vdekurve, duke vëzhguar horizontin, në gjunjë, duke

mbështetur gjithë pjesën e përparme të trupit mbi dy gishtat tregues, që i kishte ngulur në dhë, me kokën që përgjonte sipër ledhit të udhës së thellë. Të katër këmbët e çakallit u përshtaten mirë disa veprimeve si ky.

Pastaj, si e mblodhi mendjen, u çua në këmbë.

Në këtë çast ai u drodh i tëri. Ndjeu se dikush e kishte kapur nga pas.

U rrotullua prapa; dora e hapur ishte mbyllur dhe i kishte kapur cepin e kapotës.

Po të ishte ndonjë burrë i ndershëm, ai do të kishte pasur frikë. Kurse ai ia plasi gazit.

-Pa shih, - tha ai, - na paskësh qenë i vdekuri. Më mirë një njeri i ngjallur lugat, sesa një xhandar.

Ndërkohë dora u zgjat dhe e lëshoi. Përpyekja shteron shpejt në varr.

-Po mirë! - vazhdoi endacaku, - i gjallë na qenka ky i vdekuri? Pa të shohim njëherë.

U përkul përsëri, kërkoi nëpër grumbull, largoi çdo gjë që e pengonte, zuri dorën, kapi krahun, liroi kokën, tërhoqi trupin, dhe pas pak ai ishte duke tërhequr në hijen e udhës së thellë një njeri pa shpirt, të paktën një njeri që kishte humbur ndjenjat. Ky na ishte një koracier, një oficer, madje një oficer i sërës së lartë; një supëz e madhe prej ari dilte që poshtë parzmore; ky oficer s'kishte përkrenare. Një goditje e furishme shpate ia kishte çarë fytyrën, ku s'dukej gjë tjetër veçse gjak. Sidoqoftë, nuk dukej të kishte ndonjë gjymtyrë të thyer, dhe, për fat, në qoftë se kjo fjalë mund të përdoret këtu, të vdekurit e tjerë ishin lakuar sipër tij, në mënyrë që ta ruanin nga shtypja. Sytë i kishte të mbyllur.

Mbi parzmore kishte dekoratën e Kryqit të argjendtë të Legionit të Nderit.

Endacaku e shkuli këtë kryq, i cili u zhduk në njërin prej honeve që kishte nën kapotën e tij.

Pas kësaj ai preku xhepin e vogël të oficerit, ndjeu aty një sahat dhe e mori. Pastaj kërkoi një jelek, gjeti aty një qese dhe e shtiu në xhep.

Ndërsa endacaku ishte në këtë fazë të ndihmës që po i jepte këtij njeriu në heqje, oficeri hapi sytë.

-Faleminderit, - tha ai me zë të mekur.

Shpejtësia e lëvizjeve të njeriut që po e sillte nëpër duar, freskia e natës, ajri që thithi lirisht, e kishin nxjerrë oficerin nga letargjia.

Endacaku s'u përgjigj fare. Ai ngriti kokën. Në fushë dëgjohej një zhurmë hapash; me gjasë, do të ishte ndonjë patrullë që po afrohej.

Oficeri murmuriti, sepse në zërin e tij kishte akoma agoni:

-Kush e fitoi betejën?

-Anglezët, - u përgjigj endacaku.

Oficeri nisi përsëri:

-Kërkoni në xhepat e mi. Do të gjeni aty një qese dhe një sahat. Merrini.

Kjo punë kishte marrë fund me kohë.

Endacaku bëri sikur zbatoi porosinë dhe tha:

-S'paska gjë.

-Më paskan vjedhur, - vazhdoi oficeri, - më vjen keq. Do t'jua kisha dhënë juve.

Hapat e patrullës sa vinin e po dëgjoreshin më shkoqur.

-Po vijnë, - tha endacaku duke bërë lëvizjen e një njeriu që largohet.

Oficeri, duke ngritur me mundim krahun, e ndali.

-Më shpëtuat jetën. Kush jeni ju?

Endacaku u përgjigj shpejt dhe me zë të ulët:

-Isha si ju, në ushtrinë frënge. Duhet të largohem e t'ju lë këtu. Po të më kapin, do të më pushkatojnë. Unë jetën jua shpëtova. Tani bëjini hall kokës.

-Ç'gradë keni?

-Rreshter.

-Si quheni?

-Tenardie.

-Nuk do ta harroj këtë emër, - tha oficeri. - Edhe ju, mbajeni mend emrin tim. Më quajnë Pontmersi.

Libri i dytë

ANIJA "ORION"

I

Numri 24601 bëhet numër 9430

Zhan Valzhanin e kishin kapur përsëri.

Lexuesi do të na e dijë për nder që po kalojmë fluturimthi mbi disa hollësi të dhimbshme. Po mjaftohemi të sjellim fjalë për fjalë dy trafilete të botuara nga gazetatat e kohës, disa muaj pas ngjarjeve të çuditshme që ndodhën në Montrëj-syr-Mer.

Këta artikuj janë pakëz të përmbledhur. Gjithkush e mban mend se asokohe nuk ekzistonte akoma "Gazete des Tribunaux".

Artikullin e parë po e marrim nga "Drapeau blanc". Ai ka datën 25 korrik 1823.

"Një rreth i Pa-dë-Kalesë, para pak kohësh u bë arena e një ngjarjeje jo të zakonit. Një njeri që s'ishte banor i qarkut dhe që quhej zoti Madëlen, qysh prej disa vjetësh, falë disa proceseve të reja, kishte rimëkëmbur një industri të hershme lokale, fabrikimin e rruazave prej sere dhe të qelqit të zi. Me këtë ai kishte bërë pasuri të madhe dhe, le ta themi, kishte pasuruar edhe rrethin. Si mirënjohje për shërbimet që kishte sjellë, atë e kishin emëruar kryetar bashkie. Policia zbuloi se ky farë zoti Madëlen na paskësh qenë një ish-i dënuar me punë

të rënda, me banim të jashtëligjshëm, i dënuar më 1796 për vjedhje dhe i quajtur Zhan Valzhan. Zhan Valzhani u kap dhe u rreshtua përsëri në kampin e punëve të rënda. Duket se para arrestimit të tij, ai paskësh arritur të tërhiqte nga banka e Lafitit një shumë prej më tepër se gjysmë milioni, që e paskësh vendosur aty, dhe që, siç thonë, e paskësh fituar në mënyrë shumë të ligjshme në tregtinë që bënte. Nuk u mor vesh se ku e kishte fshehur Zhan Valzhani atë shumë, që kur hyri përsëri në kampin e punëve të rënda të Tulonit."

Artikulli i dytë, pakëz më i hollësishëm, është nxjerrë nga "Journal de Paris" e po asaj date.

"Një ish-i dënuar me punë të rënda i liruar, i quajtur Zhan Valzhan, para pak kohësh doli përpara gjykatës penale të Varit në disa rrethana që meritojnë vëmendje. Ky kobtar kishte arritur ta mashtronte vigjilencën e policisë, kishte ndërruar emrin dhe kishte mundur të emërohej kryetar bashkie i njërit prej qyteteve tona të vogla të Veriut. Aty kishte ngritur një industri mjaft të madhe. Më në fund ai u demaskua dhe u arrestua falë zellit të palodhshëm të prokurorisë politike. Ai mbante si grua pa kurorë një grua publike, e cila vdiq nga dëshpërimi në çastin e arrestimit të tij. Ky fatkeq, i pajisur me një forcë prej divi, gjeti mjetin për t'u arratisur, por, tri a katër ditë pas arratisjes nga burgu, policia e shtiu përsëri në dorë brenda në Paris, në çastin kur po hipte në një nga ato karrocet e vogla që bëjnë udhëtimin nga kryeqyteti në Monfermej (Senë-e-Uazë). Thuhet se kishte përfituar nga ato tri a katër ditët e lirisë së tij për të shtënë në dorë një shumë fort të majme, që e kishte vendosur te njëri prej bankierëve tanë kryesorë. Kjo shumë çmohet deri gjashtë a shtatëqind mijë franga. Po t'i zihet besë aktpadisë, ai i kishte fshehur këto të holla në një vend që vetëm ai e dinte, kështu që nuk ishte e mundur të vihej dorë mbi to. Sidoqoftë, i quajturi Zhan Valzhan ishte nxjerrë përpara gjykatës penale të qarkut të Varit, i pandehur për kusari me armë në dorë, të kryer afro tetë vjet përpara, kundër njërit prej atyre çunave të ndershëm, të cilët, siç e ka thënë patriarku i Ferneit¹³²⁾ në vargje të pavdekshme:

*Nga Savoja çdo vit ata vijnë
dhe me duar të lehta fshijnë
oxhakët, që nga bloza nxijnë.*

Ky kusar nuk pranoi të mbrohej. U përcaktua nga prokurori i shkathët e gojëtar se vjedhja ishte kryer në bashkëpunim dhe se Zhan Valzhani bënte pjesë në një çetë hajdutësh në jug. Si rrjedhim, Zhan Valzhani, i shpallur fajtor, u dënua me vdekje.

Ky kriminel hoqi dorë nga e drejta për ta hedhur çështjen në gjykatën e apelimit. Mbreti, me shpirtmadhësinë e tij të pashtershme, denjoi ta kthente dënimin e tij me vdekje në dënim me punë të detyruar përjetë. Zhan Valzhani u dërgua menjëherë në kampin e Tulonit.”

S’do ta keni harruar se Zhan Valzhani në Montrëj-syr-Mer i kryente ritet fetare. Disa gazeta, midis të cilave “Constitutionnel”, e paraqitën këtë kthim dënimi si një triumf të partisë së priftërinjve.

Zhan Valzhani ndërroi edhe numrin në kamp. Ai u quajt 9430.

Si përfundim, le ta themi që tani për të mos u kthyer më në këtë çështje, lulëzimi në Montrëj-syr-Mer u zhduk tok me zotin Madëlen. Gjithçka kishte parashikuar asaj nate plot ethe e dyzime, u realizua: mungoi ai, në të vërtetë *mungoi edhe shpirti*. Pas rënies së tij, në Montrëj-syr-Mer u bë ajo ndarja egoiste që ngjet pas rënies së njerëzve të mëdhenj, ai copëtim fatal i gjërave të lulëzuara që kryhet çdo ditë, pa u vënë re në bashkësinë njerëzore, dhe që historia e ka vënë rë vetëm një herë, sepse u bë pas vdekjes së Aleksandrit. Adjutantët u kurorëzuan mbretër; mjeshtrit e fabrikës u sajuan si fabrikantë. Hasmëritë plot smirë dolën mbi ujë. Punishtet e mëdha të zotit Madëlen u mbyllën, ndërtesat u rrënuan, punëtorët u shpërndanë. Disa u larguan nga qyteti, disa të tjerë braktisën mjeshhtërinë. Çdo gjë tani u bë në shkallë të vogël në vend që të bëhej në shkallë të gjerë, u bë për lakminë, në vend që të bëhej për të mirën e përgjithshme. S’mbeti më qendër, konkurrenca u ngjall gjithandej, dhe njerëzit filluan të hanin kokën njëri me

tjetrin. Zoti Madëlen sundonte gjithçka, dhe drejtonte. Me të rënë ai, secili rrahu për vete; fryma e luftës i zuri vendin frymës së organizimit, ashpërsia zuri vendin e përzemërsisë, urrejtja për njëri-tjetrin zuri vendin e dashamirësisë që kishte themeluesi për të gjithë; fijet që kishte lidhur zoti Madëlen, u kokolepsën dhe u këputën; proceset e prodhimit u falsifikuan, produktet u keqësuan dhe besimi u varros i gjallë; tregjet e shitjes u ngushtuan dhe porosira kishte më pak; mëditja u ul, punishtet mbetën pa punë, pllakosi falimenti. Kështu që për të varfrit s’mbeti gjë. Gjithçka u tret e humbi.

Edhe shtetit vetë i ra në sy se dikush ishte zhdukur diku. Pas më pak se katër vjetësh nga dita e vendimit të gjykatës penale që konstatoi identitetin e zotit Madëlen dhe të Zhan Valzhanit, shpenzimet e vjeljes së taksave ishin dyfishuar në rrethin e Montrëj-syr-Merit, dhe zoti Dë Vilelë¹³³ bëri rreth kësaj çështjeje një vërejtje publike në muajin shkurt 1827.

II

Ku do të lexoni dy vargje, të cilat ndoshta janë të djallit

Para se të shkojmë më tutje, është me vend të kallëzojmë me disa hollësi një ngjarje të pazakontë që ndodhi rreth po asaj kohe në Montrëj-syr-Mer dhe që ndoshta nuk është fare pa lidhje me disa dyshime të prokurorit të shtetit.

Në fshatin Monfermej ka një besëtytni fort të lashtë, aq kurioze dhe të çmuar sa një besëtytni popullore në afërsitë e Parisit, siç është një bimë aloesi në Siberi. Ne jemi nga ata që respektojmë çdo gjë që është si një bimë e rrallë. Ja, pra, se ç’është besëtytni e Monfermejit. Njerëzit besojnë se djalli, qysh prej kohësh që s’mbahen mend, ka zgjedhur pyllin si vend për të fshehur në dhë paratë e veta. Ndrikullat pohojnë se jo rrallë ndaj të ngrysur mund të takosh, në vende të veçuara të pyllit, një njeri të zi, që ka tiparet e një karrocieri ose të një druvari të

mbathur me sabo^{*)}, të veshur me pantallona e këmishë pëlhere, që mund ta njohësh, sepse, në vend të kësulës ose të kapelës, ai ka dy brirë të mëdhenj në kokë. Kjo gjë e bën në të vërtetë atë, që të njihet se kush është. Ky njeri zakonisht merret me çeljen e ndonjë grope. Ka tri mënyra për të dalë faqebardhë nga një takim i tillë. E para është që t'i afrohesh këtij njeriu dhe t'i flasësh. Atëherë e sheh se ky njeri na qenka, as më pak, as më shumë, vetëm një fshatar, i cili duket sikur është i zi, sepse është mugëtirë, i cili nuk merret me çelje gropash, por mbledh bar për lopët e tij, dhe ato që të janë dukur si brirë, s'janë gjë tjetër veçse një sfurk për pleh që e mban në kurriz dhe bigat e të cilit, për shkak të perspektivës së mbrëmjes, duken sikur i dalin nga koka.

Po u ktheve në shtëpi, do të vdesësh brenda javës. Mënyra e dytë është që ta vëzhgosh, të presësh gjersa ta ketë çelur gropën, ta ketë mbuluar dhe të jetë larguar nga vendi, pastaj të vraposh shpejt e shpejt te gropa, ta hapësh përsëri dhe të marrësh së andejmi "thesarin", që pa dyshim njeriu i zi ka vendosur aty. Në këtë rast do të vdesësh brenda muajit. Më në fund, mënyra e tretë është që të mos i flasësh fare njeriut të zi, të mos ia hedhësh fare sytë dhe t'ia mbathësh me të katra. Edhe në këtë rast do të vdesësh brenda vitit.

Meqenëse të tria mënyrat kanë belatë e tyre, mënyra e dytë zbatohet zakonisht më shumë, sepse nga ajo, të paktën, ke disa përfitime, në mos tjetër, por të bën zot të një thesari, qoftë edhe për një muaj. Njerëzit e guximshëm, të cilët i tërheq kësmeti, mjaft dendur, mesa na sigurojnë bota, kanë çelur përsëri gropat e hapura nga njeriu i zi dhe janë orvatur të vjedhin djallin. Duket se s'u ka dalë gjë. Të paktën, në qoftë se i zihet besë traditës dhe veçanërisht dy vargjeve enigmatike në latinishten barbare, që ka lënë për këtë rast një murg i keq normand, pak si magjistar, që quhet Trifon. Ky Trifoni është varrosur në abacinë e Shën-Gjergjit të Boshervilës afër Ruenit, dhe mbi varrin e tij lindin zhabiakë.

Duhet të përpiqesh shumë, sepse këto gropa janë shumë

^{*)} Lloj nallanesh prej druri që mbajnë fshatarët në Francë.

të thella, duhet të dërsish, të gërmosh, të punosh një natë të tërë, sepse këto punë natën bëhen, ta bësh qull këmishën, ta harxhosh të tërë kandilin, ta ronitësh kazmën, dhe, kur, tek e mbramja, të kesh arritur në fundin e gropës dhe të kesh vënë dorën mbi "thesarin", çfarë do të gjesh? Ç'është vallë thesari i djallit? Një su, herë-herë një skud, një gur, një skelet, një kufomë që kullon gjak, disa herë hije të palosura më katërsh, si ndonjë fije letër në portofol; disa herë asgjë. Pikërisht një gjë të tillë duket se u paralajmërojnë kureshtarëve të panginjur këto vargje të Trifonit:

*Fodit, et in fossa thesauros condit opaca
As, nummos, lapides, cadaver, simulacra, nihilique^{*)}*

Duket se edhe në ditët tona në këto gropa gjen herë ndonjë vezme baruti me plumba, herë ndonjë palë letra bixhozi të vjetra, të përlyera e të skuqura, të cilat u kanë shërbyer me siguri djajve. Trifoni nuk i regjistron këto dy gjetje të fundit, sepse dihet që Trifoni jetonte në shekullin e dymbëdhjetë dhe nuk ka aspak të ngjarë që djallit t'i ketë shkrepur në mendje të shpikte barutin përpara Rozhe Bakonit¹³⁴⁾ dhe letrat e bixhozit përpara Karlit VI.

Dhe, po luajte me këto letra, të jesh i sigurt se do të humbasësh gjithçka që zotëron; dhe, përsa i përket barutit që është vënë në vezme, ai ka vetinë që të ta pëlcasë copë e thërrime pushkën përpara fytyrës.

Kështu që, fare pak kohë pas epokës kur prokurorisë iu duk se ish-i burgosuri Zhan Valzhan, i dalë në lirim, gjatë sorollatjes së tij prej disa ditësh, ishte sjellë rreth Monfermejit, u vu rë po në këtë fshat se njëfarë punëtori rrugësh, një plak i quajtur Bulatryel, "shkonte e vinte" në pyll. Njerëzit në fshat besonin se kishin rënë në erë që ky Bulatryeli na paskësh qenë në kampin e punëve të rënda; atë e mbikëqyrte në njëfarë

^{*)} Ai gërmon dhe mbulon në një gropë të errët: një grosh, monedha, gurë, një kufomë, figura dhe asgjë (lat.).

mënyre edhe policia, dhe, meqenëse nuk gjente dot punë në asnjë vend, administrata e përdorte me mëditjen më të vogël si punëtor në udhën tërthore që çonte nga Ganjja në Lanjë.

Ky Bulatryeli na paskësh qenë një burrë, të cilin e shikonin vëngër vendasit; ai na i respektonte me të tepërt të tjerët, ishte tepër i përvuajtur, gati që t'i hiqte kësulën gjithë botës; dridhej i tëri dhe buzëqeshte përpara xhandarëve; me gjasë, ishte i lidhur ortak me çeta kusarësh, siç thuhej, dhe dyshohej se ngrinte pusi skutave të zabeleve kur binte nata.

Ja se ç'kujtonin njerëzit se kishin vënë rë:

Kishte ca kohë që Bulatryeli na e braktiste fort herët punën për të shtruar me gurë dhe për të mirëmbajtur udhën dhe na shkante në pyll, duke marrë edhe kazmën me vete. Bota e takonin mbrëmjeve në lirishtet më të shkreta, në shkurret më të egra; ai dukej sikur kërkonte diçka; herë-herë ai çelte gropa. Gratë e urta, që kalonin atyre anëve, kujtonin në fillim se mos ishte zerzevuli, pastaj shihnin se na ishte Bulatryeli, por prapëseprapë nuk u flinte mendja. Këto takime dukej se nuk i pëlqenin fare Bulatryelit. Dukej shkoqur që ai përpiquej të fshihej dhe që kishte njëfarë misteri në gjërat që bënte.

Në fshat thoshin kështu: "Është e qartë se qoftëlargu është fanepsur këtyre anëve. Bulatryeli e ka parë, ndaj dhe kërkon. Sidoqoftë, në vëntë dorë mbi thesarin e fshehur të qoftëlargut, e mori lumi". Volterianët shtonin: "Do ta kapë Bulatryeli djallin apo djalli Bulatryelin?" Plakat bënë kryqe njërin pas tjetrit.

Ndërkohë marifetet e Bulatryelit në pyll morën fund, dhe ai filloi përsëri në rregull punën e tij si punëtor. Atëherë bota u morën me fjalë të tjera.

Megjithatë, disa njerëz ishin akoma kureshtarë, duke menduar se në këtë mes do të ishin jo thesarët përrallore të legjendës, por ndonjë pasurizë e mirë, më serioze dhe më me bukë se kartëmonedhat e djallit, pas së cilës punëtori i rrugëve pa dyshim do të kishte rënë në erë. Më "kureshtarët" ishin mësuesi i fshatit, dhe hanxhiu Tenardie, i cili ishte mik me gjithë botën dhe nuk e kishte pasur për gjë të lidhej edhe me Bulatryelin.

-Ka qenë në galera? - thoshte Tenardieja. - Epo mirë se ka

qenë! Ku i dihet se kush është sot në galera e kush do të jetë nesër?

Në mbrëmje mësuesi i shkollës ngulte këmbë se, po të qe si më parë, drejtësia do të kishte bërë hetime se çfarë bënte Bulatryeli në pyll, dhe se aty do t'i duhej medoemos që të fliste, dhe se do ta shtrëngonin me tortura, po të qe nevoja, dhe se Bulatryeli nuk do t'i bënte dot ballë, për shembull, torturës me ujë.

-Le ta torturojnë me verë, - tha Tenardieja.

Dhanë e morën e s'lanë gjë pa bërë dhe, më në fund, e bënë punëtorin plak të pinte. Bulatryeli piu sa mend plasi, por, për të folur, foli pak. Ai i kurdisi me marifet, me një art të përsosur dhe me përmasat prej mjeshtri etjen e një të panginjuri me kujdesin dhe fshehtësinë e një gjykatësi. Por, duke e bombarduar vazhdimisht, duke i ngjitur dhe duke i shtrydhur ato pak fjalë të errëta që i shpëtonin Bulatryelit, Tenardiesë dhe mësuesit iu mbush mendja top se kishin nxjerrë e kuptuar sa vijon:

Bulatryeli, një mëngjes, duke vajtur në punë më të zbardhur të ditës, paskësh mbetur i habitur tek kishte parë në një skutë të pyllit, nën një ferrë, një lopatë dhe një kazmë, si të *thuash, të fshehura*. Por ai paskësh menduar se do të ishin lopata dhe kazma e xha Si-Furit, mbartësit të ujit, dhe s'e paskësh vrarë mendjen më tej. Por mbrëmjen e po asaj dite ai na paskësh parë, pa u vënë re nga askush, sepse ishte fshehur prapa një peme të madhe, tek po drejtohej nga rruga për në pjesën më të dendur të pyllit "njëfarë njeriu, i cili s'ishte aspak vendas, por që ai, Bulatryeli, e njihte shumë mirë." Tenardieja e kishte interpretuar kështu këtë gjë: "Një shok i kampit të punëve të detyruara." Bulatryeli me kryeneçësi nuk paskësh pranuar të tregonte emrin e këtij njeriu. Ky farë njeriu mbante një pako, një gjë si katrore, një si kuti të madhe ose një si arkë të vogël. Bulatryeli na paskësh bërë çudi. Por vetëm pas shtatë a tetë minutash i paskësh shkrepur Bulatryelit t'i binte pas "atij farë njeriu". Mirëpo ishte tepër vonë, sepse ai njeriu na qenkësh futur thellë në dendësinë e pyllit, nata kishte rënë dhe Bulatryeli s'paskësh mundur ta arrinte dot. Atëherë ky na paskësh

vendosur të vëzhgonte buzën e pyllit “Kishte bërë”. Pas dy a tri orësh, Bulatryeli e paskësh parë atë “farë njeriu” tek po dilte nga pylli, duke mbajtur tani jo më atë arkën e vogël, por një kazmë e një lopatë. Bulatryeli na e paskësh lënë njeriun të kalonte dhe nuk paskësh menduar t’i afrohej, sepse paskësh thënë me vete se ai tjetri ishte nja tri herë më i fortë dhe i armatosur me një kazmë, kështu që ndoshta do ta kishte lënë thes në vend, po ta kishte njohur se kush ishte dhe po të kishte parë se edhe atë dikush e njohu. Ngashërime prekëse të dy shokëve që takojnë përsëri njëri-tjetrin. Por lopata dhe kazma paskëshin qenë një rreze drite për Bulatryelin; ai na paskësh ngarë vrap te ferra e mëngjesit dhe s’paskësh gjetur aty as lopatë, as kazmë. Nga të gjitha këto, ai na paskësh nxjerrë si përfundim se ai farë njeriu, si kishte hyrë në pyll, paskësh gërmuar një gropë me kazmën, paskësh futur aty arkëzën dhe e paskësh mbuluar përsëri gropën me lopatë. Mirëpo arkëza na paskësh qenë tepër e vogël dhe s’kishte si të mbante brenda ndonjë kufomë, pra ajo brenda kishte para. Ky na qenkësh shkaku i kërkimeve të tij. Bulatryeli e paskësh kërkuar dhe kthyer mbarë e prapë të gjithë pyllin, paskësh gërmuar kudo që i ishte dukur dheu i mihur rishmë. Më kot.

S’kishte mundur të “nxirrte gjë në dritë”. Askush s’ia vari më kësaj çështjeje në Monfermej. Pati vetëm disa ndrikulla të urta që thanë: “Ta dini si një e një që bëjnë dy se punëtori i Ganjisë nuk e ka bërë gjithë atë rropatje për shpirt të babait; me siguri që djalli ka ardhur këtyre anëve.”

III

Vargoi i prangave duhej të kishte pësuar ndonjë farë pune përgatitore, përderisa u këput asisoj, me një të goditur të çekanit

Aty nga mbarimi i tetorit të po këtij viti, 1823, banorët e Tulonit panë tek po kthehej në port, për shkak të kohës së keqe dhe për të meremetuar disa avari, anijen “Orion”, e cila më vonë pati qenë përdorur si anije-shkollë dhe asokohe bënte pjesë në skuadrën e Mesdheut.

Kjo anije, sado e sakatosur, sepse e kishte dëmtuar deti, bëri përshtypje kur hyri në radë. Ajo mbante nuk di çfarë flamuri, për të cilin i bënë një përshtendetje të rregullit me njëmbëdhjetë të shtëna topi, të cilat ajo ia ktheu një për një: gjithsej njëzet e dy të shtëna topi. Është llogaritur se për përshtendjetet, mirësjelljet mbretërore dhe ushtarake, këmbime zhurmash për oborrësi, sinjale etikete, formalitete rade dhe kështjelle, lindje dhe perëndim dielli, të përshtendetura çdo ditë nga të gjitha fortesat dhe anijet e luftës, hapje dhe mbyllje portash etj. etj., bota e qytetëruar bënte qitje me barut në të gjithë rruzullin tokësor, në çdo njëzet e katër orë, njëqind e pesëdhjetë mijë të shtëna topi, pa pikë dobie. Për gjashtë franga çdo e shtënë topi, bëjnë nëntëqind mijë franga në ditë, bars me treqind milionë franga në vit, të cilat fluturojnë në tym. Kjo është vetëm një hollësi. Ndërkohë të varfrit vdesin urie.

Viti 1823, siç e quajti Restaurimi, ishte “epoka e luftës së Spanjës”.

Kjo luftë përfshinte shumë ngjarje në një të vetme, edhe shumë veçantira. Kjo ishte një çështje e madhe, për shtëpinë e Burbonëve; dega e Francës ndihmonte e mbronte degën e Madridit, domethënë vepronte si motra më e madhe; një kthim të dukshëm në traditat tona kombëtare, i ndërlikuar me nënshtrim e vartësi ndaj kabineteve të Veriut; zoti dukë D’Angulem, të cilin fletushkat liberale e mbiquajtën “heroi i Anduzharit”, me një qëndrim triumfal, të cilin e prishte pakëz

pamja e tij e qetë, frenonte terrorizmin e vjetër fort real të selisë së shenjtë, që hahej me terrorizmin imagjinar të liberalëve; të pabrekët ringjalleshin nën emrin e të pakëmishëve dhe u kallnin datën vejushave fisnike; monarkia i bëhej pengesë përparimit, duke e cilësuar atë si anarki; teorive të vitit 1789 u pritej rruga shkurt, duke i shkatërruar pa pushim; një *ndal* evropian i drejtohej plot kërcënim idesë franceze dhe i binte rreth e qark gjithë botës; krahas birit të Francës, gjeneralisimit, princi Dë Karinjan¹³⁵⁾ qysh nga Karl-Alberi rreshtohej në këtë kryqëzatë të mbretërve kundër popujve si vullnetar me supëza granatieri prej stofi të leshtë me ngjyrë të kuqe; ushtarët e perandorisë hynin përsëri në fushat e betejës, por pas tetë vjetësh, të plakur, të trishtuar dhe nën kokardën e bardhë; flamuri tringjyrësh valëvitej në dhë të huaj nga një grusht francezësh heroikë,¹³⁶⁾ ashtu siç kishte qenë valëvitur flamuri i bardhë në Koblenc¹³⁷⁾ tridhjetë vjet përpara; murgjërit përziheshin me trupat tona ushtarake; shpirti i lirisë dhe i së resë bëhej zap me anë të bajonetave; parimeve u pritej udha shkurt me të shtëna topi; Franca po prishte me armët e saj atë që kishte bërë me shpirtin e saj; veç këtyre, kryetarët armiq ishin shitur, ushtarët ishin topitur, qytetet ishin rrethuar me anë të milionave; rreziqe ushtarake s'kishte aspak, e, megjithatë, shpërthimet pritëshin nga çasti në çast, si në ndonjë galeri të minuar miniere që është marrë e pushtuar në befasi; gjak derdhej pak, por edhe nder fitohej pak, disa korrnin turpin, ndërsa lavdi nuk korrte askush; e tillë pati qenë kjo luftë e bërë nga princat që rridhnin nga Luigji XIV dhe e udhëhequr nga gjeneralë që kishin dalë nga dora e Napoleonit. Ajo pati fatin e trishtuar të mos u kujtonte njerëzve as luftën e madhe, as politikën e madhe.

Disa veprime të armatosura patën qenë serioze; marrja e Trokaderos, midis së tjerash, ishte një veprim i bukur luftarak, por, në fund të fundit, po e përsëritim, trumbetat e kësaj lufte nxjerrin një tingull të ngjirur, në tërësi kjo luftë ishte e dyshimtë, historia i jep të drejtë Francës, që e pranoi me vështirësi këtë triumf të rremë. U duk e natyrshme që disa oficerë spanjollë, të ngarkuar të bënin qëndresë, u dorëzuan me shumë lehtësi, kështu që fitorja ra erë korrupsioni; u duk

sikur më shumë ishin fituar gjeneralët sesa betejat, dhe ushtari fitimtar u kthye në atdhe i poshtëruar. Kjo në të vërtetë ishte një luftë përulëse. Në palat e flamurit të saj mund të lexoje fjalët: "Banka e Francës."

Ushtarë të luftës së 1808-ës, nën të cilët ishte rrëzuar në mënyrë të hatashme Saragosa, ngrysnin vetullat më 1823 përpara pushtimit të lehtë të qytezave dhe kujtonin me keqardhje Palafoksin.^{*)} Franca e ka zakon të dojë më mirë të ketë përpara saj Rostopçinin sesa Balesterosin.¹³⁸⁾

Në një pikëpamje akoma më serioze, dhe mbi të cilën e do puna gjithashtu të ndalemi, kjo luftë, e cila prekte në Francë shpirtin ushtarak, zemëronte shpirtin demokratik. Kjo luftë ishte një ndërmarrje skllavërimi. Në këtë fushatë qëllimi i ushtarit francez, bir i demokracisë, ishte të fitonte një zgjedhë për të tjerët. Kundërkuptim i fëlliqur e i neveritshëm. Franca duhet ta ngrejë lart shpirtin e popujve dhe jo ta mbyhtë.

Lufta e vitit 1823, atentat kundër kombit bujar spanjoll, ishte në të njëjtën kohë një atentat kundër Revolucionit Francez. Këtë veprim të përbindshëm po e bënte Franca me dorë të vet; e detyruar me forcë; sepse, përveç luftërave çlirimtare, çdo gjë që bëjnë ushtritë, e bëjnë se detyrohen me forcë. Fjala *bindje pasive* e tregon qartë këtë gjë. Një ushtri është një kryevepër e çuditshme kombinimi, ku forca del si pasojë e një shume të stërmadhe pafuqishmërie. Kështu shpjegohet lufta që bën njerëzimi kundër njerëzimit, pa hirin e njerëzimit.

Lufta e vitit 1823 ishte fatale për Burbonët. Ata e morën këtë luftë për një sukses. Ata nuk e panë se sa rrezik është të vrasësh një ide me anë të një urdhri. Në lehtëbesimin e tyre ata gabuan rëndë, duke futur në vendosjen e rendit të tyre si element force dobësimin e stërmadh të një krimi. Fryma e kurtheve hyri në politikën e tyre. Viti 1830 mbiu në vitin 1823. Fushata u bë në këshillat e tyre një argument për grushtet e tyre dhe për aventurat e së drejtës hyjnore. Franca, duke

^{*)} Dukë i Saragosës që u shqua për mbrojtjen heroike që i bëri asaj.

rivendosur *el rey neto-n*^{*)} në Spanjë, mund të rivendoste fare mirë mbretin absolut në shtëpi të vet. Ata ranë në një gabim të tmerrshëm, duke e marrë bindjen e ushtarit si një pranim të kombit. Një besim i tillë të bën të humbasësh fronet. Nuk duhet të flesh as nën hijen e manxaniles,^{**)} as nën hijen e një ushtrie.

Le të kthehemi përsëri tek anija "Orion."

Gjatë veprimeve të ushtrisë së komanduar nga princi gjeneralisimus, një skuadër ushtarake detare patrullonte në Mesdhë. Thamë pak më parë se "Orioni" bënte pjesë në këtë skuadër dhe se u shtrëngua të vinte në portin e Tulonit për shkak të detit të keq.

Prania e një anijeje lufte në një port ka nuk di ç'gjë që e tërheq dhe e zaptton turmën. Arsyeja është se anija është diçka e madhe dhe populli i do gjërat e mëdha.

Një anije lufte është një nga ndeshjet më të madhërishtme që mund të ketë gjenia e njeriut me fuqinë e natyrës.

Një anije linjë është e përbërë njëherësh edhe nga ç'ka më të rëndë edhe nga ç'ka më të lehtë, sepse ajo ka të bëjë me të tria format e lëndës, me lëndën e ngurtë, lëndën e lëngshme dhe lëndën fluide, dhe i duhet të luftojë kundër të triave. Kjo anije ka njëmbëdhjetë çataj hekuri, për të mbërthyer granitin në fund të detit, dhe më shumë flatra e antena, për të kapur erën e reve, se sa bigaja.^{***)} Fryma e saj shpërthen nga të njëqind e njëzet topat e saj, sikur të dilte nga disa trumbeta vigane, dhe i përgjigjet rrufesë me krenari. Oqeani rreh t'ia marrë mendjen me ngjashmërinë e frikshme të dallgëve të tij, por anija ka shpirtin e vet, busullën e vet, që e këshillon dhe i tregon gjithmonë veriun. Netëve të zeza sterrë, fenerët e saj zëvendësojnë yjet. Kështu, kundër erës ajo ka litarin dhe pëlhurën; kundër ujit drurin; kundër shkëmbit hekurin, bakrin

*) Mbretin legjitim (spanjisht).

***) Manzanilla (spanjisht) është një pemë që arrin 5-7 metra lartësi dhe që rritet në Antilet dhe në Amerikën Ekuatoriale. Fruti i kësaj peme, sa një mollë e vogël, është i thartë dhe helmues: Quhet edhe pema e helmit ose pema e vdekjes.

****) Bigaille (fr.) – emër gjenerik i insekteve me krahë të kolonive franceze.

dhe plumbin, kundër errësirës dritën; kundër hapësirës së pafund një gjilpërëz.

Në qoftë se dikush do të formojë një ide mbi të gjitha përpjesëtimet vigane, tërësia e të cilave përbën anijen e linjës, mjafton të hyjë në një prej hambarëve të mbuluar gjashtëkatësh të portit të Brestit ose të Tulonit. Anijet janë aty, si të thuash, të vendosura nën çati. Ai tra kolosal është një sarenë; ajo kolonë e trashë druri, e shtrirë përtokë sa të ha syri, është direku i madh. Po ta marrësh nga rrënja në fund të skafit gjer te maja që prek retë, ky direk është gjashtëdhjetë kut i gjatë dhe ka një diametër prej tri këmbësh në bazë. Direku i madh anglez ngrihet dyqind e shtatëmbëdhjetë këmbë përpjetë që nga vija e ujit. Marina e etërve tanë përdorte kablllo litari, jona përdor zinxhirë. Vetëm kapica e thjeshtë e zinxhirëve të një anijeje njëqindtopëshe ka katër këmbë lartësi, njëzet këmbë gjerësi, tetë këmbë thellësi. Po sa dru duhet vallë për të bërë një anije? Tri mijë stera^{*)}. Një pyll i tërë që noton.

Për më tepër, vëreni re mirë këtë, këtu është fjala vetëm për anijet ushtarake të këtu e dyzet vjetëve të kaluar, për anijen e thjeshtë me vela; avulli, që asokohe ishte akoma në fëmijërinë e tij, i ka shtuar akoma mrekulli të reja asaj gjëje të çuditshme që quhet anije lufte. Sot, për shembull, anija mikse me helikë është një makinë që të lë gojëhapur. Ajo tërhiqet nga një tërësi velash, që ka një sipërfaqe prej tri mijë metrash katrorë dhe nga një kaldajë me një forcë prej dy mijë e pesëqind kuajsh fuqi.

Pa folur për këto mrekulli të reja, anija e moçme e Kristofor Kolombit dhe e Ryterit¹³⁹⁾ është një nga kryeveprat e njeriut. Kjo anije ka forca të pashtershme, ashtu siç ka pafundësia frymë; ajo mbledh erën në nivelin e vet, është e përpiktë në përhapjen e pafund të valëve, lundron dhe mbretëron.

Megjithatë, vjen një çast kur stuhia e thyen si ndonjë fije kashte atë direk horizontal gjashtëdhjetë këmbësh të gjatë, kur era e përkul si ndonjë purtekëz atë direk katërqind këmbësh të lartë, kur ai çengel, që peshon 5 ton, përdridhet në gojë të valëve

*) Masë që shërben për të matur sasinë e druve.

si grepi i një peshkatari në nofullat e një peshku, kur ata topa të përbindshëm hungërojnë përvajshëm dhe pa dobi, të cilat rrebeshi i rrëmben e i përflak në hon e në terr, kur gjithë ajo fuqi dhe gjithë ajo madhështi rrënohen nga një fuqi dhe nga një madhështi akoma më e madhe.

Sa herë që një forcë e madhe shpaloset për të përfunduar në një dobësi të madhe, kjo i bën njerëzit të ëndërrojnë. Për këtë arsye, në portet, kureshtarët mblidhen me shumicë, pa e shpjeguar as ata vetë se përse, rreth këtyre makinave të mrekullueshme të luftës e të lundrimit.

Çdo ditë, pra, nga mëngjesi e gjer në mbrëmje, skelat e molet e portit të Tulonit ishin të mbuluara nga një numër të papunësh dhe endacakësh, siç thonë në Paris, të cilët kishin si punë soditjen e "Orionit".

"Orioni" ishte një anije e sëmure që prej kohësh. Gjatë lundrimeve të saj të mëparshme ishin ngjitur pas skafit të saj aq shumë shtresa të trasha guaskash deti, saqë kishin bërë që anija të humbiste gjysmën e shpejtësisë; e kishin nxjerrë më të thatë një vit më parë për t'i kruar ato guaska; pastaj ajo kishte marrë përsëri detin. Por kjo kruarje i kishte dëmtuar rrumbat e skafit kështu që kur arriti në afërsitë e ishujve Baleare, veshja e skafit ishte e vajtur fare dhe e çarë, dhe, meqenëse kallafatimi nuk bëhej asokohe me llamarinë, anija kishte futur ujë. Një stuhi e furishme ekinoksi paskësh plasur papandehur dhe e kishte çarë faqen e majtë, majën e bashit dhe një dritare me kapak, dhe kishte dëmtuar mbajtësen e pallasartës së tringetës. Si rrjedhim i këtyre ceneve "Orioni" ishte kthyer përsëri në Tulon.

Një mëngjes turma që po e sodiste, u bë dëshmitare e një aksidenti.

Ekui pazhi po merrej me lidhjen e velave nëpër sarenat. Gabieri, i ngarkuar të merrte terezinë e gabies së madhe në tribord, e humbi drejtpeshimin. Mizëria e mbledhur buzë molit të Arsenalit e panë tek lëkundej dhe lëshuan një klithmë. Koka e rrëmbeu trupin dhe njeriu u soll rreth sarenës, me duart të shtrira drejt humnerës; ai kapi kalimthi peshkaxhinën e rreme, në krye me njerën dorë, pastaj me tjetrën, dhe ngeci aty i varur.

Deti ishte poshtë tij në një thellësi që të merrte mendjen. Tronditja e rrëzimit të tij i kishte shkaktuar peshkaxhinës së rreme një lëvizje të fortë lavjerrësi. Njeriu shkante e vinte në skajin e atij litari si guri i një hobeje. T'i shkoje në ndihmë, duhej t'i hyje një rreziku të llahtarshëm. Asnjë prej detarëve, të gjithë peshkatarë të bregut që sapo ishin çuar për shërbim, s'kishte guxim t'i hynte kësaj aventure. Ndërkohë gabieri fatkeq po lodhej; gjindja s'mund t'ia shihnin ankthin në fytyrë, por shquanin në të gjitha gjymtyrët e tij rraskapitjen. Ai shtrinte krahët dhe i përpëlente në mënyrë të llahtarshme. Çdo orvatje që bënte për të hipur përsëri lart, nuk bënte tjetër veçse shtonte lëkundjet e peshkaxhinës së rreme. Ai nuk bërtiste nga frika se mos humbiste fuqinë. Gjindja që ishin aty, po prisnin vetëm minutën kur ai do të lëshonte litarin, dhe në çdo çast të gjithë kthenin kokën mënjanë, që të mos e shikonin me sy kur të rrëzohej. Ka çaste kur një skaj litari, një shtagë, një degë peme, është vetë jeta, dhe është diçka e llahtarshme të shohësh një qenie të gjallë të shkëputet së andejmi dhe të bjerë si ndonjë kokërr peme e pjekur.

Befas gjindjes i zunë sytë një burrë që po u qepej armixheve me zhdërvjelltësinë e një maceje të egër. Ky burrë ishte i veshur me rroba të kuqe, ishte një i burgosur me punë të rëndë; ai kishte një kësulë të gjelbër, ishte, pra, një i burgosur përjetë. Kur arriti në lartësinë e çanakut të gabies, era ia mori kësulën dhe zbuloi një kokë me flokë krejt të bardhë; nuk ishte djalë i ri.

Në të vërtetë, një i burgosur, që punonte angari në anije, qysh në çastin e parë kishte vrapuar tek oficeri i ditës dhe në mes të turbullimit dhe të dyzimit të ekui pazhit, ndërsa të gjithë detarët dridheshin e zbrapseshin, ai i kishte kërkuar oficerit leje të rrezikonte jetën për të shpëtuar gabierin. Sa dha shenjë pohuese oficeri, ai e kishte këputur me një të goditur çekani zinxhirin e perçinosur në rrethin e këmbës, pastaj kishte marrë një litar dhe u ishte qepur me vërtik pallasartave përjetë. Askujt s'i ra në sy atë çast se me sa lehtësi u këput ai vargua. Për këtë u kujtuan më vonë.

Sa hap e mbyll sytë, ai u gjend mbi sarenë. Qëndroi disa

sekonda dhe u duk sikur po e maste me sy. Këto sekonda, gjatë të cilave era tundte e shkundte gabierin në skajin e një filli, i dukën si shekuj atyre që po e vështronin. Më në fund, i burgosuri ngriti sytë në qiell dhe bëri një hap përpara. Turma mori frymë. Gjindja e panë tek kaloi mbi sarenë duke vrapuar. Si arriti te skaji, ai lidhi një rën anë të litarit që kishte marrë me vete dhe anën tjetër e la të varej poshtë, pastaj filloi të zbriste me duar përgjatë këtij litari, dhe atëherë erdh e sundoi një ankth që s'tregohet dot me gojë; në vend të një njeriu të vetëm të varur mbi humnerë, u bënë dy.

Thoshe se ishte një merimangë që shkonte të kapte një mizë; veçse në këtë rast merimanga sillte jetën dhe jo vdekjen. Dhjetë mijë palë sy ishin ngulur mbi këtë çift burrash. Asnjë britmë, asnjë fjalë, e njëjta dridhmë ngryste vetullat. Të gjithë gojë mbanin frymën, sikur të kishin frikë se mos i shtonin qoftë edhe puhizën më të vogël erës, që tundte të dy fatkeqët.

Ndërkohë i burgosuri kishte mundur të zbriste pranë detarit. Ishte tamam koha; një minutë më vonë njeriu i rraskapitur dhe pa pikë shprese do të lëshohej e do të rrëkëllehej në humnerë; i burgosuri e kishte lidhur fort me litarin pas të cilit mbahej me një dorë, ndërsa me tjetrën punonte. Më në fund, e panë tek hipi përsëri mbi sarenë dhe e ngriti aty detarin; e mbajti mbështetur aty një hop për t'i lënë kohë të merrte fuqi, pastaj e mori ndër krahë dhe e mbarti, duke ecur mbi sarenë, gjer te kllaposja e direktut të epërm me direktun e poshtëm dhe prej andej në çanakun e gabies, ku e la në duart e shokëve të tij.

Në këtë çast turma shpërtheu në duartrokitje; pati edhe ca gardianë pleq që qanë, gratë përqafoheshin mbi mol, dhe u dëgjuan të gjithë zërat që bërtitnin me njëfarë furie plot dashuri: "Falje për këtë njeri! Falje!"

Ndërkohë ai kishte filluar të zbriste përsëri menjëherë për t'u bashkuar me grupin e angarisë. Për të arritur më shpejt, ai rrëshqiti në armixhe dhe filloi të vraponte mbi një sarenë të ulët. Të gjithë sa ishin po e ndiqnin me sy. Në një çast të caktuar, gjindjen e pushtoi frika; qoftë pse ishte i lodhur, qoftë pse po i merreshin mendtë, ai u duk sikur po dyzonte e po lëkundej sa

andej-këtej. Befas turma lëshoi një klithmë të madhe; i burgosuri kishte rënë në det.

Rrëzimi ishte i rrezikshëm. Fregata "Alzhezir" ishte ancoruar pranë "Orionit", dhe galeriani i varfër kishte rënë midis dy anijeve. Katër burra u hodhën me të shpejtë në një varkë. Turma po u jepte zemër, ankthi i kishte pushtuar përsëri të gjithë shpirtrat. Njeriu s'kishte dalë më në sipërfaqe. Ai që zhdukur në det, pa bërë asnjë rrudhëz, sikur të kishte rënë më ndonjë fuqi me vaj. Matën thellësinë, u zhytën, por më kot. Kërkuan gjer në mbrëmje; por as trupin s'e gjetën dot.

Të nesërmen gazeta e Tulonit botonte këto pak radhë: "17 nëntor 1823. Dje, një i burgosur me punë angari në anijen "Orion", duke u kthyer, pasi i pati dhënë ndihmë një detari, ra në det dhe u mbyt. Nuk qe e mundur të gjendej kufoma e tij. Dyshohet të ketë ngecur nën hunjtë e molit të Arsenalit. Ky njeri ishte i burgosuri me Nr. 9430 dhe quhej Zhan Valzhan".

Libri i tretë

PLOTËSIMI I PREMTIMIT DHËNË SË VDEKURËS

I

Çështja e ujit në Monfermej

Monfermeji gjendet midis Livrisë dhe Shelës, në buzën jugore të asaj rrafshnalte që ndan Urkun nga Marna. Sot Monfermeji është një fshat mjaft i madh, i stolisur gjithë vitin nga vilat e suvatuara, dhe të dielave nga borgjezët, shend e verë. Më 1823, në Monfermej, s'kishte as kaq shtëpi të bardha, as kaq borgjezë të kënaqur. Ai ishte vetëm një fshat i humbur në mes të pyjeve. Njeriu mund të haste aty-këtu ndonjë shtëpi pushimi të shekullit të kaluar, që njihej nga pamja e saj madhështore, nga ballkonet me shufra hekuri të përdredhur dhe nga ato dritare të gjata, xhamat e vegjël të cilave sajojnë mbi të bardhët e kanateve të mbyllura gjithfarë gjelbërimesh të ndryshme. Por, megjithëkëtë, Monfermeji prapë fshat se fshat ishte. Tregtarët e stofave dhe qejflinjte e pushimeve nuk e kishin zbuluar akoma. Ishte një vend i qetë dhe i këndshëm, që nuk e shkelte asnjë udhë; njeriu jetonte aty për së liri me atë jetë fshatarake aq të bollshme dhe aq të lehtë. Veçse uji aty ishte i rrallë, për shkak të lartësisë së rrafshinës.

Duhej të shkoje larg të mbushje ujë. Skaji i fshatit që ishte nga krahu i Ganjisë, e merrte ujin që i duhej në liqenet e

mrekullueshme, që ndodhen asaj ane nëpër pyjet; skaji tjetër përreth kishës që është nga krahu i Shelës, mund të gjente ujë të pijshëm vetëm te një burim i vogël në faqe të shpatit, afër udhës së Shelës, afro një çerek ore larg Monfermejtit.

Furnizimi me ujë ishte, pra, një angari e madhe për çdo familje. Shtëpitë e mëdha, aristokracia, si dhe bujtina Tenardie, që bënte pjesë në këtë kategori, i paguanin nga një *su* për kovë një burri plak, që e kishte për zanat dhe që fitonte me këtë punë në Monfermej rreth tetë *su* në ditë; por ky farë burri punonte vetëm gjer në orën shtatë të mbrëmjes kur ishte verë, ndërsa dimrit gjer në orën pesë, dhe, me të rënë nata e me t'u mbyllur kanatet e dritareve të kateve përdhese, ai që s'kishte ujë, shkonte vetë e mbushte ose bënte edhe pa të.

Ky ishte tmerrri i asaj qenieje të shkretë, të cilën lexuesi ndoshta nuk e ka harruar, i Kozetës së vogël. Ju kujtohet që Kozeta ishte e dobishme për Tenardietë nga dy anë; ata nga nëna zhvatnin para, dhe nga fëmija shërbime. Kështu, edhe kur nëna pushoi fare së paguari, ju e keni lexuar në kapitujt e mëparshëm përse Tenardietë e mbajtën Kozetën. Ajo zinte vendin e një shërbëtoreje. Si e tillë, asaj i takonte të shkonte e të mbushte ujë sa herë duhej. Kësisoj, fëmija, e tmerruar nga mendimi për të vajtur natën në burim, kishte kujdes të madh që ujët të mos mungonte asnjëherë në shtëpi.

Krishtlindjet në vitin 1823 u kremtuan me shkëlqim të veçantë në Monfermej. Fillimi i dimrit kishte qenë i butë atij moti; akoma s'kishin zënë ngricat e dëbora. Disa tregtarë të ardhur nga Parisi kishin marrë nga zoti kryetar i bashkisë leje që të ngrinin barakat e tyre në xhadenë e fshatit dhe një tog tregtarësh shëtitës, po me këso lejesh, kishin ngritur strehët e tezat e tyre në sheshin e kishës, gjer në rrugëzën "Bulanzhe", ku ndodhej, siç e mbani mend, ndoshta, bujtina e Tenardieve. Të gjitha këto bënin që hanet e kabaretë të mbusheshin plot, dhe i jepnin këtij fshati të vogël e të qetë një jetë plot zhurmë e gaz. Madje, për të qenë historian besnik, duhet të themi se ndër kuriozitetet e ekspozuara në shesh, kishte edhe një panair kafshësh të huaja e të rralla, ku disa palaço të frikshëm, të veshur me zhele dhe të ardhur s'di prej nga, u tregonin më 1823

fshatarëve një prej atyre skifterëve të llahtarshëm të Brazilit, që Muzeu ynë Mbretëror e pati vetëm më 1845 dhe që kanë përmbi sy një kokardë tringjyrëshe. Natyralistët e quajnë besoj këtë zog *Caracara Polyborus*. Ai është nga rendi i apicideve dhe nga familja e fajkonjve. Disa ushtarë të vjetër bonapartistë të kthyer në fshat shkonin dhe e vështronin këtë shpend plot me devotshmëri. Ata që jepnin shfaqje, e quanin kokardën tringjyrëshe si një fenomen të pashoq dhe të bërë apostafat nga zoti për teatrin e tyre.

Në mbrëmjen e krishtlindjeve, shumë burra, qiraxhinj e tregtarë shëtitës, ishin ulur nëpër tryeza dhe pinin rreth katër a pesë shandanëve në sallën e ulët të hanit të Tenardieve. Kjo sallë u përngjiste të gjitha sallave të kabareve; tryeza, broke kallaji, shishe, njerëz që pinin e tymosnin duhan; dritë pak e zhurmë shumë. Viti 1823 ishte shënuar në atë kohë prej dy sendeve, që hiqeshin shumë asokohe në klasën borgjeze dhe që ishin vendosur mbi një tryezë, d.m.th. një kaleidoskop dhe një llambë llamarine e bardhë me xixa. Tenardieja po mbikëqyrte darkën, që përgatitej përpara një zjarri të mirë bubulak; bashkëshorti Tenardie pinte me myshterinjtë e vet dhe fliste për politikë.

Veç bisedimeve politike, që kishin si çështje kryesore luftën e Spanjës dhe zotin dukë D'Angulem, njeriu mund të dëgjonte në atë gjurulldi edhe paranteza krejt lokale si këto:

-Nga ana e Nanterës dhe Syrenës vera ka qenë me shumicë të madhe. Atje ku llogariteshin gjashtë voza, njerëzia prodhuan dymbëdhjetë. Rrushi ka pasur lëng të madh sivjet. "Mirë, po mos nuk ishte i pjekur tamam?" "Në ato krahina andej rrushi nuk duhet të vilet edhe shumë i pjekur". "Po u vol i pjekur, vera vjen e bëhet pelte me të hyrë pranvera". "Atëherë do të jetë ndonjë verë fare e hollë?" "Janë verëra akoma më të holla se këto tonat këtej. Duhet që vjelja të bëhet kur rrushi s'është pjekur akoma". Etj.

Ose ndonjë mullis që thërriste:

-Po se mos jemi ne përgjegjës për atë që kanë thasët brenda? Ne gjejmë aty një tog me fara të vogla, të cilat s'kemi nge t'i qërojmë, dhe detyrohemi t'i lëmë të kalojnë nën gurët e

mullirit, atje ke egjër, ke buxhak, ke urth, ke grashinë, ke kërp, ke thekër të egër dhe një mori kokrrash të tjera, pa zënë në hesap guriçkat, që i ke me bollëk në disa grunjëra, sidomos në grunjërat bretone. As ma ka qejfi fare të bluaj grurë breton, ashtu sikurse nuk ua ka qejfi sharrëxhinjve të sharrojnë trarë ku ka gozhdë. Merreni me mend dhe gjykojeni vetë tani se çfarë pluhuri të keq të nxjerrin të gjitha këto plehra nën gur. Dhe pastaj bota qahen për miellin. S'kanë hiç të drejtë. Miellit s'ia kemi ne fajin.

Midis dy dritareve, një kositës, ulur në tryezë me një pronar që po caktonte hakun për një punë livadhi që do të kryhej në pranverë, po thoshte:

-S'ka asgjë të keqe, po të jetë bari i lagur. Pritet më mirë. Vesa është e mirë, zotëri, dëgjomëni mua. Bari juaj është njësh, është bar i ri dhe akoma i vështirë për t'u kositur. Kur bari është i hollë e i butë, epet nën tehun e kosës e s'ka zot që e pret. Etj.

Kozeta ishte në vendin e vet të zakonshëm, ulur mbi mbështetësen e këmbëve të tryezës së kuzhinës afër oxhakut. Ishte fund e krye me zhele, këmbët e saj lakuriqe i kishte mbathur me një palë *sabo* druri, dhe po thurte nën dritën e zjarrit çorape leshi për Tenardietë e vogla. Një kotele po luante nën karriget. Në një dhomë aty afër dëgjoheshin tek qeshnin e belbëzonin dy zëra të freskët fëmijësh; këto ishin Eponina dhe Azelma.

Te qoshja e oxhakut, një tigan ishte varur në një gozhdë.

Hope-hope një britmë fëmije të vogël, që ishte diku nëpër shtëpi, shponte zhurmën që bëhej në kabare. Ishte një djalë i vogël, që Tenardieja e kishte lindur një prej dimreve të mëparshme - "Pa ditur as unë sesi, - thoshte ajo, - por nga të ftohtët" - dhe që ishte pak më shumë se tre vjeç. Nëna e kishte ushqyer, por nuk e donte. Kur britmat këmbëngulëse të vocërrakut, bëheshin tepër të bezdisshme: "Yt bir po ulërin, - thoshte Tenardieja, - shko e shih një herë se ç'kërkon." "Bah! - përgjigjej nëna, - po më mërzit si shumë ai dreq." Dhe vogëlushi i braktisur vazhdonte të këlthiste në errësirë.

Dy portrete të përkryera

Gjer tani, në këtë libër, i kemi parë Tenardietë vetëm në profil; ka ardhur koha t'i biem rrotull këtij çifti dhe ta vështrojmë nga të gjitha anët.

Tenardieja sapo i kishte kaluar të pesëdhjetat; zonja Tenardie po shkelte në të dyzetat, që janë pesëdhjetë vjet për gruan; kësisoj kishte një drejtpeshim moshe midis gruas dhe burrit.

Lexuesit, që me paraqitjen e saj të parë, ndoshta kanë ruajtur ndonjë kujtim nga kjo Tenardieja shtatmadhe, flokëverdhe, fytyrëkuqe, e trashë, gjithë tule, rondokope, vigane dhe e zhdërvjellët; siç e kemi thënë, ajo ishte nga ajo raca e bishave vigane, që kapardisen e fryhen panairëve plot xhingla të varura në flokët. Ajo bënte gjithçka në shtëpi, rregullonte shtretërit, dhomat, lante rrobat, gatuate; ajo bënte, ligjin e drejtonte, si i thonë fjalës. Për shërbëtoresh kishte vetëm Kozetën; një mi i vogël në shërbim të një elefanti. Gjithçka dridhej kur bërtiste ajo, edhe xhamat, edhe mobiljet, edhe njerëzit. Fytyra e saj e gjerë, mbushur me pikla të kuqe, dukej si ndonjë lugë e madhe me vrime për të qeruar shkumën. Kishte edhe ca qime në mjekër. Ishte tamam si ndonjë hamall pazari, veshur si vajzë. Truante për shtatëqind dreqër; lëvdohej se mund të thyente një arrë me një të goditur të grushtit. Po ato romane që kishte lexuar, romane të cilat, herë-herë, bënin që të shfaqeshin naze prej gruaje lozonjare prapa asaj lubie, askujt nuk do t'i shkonte mendja kurrë të thoshte për të: "Kjo është grua". Kjo Tenardieja ishte si produkti i shartimit të një gruaje tekanjoze me një grua harbute. Po ta dëgjoje kur fliste, do të thoshte: "Kjo qenka xhandar"; po ta shikoje kur pinte, thoshte: "Kjo qenka karrocier;" po ta shikoje si sillej me Kozetën, do të thoshte: "Kjo qenka xhelat." Kur nuk fliste, i dilte nga buza një dhëmb jashtë.

Tenardieja ishte një burrë kërthi, i thatë, verdhacuk, gjithë qoshe, kockë e lëkurë, i dobët, çehrevrarë si i sëmurë, por

mbahej për mrekulli; këtu fillonte edhe ajo djallëzia e tij. Ai zakonisht buzëqeshte, me qëllim që të ruhej nga çdo e papritur, dhe ishte i sjellshëm pothuajse me të gjithë, madje edhe me lypësin, të cilit nuk i falte asnjë qindarkë. Kishte vështrim shqarshi dhe fytyrë letrari. Ai u përngjiste shumë portreteve të abat Delilit. Qejfi i tij ishte të pinte me qiraxhinjtë. S'kishte burrë që ta dehte. Pinte duhan me një pipë të madhe. Mbante një bluzë, dhe nën bluzë një palë rroba të vjetra, të zeza. Hiqej sikur merrte vesh nga letërsia dhe nga materializmi. Shpesh zinte në gojë disa emra për të mbështetur fjalët boshe që thoshte, Volterin, Rejnalin, Parnin dhe, për çudi, Sent-Augustenin. Pohonte se kishte "një sistem" të tijin filozofik. Veç këtyre, bataçqi i mbaruar. Një filusof." Kjo nuancë ekziston. E mbani mend që ai hiqej sikur kishte shërbyer edhe në ushtri; ai tregonte, duke ilustruar çdo gjë, se në Vaterlo, kur ishte rreshter në njëfarë regjimenti të 6-ës ose të 9-ës të këmbësorisë, ai, fill i vetëm kundër një eskadroni të tërë husarësh të vdekjes, kishte mbuluar e mbrojtur me trupin e vet dhe shpëtuar përmes breshërisë "një gjeneral të plagosur keq". Që këtej rridhte ajo tabela flakëruese mbi murin e tij, si edhe emri që i kishin vënë në fshat hanit të tij "Kabareja e rreshterit të Vaterlosë". Ai ishte liberal, klasik dhe bonapartist. Kishte vënë emrin në listën për të ndihmuar bonapartistët, të mërguar në "Fushën e strehimit" të Teksasit të Amerikës. Në fshat thuhej se ai kishte ndjekur studimet për t'u bërë prift.

Kurse ne besojmë se ai kishte studiuar në Holandë për t'u bërë haxhi. Ky maskara i të nëntëdhjetë e nëntave, sipas gjasave hiqej si flamand nga qyteti Lilë kur ishte në Flandër; si francez kur ishte në Paris; si belg kur ishte në Bruksel, duke qëndruar si në gjë të perëndisë, kaluar midis dy kufijve. Trimërinë e tij në Vaterlo e dinin gjithë bota. Siç shihet, pra, ai i frynte pak si tepër gjërat. Batica dhe zbatika, dredha, aventura ishin baza e jetës së tij; një ndërgegje e shprishur sjell si rrjedhim edhe një jetë të shthurur; dhe me siguri që në periudhën e stuhishme të 15 qershorit 1815 Tenardieja bënte

* Fjalë e kompozuar nga autori, filusof do të thotë vjedhacak, hileqar.

pjesë në atë farë kantierësh endacakë që kemi zënë ngoje e që sillen poshtë e lart për të nuhatur e kapur ndonjë gjah, që shesin në një krah dhe vjedhin në tjetrin, që shëtitin tok me familjen, me grua e me fëmijë, në ndonjë qerre çapaloqe, prapa trupave në marshim, duke nuhatur me kujdes që të lidhen mirë pas ushtrisë fitimtare. Si e pati kryer këtë fushatë, meqë e pati bërë, siç thoshte ai, qesen “kukurec”, kishte ardhur e kishte çelur një bujtinë në Monfermej.

Kjo qese, e përbërë nga kuleta e sahate, unaza ari e kryqe argjendi, të vjela në kohën e të korrave, nëpër brazdat të mbjella me kufoma, nuk përbënte ndonjë shumë të madhe dhe nuk e kishte çuar larg këtë kantinier të kthyer në bujtinar.

Tenardieja kishte diçka si të prerë me thikë në gjestet e tij, të cilat, të përziera me ndonjë të sharë, të sjellin ndër mend kazermën dhe, të përziera me një të bërë të kryqit, të sjellin ndër mend seminarin. Nga goja që shpatë. E hiqte veten si dijetar. Megjithatë, mësuesi i shkollës kishte vënë re se nuk ishte dhe aq shumë i “gramës”. Tenardieja ua përpilonte me mjeshtëri të rrallë udhëtarëve faturën që duhej të paguanin, por ndonjë sy i stërvitur gjente në të shpeshherë edhe gabime ortografike. Tenardieja ishte tinzar, llupës, përtac dhe dinak. Ai nuk i përbuzte shërbëtoret, dhe kjo kishte sjellë si rrjedhim që e shoqja të kishte mbetur pa shërbëtorë. Ajo grua vigane ishte xheloze e madhe. I dukej sikur atë burrec thatuq e verdhacuk e lakmonin të gjitha gratë e botës.

Tenardieja, kopil i madh e i përmbajtur, mbi të gjitha, ishte një maskara nga ata të llojit të butë. Ky lloj është më i keqi, sepse aty hyn në mes hipokrizia.

Kjo nuk do të thotë aspak që, kur e sillte puna, Tenardiesë të mos i hipnin xhindet, të paktën aq sa edhe gruas së tij; por kjo punë ngjiste shumë rrallë, dhe në çaste të tilla, meqë atë e brente inati për gjithë njerëzimin, e digjte prushi i urrejtjes, meqë ai ishte nga ata njerëz që hakmerren pareshtur e gjer në fund të jetës së tyre, që paditin gjithçka u kalon përpara dhe gjithçka që u ka pllakosur sipër dhe që janë gati të zbrazin mbi njeriun e parë që hasin, si mëri të ligjshme, të gjithë vandakun

e dështimeve, falimenteve dhe mynxyrave të jetës së tyre; kur i gufonte gjithë ky vrer në zemër dhe i ziente në gojë dhe në sy, ai të kallte datën. Mjerë ai që kalonte atë çast nën rrebeshin e tërbimit të tij.

Veç cilësive të tjera që kishte, Tenardieja ishte i vëmendshëm dhe njeri që t'i këndonte kartrat në xhep, i heshtur e gojëlëshuar, sipas rastit, dhe gjithmonë me një zgjuarsitë të lartë. Ai kishte diçka nga vështrimi i detarëve, që kapsallitin synë kur shikojnë me tejqyrë. Tenardieja ishte burrë shteti.

Kushdo që hynte rishmë në han, kur shikonte zonjën Tenardie, thoshte: “Kjo është zot shtëpie”. Gabim. Ajo s'ishte bile as zonja e shtëpisë. Zoti dhe zonja e shtëpisë ishte burri. Ajo zbatonte, ai krijonte. Ai drejtonte gjithçka me anë të një veprimi magnetik të padukshëm e të pandërprerë. Mjafton të thoshte një fjalë goje e disa herë të bënte vetëm një shenjë, dhe buallica bindej. Për zonjën Tenardie, Tenardieja ishte, pa e kuptuar as ajo vetë, njëfarë qenieje e veçantë dhe e tërëpushtetshme. Ajo kishte disa virtyte sipas mënyrës së saj; edhe sikur të ishte në kundërshtim mbi ndonjë hollësi me “zotin Tenardie” (hipotezë e papranueshme), ajo kurrën e kurrës nuk do të thoshte faqe të tjerëve se i shoqi s'kishte të drejtë për çfarëdo gjëje që të ishte. Kurrën e kurrës nuk do të binte “faqe të huajve” në atë gabim ku bien shpeshherë gratë, gabim që në gjuhën parlamentare i thonë: “të zbulosh kurorën”). Megjithëse marrëveshje e tyre kishte si rezultat vetëm të keqen, Tenardieja i nënshtrohej me përnderim të madh të shoqit. Gjithë ai mal zhurmë-e-tul lëvizte nën gishtin e vogël të këtij despoti të hajthëm. Po ta shikosh nga ana e shtrembër dhe groteske, gjithë kjo përbënte atë gjënë e madhe universale që quhet adhurimi që ka materia ndaj shpirtit, sepse disa lloj shëmtish kanë arsyen e tyre që të kenë në thellësinë e tyre bukuri të përjetshme. Te Tenardieja kishte diçka të panjohur; që këtej rridhte sundimi i plotë i këtij njeriu mbi atë grua. Kishte çaste kur asaj i dukej si ndonjë shandan i ndezur; kishte çaste të tjera kur asaj i dukej si ndonjë kthetër që i ngulej.

*) Të rrëzosh pushtetin.

Ajo grua ishte një krijesë e hatashme që nuk donte njeri tjetër veç fëmijëve të vet dhe që nuk ia kishte frikën njeriu, veç burrit të vet. Ajo ishte nënë, sepse ishte sisore. Bile amësia e saj ndalej te të bijat, e siç do të shohim më tej, nuk arrinte të shtrihej gjer te të bijtë. Kurse atij burrit i rrinte mendja vetëm në një vend: të pasurohej.

Mirëpo nuk ia arrinte dot. Këtij talenti të madh i mungonte një skenë e denjë. Tenardieja në Monfermej po rrënohej, në qoftë se rrënimi është i mundur kur ai fillon nga zeroja; në Zvicër ose në krahinën e Pirenejve, ky njeri pa një grosh në xhep do të ishte bërë milioner. Por hanxhiu duhet të kullotë atje ku e ka lidhur fati.

Kuptohet se fjala *hanxhi* është përdorur këtu në një kuptim të ngushtë dhe nuk shtrihet mbi një klasë të tërë.

Pikërisht në vitin 1823 Tenardieja kishte hyrë borxh një mijë e pesëqind franga, ky borxh s'priste, dhe kjo e shtinte në merak të madh.

Cilado që të ishte kundër tij padrejtësia këmbëngulëse e fatit, Tenardieja ishte nga ata njerëz që e kuptojnë më mirë se kushdo tjetër, me thellësinë më të madhe dhe në mënyrën më moderne, mikpritjen, që është një virtyt te popujt barbarë dhe një plaçkë tregu te popujt e qytetëruar. Veç këtyre, ai ishte një gjahtar kaçak i shkëlqyer dhe i dëgjuar si qitës. Ai kishte një lloj të qeshuri të ftohtë dhe të qetë, që ishte veçanërisht i rrezikshëm.

Teoritë e tij prej hanxhiu shpërthenin disa herë prej tij si shkrepitima. Ai kishte disa aforizma të mjeshtërisë, të cilat ia nguliste në kokë së shoqes. "Hanxhiu ka për detyrë, - i thoshte një ditë asaj plot dhunë e me zë të ulët, - që t'i shesë të parit që të vijë gjellë, çlodhje, dritë, zjarr, çarçafë të palarë, shërbëtorë, pleshta, buzëqeshje; që t'i ndalë udhëtarët, të zbrazë qeset e vogla dhe të lehtësojë ndershmërisht qeset e mëdha, të strehojë me respekt familjet që janë në udhëtim, të gërryejë burrat, t'i shkulë puplat grave, të qërojë fëmijët; ai ka për detyrë të shtjerë në faturë dritaren e hapur, dritaren e mbyllur, qoshen e oxhakut, kolltukun, karrigen, stolin, fronin, shtratin me pupla, dyshekun dhe vandakun me kashtë; ai duhet të dijë se sa e

harxhon hija pasqyrën dhe të caktojë tarifën, dhe, pasha të pesëqind mijë dreqërit, ta bëjë udhëtarin të paguajë për gjithçka, deri dhe për mizat që ha qeni i tij!"

Ky burrë e kjo grua ishin dhëlpëria dhe tërbimi të martuar së bashku, një pendë qe e llahtarshme dhe e tmerrshme.

Ndërsa burri bluante mendime e sajonte plane, Tenardieja, nga ana e saj, nuk mendonte për kreditorët, që s'i kishte parasysh, s'e hante merakun as për të djeshmen, as për të nesërmen dhe rrëmbehej e tëra nga jeta e çastit.

Të tilla ishin këto dy krijesa. Kozeta qëndronte midis të dyve dhe vuante shtypjen e tyre të dyfishtë, si ndonjë krijesë që njëkohësisht bluhej nga një mokër dhe shkitej copë e çikë nga një darë. Burri dhe gruaja kishin secili huqet e tyre; Kozeta shembej në dru, dhe këtë e kishte peshqesh nga gruaja: ajo shkonte këmbëzbathur dimrit, dhe këtë e kishte peshqesh nga burri.

Kozeta ngjitej, zbriste, lante, fshinte me brushë, fërkonte, fshinte me fshesë, vraponte, rraskapitej, gulçonte, lëvizte sende të rënda dhe, ashtu, siç ishte, shëndetligë, kryente punët më të rënda. Asnjë mëshirë për të; një zonjë shtëpie e egër, një zot shtëpie gjithë helm e vrer. Hani i Tenardieve ishte si ndonjë pëlhurë merimange, ku Kozeta kishte rënë e dridhej. Kjo ishte si miza në shërbim të merimangave.

Fëmija e shkretë nënshtrohej dhe kyçte gojën.

III

Njerëzit duan verë dhe kuajt ujë

Kishin ardhur katër udhëtarë të rinj.

Kozeta mendonte plot trishtim; sepse, sadoqë ishte vetëm tetë vjeç, ajo kishte hequr e vuajtur aq shumë, sa bluante mendime me pamjen e përzishme të një gruaje të moçme.

Njërin kapak të syve e kishte të nxirë nga një grusht që i kishte dhënë Tenardieja, dhe kjo e bënte Tenardienë vetë të

thoshte kohë më kohë: “Sa e shëmtuar duket me atë dangë mbi sy!”

Kozeta mendonte, pra, se ishte bërë natë, shumë natë, se do t'i duhej të mbushte papritmas poçet e kungujt në dhomat e udhëtarëve që sapo erdhën, kurse në kazan nuk kishte më ujë.

Ajo që i jepte pakëz zemër, ishte se njerëzit nuk pinin shumë ujë në shtëpinë e Tenardieve. Njerëzit që kishin etje, nuk mungonin aty; por kishin etje të tillë që i çonte më shumë te broka e verës, sesa te poçi i ujit. Po të kishte kërkuar dikush ndonjë gotë ujë në mes të gjithë atyre gotave me verë, ky do t'u ishte dukur gjithë atyre burrave si njeri i egër. E megjithatë, erdhi një çast kur fëmija u drodh e tëra: Tenardieja ngriti kapakun e një tenxhereje që po merrte valë mbi furrë, pastaj kapi një gotë dhe iu afrua vrik çurgut të ujit. Vërtiti musllukun; fëmija kishte ngritur kokën dhe po ndiqte me sy të gjitha lëvizjet e saj. Një curril i vogël uji rrodhi nga muslluku dhe e mbushi gotën përgjysmë. “Pa shih, - tha ajo, - s'paska ujë!”

Pastaj heshti një hop. Fëmija nuk po merrte frymë.

-Bah, - vazhdoi Tenardieja duke këqyrur gotën e mbushur përgjysmë, - mjaft e ka kaq.

Kozeta ia filloi përsëri punës, por gjatë më shumë se një çerek oreje ajo ndjeu se si po i rrihte zemra si e zogut në kraharor. Ajo i numëronte minutat që po rridhnin kështu; dhe do të dëshironte me gjithë zemër që të ishte e nesërmja në mëngjes.

Kohë më kohë ndonjëri nga ata që po pinin, hidhte sytë nga rruga dhe bërtiste me habi: “More, sa errët bëka, nxin nata si pus!” ose: “Duhet të kesh sytë e maces, që të dalësh në rrugë pa fener në këtë orë!” Dhe Kozetës i dridhej i tërë shtati.

Befas një nga tregtarët shëtitës të vendosur në han hyri brenda dhe tha me zë të ashpër:

-S'i paskan dhënë ujë kalit tim.

-Ujë i kemi dhënë që ç'ke me atë punë, - tha Tenardieja.

-Unë them se s'i keni dhënë, moj nënë, - vazhdoi tregtari. Kozeta kishte dalë që poshtë tryezës.

-Po si s'i paskemi dhënë, zotëri? - tha ajo, - kali ka pirë një

kovë, një kovë të tërë, dhe, në daçi të dini, po ju them se ia kam shpënë me dorën time, bile dhe i kam folur.

Por s'ishte e vërtetë. Kozeta gënjente.

-Pa shih këtë piçiruke sa një gogël, që ditka t'i shesë rrenat sa një buall, - bërtiti tregtari. - Unë po të them se s'ka pirë, moj maskareshë e vogël! Kali im ka një mënyrë të tijën të turfulluari kur nuk ka pirë, dhe këtë ia njoh mirë unë.

Kozeta nguli këmbë dhe shtoi me të ngjirur nga ankthi, aq sa mezi dëgjohej:

-Dhe bile ka pirë mirë!

-Hajde, - vazhdoi tregtari me inat, - lëri këto dëngla, jepi ujë kalit dhe kyçe atë gojë!

Kozeta u kthye nën tryezë.

-Ashtu është, keni të drejtë, - tha Tenardieja, - në qoftë se kafsha nuk ka pirë, duhet të pijë.

Mandej, duke parë rreth e rrotull:

-Ej, ku është ajo bija e botës?

U përkul dhe zbuloi Kozetën, që ishte strukur kutullaç në skajin tjetër të tryezës, pothuajse nën këmbët e atyre që po pinin.

-Do të vish këtu, apo jo? - bërtiti Tenardieja.

Kozeta doli nga ajo farë vrime ku qe fshehur. Tenardieja vazhdoi:

-Ti, zonjusha Bushtër, shko e jepi kalit të pijë.

-Por, zonjë, - tha Kozeta me zë të mekur, - është puna se s'ka ujë.

Tenardieja e hapi kat e kat portën e rrugës.

-Po mirë, shko e mbush!

Kozeta uli kryet dhe vajti të merrte një kovë të zbrazët që ishte te qoshja e oxhakut. Kjo kovë ishte më e madhe se Kozeta, dhe fëmija mund të ulej brenda në të dhe të qëndronte rehat.

Tenardieja filloi përsëri punën e vet te furra dhe shijoi me një lugë druri gjellën që ishte në tenxhere, duke vazhduar të llomotiste me gërnjë.

-Ujë ka te burimi. Është e vetmja për djallëzira ajo. Them se do të kisha bërë më mirë sikur t'i kisha tiganisur qepët.

Pastaj kërkoi në një sirtar, ku kishte ca *su*, piper të zi dhe hudhra.

-Na, ti, zonjusha Bretkosë, - shtoi ajo, - kur të kthehesh, të na marrësh edhe një bukë të madhe te furrtari. Na këtë monedhë pesëmbëdhjetësushe.

Kozeta kishte një xhep të vogël anës së përparës; e mori monedhën, pa thënë asnjë fjalë, dhe e vuri në xhep.

Pastaj qëndroi e shtangur me kovë në dorë, përpara portës së hapur. Dukej sikur priste t'i vinte dikush në ndihmë.

-Këput qafën! - bërtiti Tenardieja.

Kozeta doli. Porta u mbyll përsëri.

IV

Hyrja në skenë e një kukulle

Vargu i dyqaneve përjashta në shesh, siç ju kujtohet, niste nga kisha dhe shtrihej gjer te hani i Tenardieve. Këto dyqane, meqë pas pak do të kalonin borgjezët për të vajtur në meshë, ishin të gjitha të ndriçuara me llambadhe që digjeshin në fenerë letre, gjë që, siç thoshte mësuesi i shkollës së Monfermejtit, i ulur atë çast në tryezë te Tenardieja, bënte "një efekt magjik". Por, nga ana tjetër, asnjë yll nuk dukej në qiell.

Baraka e fundit, e vendosur pikërisht përballë portës së Tenardieve, ishte një dyqan lodrash për fëmijë, i cili shndriste i tëri nga xhixhat, qelqurinat dhe sendet farfuritëse prej teneqeje. Në radhën e parë, mu në ballë, tregtari kishte vendosur, në një sfond pecetash të bardha, një kukull të madhe, të lartë afro dy këmbë, veshur me një fustan krep i ngjyrë trëndafili, me kallinj ari mbi kokë, me ca flokë të vërtetë dhe me sy smalti. Gjithë ditën e ditës ajo qëndronte aty, dhe kalimtarët, më poshtë, se dhjetë vjeç, mbeteshin gojëhapur nga habia, por në Monfermej nuk gjendej ndonjë nënë aq e pasur ose aq dorëshpuar sa për ta blerë dhe për t'ia dhënë fëmijës së vet. Eponina dhe Azelma kishin kaluar aty orë të tëra duke e

soditur, edhe vetë Kozeta, tinëz, ç'është e vërteta, kishte guxuar ta vështronte.

Në çastin kur Kozeta doli me kovën në dorë, sado e zymtë dhe e dërrmuar që ishte, s'mundi të rrinte pa ngritur sytë nga ajo kukull e mrekullueshme, nga "*zonja*", siç e quante ajo. Fëmija e shkretë shtangu në vend si e ngrirë. Akoma s'e kishte parë nga afër këtë kukull. Gjithë ai dyqanth i dukej si ndonjë pallat; kukulla nuk ishte kukull, por ëndërr. Ishte gëzimi, shkëlqimi, pasuria, lumturia vetë, që shfaqeshin me njëfarë rrezatimi përrallor përpara asaj qenieje të vogël e fatkeqe, të zhytur aq thellë në një mjerim aq të kobshëm e të ftohtë. Kozeta maste me atë mprehtësinë naive dhe të trishtuar të fëmijës humnerën që e ndante nga ajo kukull. Ajo thoshte me vete se duhej të ishte mbretëreshë ose të paktën princeshë për të pasur një "gjë" të tillë. Ajo kundronte atë fustan të bukur ngjyrë trëndafili, ata flokë të bukur e të lëmuar dhe mendonte: "Sa e lumtur duhet të jetë kjo kukull!" Sytë e saj nuk mund të shqiteshin nga ai dyqan fantastik. Sa më shumë e vështronte, aq më shumë i lëbyreshin sytë nga shkëlqimi. I dukej sikur shikonte parajsën. Prapa së madhes kishte edhe kukulla të tjera, që i dukeshin si zana e shtojzovalle. Tregtari, që shkonte e vinte në fund të barakës së tij, i dukej Kozetës sikur ishte ati i amshuar.

Në këtë adhurim ajo harronte gjithçka, madje edhe detyrën që i kishin ngarkuar. Befas zëri i vrazhdë i Tenardiesë e solli përsëri në vete: "Si kështu, moj kuçkë? S'paske shkuar akoma? Dale, pa të erdha aty! Ç'dreqin kërkon ajo aty? Nisu, lugate e dreqit!"

Tenardieja kishte hedhur një sy në rrugë dhe kishte parë Kozetën, që po qëndronte e mahnitur.

Kozeta iku duke marrë me vete kovën dhe duke bërë hapa të mëdhenj, sa i hanin këmbët.

Vogëlushja mbetet fill vetëm

Duke qenë se hani i Tenardieve ndodhej në atë pjesë të fshatit që është pranë kishës, Kozeta duhej të shkonte e të mbushte ujë te burimi i pyllit nga krahu i Shelës.

Ajo nuk i hodhi më sytë nga asnjë tezgë e tregtarëve. Sa kohë që ishte në rrugën “Bulanzhe” dhe në rrethinat e kishës, dyqanet plot dritë ia ndriçonin udhën; por pas pak drita e fundit e barakës së fundit u zhduk. E shkreta fëmijë u gjend në mes të errësirës dhe u zhyt në këtë errësirë. Por, meqenëse po e pushtonte njëfarë dridhjeje, ndërsa ecte, ajo tundte mesa mundte vegjën e kovës. Zhurma që bëhej kësisoj, e shoqëronte vajzën e vogël.

Sa më shumë ecte, aq më i dendur bëhej terri. Rrugëve s’pipëtinte njeri fare. Megjithatë, ajo takoi një grua, e cila, kur e pa tek kalonte, u kthye dhe shtangu duke murmuritur nëpër buzë: “Ku vallë po shkon kështu kjo fëmijë? Mos është ndonjë fëmijë e ngjallur lugat? “Pastaj gruaja njohu Kozetën. “Pa shih, - tha ajo, - qenka Lauresha.”

Kozeta e përshkoi kështu labirintin e rrugëve të shkreta dhe plot dredha, ku merr fund fshati Monfermej nga krahu i Shelës. Sa kohë që pati shtëpi, qoftë edhe mure në të dyja anët e udhës së saj, Kozeta eci me mjaft guxim. Kohë më kohë ajo shikonte rrezet e ndonjë kandili përmes ndonjë kanate dritareje. Kur kishte dritë, kishte ca jetë, kishte njerëz të gjallë dhe kjo ia ngrohte zemrën. Ndërkohë, sa më shumë bënte përpara, aq më shumë e ngadalësonte ecjen, ashtu si mekanikisht. Kur e kaloi qoshen e shtëpisë së fundit, Kozeta u ndal në vend. Për të shkuar më tej se dyqani i fundit, kishte qenë e vështirë; por për të shkuar më tej se shtëpia e fundit, ecja po bëhej e pamundur. Vendosi kovën përdhë, zhyti dorën në flokë dhe filloi të kruante ngadalë kokën, lëvizte, kjo, e fëmijëve të cilëve u ka hyrë llahtara në palcë dhe s’dinë nga t’ia mbajnë. Tani s’ishte më Monfermeji, por arat. Hapësira e zezë

dhe e shkretë qëndronte përpara saj. Ajo e vështroi me dëshpërim këtë errësirë, ku s’kishte më njeri të gjallë, ku kishte shtazë, ku kishte ndoshta lugetër. Vështroi mirë dhe dëgjoi shtazët që ecnin nëpër bar, pa me sy shkoqur lugetërit që lëvrinin pemëve. Atëherë ajo e rrëmbeu përsëri kovën; frika i dha guxim: “Bah! - tha ajo, - do t’i them se s’kishte më ujë!”

Dhe u kthye me mendje top për në Monfermej.

Pa bërë akoma mirë njëqind hapa, ajo u ndal përsëri dhe nisi prapë të kruante kokën. Tani ishte Tenardieja ajo që i shfaqej përpara; Tenardieja e llahtarshme, me atë gojë prej çakalli dhe me atë tërbim që i flakërinte ndër sy. Fëmija hodhi një vështrim të përvajshëm përpara dhe prapa. Ç’të bënte? Nga t’ia mbante? Ku të mbytej? Përpara saj, hija e Tenardiesë; prapa, të gjitha fantazmat e natës dhe të pyllit. Por ajo u zmbrops përpara Tenardiesë. Mori përsëri udhën për nga burimi dhe filloi të ngiste me vrap. Doli nga fshati duke rendur, hyri në pyll duke rendur, duke mos vështruar më asgjë, duke mos mbajtur më vesh asgjë. E ndali vrapin vetëm atëherë kur iu mor fryma fare, por nuk e ndërpreu aspak të ecurit. Ajo shkonte përpara krejt e hutuar.

Tek ishte duke vrapuar, asaj i vinte për të qarë.

Dridhma mbrëmësore e pyllit e pushtonte fund e krye. Ajo nuk mendonte më, nuk shikonte më. Nata e pafundme qëndronte përballë asaj qenieje të vogël. Nga njëra anë, i tërë terri; nga ana tjetër, një kokrrizë.

Nga buza e pyllit gjer te burimi nuk mbante më shumë se shtatë a tetë minuta. Kozeta e dinte udhën, se e kishte bërë shumë shpesh ditën. Sa e çuditshme, udhën nuk e humbi fare. Një mbeturinë instinkti e udhëhiqte verbtazi. Por ajo nuk i hidhte sytë as djathtas, as majtas, nga frika se mos shikonte gjëra nëpër degët e nëpër ferrat. Kësisoj ajo arriti te burimi.

Burimi ishte si lug i ngushtë natyral, i gërryer nga ujët në një tokë argjilore, i thellë nja dy këmbë, i rrethuar me lëmyshk dhe me ato bimët e mëdha si ngjyrë mjalti që quhen “gushoret e Henrikut IV,” dhe i mbathur me disa gurë të mëdhenj. Nga ky lug rridhte një vijë uji, duke bërë një zhurmë të vogël e të qetë.

Kozeta nuk priti të merrte frymë. Bënte shumë errët, por ajo që mësuar të vinte në këtë krua. Kërkoj me dorën e majtë nëpër errësirë një dushk të ri që varej mbi burim dhe që zakonisht i shërbente si pikëmbështetje, hasi në një degë, u var pas saj, u përkuh dhe zhyti kovën në ujë. Ajo ndodhej në një çast aq të mundimshëm, sa forcat e saj ishin trefishuar. Në kohën kur ishte përkulur ashtu, ajo nuk vuri re që xhepi i përparës së saj u zbraz në burim. Monedha pesëmbëdhjetësushe ra në ujë. Kozeta as e pa dhe as e dëgjoi kur i ra. E hoqi kovën, të mbushur pothuajse plot, dhe e vendosi mbi bar.

Si e kreu këtë punë, ndjeu se ishte rraskapitur nga lodhja. Zemra ia desh fort që të ikte menjëherë; por përpjekja që kishte bërë për të mbushur kovën kishte qenë aq e madhe, sa nuk mundi të bënte asnjë hap përpara. U detyrua, pra, të ulej shesh. U lëshua deng mbi bar dhe qëndroi aty e strukur. Mbylli sytë, pastaj hapi përsëri, pa ditur përse, por pa mundur të bënte ndryshe.

Pranë saj, uji, që tundej në kovë, formonte ca rrathë që ngjisnin me ca gjarpërinj të zjarrtë, të bardhë.

Mbi kryet e saj, qielli ishte i mbuluar me re të mëdha e të zeza, që dukeshin si shtëllunga vigane tymi. Maska tragjike e hijes dukej sikur përkulej mbyturazi mbi këtë fëmijë.

Ylli Jupiter po perëndonte andej thellë.

Fëmija e vështronte me sy të çakërdisur atë yll të madh, që nuk e njihte, por që i shtinte frikën. Planeti, në të vërtetë, ndodhej atë çast shumë afër horizontit dhe po përshkonte një shtresë të trashë mjegulle, e cila i jepte një të kuq të llahtarshëm. Mjegulla, e skuqur për llahtar, e zgjeronte dhe e zmadhonte yllin akoma më shumë. Të thoshte mendja se ishte një plagë e shndritshme.

Një erë e ftohtë po frynte që nga fusha. Pylli ishte pus i errët, pa një fëshfërimë gjethesh, pa asnjë nga ato ndriçimet e vagëta e të freskëta të verës. Degë të mëdha ngriheshin llahtarshëm. Ca shkurre thatanike dhe të shëmtuara fishkëllenin lirishtave. Barërat e larta lëvrinin nga thëllimi si ngjala. Ferrat përdridheshin si krahë të gjatë e të armatosur

me çaponj dhe dukeshin sikur kërkonin të kapnin ndonjë gjah; disa gjethe shqopash të thata, të përzëna nga era, kalonin me shpejtësi dhe dukeshin sikur po iknin nga sytë këmbët e plot frikë përpara diçkaje që ngiste pas tyre. Nga të gjitha anët kishte hapësira kobzeza.

Errësira të merr mendtë. Njeriut i duhet dritë. Kujtdo që kridhet në të kundërtën e dritës, i ndrydhet zemra. Kur syri shikon terr, mendja shikon turbull. Në eklips, në terr, në cipën e zezë si bloza, edhe ata më të fortët e të fortëve ndiejnë një ankth të madh në shpirt. Askush nuk ecën dot vetëm në pyll natën pa u dridhur. Hijet dhe pemët janë dy shtresa që të kallin frikën. Në thellësinë e mjegullt shfaqet një realitet shimerik.^{*)} E pakonceptueshmja përvijohet disa hapa para teje me një përpikmëri fantastike. Njeriu sheh tek lundron në hapësirë ose në trurin e vet nuk di ç'gjë të vagët dhe të pakapshme, si ëndrrat e luleve të përgjumura. Në horizont ka qëndrime kërcënuese. Njeriu thith erën e keqe të zbrazësirës së madhe e të zezë. Edhe ka frikë, edhe i vjen të vështrojë prapa. Guvat e natës, gjithçka që është bërë si e çakërdisur, profilet e heshtura, që davariten e zhduken kur bën përpara, shkapërderdhjet e errëta, tufat e hakërryera, pllangat e zbehta, e përzishmja e pasqyruar tek e përmortshmja, hapësira prej varri e heshtjes, qeniet e panjohura që mund të dalin përpara, përkuljet e mistershme të degëve, trungjet e frikshme të drurëve, tufat e gjata të barit, që dridhen, kundër të gjitha këtyre gjërave njeriu është pa mbrojtje. S'ka trimëri që të mos dridhet dhe të mos pushtohet prej ankthit. Njeriu ndien diçka të lemerishme, sikur shpirti përzihet e bëhet një me terrin. Ky depërtim i territ është për fëmijën aq kobzi, sa nuk mund të shprehet.

Pa e kuptuar as vetë se çfarë po hiqte, Kozeta e ndiente veten të mbërthyer nga kjo hata e zezë e natyrës. Tani nuk ishte vetëm tmerrri që po e pushtonte, por diçka akoma më e tmerrshme se tmerrri. Ajo dridhej si purteka. Nuk mund të gjesh dot fjalë për të treguar se ç'gjë të çuditshme kishte ajo dridhje, që e ngrinte akull gjer në fund të zemrës. Syri i saj ishte egërsuar.

^{*)} Fantastik, i rremë.

Ajo ndiente ashtu vagët se s'do të kishte arsye pse të mos vinte përsëri të nesërmen aty, në të njëjtën orë.

Atëherë, e shtyrë nga një instinkt, për të dalë nga ajo gjendje e pazakontë, që s'e kuptonte se ç'ishte, por që i kallte frikë, filloi të numëronte me zë të lartë, një, dy, tre, katër, gjer më dhjetë, dhe, si mbaroi, ia nisi përsëri. Kjo e bëri t'i përcaktonte ashtu siç ishin me të vërtetë gjërat që e rrethonin. Ndjeu të ftohtët në duart e saj, që i qenë lagur duke mbushur ujë. U çua në këmbë. Frika e kishte pushtuar përsëri, një frikë e natyrshme dhe e pakapërcyeshme. I shkrepí vetëm një mendim në kokë, të ikte, të ikte me të katra, pyllit, arave, gjer te shtëpitë, gjer te dritaret, gjer te kandilet e ndezura. Vështrimi i saj ra mbi kovën, që ishte para saj. Aq e madhe ishte frika që i kallte Tenardieja, sa nuk guxoi të ikte pa kovën me ujë. E kapi vegjën me të dyja duart. E pati vështirë ta ngrinte kovën.

Bëri kështu nja dymbëdhjetë hapa, por kova ishte buzë më buzë, ishte e rëndë, kështu që u detyrua ta lëshonte përsëri përdhë. Mori frymë një hop, pastaj e kapi vegjën përsëri dhe nisi prapë të ecte, kësaj radhe për një kohë pakëz më të gjatë. Por iu desh të qëndronte prapë. Si u çlodh disa sekonda, u nis përsëri. Ajo ecte e kërrusur përpara me kokën të ulur, si ndonjë plakë. Pesha e kovës ia ndente dhe ia mpinte krahët e hollë. Vegja e hekurt ia kishte mpirë dhe bërë akull ato duar të vogla të lagura qull; kohë më kohë ishte e shtrënguar të qëndronte, dhe, sa herë qëndronte, ujët e ftohtë, që teptiste nga kova, derdhej mbi këmbët e saj të zbathura. Kjo ngjiste në thellësi të një pylli, natën, në dimër, larg çdo vështrimi njerëzor; ajo ishte një fëmijë tetë vjeç.

Ajo shfrynte me njëfarë gulçi plot dhembje; ngashërimet ia shtrëngonin grykën; por nuk guxonte të qante, kaq frikë kishte, frikë nga Tenardieja, madje edhe së largu. Asaj i qe bërë zakon dhe i dukej se Tenardieja ishte gjithmonë aty.

Ajo nuk mund të bënte shumë udhë në atë mënyrë, prandaj bënte përpara shumë ngadalë. Më kot e kishte pakësuar kohën e qëndrimeve dhe kishte ecur midis çdo pushimi sa kishte mundur më gjatë. Ajo mendonte me ankth se do t'i duhej më shumë se një orë për t'u kthyer kështu në Monfermeij dhe se

Tenardieja do ta kalbte në dru. Ky ankth pleksej me frikën që e kishte pushtuar, ngaqë ishte vetëm natën në pyll. Ajo ishte rraskapitur nga lodhja dhe akoma nuk kishte dalë nga pylli. Si arriti pranë një gështenje të moçme që e njihte, ajo bëri një qëndrim më të gjatë se të tjerët për t'u çlodhur mirë, pastaj përmblodhi të gjitha fuqitë e veta, e kapi përsëri kovën dhe u nis prapë për udhë me guxim. Por krijesëza e dëshpëruar nga mundi, nuk u përmbajt dot dhe thirri: "O Zot! O Zoti im!"

Në atë çast, ajo ndjeu befaz që kova e saj nuk peshonte më fare. Një dorë, e cila iu duk e stërmadhe, kishte kapur vegjën dhe po e çonte peshë me fuqi të madhe. Ajo ngriti kokën. Një formë e madhe, e zezë, e drejtë dhe në këmbë, po ecte pranë saj në errësirë. Ishte një burrë, që kishte ardhur prapa saj dhe që ajo s'e kishte ndier tek vinte. Ai burrë, pa thënë asnjë fjalë, kishte kapur vegjën e kovës që mbante ajo.

Ka disa instinkte për të gjitha takimet në jetë. Fëmija s'pati frikë.

IV

Këtu provohet ndoshta zgjuarsia e Bulatryelit

Në pasdrekën e po asaj dite të krishtlindjeve të vitit 1823, një burrë u end për një kohë mjaft të gjatë në pjesën më të shkretë të Bulevardit të Spitalit në Paris. Ky burrë dukej si një njeri që kërkon ndonjë shtëpi për banim dhe, siç duket, i pëlqente të ndalej te shtëpitë më të thjeshta të kësaj buze të ronitur të rrethinës "Sen-Marsò".

Siç do ta shohim më tutje, ai burrë kishte zënë vërtet një dhomë me qira në këtë lagje të vetmuar.

Ai burrë, me veshjen dhe me gjithë personin e vet, përfaqësonte atë tip që mund të quhet lypës i kulturuar, përfaqësonte mjerimin më të madh, të gërshetuar me pastërtinë më të madhe. Kjo ishte një përzierje mjaft e rrallë, që u frymëzon zemrave të mençura atë respektim të dyfishtë që ndien njeriu

për atë që është shumë i varfër dhe për atë që është shumë i denjë. Ai kishte një kapele të rrumbullakët, të vjetër fare të ngrënë nga furça, një redingotë të ronitur, sa i kishte dalë indi, prej stofi të trashë ngjyrë të verdhë si në të murrme, ngjyrë, kjo, që nuk dukej tepër e pazakontë në atë kohë, një jelek të madh me xhepa, që kishin një formë që s'u ikën moda kurrë, pantallona të zeza, që ishin bërë ngjyrë hiri te gjunjët, çorape leshi të zeza dhe këpucë të trasha me tokëza prej bakri. Të thoshte mendja se ishte një edukator i ndonjë familjeje të mirë që kthehej nga mërgimi. Nga flokët krejt të bardhë, nga balli plot rrudha, nga buzët pa ngjyrë, nga fytyra, ku gjithçka pasqyronte peshën dhe rraskapitjen nga jeta, këtij burri mund t'i jepje me hamendje më shumë se gjashtëdhjetë vjeç. Nga ecja me hapa të sigurt, megjithëse të ngadalshëm, nga forca, që spikaste në të gjitha lëvizjet e tij, do t'i jepje pesëdhjetë vjeç. Rrudhat e ballit i shkonin dhe të linin një përshtypje të mirë, në qoftë se do ta këqyrje me vëmendje. Buza e tij tkurrej duke bërë një rrudhë të çuditshme, dhe dukej e vrazhdë, por, në të vërtetë, ishte e përvuajtur. Kishte në thellësi të vështrimit të tij nuk di se ç'dëlirësi të përzishme. Mbante në dorën e majtë një paketë të vogël, të lidhur me një shami; me dorën e djathtë, ai mbështetej mbi njëfarë shkopi, që dukej se ishte prerë në ndonjë gardh. Ai shkop ishte punuar me njëfarë kujdesi dhe nuk kishte ndonjë pamje fort të keqe; ai që e kishte punuar, kishte shfrytëzuar nyjet dhe i kishte sajuar një dorezë ngjyrë koralit prej dylli të kuq; ai qe një dajak, por dukej si ndonjë bastun.

Pak kalimtarë ka në këtë bulevard, sidomos dimrit. Ky njeri, megjithëse qe i thjeshtë e jo i shtirë, dukej sikur u shmangej kalimtarëve, në vend që t'u afrohej.

Në këtë epokë, mbreti Luigj XVIII shkante pothuajse çdo ditë në "Shuazi-lë-Ruà".¹⁴⁰⁾ Kjo ishte një nga ato shëtitjet e tij që ai parapëlqente më shumë. Aty nga ora dy, pothuajse pa e ndryshuar kurrë, njerëzit shikonin karrocën dhe kavalerinë mbretërore tek kalonin me shpejtësi të madhe në Bulevardin e Spitalit.

Kjo gjë u shërbente si punë sahati grave të varfra të lagjes,

që thoshin: "Vajti ora dy, ja tek po kthehet në Pallatin e Tuilërive".

Dhe një palë ngarendnin, dhe një palë të tjerë rreshtoheshin për të lëshuar udhë; sepse, kur kalon një mbret, bëhet gjithmonë zallamahi e madhe. Zaten, shfaqja dhe zhdukja e Luigjit XVIII bënte njëfarë efekti në rrugët e Parisit. Kjo ishte diçka e shpejtë, por madhështore. Ky mbret i pafuqishëm e kishte shumë qejf galopin e madh, ngaqë s'mund të ecte, ai deshte të ngiste me vrap; ky gjysmë uloku do të pranonte me gjithë zemër që karrocën e tij ta tërhiqte vetëtima. Ai kalonte i qetë dhe hijerëndë midis shpatave të zhveshura. Karroca e tij e rëndë, e larë krejt në ar, me degë të mëdha zambaku, të pikturuara faqeve, rrëshqiste me potere të madhe. Njerëzit sa mezi arrinin t'i hidhnin një vështrim. Ata shikonin në këndin e fundit në të djathtë, mbi ca jastëkë prej sateni të bardhë, një fytyrë të gjërë, të palëvizur dhe të kuqe si gjaku, një ballë të pudrosur taze, një sy të kapardisur, të ashpër dhe dinak, buzëqeshjen e një njeriu të kënduar, dy supëza të mëdha me gajtanë të pleksur, që vareshin e tundeshin mbi një kostum borgjez. Bashka e Artë, kryqi i Shën-Luigjit, kryqi i Legjionit të Nderit, pllaka e argjendte e Shpirtit të Shenjtë një bark i fryrë dhe një kordon mavi, ky ishte mbreti. Jashtë Parisit ai e mbante kapelën me pupla të bardha mbi gjunjët e tij të mbështjellë me gete të gjata angleze; kur kthehej në qytet, ai e vinte kapelën në kokë, duke përshëndetur pak. Ftohtë e shikonte popullin, por edhe populli ashtu ia kthente. Kur u shfaq për herë të parë në lagjen "Sen-Marsò", gjithë sukcesi që korri, ishte kjo fjalë që një banor i rrethinave i tha shokut të vet: "Ja, ai trashamani atje është qeveria".

Ky kalim i pashmangshëm i mbretit në të njëjtën orë ishte, pra, ngjarja e përditshme e Bulevardit të Spitalit.

Shëtitësi me redingotë të verdhë, mesa dukej, nuk ishte banor i lagjes, dhe ndoshta as i Parisit, sepse ai nuk e dinte këtë hollësi. Atëherë, kur në orën dy, karroca mbretërore, e rrethuar nga një skuadër kalorësish të gardës mbretërore me supëza të argjendta, ia behu në krye të bulevardit, pasi bëri kthesë në "Salpetrierë," shëtitësi u habit dhe pothuajse u

frikësua. Vetëm ai ishte në rrugëzën anash bulevardit dhe u rras me vërtik prapa një qosheje të murit rrethues, por kjo nuk e pengoi zotin dukë Dë Havrë ta vinte re. Zoti dukë Dë Havrë, si kapiten i gardës, së shërbimit asaj dite, ishte ulur brenda në karrocë ballë për ballë me mbretin. Ai i tha madhërisë së tij: "Ja një njeri me fytyrë të dyshimtë". Njerëz të policisë, që pastronin udhën ku kalonte mbreti, gjithashtu e vunë re, dhe njëri syresh mori urdhër që t'i binte pas. Por njeriu u fut në rrugët e ngushta dhe të shkreta të lagjes, dhe, meqenëse po ngrysej, agjenti ia humbi gjurmën, ashtu sikurse është konstatuar nga një raport, paraqitur po atë mbrëmje zotit kont D'Angles, ministër shteti, prefekt i policisë.

Pasi iu vodh agjentit të policisë, njeriu me redingotën e verdhë nxitoi hapin duke kthyer shumë herë kokën prapa për t'u siguruar se s'po e ndiqte më njeri nga pas. Në orën katër e një çerek, domethënë si u errësua fare, ai kalonte përpara teatrit të Portë-Sen-Martenit, ku shfaqej atë ditë drama "*Dy të burgosurit me punë të detyruar*". Kjo afishe, e ndriçuar nga fenerët e teatrit, i tërhoqi vëmendjen, sepse, megjithëse po nxitonte, ai u ndal për ta lexuar. Pas një hapi u ndodh në rrugën e verbër të "Planshetës" dhe hyri te "Pjata e Kallajit", ku ishte asokohe zyra e karrocës së Lanjisë. Kjo karrocë nisej në orën katër e gjysmë. Kuajt ishin të mbrehur, dhe udhëtarët, të thirrur prej karrocierit, i qepeshin me vrap shkallës së hekurt të karrocës me dy rrota.

Njeriu pyeti:

-A keni ndonjë vend?

-Vetëm një, bri meje, në ndenjësën time, - tha karrocieri.

-E pranoj.

-Hipni.

Ndërkohë, para se të nisej, karrocieri i hodhi një sy kostumit të varfër të udhëtarit, pakos së vogël dhe kërkoi të paguhej në dorë.

-Do të shkoni gjer në Lanji? - pyeti karrocieri.

-Po, - tha njeriu.

Udhëtari pagoi për deri në Lanji.

U nisën. Kur kaluan barrierën, karrocieri u përpoq të lidhte

bisedë, por udhëtari përgjigjej vetëm me fjalë njërrokëshe. Atëherë karrocieri filloi t'u fishkëllente e t'u shfrynte mallkime kuajve.

Karrocieri u mbështoll me pallton e vet. Bënte ftohtë. Njeriu dukej sikur s'e kishte mendjen fare te të ftohtët. Kaluan kësisoj Gurnejin dhe Nëji-syr-Marnën.

Aty nga ora gjashtë arritën në Shelë. Karrocieri u ndal, për t'i lënë kuajt të merrnin pak frymë, përpara hanit të qiraxhinjve, të vendosur në ndërtesat e vjetra të abacisë mbretërore.

-Po zbres këtu, - tha njeriu.

Mori pakon dhe shkopin dhe kërcëu poshtë nga karroca. Pas pak ai qe zhdukur. Në han nuk hyri fare.

Kur, pas disa minutash, karroca u nis përsëri për në Lanji, ajo nuk e takoi në rrugën e madhe të Shelës.

Karrocieri u kthye nga udhëtarët që ishin brenda e u tha:

-Ky njeri nuk qenka prej këtej, sepse nuk e njoh. Duket sikur s'ka asnjë pesësh në xhep, mirëpo paraja s'i bëka fare përshtypje; paguan për në Lanji dhe vete vetëm gjer në Shelë. Tani është natë, dhe të gjitha shtëpitë janë të mbyllura, në han nuk hyri dhe s'duket gjëkund. Do ta ketë përpirë dheu.

Njeriun nuk e kishte përpirë dheu; ai kishte kaluar me hapa të mëdhenj gjatë rrugës kryesore të Shelës, nëpër terr; pastaj kishte marrë majtas, para se të kapte udhën e tërthortë te kisha, që shpinte në Monfermej, tamam si ndonjë njeri që e njihte vendin dhe që kishte ardhur aty edhe më përpara.

E vazhdoi këtë udhë me shpejtësi. Te vendi ku kjo udhë pritej nga rruga e vjetër e mbjellë anash me pemë dhe që shkonte nga Ganjia në Lanji, ai dëgjoi që po vinin disa kalimtarë. U fsheh shpejt e shpejt në një hendek dhe priti aty gjersa të largoheshin njerëzit. Ky kujdes ishte pothuajse i tepërt, sepse, siç e kemi thënë edhe më parë, ishte një natë dhjetori sterrë e zezë. Mezi mund të shikoje dy a tri yje në qiell.

Pikërisht tek ajo pikë fillon e përpjeta e kodrës. Njeriu nuk i hyri rrugës së Monfermejit, por mori në të djathtë, përmes arave, dhe zuri pyllin me hapa të mëdhenj.

Kur u gjend në pyll, e ngadalësoi ecjen dhe filloi të

vështronte me kujdes të madh të gjithë drurët, duke qëndruar në çdo hap, sikur kërkonte dhe ndiqte një rrugë misterioze, që vetëm ai e njihte. Një hop u duk sikur e humbi tragën dhe qëndroi, duke mos ditur se ç'të bënte. Më në fund, duke kërkuar verbatazi andej e këtej, arriti në një lirishtë ku kishte një kapicë me gurë të mëdhenj, të zbardhëlyer. Bëri me të shpejtë për nga këta gurë dhe i vërejti me vëmendje përmes mjegullinës së natës, sikur t'i kalonte në revistë. Disa hapa larg togut të gurëve ndodhej një pemë e madhe, plot me gunga si çibanë bimorë. Vajti tek ajo pemë dhe hodhi dorën mbi koren e trungut, sikur donte të njihte dhe të numëronte të gjitha gungat.

Ballë për ballë këtij druri, që ishte një frashër, ndodhej një gështenjë e sëmurë e me lëkurë të ronitur, së cilës i kishin vënë një shirit zinku të mbërthyer me gozhdë. U ngrit në majë të këmbëve dhe preku me dorë atë shirit zinku.

Pastaj rrahu për njëfarë kohe me këmbë dheun në hapësirën që përfshihej midis pemës dhe gurëve, si ndonjë që kërkon të sigurohet se toka nuk ka qenë trazuar rishmë.

Si e bëri këtë punë, ai u drejtua dhe mori përsëri udhën e tij përmes pyllit.

Ky ishte ai burri që sapo kishte takuar Kozetën.

Duke ecur përmes shkurreve në drejtim të Monfermejit, atij i kishte zënë syri atë hije të vogël që lëvizte duke rënkuar, që lëshonte një barrë përtokë, pastaj e merrte përsëri dhe përsëri fillonte të ecte. Ishte afruar dhe kishte parë se kjo hije qe një fëmijë fare e njomë, e ngarkuar me një kovë shumë të madhe me ujë. Atëherë kishte shkuar drejt fëmijës dhe kishte kapur pa u ndier vegjën e kovës.

VII

Kozeta krah për krah nëpër terr me të panjohurin

Kozeta, siç e thamë, nuk ishte trembur fare.

Njeriu i foli. Ai fliste me zë të rëndë dhe pothuajse të ulët.

-Bija ime, kjo që po mbani ju, është shumë e rëndë.

Kozeta ngriti kokën dhe u përgjigj:

-Po, zotëri.

-Ma jepni mua, - vazhdoi njeriu. - Do t'jua mbaj unë.

Kozeta e lëshoi kovën. Njeriu filloi të ecte pranë saj.

-Me të vërtetë qenka shumë e rëndë, - tha ai nëpër dhëmbë.

Pastaj shtoi:

-Vogëlushe, sa vjeç je?

-Jam tetë vjeç, zotëri.

-Dhe po vjen që larg kështu?

-Po vij nga burimi që është në pyll.

-Po a është larg vendi ku po vete?

-Do një çerek ore të mirë prej këtu.

Njeriu ndenji një hop pa folur, pastaj tha befas:

-S'paske nënë?

-Nuk e di, - u përgjigj fëmija.

Para se njeriu të kishte kohë të merrte përsëri fjalën shtoi:

-Nuk besoj. Të tjerët kanë nënë. Unë nuk kam.

Dhe pas një heshtjeje, ajo filloi përsëri:

-Më thotë mendja se s'kam pasur kurrë nënë.

Njeriu qëndroi në vend, lëshoi kovën përtokë, u përkul dhe vuri duart mbi të dyja supet e fëmijës, duke u përpjekur ta vështronte dhe të shihte fytyrën e saj në terr. Fytyra e thatë dhe e imët e Kozetës vizatohej vagët në dritën e zbehtë të qiellit.

-Si ta thonë emrin? - tha njeriu.

-Kozetë.

Njeriu u hodh përpjetë, sikur ta kishte dredhur korrenti elektrik. Vështroi akoma; pastaj i hoqi duart nga supet e Kozetës, rrëmbeu kovën dhe filloi përsëri të ecte.

Pas një hopi ai e pyeti:

-Ku banon ti, vogëlushe?

-Në Monfermej, në qoftë se e dini.

-Atje po vemë tani?

-Po, zotëri.

Heshti edhe një hop, pastaj filloi përsëri:

-Kush të paska dërguar kështu, në këtë orë, të marrësh ujë në pyll?

-Zonja Tenardie.

Njeriu ia ktheu me një zë, që, megjithëse ai përpiqej ta bënte të dukej moskokëçarës, kishte një të dridhur të pazakontë.

-E çfarë bën kjo zonja Tenardie?

-Është zonja ime, - tha fëmija. - Ka një han.

-Paska han? - tha njeriu. - Eh, pra, unë do të vete të fle sonte atje. Shpërmë.

-Atje po shkojmë, - tha fëmija.

Njeriu ecte mjaft shpejt. Kozeta i vinte pas, pa ndonjë vështirësi. Tani ajo nuk e ndiente më lodhjen. Kohë më kohë ajo ngrinte sytë drejt këtij njeriu me njëfarë qetësie dhe lehtësimi që nuk mund të shprehen... Ajo ndiente në veten e saj diçka që përngjiste me shpresën dhe gëzimin.

Kaluan kështu disa minuta. Njeriu filloi përsëri:

-Nuk ka ndonjë shërbëtores te zonja Tenardie?

-Jo, zotëri.

-Po ti, vetëm je?

-Po zotëri.

Pati përsëri edhe një ndërprerje. Kozeta ngriti zërin:

-Desha të them që ka dy vajza të vogla.

-Ç'vajza të vogla?

-Ponina dhe Zelma.

Kështu i thjeshtësonte fëmija emrat romaneskë, që i kishte aq për zemër Tenardieja.

-Ç'janë këto Ponina dhe Zelma?

-Janë zonjushat e zonjës Tenardie, si të thuash bijat e saj.

-Dhe ç'bëjnë ato?

-Oh! - tha fëmija, - ato kanë kukulla të bukura, gjëra të

veshura me ar, plot gjëra të bukura. Ato luajnë dhe kënaqen.

-Gjithë ditën?

-Po, zotëri,

-Po ti?

-Unë? Unë punoj.

-Gjithë ditën?

Fëmija ngriti sytë e saj të mëdhenj ku bulonte një lot, që nuk shihej, se qe natë, dhe u përgjigj ngadalë:

-Po, zotëri.

Ajo vazhdoi pasi heshti një hop:

-Herë-herë, kur kam mbaruar punët dhe kur më lejojnë, edhe unë argëtohem.

-Si argëtohesh?

-Ashtu, si mundem. Më lënë e s'më thonë gjë. Por unë nuk kam shumë lodra. Ponina dhe Zelma nuk duan që unë të luaj me kukullat e tyre. Kam vetëm një shpatë prej plumbi, jo më të gjatë se kaq.

Fëmija tregoi gishtin e saj të vogël

-Dhe që nuk pret?

-Posi, zotëri, - tha fëmija, - ajo pret sallatën dhe kokat e mizave.

Arritën në fshat. Kozeta e udhëhoqi të huajin nëpër rrugë. Ata kaluan përpara furrës, por Kozetës as që i shkoi nder mend për bukën, që duhej të merrte. Njeriu nuk po i bënte më pyetje dhe ruante tani një heshtje të zymtë. Kur lanë prapa kishën, njeriu, duke parë të gjitha ato dyqanka të ngritura në shesh, e pyeti Kozetën:

-Panair u bëka këtu?

-Po, zotëri, janë krishtlindjet.

Tek po arrinin te hani, Kozeta i preku krahun, ashtu si me druajtje.

-Zotëri?

-Ç'është, bija ime?

-Erdhëm afër shtëpisë.

-E pastaj?

-Tani, ju lutem, do të ma lini mua ta marr kovën.

-Pse?

-Sepse, po e pa zonja se ma ka mbajtur dikush tjetër, do të më rrahë.

Njeriu ia dorëzoi kovën. Pas një hopi ata u ndodhën te porta e hanit.

VIII

*S'ta ka ënda të presësh në shtëpi një të varfër,
i cili ndoshta është i pasur*

Kozetës nuk iu durua pa i hedhur një sy vjedhurazi asaj kukullës së madhe që ishte vendosur në dyqanin e çikërrimtarit, pastaj trokiti. Porta u hap. Tenardieja ia behu me një kandil në dorë.

-Ah, qenke ti, moj ditëshkurtër? Nga e theve qafën që u vonove kaq shumë? Do të ketë luajtur rrugës kjo dreqe!

-Zonjë, - tha Kozeta duke u dridhur e tëra, - ky zotëria ka ardhur në han për të fjetur.

Tenardieja i dha menjëherë fytyrës së saj të xhindosur një shprehje të ngërdheshur plot dashamirësi, ndërrim i atypëratyshëm, që është një veti e hanxhinjve, dhe e përpiu me sy plot lakmi të porsaardhurin.

-Zotëria e tij është? - tha ajo.

-Po, zonjë, - u përgjigj njeriu duke vënë dorën te kapela. Udhëtarët e pasur nuk janë kaq të sjellshëm. Ky gjest, si dhe vëzhgimi që i bëri Tenardieja kostumit dhe bagazhit të të huajit me një sy që i hodhi, bënë që ajo ngërdheshje plot dashamirësi të zhdukej dhe të zëvendësohej me fytyrën e inatosur. Ajo vazhdoi thatë:

-Hyni, xhaxho.

"Xhaxhoja" hyri brenda. Tenardieja i hodhi edhe një sy tjetër, shqyrtoi veçanërisht redingotën e tij, e cila ishte fare e rrjepur, dhe kapelën e tij, e cila ishte pak e zhbravitur, dhe me një të lëvizur të kokës, me një të mbledhur të hundës dhe me një të shkelur të syrit u konsultua me të shoqin, i cili po

pinte akoma me qiraxhinjtë. I shoqi u përgjigj me atë lëvizje të pakapshme të gishtit tregues dhe me atë të varur të buzëve, që, në raste të tilla, duan të thonë: qenka fare i rënë nga dynjallëku. Si rrjedhim, edhe Tenardieja bërtiti:

-Për besë, more xhaxho, është puna se s'kam vend fare tani.

-Vendosmëni ku të doni, - u përgjigj njeriu. - Në papafingo, në haur, ku të jetë. Unë do të paguaj sikur të më kishit dhënë një dhomë.

-Dyzet su.

-Dyzet su, Ashtu qoftë.

-Shyqyr që u morëm vesh!

-Dyzet su! - i tha një qiraxhi Tenardisë, - por një dhomë bën vetëm njëzet su.

-Për atë dyzet su bën, - ia ktheu Tenardieja me të njëjtin ton. - Të varfërve kaq u marr unë.

-Ashtu është, - shtoi i shoqi me zë të butë, - sepse prishet shtëpia, po fute kësi mileti brenda.

Ndërkohë njeriu kishte lënë mbi një bankë paketën dhe shkopin dhe ishte ulur në një tryezë, ku Kozeta kishte vendosur me vrap një shishe me verë dhe një gotë. Tregtari që kishte kërkuar kovën me ujë, vajti t'ia shpinte kalit me dorën e vet. Kozeta kishte zënë përsëri vendin e saj nën tryezën e kuzhinës dhe kishte marrë në dorë çorapin.

Njeriu, i cili sa kishte lagur buzët me verë, që e kishte shtënë në gotë me dorën e vet, po e kundronte fëmijën me një vëmendje të çuditshme.

Kozeta ishte e shëmtuar. Po të kishte qenë e lumtur, ndoshta do të ishte edhe e bukur. Pak përpara e patëm përvijuar këtë fytyrë të vogël e të zymtë. Kozeta që thatanike e verdhacuke. Ishte afro tetë vjeç, por nuk mund t'i jepej më shumë se gjashtë vjeç. Sytë e saj të mëdhenj, të zhytur në njëfarë hijeje të thellë, ishin fikur fare pothuajse nga të qarët. Cepat e gojës së saj kishin një të përkulur ankthi të përhershëm, që mund të vihet re te të dënuarit dhe të sëmuret e dëshpëruar. Duart e saj ishin, ashtu siç e kishte marrë me mend e ëma, "të mbufatura nga të ftohtët". Zjarri, që po e ndriçonte në këtë çast,

ia nxirrte akoma më shumë në pah gungat e kokallave dhe e bënte trupin e saj të dukej tmerrësisht i thatë. Meqë dridhej gjithmonë nga të ftohtët, ajo e kishte zakon të shtrëngonte gjunjët njërin pas tjetrit. Gjithë veshja e saj nuk ishte gjë tjetër veçse një zhele, e cila të ngjallte keqardhje në verë dhe të fuste llahtarë në dimër. Mbi trupin e saj, ajo kishte vetëm një beze vrima-vrима; asnjë copë leckë të leshtë. Mund t'ia shikoje vende-vende edhe lëkurën dhe mund të shquaje kudo njolla të mavia dhe të zeza, të cilat tregonin vendet ku Tenardieja kishte vënë dorë. Kofshët e saj të zhveshura ishin të skuqura dhe të holla si shkopinj. Gropat e qafës ishin të tilla, sa të vinte për të qarë kur i shikoje. Gjithë qenia e asaj fëmije, të ecurit, qëndrimi, tingulli i zërit, koha që ndante një fjalë nga tjetra, vështrimi, heshtja, gjesti i saj më i vogël, shprehnin dhe pasqyronin një ide të vetme: frikën.

Frika që shpërndarë mbi të tejetej, ajo, si të thuash, e mbulonte anë e kënd; frika e bënte atë të puthiste bërrylat pas ijeve, të tërhiqte thembrat nën fustan, e bënte të zinte sa më pak vend që të ishte e mundur, e linte të merrte vetëm aq frymë sa ishte e domosdoshme dhe asnjë grimë më shumë, dhe i qe bërë, si të thuash, shprehi e trupit të saj, që nuk ndryshonte, në mos po vetëm shtoej. Në fund të bebes së syrit të saj ajo kishte një kënd të habitur, ku qëndronte tmërri.

Kjo frikë ishte aq e madhe, sa Kozeta, edhe pse kishte ardhur e lagur qull, nuk kishte guxuar të shkonte e të thahej pas zjarrit dhe kishte filluar përsëri në heshtje punën e vet.

Shprehja e vështrimit të kësaj fëmije tetëvjeçare ishte zakonisht aq e zymtë dhe hera-herës aq tragjike, sa dukej në disa çaste sikur po shndërrohej në idiote ose në demone.

Njeriu me redingotë të verdhë nuk ia hiqte sytë Kozetës.

-Pa dale, se m'u kujtua! Po bukën ku e ke?

Kozetës i ishte bërë zakon që, sa herë bërtiste Tenardieja me zë të lartë, të dilte shpejt e shpejt që poshtë tryezës.

Ajo e kishte harruar fare atë bukën e shkretë. Gjetei rrugëdaljen e fëmijëve që janë gjithmonë të trembur. Gënjeu.

-Zonjë furrtari e kishte mbyllur.

-Duhej të trokisje.

-Po trokita, zonjë.

-E pastaj?

-Nuk e hapi.

-Do ta marr vesh nesër në është e vërtetë, - tha Tenardieja, - dhe, në më paç gënjer, moj e zezë, do të të bëj unë të kërcesh me një këmbë... Hëpërhë kthemi të pesëmbëdhjetë *sutë* këtu.

Kozeta futi dorën në xhepin e përparësës dhe u bë e tëra jeshil. Monedha pesëmbëdhjetësushe s'ishte më në xhep.

-Moj ti, - tha Tenardieja, - dëgjon ç'po të them, apo jo?

Kozeta e përveshi xhepin, por aty s'kishte gjë fare. Ç'të ishin bërë vallë ato para? Vogëlushja e varfër s'gjetei dot fjalë të nxirrte nga goja. Kishte ngrirë e qe bërë gur.

-Mos i ke humbur paratë, moj ditëshkurtër? - gulçoi Tenardieja, - apo mos do edhe të na vjedhësh?

Në të njëjtën kohë ajo zgjati dorën drejt kamxhikut të varur tek oxhaku. Ky gjest frikësues i dha Kozetës fuqi të thërriste:

-Falmëni, zonjë, falmëni! Nuk do ta bëj më.

Tenardieja zhvari kamxhikun.

Ndërkohë njeriu me redingotë të verdhë kishte futur dorën në xhepin e jelekut të vet, pa e vënë kush re këtë lëvizje. Nga ana tjetër, udhëtarët e tjerë po pinin dhe po luanin me letra dhe s'e kishin mendjen gjëkund.

Kozeta po strukej kutullaç në qoshen e oxhakat, duke u përpjekur të mblidhte dhe të fshihte gjymtyrët e saj të shkreta e gjysmë lakuriqe. Tenardieja ngriti krahun.

-Më falni, zonjë, - tha njeriu, - por unë sapo pashë që ra nga xhepi i përparësës së kësaj fëmije të vogël një diçka që u rrëkëllye përdhe. A mos është kjo?

Në të njëjtën kohë ai u përkul dhe bëri një hop sikur diçka po kërkonte.

-Tamam. Ja ku qenka, - vazhdoi ai duke u ngritur.

Dhe i dorëzoi Tenardiesë një monedhë argjendi.

-Po, kjo është, - tha ajo.

S'ishte ajo, sepse monedha që mori ishte njëzetsushe, por Tenardieja në këtë mes dilte e fituar. Ajo e vuri monedhën në xhep dhe s'bëri gjë tjetër veçse i hodhi fëmijës një vështrim të hakërryer duke thënë:

-Shiko se mos e bësh dhe herë tjetër këtë që bëre, se ta mora shpirtin.

Kozeta u fut përsëri në atë që Tenardieja quante "kamare" dhe, duke ia ngulur sytë e saj të mëdhenj udhëtarit të panjohur, filloi të merrte një shprehje që kurrë nuk e kishte pasur. S'ishte akoma veçse një habitje naive, por në këtë shprehje përzihej një besim plot habi.

-Mirë që u kujtova, mos doni të hani darkë? - e pyeti Tenardieja udhëtarin.

Ai nuk u përgjigj. Dukej se kishte rënë në mendime të thella.

-Çfarë njeriu qenka dhe ky kështu? - tha ajo nëpër dhëmbë. - Do të jetë ndonjë i varfër copë e trokë. Ky s'do të ketë asnjë dysh për të ngrënë darkë. A do të ma paguajë vallë, të paktën, qiranë e hanit? Megjithatë, shyqyr zotit, që s'i ra ndër mend të vidhte paratë që ishin përtokë.

Ndërkohë ishte hapur një derë dhe kishin hyrë brenda Eponina dhe Azelma.

Ato ishin me të vërtetë dy vajza të vogla e të bukura, më shumë qytetare se fshatare, shumë të lezetshme, njëra me gërsheta ngjyrë gështenjë të ndritshme, tjetra me bishtaleca të gjatë, të zez, që i binin prapa kurrizit; të dyja të gjalla, të pastra, të ardhangëta, të kizëta e të shëndetshme, që ta kishte ënda t'i shikoje me sy. Ishin veshur me petka të ngrohta; por me një art aq amësor, sa trashësia e stofrave nuk e prishte aspak hijeshinë e qepjes së veshjes. Në këto veshje ishte parashikuar edhe stina e dimrit, por as pranvera nuk qe lënë pas dore. Nga ato dy vajza të vogla shpërthente drita. Veç kësaj, ato ishin si mbretëresha në shtëpi të tyre: në gazin e tyre, në zhurmën që bënin spikaste një pushtet sovran. Kur hynë brenda, Tenardieja u foli me një ton qortues, por tërë adhurim:

-Ah, erdhët edhe ju të dyja, tani!

Pastaj, duke i marrë mbi gjunjë njërën pas tjetrës, duke ua pilluar flokët, duke ua lidhur fjongot dhe duke i lëshuar pastaj me nga një dackëz ledhatuese nga pas, ashtu siç e kanë nënat, ajo u bërtiti: "Ç'më qenkeni veshur kështu, si dengje!"

Ato erdhën e u ulën te qoshja e zjarrit. Kishin një kukull,

të cilën e kthenin dhe e rrotullonin mbi gjunjët e tyre me gjithfarë britmash e belbëzimesh të gëzuara. Kohë më kohë Kozeta ngrinte sytë nga puna dhe i shikonte tek luanin, me një vështrim të përzishëm.

Eponina dhe Azelma nuk ia hidhnin sytë fare Kozetës. Kozeta për to ishte njëlloj si qeni. Këto tri vajza të vogla nuk mbushnin tok as njëzet e katër vjet, e megjithatë ato përfaqësonin të tërë shoqërinë e njerëzve: nga njëra anë, lakmia, nga tjetra, përbuzja.

Kukulla e motrave Tenardie ishte e shpëlarë shumë, shumë e vjetër dhe gjithandej e thyer dhe e plasaritur, e, megjithatë. Kozetës nuk i dukej më pak e admirueshme, sepse ajo gjithë jetën e saj nuk kishte pasur asnjëherë ndonjë kukull, "një kukull të vërtetë", për të përdorur një shprehje, të cilën të gjithë fëmijët do ta kuptojnë.

Papritmas Tenardieja, e cila vazhdonte të shkante e të vinte nëpër sallë, vuri re se Kozeta e kishte humbur mendjen dhe, në vend që të punonte, po merrej duke vështruar vajzat që po luanin.

-Ah! Të zura, - bërtiti ajo. - Kështu punuake ti, hë!? Hajde, se ta tregoj unë si punohet, me atë kamxhikun aty.

I huaji, pa u larguar nga karrigia, u kthye nga Tenardieja:

-Zonjë, tha ai duke buzëqeshur me një pamje gati të druajtur, - s'u bë gjë! Lëreni të luajë.

Po të ishte ndonjë udhëtar që të kishte ngrënë ndonjë copë kofshë qengji dhe të kishte pirë nja dy shishe verë për darkë dhe të mos e kishte atë pamjen e një "skamësi të mjerë", një dëshirë e tillë nuk do t'i qe bërë dysh dhe do t'i qe pranuar si urdhër. Por një njeri si ai, me atë kapelë, të guxonte të kishte një dëshirë dhe, me një redingotë si ajo, të guxonte të shprehte një vullnet, kjo iu duk Tenardiesë e padurueshme. Prandaj dhe ia pati idhët:

-Duhet të punojë, përderisa ha bukë. Unë nuk e ushqej për sytë e bukur.

-Po mirë, çfarë bën ajo? - vazhdoi i huaji me atë zë të butë, që binte aq çuditërisht në kundërshtim me petkat e tij prej lypësi dhe me shpatullat e tij prej hamalli.

Tenardieja denjoi të përgjigjej.

-Çorape bën, që thoni, zotëria juaj. Çorape për vajzat e mia të vogla, që nuk kanë, si të thuash, dhe që tani po ecin zbatshur.

Njeriu vështroi ato këmbët e mjera të kuqe të Kozetës dhe vazhdoi:

-Kur duhet t'i mbarojë ato çorape?

-I duhen të paktën edhe tri a katër ditë të mira kësaj dembelice.

-Dhe sa para mund të vlejné ato çorape kur t'i mbarojë?

Tenardieja i hodhi një vështrim plot përbuzje.

-Të paktën, tridhjetë *su*.

-A do t'i jepnit ato çorape për pesë franga? - vazhdoi njeriu.

-Pasha zotin! - bërtiti me një të qeshur të fortë një qiraxhi që po dëgjonte, - pesë franga? Më thershin mua, që ky s'qenka në vetel! Pesë franga s'i tërheqin dot as pesë buaj në këtë kohë.

Burri Tenardie e pa të udhës të merrte fjalën.

-Po, zotëri, në qoftë se ju ka shkrepur në kokë, do t'ju japim ato çorape për pesë franga. Ne nuk dimë kurrë t'ua prishim qejfin udhëtarëve tanë.

-Duhet të paguani peshin që tani, - tha Tenardieja me atë mënyrën e saj të prerë dhe urdhëruese.

-Po i blej ato çorape, - u përgjigj burri dhe shtoi duke nxjerrë nga xhepi një monedhë pesëfrangëshe, që e lëshoi mbi tryezë, - po i paguaj në dorë.

Pastaj u kthye nga Kozeta.

-Tani puna jote më përket mua. Luaj, bija ime, luaj.

Qiraxhiu u prek aq shumë nga monedha pesëfrangëshe, sa e la në vend gotën e verës dhe ngarendi për të parë.

-More, po qenka tamam! - bërtiti ai duke e shqyrtuar monedhën mbarë e prapë. - Qenka me të vërtetë një rrotë e prapme karroce!) Dhe nuk qenka as kallp, besa!

Tenardieja u afrua dhe, pa bërë zë, e vuri monedhën në xhep të jelekut.

Ajo s'gjente dot fjalë si t'i kthente përgjigje të huajit. Kafshoi buzët dhe erdhi e u nxi në fytyrë nga urrejtja.

^{*)} Në zhargon do të thotë franga.

Ndërkohë Kozeta po dridhej e tëra. Megjithatë, kuturisi e pyeti:

-Zonjë, e keni me gjithë mend? A mund të luaj?

-Luaj! - tha Tenardieja me një zë të tmerrshëm.

-Faleminderit, zonjë! - tha Kozeta.

Dhe, ndërsa goja e saj falënderonte Tenardienë, gjithë shpirti i saj i vogël falënderonte udhëtarin.

Tenardieja kishte filluar përsëri të pinte. E shoqja i tha në vesh:

-Ç'do të jetë vallë ky njeri i verdhë kështu?

-Unë kam parë, - u përgjigj rëndë-rëndë Tenardieja, - milionerë që kishin redingota kështu si ky.

Kozeta i kishte lënë mënjanë shtizat, por nuk kishte dalë nga vendi ku ndodhej. Kozeta lëvizte gjithmonë sa të ishte e mundur më pak. Ajo kishte marrë në një kuti, që ndodhej prapa saj, disa lecka dhe një shpatë të vogël prej plumbi.

Eponina dhe Azelma s'ua vinin fare veshin atyre që po ngjisnin. Ato sapo kishin kryer një veprim shumë të rëndësishëm: kishin kapur macen. Kukullën e kishin flakur përdhe, dhe Eponina, që ishte më e madhja po e mbështillte macen e vogël me gjithë të mjaulliturat e të përdredhurat e saj me një tog leckash e zhelesh të kuqe e të mavia. Ndërsa ishte duke bërë këtë punë të rëndë e të vështirë, ajo i thoshte së motrës me atë të folur të ëmbël e të adhureshëm të fëmijëve, hiri i të cilëve, po si ai shkëlqimi i flatrës së fluturave, ikën e shkrin kur ne duam ta fiksojmë.

-Dëgjo këtu ti, motërza ime, me këtë kukull bën më shumë qejf se me atë tjetrën atje. Kjo lëviz, bërtet dhe është e ngrohtë. Dëgjomë mua ti, motërza ime, hajde të luajmë me këtë. Kjo do të jetë vajza ime. Unë do të vij për vizitë dhe ti do ta vështrosh. Pak nga pak ti do të shikosh mustaqet e saj dhe do të çuditësh. E pastaj do të shikosh veshët e saj, e pastaj do të shikosh bishtin e saj dhe do të çuditësh. Dhe ti do të më thuash: "Ah! O zot, o zot!", dhe unë do të të them: "Po, zonjë, kjo është vajza ime dhe kështu e kam. Kështu janë vajzat e vogla tani."

Azelma e dëgjonte Eponinën me admirim,

Ndërkohë burrat, që po pinin, kishin filluar të këndonin

një këngë të ndyrë, me të cilën qeshnin sa tundej tavani. Tenardieja u jepte zemër dhe i shoqëronte.

Ashtu si zogjtë, që bëjnë folenë me gjithçka, edhe fëmijët bëjnë një kukull me çdo gjë që t'u bjerë në dorë. Në kohën kur Eponina dhe Azelma po mbështillnin macen, Kozeta, nga ana e saj, kishte mbështjellë shpatën. Si e kishte kryer këtë punë, e kishte marrë ndër duar dhe po i këndonte ëmbël për ta vënë në gjumë.

Kukulla është një nga nevojat më të domosdoshme dhe në të njëjtën kohë një nga instinktët më të këndshme të fëmijërisë femërore. Të kujdesesh, ta veshësh, ta zbukurosh, ta zhveshësh, ta veshësh përsëri, ta mësosh, ta qortosh nga pak, ta tundësh, ta nanuritësh, ta vësh në gjumë, të përfytyrosh se një diçka është një dikush, e gjithë e ardhmja e gruas përmbledhet në këto gjëra. Duke ëndërruar dhe duke cicëruar, duke bërë paja të vogla dhe shpërgënj të vegjël, duke qepur fustane të vogla, korsera dhe mëngore të vogla, fëmija bëhet vajzë e re, vajza e re bëhet vajzë e rritur, vajza e rritur bëhet grua. Fëmija i parë, që lind gruaja, është vazhdimi i kukullës së fundit.

Një vajzë e vogël pa kukull, është pothuajse aq fatkeqe dhe plotësisht aq e papërkryer sa edhe një grua pa fëmijë.

Kozeta, pra, kishte bërë për vete një kukull me shpatën e saj.

Tenardieja, nga ana e saj i qe afruar "*njeriut të verdhë*".

-Im shoq ka të drejtë, - mendoj ajo, - ndoshta ky mund të jetë bankieri Lafit. Ka të pasur që bëjnë shakara të tilla.

Erdhi, pra, e u mbështet me bërryla te tryeza e tij.

-Zotëri... - tha ajo.

Kur dëgjoi fjalën *zotëri*, njeriu u kthye. Tenardieja e kishte thirrur gjer atëherë *burrë i dheut ose xhaxho*.

-Shikoni si është puna, zotëri, - vazhdoi ajo duke e ëmbëlsuar fytyrën, dhe ky ëmbëlsim ishte akoma më i pështirë për t'u parë, sesa fytyra e saj e egër, - unë me gjithë qejf dua që fëmija të luajë, nuk kam ndonjë kundërshtim, por kjo punë është e mirë vetëm kur bëhet një herë, sepse ju jeni zemërgjerë. Po, që thoni zotëria juaj, ajo s'ka asgjë prej gjëje dhe duhet të punojë.

-S'qenka juaja kjo fëmijë? - pyeti njeriu.

-Oh, për besë, jo, zotëri! Është një vogëlushe e varfër, që ne e kemi marrë nga rruga, ashtu për mëshirë. Është njëfarë fëmije trutharë. Duhet të ketë ujë dhe jo tru në kokë. Kokën e ka të madhe, siç e shikoni. Ne bëjmë për atë çka na vjen për dore, sepse nuk jemi as të pasur. Dërguam e dërguam letra sa mundëm në fshatin e saj, por më kot, sepse u bënë gjashtë muaj që s'po na përgjigjet njeri. Më thotë mendja se e ëma do të ketë vdekur.

-Ah! - tha njeriu dhe ra përsëri në ëndërrimet e tij.

-Edhe e ëma ishte një palo grua, - shtoi Tenardieja. - E braktisi fëmijën e vet dhe s'e çau fare kokën për të.

Gjatë gjithë këtij bisedimi, Kozeta, sikur ta kishte kuptuar instinktivisht se po flisnin për të, s'ia kishte hequr fare sytë Tenardiesë. Ajo mbante vesh ashtu në tym. Dhe dëgjonte aty-këtu disa fjalë.

Ndërkohë ata që po pinin, të gjithë tre çerek të dehur, përsëritnin refrenin e tyre të ndyrë me një gaz të dyfishuar. Ishte një këngë çapkëne gjithë kripë e lezet, ku ishin përzier virgjëresha dhe Jezu Krishti fëmijë. Tenardieja kishte vajtur që të merrte edhe ajo pjesë me shpërthimet e të qeshurave të saj. Kozeta vështronte zjarrin, i cili po pasqyrohej në syrin e saj të palëvizur; ajo kishte filluar përsëri ta përkundte atë farë kopaneci që e kishte sajuar dhe, duke e përkundur kësisoj, këndonte me zë të ulët: "Nëna ime ka vdekur! Nëna ime ka vdekur! Nëna ime ka vdekur!"

Pas këmbënguljesh të përsëritura të hanxheshës, njeriu i verdhë, "milioneri", pranoi më në fund, të hante darkë.

-Çfarë dëshiron, zotëria juaj?

-Bukë dhe djathë, - tha njeriu.

-Me siguri ky do të jetë ndonjë i këputur, - mendoj Tenardieja.

Të dehurit këndonin gjithmonë këngën e tyre, dhe fëmija nën tryezë këndonte këngën e saj.

Befas Kozeta e pushoi këngën. Ajo sapo ishte kthyer dhe kishte pikasur kukullën e Tenardieve të vogla, që e kishin

braktisur për të kapur macen dhe e kishin lënë përdhe, disa hapa nga tryeza e kuzhinës.

Atëherë ajo e lëshoi shpatën e mbështjellë, e cila nuk e kënaqte siç duhet, pastaj solli ngadalë sytë rreth e rrotull sallës. Tenardieja ishte duke i folur me zë të ulët të shoqit dhe po numëronte disa të holla, Ponina dhe Zelma po luanin me macen, udhëtarët hanin ose pinin ose këndonin, asnjë vështrim nuk ishte përqendruar mbi të. Nuk duhej të humbiste asnjë çast. Doli që poshtë tryezës duke u zvarritur me gjunjë e me duar, u sigurua edhe një herë që s'po e përgjonte njeri, pastaj rrëshqiti me vrap gjer te kukulla dhe e kapi. Me të shpejtë ajo u gjend përsëri në vendin e saj, e ulur, e palëvizur, por e kthyer në mënyrë të tillë që t'i bënte hije kukullës, që po e mbante në krah. Lumturia që të luante me një kukull, ishte aq e rrallë për të, sa që kishte gjithë furinë e një dalldisjeje.

Asnjëri s'e kishte parë përveç udhëtarit, që po hante ngadalë darkën e tij të varfër.

Ky gëzim mbajti afro një çerek ore.

Por, sado kujdes që kishte pasur Kozeta, ajo nuk kishte vënë re se njëra këmbë e kukullës dilte jashtë dhe se zjarri i oxhakut e ndriçonte me dritë të fortë. Kjo këmbë ngjyrë trëndafili, që dilte nga hija, i ra menjëherë në sy Azelmës, e cila i tha Eponinës: "Pa shih, moj motër!"

Të dyja motrat e vogla u ndalën të habitura. Kozeta kishte guxuar të merrte kukullën! Eponina u ngrit në këmbë dhe, pa e lëshuar macen, vajti drejt s'emës dhe filloi ta tërhiqte për fustani.

-Moj po, lërmë rehat, të them! - i foli e ëma. - Ç'më do?

-Nënë, - tha fëmija, - pa shiko njëherë!

Dhe tregonte me gisht Kozetën. Kozeta, krejt e dalldisur nga ajo që kishte shtënë në dorë, as shihte, as dëgjonte më se ç'bëhej.

Fytyra e Tenardiesë mori atë shprehje të veçantë, ku ndërthuret e tmerrshmja me hijet e jetës dhe që ka bërë që këto lloj grash të quhen shtriga. Kësaj radhe ajo ishte prekur në sedër, dhe kjo ia ndizte akoma më shumë inatin. Kozeta kishte kapërcyer çdo cak e kufi. Kozeta kishte dhunuar kukullën

e "këtyre zonjushave". Një careshë që do të shikonte një muzhik tek provonte kordonin e madh, të kaltër të të birit të saj perandorak, nuk do të kishte fytyrë tjetër.

Ajo bërtiti me një zë të ngjirur nga zemërimi:

-Kozetë!

Kozeta u drodh e tëra, sikur t'i qe tundur toka nën vete.

Ajo u kthye.

-Kozetë! - përsëri Tenardieja.

Kozeta e mori kukullën dhe e vendosi përdhe me njëfarë përnderimi, të përzier me dëshpërim. Atëherë, pa i hequr sytë prej saj, ajo, është e tmerrshme ta thuash për një fëmijë të asaj moshe, i bashkoi duart dhe i përdrodi; pastaj ndodhi ajo gjë që s'ia kishte shkaktuar dot asnjë nga tronditjet e ditës, as vajtja në pyll, as pesha e kovës me ujë, as humbja e parave, as pamja e kamxhikut, madje as fjala mynxyrëmadhe që kishte dëgjuar nga goja e Tenardiesë, ajo qau. Ia plasi të qarit me dënesë.

Ndërkohë udhëtari ishte ngritur në këmbë.

-Ç'është kështu? - i tha ai Tenardiesë.

-A nuk po e shikoni vallë? - tha Tenardieja duke treguar me gisht sendin e fajit, që po dergjej në këmbët e Kozetës.

-E pastaj? - vazhdoi udhëtari.

-Kjo ndyravece, - u përgjigj Tenardieja, - guxoi të prekte me dorë kukullën e fëmijëve.

-Gjithë kjo zhurmë për kaq gjë! - tha njeriu. - Por edhe sikur të luante me atë kukull, ç'do të bëhej?

-Ajo e ka prekur kukullën me ato duar të ndyra! - vazhdoi Tenardieja, - me ato duar të llahtarshme!

Këtu Kozeta ia plasi edhe më keq të qarit me dënesë.

-Do ta mbyllësh gojën, apo jo? - bërtiti Tenardieja.

Njeriu vajti drejt e te porta, e hapi dhe doli në rrugë.

Sa doli ai, Tenardieja përfitoi nga mungesa për t'ia përveshur nën tryezë Kozetës me një shkelm të rëndë, që e bëri fëmijën të lëshonte britma të mëdha.

Porta u hap përsëri, dhe përsëri u duk njeriu. Ai mbante me të dyja duart kukullën përralore, që kemi zënë ngoje dhe që të gjithë kalamajtë e fshatit e soditnin qysh nga mëngjesi, dhe e vendosi në këmbë përpara Kozetës duke thënë:

-Merre, është për ty.

Duhet besuar se, qysh prej më shumë se një ore që ishte aty, i zhytur në ëndërrime, ai e kishte vënë re, ashtu si nëpër tym, atë dyqanin e vogël të lodrave, të ndriçuar me fenerë e qirinj, gjithë shkëlqim, sa mund ta shikoje edhe përmes xhamit të kabaresë, si ndonjë flakërimë.

Kozeta ngriti sytë, ajo e kishte parë burrin të vinte drejt saj me atë kukull, sikur të kishte parë t'i vinte vetë dielli, ajo i kishte dëgjuar ato fjalë të pabesueshme: "Është për ty". E vështroi burrin, vështroi edhe kukullën, pastaj u zmbraps ngadalë dhe vajti e u fsheh thellë nën tryezë, në një qoshe të murit.

Kozeta nuk po qante më, nuk po klithte më; ajo dukej sikur nuk guxonte as të merrte frymë.

Tenardieja, Eponina, Azelma ishin bërë si statuja guri. Edhe vetë burrat, që po pinin, kishin shtangur. Në të gjithë kabarenë mbretëronte një heshtje e madhërishtme. Tenardieja, e shtangur si guri dhe e heshtur, filloi përsëri të bluante me trurin e saj:

-Ç'të jetë vallë ky plak kështu? Të jetë ndonjë i varfër? Të jetë ndonjë milioner? Ndoshta është edhe i varfër, edhe milioner, domethënë hajdut.

Fytyra e bashkëshortit Tenardie paraqiti atë rrudhë shprehëse, që e thekson edhe më shumë fytyrën njerëzore, sa herë që instinkti mbizotërues shfaqet aty me të gjithë fuqinë e tij shtazore. Hanxhiu këqyrte herë kukullën, herë udhëtarin, dukej se po e nuhaste atë njeri, sikur po nuhaste një thes me para. Kjo zgjati sa hap e mbyll sytë. Ai iu afrua së shoqes dhe i tha me zë fare të ulët:

-Ky marifet kushton të paktën tridhjetë franga. Përmbys përpara këtij njeriu!

Njerëzit që janë të trashë nga natyra, kanë diçka të përbashkët me njerëzit syleshë, dhe kjo ndodh se të dyja palët e kthejnë fletën aty për aty, pa pikë marifeti.

-Hajde, pra, Kozetë, - tha Tenardieja me një zë që rrihte të ishte i ëmbël dhe që ishte fund e krye i përzier me atë lloj vreri të grave shpirtliga, - a nuk po e merr kukullën tënde?

Kozeta kuturisi e doli nga vrima ku që strukur.

-Kozeta ime e vogël, - vazhdoi Tenardieja me një mënyrë përkëdhelëse, - zotëria po të jep një kukull. Merre. Është jotja.

Kozeta po e këqyrte kukullën e mrekullueshme me njëfarë tmerri. Fytyrën e kishte akoma të mbytur në lot, por sytë e saj po fillonin të mbusheshin, ashtu si qielli në agimin e mëngjesit, me rrezatimet e çuditshme të gëzimit. Ajo që po ndiente Kozeta në atë çast, përngjihte pak me atë që do të kishte ndier sikur dikush t'i kishte thënë papritmas: "Vogëlushe, ti je mbretëresha e Francës".

Asaj i dukej sikur po ta prekte me dorë atë kukull, do të shpërthente prej saj rrufeja. Dhe kjo deri në njëfarë mase ishte e vërtetë, sepse ajo thoshte me vete se Tenardieja do të bërtiste si bubullimë dhe do ta rrihte. E megjithatë, tundimi doli më i fortë. Ajo dha e dha, pastaj u afrua dhe belbëzoi me druajtje, duke u kthyer nga Tenardieja.

-A mundem, zonjë?

S'ka shprehje që të mund ta përshkruajë atë pamje njëkohësisht të dëshpëruar, të trembur dhe të kënaqur.

-Për besë, po! - ia pati Tenardieja, - kukulla është jotja. Përderisa zotëria ta jep.

-Vërtet, zotëri? - vazhdoi Kozeta, - e vërtetë është? Për mua është zonja?

I huaji dukej sikur i kishte sytë të mbushur me lot. Ai dukej sikur ishte në atë pikë të mallëngjimit kur njeriu nuk flet për të mos ia plasur të qarit. I bëri një shenjë me kokë Kozetës dhe vuri dorën e "zonjës" në dorën e saj të vogël.

Kozeta e tërhoqi me vërtik dorën e vet, sikur dora e zonjës e dogji dhe e përvëloi, dhe filloi të vështronte truallin. Jemi të detyruar të shtojmë se pikërisht në atë çast Kozeta e kishte nxjerrë gjuhën përjashta jashtë masës. Befas ajo u kthye dhe e rroku kukullën me gaz të madh.

-Do ta quaj Katerinë, - tha ajo.

Ishte një çast i pazakontë, kur zhelet e Kozetës takuan dhe pushtuan fjongot dhe muselinat e freskëta të kukullës.

-Zonjë, - vazhdoi ajo, - a mund ta vendos mbi një karrige?

-Po, bija ime, - u përgjigj Tenardieja.

Tani e kishin radhën Eponina dhe Azelma ta shikonin Kozetën me lakmi. Kozeta e vendosi Katerinën mbi një karrige, u ul përdhe përpara saj dhe qëndroi pa lëvizur, pa thënë asnjë fjalë, në një soditje të thellë.

-Luaj, pra, Kozetë, - tha i huaji.

-Oh! Ja, po luaj, - u përgjigj fëmija.

Ky i huaj, ky burrë i panjohur, që dukej si i dërguar nga qielli për Kozetën, ishte në atë çast njeriu që Tenardieja urrente më shumë se këdo tjetër në botë. Megjithatë, duhej të ndrydhej e ta mbante veten. Mirëpo tronditja ishte shumë më e madhe nga sa mund të duronte ajo, sado që ishte e stërvitur për të fshehur ndjenjat, duke kopjuar të shoqin në të gjitha veprimet e saj. Ajo u nxitua t'i dërgonte të bijat për të fjetur, pastaj i kërkoi njeriut të verdhë leje që të dërgonte edhe Kozetën për të fjetur, - *"e cila është lodhur shumë sot"*, - shtoi ajo me një ton gjoja amësor. Kozeta shkoi të flinte me Katerinën në krah.

Tenardieja shkante kohë më kohë në skajin tjetër të sallës ku ishte i shoqi. - *"për të lehtësuar shpirtin"*, - thoshte ajo. Këmbente me të shoqin disa fjalë, të cilat ishin aq të tërbuara, sa nuk guxonte t'i thoshte me zë të lartë:

-Shtazë e keqe! Çfarë të ketë ky njeri në bark? Vjen e na prish qetësinë këtu! Dhe kërkon që ajo përbindshja e vogël të luajë, pale! Na i dhënka edhe kukulla, pale! Dhe i jep kukulla dyzetfrangëshe një geneje, të cilën unë do ta shisja me gjithë qejf për dyzet su. Dhe për pak do të na i thoshte "madhëria juaj", si dukeshës Dë Berri! A nuk ka dalë fare nga kondaku ky njeri? A nuk është i tërbuar ky plak misterioz?

-E pse? Kjo është fare e thjeshtë, - ia kthente Tenardieja. - Kur ka qejf! Ti bën qejf kur e vogla punon, ai bën qejf kur ajo luan. Ka të drejtën e tij edhe ai. Një udhëtar bën si t'i shkrepë kur e zgjidh qesen e paguan. Në qoftë se ky plaku është një filantrop, ç'të keqe ke ti? Në qoftë i krisur nga kondaku, kjo s'të përket fare ty. Ç'ke ti që shikon e fut hundët, përderisa ai ta thyen kokën me para?

Të folur prej mjeshtri dhe arsytim prej hanxhiu, që nuk kishe se ç'përgjigje t'u jepje.

Njeriu ishte mbështetur me bërryla mbi tryezë dhe kishte

marrë përsëri qëndrimin e tij ëndërrues. Të gjithë udhëtarët e tjerë, tregtarë e qiraxhinj, ishin larguar pakëz dhe nuk po këndonin më. Ata e kundronin nga larg me një farë frike plot respekt. Ky njeri, i veshur aq varfër, që nxirrte nga xhepi "rrota të prapme" me aq lehtësi dhe që u jepte kukulla vigane ndyrashkave me nallane, duhej të ishte me siguri ndonjë babaxhan i madhërishëm dhe i drashtur.

Shumë orë kaluan kështu. Mesha e mesnatës kishte mbaruar, nata e kërsëndellave kishte marrë fund, ata që pinin, ishin larguar, kabareja ishte mbyllur, salla e ulët kishte mbetur e shkretë, zjarri ishte shuar, i huaji qëndronte gjithmonë po në atë vend dhe po në atë mënyrë. Kohë më kohë ai ndërronte bërrylin mbi të cilin mbështetej. Kaq dhe asgjë tjetër. Por ai s'kishte thënë asnjë fjalë që nga koha kur Kozeta nuk ishte më aty.

Vetëm Tenardietë, për të mos prishur qejf dhe për kureshtje, kishin qëndruar në sallë.

-Po pse kështu do ta kalojë tërë natën ky? - grindej Tenardieja.

Kur ra ora dy e mëngjesit, ajo deklaroi se nuk duronte dot më dhe i tha të shoqit:

-Unë do të vete të fle. Bëj ç'të duash me të!

Burri u ul pranë një tavoline në një qoshe, ndezi një qiri dhe filloi të lexonte gazetën *"Courrier français"*.

Kaloi kështu një orë e tërë. Hanxhiu i denjë e kishte lexuar të paktën tri herë *"Courrier français"*, që nga data e deri te emri i botuesit. I huaji nuk po lëvizte fare nga vendi.

Tenardieja lëvizti, u kolliti, pështyu, fshiu hundët, kërciti karrigen. Po i huaji s'bënte asnjë lëvizje. - "Mos po fle?" - mendoj Tenardieja. Njeriu nuk po flinte, por asgjë s'mund ta zgjonte. Më në fund Tenardieja hoqi kësulën, u afrua ngadalë dhe kuturisi e tha:

-A nuk do të shkojë të çlodhet zotëria juaj?

Nuk do të shkoni të flini. Tenardiesë do t'i dukej si diçka e tepruar dhe si familjaritet. Të çlodheni mbante erë luks dhe ishte plot respekt. Këto fjalë kanë vetinë e mistershme dhe të admirueshme që ta fryjnë të nesërmen në mëngjes, faturën që

duhet të paguajë klienti. Një dhomë ku *fle* kushton njëzet *su*; një dhomë ku *çlodhesh* kushton njëzet franga.

-Pa shih, - tha i huaji, - keni të drejtë. - Ku e keni haurin?

-Zotëri, - ia pat Tenardieja me një buzëqeshje, - do ta shoqëroj vetë zotërinë tuaj.

Ai mori qiriun, njeriu mori paketën dhe shkopin e vet, dhe Tenardieja e çoi në një dhomë në katin e parë, e cila kishte një shkëlqim të rrallë, e tëra e pajisur me mobilje mogani me një shtrat si anije dhe me perde pëlhere të kuqe.

-Ç'është kjo kështu? - tha udhëtari.

-Kjo është dhoma jonë martesore, - tha hanxhiu. - Tani banojmë në një tjetër, unë dhe bashkëshortja ime. Këtu hyjmë vetëm tri ose katër herë në vit.

-Mua do të më pëlqente njëlloj edhe hauri, - tha prerë njeriu.

Tenardieja bëri sikur nuk e dëgjoi këtë mendim jo shumë të pëlqyer.

Ai ndezi dy qirinj dylli krejt të rinj, që qëndronin mbi oxhak. Një zjarr mjaft i mirë flakëronte në vatër. Mbi këtë oxhak kishte një kapelë gruaje me fije argjendi dhe me lule portokalli.

-Po kjo këtu ç'është, - vazhdoi i huaji.

-Zotëri, - tha Tenardieja, - kjo është kapela e martesës e gruas sime.

Udhëtari i hodhi sendit një vështrim që dukej sikur thoshte: "Paska qenë njëherë e një kohë edhe kjo përbindëshe virgjëreshë!"

Në të vërtetë, Tenardieja gënjente. Kur e kishte marrë me qira atë gërmadhë për ta shndërruar në han, e kishte gjetur atë dhomë të pajisur ashtu siç ishte dhe i kishte blerë ato mobilje lule portokalli, duke gjykuar se kjo gjë do t'ia shtonte nurin "bashkëshortes së tij" dhe se, si përfundim, hani i tij do të fitonte atë që anglezët quajnë "respektueshmëri".

Kur udhëtari u kthye, hanxhiu qe zhdukur. Tenardieja ishte vjedhur tinëz, pa guxuar t'i thoshte as "natën e mirë", duke mos dashur që të trajtonte me një përzemërsi jorespektuese një njeri, të cilin kishte ndër mend ta rripte paq të nesërmen në mëngjes.

Hanxhiu u tërhoq në dhomën e vet. E shoqja, kishte rënë, por nuk po flinte. Kur dëgjoi hapat e të shoqit, u rrotullua dhe i tha:

-A e di se nesër do t'i vë drunë Kozetës?

Tenardieja u përgjigj ftohtë:

-Dale, dale, si shumë po ngutesh!

Nuk këmbyen më fjalë të tjera, dhe pas disa minutash kandili i tyre ishte fikur.

Nga ana e tij, udhëtari kishte vendosur në një qoshe shkopin dhe pakon e vet. Si u largua hanxhiu, ai u ul në një kolltuk dhe ndenji një hop i menduar. Pastaj zbathi këpucët, mori njërin nga të dy qirinjtë, i fryu tjetrit, shtyu derën dhe doli nga dhoma, duke vështruar përreth, sikur të kërkonte diçka. Kaloi përmes një korridori dhe arriti te shkallët. Atje dëgjoi një zhurmë shumë të lehtë, që i përngjiste frymëmarrjes së një fëmije. Shkoi pas asaj zhurme dhe arriti në njëfarë skute trekëndëshe, të sajuar nën shkallë. Kjo birucë s'ishte tjetër veçse pjesa e poshtme e shkallareve. Atje, në mes të gjithfarë kanistrash dhe zhelesh të vjetra, në mes të pluhurit dhe të merimangave, kishte një shtrat, në qoftë se mund t'i themi shtrat një dysheku vrima-vrime, sa i dukej kashta, dhe një kuvertë vrime-vrime, sa dukej dysheku. Çarçafë aspak. Të gjitha këto ishin shtruar përdhe mbi truall. Në këtë shtrat flinte Kozeta.

Njeriu u afrua dhe e këqyri. Kozeta po bënte një gjumë të thellë. Ishte e veshur. Dimrit ajo nuk zhvishej për të pasur më pak ftohtë.

Ajo e mbante shtrënguar pas vetes kukullën, sytë e mëdhenj e të hapur të së cilës ndritnin në errësirë. Kohë më kohë ajo lëshonte nga një psherëtimë të thellë, sikur do të zgjohej nga gjumi, dhe e shtrëngonte kukullën në krah, pothuajse me dalldi. Pranë shtratit ishte vetëm njëra prej nallaneve të saj.

Përmes një porte të hapur, pranë skutës së Kozetës, dukej një dhomë mjaft e madhe dhe e errët. I huaji hyri brenda. Në fund, përmes një dere me xhama, shquheshin dy shtretër të vegjël binjakë, shumë të bardhë. Ishin shtretërit e Azelmës dhe

të Eponinës. Prapa këtyre shtretërve dukej përgjysmë një djep xunkthi pa perde, ku po flinte ai djali i vogël që kishte bërë titur gjithë atë mbrëmje.

I huaji e mori me mend që kjo dhomë lidhej me dhomën e bashkëshortëve Tenardie. Ishte duke dalë, kur sytë i vajtën te oxhaku; ishte një nga ata oxhakët e mëdhenj të haneve, ku ka një zjarr shumë të vogël, edhe kur i ndezin, dhe që të duken shumë të ftohtë kur i shikon. Në atë oxhak nuk kishte zjarr, s'kishte as hi; por megjithatë, ajo që ndodhej në atë oxhak, tërhoqi vëmendjen e udhëtarit. Ishin dy këpucë fëmijësh me formë të hijshme dhe me madhësi të ndryshme; udhëtarit iu kujtua zakoni i bukur dhe i vjetër sa s'mbahet mend i fëmijëve, që vendosin këpucët në oxhak ditën e krishtlindjeve për të pritur në terr ndonjë dhuratë të shndritshme nga zana e tyre e mirë. Eponina dhe Azelma nuk e kishin harruar këtë zakon dhe kishin vënë secila nga një këpucë në oxhak.

Udhëtari u përkul.

Zana, domethënë nëna e tyre, e kishte bërë tashmë vizitën e saj dhe mund të shikoje tek shndriste në secilën këpucë një monedhë të bukur gjashtësushe, fringo të re.

Njeriu ishte duke u çuar në këmbë dhe duke u larguar së andejmi, kur i zunë sytë në fund, aty mënjane, në skajin më të errët të vatrës, një send tjetër. Ai vështroi dhe pa një nallane, një nallane të shëmtuar prej druri të pagdhendur, gjysmë të thyer dhe krejt të mbuluar me hi dhe me baltë të tharë. Ishte nallania e Kozetës. Kozeta, me atë besimin prekës të fëmijëve, që mund t'i mashtrosh gjithmonë, por që s'i lëshon zemra asnjëherë, kishte vënë edhe ajo nallanen e vet në oxhak.

Sa gjë e lartë dhe e ëmbël është shpresa te një fëmijë që s'ka njohur kurrë gjë tjetër përveç dëshpërimit.

Në këtë nallane s'kishte asgjë. I huaji kërkoi në jelekun e tij, u përkul dhe vuri në nallanen e Kozetës një luigj ari.

Pastaj u kthye përsëri në dhomën e tij lehtë-lehtë e pa u ndier.

IX

Tenardieja bën manovra

Të nesërmen në mëngjes, të paktën dy orë përpara se të zbardhte dita, bashkëshorti Tenardie, i ulur në tryezë, pranë një kandili, në sallën e ulët të hanit, me një penë në dorë, përpilonte faturën për udhëtarin me redingotë të verdhë.

Gruaja, në këmbë, gjysmë e kërrusur mbi të shoqin, po e ndiqte me sy. S'po këmbenin asnjë fjalë. Nga njëra anë, ishte mendimi i thellë, nga ana tjetër, ishte ai admirimi fetar, me të cilin njeriu vështron tek lind e zhvillohet një mrekulli e mendjes njerëzore. Në shtëpi dëgjohej një zhurmë; ishte Lauresha, që po fshinte shkallët.

Pas një çerek ore të mirë dhe pas disa korigjimesh, Tenardieja kishte sajuar këtë kryevepër:

FATURË PËR ZOTËRINË E N. 1

Darka.....	fr. 3
Dhoma.....	“ 10
Qiriu.....	“ 5
Zjarri.....	“ 4
Shërbimi.....	“ 1

SHUMA..... fr. 23

Shërbimi ishte shkruar *shërpim*.

-Njëzet e tre franga! - bërtiti gruaja me një entuziazëm të përzier me njëfarë ngurrimi.

Ashtu si të gjithë artistët e mëdhenj, Tenardieja nuk ishte i kënaqur.

-Puf! - ia bëri ai.

Ky ishte theksi i Kesëllrit¹⁴¹⁾, që hartoi në Kongresin e Vjenës, faturën e pagesës për Francën.

-Zoti Tenardie, ti ke të drejtë, e ke me hak të të paguajë

kaq, - murmuriti gruaja, e cila po mendonte për kukullën, që i huaji i kishte dhënë Kozetës në prani të të bijave, - e drejtë është, por është ca si tepër. Nuk do të pranojë të paguajë.

Tenardieja lëshoi atë të qeshurën e tij të ftohtë dhe tha:

-Do të paguajë.

Kjo qeshje ishte shprehja më e lartë e sigurisë dhe e autoritetit. Do të bëhej siç kishte thënë ai. Gruaja nuk nguli më këmbë. Ajo filloi të radhiste tryezat; burri po i binte kryq e tërthor sallës. Pas një hopi ai shtoi:

-Edhe unë kam një mijë e pesëqind franga borxh!

Ai vajti e u ul te qoshja e oxhakut, duke bluar mendime, me këmbët të vendosura mbi hirin e ngrohtë.

-Ah, për besë! - ia pat përsëri gruaja, - mos harrove që do t'i vë drunë sot Kozetës? Hëë, shtriga! Po ma plas shpirtin me atë kukullën e saj! Më mirë të martohem me Luigjin XVIII, sesa ta mbaj qoftë edhe një ditë më shumë në shtëpi!

Tenardieja ndezi llullën dhe u përgjigj midis dy shtëllungash tymi:

-Këtë faturë do t'ia dorëzosh ti atij burrit.

Pastaj doli. Ai s'kishte dalë akoma mirë nga salla, kur udhëtari hyri brenda.

Tenardieja u duk përsëri aty për aty prapa udhëtarit dhe qëndroi pa lëvizur te dera e hapur, në mënyrë që ta shikonte vetëm e shoqja.

Njeriu i verdhë mbante në dorë shkopin dhe pakon e tij.

-Kaq herët qenkeni ngritur? - tha Tenardieja, - do të largoheni kaq shpejt, zotëria juaj?

Ndërsa ishte duke folur kësisoj, ajo vërtiste me njëfarë shqetësimi faturën nëpër duar, duke e bërë palë-palë. Fytyra e saj e ashpër kishte marrë një shprehje që nuk e kishte zakon, ngurrimin dhe skrupullin.

Punë dreqi dhe kjo, t'i paraqiste një faturë të tillë një njeriu që dukej tamam sikur ishte njeri "i varfër".

Udhëtari dukej se bluante gjëra të tjera dhe nuk e kishte mendjen aty. Ai u përgjigj:

-Po, zonjë, po largohem.

-Domethënë, zotëria juaj s'keni pasur punë në Monfermej?

-Jo. Më ra udha këtej. Kaq. Zonjë, - shtoi ai, - sa duhet të paguaj?

Tenardieja, pa kthyer përgjigje, i zgjati faturën e palosur.

Njeriu e shpalosi letrën, e vështroi, por dukej qartë që mendja i rrihte gjetiu.

-Zonjë, - vazhdoi ai, - a ju venë mirë punët këtej nga Monfermeji?

-Hiq e mos e këput, zotëri, - u përgjigj Tenardieja, e cila po çuditej që s'po pëlçiste poterja.

Ajo vazhdoi me një theks elegjiak e më të qartë:

-Oh, zotëri, kanë ardhur kohë të këqija fort! Le që pastaj kalojnë shumë pak zotërinj këtyre anëve! Edhe ata pak myshterinj që kemi, janë të këputur, siç e shikoni. Po të mos kishim aty-këtu udhëtarë bujarë dhe të pasur, si zotëria juaj, do të na kishte marrë lumi me kohë! Kemi detyrime shumë. Ja, për shembull, ajo vajza e vogël na kushton qimet e kokës.

-Cila vajzë e vogël?

-Po ja, ajo e vogla, që e njihni edhe ju! Kozeta! Lauresha, si i thonë në fshat!

-Ah! - ia bëri njeriu.

Ajo vazhdoi:

-Edhe këta fshatarët janë fare hajvanë! Ç'nofka që u ngjitin të tjerëve! Ajo ka më shumë pamjen e një laureshe. Siç e shikoni edhe zotëria juaj, ne nuk kerkojmë lëmoshë, por edhe lëmoshë nuk mund të japim, sepse s'ia kemi fuqinë. Për të fituar, nuk fitojmë gjë, por për të paguar, paguajmë qimet e kokës. Patentat, taksat për dyert e dritaret, përqindjet! Zotëria juaj e dini mirë që qeveria nuk ngopet së kërkuari para. Pastaj kam edhe vajzat e mia! S'kam takat të mbaj me bukë edhe fëmijën e botës.

Njeriu filloi përsëri me atë zë që mendohej ta bënte si mospërfillës, por që i dridhej:

-Po sikur t'jua hiqnin qafe?

-Cilën Kozetën?

-Po.

Fytyra e kuqe dhe e ashpër e hanxheshës u ndriçua nga një të çelur i përçudshëm.

-Ah, zotëri! Zotëria im i mirë! Merreni, mbajeni, merreni me vete, çojeni ku të doni, sheqeroseni, mbusheni me thelpinj, pijeni, hajeni, dhe bekuar qofshi nga e tërëshenja virgjëreshë dhe nga të gjithë shenjtët e parajsës!

-Na qoftë për hair.

-Vërtet? Po e merrni me vete?

-Po e marr.

-Që tani?

-Që tani. Thirreni fëmijën.

-Kozetë! - bërtiti Tenardieja.

-Ndërkohë, - vazhdoi njeriu, - po ju paguaj edhe shpenzimet që kam bërë. Sa janë?

I hodhi një sy faturës dhe nuk mundi të përmbante një lëvizje habie:

-Njëzet e tri franga!

Ai e vështroi hanxheshën dhe përsëriti:

-Njëzet e tri franga?

Në shqiptimin e këtyre fjalëve të përsëritura kësisoj, kishte theksin që ndan pikëçuditësen nga pikëpyetja. Tenardieja pati kohë që të përgatitej për t'i bërë ballë goditjes. Ajo u përgjigj serbes:

-Pasha zonzën e bekuar, po, zotëri! Njëzet e tri franga bën.

I huaji lëshoi pesë monedha nga pesë franga mbi tryezë.

-Shkoni e thirrni vajzën e vogël, - tha ai.

Në këtë çast bashkëshorti Tenardie bëri përpara gjer në mes të sallës dhe tha:

-Zotëria e tij ka vetëm njëzet e gjashtë su për të paguar. Njëzet su për dhomën e gjashtë për darkën që hëngri. Përsa i përket asaj së voglës, dua të flas pakëz me zotërinë e tij. Na lër vetëm ti, grua.

Tenardiesë iu lëbyrën sytë, ashtu siç i ndodh ndokujt kur sheh papritur shkrepimat e talentit. Ajo e ndjeu që aktori i madh po hynte në skenë, nuk ktheu as gjysmë fjale dhe doli.

Me të mbetur vetëm për vetëm, Tenardieja i dha një karrige udhëtarit. Udhëtarit u ul; Tenardieja qëndroi në këmbë dhe fytyra e tij mori një shprehje të pazakontë prej babaxhani dhe njeriu të thjeshtë.

-Zotëri, - tha ai, - dëgjoni këtu se ç'dua t'ju them. Është puna se unë e dua me gjithë shpirt atë fëmijë.

I huaji e vështroi ngultazi.

-Cilën fëmijë?

Tenardieja vazhdoi:

-E çuditshme është dhe kjo punë! Por ja që më ka hyrë në zemër. Ç'i keni gjithë këto të holla? Merrini, pra, ato monedhat tuaja njëqindsushe. Unë atë fëmijë e adhuroj me shpirt.

-Cilën kështu? - pyeti i huaji.

-Kë? Kozetën tonë të vogël! A nuk doni të na e merrni me vete? Eh, pra, ja ku po jua them troç, është e vërtetë, ashtu siç është e vërtetë që ju jeni një njeri i ndershëm, që unë nuk mundem të shkëputem prej saj. Do të më dukej jeta e zbrazur pa atë fëmijë. E kam parë që kur ishte e vogël. Është e vërtetë që ajo na kushton shumë para, është e vërtetë që ka të meta, është e vërtetë që nuk jemi të pasur, është e vërtetë që kam paguar më shumë se katërqind franga barna vetëm për njërën nga sëmundjet e shumta që e kanë zënë! Por njeriu e ka për detyrë të bëjë diçka për hatër të zotit. Ajo s'të ka as baba, as nënë, unë e kam mbajtur me bukë. Dhe bukë kam edhe për atë, edhe për vete. Ç'është e vërteta, mua s'më ndahet dot shpirti nga ajo fëmijë. Ju e kuptoni mirë njeriut, kur i hyn një gjë në zemër, s'ke ç'i bën: unë jam tuaf njeri; nuk arsyetoj shumë; unë e dua atë vogëlushe; ime shoqe është pakëz si e sertë, por edhe ajo e do me shpirt. Duhet të më kuptoni, atë e kemi si fëmijën tonë. Kam nevojë ta dëgjoj si guget nëpër shtëpi.

I huaji vazhdonte gjithnjë ta vështronte ngultas. Tenardieja vazhdoi:

-Më ndjeni, zotëri, por njeriu s'mund t'ia japë fëmijën e vet kështu, të parit që kalon aty pari. Apo s'kam të drejtë? Pastaj, unë nuk them, ju jeni i pasur, dhe dukeni njeri shumë i mirë, dhe, po të ishte puna për lumturinë e saj, a do të kisha ndonjë kundërshtim unë? Por njeriu duhet t'i dijë të gjitha. Kuptoni? Ta zëmë se unë do ta lë të shkojë dhe ta bëj këtë sakrificë, por unë dua të di se ku vete, nuk dua që ta humbas nga sytë, dua të di se në shtëpi të kujt është, që të vete e ta shoh kohë më kohë, që edhe ajo ta dijë se babai i saj në shpirt, që e mëkoi dhe e

rriti, është aty dhe kujdeset për të. Më në fund, ka disa gjëra që s'mund të bëhen. Unë s'di as emrin tuaj. Ju do ta merrni me vete dhe unë do të them pastaj: "Po mirë, kjo Lauresha ku ka vajtur vallë?" Njeriu duhet të shikojë qoftë edhe një copëz letër të keqe, një copëz të vogël letërnjoftimi, apo jo!?

I huaji nuk reshtte së vështruar i hanxhiun me atë vështrim që shkon, si i thonë fjalës, gjer në fund të ndërgjegjes. Ai iu përgjigj me një theks të rëndë dhe të vendosur:

-Zoti Tenardie, njeriu s'ka si ta marrë me vete letërnjoftimin kur vete pesë lega larg Parisit. Në e marrsha Kozetën me vete, do ta marr, dhe mbaroi me kaq. Ju nuk do ta dini emrin tim, ju nuk do ta dini shtëpinë ku banoj, ju nuk do ta dini se ku do të jetë, dhe qëllimi im është që ajo të mos ju shikojë kurrë sa të jetë gjallë. Unë po e këput fillin që ka në këmbë, dhe ajo largohet së këtejmi. Kjo punë a ju leverdis? Po apo jo.

Ashtu sikundër demonët dhe gjenitë njihnin nga disa shenja praninë e një perëndie më të lartë, Tenardieja e kuptoi se kishte të bënte me një njeri shumë të fortë. Këtë gjë ai e nuhati; si të thuash, ai e kuptoi me atë mprehtësinë e tij të kulluar dhe të hollë. Një natë më parë, ndërsa ishte duke pirë dhe duke kënduar këngë të ndyra me qiraxhinjtë, mes tymit të duhanit, ai e kishte kaluar mbrëmjen duke e vëzhguar të huajin, duke e përgjuar si ndonjë mace dhe duke e studiuar si ndonjë matematicien. Ai kishte përgjuar tinëz njëkohësisht për hesap të vet, për qejf dhe për instinkt, dhe e kishte gjuajtur sikur të kishte qenë paguar për një punë të tillë. Asnjë gjest, asnjë lëvizje e njeriut me redingotë të verdhë nuk i kishte shpëtuar Tenardiesë. Madje, edhe përpara se i panjohuri të kishte shprehur aq shkoqur interesin e tij për Kozetën, Tenardieja e kishte nuhatur këtë punë që më parë. Ai i kishte kapur në befasi vështrimet e thella të atij plaku, që ktheheshin gjithmonë mbi atë fëmijë. Përse gjithë ky interes? Ç'ishte vallë ky njeri? Pse të mbante një kostum aq të mjerë me tërë ato para në xhep? Këto ishin disa pyetje që ai ia bënte vetes dhe që nuk mund t'i zgjidhte; dhe kjo e bënte të pëlciste. Tërë natën e natës kishte menduar për këtë punë. Ky nuk mund të qe babai i Kozetës. A

mos ishte vallë ndonjë gjysh i saj? Atëherë, përse nuk dha të njohur menjëherë? Kur njeriu ka një të drejtë, ai e tregon sheshit. Ishte e qartë që ai njeri nuk kishte ndonjë të drejtë mbi Kozetën. Atëherë, ç'të ishte vallë? Tenardieja qe zhytur në gjithfarë hamendjesh. Ai ajgëtonte gjithçka, por nuk shihte dot asgjë. Por sidoqoftë, një gjë e bënte ta ndiente veten të fortë: mendimi se do të fillonte bisedimin me atë njeri, i sigurt se në këtë mes kishte një sekret, se njeriut i interesonte të qëndronte në errësirë; kur dëgjoji përgjigjen e qartë dhe të vendosur të të huajit, kur pa se ky njeri i mistershëm ishte i mistershëm dhe vetëm kaq, ai e ndjeu veten të dobët. Kurrën e kurrës nuk e priste një gjë të tillë. Hamendjet e tij pësuan disfatë e u shpartalluan fare. Atëherë e mbloodhi përsëri mendjen. Të gjithë punën e peshoi brenda një sekonde. Tenardieja ishte nga ata njerëz që e gryojnë një gjendje të caktuar vetëm me një të hedhur të syrit. Ju duk, pra, e udhës se kishte ardhur çasti që t'i binte shkurt dhe shpejt. Bëri ashtu siç bëjnë kapitenët e mëdhenj në këtë çast vendimtar, të cilin vetëm ata dinë ta pikasin e ta njohin; ai i zbuloi papritmas bateritë e tij.

-Zotëri, - tha ai, - më duhen një mijë e pesëqind franga.

I huaji nxori nga xhepi anash një portofol të vjetër prej lëkure të zezë, e hapi dhe nxori soje tri bankënota, të cilat i vendosi mbi tryezë. Pastaj nguli gishtin e tij të madh sipër këtyre tri biletave dhe i tha hanxhiut:

-Silleni Kozetën këtu.

Në kohën kur po ngjisnin këto gjëra, çfarë po bënte Kozeta?

Kozeta, me t'u zgjuar nga gjumi, vrapoi te nallania e vet. Aty kishte gjetur monedhën prej ari. Nuk ishte një napolon, por një nga ato paratë njëzetfrangëshe fringo të reja të Restaurimit, në faqen e të cilave bishti i vogël prusian kishte zëvendësuar kurorën me dafina. Kozetës iu errën sytë fare. Fati i saj po fillonte ta dehte. Ajo nuk e dinte se ç'ishte një monedhë ari, kurrë nuk kishte parë të tillë, e fshehu, pra, shpejt e shpejt në xhepin e vet, sikur ta kishte vjedhur. Megjithatë, ajo e ndiente se kjo monedhë ishte tamam e vetja dhe e merrte me mend se nga i vinte kjo dhuratë, por gëzimi i saj ishte tërë frikë. Ishte e kënaqur, por më shumë ishte e habitur. Ato gjëra aq

madhështore dhe aq të bukura nuk i dukeshin si të vërteta. Kukulla i fuste frikën, monedha e artë i fuste frikën. Ajo fërgëllonte përpara këtyre gjërave të madhërishme. Vetëm ai i huaji nuk i fuste frikën. Përkundrazi, ai ia ngrohte zemrën. Që një natë më parë, përmes mahnitjeve të saj, përmes gjumit të saj, ajo bluante me mendjen e vet prej fëmije për atë njeri, që nga të pamët ishte i vjetër, i varfër dhe i trishtuar, por që ishte aq i pasur dhe aq i mirë. Që nga çasti kur e pati takuar këtë njeri në pyll, asaj i dukej sikur gjithçka kishte ndërruar faqe. Kozeta, më pak e lumtur se dallëndyshja më e vogël e qiellit, kurrë nuk e kishte ditur se ç'donte të thoshte të strukesh në gjirin e nënës ose nën një krah. Që kur ishte pesë vjeç, domethënë aq larg sa mund ta çonin kujtimet e saj, fëmija e varfër rrëqetëj dhe dridhej nga të ftohtët. Ajo kishte qenë gjithmonë krejt e zhveshur nën thëllimin e hidhur të fatkeqësisë, tani asaj i dukej sikur ishte e veshur. Dikur shpirti i saj kishte të ftohtë, tani shpirti i saj ndiente të ngrohtë. Tani s'kishte më edhe aq frikë nga Tenardieja. Tani ajo s'ishte më vetëm; dikush i ndodhej pranë dhe e përkrahte.

Kozeta u kishte hyrë shpejt e shpejt punëve të mëngjesit. Ai flori që kishte më vete, po në atë xhep të përparësës, prej ku monedha pesëmbëdhjetësushe kishte rënë një natë më parë, e argëtonte shumë. Nuk guxonte ta prekte me dorë, por qëndronte nga pesë minuta duke e soditur dhe, duhet ta themi, duke nxjerrë gjuhën. Ndërsa fshinte shkallët, ajo ndalej dhe qëndronte aty, pa lëvizur dhe, duke harruar fshesën dhe botën e tërë, vështronte atë yll tek ndriçonte në fund të xhepit të saj.

Pikërisht një çast, kur qe zhytur në soditje të tilla, i erdhi pranë Tenardieja.

Me urdhrin e të shoqit, ajo kishte ardhur ta thërriste. Gjë e padëgjuar gjer atëherë, ajo as shuplakë s'i dha, as ndonjë të sharë s'i hoqi.

-Kozetë, - tha ajo pothuajse me të butë, - eja shpejt.

Pas një hopi Kozeta hynte në sallën e poshtme.

I huaji mori paketën që kishte sjellë me vete dhe e zgjidhi. Kjo paketë kishte brenda një fustan të vogël të leshtë, një përparëse, një këmishëz të pambuktë, një fund, një shami,

çorape leshi, këpucë, me një fjalë, një palë petka për një vajzë tetë vjeç. Të gjitha petkat ishin të zeza.

-Bija ime, - tha njeriu, - merri këto dhe shko e vishu sa më shpejt.

Dita kishte filluar të zbardhte, kur ata banorë të Monfermejit që po fillonin të hapnin portat e shtëpive të tyre, panë të kalonin në rrugën për në Paris një plak të veshur varfër, që kishte marrë për dore një vajzë të vogël, veshur e tëra në të zeza. Ajo mbante një kukull të madhe ngjyrë trëndafili në krahët e saj. Ata po drejtoheshin nga ana e Livrisë. Këta ishin njeriu për të cilin kemi folur dhe Kozeta.

Askush nuk e njihte njeriun; dhe, meqenëse Kozeta nuk i kishte më ato zhelet që mbante gjithmonë, shumë veta nuk e njohën dot.

Kozeta po largohej. Me cilin? As ajo nuk e dinte. Ku? As këtë nuk e dinte. Ajo kuptonte vetëm një gjë, që po largohej nga hani i Tenardieve dhe po e linte prapa. Askujt s'i kishte rënë ndër mend t'i thoshte lamtumirë, por as asaj s'i kishte rënë ndër mend t'i thoshte ndokujt lamtumirë. Ajo dilte nga ajo shtëpi, e urretur dhe duke urryer.

O krijesëz e varfër dhe e butë! Zemra jote gjer në atë çast kishte qenë ndrydhur e shtypur!

Kozeta ecte rëndë-rëndë, duke hapur ata sytë e saj të mëdhenj dhe duke kundruar qiellin. Ajo e kishte vënë monedhën e artë në xhepin e përparësës së saj të re. Kohë më kohë ajo përkulej dhe i hidhte nga një sy, pastaj vështronte plakun.

X

Kush lakmon për më mirë, gjen më keq

Sipas zakonisht, Tenardieja e kishte lënë të shoqin të vepronte si të donte. Ajo priste ngjarje të mëdha. Kur njeriu dhe Kozeta kishin ikur, Tenardieja priti një çerek ore të mirë,

pastaj e mori të shoqen mënjane dhe i tregoi të një mijë e pesëqind frangat.

-Vetëm kaq!? - tha ajo.

Ishte e para herë, që nga fillimi i jetës së tyre bashkëshortore, që ajo guxonte të kritikonte një veprim të mjeshtrit. Këtë radhë ajo kishte qëlluar mu në shenjë.

-Vërtet, ashtu është, ke të drejtë, - tha ai, - sa i marrë jam. Më jep kapelën.

I palosi të tri bankënotat, i rراسi në xhep dhe doli jashtë me nxitim të madh, por u gabua dhe herën e parë mori në të djathtë. Disa fqinjë, të cilët e njoftuan, e vunë përsëri në rrugë të drejtë; Lauresha dhe njeriu ishin parë tek po shkonin në drejtim të Livrisë. Ai ndoqi rrugën që i treguan, duke ecur me hapa të mëdhenj dhe duke folur me veten e vet.

-Ky njeri do të jetë pa dyshim një milioner i veshur me të verdha, kurse unë jam një hajvan i madh. - Ai dha në krye njëzet su, pastaj pesë franga, pastaj pesëdhjetë franga, pastaj një mijë e pesëqind franga, gjithnjë po me atë lehtësi. Po ta sillte puna, edhe pesëmbëdhjetë mijë franga do t'i kishte dhënë si pa gjë të keq. Por do ta arrij e do ta zë.

Dhe, pastaj, ajo pako me petka, e përgatitur që më parë për vajzën e vogël, ishte diçka e çuditshme; shumë gjëra të panjohura kishte në këtë mes. Njeriu nuk duhet t'i lëshojë nga dora misteret, kur i ka mbërthyer mirë. Sekretet e pasanikëve janë sfungjerë plot me ar; duhet të dish t'i shtrydhësh. Të gjitha këto mendime i silleshin vërdallë në tru. "Paskam qenë hajvan i hajvanëve", - thoshte ai.

Kur del nga Monfermeji dhe kur arrin te bërryli i rrugës që të çon në Livri, e sheh rrugën tek shpaloset përpara teje deri larg mbi rrafshinë. Kur arriti aty, ai llogariti se duhej t'ia zinte syri njeriun dhe vajzën e vogël. Vështroi larg, sa i hante syri, dhe nuk pa asgjë. U informua akoma edhe një herë. Por po humbiste kohë. Disa udhëtarë i thanë se njeriu dhe fëmija që po kërkonte, kishin marrë udhën drejt pyllit nga ana e Ganjisë. Ngau vrap në këtë drejtim.

Ata kishin shkuar shumë përpara, por fëmija është fëmijë

dhe ecën më ngadalë, ndërsa ai ecte shpejt. Pastaj vendin ai e njihte fare mirë.

Befas Tenardieja qëndroi dhe i ra ballit, si të kishte harruar gjënë kryesore dhe sikur ishte gati të kthehej andej nga kishte ardhur.

-Duhej të kisha marrë pushkën! - tha me vete.

Tenardieja ishte prej atyre natyrave të dyfishta, që na kalojnë ndonjëherë përpara pa u vënë re dhe që zhduken pa i njohur, për arsye se fati na ka treguar vetëm një rën faqe të tyre. Fati i shumë njerëzve është që të jetojnë kështu, të çkredhur përgjysmë. Në një situatë të qetë dhe të shtruar. Tenardieja kishte gjithçka që i duhej për të luajtur rolin - nuk themi për të qenë njeriu që jemi mësuar ta quajmë tregtar të ndershëm, borgjez të mirë. në të njëjtën kohë me t'u paraqitur disa rrethana të caktuara, me t'u ndier disa lëkundje dhe me ta çuar peshë natyrën e tij që nga poshtë, ai kishte gjithçka që i duhej për të qenë një maskara i mbaruar. Ai ishte një dyqanxhi, tek i cili gjeje një pjesë përbindëshi. Satanai kohë më kohë qëndronte i strukur në ndonjë qoshe të birucës ku jetonte Tenardieja dhe binte në mendime të thella përpara kësaj kryevepre të fëlliqur.

Si dyzoi për një çast:

-Bah! - mendoi ai, - do të kenë kohë të ikin e të shpëtojnë.

Vazhdoi udhën duke bërë përpara me shpejtësi dhe gati me një pamje sigurie, me mprehtësinë e këmbënguljen e dhelprës që ka nuhatur një trumbë thëllëzash.

Kështu, si kaloi pellgjet dhe përshekoi tërthorazi lirishtën e madhe, që është në të djathtë të rrugës së gjerë të Belëvysë, si arriti në atë rruginë të shtruar me bar, që i bie pothuajse rreth e rreth kodrinës dhe që mbulon qemerin e kanalit të vjetër të ujërave të abacisë së Shelës, atij i zuri syri, që sipër një ferre, një kapelë për të cilën kishte sajuar shumë e shumë hamendje. Ajo ishte kapela e njeriut që kërkonte. Ferra ishte e ulët. Tenardieja e kuptoi që njeriu dhe Kozeta ishin ulur aty. Fëmija nuk dukej, sepse ishte e vogël, por dukej koka e kukullës.

Tenardieja nuk gabonte. Njeriu që ulur aty për ta lënë Kozetën të çlodhej një grimë. Hanxhiu i ra përreth ferrës dhe doli befas përpara vështrimeve të atyre që kërkonte.

-Më falni, zotëri, - tha ai, pa frymë, - por merrini këto të një mijë e pesëqind frangat tuaja.

Duke folur kështu, ai i zgjaste të huajit të tri bankënotat. Njeriu ngriti sytë përpjetë.

-Ç' do të thotë kjo?

Tenardieja u përgjigj plot respekt:

-Zotëri, kjo do të thotë që unë po e marr përsëri Kozetën. Kozeta u rrëqeth dhe u rras pas plakut.

Ai u përgjigj duke e vështruar Tenardienë thellë në sy dhe duke i ndarë të gjitha rrokjet e fjalëve:

-Po e merr-ni për-së-ri Kozetën?

-Po zotëri, po e marr prapë. Ja ku po jua them. I vura gishtin kokës dhe mendova. Në të vërtetë unë nuk kam të drejtë t'jua jap juve. Unë jam një njeri i ndershëm, siç e shikoni. Kjo vajzë e vogël nuk është imja, është e s'ëmës. Ma ka lënë amanet e ëma, dhe nuk mund t'ia jap tjetërkujt veç s'ëmës. Ju do të më thoni: "Po nëna ka vdekur". Mirë. Në këtë rast unë mund t'ia dorëzoja fëmijën vetëm atij njeriu që do të më sillte një shkresë të nënshkruar nga e ëma, ku të thuhet se duhet t'ia dorëzoj fëmijën sjellësit të shkresës. Kjo është e qartë.

Njeriu, pa kthyer përgjigje, kërkoi në xhep, dhe Tenardieja pa të dilte përsëri në shesh ai portofoli me bankënota. Hanxhiut iu rrëqeth mishi nga gëzimi.

"Mirë e ke, - mendoj ai, - mbahu këtu, Tenardie. Do që të më thyejë me para!"

Përpara se të hapte portofolin, udhëtari hodhi një vështrim rreth e rrotull. Vendi ishte krejt i shkretë. As frymë njeriu s'kishte në pyll e në luginë. Njeriu e hapi portofolin dhe nxori, soje jo grushtin me bankënota, që priste Tenardieja, por një copë letër të thjeshtë, që e shpalosi dhe ia paraqiti krejt të hapur hanxhiut duke thënë:

-Keni të drejtë. Lexoni këtu.

Tenardieja e mori letrën dhe lexoi:

Montrëj-syj-Mer, 25 mars 1823

"Zoti Tenardie, do t'ia dorëzoni Kozetën këtij njeriu. Do

t'ju paguhen të gjitha gjërat e vogla që keni shpenzuar.

Kam nderin t'ju përshëndes me nderime

FANTINA"

-A e njihni këtë nënshkrim? - foli përsëri njeriu.

Ishte nënshkrimi i Fantinës. Tenardieja e njohu.

S'kishte ç'të thoshte më. Ai ndjeu dy inate të dhunshme: inatin që hoqi dorë nga korruptimi që shpresonte dhe inatin që u mund. Njeriu shtoi:

-Mund ta ruani këtë letër, që ta quani veten të shkarkuar. Tenardieja u tërhoq me kujdes.

-Ky nënshkrim është imituar mjaft mirë, - u grind ai nëpër dhembë. - Fundi, ashtu qoftë!

Pastaj bëri edhe një orvatje tjetër të dëshpëruar!

-Zotëri, - tha ai, - ashtu qoftë, përderisa ju jeni njeriu i ngarkuar. Por duhet të më paguani "të gjitha gjërat e vogla që kam shpenzuar". Borxhi që kam marrë për të është i madh.

Njeriu u çua në këmbë dhe tha duke shkundur me gishtin e mesit pluhurin e mëngës së tij të fërkuar:

-Zoti Tenardie, në muajin janar nëna bënte llogari dhe, sipas kësaj llogarie, ju detyrohej njëqind e njëzet franga; ju i keni dërguar në shkurt një përkujtesë prej pesëqind frangash, keni marrë treqind franga në fund të shkurtit dhe treqind franga të tjera në fillim të marsit. Kanë kaluar qysh atëherë nëntë muaj për nga pesëmbëdhjetë franga, sipas çmimit të caktuar, që bëjnë njëqind e tridhjetë e pesë franga. Kini marrë kështu njëqind franga më tepër. Mbeten edhe tridhjetë e pesë franga që keni për të marrë. Unë ju dhashë qëpari një mijë e pesëqind franga.

Tenardieja provoi atë që provon ujku në çastin kur e ndien se e ka kafshuar dhe e ka kapur nofulla e çeliktë e çarkut.

"Ç'është ky drejç njeri?" - mendoj ai.

Ai bëri atë që bën ujku. Bëri një të shkundur. Guximi e kishte nxjerrë në dritë njëherë e një kohë.

-Zotëri, që s'jua di emrin, - tha ai me vendosmëri dhe duke lënë mënjane, kësaj radhe, mënyrat plot respekt, - unë do ta marr Kozetën ose do të më jepni një mijë napolona ar.

I huaji tha me qetësi:

-Eja, Kozetë.

E mori Kozetën me dorën e majtë dhe me të djathtë kapi shkopin që ishte përdhe. Tenardieja e vuri re mirë se sa i madh ishte dajaku dhe sa i shkretë vendi.

Njeriu u fut në pyll së bashku me fëmijën, duke e lënë hanxhiun të ngrirë në vend. Ndërsa ata po largoheshin, Tenardieja këqyrte shpatullat e tij të gjera, pakëz të kërrusura dhe grushtet e tij të mëdha. Pastaj i ktheu sytë nga vetja e vet, i solli mbi krahët e vet të dobët e thatanikë dhe mbi duart e veta të holla.

“Qenkam me të vërtetë hajvan i madh, - mendoj ai, - që nuk mora pushkën, përderisa vija për gjah!”

Por as kësaj radhe hanxhiu nuk e quajti veten të mundur.

-Dua të di se ku do të shkojë, - tha ai.

Filloi t’u binte pas duke ruajtur njëfarë largësie. I mbeteshin akoma dy gjëra në dorë, një ironi, copa e letrës nënshkruar *Fantina*, dhe një ngushëllim, të një mijë e pesëqind frangat.

Njeriu po e shpinte Kozetën në drejtim të Livrisë dhe të Bonit. Ai ecte ngadalë, kokulur, në një qëndrim të mendueshëm dhe të trishtuar. Dimri ia kishte shkundur gjethet pyllit dhe e kishte bërë të tejdukshëm, kështu që Tenardiesë nuk i humbiste nga syri edhe duke ndenjmur mjaft larg. Kohë më kohë njeriu kthehej dhe vështronte se mos i binte ndokush pas. Befas atij i zuri syri Tenardienë. Hyri shpejt e shpejt me Kozetën në një shkurre, ku mund t’u vidheshin që të dy syve të të tjerëve.

-Dreq! - tha Tenardieja dhe e shpejtoi hapin.

Dendësia e shkurreve e kishte detyruar Tenardienë që t’u afrohej. Kur njeriu u fut në pjesën më të dendur, u rrotullua prapa. Më kot Tenardieja u mundua të fshihej në mes të degëve; ai nuk mund të ikte tani pa e parë njeriu. Njeriu i hodhi një vështrim shqetësues, pastaj tundi kokën dhe nisi përsëri udhën. Hanxhiu filloi përsëri t’i binte pas. Bënë në këtë mënyrë nja dy a treqind hapa. Befas njeriu u rrotullua përsëri. Ai e pa hanxhiun. Kësaj radhe ai e vështrroi me një pamje kaq të zymtë, sa Tenardieja e quajti “të padobishme” të shkante më tutje. Tenardieja ktheu udhë.

XI

Numri 9430 del përsëri në shesh dhe Kozeta e fiton në llotari

Zhan Valzhani nuk kishte vdekur.

Duke rënë ose, më mirë, duke u hedhur në det, siç e pamë, ai i kishte të zgjidhura prangat. Notoi zhytas gjer në një anije që kishte lëshuar çengelat dhe pas së cilës qe lidhur një varkë. Ai gjeti mënyrën që të fshihej në këtë varkë gjer në mbrëmje. Si ra nata, u hodh përsëri në det dhe me not arriti bregun jo shumë larg kepit Brën. Atje, duke qenë se paratë nuk i mungonin, mundi të gjente petka të tjera. Njëfarë kabareje, jashtë qytetit në rrethinat e Balagierit, ishte asokohe gardëroba e të burgosurve që arratiseshin, një specialitet, ky, që jepte fitime të majme. Pastaj Zhan Valzhani, si të gjithë firarët e mjerë, që mundohen t’ua humbasin gjurmët përgjimit të ligjit dhe fatalitetit shoqëror, ndiqte një itinerar të errët dhe plot dredha. Së pari, ai gjeti një strehë në Prado, pranë Bosetit. Pastaj u drejtua nga Gran-Vijari, afër Briansonit, në Alpet e Epërme. Ishte një ikje qorrthi dhe e shqetësuar, një udhë urithësh, degëzimet e së cilës janë të panjohura. Më vonë u arrit të gjendej ndonjë gjurmë e kalimit të tij në En, në trevën e Sivriëjit, në malet e Pirenejve, në Akon, në vendin e quajtur Grandë-de-Dumek, pranë fshatit të Shavajës, dhe në rrethinat e Perigëjit, në Bryni, kanton i Shapelë-Gonagetit. Pastaj zuri Parisin. Dhe pak më parë e pamë në Monfermej.

Kujdesi i tij i parë, me të arritur në Paris, ishte që të blinte një palë petka zie për një vajzë të vogël shtatë a tetë vjeç, pastaj të siguronte një banesë. Me të kryer këto punë, ai kishte vajtur në Monfermej.

Ju kujtohet se qysh më parë, në kohën e arratisjes së tij të mëparshme, ai kishte bërë aty ose në rrethinat andej pari një udhëtim misterioz, rreth të cilit policia kishte rënë pak në erë. Fundi i fundit, bota atë e dinin të vdekur, dhe kjo gjë e trashte akoma më shumë errësirën që ishte krijuar rreth tij. Në Paris

atij i ra në dorë një gazetë që kishte botuar këtë lajm. Ai e ndjeu veten të siguruan dhe pothuajse në paqe, sikur me të vërtetë të kishte vdekur.

Mbrëmjen e po asaj dite, kur Zhan Valzhani e kishte shkëputur Kozetën nga thonjtë e Tenardieve, ai kthehej në Paris. Ai kthehej më të ngrysur, me gjithë fëmijën, nga ana e Barrierës së Monsoit. Atje ai hipi në një llandon, që e shpuri në tarracën e Observatorit. Aty zbriti, pagoi karrocierin, mori Kozetën për dore, dhe që të dy, nëpër natën e errët, nëpër rrugët e shkreta afër Lursinës dhe Glasierës, u drejtuan nga Bulevardi i Spitalit.

Dita kishte qenë e çuditshme dhe e mbushur plot me emocione për Kozetën; kishin ngrënë prapa gardhiqeve bukë me djathë, që e kishin blerë mejhaneve të vetmuara, shpesh kishin ndërruar edhe karrocë, kishin bërë edhe ca copëra udhë në këmbë; ajo nuk ankohej, por ishte e lodhur, dhe Zhan Valzhani e pikasi këtë gjë nga dora, që ajo e tërhiqte prapa gjithmonë e më shumë, duke ecur. Atëherë ai e mori kalakiç; Kozeta, pa e lëshuar nga duart Katerinën, vari kokën mbi supin e Zhan Valzhanit. Atë e qepi gjumi.

Libri i katërt

KARAKATINA "GORBO"

I

Usta Gorboi

Këtu e dyzet vjet të shkuar, një shëtitës i vetmuar që do të guxonte të endej në vendet e humbura të "Salpetrierës" dhe të bënte përpjekje bulevardit gjer andej nga Barriera e Italisë, do të arrinte në disa vende ku të thoshte mendja se aty Parisi zhdukej. Vend i vetmuar nuk qe, sepse kishte kalimtarë; fushë nuk qe, se kishte shtëpi dhe rrugë; qytet nuk qe, se rrugët kishin hulli karrosi si udhët e mëdha dhe aty mbinte bari, por edhe fshat nuk qe, se shtëpitë ishin tepër të larta. Ç'ishte, pra? Ishte një vend i banuar, ku nuk kishte njeri, ishte një vend i shkretë, ku qe dikush, ishte një bulevard i qytetit të madh, një rrugë e Parisit, e cila natën ishte më e frikshme se pylli dhe ditën më e zymtë se varrezat.

Kjo ishte lagjja e vjetër e "Pazarit të Kuajve".

Ky shëtitës, në qoftë se do të guxonte të shkonte përtej mureve gjysmë të rëna të "Pazarit të Kuajve", në qoftë se do të pranonte të kalonte tej rrugës së "Bankierit të Vogël", pasi të kishte lënë në të djathtë një oborr të rrethuar nga katër mure të larta, pastaj një livadh ku ngriheshin përpjetë disa kapule tanini, si ato kasollet vigane të kastorëve, pastaj një bashtinë

të mbushur me qereste, me kapule trungjesh me rrënjë, me tallash e me bluashka, mbi të cilat lehte një qen i madh, pastaj një mur të gjatë e të ulët krejt të rrënuar, me një derë të vogël dhe të përzishme, të veshur me lëmyshek, që mbushej plot me lule në stinën e pranverës, pastaj, në vendin më të shkretë, si të kishte lënë prapa një karakatinë të shëmtuar e të ronitur, mbi të cilën mund të lexoje me shkronja të mëdha: "NDALOHET AFISHIMI", ky shëtitës kuturisës do të arrinte te qoshja e rrugës së "Vreshtave të Shën-Marselit", gjerësira gjeografike, këto, jo shumë të njohura. Atje, afër një uzine dhe midis dy mureve kopshtesh, njeriu mund të shikonte asokohe një karakatinë, e cila në vështrimin e parë dukej e vogël sa një kasolle, por që në të vërtetë ishte e madhe sa një katedrale. Nga rruga publike, që kalonte brinjazi, ajo kishte anën e murit, që, bashkë me çatinë, formonte në krye një trekëndësh; për këtë arsye ajo dukej e vogël. Pothuajse e gjithë shtëpia ishte e fshehur. Të zinte syri vetëm portën dhe një dritare.

Kjo karakatinë kishte vetëm një kat.

Po ta shikoje me kujdes, ajo që të binte së pari në sy, ishte se ajo portë nuk duhej të kishte qenë kurrë gjë tjetër veçse porta e ndonjë biruce, ndërsa ajo dritare, po të ishte ndërtuar me gurë të gdhendur, në vend që të ishte me gurë të bardhë, të vegjël, mund të kishte qenë dritarja e ndonjë pallati.

Porta nuk ishte gjë tjetër veçse një bashkim dhogash të brejtura nga krimbat, të lidhura trashë me traversa si copa drunjsh dhe të gdhendura keq. Kjo portë hapej drejtpërdrejt mbi një shkallë të përpjetë, me shkallare të larta, tërë baltë e suva të rënë, e pluhur. Ajo kishte të njëjtën gjerësi me portën. Shkalla, tek ngjitej përpjetë, dukej që nga rruga si ndonjë shkallë litari dhe humbiste në errësirë midis dy muresh. Pjesa e sipërme e kësaj zgavre pa formë që mbyllte kjo portë, ishte e maskuar me një copë dërrasë të ngushtë, midis së cilës ishte hapur me sharrë një vrimëz trekëndëshe, e cila shërbente edhe si dritarez, edhe si kapak, kur porta qëndronte e mbyllur. Mbi pjesën e brendshme të portës, ishte përvijuar me dy të rëna furçe të ngjyer me bojë shkrimi shifra 52, dhe sipër dërrasës po ajo furçe kishte shkarravitur numrin 50. Nuk dihet se çfarë zhelesh

ngjyrë pluhuri vareshin si perde te dritareza trekëndëshe.

Dritarja ishte e gjerë, mjaft e ngritur, e pajisur me grila dhe me xhama të mëdhenj; veçse këta xhama të mëdhenj kishin disa plagë të ndryshme, të cilat ishin njëkohësisht edhe të fshehura, por edhe të zbuluara nga një bandazh i shkathët me letër; ndërsa grilat, të shqyera e të dala vendit, më shumë i kërcënonin kalimtarët, sesa i mbronin banorët. Strehët horizontale mungonin aty-këtu dhe ishin zëvendësuar si mos më keq me dërrasa të mbërthyera pingul; kështu që, kjo gjë nga poshtë fillonte me grila dhe sipër mbaronte me qepena.

Kjo portë, që të kallte krupën, dhe kjo dritare, që kishte një pamje të ndershme, megjithëse ishte e ronitur, duke qëndruar asisoj së bashku mbi të njëjtën shtëpi, të krijonin përshtypjen e dy lypësve të ndryshëm nga njëri-tjetri, por që shkonin së bashku krah për krah, që kishin dy fytyra të ndryshme, por që mbështilleshin me të njëjtat zhele, që kishin qenë njëri syresh gjithmonë një varfanjak dhe tjetri gjithmonë një fisnik.

Shkalla të shpinte në një korpus ndërtese shumë të gjerë, që ngjiste me një hangar të kthyer në shtëpi banimi. Kjo ndërtesë kishte si zorrë barku një mesore të gjatë, ku gjendeshin, djathtas e majtas, disa lloj kthinash me përmasa të ndryshme, të banueshme nga zori dhe që u përngjisinin më shumë shatoreve, sesa qelive. Këto dhoma merrnin dritë nga disa dritare që binin mbi disa djerrina aty përreth. E gjithë kjo ishte diçka e errët, e zyrtë, e shpëlarë, melankolike, e përmortshme, e përshtuar, sipas plasave që ishin në çati pse në derë, prej rrezesh të ftohta ose prej thëllimesh të akullta. Një veçori interesante dhe piktoreske e banesave të kësaj fare janë merimangat me trup shumë të madh.

Në të majtë të portës së hyrjes, mbi bulevard, në lartësinë e një boje njeriu, një dritarez e mbyllur me mur formonte një kamarez katrore plot me gurë, që ishte mbushur nga fëmijët që kalonin aty pari.

Një pjesë e kësaj ndërtese është prishur këto kohët e fundit. Nga ç'ka mbetur deri sot, mund të gjykojmë se çfarë ka qenë njëherë e një kohe. E gjithë shtëpia, në tërësinë e saj, nuk është

më e moçme se njëqind vjet. Njëqind vjet janë vite rinie për një kishë dhe pleqërie për një shtëpi. Duket se banesa e njeriut i shton përshtat jetës së shkurtër të tij...

Shpërndarësit e postës e quanin këtë karakterinë numri 50-52, por në lagje ajo njihej me emrin shtëpia "Gorbo". Le ta themi që tani se nga i vinte ky emërtim.

Mbledhësit e ngjarjeve të vogla, që bëjnë me to farishte anekdotash dhe që kolisin në kujtesën e tyre datat fluturuese me një gjilpërëzë, e dinë se në Paris në shekullin e fundit, rreth vitit 1770, ishin dy prokurorë në Shtatëlë, që quheshin njëri Korbo,^{*)} tjetri Rënar^{**)}. Dy emra të parashikuar nga La Fonteni. Rasti ishte aq i bukur, sa rrethi i kadilerëve s'kishte si të mos sajonte gjithfarë shakash e shpotish me këtë punë. Menjëherë, nëpër galeritë e Pallatit të Drejtësisë, parodia mori dhenë me këto vargje disi të çala:

*Ky mjeshtri Korb, mbi një dosje hipur,
po mbante në sqep një vendim zbatimi:
ky mjeshtri Dhëlpër, nga era i joshur,
Pak a shumë kështu ia nisi një tregimi:
Hë, mirëdita! etj.*

Të dy kadilerët e ndershëm, të mërzitur nga shpotitë dhe të sëndisur nga shpërthimet e të qeshurave që s'u ndaheshin, vendosën t'i hiqnin qafe emrat e tyre dhe e panë të udhës t'i drejtoheshin mbretit. Lutja iu paraqit Luigjit XV po atë ditë kur nunci^{***)} apostolik, nga njëra anë, dhe kardinali i La Rosh-Aimonit, nga ana tjetër, në prani të madhërisë së tij, i mbathën secili nga një pantofël në këmbë zonjës Dy Bari,¹⁴²⁾ kur ajo zbriti nga shtrati. Mbreti, që po qeshte, vazhdoi të qeshte; ai kaloi plot gaz nga të dy peshkopët te të dy prokurorët dhe lëshoi pe për emrat e këtyre dy kadilerëve. U lejua me urdhër të mbretit që mjeshtrë Korboi t'i shtonte një bisht germës së tij të parë

^{*)} Korb.

^{**)} Dhëlpër.

^{***)} Ambasador i papës.

dhe të quhej Gorbo; mjeshtrë Rënar i doli më pak i fituar; atij iu lejua vetëm që të vinte një P përpara R-së së tij dhe të quhej Prënar^{*)}; kështu që emri i dytë nuk ishte më pak i përngjashëm me të parin.

Kështu, sipas traditës lokale, ky mjeshtrë Gorboi na kishte genë pronar i ndërtesës me numër 50-52 në Bulevardin e Spitalit. Ai, madje, ishte edhe autor i dritares monumentale. Që këtej ka rrjedhur emri i asaj ndërtese: shtëpia "Gorbò".

Përballë numrit 50-52 ngrihet përpjetë, midis pemëve të bulevardit, një vidh i madh tre çerek i tharë; pothuajse ballë për ballë tij nis fill rruga e Barrierës së Gobelinëve, rrugë asokohe pa shtëpi, pa kalldrëm, e mbjellë me drurë të rritur keq, e gjelbër ose tërë llucë, sipas stinës, e cila shkonte e përfundonte drejtpërdrejt te muri rrethues i Parisit. Një erë gurkali del dallgë-dallgë nga çatitë e një fabrike aty afër.

Barriera ishte fare pranë. Më 1823 muri rrethues ishte akoma në këmbë.

Edhe vetë kjo barrierë të ngjallte në shpirt figura kobzeza. Aty ishte Udha e Bisetrës. Që andej, në kohën e Perandorisë dhe të Restaurimit, hynin në Paris të dënuarit me vdekje ditën e ekzekutimit të tyre. Pikërisht aty qe kryer rreth vitit 1820 ajo vrasja misterioze që quhet vrasja e Barrierës së Fontenëblosë, autorët e së cilës drejtësia nuk mundi t'i zbulonte, problem i kobshëm që nuk u sqarua, enigmë e llahtarshme që nuk u zbulua. Bëni edhe disa hapa më tutje dhe do të gjeni atë rrugën fatale "Krulëbarbë", ku Ylbahu vrau me kamë bareshën nga Ivria,¹⁴³⁾ nën zhurmën e bubullimës, si në ndonjë melodramë. Edhe disa hapa akoma dhe do të gjendeni te vidhat mynxyrëmëdhenj e kokëprerë të Barrierës Sen-Zhak, mjet i volitshëm për filantropët, që fshihnin karamanjollën, Sheshin e Grevës, atë shesh meskin dhe të turpshëm të një shoqërie bakejsh dhe borgjezësh, që u zbraps përpara dënimit me vdekje, duke mos guxuar as ta abrogonte me madhështi, as ta mbante me autoritet.

Tridhjetë e shtatë vjet më parë, duke lënë mënjanë atë

^{*)} Marrës, rrëmbyes.

sheshin "Sen-Zhak", që, si i paracaktuar nga fati, ka qenë gjithmonë i llahtarshëm, pika më e zymtë ndoshta e të gjithë këtij bulevardi të zymtë ishte vendi, aq pak tërheqës edhe sot e kësaj dite, ku njeriu haste karakatinën Nr. 50-52.

Shtëpitë borgjeze filluan të mbinin aty vetëm njëzet e pesë vjet më vonë. Vendi ishte i zymtë. Me idetë kobzeza që e pushtonin aty, njeriu e ndiente veten midis "Salpetrierës",¹⁴⁴⁾ kubenë e së cilës mund ta ajgëtonte me sy, dhe "Bisetrës",¹⁴⁵⁾ barrierën e së cilës mund ta prekte me dorë, domethënë e ndiente veten midis marrëzisë së gruas dhe marrëzisë së burrit. Sa të hante syri, nuk shikoje gjë tjetër veçse thertoret, murin rrethues dhe disa ballina uzinash, të ngjashme me kazermat ose me manastiret; kudo baraka dhe mbeturina suvash, mure të vjetra e të zeza si qefinë, mure të bardha si savane; kudo rreshta pemësh paralele, ndërtesa si të prera me pe, ndërtime të shpëlara, vija të gjata, të ftohta, si edhe trishtimin e përzishëm të këndeve të drejta, Asnjë larmi trualli, asnjë tek arkitekture, asnjë rrudhë. E gjitha kjo ishte një tërësi e akullt, e rregullt, e neveritshme. Asgjë nuk ta ndrydh më shumë zemrën sesa simetria. Duke qenë se simetria është mërzia vetë, dhe mërzia është vetë burimi i zisë. Dëshpërimi shtriqet i përgjumur. Ferri ku njeriu do të mërziqej është më i tmerrshëm se ai ku do të vuante. Në qoftë se ky ferr do të ekzistonte, kjo copë e Bulevardit të Spitalit do të mund të kishte qenë rruga që të shpie te ky ferr.

Ndërsa ndaj të ngrysur, në çastin kur drita largohet, sidomos dimrit, në orën kur thëllimi i mugëtirës u shkëput vidhave gjethet e fundit të kuqërremta, kur nata është e errët dhe pa yje ose kur hëna dhe era bëjnë vrime nëpër retë, ky bulevard vinte e bëhej befasi i llahtarshëm. Vijat e drejta zhyteshin dhe humbeshin nëpër terr si copa të përjetësisë. Kalimtarit nuk mund të mos i shkonte mendja tek ai vargu i pandërprerë i trekëmbëshave që ngriheshin dikur te ky vend. Vetmia e këtij vendi, ku ishin kryer aq krime, kishte diçka të llahtarshme. Njeriut i dukej sikur parandiente gracka në këtë terr, të gjitha format e paqarta të errësirës dukeshin të dyshimta, edhe zgavrat e gjata katrore që shquante midis

pemëve do t'i dukeshin si varre. Ditën ky vend ishte i shëmtuar, mbrëmjeve ishte i përzishëm, natën ogurzi.

Verës, ndaj të ngrysur, mund të shikoje aty-këtu disa plaka, të ulura bythë vidhave, mbi banka të mykura nga shirat. Këto plaka të ngrata dilnin me qejf të kërkonin lëmoshë.

Veç kësaj, kjo lagje, që dukej më shumë e vjetruar sesa e lashtë, kishte prirje qysh atëherë që të shndërrohej. Edhe në atë kohë, ai që do të donte ta shikonte këtë lagje, duhej të nxitonte e të mos humbiste kohë. Çdo ditë zhdukej ndonjë hollësi e kësaj tërësie. Stacioni i hekurudhës së Orleanit ndodhet aty edhe sot e kësaj dite, që prej njëzet vjetësh, krahas rrethinës së vjetër të qytetit, dhe e ndryshon gjithnjë formën. Kur në qendër të një kryeqyteti vendoset stacioni i një hekurudhe, rrethina vdes dhe lind qyteti. Duket sikur përreth këtyre qendrave të mëdha të lëvizjes së popujve, nën rrëshqitjen e këtyre makinave të fuqishme, nën shfryrjen e këtyre kuajve të përbindshëm të qytetërimit, që hanë qymyrguri dhe vjellin zjarr, toka plot farëra dridhet e hap gojën për të gëlltitur banesat e vjetra të njerëzve dhe për të lënë të dalin të rejat. Shtëpitë e vjetra shemben, shtëpitë e reja ngrihen lart.

Që nga koha kur stacioni i hekurudhës së Orleanit ka pushtuar trojet e "Salpetrierës", rrugët e ngushta antike afër hendeqeve të "Sen-Viktorit" dhe të Kopshtit Botanik po tunden e shkunden me turr tri a katër herë në ditë nga ato rryma llandonësh, karroca postash dhe omnibusesh, të cilat vjen një kohë e i shtyjnë shtëpitë djathtas e majtas. Ka gjëra të çuditshme që duhen përmendur dhe që janë rigorozisht të përpikta, dhe, ashtu sikundër është e vërtetë të thuhet se në qytetet e mëdha dielli bën që të lindin e të rriten ballinat e shtëpive në kohë të drekës, është e sigurt se kalimi i shpeshtë i mjeteve të mbartjes i zgjeron rrugët. Spikatjet e një jete të re duken çiltazi. Në këtë lagje të vjetër krahinore, në skutat më të egra, fillon e bën majë kalldrëmi, trotualet fillojnë të shtrihen e të zgjaten, madje edhe atje ku akoma nuk ka kalimtarë. Një mëngjes, mëngjes i shënuar, në korrik të vitit 1845, njerëzit panë të nxirrnin tym kazanët e zinj të serës: atë ditë njerëzit mundën të thoshin se qytetërimi kishte arritur në rrugën "Lursinë" dhe se Parisi kishte hyrë në rrethinën "Sen-Marso".

II

Fole për kukumjaçka dhe cirikoka

Pikërisht pranë karakatinës "Gorbo" u ndal Zhan Valzhani. Ashtu si zogjtë e egër, ai kishte zgjedhur vendin më të shkretëtë për të ngritur fole të tij. Kërkoj në xhep, nxori së andejmi një farë çelësi kopil, hapi derën, hyri brenda, pastaj e mbylli përsëri me kujdes dhe u ngjit përpjetë shkallëve, duke mbajtur gjithmonë Kozetën në krah. Në krye të shkallëve, ai nxori një çelës të dytë, me të cilin hapi një derë tjetër. Dhoma ku hyri dhe e mbylli shpejt e shpejt derën, ishte njëfarë kthine mjaft e gjerë dhe e gjatë, me një dyshek të shtruar përdhë, me një tryezë dhe disa karrige. Një stufë e ndezur, ku dukej prushi, qëndronte në një qoshe të kthinës. Feneri i bulevardit ndriçonte vagët këtë brendësi të varfër. Në fund kishte një dhomëz dhe një krevat qingle. Zhan Valzhani e çoi fëmijën në këtë krevat dhe e vendosi aty, pa ia prishur gjumin.

Shkrepi çakmakun dhe ndezi me të një qiri; të gjitha këto ishin përgatitur që më parë mbi tryezë; dhe, ashtu siç kishte bërë një natë më parë, ai filloi ta këqyrte Kozetën me një vështrim plot dalli ku shprehja e mirësisë dhe e dashurisë shkonte deri në një si çoroditje. Vajza e vogël, me atë besim të qetë që i përket vetëm forcës së tejmë dhe vetëm dobësisë së tejmë, ishte përgjumur, pa e ditur se me cilin njeri ishte, dhe vazhdonte të flinte pa e ditur se ku ishte.

Zhan Valzhani u përkul dhe ia puthi dorën fëmijës. Nëntë muaj të shkuar ai puthte dorën e nënës, e cila, edhe ajo, sa ishte përgjumur. Po ajo ndjenjë e dhimbshme, fetare, therëse i mbushte zemrën Zhan Valzhanit. Ai u gjunjëzua pranë shtratit të Kozetës.

Dita kishte zbardhur krejt, kurse fëmija po flinte akoma. Një rreze e zbehtë e diellit të dhjetorit përshkonte dritaren e kthinës dhe vizatonte në tavan tizga të gjata drite dhe hijeje. Befas një karro, e ngarkuar rëndë, që kalonte mbi truallin e bulevardit, e tundi barakën si ndonjë gjëmim stuhie dhe e bëri të dridhej nga kreu në fund.

-Oh, po, zonjë! - bërtiti Kozeta duke u zgjuar me të brofur, - ja ku jam! Ja ku erdha!

Dhe u hodh poshtë shtratit, me kapakët e syve akoma gjysmë të mbyllur e duke zgjatur krahët drejt qoshes së murit.

-Ah, o Zot! Ç'm'u bë fshesa! - tha ajo.

I çeli sytë fare dhe pa fytyrën e buzëqeshur të Zhan Valzhanit.

-Ah! Pa shih, qenka vërtet! - tha fëmija. - Mirëdita, zotëri!

Fëmijët e pranojnë menjëherë dhe me lehtësi gëzimin dhe lumturinë, duke qenë se edhe ata vetë nga natyra janë lumturi dhe gëzim.

Kozetës i zuri syri Katerinën te këmbët e shtratit dhe e rrëmbëu; dhe, duke luajtur, i drejtonte njëqind e një pyetje Zhan Valzhanit. Ku ishte kështu? A ishte i madh Parisi? A ishte shumë larg zonja Tenardie? A do të kthehej më! Etj., etj. Papritmas ajo bërtiti:

-Sa bukur qenka këtu!

Ajo ishte një guvë e llahtarshme, por fëmija e ndiente veten të lirë.

-Mos duhet të fshij? - ia pati edhe një herë në fund.

-Luaj, - tha Zhan Valzhani.

Gjithë dita kaloi kështu. Kozeta, pa u bërë merak të kuptonte se ç'po ndodhte, ishte aq e lumtur sa nuk rrëfëhet, midis asaj kukulle dhe atij plaku.

III

Dy fatkeqësi së bashku sjellin lumturi

Të nesërmen, me të zbardhur dita, Zhan Valzhani ishte akoma pranë shtratit të Kozetës. Ai priti aty pa lëvizur dhe e vështroi tek zgjohej.

Diçka e re po i hynte në shpirt.

Zhan Valzhani s'kishte dashuruar kurrë. Që prej njëzet vjetësh ai ishte vetëm në këtë botë. S'kishte qenë kurrë baba,

dashnor, bashkëshort ose mik. Në burg ai ishte i keq, i zymtë, i papërljer, i padijshëm, i egër. Zemra e këtij të burgosuri të moçëm ishte plot ndjenja të virgjra. E motra dhe fëmijët e së motrës i kishin lënë vetëm një kujtim të vagët dhe të largët, që, më në fund, ishte shlyer plotësisht. Ai qe përpjekur me të gjitha mënyrat për t'i gjetur përsëri, dhe, meqë nuk kishte mundur t'i gjente, i kishte harruar. Kështu është gatuar natyra njerëzore. Emocionet e tjera të ëmbla të rinisë së tij, në qoftë se kishte pasur emocione, kishin rënë në një humnerë.

Kur pa Kozetën, kur e zuri me dorë, kur e mori me vete dhe e çliroi, atij iu tronditën thellë zemra e shpirti bashkë. Të gjitha ndjenjat e zjarra dhe plot dashuri, që kishte ai në veten e tij, u zgjuan dhe vërshuan drejt kësaj fëmije. Shkonte pranë shtratit ku ajo flinte, dhe rrëqethej nga gëzimi; ai ngazëllehej si ndonjë nënë dhe nuk e kuptonte mirë se ç'po i ndodhte; sepse lëvizja e madhe dhe e çuditshme e një zemre që fillon të dashurojë, është diçka shumë e pakuptueshme dhe e ëmbël.

E shkreta zemër plakë krejt e re!

Veçse, duke qenë se ai ishte pesëdhjetë e pesë vjeç dhe Kozeta tetë vjeç, gjithçka që mund të kishte pasur ai si dashuri në tërë jetën e tij, u shkri në njëfarë drite që nuk mund të shprehej me fjalë.

Kjo ishte shfaqja e dytë e dëlirësisë që ai haste në jetë. Peshkopi kishte bërë të lindte në horizontin e tij agimi i virtytit; Kozeta po bënte të lindte në këtë horizont agimi i dashurisë.

Ditët e para rrodhën në këtë shkëlqim verbues.

Nga ana e saj, edhe Kozeta gjithashtu po bëhej tjetër njeri, pa e kuptuar as vetë, kjo qenie e shkretët! Ajo ishte aq e vogël kur e la e ëma, sa nuk e mbante mend fare. Si të gjithë fëmijët, që janë si ata lastarët e rinj të hardhisë, që kacavirren pas gjithçkaje, edhe ajo ishte përpjekur që të donte. Por nuk ia kishte dalë dot mbanë. Të gjithë e kishin përbuzur. Tenardietë, fëmijët e tyre, fëmijët e të tjerëve. Ajo kishte dashur qenin, por edhe ai pati ngordhur. Pas kësaj asgjë dhe askush nuk kishte dashur t'i hidhte sytë. Është e tmerrshme të thuash, dhe ne e kemi treguar më përpara, por ajo, në moshën tetë vjeç, e kishte zemrën të ftohtë. Nuk qe faji i saj, sepse asaj nuk i mungonte

aftësia për të dashur. Medet! Nuk kishte kë të donte. Kështu, qysh ditën e parë, gjithçka që ndiente dhe mendonte tek ajo, filloi të donte atë babëlok. Ajo provonte atë që kurrë s'e kishte ndier, një ndijim si shpërthim lulëzimi.

Babëloku s'i dukej më as si plak, as si i varfër. Asaj Zhan Valzhani i dukej i pashëm, madje edhe ajo banesa gërmadhë i dukej e bukur.

Këto janë fryte agimi, fëmijërie, rinie, gëzimi. Toka e re dhe jeta e re ndikojnë shumë në këtë drejtim. S'ka gjë më magjepsëse sesa pasqyrimi plot ngjyra i lumturisë në papafingo. Të gjithë kemi nga e kaluara jonë nga një kujtim të ëmbël në këso kthinash të varfra, por të lumtura.

Natyrë dhe pesëdhjetë vjet diferencë kishin vendosur një hendek të thellë midis Zhan Valzhanit dhe Kozetës; këtë hendek fati e mbushi dhe e sheshoi. Fati i bashkoi papritmas dhe i fejoi me pushtetin e tij të pathyeshëm këto dy jetë pa plëng e pa shtëpi, të ndryshme nga mosha, por të ngjashme nga zia. Në të vërtetë, njëra plotësonte tjetrën. Instinkti i Kozetës kërkonte një baba, ashtu sikundër instinkti i Zhan Valzhanit kërkonte një fëmijë. Me t'u takuar, ata iu bënë krah njëri-tjetrit. Në çastin e mistershëm, kur të dyja duart e tyre u bashkuan, ata u lidhën përjetë të jetës. Kur këta dy shpirtra u panë me njëri-tjetrin, e kuptuan se ishin bërë për njëri-tjetrin dhe u përqaftuan fort.

Duke i marrë fjalët në kuptimin e tyre më të qartë dhe më absolut, mund të themi se, të ndarë nga të katër anët me mure varri, Zhan Valzhani ishte i Veu, ashtu siç ishte Kozeta Jetimja. Kjo gjë bëri që Zhan Valzhani të bëhej babai i Kozetës. Dhe, në të vërtetë, përshtypja e mistershme që iu përftua Kozetës, në thellësitë e pyllit të Shelës, nga dera e Zhan Valzhanit, që kapi dorën e saj në errësirën e natës, nuk ishte një ëndërr, por një realitet...

Veç të tjerave, Zhan Valzhani e kishte zgjedhur mirë strofkën e vet. Ai ishte atje pothuajse plotësisht i siguruar.

Dhoma dhe ajo kthinëz, ku banonte bashkë me Kozetën, ishte ajo dhomë që kishte dritaren nga bulevardi. Duke qenë se kjo dritare ishte e vetmja në tërë atë shtëpi, ata nuk kishin

pse të druheshin nga asnjë vështrim fqinjë ose anash, ose ballazi.

Kati përdhes i numrit 50-52 ishte njëfarë strehe e ronitur, që u shërbente kopshtarëve si vend për të strehuar karrot e tyre, dhe nuk kishte asnjë lidhje me katin e parë. Ai ndahej soje nga dyshemeja, e cila nuk kishte as qepen, as shkallë dhe ishte si pahi e karakatinës. Kati i parë përmbante, sikundër e thamë, shumë dhoma dhe disa papafingo, nga të cilat vetëm njëra ishte e zënë nga një grua plakë, e cila i bënte Zhan Valzhanit edhe shërbimet e shtëpisë. E gjithë pjesa tjetër ishte e pabanuar.

Ishte pikërisht kjo grua plakë, e quajtur "qiraxhesha kryesore" dhe, në të vërtetë, e ngarkuar me detyrat e portieres, që ia kishte lëshuar me qira këtë banesë Zhan Valzhanit ditën e krishtlindjeve. Zhan Valzhani i qe shitur asaj si rentar i rrënuar nga aksionet e Spanjës, që do të vinte të banonte aty së bashku me të mbesën. I kishte paguar plakës gjashtë muaj paradhënie dhe e kishte ngarkuar që të pajiste me mobilje dhomën dhe kthinën, siç e pamë më parë. Ishte ajo plakë e mirë që e kishte ndezur stufën dhe kishte bërë gati gjithçka atë mbrëmje kur arritën nga Monfermeji.

Javët rrodhën njëra pas tjetrës. Këto dy genie çonin në këtë birucë të mjerë një jetë të lumtur. Me të shkrepur agimi, Kozeta qeshte, gugatte, këndonte. Edhe fëmijët kanë këngën e tyre mëngjesore, ashtu siç e kanë edhe zogjtë.

Qëllonte disa herë që Zhan Valzhani ia merrte atë doçkë të kuqe e të plasaritur nga të ftohtët dhe ia puthte. Fëmija e shkretë, e mësuar gjithmonë me të rrahura, nuk e dinte aspak se ç'donte të thoshte kjo; dhe largohej krejt e turpëruar.

Hera-herës ajo bëhej serioze dhe e këqyrte me vëmendje fustanin e saj të zi. Kozeta s'ishte e veshur më me zhele, por ishte veshur me të zeza. Ajo dilte nga mjerimi dhe hynte në jetë.

Zhan Valzhani ishte vënë që t'i mësonte të lexonte. Shpesh, ndërsa e vinte fëmijën të lexonte shkronjë për shkronjë, atij i shkonte mendja se si ai vetë kishte filluar në burg të mësonte lexim vetëm e vetëm për të bërë keq. Ky mendim tani ishte

ndryshuar dhe e shtynte që t'i mësonte një fëmije shkrim e këndim. Atëherë ky hapsanik i vjetër vinte buzën në gaz.

Ai ndiente se ishte njeri, dhe humbiste në ëndërrime. Mendimet e mira kanë edhe ato humnerat e tyre, njëlloj siç i kanë edhe mendimet e këqija.

Pothuajse e tërë jeta e Zhan Valzhanit përmbledhej në atë që t'i mësonte Kozetës të lexonte dhe ta linte të luante. E pastaj ai i fliste për t'ëmën dhe e vinte të falej.

Ajo e thërriste "baba" dhe nuk i dinte emër tjetër.

Ai kalonte orë të tëra duke e soditur tek vishte e zhvishte kukullën e saj dhe duke e mbajtur vesh tek gugatte. Jeta tani e tutje i dukej plot interes, njerëzit i dukeshin të mirë dhe të drejtë, tani në mendjen e tij ai s'i vinte faj askujt, nuk shihte asnjë arsye pse të mos rronte deri në një moshë shumë të shtyrë, tani që kjo fëmijë e donte. Ai shikonte për veten e vet një të ardhme fund e krye të ndriçuar nga Kozeta, si nga ndonjë dritë magjepsëse. Edhe njerëzit më të mirë nuk janë të larë nga mendimet egoiste. Hera-herës ai mendonte me njëfarë gëzimi se ajo nuk do të ishte një vajzë e pashme.

Kjo nuk është veçse një përshtypje vetjake; por për të thënë gjithçka që mendojmë, në atë pikë ku kishte arritur Zhan Valzhani, kur filloi të donte Kozetën, nuk kemi asnjë provë që të dëshmojë se ai nuk kishte nevojë për këtë furnizim, që të vazhdonte pa ndërprerje udhën e mirësisë. Ai sapo e kishte parë nën aspekte të reja ligësinë e njerëzve dhe mjerimin e shoqërisë, aspekte të paplota dhe që fatalisht nuk tregonin veçse një faqe të së vërtetës, fatin e gruas, të përmbledhur te Fantina, autoritetin shtetëror, të mishëruar te Zhaveri; ai ishte kthyer përsëri në kampin e punëve të rënda, kësaj radhe pse kishte bërë mirë; ai kishte pirë kupa të reja me helm; pështirosja dhe lodhja e pushtonin përsëri. Kujtimi i peshkopit ndoshta kishte filluar t'i shuhej si në eklips, paçka se do t'i shfaqej më vonë i ndritur dhe triumfues; por, fundi, ky kujtim i shenjtëruar po dobësohej. Kushedi nëse Zhan Valzhani nuk ishte gati të humbiste kurajën dhe të gremisej përsëri? Ai dashuroi dhe u bë i fortë. Medet! Ai ishte po aq i brishtë sa Kozeta. Ai e mbrojti Kozetën dhe Kozeta e forcoi atë. Falë atij ajo mundi të ecte në

jetë; falë asaj ai mundi të vazhdonte në udhën e virtytit. Ai u bë mbrojtës i fëmijës dhe fëmija u bë mbështetja e tij. O mister i padepërtueshëm dhe hyjnor i drejtpeshimeve të fatit!

IV

Vërejtjet e “qiraxheshës kryesore”

Zhan Valzhani kishte kujdes që të mos dilte kurrë ditën. Çdo mbrëmje, në mugëtirë, ai shëtiste një orë ose dy, disa herë vetëm, shpesh tok me Kozetën, duke ndjekur rrugët anësore më të vetmuara të bulevardit ose duke hyrë kishave kur binte nata. Ai vinte me qejf në kishën e Sen-Medarit, që ishte kisha më e afërt. Kur nuk e merrte Kozetën me vete, ajo rrinte me plakën; por qejfi i fëmijës ishte të dilte me babëlokun; ajo parapëlqente më shumë të dilte qoftë edhe një orë të vetme me të, në vend që të rrinte kokë më kokë me Katerinën. Ai ecte duke e mbajtur për dore dhe duke i thënë fjalë të ëmbla.

Kozeta na ishte një vajzë shumë gaztore.

Plaka bënte punët e shtëpisë, gatuate dhe shkonte për të blerë harxhet.

Ata jetonin hollë, duke pasur gjithmonë nga pak zjarr, porsi njerëz shumë të varfër. Zhan Valzhani s’kishte ndërruar asnjë nga mobiljet e ditës së parë: vetëm kishte zëvendësuar me një derë prej dërrase derën me xhama të kthinëzës së Kozetës.

Ai kishte akoma redingotën e verdhë, pantallonat e zeza dhe kapelën e tij të vjetër. Në rrugë, njerëzit e merrnin për ndonjë të varfër. Qëllonte ndonjëherë që gra shpirtmira ktheheshin dhe i falnin ndonjë qindarkë. Zhan Valzhani e merrte qindarkën dhe përshëndeste duke u përkulur thellë. Qëllonte gjithashtu ndonjëherë që të takonte ndonjë të mjerë që lupte lëmoshë, atëherë ai vështronte prapa, se mos e shikonte njeri, i afrohej me kujdes njeriut fatkeq, i lëshonte në dorë ndonjë monedhë, shpesh një monedhë argjendi, dhe largohej

shpejt e shpejt. Por kjo kishte edhe ngatërresat e veta. Njerëzit kishin filluar ta njihnin në lagje me emrin “Lypësi që jep lëmoshë”.

“Qiraxheshja kryesore” krijesë e ngrysur, e pajisur me atë vëmendjen e ziliqares për fqinjin, e vëzhgonte shumë Zhan Valzhani, pa i rënë në erë këtij të fundit. Ajo ishte pakëz e rëndë nga veshët, gjë që e bënte edhe llafazane. Nga e kaluara i kishin mbetur akoma dy dhëmbë, njëri sipër e tjetri poshtë, që i kërciste gjithmonë njërin pas tjetrit. Ajo e kishte pyetur Kozetën, por Kozeta, duke mos ditur se si qe puna, s’kishte mundur të thoshte gjë, vetëm se vinte nga Monfermeji. Një mëngjes kjo vëzhguese e pa Zhan Valzhani tek po hynte në një nga kthinat e pabanuara të karakatinës me një pamje që asaj iu duk e veçantë. I ra pas me hapat e një maceje të vjetër dhe mundi të vërente, pa u parë nga njeri, përmes vrimës së derës që ishte aty puqur. Zhan Valzhani, pa dyshim, duke dashur të ruhej, i kishte kthyer shpinën kësaj dere. Plaka e pa atë që kërkoi diçka në xhep dhe nxori soje një këllëf, një palë gërshërë dhe ca pe, pastaj filloi të shqephte astarin e një kindi të redingotës, që nga nxori një copë kartë të zverdhëlleme, të cilën e shpalosi. Plaka e kuptoi me llahtarë se ajo copë kartë na ishte një bankënotë njëmijëfrangëshe. Ishte bankënota e dytë ose e tretë që po shikonte ajo qysh se ishte në këtë botë. Iku shumë e trembur.

Pas një hopi Zhan Valzhani iu afrua dhe iu lut që të shkonte e të thyente atë biletë njëmijëfrangëshe, duke shtuar se një ditë përpara kishte marrë këstin gjashtëmujor të rentës së tij.

“Ku? - mendoj plaka. Ai doli vetëm në orën gjashtë të mbrëmjes dhe me siguri arka e qeverisë nuk është hapur në këtë orë.”

Plaka vajti ta thyente bankënotën dhe filloi të bluante në kokën e saj. Kjo biletë njëmijëfrangëshe, e komentuar dhe e shumëfishuar, prodhoi një tufë bisedash rrëqethëse midis ndrikullave të Rrugës së Vreshtave të Shën-Marselit.

Ca ditë më pas ndodhi që Zhan Valzhani llërëpërveshur po sharronte dru në korridorin e ndërtesës. Plaka ishte në dhomë dhe po merrej me punët e shtëpisë. Ajo ishte vetëm

aty, sepse Kozeta kishte dalë të kundronte drutë që po sharroheshin; plaka e pa redingotën të varur në një gozhdë dhe e rrëmoi, astari ishte qepur përsëri. Gruaja e mirë e preku me kujdes dhe iu bë sikur ndjeu në kindet dhe në të kthyerat tufa kartërash. Të tjera bileta njëmijëfrangëshe, pa dyshim!

Veç kësaj, ajo vuri re se nëpër xhepat kishte gjithfarë gjërash, jo vetëm gjilpërat, gërshërët dhe perin që kishte parë, por edhe një portofol të madh, një thikë shumë të madhe, si dhe një hollësi, që e shtyu në dyshime, shumë parruka ngjyrash të ndryshme. Secili xhep i kësaj redingote dukej sikur ishte një depo gjërash të rastit për ngjarje të papritura.

Kësisoj, banorët e karakatinës ua mbërritën ditëve të fundit të dimrit.

V

Një monedhë pesëfrangëshe që bie përdhe e bën zhurmë

Na ishte pranë Sen-Medarit një i varfër, që kërrusej mbi grykën e një pusi të rëndomtë dhe të braktisur. Këtij të varfri Zhan Valzhani i jepte me gjithë zemër lëmshë. Kurrë nuk kalonte para këtij njeriu pa i dhënë ndonjë qindarkë. Heraherës edhe i fliste. Ata që e kishin zili lypësin, thoshin se ai na qenkësh “njeri i policisë”. Ai na qe një kandillonaft i vjetër shtatëdhjetë e pesë vjeç, që llomotiste vazhdimisht urata fetare.

Një mbrëmje, kur Zhan Valzhani po kalonte asaj ane pa Kozetën, e pa lypësin në vendin e zakonshëm, nën fenerin, që sapo ishte ndezur. Ky njeri, siç e kishte zakon, dukej sikur po thoshte urata dhe ishte kërrusur fare. Zhan Valzhani vajti tek ai dhe i lëshoi në dorë lëmshën e zakonshme. Lypësi ngriti papritmas sytë, e vështroi ngultas Zhan Valzhanin dhe pastaj uli kokën me të shpejtë. Kjo lëvizje u bë me shpejtësi rrufeje; Zhan Valzhanin e përshkoi një rrëqethje. Atij iu duk sikur kishte ajgëtuat në dritën e fenerit jo fytyrën e qetë dhe të çiltër të

kandillonaftit të vjetër, por një fytyrë të frikshme dhe të njohur. Pati atë përshtypje që ka njeriu kur ndodhet në terr dhe ndeshet papritur e pakujtuar ballë për ballë me një tigër. U zmbrapsi i tromaksur dhe i ngrirë si gur, duke mos guxuar as të merrte frymë, as të fliste, as të qëndronte, as të ikte, duke e vështuar lypësin, që kishte ulur kryet e mbuluar me një zhele dhe që dukej sikur nuk i interesonte në ishte apo s’ishte ai aty. Në këtë çast të çuditshëm, një instinkt, ndoshta instinkti misterioz i vetëmbrojtjes, e bëri Zhan Valzhanin të mos shqiptonte asnjë fjalë. Lypësi kishte po atë shtat, po ato zhele, po atë pamje si ditët e tjera. “Bah!... - tha Zhan Valzhani, - qenkam marrosur! Po shoh ëndërr! E pamundur!” Dhe vajti në shtëpi shumë i turbulluar.

Ai mezi guxonte t’ia pohonte vetvetes se ajo fytyrë, që iu duk se kishte parë, ishte fytyra e Zhaverit.

Natën, duke e vrarë mendjen për këtë punë, u pendua që nuk e kishte pyetur, që ta detyronte të ngrinte kokën edhe një herë tjetër.

Të nesërmen, ndaj të ngrysur, vajti edhe një herë aty. Lypësi ishte në vendin e vet. “Mirëdita, xhaxho”, - tha i vendosur Zhan Valzhani, duke i dhënë një qindarkë. Lypësi ngriti kokën dhe u përgjigj me një zë të rraskapitur: “Falemnderit, o Zoti im i mirë”. Ishte tamam kandillonafti i vjetër.

Zhan Valzhani e ndjeu veten plotësisht të siguar. Ai filloi të qeshte.

“Si dreqin m’u bë sikur pashë Zhaverin aty?” - mendoi ai. - “Për besë, mos do të filloj të shoh ëndërra në diell tani?”

Dhe nuk e vrau mendjen më fare për këtë çështje.

Disa ditë më pas, mund të ishte ora nja tetë e mbrëmjes, ai ndodhej në dhomë dhe po i mësonte Kozetës të lexonte germë për germë e me zë të lartë, kur dëgjoji portën e karakatinës të hapej e pastaj të mbyllej përsëri. Kjo iu duk si diçka e pazakontë. Plaka, e cila ishte e vetmja që banonte në atë shtëpi tok me të, binte të flinte gjithmonë me t’u errur, që të mos e ndizte kandilin. Zhan Valzhani i bëri shenjë Kozetës që të heshte. Dëgjoji se dikush po u ngjitej shkallëve. Kishte mundësi që të ishte plaka, e cila, duke mos e ndier veten mirë, do të kishte

vajtur te farmacisti. Zhan Valzhani mbajti vesh. Çapi ishte i rëndë dhe ushtonte si çap burri; por plaka mbante këpucë të mëdha, dhe s'ka gjë që mund t'i përngjasë më shumë hapit të një burri, sesa hapi i një gruaje plakë. Ndërkohë Zhan Valzhani i fryu kandilit dhe e fiku.

Ai e kishte dërguar Kozetën në krevat, duke i thënë me zë fare të ulët: "Bjer e fli pa bërë asnjë zhurmë"; dhe, në kohën kur ai po e puthte në ballë, hapat ishin ndalur. Zhan Valzhani qëndroi në heshtje, pa lëvizur, me shpinë të kthyer nga dera, i ulur mbi karrige, nga e cila s'kishte luajtur fare, duke mbajtur frymën në errësirë. Pasi kaloi një kohë mjaft e gjatë, meqë nuk dëgjoji më asgjë, ai u rrotullua pa bërë zhurmë dhe, tek po ngrinte sytë drejt derës së dhomës së vet, ai pa një dritë nëpër vrimën e bravës. Kjo dritë formonte njëfarë ylli të përzishëm mbi errësirën e derës dhe të murit. Me siguri aty qe dikush që mbante një qiri në dorë dhe përgjonte.

Kaluan disa minuta dhe drita u largua. Por ai nuk dëgjoji më asnjë zhurmë hapash, gjë që tregonte se ai që kishte ardhur të mbante vesh te dera, i kishte zbatuar këpucët.

Zhan Valzhani u lëshua i veshur mbi shtratin e vet dhe nuk mbylli sy gjithë natën e natës.

Më të zbardhur dita, tek po dremiste i këputur nga lodhja, ai u zgjua nga kërcitja e një dera që hapej në një papafingo në fund të korridorit, pastaj dëgjoji po atë hap burri që u ishte ngjitur shkallëve një natë më parë. Hapi po afrohej. Kërceu poshtë shtratit dhe vuri syrin te vrima e bravës, e cila ishte mjaft e madhe, duke shpresuar se do ta shikonte, kur të kalonte, atë dikushin që kishte hyrë natën në karakatinë dhe që kishte mbajtur vesh te dera e tij. Me të vërtetë, ai që kaloi ishte një burrë, kësaj radhe ai kaloi pa u ndalur përpara dhomës së Zhan Valzhanit. Korridori ishte akoma tepër i errët dhe s'mund ta dalloje fytyrën e njeriut, por, kur burri arriti te shkallët, një rreze drite që nga jashtë bëri që të shquhej silueta e tij; dhe Zhan Valzhani e pa nga shpina plotësisht. Burri kishte shtat të lartë, kishte veshur një redingotë të gjatë dhe mbante një dajak nën sqetull. Ishte kallëpi i hatashëm i Zhaverit.

Zhan Valzhani mund të provonte ta shikonte përsëri nga

dritarja e tij mbi bulevard. Por për këtë do t'i duhej ta hapte dritaren dhe nuk guxoi.

Ishte e qartë që ky njeri kishte hyrë me çelës dhe si në shtëpi të vet. Kush t'ia kishte dhënë këtë çelës? Ç'donte të thoshte e gjithë kjo?

Në orën shtatë të mëngjesit, kur plaka erdhi të bënte punët, Zhan Valzhani i hodhi një vështrim hetues, por nuk e pyeti. Gruaja e mirë dukej si zakonisht.

Teksa ishte duke fshirë, ajo i tha:

-Zotëria juaj a e dëgjuat ndoshta atë njeri që hyri mbrëmë natën këtu?

Për këtë moshë dhe për këtë bulevard, ora tetë e mbrëmjes është natën vonë.

-Aha, posi, vërtet, - u përgjigj ai me theksin më të natyrshëm që mund të bëhej. - Ç'ishte vallë ai njeri?

-Është një qiraxhi i ri, që ka ardhur në këtë shtëpi, - tha plaka.

-Dhe si quhet?

-Ku ta di unë e shkreta? Zoti Dymon a zoti Domon. Një emër pak a shumë si ky.

-Dhe ç'është ky zoti Dymon?

Plaka e këqyri me ata sytë e saj prej kunadheje dhe u përgjigj:

-Një rentar, si ju.

Ajo ndoshta s'kishte asnjë paramendim. Por Zhan Valzhanit i dogji dhe iu bë sikur ajo e kishte një të tillë. Kur plaka shkoi, ai mbështolli tufë nja njëqind franga, që i kishte në një dollap, dhe i vuri në xhep. Sado që në këtë veprim ai pati kujdes të mos e dëgjonte njeri, tek i sillte ato para nëpër duar, një monedhë njëqindsushe i shpëtoi nga duart dhe u rrëkëllye me zhurmë mbi truall.

Kur u thye dita, ai zbriti dhe vështroi me kujdes nga të gjitha anët në bulevard. S'pa njeri të gjallë. Bulevardi dukej fare i shkretë, por, ama, njeriu mund të fshihet edhe prapa drurëve.

U ngjit përsëri lart.

-Eja, - i tha ai Kozetës.

E mori për dore dhe dolën që të dy jashtë.

SHËNIME

1) *...ish-anëtar i Këshillit të Pesëqindtëve, përkrahës i 18 brymerit...* - Në periudhën e Revolucionit Borgjez Francez u vu në përdorim një kalendar i ri, që u shfuqizua në vitin 1806. Njehsimi i kohës fillonte që nga çasti i përmbysjes së pushtetit mbretëror, nga 22 shtatori 1792 ("Viti i parë i Lirisë"); muajve u dhanë emra të rinj. *Më 18 brymer të vitit VIII* (9 nëntor i vitit 1799) Napoleon Bonaparti bëri grushtin e shtetit, që e ndryshoi formën e diktaturës së borgjezisë. Trupi legjislativ, i përbërë nga Këshilli i të Pesëqindtëve dhe nga Këshilli i Pleqve, u shpërnda, Direktorati u suprimua dhe pushteti kaloi në duart e tre konsujve me Bonapartin në krye.

2) *Solidizmi* - doktrinë mjekësore, e cila i shpjegonte sëmundjet me ndryshimet që pësojnë grimcat e ngurta të indeve.

3) *Zhozef Turnëfor* (1656-1708) - shkencëtar botanist francez, pararendës i Lineut.

4) *Zhysje* - familje botanistësh francezë, që kanë punuar në gjysmën e parë të shekullit XVIII në lëmin e sistemimit të bimëve.

5) *Sharl Lineja* (1707-1778) - shkencëtar natyralist suedez, themelues i sistemit shkencor të klasifikimit të bimëve.

6) *...Telemakun, që po dorëzohet kalorës nga Minerva...* - Telemaku është i biri i Odiseut në poemën e Homerit. Në rastin konkret është fjala për vizatime dhe tablora të bëra në bazë të subjektit të romanit politiko-didaktik "Aventurat e Telemakut" (1699), që ishte mjaft popullor në shekullin XVIII dhe autori i të cilit është shkrimtari francez Fenelon.

7) *Listat e proskripcionit* - në Romën e lashtë listat e njerëzve që shpallehin jashtë ligjit (*proscriptio* - shpallje me shkrim); në Francë gjatë kohës së Restaurimit këto lista ishin listat e

pjesëmarrësve të Revolucionit, që duheshin dëbuar jashtë Francës.

8) *Kartushi* - kryetar i një bande në Paris, që u ekzekutua në sheshin "Grevé" të Parisit në vitin 1721.

9) ...*Bosyenë, që këndonte një "Te Deum" për dragonadat...* - *Zhak-Benin Bosye* - teolog dhe predikator francez i shekullit XVII, ideolog i monarkisë absolute. *Dragonadat* - ekspedita ushtarake ndëshkimore që dërgonte mbreti Luigji XIV kundër hugenotëve gjatë viteve 80 të shekullit XVII.

10) ...*dilte më shumë ultramontan se galikan.* - *Ultramontanët* - ithtarë të nënshtrimit të kishës franceze ndaj Romës dhe përkrahës të pushtetit laik të papës. *Galikanët* - ithtarë të pavarësisë së kishës franceze.

11) *Të njëqindditët* - koha e sundimit të dytë të Napoleonit mbasi u kthye në Francë prej ishullit Elba në vitin 1815.

12) *"Më mirë të vdes sesa të mbaj mbi zemrën time të tre zhabjakët!"* Burbonët e mbajtën Urdhrin e Legjionit të Nderit, që kishte vënë në përdorim Napoleoni, por figurën e Napoleonit në anën e parme të urdhrin e zëvendësuan me figurën e Henrikut IV, kurse në anën e prapme vunë, në vend të shqiponjës, tre zambakë heraldikë. (Këto lule të kujtonin me trajtat e tyre tri zhaba, nga të cilat, sipas një versioni, rridhte ky vizatim i bërë në stemën e mbretërve të Francës.)

13) ...*mbajnë kotruven e Peretës mbi kokë.* - Pereta - personazh i një përralle të shkrimtarit francez Lafonten (shekulli XVII). Duke ëndërruar sa shumë pasuri do të grumbullonte ajo me paratë e fituara nga shitja e qumështit, gjatë rrugës për në treg, Peretës i ra kotruvja nga koka dhe bashkë me këtë u zhdrukën edhe ëndrrat e saj.

14) ...*"Tiridati"* (viti 1691) - tragjedi e Kampistronit, imitues i klasicistëve, prandaj dhe këtu është quajtur "Kornej i rremë".

15) ...*Prydomi ushtarak e fitoi rastësisht betejën...* - Zhozef Prydom - personazh i librit të Anri Moniesë me titull "Kujtimet e Zhozef Prydomit" (1857), tip i një borgjezi mendjengushtë dhe që bie në vetëkënaqësi; emri i tij ka marrë një kuptim të përgjithshëm.

16) ...*Svedenborgu e Paskali ranë në çmenduri.* *Svedenborgu* - filozof mistik suedez, shekulli XVIII, ka përshkruar halucinacionet e veta. *Paskali* (1623-1682) - matematikan, fizikan dhe filozof i njohur francez, i cili aty nga fundi i jetës së tij pësoi çrregullime psikike lidhur me fenë.

17) *Gjirit të Zhyanit.* - Më datën 1 mars 1815, Napoleon Bonaparti, pasi u arratis nga ishulli i Elbës, zbarkoi në gjirin e Zhyanit, në jug të Francës, dhe menjëherë i bëri thirrje ushtrisë dhe popullit.

18) ...*kryekomandanti i armatës së Italisë...* - Buona-Parte. -

Në fushatën e Italisë të viteve 1796-1797, trupat franceze ishin nën komandën e Napoleon Bonapartit. Bonapart është forma franceze e mbiemrit të vërtetë korsikan Buonaparte (që do të thotë një pjesë e mirë, fat).

19) *Klod Gei kishte vjedhur një bukë; Zhan Valzhani kishte vjedhur një bukë.* - Në novelën e Hygoit me titull "Klod Ge" (1834) është dhënë një skicë e parë e historisë së Zhan Valzhanit.

20) ...*pa...një savojas...* - Varfanjakët e Savojës, që është në kufi me Francën, shkonin për çdo vit me shumicë në Francë dhe bridhnin fshatrave dhe qyteteve duke kërkuar punë.

21) *Viti 1817 është viti të cilin Luigji XVIII... e cilësonte si vitin e njëzetedytë të mbretërimit të tij.* - Në bazë të Kushtetutës që i "falën" Francës Burbonët, viti i parë i Restaurimit (1814) u shpall viti i nëntëmbëdhjetë i mbretërimit të "ligjshëm" të Luigjit XVIII (duke e bërë numërimin prej vitit 1795, vit në të cilin vdiq Luigji XVII). Me këtë akt Burbonët i hiqnin vizë tërë periudhës së revolucionit dhe të sundimit të Napoleonit.

22) *Duka d'Angulem* - djali i madh i kontit D'Artua (më vonë mbreti Karli X); ishte komandant i trupave franceze ruajaliste në kohën kur hipi në fron Luigji XVIII. Në vitin 1823 ai ishte në krye të fushatës që organizoi Lidhja e Shenjtë kundër Spanjës revolucionare.

23) *Potie, Odri* - aktorë komikë francezë të gjysmës së parë të shekullit XIX.

24) *Zonja Saki* - akrobate; *Foriozo* - valltar në tel (fillimi i shekullit XIX).

25) *Zoti Delalo* - një nga krerët e kryengritjes ruajaliste kundër Konventës më 13 vandemer (5 tetor 1795); në kohën e Restaurimit u bë anëtar i dhomës së deputetëve.

26) *Plenie, Karbono dhe Toleron* - organizatorë të shoqatës së fshehtë bonapartiste "Patriotët".

27) ...*Talejrandi, shambelan i madh dhe abat Luizi.* - Princi Charl-Moris Talejrand (1754-1838) - diplomat i shquar francez, i njohur për politikën e tij krejt pa parim; në kohën e rinisë kishte qenë prift dhe qe bërë peshkop. Duke qenë pjesëmarrës aktiv i ngjarjeve të para të revolucionit, ai bëri madje edhe meshimin kur u kremtua përvjetori i parë i marrjes së "Bastijës" në vitin 1790. Abat Luiz, baroni Zhozef Dominik Luiz, më vonë ministër i Financave i Luigjit XVIII.

28) ...*dhe me gjurmë shqiponjash e bletësh...* - Shqiponjat që ishin vizatuar me flamurët e Napoleonit dhe bletët e arta që ishin qëndisur në mantelin e tij quheshin simbol i Perandorisë Napoleoniane.

29) *Kuvendi i Majit* - në kohën e feudalizmit ishte mbledhja e vasalëve për shpalljen e këtij apo atij akti të rëndësishëm; në kohën e Të njëqindtëve qe një paradë ushtarake dhe një mbledhje solemne e Trupit Legjislativ, organizuar nga Napoleoni në Fushën e Marsit, në Paris për të shpallur Kushtetutën e re, në të cilën ai bënte disa lëshime liberale për të tërhequr popullin në anën e vet.

30) *Volter-Tuketi* - Botuesi dhe librashitësi Tuke, i cili në të kaluarën kishte qenë oficer i ushtrisë napoleoniane, e shprehu urrejtjen e tij ndaj regjimit të Restaurimit duke botuar vepra të autorëve të opozitës, si edhe ato të iluministëve të shekullit XVIII - Volterit dhe Rusoit.

31) *...mbi atë fregatën fatale të "Meduzës", e cila duhej të mbulonte me turp Shomareiksin dhe me laudi Zherikonë.* - Në vitin 1816 anija franceze "Meduza" u mbyt; nga të njëqind e dyzet e tetë pasagjerët, që u munduan të shpëtonin me varka dhe me trape, shpëtuan vetëm 9. Kapiteni i "Meduzës" Shomareiksi u dërgua para gjyqit. Piktori Zheriko fitoi famë duke bërë tablonë "Trapi i Meduzës".

32) *Matyren Bryno* - biri i një këpucari, që e hiqte veten sikur ishte princi i Navarës (Luigji XVII); u burgos në vitin 1818.

33) *Zoti Belart njihej zyrtarisht si gojëtar.* - Belarti ka qenë prokuror i përgjithshëm, që fitoi nam të keq me egërsinë e vet gjatë kohës së terrorit të bardhë të Restaurimit.

34) *Dë Broeja, që do të thumbohej me sarkazëm nga Pol-Lui Kurieja.* - Broeja ka qenë prokuror në shumë procese politike të periudhës së Restaurimit, përfshirë këtu edhe procesin gjyqësor kundër Pol-Lui Kuriesë (1772-1825), shkrimtar pamfletist, që shkroi kundër reaksionit feudal në Francë satira të forta dhe therëse.

35) *U gjet edhe një Shatobrian i rremë, i quajtur Marshanji... një Marshanji i rremë i quajtur D'Arlenkur...* - Lui Antuan Marshanji është autor i epopesë reaksionare me titull "Galia politike (1813), ku ka imituar "Gjeniu e krishterimit" dhe "Martirët" e Shatobrianit. Charl D'Arlenkur, viskont, është një shkrimtar pjellor, por i klasit të tretë në kohën e Restaurimit, autor i poemës "Karoleida", ku ai u thurte lavdi Burbonëve.

36) *...Zonja Koten ishte shpallur shkrimtarja më e mirë e kohës.* - Sofia Koten (1773-1807) - shkrimtare franceze, autore romanesh dashurie e sentimentale, ndër të cilat përfshihen edhe "Klara Alba" dhe "Matilda"; ky roman i fundit shërbeu si subjekt i operës "Malek-Abel" të kompozitorit italian Kosta.

37) *...qyteti i Angulemit i gëzonte me ligj të gjitha privilegjet e*

një porti detar... - Ironia qëndron në atë që qyteti Angulem nuk është në det, por në lumin Sharantë.

38) *Frankoni* - pronar cirku në Paris.

39) *Zoti Paer, autor i Anjezës...* - Fernando Paer (1771-1839), kompozitor italian, operat e të cilit shfaqeshin në Paris. - "Anjezja" është vepra e tij më e mirë.

40) *"Shkurtabiqi i verdhë"* - revistë satirike letrare-teatrale, themeluar në vitin 1814 dhe mbyllur në vitin 1815 për shkak të përkrahjes së dhënë Napoleonit në kohën e Të njëqindtëve.

41) *Dukë dë Beri... të cilit ia kishte mbërthyer sytë Luveli.* Duka Dë Beri, djalë i dytë i kontit D'Artua (më vonë mbret i Francës, Karli X), të cilin Burbonët e konsideronin si trashëgimtar të mundshëm të fronit të Francës, u vra më 13 shkurt 1820 nga një punëtor lëkurëpunues me emrin Pier Luvel. Ky akt terrorist, i provokuar nga terrori i bardhë, që kishte shpërthyer gjatë viteve të para të Restaurimit, pruri si pasojë një egërsim më të madh të reaksionit.

42) *Zonjusha Mars (1779-1847)* - aktore e famshme franceze.

43) *Formati ishte i kufizuar, por nuk ishte e kufizuar liria.* - Kjo "Liri" fiktive e shtypit borgjez pruri heqjen e përkohshme të çensurës paraprake (çensurë e cila u rivendos mbas vrasjes së Dukës Dë Beri në vitin 1820).

44) *"Konstitucionali"* - një nga gazetatat më popullore të grupit "të majtë" (liberalë të moderuar) të borgjezisë në periudhën e Restaurimit.

45) *Shatobrian, Fransua Rëne, viskont (1768-1848)* - shkrimtar reaksionar francez, që u shpreh kundër letërsisë dhe filozofisë iluministe të shekullit XVIII ("Një sprovë mbi revolucionet", "Gjeniu i krishterimit"), kreu i romantizmit reaksionar (novelat "Rëne", "Atala"). Mbiemri Shatobrian (Chateaubriand) kumbon i përafërt me emrin e një gjelle; me fileto prej mishi kau me një garniturë patatesh (chateaubriant); këtu pikërisht bazohet loja e fjalëve që ka teksti i romanit.

46) *...Davidi s'kishte më talent, Arnolti s'kishte më mendjemprehtësi, Karnoti s'kishte më përpikmëri...* - Zhan-Lui Davidi (1748-1825) - piktor klasikist i shquar francez; pjesëmarrës i revolucionit dhe anëtar i Konventës; në kohën e Restaurimit rrojti në mërgim. Arnolt (1766-1834) - dramaturg dhe fabulist. Karno (1753-1823) - aktivist i shquar i Konventës dhe i Komitetit të Shpëtimit Publik, kundërshtar i bindur i despotizmit politik, të cilin Burbonët e dëbuan nga Franca.

47) *Sult (1769-1851)* - mareshal i ushtrisë franceze, që fitoi famë

në betejën e Austerlicit dhe korri një sërë fitoresh në Spanjë.

48) ...Luigji XVIII, i mbiquajtur "autor i pavdekshëm i Kartës". - Në vitin 1814 Luigji XVIII i "fali Francës" një kartë - një kushtetutë, në bazë të së cilës aristokracia e madhe e ndante pushtetin e saj me shtresën e lartë të borgjezisë tregtare dhe financiare.

49) ...mbi piedestalin që priste statujën e Henrikut IV... Në fillim të Restaurimit, Burbonët i dhanë rëndësi të madhe kultit të mbretit Henriku IV (që ka mbretëruar nga viti 1589-1610), si themelues i dinastisë së tyre. Në vitin 1819 u ngrit përsëri statuja e tij, që ishte rrëzuar në kohën e revolucionit.

50) "I duhet shkruar Bakotit". - Baroni Bakot *dë* Roman, një ruajalist i tërbuar, anëtar i "Dhomës së Pashembullit" reaksionare të viteve 1815-1816.

51) "Gjilpëra e Zezë" - një shoqëri e fshehtë e borgjezëve liberalë, që ishin kundërshtarë të Restaurimit; procesi gjyqësor kundër pjesëmarrësve të saj u bë në vitin 1817.

52) Zoti Dekaz. - Dekaz - kryeministër i Luigjit XVIII, i cili në fillim të Restaurimit manovroi ndërmjet liberalëve dhe ultraruajalistëve. Këta të fundit, duke u përpjekur ta rrëzonin Dekazin, organizuan kundër tij "komplotin e bregdetit"; gjatë viteve të mëvonshme Dekazi u bë edhe vetë një reaksionar i tërbuar.

53) Kritika, që kishte mjaft autoritet, çmonte më shumë Lafonin sesa Talmën. - Fransua Zhozef Talma (1763-1826) - aktor tragjik me famë, që u bë i njohur gjatë kohës së revolucionit. Edhe Lafoni ishte një aktor i madh; ai ishte kundërshtar i Talmës.

54) *Dë Feleci nënshkruante A., Hofmani nënshkruante Z.* - Fransua Hofman - gazetar, kritik dhe dramaturg francez. Charl-Mari-Feleci ishte kritik; në vitin 1817 që të dy luajtën një rol të dukshëm në gazetën "Zhurnal *dë* Deba", që mbante atëherë një qëndrim ruajalist.

55) Charl Nodje (1780-1844) - shkrimtar francez, një nga figurat qendrore të lëvizjes romantike të fillimit të viteve njëzetë të shekullit XIX.

56) Mbreti i Romës - djali i vetëm i Napoleonit dhe i bijës së perandorit të Austrisë, Mari-Luizës, i cili mori pas lindjes titullin "Mbret i Romës"; kur ra Napoleoni nga fuqia, ai u dërgua bashkë me nënën në kështjellën austriake të Shënbrunit, jo larg Vjenës, ku jetoi me emrin e dukës së Rajshtatit.

57) Invalidët - një pallat në bregun e majtë të lumit Senë, ndërtuar në shekullin XVII nga mbreti Luigji XIV për aristokratët që sakatoheshin ndër beteja. Në shekullin XIX atje u vendos Biblioteka dhe Muzeumi i Luftës.

58) *Trënkëlagu* - politikan i dorës së dytë, reaksionar.

59) Klozel *dë* Kuserg (anëtar i parlamentit), Klozel *dë* Mental (prift) - dy vëllezër, politikanë reaksionarë të kohës së Restaurimit, që ishin ultraruajalistë.

60) Charl Salaberi - një nga organizatorët e terrorit të bardhë në fillim të Restaurimit.

61) Lui-Fransua Pikar - aktor dhe dramaturg francez shumë popullor në kohën e Restaurimit.

62) Kynie *dë* Montarlo - politikan i periudhës së Restaurimit, që ishte në opozitën liberale kundër qeverisë së Burbonëve, pjesëmarrës i dy komplotëve kundër tyre. Luftoi në anën e spanjollëve kundër trupave të dukës së Angulemit dhe u pushkatua prej këtij të fundit më 1824.

63) Fabvieri ishte rebel; Bavui ishte revolucionar. - Fabvieri, Bavui - profesorë-juristë liberalë, që ishin shumë popullorë në rrethet studenteske të Parisit gjatë viteve 20 të shekullit XIX.

64) Charl Luazon - letrar reaksionar, që paraqiti në konkursin e organizuar për të hyrë në Akademinë Franceze një përmbledhje poezish kushtuar mbretit, Luigjit XVIII.

65) Në Akademinë e Shkencave kishte një Furie të famshëm. Është fjala për baronin Zhan-Batist-Zhozef Furié (1768-1830), një gjeometër i shquar, që rridhte nga e njëjta familje prej së cilës rridhte utopisti i madh.

66) David *d'Anzher* - Pjer-Zhan (1788-1856), skulptor i shquar francez.

67) Felisite Rober Lamëne (1782-1854) - një nga teoricienët dhe militantët kryesorë të socializmit të krishterë gjatë viteve 30-40 të shekullit XIX.

68) Lagjja "Sen-Zhermën" dhe pavijoni "Marson"... - Lagjja "Sen-Zhermën" është rajoni aristokratik i Parisit. Pavijoni "Marson" është njëri krah i pallatit mbretëror të "Tyilërive", ku në kohën e Restaurimit jetonte Duka *dë* Beri; vend i përhershëm ku mblidheshin reaksionarët ekstremistë (ultraruajalistët).

69) Ruqajer-Kolar - kreu i grupit politik të "doktrinerëve", monarkistë të moderuar në kohën e Restaurimit.

70) Blyher - feldmareshal prusian i kohës së luftërave napoleoniane, i cili luajti një rol të rëndësishëm në betejën e Vaterlosë.

71) Kasteni... Edm-Samuel Kasten, mjek francez, që u ekzekutua në vitin 1823, sepse u akuzua se kishte helmuar dy miq të tij, me qëllim që t'u merrte pasurinë.

72) "Nisja për në Siterë" - një tablo e Vatosë (1684-1721), piktor

i madh i rokokosë franceze. *Lankré* - mik i Vatosë, piktor i po asaj rryme; ai u quajt "artist i festave galante".

73) *Onore D'Yrfe* - shkrimtar francez i shekullit XVII, autor romanesh baritore.

74) *Tyrkaretin, të shndërruar në Priap*. - Tyrkareti, një shërbëtor i pasuruar, i cili u bë tagrambledhës i përgjithshëm; personazh i komedisë me të njëjtin titull të shkrimtarit Lësazh (1807). *Priapi* - perëndi e epshit në mitologjinë greke.

75) *Greze (Zhan Batist)* (1725-1805) - piktor francez, autor tablosh sentimentale të marra nga jeta e borgjezisë.

76) *Jepini një heshtë, dhe keni për të parë po s'e bëri 10 gushtin* - 10 gushti i vitit 1792 është dita e kryengritjes popullore, si rezultat i së cilës Franca u shpall republikë.

77) *Gryka e Kaudinave* - vendi i një beteje vendimtare gjatë së cilës ushtria romake u thye prej samniteve (viti 321 para erës së re).

78) *Grimond dhe la Reinieri është i një mendjeje me Talejrandin*. - Është fjala për shprehjen cinike të Talejrandit, drejtuar politikanëve: "Kryesorja është ca më pak zell". *Grimond dhe la Reinier* - letrar francez i mbarimit të shekullit XVIII dhe i fillimit të shekullit XIX, autor i një "Kalendari llupësish", vepër komike me tetë vëllime.

79) *...një vendim heroik dhe jep dorëheqjen si Sila ose si Origjeni!...* - Luc Kornel Sila (138-78 para erës sonë) - prijës ushtarak romak dhe burrë shteti, që njihet në histori si një uzurpator i egër. Një vit para se të vdiste, Sila hoqi dorë nga pushteti dhe u kthye në jetën private. Origjeni - filozof kristian i shek. II-III; gjatë persekutimeve të kishës së Aleksandrisë në vitin 216, iku në Palestinë.

80) *Dezozhieri* - autor vodevilësh dhe këngësh; ai kryesonte në fillim të shekullit XIX mbledhjet gazmore të rrethit letrar "Taverna e Kohës Sonë".

81) *Arno Berken* - shkrimtar francez i fundit të shekullit XVIII dhe i fillimit të shekullit XIX, autor veprash fetaro-moraliste mjaft popullore për fëmijë. *Zhozef Bershu* - poet i dorës së dytë i së njëjtës kohë, autor i poemës komike "Gastronomia".

82) *Aspasia* - mikeshë e sundimtarit të Athinës, Perikliut, (shekulli V para erës sonë), ajo shquhej për zgjuarsin dhe për bukuri. Në shtëpinë e saj mbledheshin njerëzit më të famshëm të kohës, ndër të cilët edhe filozofi Sokrat.

83) *Manon Lesko* - një kurtizane tërheqëse, heroinë e romanit të shkrimtarit francez abatit Prevo: "Historia e kalorësit Dë Grie dhe e Manon Leskosë" (1733).

84) *Ne po ikim në krahët e Lafitit dhe mbi flatrat e Kajardit* -

domethënë do të sulemi drejt pasurisë me anë të karrierës juridike. Lafiti - bankier parizian, që luajti një rol të dukshëm në vendosjen e mbretit borgjez Luigj-Filipit të Orleanit. Gjatë Monarkisë së Korrikut ai qe kryeministër, pastaj ministër i Financave. *Kajardi* - avokat i shekullit XVII. Duke lakmuar pasuri, merrej me proceset gjyqësore më të ndërlikuara.

85) *Homeri do të kishte lidhur aty Polifemin dhe Shekspiri Kalibanin*. Kalibani - një përbindësh i shëmtuar ("Shtrengata" e Shekspirit).

86) *...romani i hershëm klasik, i cili, pasi pati qenë "Klelia"...*, "Lodoiska"... - "Klelia" - roman i shkrimtares franceze të shekullit XVII, zonjushës Skuderi, vepër që është njëfarë manuali për mirësjelljen në shoqëri dhe për dashurinë në sallonet mondane. "Lodoiska" - vepër e Filiet-Lorosë, që ka dhënë subjektin për operat me të njëjtin emër të Krajcerit dhe të Kerubinit.

87) *Zonja Dë Lafajetë* - shkrimtare franceze e shekullit XVII, autore romanesh psikologjike dashurie.

88) *Zonja Burnon - Malarme* - romanciere e dorës së tretë në fillim të shekullit XIX.

89) *Pamela* - heroinë e romanit me të njëjtin emër të shkrimtarit anglez Riçardson, personifikim i virtytit borgjez.

90) *Dykre-Dyminil* - autor romanesh të verdha, komedish dhe melodramash, që kanë qenë shumë popullore në Francë aty nga fillimi i shekullit XIX.

91) *...asaj fuqie të mistershme, ... këtu e dy mijë vjet të shkuar, - një të dënuari tjetër: "Shko!"* - është fjala për legjendën kishtarë të Çifutit të Përjetshëm; sipas një versioni të saj, këpucari Agasfer e dëboi në mënyrë brutale Jezun Krishtin, që ishte ndalur te shtëpia e tij gjatë rrugës për në vendin e ekzekutimit; ai e dëboi me fjalët: "Shko, shko!", dhe Krishti iu përgjigj: "Unë do të ndalem dhe do të pushoj, kurse ti do të shkosh". Dhe që atëherë Agasferi u dënua me shtegtime të përjetshme si endacak.

92) *"Drapeau blanc"* - gazetë monarkiste shumë reaksionare, organ i partisë së ultrarajalistëve.

93) *Lënotri* - kopshtar-dekorator i shekullit XVII, rregullues i kopshteve mbretërore të Versajës, Fontenëblosë etj., i cili vendosi stilin e së ashtuquajturave parqe "franceze".

94) *Edikti i Nantës*. - Edikt i shpallur më 13 prill 1598 nga mbreti Henriku IV, që i dha fund formalisht periudhës së luftërave fetare në Francë; katolicizmi u njoh si fe shtetërore, por protestantëve (hugenotëve) iu njoh liria e besimit dhe e shërbimit fetar (me

përrjashtim të Parisit dhe të disa qyteteve të tjera). Shfuqizimi i Ediktit të Nantës nga Luigji XIV në vitin 1685 bëri që hugenotët të emigronin në masë jashtë Francës.

95) *Abukir* - fshat në bregdetin e Egjiptit, vend ku më 1 gusht 1798 u zhvillua një betejë detare në të cilën anglezët asgjësuan flotën franceze dhe e shkëputën ushtrinë e Bonapartit nga Franca.

96) *Salvator Roza* (1615-1673) - piktor italian, autor i një vargu tablosh ku përshkruhen betejat. *Gribovali* - inxhinier ushtarak francez i gjysmës së dytë të shekullit XVIII, i cili bëri një sërë perfeksionimesh në artileri.

97) *Van Der Mëleni* (1634-1650) - piktor i shkollës flamande, artist oborrtar i Luigjit XIV, i specializuar në gjininë e betejave; ka bërë tablo që shquhen për një saktësi skrupuloze të detajeve dhe për një ngjashmëri të madhe portretale të personazheve.

98) *Kjo ijep Folardit të drejtë ta kundërshtojë Polibin*. - *Folardi* (1669-1752) - strateg francez, autor i "Komentareve" për "Historinë universale" të historianit grek Polibit (shek. III-II para erës sonë), ku përshkruhen luftërat e romakëve të vjetër, formacionet e tyre ushtarake, si edhe disiplina e tyre.

99) *Zhan Batist Sharas* (1810-1865) - shkrimtar ushtarak francez, armik i bonapartizmit. Mbas grushtit të shtetit të Luigj-Bonapartit, u dëbua nga Franca njëherësh me Hygoin dhe u persekutua edhe ai prej reaksionit evropian. Pothuajse në të njëjtën kohë me "Të mjerët", në Bruksel u botua edhe libri i Sharasit me titull "Historia e fushatës së vitit 1815", që përbën të parën përpjekje serioze për të demaskuar legjendën napoleoniane. Në përshkrimin dhe interpretimin e betejës së Vaterlosë, Hygoi është mbështetur në punimet e Sharasit, të cilat i njihte mirë, dhe njëkohësisht ka polemizuar me të.

100) *Uelingtoni u thërriste shokëve të tij të vjetër të luftës në Talaver, Vitoria dhe Salamankë*. - Në periudhën e luftërave që bëri Napoleoni në Spanjë, trupat angleze të komanduara nga Uelingtoni luftuan në anën e spanjollëve kundër forcave franceze. Në betejat e Talaverit (1809), Vitories (1813) dhe Salamankës (1812) francezët u zbrapsën para trupave të Uelingtonit.

101) *Qesh Cezari, Pompeu qan*. - Gnei Pompeu (106-48) para erës sonë) - strateg dhe burrë shteti romak, përfaqësues i shtresave reaksionare të shoqërisë së vjetër romake; u mund nga Jul Cezari mbas një lufte civile të gjatë dhe të përgjakshme.

102) *...manovra e kotë e Piresë...* - Gjenerali Epolit Pirè, në betejën e Vaterlosë, komandonte kalorësinë në krahun e djathtë të

ushtrisë napoleoniane. Ai mundi ta nxirrte repartin e vet jashtë zjarrit të armikut dhe ta drejtonte në Paris. Rrugës, në afërsi të Versajës, Pireja shpartalloi një detashment husarësh prusianë, gjë që ishte e kotë për shkak të disfatës së francezëve në Vaterlo.

103) *...Vonesa e Grushiut*. - Emanuel Grushi, mareshal i Napoleonit, i cili në Vaterlo komandoi kalorësinë e rezervës dhe mori urdhër t'i ndiqte prusianët e thyer më 16 qershor afër Linjisë. Në sajë të një vargu rrethanash të rastit, Blyheri mundi të shkëputej nga Grushiu dhe arriti më 18 qershor në fushën e betejës së Vaterlosë, ku u erdhi në ndihmë anglezëve, përpara se Grushiu të bashkohej me Napoleonin. Prandaj Napoleoni e quante Grushiun fajtor për disfatën e vet.

104) *...kur ke prapa Berezinën, Lajpcigun dhe Fontenëblonë...* Kalim i Berezinës (nëntor 1812), gjatë të cilit gjetën vdekjen dhjetë mijë ushtarë francezë, plotësoi shpartallimin e ushtrisë napoleoniane gjatë tërheqjes së saj nga Rusia. Beteja afër Lajpcigut (më 16-19 tetor 1813) ("beteja e popujve") ndërmjet ushtrisë së Napoleonit dhe trupave të aleatëve mori fund me tërheqjen e Napoleonit, i cili humbi rreth 65 mijë njerëz; më 6 prill 1814, pasi kapitulloi Parisi para ushtrisë së aleatëve, që numëronte më shumë se 100 mijë ushtarë, në Kështjellën e Fontenëblosë, Napoleoni nënshkroi heqjen dorë nga fronti dhe mbas kësaj u dërgua në ishullin e Elbës.

105) *...Kështu merrej haku i Kresit, Puatjesë, Malplaketit dhe i Ramilisë*. - Gjatë Luftës 100-vjeçare me Anglinë, në betejat e Kresit (1346) dhe të Puatjesë (1356), trupat franceze u thyen nga anglezët. Gjatë së ashtuquajturës luftë për trashëgimin spanjoll, trupat e mbretit të Francës, Luigjit XIV, pësuan disfata të rënda në betejat me forcat angleze afër Malplaketit (1709) dhe Ramilisë (1706).

106) *Njeriu i Marengos i hiqte vizë Azenkurit*. - Është fjala për fitoren e trupave napoleoniane mbi austriakët në 14 qershor 1800, në betejën e Marengos. Më 25 tetor 1415 mbreti i Anglisë, Henriku V, në betejën e Azenkurit i theu plotësisht forcat e francezëve, që ishin eprore në numër.

107) *Myrati mungonte, por Neji ishte aty*. - Joakim Myrati (1769-1815) - mareshal i ushtrisë napoleoniane, u bë kunat me Napoleonin dhe hipi në fronin e mbretërisë së Napolit. Kur mori vesh se Napoleoni ishte arratisur nga ishulli i Elbës, Myrati marshoi papritmas kundër austriakëve dhe u thye përpara se Napoleoni vetë të niste veprimet luftarake. Napoleoni mendonte se do ta kishte fituar betejën e Vaterlosë sikur të kishte qenë ushtria e Myratit me të. *Mishel Neji* (1769-1815) - mareshal i Napoleonit, pjesëmarrës i të gjitha

fushatave të tij më të mëdha; para se të abdikonte Napoleoni, u hodh në anën e Burbonëve. Në periudhën e Të njëqindditëve, së bashku me një grup trupash mbretërore, u hodh prapë me Napoleonin dhe luftoi në Vaterlo në anën e tij. Mbas rënies së Perandorisë për herë të dytë, iku në Zvicër, mirëpo u kap dhe më 7 dhjetor 1815 u pushkatua me vendim të Dhomës së Parëve.

108) *Këta skocezë udisnin duke çuar mendjen te Bel Lotiani, ashtu si bënin dikur grekët duke kujtuar Argosin.* - Lotiani është një krahinë e Skocisë, por përmendet këtu si simbol i atdheut për skocezët, ashtu sikundër ishte qyteti Argos për grekët e vjetër.

109) *...habiti Klintonin, i cili kishte parë edhe betejat e Talaverës dhe të Badajozit.* - Talavera - shih shënimin 100 - Badajozit - një qytet spanjoll, ku u zhvillua një betejë e ashpër midis trupave franceze dhe spanjollëve, të cilët nuk i nënshtroheshin Napoleonit.

110) *Ky panik... pushtoi edhe princin e Kondesë në Malinë dhe Luigjin XVIII në Gand.* - Princi Kondé (Luigj-Zhozef Burbon) ishte kryekomandant i ushtrisë kundërrevolucionare të aristokratëve francezë të arratisur jashtë. Luigji XVIII e caktoi atë si komandant të të gjitha forcave të këmbësores. Gandi është një qytet i Belgjikës ku u arratis Luigji XVIII në kohën e Të njëqindditëve.

111) *Myfling* - feldmareshal prusian, që luftoi në ushtrinë e Blyherit; autor i disa punimeve ushtarako-historike, ndër të cilat figuron edhe "Historia e betejave të ushtrisë së Uelingtonit dhe Blyherit në vitin 1815" (1817).

112) *Ulmi, Vagrami, Jena dhe Fridlandi* - vende betejash ku Napoleoni ka korrur fitore. Në Ulm (20 tetor 1805) kapitulloi ushtria austriake; në Vagram (5-6 korrik 1809) u shpartalluan përsëri trupat austriake; në betejën e Jenës (14 tetor 1806) u asgjësua faktikisht ushtria prusiane; në betejën e Fridlandit afër Keningsbergut (14 qershor 1807) Napoleoni theu trupat ruse të komanduara nga Beningseni.

113) *Pjer Zhan Etjen Kambron* (1770-1842) - një nga oficerët më të afërt të Napoleonit. U bë gjeneral, e shoqëroi Napoleonin në ishullin e Elbës dhe mori pjesë aktivisht në organizimin e kthimit të tij në Francë, komandoi repartet e gardës së vjetër në Vaterlo.

114) *Ti kthesh një përgjigje të tillë katastrofës...* - Historianët e kohës së Hygoit thoshin se Kambroni ishte përgjigjur ndryshe: "Garda vdes, por nuk dorëzohet". Hygoi e hodhi poshtë këtë version, duke e konsideruar si një zbulim të faktit historik. Në materialet për romanin gjendet një shënim i tillë: "Kambroni. Për ç'arsye e kam vënë unë këtë fjalë të ndyrë? Ajo ka hyrë me të drejtë në librin tim. Kjo

është një fjalë e përbuzur. Por do të vijë një ditë kur, duke u ngritur deri në heroizëm, do të shndërrohet në një predhë. Fjala që shpreh përbuzje kryen një vepër të madhe. Unë konstatoj një fakt."

115) *Rozhe të Lili gjen "Marsejezën"...* - Muzika dhe fjalët e këngës revolucionare të "Marsejezës" u kompozuan në valën e entuziazmit patriotik prej kapitenit të xhenjos Rozhe të Lil, natën duke u gdhirë 24 prilli i vitit 1792, në Strasburg; ai sapo kishte marrë lajmin e krijimit të koalicionit të shteteve evropiane kundër Francës revolucionare.

116) *Kleberi* - gjeneral francez, që mori pjesë në fushatën egjiptiane të Napoleon Bonapartit dhe që pastaj u bë kryekomandant i forcave franceze në Egjipt.

117) *Zhomini* (1779-1869) - strateg dhe takticien i njohur, zviceran nga origjina; ai që në shërbim të Napoleonit. Ka shkruar një "Histori të fushatave napoleoniane" në shumë vëllime.

118) *Uelingtoni ishte Baremi i luftës...* - Baremi (Shek. XVII) është autor i "Librit të llogaritjeve", i një vargu Manualësh për veprimet monetare dhe i "Lavdërimit të parave" në poezi. Në Francë emri i tij u bë simbol i përdorimit me shkathtësi të aritmetikës së aplikuar.

119) *Kukumjaçka e vjetër krisi e iku përpara fajkoit të ri.* - Në vitin 1796, gjatë luftës në Spanjë, Napoleoni e theu tri herë gjeneralin austriak Vurmser, duke i përforcuar në këtë mënyrë pozitat e tij në karrierën ushtarake.

120) *..fushave të përkohshme të Filipit.* - Është e qartë se këtu bëhet fjalë për betejën në Filipi të Maqedonisë, gjatë luftës civile në Romën e lashtë (viti 42 para erës sonë); në këtë betejë Bruti u thye prej Antonit. Dëshmitar i kësaj beteje që poeti Horaci (dhe jo Virgjili, siç thotë Hygoi).

121) *...është 14 korriku i 1789 i sulmuar nga 20 marsi 1815...* - 14 korriku i vitit 1789 është dita e marrjes së "Bastijës", 20 marsi 1815 është dita kur Napoleoni hyri në Paris, mbasi u kthye prej ishullit të Elbës.

122) *Bonaparti vë një karrocier në fronin e Napolit dhe një rreshter në fronin e Suedisë...* - Mareshali Myrat, që hipi në fronin e Napolit në vitin 1808, ishte i biri i një hotelxhiu dhe karrierën e vet ushtarake e nisi si ushtar i thjeshtë. Mareshali i Napoleonit, Bernadoti, bir i një avokati, që në të kaluarën kishte qenë edhe ai një ushtar i thjeshtë, në vitin 1810 u zgjodh regjent dhe në vitin 1818 hipi në fronin e Suedisë (me emrin Karli XIV).

123) *Fuai bie në Hugomont dhe ngrihet përsëri në tribunë.* -

Gjenerali i ushtrisë napoleoniane Maksimilian Fua, i plagosur në betejën e Vaterlosë, në kohën e Restaurimit u bë anëtar i dhomës së deputetëve, ku zuri një vend të dukshëm si orator i opozitës liberale (fjalimi për lirinë e individit dhe për lirinë e shtypit, 1820).

124) *Bearnezi* - nofkë e Henrikut IV, që ishte me origjinë nga provinca Bearnen.

125) *Tryeza prej pise e "Hartuellit"...* - "Hartuell" është një kështjellë që ndodhet 6 kilometra larg Londrës; atje banoi për shumë vjet me radhë Luigji XVIII Burbon para se të hipte në fronin e Francës.

126) *Buvin* - vend ku u zhvillua beteja e 27 korrikut 1214, në të cilën mbreti i Francës, Filipi II August, theu perandorin e Gjermanisë, Otonin IV. *Fontenua* - një fshat i Belgjikës; më 11 maj 1745, gjatë luftës për trashëgimin austriak, trupat franceze, nën komandën e Morisit të Saksonisë, u thyen dhe vunë këtu në ikje ushtrinë anglo-hanoveriane.

127) *Trestajon* - njëri nga krerët e bandave monarkiste që bënë kërdinë në krahinat jugore të Francës gjatë terrorit të bardhë në vitin 1815.

128) *...pak si i turpëruar ndoshta për Marengon dhe Arkolën, e hodhi lumin paq me statujën e dukës së Angulemit.* - Fitoret e Napoleonit në Marengo dhe në Arkolë (në Itali, në vitin 1796) i kundërvihen këtu ekspeditës ndëshkimore të Dukës së Angulemit në Spanjën revolucionare.

129) *Duka i Engienit* - princ i dinastisë së Burbonëve, që u pushkatua me urdhër të Napoleonit natën duke u gdhirë data 15 mars 1804.

130) *...me nenin 14 në zemër.* - Neni i 14 i Kartës së Luigjit XVIII thoshte se, ndër të drejtat e tjera të mbretit, përfshihej edhe e drejta për të ndarë të gjitha ofiqet shtetërore.

131) *Anglia vuri Hatson Lovin ta ruante dhe Franca vuri Montshenynë ta përgjonte Napoleonin.* - Hatson Lovi - guvernator i ishullit të Shën Helenës, ku u internua Napoleoni. Për mbikëqyrjen e Napoleonit në ishull gjendeshin vazhdimisht katër përfaqësues të fuqive evropiane, ndër ta edhe markezi Dë Montsheny, i plotfuqishmi francez.

132) *Patriarku i Ferneit* - kështu e quanin Volterin, i cili jetoi shumë vjet në çifligun e tij të Ferneit, afër kufirit me Zvicrën.

133) *Vileli* - vegël e ruajalistëve ekstremistë, i cili kryesoi nga viti 1821-1827 kabinetet reaksionare nën Luigjin XVIII dhe Karlin X.

134) *Rozhe Bakon* (1214-1294) - dijetar anglez, një nga shkencëtarët më të mëdhenj mesjetarë.

135) *Princi Dë Karinjan* - përfaqësues i fisit të princërve të

Savojes; në vitin 1823 mori pjesë në fushatën e Dukës së Angulemit kundër Italisë për të shtypur lëvizjen nacionalçlirimtare. Në vitin 1831 hipi në fronin e Sardenjës me emrin Karl Alberti. Me gjithë famën e tij si një mbret liberal, shtypi me egërsi lëvizjen republikane të "Italisë së Re" (1843).

136) *...flamuri tringjyrësh, valëvitej në dhé të huaj nga një grusht francezësh heroikë...* - Në kohën e fushatës së Dukës së Angulemit në Spanjë, në vitin 1823, një grup republikanësh francezë u bashkua me patriotët spanjollë dhe luftoi nën flamurin tringjyrësh kundër trupave ruajaliste franceze.

137) *...ashtu siç kishte qenë valëvitur flamuri i bardhë në Koblenc...* - "Koblenci" është një fortesë në krahinën prusiane të lumit Rin, e cila gjatë Revolucionit Borgjez Francez që vendi ku mblihdeshin emigrantët monarkistë, ajo ishte qendra e luftës kundër Republikës Franceze. *Flamuri i bardhë* ishte flamuri i Burbonëve.

138) *...më mirë të ketë përpara saj Rostopçinin sesa Balesterosin.* - Rostopçini në këtë rast është marrë nga Hygoi në mënyrë arbitrare si personifikim i Luftës Patriotike të popullit rus kundër Napoleonit të vitit 1812. Luftërat napoleoniane me Rusinë dhe Spanjën, ku ushtria franceze pësoi disfatë, u kundërvihen fitoreve të lehta të francezëve në Spanjë në vitin 1823, kur aristokracia reaksionare spanjolle dhe kleri, nga frika e revolucionit popullor, i hapi dyert e fortesave ushtrisë franceze, duke përfituar nga dobësia e qeverisë së përkohshme borgjeze të kryesuar nga Francisko Balesterosi.

139) *Andrianson Ryiteri* - admiral holandez i shekullit XVII.

140) *"Shuazi-lé-Rua"* - kështjellë mbretërore në afërsi të Parisit.

141) *Robert Stuart Kesëllri* (1769-1822) - politikan reaksionar anglez, një nga frymëzuesit kryesorë të Lidhjes së Shenjtë.

142) *Dy Bari* - favorite e plotfuqishme e Luigjit XV.

143) *...Ylbahu urau me kanë bareshën nga Ivria...* - Në vitin 1827 shërbëtori i një taverne të Parisit, i quajtur Honore Ylbah, vrau të fejuarën, e cila nuk e donte; ajo u quajt "Baresha e Ivries". Rreth figurës së saj lindi një legjendë; u ngrit për të edhe një përmendore në Sheshin e Laureshave.

144) *"Salpetrier"* - një spital i madh për gra në Paris, me një pavijon për të çmendura dhe me një strehë për plaka, i themeluar në shekullin XVII; ky spital që për një kohë të gjatë vendi ku mbaheshin të burgosura prostitutat dhe vjedhëset.

145) *"Bisetri"* - një spital i vjetër për meshkuj në Paris, me një pavijon psikiatrik dhe një shtëpi mbikëqyrjeje; spitali u themelua si shtëpi korrektimi për lypësit dhe endacakët.

PASQYRA E LËNDËS

PJESA E PARË

FANTINA

Libri i parë

Një njeri i drejtë

I.	Zoti Miriel.	7
II.	Zoti Miriel bëhet imzot Bienvény.	10
III.	Ipeshkvit të mirë, ipeshkvi të vështirë.	16
IV.	Si fjalët, punët.	18
V.	Sa kohë i rronin veladonët imzot Bienvényit.	22
VI.	Kush ia ruante shtëpinë.	24
VII.	Kravati.	29
VIII.	Ç'tregon motra për të vëllanë.	32
IX.	Ipeshkvi përpara një drite të panjohur.	36
X.	Një rezervë.	49
XI.	Vetmia e imzot Bienvényit.	53
XII.	Çfarë mendonte.	56

Libri i dytë

Rënia

I.	Mbrëmjen e një dite udhëtimi.	59
II.	Urtësisë i këshillohet maturi.	72
III.	Heroizmi i bindjes pasive.	75
IV.	Hollësira mbi baxhot e Pontarlierit.	81
V.	Qetësi.	84

VI.	Zhan Valzhani.....	86
VII.	Brendësia e dëshpërimit.....	91
VIII.	Vala dhe hija.....	99
IX.	Helme të reja.....	101
X.	Njeriu që zgjohet nga gjumi.....	102
XI.	Çfarë bën ai.....	105
XII.	Ipeshkvi punon.....	108
XIII.	Zhervezi i Vogël.....	112

Libri i tretë

Në vitin 1817

I.	Viti 1817.....	121
II.	Katërsh i dyfishtë.....	128
III.	Katër me katër.....	132
IV.	Tolomiesi është aq i gëzuar, sa këndon një këngë spanjolle.....	137
V.	Te "Bombarda".....	140
VI.	Kapitulli ku njerëzit adhurojnë njëri-tjetrin.....	143
VII.	Urtësia e Tolomiesit.....	144
VIII.	Ngordhja e një kali.....	151
IX.	Fundi gazmor i gëzimit.....	154

Libri i katërt

Të lësh amanet, disa herë do të thotë të dorëzosh.

I.	Një nënë që takon një nënë tjetër.....	157
II.	Vizatimi i parë i dy fytyrave të dyshimta.....	167
III.	Lauresha.....	169

Libri i pestë

Tatëpjeta

I.	Historia e një përparimi në industrinë e rruazave prej qelqi të zi.....	173
II.	Madëleni.....	175
III.	Shumat e vendosura te Lafiti.....	178

IV.	Zoti Madëlen në zi.....	181
V.	Vetëtimja të vagëta në horizont.....	184
VI.	Xha Foshëlëvani.....	189
VII.	Foshëlëvani bëhet kopshtar në Paris.....	193
VIII.	Zonja Viktyrnien shpenzon tridhjetë e pesë franga për moralin.....	194
IX.	Suksesit i zonjës Viktyrnien.....	197
X.	Vazhdimi i suksesit.....	200
XI.	Ç'është vallë kjo historia e Fantinës?.....	206
XII.	Zoti Bamatabua pa punë e pa zanat.....	207
XIII.	Zgjidhja e disa çështjeve të policisë bashkiake.....	210

Libri i gjashtë

Zhaveri

I.	Fillimi i çlodhjes.....	221
II.	Si mund të bëhet Zhani Shamp.....	225

Libri i shtatë

Çështja Shamatjë

I.	Mendjemprehtësia e usta Skoflerit.....	235
II.	Stuhi në shpirt.....	240
III.	Format që merr vuajtja gjatë gjumit.....	260
IV.	Gjalma nëpër këmbë.....	263
V.	Motra Semplis vihet në provë.....	276
VI.	Udhëtari që arrin, merr masa për të ikur përsëri.....	284
VII.	Hyrje për njerëz të zgjedhur.....	289
VIII.	Një vend ku janë duke u formuar bindje.....	292
IX.	Sistemi i mohimeve.....	300
X.	Shamatjëi çuditet shumë e më shumë.....	308

Libri i tetë

Kundërgoditje

I.	Në cilën pasqyrë zoti Madëlen vështron flokët e tij.....	313
II.	Fantina e lumtur.....	316

III.	Zhaveri i kënaqur.....	320
IV.	Pushteti i ligjshëm i fiton përsëri të drejtat e veta.....	324
V.	Varr i përshtatshëm.....	329

PJESA E DYTË

KOZETA

Libri i parë

Vaterloja

I.	Çfarë takon njeriu kur vjen nga Nivelat.....	337
II.	Hugomonti.....	339
III.	18 qershori i vitit 1815.....	346
IV.	A.....	349
V.	“Quid obscurum-i” i betejave.....	351
VI.	Ora katër pasdreke.....	355
VII.	Napoleoni është në qejf.....	358
VIII.	Perandori i bën një pyetje udhërrëfyesit Lakost.....	364
IX.	E papritura.....	367
X.	Rrafshina e Mon-Sen-Zhanit.....	371
XI.	Udhërrëfyes i keq për Napoleonin, udhërrëfyes i mirë për Bylovin.....	376
XII.	Garda.....	378
XIII.	Katastrofa.....	380
XIV.	Katrori i fundit.....	382
XV.	Kambroni.....	384
XVI.	Quot libras in duce?.....	386
XVII.	A duhet ta quajmë të mirë Vaterlonë?.....	392
XVIII.	Malcim i së drejtës hyjnore.....	394
XIX.	Fusha e betejës natën.....	397

Libri i dytë

Anija “Orion”

I.	Numri 24601 bëhet numri 9430.....	404
----	-----------------------------------	-----

II.	Ku do të lexoni dy vargje, të cilat ndoshta janë të djallit.....	407
III.	Vargoi i prangave duhej të kishte pësuar ndonjë farë pune përgatitore, përderisa u këput asisoj, me një të goditur të çekanit.....	413

Libri i tretë

Plotësimi i premtimit dhënë së vdekurës.

I.	Çështja e ujit në Monfermej.....	422
II.	Dy portrete të përkryera.....	426
III.	Njerëzit duan verë dhe kuajt ujë.....	431
IV.	Hyrja në skenë e një kukulle.....	434
V.	Vogëlushja mbetet fill vetëm.....	436
VI.	Këtu provohet ndoshta zgjuarsia e Bulatryelit.....	441
VII.	Kozeta krah për krah nëpër terr me të panjohurin.....	447
VIII.	S'ta ka ënda të presësh në shtëpi një të varfër, i cili ndoshta është i pasur.....	450
IX.	Tenardieja bën manovra.....	469
X.	Kush lakmon për më mirë, gjen më keq.....	477
XI.	Numri 9430 del përsëri në shesh dhe Kozeta e fiton në llotari.....	483

Libri i katërt

Karakatina “Gorbo”

I.	Usta Gorboi.....	485
II.	Folë për kukumjaçka dhe cirikoka.....	492
III.	Dy fatkeqësi së bashku sjellin lumturi.....	493
IV.	Vërejtjet e “qiraxheshës kryesore”.....	498
V.	Një monedhë pesëfrangëshe që bie përdhe e bën zhurmë.....	500
	Shënime.....	505